



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËSISË**



**Tezë për mbrojtjen e gradës
“Doktor”**

MËSIMDHËNIA E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË

(Nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)

Punoi:

Ma. Ragip GJOSHI

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. Mimoza GJOKUTAJ

Tiranë, 2015

Tezë për mbrojtjen e gradës
“Doktor”

MËSIMDHËNIA E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË

(Nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)

Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Mimoza GJOKUTAJ

Mbrohet ,më _____.____.2015 para jurisë:

1. _____, kryetar
2. _____, anëtar
3. _____, anëtar
4. _____, anëtar
5. _____, anëtar

DEKLARATË STATUSORE

Nën përgjegjësinë time, deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar më parë. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë autor tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

Nënshkrimi

Ragip Gjoshi

PËRMBAJTJA**KREU I**

MËSIMI I GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË- VËSHTRIM HISTORIK	1
1.1. Gjurmë të mësimit të gjuhës shqipe para Rilindjes Kombëtare Shqiptare	3
1.2. Mësimi i gjuhës shqipe në Kosovë, 1878-1918	5
1.3. Gjendja e arsimit në Kosovë, në zonat e administruara nga austro-hungarezët	13
1.4. Gjendja e arsimit në Kosovë, ndërmjet dy luftërave botërore, 1918-1941	16
1.5. Hapja e shkollave shqipe për mësimin e gjuhës shqipe, 1941-1944	20
1.6. Shtrirja e mësimit të gjuhës shqipe dhe sfidat në periudhën 1945-1966	27
1.7. Mësimi i gjuhës shqipe në shkollat e Kosovës, 1966-1981	30
1.8. Përpjekjet serbe për hartimin e “bërthamave të përbashkëta”, 1981-1989	33
1.8.1. Rëndësia e kundërshtimit të bërthamave “të përbashkëta” - Planet dhe programet mësimore për gjuhën shqipe	35
1.9. Hapat e parë të përafrimit kurrikular Kosovë-Shqipëri për gjuhën shqipe, 1990-1999	40

KREU II

KËNDVËSHTRIME NË DIDAKTIKËN E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË	45
2.1. Fillesat e mësimdhënies institucionale të gjuhës shqipe-periodizimi	46
2. 2. Praktika tradicionale e mësimdhënies të gjuhës shqipe, 1941-2000	50
2. 3. Ideologjizimi i tejskajshëm pesëdhjetëvjeçar i mësimdhënies së gjuhës shqipe	52
2. 3.1. Objekti i metodikës së mësimdhënies së gjuhës shqipe ndër vite në Kosovë	53
2. 4. Gjuha shqipe në shkollat tetëvjeçare dhe të mesme në Kosovë	55
2. 4.1. Planifikimi i lëndës së gjuhës shqipe	56
2. 4.2. Metodat mësimore në lëndën e gjuhës shqipe	57
2. 4.3. Parimet didaktike në lëndën e gjuhës shqipe	58
2. 4.4. Etapat e procesit të mësimdhënies tradicionale të gjuhës shqipe	59
2. 4.5. Mjetet mësimore në lëndën e gjuhës shqipe	64
2. 4.6. Kabineti i gjuhës dhe letërsisë shqipe, rëndësia e bibliotekës	64
2. 4.7. Personaliteti i mësimdhënësit të gjuhës shqipe dhe roli i tij	65
2.4. 8. Lektyra shkollore në raport me ndryshimet në mësimdhënien e gjuhës shqipe	67
2.5. Përpjekjet për reformimin e mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë	69
2.5.1. Teoria dhe praktika e mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë	70
2.6. Kompleksiteti përmbajtësor dhe didaktik i mësimdhënies së gjuhës shqipe	73

2.6.1. Integrimi i teorisë me praktikën mësimdhënëse	74
KREU III	
TRAJEKTORJA E ABETAREVE NË GJUHËN SHQIPE NË KOSOVË	77
3.1. Abetarja, libri i parë për formimin e shprehive të lexim - shkrimit	78
3.2. Abetaret gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare	82
3.2.1. Kontributi i klerit në hartimin e alfabeteve dhe të abetareve të gjuhës shqipe	82
3.3. Disa nga tekstet e veçanta të abetareve	85
3.4. Rrugëtimi i abetareve në Kosovë	90
3.4.1. Nga Abetarja e parë tek Abetarja e përbashkët Shqipëri – Kosovë	92
3.4.2. Bibliografi e Abetareve të para shqipe	93
3.5. Programet, metodikat dhe tekstet ndihmëse për abetare	100
3.5.1. Programet e abetareve dhe vendi i mësimi të lexim - shkrimit në planet mësimore	100
3.5.2. Metodatat e mësimi të abetares	101
3.5.2.1. Metodatat tradicionale të mësimi të lexim-shkrimit në Kosovë	103
3.5.2.2. Metodatat sintetike të mësimi të shkrim-leximit fillestar	105
3.5.2.3. Metodatat analitike të mësimi të shkrim-leximit fillestar	106
3.5.3. Disa aspekte të praktikave didaktike tradicionale për përdorimin e abetares	108
3.5.4. Plani dhe Programi mësimor për gjuhën shqipe, për klasën e parë në shkollat fillore (1973)	110
KREU IV	
PLANET DHE PROGRAMET E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË	114
(Nga periudha e Rilindjes Kombëtare deri në vitin 2014)	
4.1. Vështrim i përgjithshëm mbi programet mësimore dhe kurrikulën shkollore në Kosovë	115
4.1.1. Këndvështrim historik i kurrikulës së gjuhës shqipe në Kosovë	117
4.2. Planet dhe programet mësimore të gjuhës shqipe në Kosovë, 1915-2015	121
4.2.1. Plani mësimor austriak, 1915-1918	121
4.2.2. Plani mësimor i Mbretërisë të Jugosllavisë, mësimi i detyruar në gjuhën serbe, 1918-1941	122
4.2.3. Plani mësimor i Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë, 1941-1945	122
4.2.4. Planet dhe programet mësimore, vitet '60	127
4.2.5. Planet dhe programet mësimore, vitet '70	131
4.2.6. Planet dhe programet mësimore, vitet '80	137
4.2.7. Planet dhe programet mësimore, vitet '90	142
4.2.7.1. Plani dhe programi mësimor për kushte të jashtëzakonshme	145
4.2.8. Planet dhe programet mësimore, pas vitit 2000	152

KREU V

VËSHTRIM HISTORIK MBI MËSIMDHËNIEN E GRAMATIKËS NË KOSOVË	155
5.1. Mësimdhënia e gramatikës nga shek. XIX, deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore	156
5.2. Mësimdhënia e gramatikës në vitet 1945-1970	158
5.3. Mësimdhënia e gramatikës pas viteve '70	160
5.3.1. Programet e gramatikës së gjuhës shqipe për shkollat 8 vjeçare në Kosovë, vitet '60	162
5.3.2. Programet e gramatikës së gjuhës shqipe gjatë viteve 2000	165
5.4. Përvoja e shkollës së Kosovës në mësimdhënien e gramatikës	170
4.4.1. Norma letrare dhe roli i institucioneve për përgatitjen e kuadrove arsimore	171
5.5. Metodologjia e mësimin të gramatikës së gjuhës shqipe	173
5.5.1. Metodika e mësimdhënies së morfologjisë	173
5.5.2. Metodika e mësimdhënies së sintaksës	175
5.5.3. Metodika e mësimdhënies së drejtshkrimit	180
5.5.4. Modele planesh mësimore, klasa VIII	182
5.6. Roli i teksteve shkollore për mësimin e gramatikës	185
 KREU VI	
HARTIMI I TEKSTEVE TË GJUHËS SHQIPE	197
6.1. Historia e librit shkollor në Kosovë	198
6.1.1. Qasja metodologjike për hartimin e një teksti cilësor shkollor	200
6.1.2. Funkcionet e tekstit mësimor të gjuhës shqipe në rrethanat e kohës	201
6.2. Historiku i hartimit të teksteve mësimore të gjuhës shqipe dhe letërsisë, 1886 – 1943	205
6.3. Tekstet e gjuhës shqipe të periudhës deri në vitin 1945	207
6.4. Tekstet e letërsisë -Libri i leximit nga viti 1945 deri në vitin 2014	211
6.5. Hartimi i teksteve shkollore të gjuhës shqipe të viteve të 90-ta	214
6.5.1. Funkcioni i teksteve të gjuhës dhe letërsisë në formësimin atdhetar të nxënësve	215
6.6. Vendi dhe roli i teksteve të gjuhës dhe letërsisë shqipe nga viti 1945 deri në vitin 1961	220
6.7. Tekstet shkollore në vitet 1962 – 1969	223
6.8. Tekstet e gjuhës shqipe në vitet 1970-1991	224
6.9. Tekstet e gjuhës shqipe në vitet 1992-2000	227
6.9.1. Tekstet e gjuhës shqipe në vitet 1992-2000	232

KREU VII

STANDARDIZIMI I GJUHËS DHE FORMIMI GJUHËSOR E LETRAR NË KOSOVË	241
7.1. Shqipja standarde dhe mësimdhënia e gjuhës shqipe	242
7.1.1. Kodifikimi i gjuhës standarde	243
7.1.2. Rëndësia e Kongresit të Manastirit	244
7.1.3. Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës	249
7.1.4. Konsulta gjuhësore e Prishtinës	251
7.1.5. Kongresi i Drejtshkrimit, 1972	253
7.2. Statusi i shqipes standarde në Kosovë	257
7.3. Përdorimi i shqipes standarde në shkolla dhe institucione	258
7.3.1. Shkollat e hershme për përgatitjen e mësimdhënësve në Kosovë	261
7.4. Roli i shtypit pedagogjik në Kosovë për mësimin e gjuhës shqipe	267
KREU VIII	
KORNIZA E RE KURRIKULARE E KOSOVËS, RËNDËSIA PËR MËSIMIN E GJUHËS	278
8.1. Roli dhe rëndësia e gjuhës shqipe në Kornizën e Re Kurrikulare	279
8.1.1. Synimet e Kurrikulës së Re	279
8.1.2. Çasje të reja të mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë	281
8.2. Parimet e zbatimit të Kurrikulit të ri të Kosovës	281
8.2.1. Roli dhe funksioni i Kornizës së Re Kurrikulare	282
8.3. Kompetencat e të nxënësve sipas Kornizës së Re Kurrikulare	282
8.4. Aplikimi i Kurrikulës Bërthamë	285
8.4.1. Qëllimet dhe funksionet e fushës kurrikulare ‘Gjuhë dhe Komunikim’	285
8.4.2. Rezultatet e të nxënësve	287
8.4.3. Aspekte metodologjike dhe praktike të fushës kurrikulare ‘Gjuhë dhe Komunikim’	289
8.4.4. Materialet mësimore në zhvillimin e kompetencave për ‘Gjuhë dhe Komunikim’	295
8.5. Vlerësimi i nxënësve sipas Kurrikulës së Re	296
8.5.1. Vlerësimi i brendshëm	296
8.5.2. Vlerësimi i bazuar në kompetenca	299
Konkluzione dhe rekomandime	302
Shtojca	305
Bibliografi	312

Lista e tabelave

- Tabela 1.** Përmbajtjet mësimore dhe sasia e orëve javore të gjuhës shqipe në klasat I-V
- Tabela 2.** Abetaret e gjuhës shqipe në Maqedoni dhe në Mal të Zi
- Tabela 3.** Abetaret në diasporën e vjetër dhe të re shqiptare
- Tabela 4.** Orët mësimore sipas planit mësimor sintetik austriak për mësim gjuhe, 1915 – 1918
- Tabela 5.** Orët mësimore sipas Planit mësimor të Mbretërisë së Jugosllavisë, në gjuhën serbe, 1918-1941
- Tabela 6.** Orët mësimore sipas Planit mësimor të Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë, 1941-1945
- Tabela 7.** Orët mësimore sipas lëminjve
- Tabela 8.** Orët sipas Planit të ri mësimor i pasluftës së Dytë Botërore në Kosovë, 1944-1945
- Tabela 9.** Fondi i orëve sipas Planit i ri mësimor i pasluftës së Dytë Botërore
- Tabela 10.** Fondi i orëve sipas Programit të ri mësimor për shkollat fillore katërklasëshe, 1945
- Tabela 11.** Fondi i orëve në shkollat fillore të komunës së Mitrovicës
- Tabela 12.** Fondi javor të orëve mësimore sipas Planit dhe programit për shkollat në gjuhën shqipe, 1948/49
- Tabela 13.** Plani mësimor për gjuhë amtare dhe për gjuhë serbe (joamtare) i vitit 1962
- Tabela 14.** Fondi i orëve sipas Planit dhe Programit për shkollat fillore, 1964
- Tabela 15.** Fondi i orëve mësimore të gjuhës amtare sipas Planit dhe programit mësimor, 1971
- Tabela 16.** Fondi i orëve mësimore për gjuhë amtare sipas Planit dhe programit mësimor, 1977
- Tabela 17.** Fondi i orëve mësimore për lëndën gjuhë dhe letërsi shqipe i vitit 1985
- Tabela 18.** Fondi i orëve mësimore për lëndën gjuhë dhe letërsi shqipe i vitit 1990
- Tabela 19.** Disa nga Variantet e Planeve dhe programeve mësimore të gjuhës dhe letërsisë shqipe për kushte të jashtëzakonshme
- Tabela 20.** Emërtimet e lëndës së gjuhës shqipe gjatë historisë së arsimit shqip në Kosovë në periudhën 1941-1999
- Tabela 21.** Fondi javor i orëve të gjuhës shqipe sipas klasave dhe viteve 1941-2000
- Tabela 22.** Lëvizjet e sasisë së orëve brenda viteve dhe klasave I-IV
- Tabela 23.** Lëvizjet e sasisë së orëve brenda viteve dhe klasave V-VIII
- Tabela 24.** Fondi i orëve mësimore për gjuhë dhe letërsi shqipe, të vitit 1964.
- Tabela 25.** Fondi i orëve për klasën e VI, sipas kategorive
- Tabela 26.** Fondi i orëve për klasën e VIII, sipas kategorive
- Tabela 27.** Fondi i orëve për klasën e VIII, sipas kategorive
- Tabela 28.** Plani i shkoqitur mësimor (orientues) për Klasën e tetë (VIII) të shkollës fillore
- Tabela 29.** Plankonspekti i mësimdhënësve të gjuhës shqipe për një orë mësimore
- Tabela 30.** Librat e leximit dhe sintaksa të hartuara nga autorët serbë dhe malazes për nxënësit shqiptarë
- Tabela 31.** Tekstet e hartuara nga “Komisioni i posaçëm”
- Tabela 32.** Botimi i teksteve për arsimin fillor në gjuhën shqipe, sipas periudhave pesëvjeçare 1945-1950
- Tabela 33.** Pasqyrë e teksteve të reja sipas klasave dhe viteve
- Tabela 34.** Pasqyrë tabelare e teksteve të reja, 1992-1999
- Tabela 35.** Tekstet e djegura
- Tabela 36.** Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa parë
- Tabela 37.** Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa dytë
- Tabela 38.** Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa tretë
- Tabela 39.** Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa katërt
- Tabela 40.** Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa e pestë

- Tabela 41.** Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa e gjashtë
- Tabela 42.** Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa e shtatë
- Tabela 43.** Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa e tetë
- Tabela 44.** Numri i teksteve dhe autorët për shkollën fillore gjatë viteve 1945-1990
- Tabela 45.** Lëvizja e analfabetizmit të përgjithshëm dhe sipas gjinisë në Kosovë, sipas regjistrimeve të viteve 1921 – 1981
- Tabela 46.** Lëvizja e përqindjes së popullsisë analfabete të Kosovës sipas grup-moshave, sipas regjistrimeve të popullsisë 1948 – 1981
- Tabela 47.** Kompetencat kryesore dhe nënkompetenca të tjera operationale
- Tabela 48.** Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit
- Tabela 49.** Shembulli i fushës kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi
- Tabela 50.** Ndërlidhja e RNSH me RNF dhe RNL në klasën e dhjetë
- Tabela 51.** Plani mësimor (shembull i ndarjes së orëve, sepse shkolla vendos)
- Tabea 52.** Plani për shkallë kurrikulare / shkalla e pestë – klasa 10
- Tabela 53.** Hapat e planifikimit vjetor / shkalla 5 (klasa 10)
- Tabela 54:** Një model i Planit të orës mësimore të gjuhës shqipe
- Tabela 55.** Teknikat për mbledhjen e të dhënave (dëshmime)

HYRJE

Punimi “*Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë*”, (nga Rilindja Kombëtare Shqiptare deri në ditët e sotme), është një përpjekje e orientuar në përshkrimin dhe pasqyrimin e rrugës së gjatë e të mundimshme të brezave të tërë, që punuan për çështjen kombëtare, arsimin në gjuhën shqipe dhe kultivimin e gjuhës shqipe. Plejada të tërë atdhetarësh të devotshëm e me dinjitet, në udhën e shkronjave shqipe, kanë hartuar tekste për të vegjël e të mëdhenj, tekste letrare e shkencore, pedagogjike e didaktike. Shpesh, ata ishin mësimdhënës e autorë tekstesh njëkohësisht. Ata i gjen në përpjekje për krijim alfabetesh, abetaresh, librash shkollorë, çelje shkollash dhe ndër beteja e kryengritje. Mësimdhënia si profesion kudo del si mision i shpërndarësve të dritës. Mësimdhënia e hershme, deri në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, u përkiste shkollave dhe rrymave të ndryshme pedagogjike, derisa në gjysmën e shekullit XX u vendos mësimdhënia e ndikuar dhe e diktuar nga pozitat moniste e dogmatike. Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë ishte e pandashme nga mënyrat e mësimdhënies në gjithë trojet shqiptare deri në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë. Mësimdhënia e gjuhës shqipe në të gjitha periudhat historike, edhe në Kosovë, ishte e ndërlidhur me ruajtjen e identitetit kombëtar.

Ky punim studimor është një përpjekje për të ofruar fakte, të munguara deri tashti, nga këndvështrimi shkencor për mënyrën e mësimdhënies, trajtimin e problemeve didaktike dhe metodike në mësimdhënien e gjuhës shqipe, kryesisht në arsimin parauniversitar (*dikur shkolla fillore dhe e mesme*). Vëmendja e trajtesës do të përqendrohet në zhvillimin historik të rrjetit të shkollave në gjuhën shqipe në territorin e Kosovës, në zhvillimin e planeve e programeve mësimore të gjuhës shqipe, si dhe në çështjen e hartimit të teksteve mësimore për lëndën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe në periudha të ndryshme të zhvillimit të arsimit në Kosovë.

Krahas dimensioneve të shtrirjes së rrjetit të shkollave shqipe, vështirësive politike e shoqërore-ekonomike, duke trajtuar mësimdhënien e gjuhës shqipe, do të analizohen dhe parimet e organizimit të mësimdhënies, format, mjetet mësimore dhe vëllimi i njohurive dhe shprehive e aftësive praktike, metodat, strategjitë e mësimdhënies (*transmetimit të njohurive*).

Punimi “*Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë*” (Nga periudha e Rilindjes Kombëtare deri në ditët e sotme) u zgjodh për t’u hartuar, pasi çështjet e mësimdhënies të kësaj periudhe të vullshme historike janë çështje që nuk janë trajtuar në trajtesat e deritashme të historisë së gjuhës shqipe dhe të historisë së didaktikës së gjuhës shqipe. Ky punim, do të jetë një ndihmesë modeste për të sjellë të sintetizuar gjithë zhvillimet që kanë ndodhur në fushën e mësimdhënies dhe njëkohësisht të kodifikimit të gjuhës së shkruar shqipe dhe në zhvillimin evolutiv të mësimdhënies së gjuhës shqipe si lëndë mësimore, së bashku me ndikimin e sistemeve arsimore evropiane të kohës, si dhe bashkë me zhvillimin e planeve dhe programeve mësimore dhe të teksteve shkollore në arsimin që u zhvillua në gjuhën shqipe në territorin e Kosovës së sotme.

Mosndriçimi i kësaj problematike nga studiues të gjuhës dhe atyre të pedagogjisë historike të arsimit në gjuhën shqipe, në këtë trevë të trazuar përherë, për shkak të një robërie të rëndë, të pakrahasueshme, ka lënë nën pluhurin e arkivave e të kujtesës sonë fakte të dhembshme historike në Kosovë¹ (Dardani), përpjekjet sizifiane dhe punën kolosale në udhën e shkronjave shqipe, në udhën e ruajtjes së identitetit tonë, kulturor dhe kombëtar.

Gjatë kërkimeve disavjeçare, burimet e shfrytëzuara për këtë punim janë të shumta dhe të ndryshme. Në periudhën kohore, (nga Rilindja Kombëtare Shqiptare deri në ditët e sotme), kanë ndodhur një sërë zhvillimesh të rëndësishme për historinë tonë, për historinë e zhvillimit të gjuhës

¹ Isak Ahmeti, *Kosova*, Prishtinë, 1996.

shqipe dhe të mësimit të saj. Punimi iu kushtohet zhvillimeve kronologjike më të rëndësishme edukative dhe arsimore në Kosovë, nga thellësia e shekujve, duke trajtuar mesjetën, periudhën e sundimit otoman, austro-hungarez, bullgar, serb, italian e gjerman dhe, së fundi, sundimin e rëndë nën zgjedhën jugosllave.

Ky kërkim shkencor sjell të sintetizuar gjithë rrugën e vështirë të mësimdhënies së gjuhës shqipe. Në fokus të punimit është edhe analiza e veçantë e teksteve të gramatikave, që janë përdorur në gjithë nivelet e arsimit, metodikat e gjuhës, abetaret, librat e leximit, struktura e orëve dhe përgatitja e mësimdhënësve të gjuhës shqipe.

Në mbyllje të studimit do të paraqiten edhe zhvillimet bashkëkohore dhe krahasimi me përvojat perëndimore dhe bashkëpunimi me institucionet arsimore evropiane e më gjerë pas luftës, por duke nisur me zhvillimin e gjuhës letrare shqipe dhe të mësimdhënies së gjuhës shqipe që nga periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare e këtej².

I inkurajuar me punën sizifiane të rilindësve dhe të shumë misionarëve të dritës, në udhën e vështirë të përhapjes së shkronjave shqipe, që shëmbëllen shumë me punën e mësimdhënësve shqiptarë në Kosovë, u hulumtuan materiale të periudhave të ndryshme për veprimtarinë arsimore, politikën arsimore, planet dhe programet mësimore dhe atë të botimit të teksteve shkollore të gjuhës shqipe.

Periudha e studiuar në këtë punim është këndvështruar bashkërisht me zhvillimet në Shqipëri dhe në Kosovë, sepse ato kishin fat të përbashkët deri në vitin 1912. Janë shfrytëzuar arkivat e Tiranës dhe Prishtinës dhe në komunat e Kosovës, për veprat bibliografike, ku janë regjistruar me saktësi vepra të botuara të kësaj natyre, të periudhës kohore 1845-2014. Janë shfrytëzuar gjithashtu edhe shumë revista shqiptare, si dhe një sërë studimesh monografike për veprimtarinë arsimore të disa shkollave dhe komunave të Kosovës.³

Burime të informacioneve ishin dokumentet, shkresat, librat, botimet e shumta të natyrës arsimore, si: programe shkollore, ligje, udhëzime, akte ligjore të ndryshme, revista arsimore, gazetat e shumta, por dhe botime të historisë së arsimit në Kosovë, në Shqipëri e në Jugosllavi. Një burim i vlefshëm ishin dhe informacionet e siguruar nga interneti, ku gjeta botime që lidhen me historinë. Pa dyshim, dëshmia e gjallë (*bashkëbisedimi me shumë mësimdhënës veteranë*) është një fakt i pamohueshëm. Janë shfrytëzuar edhe intervista të bëra kohë më parë me ish-mësues dhe punimet e tyre pedagogjike, të botuara kryesisht tek "*Përparimi*" dhe "*Shkëndija*". Pa dyshim, që "*zemra*" e punimit është e lidhur ngushtë me zhvillimet e arsimit përgjithësisht në Kosovë dhe zhvillimin e metodologjisë së punës mësimore, zhvillimin e gjuhës standarde e të drejtshkrimit, si dhe të planeve dhe programeve mësimore dhe teksteve shkollore. Derisa historia e popullit shqiptar është e lidhur ngushtë me historinë e zhvillimit të shkollës shqipe, edhe historia e mësimit të gjuhës shqipe ka fat të përbashkët në të gjitha trevat ku flitet shqip. Përpjekja e këtij studimi është në shërbim të përgënjeshtimit të mendimit se në të kaluarën shqiptarët nuk kanë pasur kurrfarë shkollash.⁴ Dëshmi të dokumentuara flasin për periudha të përpjekjeve për zhvillim të letërsisë shqipe, hartim të abetareve, të teksteve mësimore, të arsimit dhe unifikim të alfabetit shqip. Siç dihet, trojet shqiptare ndodhen në një pozitë gjeopolitike tërheqëse, ku përplasen Lindja dhe Perëndimi. Këtë më së miri e ka thënë akademik Rexhep Qosja: "*Shqiptarët u gjendën në zgripin e Romës, Bizantit dhe Stambollit,*

² Shih më gjerë: Miço Samara, *Histori e shqipes letrare*, Tiranë 1984, ribotuar më 2005; Fadil Raka, *Historia e shqipes letrare*, Prishtinë 1997; A. Haxhi - T. Topalli, *Gjuhë e shkruar shqipe*, Shkodër, 1999.

³ Shih Islam Krasniqi, *Bibliografja*, Prishtinë, 2000; P. Daka, *Bibliografia retrospektive e shtypit periodik 1848-1944*, v. I, II, III, Tiranë 1984; P. Daka, *Bibliografi e studimeve dhe e artikujve në gjuhën shqipe*, Tiranë 1975.

⁴ Jashar Rexhepagiqi, *Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*, Prishtinë, 1970.

nën ndikimet e imperializmit të tyre shpirtëror dhe kulturor, politik dhe ushtarak".⁵T okat shqiptare nuk ishin vetëm një urë për të kaluar mbi të dhe për këtë fakt ajo ka qenë tërheqëse gjithmonë për synimet e pushtuesve.

Shkolla dhe gjuha shqipe, por edhe letërsia kishte një rol të rëndësishëm në lëvizjen kombëtare dhe kulturore. Ngritja e patriotizmit shqiptar forcoi planet kombëtare në sferën e zhvillimit të rrjetit të shkollave në gjuhën shqipe dhe në edukimin e rinisë shqiptare.

Ky studim vjen si një përpjekje për të hedhur dritë mbi këtë periudhë të errët të arsimit shqip në Kosovë e për të pasqyruar informacione, nga këndvështrimi didaktik për gjuhën shqipe dhe shkollën shqipe, në të gjitha epokat, duke u ndalur më gjatë në mësimdhënien e gjuhës shqipe në kohën e pushtimit të Jugosllavisë (*pjesë e së cilës kishte mbetur dhunshëm Kosova*) dhe të institucioneve të vendeve evropiane dhe më gjerë me bindjet se, "*Vetëm një kulturë kombëtare dhe një qytetërim më i lartë nga ai që kanë fqinjët tanë, do të mund të sigurojnë të ardhmen tonë*"⁶. Ai gjithashtu vjen si një trajtesë nga këndvështrime të ndryshme sipas elementeve të mësimdhënies së gjuhës shqipe, së bashku me jehonën e reformave, me ndikimet që ato patën në krijimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve në Kosovë, ku është vendur vokacioni perëndimor i mësimdhënies së gjuhës dhe praktikave të modeleve të mësuesve të kohës në sistemet arsimore evropiane dhe më gjerë. Mirënjohje dhe nderim për të gjithë mësuesit, drejtuesit e shkollave, të kohëve të guximshme dhe motivuese për arsimin dhe kombin. Në mënyrë të veçantë, në këtë parathënie, përmendim me shumë dashuri dy patriotë të mëdhenj, Hasan Prishtinën, për ndihmën që dha ai në hapjen e shkollës shqipe dhe në shkollimin e mësuesve nga Kosova në Normalen e Elbasanit, si dhe Ernest Koliqin, Ministrin e atëhershëm të Arsimit të Shqipërisë, për kontributin e madh që dha kur dërgoi në Kosovë mbi 600 mësues, të cilët përhapën dritën e diturisë anembanë Kosovës.

Një falënderim më i veçantë vlen të bëhet për të gjithë mësimdhënësit shqiptarë, në veçanti për normalistët, këta misionarë të dritës së ardhmërisë të shtetit të Kosovës. Këtë e thoshte qysh më 1911 edhe shkrimtari ynë i mirënjohur Mihal Grameno, i cili shkruante: "*Shkolla është themeli i kombit dhe sot një mësonjë munt të përhapë shkëndijën të diturisë te i ngrati komb Shqipëtar, të cilin gjer më sot tiranët dhe armikët e kanë lënë të verbër ose e kanë përdorur për interesat e tyre, duke ia farmakosur trutë me mendime antipatriotike...*"⁷ Janë bërë përpjekje për të hedhur dritë mbi didaktikën e mësimdhënies së gjuhës shqipe në këtë periudhë mbi 180-vjeçare.

Ky punim synon të plotësojë sadopak boshllëkun e trajtimit kronologjik e të sintetizuar të kësaj problematike, duke mos harruar asnjëherë plejada të tëra atdhetarësh, që ishin në shërbim të zhvillimit të reformës arsimore të shkollës e të gjuhës shqipe në përgjithësi e të mësimdhënies në veçanti. Ky studim mendojmë t'u shërbejë:

- Studiuesve të arsimit në përgjithësi dhe të arsimit në Kosovë në veçanti.
- Mësuesve të gjuhës shqipe, që të njohin rrugëtimin e plan-programeve, metodikave, teksteve të gjuhës shqipe
- Studiuesve të gjuhës shqipe për hulumtime të mëtejshme në këtë fushë.

Bibliografia e shfrytëzuar për këtë disertacion është e larmishme, nga Arkivat, tekstet e gjuhës shqipe, nga literatura e hershme e deri në botimet më të fundit mbi historinë e arsimit shqiptar, duke u hulumtuar një sërë literaturash bashkëkohore vendase dhe të huaja, që kanë ndikuar në pasurimin dhe paraqitjen e plotë të sytheve të punimit.

⁵ Rexhep Qosja, *Strategji e bashkimit shqiptar*, Toena, Tiranë, 1998, f.7.

⁶ Gazeta "Demokratia", nr. 388, Tiranë, 23.7.1932, f. 3.

⁷ Kështu shkruante Mihal Grameno, më 16 shtator 1913, me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor pas Pavarësisë.

Metodologjia e punimit

Metodat e kërkimit për këtë studim, cilësore dhe sasiore, vjelja e një bibliografie sa të hershme aq dhe të sotme ka qenë një ndër pikësynimet kryesore për të bërë një trajtim hulumtues, kërkues, zbatues dhe origjinal në fushën e historisë së arsimit.

Hulumtimet kryesisht mbështeten në literaturë dhe burime arkivore, të vjetra e të reja, që i është kushtuar mësimi të gjuhës shqipe në shkollën e Kosovës. Për t'i pasqyruar sa më të plotë reflektimet mbi zhvillimet historike dhe aktuale të mësimi të gjuhës shqipe në shkollat e Kosovës, është bërë një analizë përshkruuese dhe krahasuese e shumë planeve e programeve mësimore dhe të shumë teksteve mësimore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Tekstet mësimore, të konsultuara, i përkasin gjysmës së dytë të shekullit XIX e deri tek tekstet bashkëkohore të ditëve të sotme. Ndërsa palanet dhe programet mësimore, të analizuara, vijnë nga viti 1914 e deri te Kurrikulum i vitit 2011. Për një analizë më të plotë përshkruuese dhe krahasuese janë shqyrtuar qindra tekste mësimore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë, dhjetëra plane dhe programe mësimore, metodika e didaktika për mësimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë, etj.).

Aspektet metodologjike të këtij punimi:

- a. **Vëzhgimi dhe hulumtimi.** Në këtë studim është hulumtuar në literaturat më të hershme si dhe të kohëve fundit të historisë së arsimit shqiptar.
- b. **Kërkimi dhe skedimi.** Literaturat janë skeduar e referuar në këtë studim për të mbështetur fakte e të dhëna të ndryshme, të cilat janë krahasuar e reflektuar në tekstet e gjuhës shqipe.
- c. **Analizë deskriptive dhe krahasuese të teksteve.** Për këtë janë analizuar disa tekste të gjuhës shqipe (përfshirë edhe abetaren) për nga ana strukturore, përmbajtësore, duke u evidentuar risitë nga njëra periudhë kohore në tjetrën.
- d. **Anketa, pyetësorë.** Për qëllime të caktuara të aplikimit të studimit janë bërë disa anketime e pyetësorë.
- e. **Data base e rezultateve.** Mbi bazën e pyetësorëve janë dhënë rezultatet, të pasqyruara në analiza e tabela.
- f. **Referencat.** Referencat në këtë studim pasqyrojnë jo vetëm referimin e burimit, por edhe shpjegime e thellime të mëtejshme të figurave të arsimit apo ngjarjeve historike, nga të cilat kushtëzohej edhe zhvillimi dhe mësimi i gjuhës shqipe.
- g. **Analiza SWOT.** Kjo analizë është përdorur në disa aspekte të punimit për të evidentuar pikat e forta e të dobëta në plan-programe e tekste mësimore, mundësitë dhe rrezikshmëritë.

Struktura e temës dhe përmbajtja

Tema “*Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë*”, (nga Rilindja Kombëtare Shqiptare deri në ditët e sotme), është e konceptuar në tetë krerë:

Në kreun e parë, “*Mësimi i Gjuhës Shqipe Në Kosovë- Vështrim Historik*” bëhet një vështrim kronologjik i të gjitha karakteristikave të mësimin të gjuhës amtare që nga fillimi i shekullit XIX deri në ditët tona. Në punim do të zërë vend mësimi i gjuhës shqipe nga fillesat e saj. Në këtë kapitull do të trajtohen edhe gjithë sfidat e mësimdhënies së gjuhës shqipe gjatë periudhës 1912-2014 deri në hapat e parë të përafrimit kurrikular Kosovë-Shqipëri për gjuhën shqipe 1990-1999.

Në kreun e dytë, “*Këndvështrime në didaktikën e gjuhës shqipe në Kosovë*” trajtohen disa problematika të procesit mësimor, reformat e vazhdueshme, roli specifik i mësimdhënësve të gjuhës shqipe gjatë mësimdhënies dhe nxënies në Kosovë. Do të analizohet evoluimi i strukturës së orës së mësimin përgjatë disa dhjetëvjeçarëve që nga vitet 1830 të shekullit XIX deri në ditët e sotme. Po ashtu, bëhet një vështrim krahasues lidhur me trajtimin e njohurive gjuhësore, vendi i gramatikës në programet dhe në tekstet mësimore. Do të përcaktohet roli i gjuhës shqipe dhe letërsisë si shkencë dhe lëndë mësimore, si dhe realizimi i misionit të gjuhës shqipe përmes disa llojeve të programeve mësimore (*qasje krahasuese*). Një vend të rëndësishëm zë edhe krahasimi i mësimdhënies tradicionale me metodologjitë bashkëkohore. Do të përimitohet zhvillimi i didaktikës së mësimdhënës së gjuhës shqipe dhe funksionet pedagogjike, duke i parë nga prizmi i mënyrave të organizimit të mësimdhënies së gjuhës shqipe (*mënyrat, format, metodat dhe mjetet mësimore*), si dhe metodika e mësimdhënies, interpretimi i teksteve (*analiza e teksteve*), struktura e orës mësimore të gjuhës amtare në Kosovë, mjetet mësimore dhe teknologjia në mësimin e gjuhës shqipe së bashku me reflektimet e përvojave jugosllave në mësimin e letërsisë dhe të gjuhës shqipe në Kosovë. Gjatë hulumtimit, vihet re se ka munguar hartimi i metodikave të veçanta për mësimin e gramatikës, si: *metodika e mësimin të fonetikës dhe fonologjisë, metodika e mësimin të morfologjisë dhe fjalëformimit; metodika e mësimin të sintaksës dhe shenjave të pikësimit; metodika e leksikologjisë, stilistikës linguistike; metodika e ushtrimeve me shkrim dhe me gojë*.

Kreu i tretë, “*Trajektorja e abetareve në gjuhën shqipe në Kosovë*”, me një vështrim përmbledhës, paraqet udhën e shkronjave-abetareve në të gjitha kohët e hartimit të tyre përgjatë shekujve XIX, XX dhe fillimshekullit XXI në shkollën e Kosovës. Fillimisht, këtu do të trajtohen përpjekjet e para për hartimin e abetareve në këtë pjesë të trojeve tona etnike dhe depërtimin e abetareve nga mërgata dhe Shqipëria, më pastaj një vështrim do t’i hidhet udhës së shkronjave shqipe të përdorura në Kosovë gjatë Mbretërisë SKS, gjatë kohës së Autro-Hungarisë, në kohën kur arsimin e drejtonte E.Koliqi, abetaret në periudhën kur Kosova ishte nën Jugosllavi dhe deri tek abetarja e përbashkët Shqipëri-Kosovë. Në këtë kapitull do të trajtohen edhe aspekte të didaktikës historike të mësimin të shkrim-leximit në Kosovë dhe praktikat pedagogjike të lexim-shkrimit fillestar gjatë traditës deri te bashkëkohorja.

Kreu IV, “*Planet dhe programet e gjuhës shqipe në Kosovë*”- (Nga periudha e Rilindjes Kombëtare deri në vitin 2014) mbështetet në këndvështrime lidhur me planet dhe programet mësimore, që janë përdorur në Kosovë gjatë periudhës në trajtim. Këtu do të trajtohet e gjithë harta

dhe gjeografia e planeve dhe programeve mësimore si dokument zyrtar shtetëror për lëndën mësimore gjuhë dhe letërsi shqipe në Kosovë. Qasja jonë është monografike, por edhe krahasuese e vlerësuese e planeve dhe programeve mësimore për këtë lëndë mësimore (*përfshirë edhe Kurrikulën e re*), që tashmë ka filluar të pilotohet në shkallë të gjerë në shkollat e Kosovës. Një vend të veçantë zë vlerësimi kritik për nivelin e planeve dhe programeve mësimore të gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Planet e programet mësimore dhe mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë do të prezantohen fragmentarisht, por me një kronologji duke u nisur nga plani mësimor sintetik austriak për gjuhë mësimi (*mësim shkrimi*) 1915-1918, për të vijuar me planin mësimor të Mbretërisë së Jugosllavisë, mësimi i detyruar në gjuhën serbe 1918-1941, atë të Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë për gjuhë shqipe 1941-1945, të pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë për lëndën gjuhë shqipe 1945-1946 dhe planet e viteve 1960, 1971, 1977, 1985, 1990, 1992-93, 1996-97, 1998-2001, 2003 dhe reformimi kurrikular-Gjuha dhe komunikimi me vizion të ri-pilotimi (2011). Në këtë kapitull prezantohet nevoja e përafrimit dhe unifikimit të Kurrikulës, planeve dhe programeve mësimore dhe të teksteve shkollore në të gjitha trojet shqiptare.

Në kreun V, “*Vështrim historik mbi mësimdhënien e gramatikës në Kosovë*” trajtohet vendi i gramatikës (*morfologji+sintaksë*) dhe i njohurive për gjuhën në programet dhe tekstet e gjuhës shqipe, të shkruarit (*ortografia*) dhe të folurit (*ortoepia*) e nxënësve në raport me normën standarde të shqipes, roli i shtëpive botuese në reformën e teksteve të gjuhës shqipe-mungesa e teksteve alternative, etj. Vend të rëndësishëm ka zënë edhe mësimdhënia e mësimnxënia e gramatikës së gjuhës shqipe në Kosovë në një vështrim historik. Roli i mësimdhënies së gramatikës së gjuhës shqipe, gjatë viteve, struktura e orës mësimore të gjuhës amtare në Kosovë, mjetet mësimore dhe teknologjia në mësimin e gjuhës shqipe, hartimet shkollore, punët me shkrim të nxënësve në arsimin parauniversitar dhe kultura e të shprehurit me gojë, janë pjesë e rëndësishme e këtij kapitulli. Këtu do të trajtohen edhe raportet në mes linjave: “*Të lexojmë*”, “*Të shkruajmë*”, “*Të flasim*” dhe “*Njohuri gjuhësore*”, si dhe aspekte të kriterëve të vlerësimit objektiv në mësimin e gjuhës tok me reflektimet e përvojave jugosllave në mësimin e letërsisë dhe të gjuhës shqipe në Kosovë.

Kreu VI, “*Hartimi i teksteve të gjuhës shqipe*” mëton të pasqyrojë një vështrim të gjerë për hartimin e teksteve shkollore të gjuhës dhe letërsisë shqipe, të bazuara në kurrikulën (*planet mësimore, programet*), që u përdorën në shkollat e Kosovës, e karakterizojnë sfidat e shumta nëpër të cilat kaloi libri shqip. Këtu, do pasqyrohet gjithë historiku i hartimit të teksteve mësimore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë para Luftës së Parë Botërore, deri pas Luftës së Dytë Botërore, për të vazhduar me tekstet e gjuhës shqipe të periudhës së viteve 1945- 2013 (*për gramatikën dhe tekstet e letërsisë -Libri i leximit nga viti 1945 deri në vitin 2013*).

Kreu VII, “*Standardizimi i gjuhës dhe formimi gjuhësor e letrar në Kosovë*”, pasqyron vendimet e mëdha lidhur me kodifikimin e gjuhës standarde, si dhe ngjarje, konferenca, seminare dhe botime të veçanta nga fusha e filologjisë, reflektuan fuqishëm në rëndësinë historike të arsimit shqip edhe në Kosovë, duke u nisur nga unifikimi i alfabetit në Kongresin e Manastirit, vendimet e Komisionit Letrar të Shkodrës (1916-1918), vendimet e Kongresit të Elbasanit, Konsulta gjuhësore e Prishtinës dhe Kongresi i Drejtshkrimit, që përbëjnë ngjarje kulmore në kodifikimin dhe unifikimin e gjuhës shqipe standarde. Në këtë rrugëtim ndikuan edhe shumë ngjarje të tjera, konferenca e seminare kushtuar gjuhës shqipe dhe mësimi të saj. Në Kosovë, përveç organizimit të përvjetshëm në Prishtinë të Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, janë bërë botime, nga më të rëndësishmet, në fushën e gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Të gjitha këto zhvillime ndikuan dukshëm

në luftën kundër analfabetizmit, në realizimin e arsimit të detyruar në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore. Këndvështrimi ynë spikat edhe kontribute në shkollimin e mësuesve, në zhvillimin e gjuhës shqipe dhe të pikëpamjeve pedagogjike të mësimdhënies në Kosovë. Në këtë kapitull do të trajtohet edhe udha e formësimit dhe përgatitjes së mësuesve në Shkollat Normale të Kosovës, në rolin e Universitetit të Prishtinës në zhvillimin dhe cilësinë e mësimdhënies së gjuhës shqipe.

Kreu VIII, *“Korniza kurrikulare e Kosovës, rëndësia për mësimin e gjuhës,* paraqet reflektime të dimensioneve evropiane për mësimin e gjuhës amtare në kontekstin global, në zhvillimin bashkëkohor në mësimdhënien e gjuhës shqipe në Kosovë. Një vend të rëndësishëm zënë fillesat e mësimdhënies bashkëkohore të gjuhës shqipe në Kosovë. Madje, krahasohet raporti i vendit të mësimdhënies bashkëkohore të gjuhës shqipe në shkollat e Kosovës dhe vendi i gjuhës në planet e programet mësimore në shkollën fillore dhe të mesme, së bashku me ndikimin e teknologjisë dhe të burimeve të reja të informacionit në mësimdhënie.

Qasjet e reja në mësimdhënie përgjithësisht dhe në veçanti metoda që nxisin mësimdhënien me në qendër nxënësin në lëndën e gjuhës shqipe, do të jenë prolog i këtij kapitulli, për t'i lënë vend trajtimit të zhvillimit të folurit të nxënësve përmes linjës së folurit (*në programet dhe tekstet e gjuhës shqipe*). Një vend meritor në këtë kapitull iu kushtohet metodave, teknikave, formave dhe mjeteve mësimore, që mundësojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës shqipe në rrethanat bashkëkohore. Po ashtu, do të trajtohet mënyra e zhvillimit të mendimit kritik dhe krijues të nxënësve përmes prurjeve dhe sfidave në mësimdhënien dhe të nxënies së gjuhës shqipe, si dhe të mësuarit me kompetenca, si dhe roli i teknologjisë së re (*kompjuterit, softuerëve, programeve dhe digjitalizimit të mësimin*) në mësimdhënie, si mundësi e re.

Bibliografia e shfrytëzuar për këtë disertacion është e larmishme, nga arkivat, burimet didaktike, tekstet e gjuhës shqipe, e deri në botimet më të fundit në fushë të arsimit.

FALËNDERIME DHE MIRËNJOHJE

Falënderime dhe mirënjohje për Departamentin e Gjuhësisë të Universitetit të Tiranës, që më mundësoi ndjekjen e programit të doktoratës. Një mirënjohje dhe falënderim i veçantë për prof. dr. Shezai Rrokaj, këshillat e të cilit përherë ishin të mirëpritura dhe për prof. as. dr. Aljula Jubani, për mbështetjen që më ka dhënë gjatë hulumtimit tim për punimin e doktoratës.

Falënderimin kryesor dhe mirënjohjen më të thellë ia kushtoj prof. dr. Mimoza Gjokutaj, e cila më udhëhoqi dinjitetshëm dhe me profesionalizëm në përgatitjen e disertacionit. Ajo, më orientoi me plot vullnet dhe energji e dashamirësi, me durim e vëmendje, drejt literaturës dhe materialeve ndihmëse që m'u deshën t'i studioja për të vjelë informacionin dhe lëndën e nevojshme në dobi të tezave të mia. Këshillat e sugjerimet e prof. Mozës ishin motivim që punimin ta sjell në formën përfundimtare.

Më meritoret për kurorëzimin e punimit tim janë trinomi i shkencës së gjuhësisë në këtë departament: dekani, prof. dr. Shezai Rrokaj, udhëheqësja e Departamentit prof.dr. Aljula Jubani dhe udhëheqësja shkencore, prof.dr. Mimoza Gjokutaj, si dhe dr. Irida Hoti dhe Mr. Sheremet Krasniqi, për ndihmesën e tyre profesionale, të cilët i falënderoj përjetësisht që më ndihmuan pa kursyer për këtë studim monografik, që punimi "*Mësimdhënie e gjuhës shqipe në Kosovë*"....të mund të konsiderohet disertacion i një rëndësie të veçantë dhe të shumëfishtë për shkencat filologjike, didaktikën e gjuhës shqipe dhe historinë e zhvillimit të gjuhës shqipe.

Me këtë rast, falënderoj edhe profesorët e respektuar për leksionet e tyre, prof. Gjovalin Shkurtaj, prof. Ethem Lika, prof. Flora Koleci, prof. Seit Mansaku, prof. Dhimitër Bello.

Është i veçantë edhe kontributi dhe ndihmesa që erdhi nga Bajram Shatri, prof.dr. Jusuf Osmani, prof.dr. Hajrullah Koliqi, prof.dr. Naser Zabeli dhe prof. dr. Bardhyl Musai. Shpreh mirënjohje të veçantë edhe për vendasin tim, (tani i ndjerë), prof.dr. Muhamet Pirraku, prof. dr. Mazllum Kumnova, prof.dr. Begzat Baliu, prof.dr. Bardh Rugova, prof.dr. Atdhe Hykolli, prof.dr. Rexhep Osmani e pedagogë të tjerë të Universitetit të Prishtinës. Falënderoj shumë edhe znj. Bukurije Haliti, mr.sc. Hajrije Devetaku, mr.sc. Safete Shala dhe mr.sc. Selim Mehmeti. Në mënyrë të posaçme, falënderoj edhe punonjësit e Arkivit Shtetëror në Prishtinë e Tiranë, si dhe ata të arkivave të disa komunave të Kosovës.

Nga thellësia e zemrës falënderoj familjen time, prindërit e mi, dy djemtë e mi, gruan time, nipërit dhe mbesat, për durimin, mirëkuptimin dhe mbështetjen e vazhdueshme që më kanë dhënë gjatë punës sime.

KREU I

MËSIMI I GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË- VËSHTRIM HISTORIK

1.1. Gjurmë të mësimit të gjuhës shqipe para Rilindjes Kombëtare Shqiptare

1.2. Mësimi i gjuhës shqipe në Kosovë, 1878-1918

1.3. Gjendja e arsimit në Kosovë, në zonat e administruara nga austro-hungarezët

1.4. Gjendja e arsimit në Kosovë, ndërmjet dy luftërave botërore, 1918-1941

1.5. Hapja e shkollave shqipe për mësimin e gjuhës shqipe, 1941-1944

1.6. Shtrirja e mësimit të gjuhës shqipe dhe sfidat në periudhën 1945-1966

1.7. Mësimi i gjuhës shqipe në shkollat e Kosovës, 1966-1981

1.8. Përpjekjet serbe për hartimin e “bërthamave të përbashkëta”, 1981-1989

1.8.1. Rëndësia e kundërshtimit të bërthamave “të përbashkëta” -Planeve dhe programeve mësimore për gjuhë shqipe

1.9. Hapat e parë të përafrimit kurrikular Kosovë-Shqipëri për gjuhën shqipe, 1990-1999

KREU I

MËSIMI I GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË- VËSHTRIM HISTORIK

Pozita gjeografike, popullsia, gjuhët në Republikën e Kosovës

Para shpalljes shtet Kosova administrohej sipas Rezolutës së Kombeve të Bashkuara 1244 të 12 qershorit 1999 ndërkaq pas shpalljes së pavarësisë së saj, më 17 shkurt 2008, Republika e Kosovës është e ndarë në 38 njësi administrative. Në mbështetje të Kushtetutës, “*Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm.*”¹ Sipas të dhënave statistikore mbi popullsinë në Kosovë, bazuar në regjistrimin të popullsisë (31 dhjetor 2011) në këtë shtet të ri dalin të jenë 1,780,021 banorë, kryesisht shqiptarë.²

Kosova ka pozitë të përshtatshme gjeografike, sepse shtrihet në qendër të *Gadishullit të Ballkanit*. Andaj, pozita gjeografike, gjeopolitike dhe gjeohapësinore, Kosovës i përcakton vend të rëndësishëm në Ballkan, Evropë dhe në botë.³ Kosova, pothuaj në të katër anët kufizohet me troje shqiptare: në veriperëndim, në veri dhe në verilindje kufizohet me Serbinë. Në jug dhe në juglindje me Maqedoninë, në jugperëndim me Shqipërinë dhe në perëndim me Malin e Zi. Kufijtë tokësorë të Kosovës janë rreth 564 km. Kosova me kufijtë e saj tokësorë kufizohet me Serbinë, me rreth 265 km; me Maqedoninë me rreth 136 km; me Shqipërinë me 101 km dhe me Malin e Zi me rreth 62 km. Në prill të vitit 2011 u hap një kapitull i ri për t’iu siguruar institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, për herë të parë, të dhëna të sakta dhe të besueshme nga “*Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011*”.⁴ Në regjistrimin e vitit 2011, Kosova kishte 1.780.020 banorë. Sipas regjistrimit të fundit, struktura e popullsisë sipas përkatësisë etnike në bazë gjuhës që flasin burimet statistikore flasin për këtë përbërje: saktësojnë se në Kosovë janë 1,616,869 ose 92.9 % shqiptarë, 25,532 ose 1.5 % serbë, 18,738 ose 1.1 % turq, 27,533 ose 1.6% boshnjakë, 8,824 ose 0.5 %, romë, 15,436 ose 0.9 %, ashkali, 11,524 ose 0.7 % egjiptian dhe 10,265 ose 0.6% bgoranë, si dhe të tjerë.⁵ Ka plot argumente shkencore se deri me aneksimin e Kosovës nga ana e Serbisë në vitin 1912, mbi 95% e popullsisë ka qenë e përkatësisë etnike shqiptare. Gjuhët që sot fliten në Kosovë janë: gjuha shqipe mbi 92 %, gjuha serbe dhe boshnjake deri 4.5%, gjuha turke dhe rome afër 3.5 % .

Për shkak të statusit të pazgjydhur politik, pastaj sfidave të rënda politike dhe etnike, të cilat kanë zgjatur me dekada, për shkak të dominimit të sistemit totalitar dhe monist, ka një trashëgimi shumë të pavolitshme të strukturës së popullsisë në aspektin e shkallës së aftësisë së popullsisë për lexim - shkrim dhe të përgatitjes shkollore. Për shkaqet e përmendura, Kosova trashëgoi shkallë të lartë analfabetizmi. Sipas regjistrimit të vitit 1948 në Kosovë 74% e popullsisë ishte analfabete.⁶ Pas punës produktive në zhdukjen e analfabetizmit, sipas regjistrimit të vitit 1953, ky numër analfabetësh u zvogëlua rreth 20 %. Nga viti 1953 deri në vitin 1961 kur

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës (të miratuar, më 9 prill 2008).

² Rezultatet e regjistrimit të popullsisë në Republikën e Kosovës 2011, nga Enti i Statistikave të Kosovës.

³ Sherif Maloku, *Kosova tërësi e lashtë gjeografike e politike*, Prishtinë, 1993, f.5.

⁴ Regjistrimi i fundit në Kosovë (para vitit 2011) ishte bërë 30 vjet më parë-1981.

⁵ Burimi nga Rezultatet e regjistrimit të popullsisë në Republikën e Kosovës 2011, nga Enti i Statistikave të Kosovës (Popullsia sipas gjinisë etnicitetit dhe vendbanimit).

⁶ *Statistički godishnjak SAP Kosova*, Prishtinë, 1979, f.38.

Statistički godishnjak SAP Kosova, Prishtinë, 1989, f.4.

u bë regjistrimi i tretë, numri i analfabetëve u zvogëlua nga 58,45% në 43,9% apo 14,5 %. Prej vitit 1961 deri në vitin 1971 numri i analfabetëve u zvogëlua për 12,3%. Ndërsa nga viti 1971 deri në vitin 1981 numri i analfabetëve u zvogëlua nga 31,6 % në 17,6%, apo 14%. Suksesi më i madh në çrrënjosjen e analfabetizmit është arritur në periudhën e viteve 1948-1953. Fatkeqësisht, problemi i analfabetizmit është i theksuar edhe sot, sepse në Kosovë llogaritet të jenë 59,624 qytetarë të moshës mbi 15 vjeç pa kurrëfarë përgatitjeje shkollore, prej të cilëve 52,304 janë shqiptarë.

1.1. GJURMË TË MËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE PARA RILINDJES KOMBËTARE SHQIPTARE

Shqiptarët qenë dhe mbetën të dalluar në shekuj nga fqinjët e tyre për kulturën materiale e atë shpirtërore. Në konsolidimin e kësaj kulture ndikuan faktorë historikë, gjeografikë e socialë.⁷ Hululumtimet shkencore në fushën e didaktikës përgjithësisht dhe asaj të gjuhës shqipe në veçanti, si dhe historisë së mendimit dhe arsimit shqiptar janë kryesisht të kohës së re, por është ky segment themelor i historisë së kulturës dhe qytetërimit të popullit shqiptar. Duke qenë e pamundur që të ndahet hululumtimi i zhvillimit historik të mësimdhënies në trevën e Kosovës së sotme, deri në vitin 1912 është këndvështruar e pandarë historia e pedagogjisë, edukatës dhe arsimit e të gjithë trevave shqiptare, sepse fatet e gjuhës dhe të popullit ishin të përbashkëta. Kjo ngjau sepse, historia shumëshekullore është histori përpjekjesh për të mbijetuar dhe për të përparuar si në aspektin material, ashtu edhe shpirtëror. Ajo “*është histori e madhe mes Lindjes dhe Përendimit*”.⁸ Megjithatë, ky studim synon të hedhë dritë mbi të mësuarit, si veprimtari shoqërore e vetëdijshme që edhe tek ne zë fill me lindjen e shoqërisë njerëzore, në procesin e jetës dhe punës së shoqërisë. Që nga komuniteti primitiv, kur lind të folurit, lindën edhe gjuhët si mjet komunikimi ndërmjet njerëzve. Në kohën e shthurjes së komunitetit primitiv, filloi të ndryshojë edhe karakteri i të mësuarit. Shumë studiues besojnë se që nga shekujt VI-IV para Krishtit, moshë 7 vjeç deri në 14 vjeç fëmijët mësonin shkrim, lexim, njësim e muzikë, pra krahas mësimëve e përgatitjeve fizike kishte dhe mjaft mësim për edukim mendor, moral e estetik e gjuhësor.⁹

Në mesjetë, është i njohur fakti se mësimi kishte kryesisht karakter teologjik. Zhvillimi i arsimit shqip me alfabetë të huaja që një rrugë, që ndoqi shkolla jonë në udhëtimin e saj të vështirë dhe të gjatë drejt shkollës kombëtare.¹⁰ Feja u fut gjerësisht në shkollë dhe në Kosovë, këtu gjenden rrënjët e mësimi të gjuhës shqipe. Të mësuarit dogmatik, kryesisht me kujtesë mekanike edhe dijet abstrakte dhe jo në gjuhën amtare ishin karakteristika të kësaj epoke. Burimet e pakta dhe të tërthorta, megjithatë të japin mundësinë për ta ndriçuar sadopak këtë problem. Në mesjetën e hershme ishin të rrallë priftërinjtë që gjuhë amtare kishin shqipen, që në shkollat pranë kishave, manastireve, katedraleve e famullive, ku ishte i përqendruar mësimi i ideologjisë fetare që ndrydhte shpirtin krijues e kritik, shpjegimet sadopak bëheshin edhe në gjuhën amtare. Kështu, me këtë formë u vazhdua deri në shekullin XII-të e XIII-të kur formën e mësimi dogmatik e zëvendëson mësimi skolastik.¹¹ Ndërsa në mesjetën e vonë nën ndikimin e

⁷ Shefik Osmani, *Reflekse etnopedagogjike I*, SHBC Iromeno, Tiranë, 1998, fq.3.

⁸ Rexhep Qosja, *Strategji e bashkimit shqiptar*, Toena, Tiranë, 1998, fq.7.

⁹ Sotir Temo, *Aleksandër Xhuvani-psikolog dhe mendimtar i shquar shqiptar*, Tiranë, 1984.

¹⁰ MASH dhe ISP, *Historia e arsimit dhe e mendimit Pedagogjik Shqiptar*, Vëllimi I, Tiranë, 2003, f.54.

¹¹ Hamit Beqja, *Në themelet e arsimit tonë popullor*, Tiranë, 1975.

rritjes së qyteteve, tregtisë dhe lindjes së borgjezisë dëgjohen thirrjet e para kundër të mësuarit dogmatik mesjetar. Kjo periudhë, epoka e Rilindjes dhe humanizmit evropian, shekujt XIV-XV shënon zhvillimin e shkencave si: matematika, astronomia, gjeografia dhe shkencat e natyrës dhe fillon të thyhet diktatura kishtarë, ringjallet kultura e lashtë e botës antike, lind e zhvillohet mendimi i ri, atje duhet kërkuar edhe fillimet e letërsisë shqipe.¹² Me depërtimin e këtyre shkollave didaktike në trojet shqiptare (*edhe në Kosovë*), kjo periudhë e zhvillimit të mendimit pedagogjik reflekton përkujdesin për ngritjen e godinave shkollore moderne, madje për instalimin e parimeve humaniste në mësimdhënie. Një rëndësi e veçantë i kushtohet mësimi të gjuhëve dhe letërsive klasike. Mësimdhënien e karakterizonte leximi i librave, bisedat e lira, mjetet e konkretizimit, etj. Ishte instaluar në shkolla teoria e shkallëve të të mësuarit.¹³ Në të gjitha periudhat historike edhe në këtë fazë të hershme të zhvillimit, mësimdhënia e gjuhës shqipe në radhë të parë kishte funksionin arsimor të të mësuarit, pastaj të mësuarit e gjuhës si unitet njohurish, shkathtësish dhe shprehish.¹⁴ Gjurmë të arsimit gjejmë që nga shkolla e Stubllës 1584, para disa shkollave të kësaj kohe në Shqipërinë londineze. Por, gjurmë të rëndësishme të përpjekjeve për mësimin e gjuhës shqipe gjenden në të gjitha epokat, por përcaktojmë që “guri” i kufirit të hulumtimit të jetë Rilindja Kombëtare Shqiptare e këndej.

¹² UTSH, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, *Historia e letërsisë shqipe*, Tiranë, 1959, fq.155.

¹³ Bedri Dedja, *Politika dhe pedagogjia*, Tiranë, 1967, f.6-10.

¹⁴ *Didaktika*, (përgatitur nga Katedra e pedagogjisë dhe psikologjisë në bashkëpunim me Institutin e studimeve pedagogjike), Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1986.

1.2. MËSIMI I GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË, 1878-1918

Për t'i arritur qëllimet tejet të rëndësishme të programit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila lindi nga vrulli patriotik i masave, inteligjenca shqiptare e përqendroi aktivitetin e saj në dy drejtime: në planin e gjuhës shqipe dhe në fushën e çeljes së shkollave kombëtare. Ishte kjo një periudhë kur në Vilajetin e Kosovës që zhvilluar një aktivitet i pasur që u shndërrua në një lëvizje gjithëshqiptare, e njohur në historinë e shkollave dhe të arsimit tonë kombëtar si Lëvizje për shkollën dhe arsimin shqip. Kjo lëvizje e fuqishme kombëtare arriti që të finalizojë me sukses objektivat më të rëndësishme kombëtare “alfabeti-gjuha-shtypi-shkolla-libri-lufta”.¹⁵ Kjo lëvizje që shtrirë në gjithë trojet shqiptare, e në veçanti në Kosovë, sidomos gjatë viteve 1883, 1909, 1910, 1911 kur u shtrua me forcë çështja e shkollave dhe e arsimit shqip.¹⁶ Dokumentacioni arkivor i kësaj periudhe, ofron të dhëna për aktivitetin e zhvilluar në këtë fushë, që për rrethanat e Vilajetit të Kosovës kishte specifikat e tyre karakteristike, ku ishte arritur një vetëdije e lartë kombëtare. Idetë e rilindasve në këto anë ishin përqaftuar bashkë me porositë që dolën nga Lidhja e Prizrenit. Është e dokumentuar se gjatë kësaj periudhe kullat, teqet, vakëfet dhe xhamitë ishin prijëtare të përhapjes së mësimin të gjuhës shqipe. Këto aktivitet e sforconte e plotësonte kënga dhe lahuta e çiftelia e rapsodëve që ka dhënë një kontribut të çmuar në edukimin dhe arsimimin e popullatës shqiptare në Kosovë. Ja, si e përshkruan gjeniu ynë popullor fazën e përpjekjeve për krijimin e shtetit shqiptar: “...Hot e Grudë na janë betue, Vin në Shkodër me da dert; Pa gjak malet mos me i lshue; Jena nisë me u ba millet...”¹⁷ Rilindasit kishin projektuar vënien e gjuhës amtare në themel të përmbajtjes së të mësuarit, që ishte kërkesa themelore e kësaj lëvizje. Një pjesë qendrore të programit të Rilindjes Kombëtare, zinte vend mësimi e lëvrimi i gjuhës amtare dhe përpjekjet për pasurimin e pastrimin e saj nga fjalët e huaja dhe ato të panevojshme. Rëndësia e mësimin të gjuhës amtare lidhej me faktin se ajo siguronte për shqiptarët:

- *Ruajtjen e qenies e të identitetit kombëtar.*
- *Bashkimin kombëtar për çlirim dhe ecjen drejt pavarësisë.*
- *Futjen në rrugën e progresit.*

Këto ishin arsytet pse rilindësit tanë, pa përjashtim, iu kushtuan drejtpërdrejt çështjes së madhe e jetike për kohën: *shkrimin e mësimin të gjuhës shqipe, hapjes së shkollave shqipe dhe organizimit të arsimit kombëtar shqiptar*. Realisht, gjuha shqipe mësohej edhe shumë kohë para 7 Marsit 1887 në shkollat në gjuhë të huaja, e forma të tjera ilegale edhe në Kosovë. Madje, edhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) i dha një impuls të madh lëvizjes për shkollën kombëtare. Në programin kombëtar të Lidhjes kërkohej njohja zyrtare e gjuhës shqipe, përdorimi i saj në administratën dhe në shkollat e Shqipërisë si dhe përdorimi i një pjese të të ardhurave të vendit për zhvillimin e arsimit.¹⁸ Sami Frashëri u drejtohej të gjithë shqiptarëve me një sërë pyetjesh “*Me se mbahetë kombësi e një kombi? Më parë me gjuhë të ti. Gjuha është m’e par’ e*

¹⁵ Zenun Gjocaj, *Roli i mësuësit dhe i shkollës shqipe në kohën e Rilindjes Kombëtare*, në “100 vjetori i shkollës shqipe të vashave në Prizren”, Simpozium shkencor i mbajtur në Prishtinë më 13 nëntor, 1992, f.97.

¹⁶ Arkivi Kombëtar i Tiranës, Fondi, Ministria e Arsimit, Materiale e dokumente, ç’thanë të tjerët për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

¹⁷ Xhafer Belegu, *Lidhja e Prizrenit*, Veprat e Sajë 1878-1881, Tiranë, 1939, f.100.

¹⁸ Marrë më 27.09.2012, në: <http://www.home.no/dukagjin/Lidhja%20Prizrenit%20II.html>.

*m'e madhe shënj' e një kombërije. Gjuha me se mbahet? Me shkronja. Një gjuh' e pashkruar s'mund të qëndrojë shumë kohë e paprishurë... Kombi shqiptar s'është komb për të pasurë turp prej tij: të qënët e një njeriu nga një komb kaqë trim e kaq i zgjuarë, s'është turp, po nder i math. Në ka mbeturë pas kombi ynë, s'është faj' i ti, po faji ynë; në ka mbeturë gjuha shqip e pashkruarë, s'ka mbeturë se është gjuhë e ligë e e metë, po vetëm se s'jemi kujdesurë na ta shkruajmë. S'na ka faj gjuha, faji është' yni."*¹⁹ Është ky një pasqyrim i rëndësisë së mësimin të gjuhës amtare që lidhej me ruajtjen e qenies e të identitetit kombëtar, bashkimin kombëtar për çlirim dhe ecjen drejt pavarësisë. Rilindësit tanë, ishin të përkushtuar për shkrimin e mësimin e gjuhës shqipe, hapjes së shkollave shqipe dhe organizimit të arsimit kombëtar shqiptar të pandarë në gjithë territoret ku flitej gjuha shqipe. Barrën e rëndë të përhapjes së gjuhës shqipe, si dhe të çlirimit kombëtar e morën këta ideologë, duke hartuar tekste shkollore, vepra shkencore e letrare, me synimin që me punën e tyre të shtonin dashurinë për atdheun dhe gjuhën amtare. Gjatë Rilindjes Kombëtare u arrit të përpilohen variante të ndryshme alfabetesh, u punua për një alfabet të njësuar, u hartuan abetare e libra këndimi si dhe tekste të ndryshme shkollore, u hapën shkolla, ku dhanë mësim edhe vetë rilindësit.

Në këtë periudhë populli i trevës së Kosovës, ishte i mobilizuar edhe në çështjen e përhapjes së arsimit në gjuhën shqipe. *"Popujt dhe kur nuk kanë një ndërgjegje kombëtare të themeluar mbi kulturë, shtytja e rrojtjes i bën që të lëvizin në kohën e rrezikut të madhë"*,²⁰ e kjo e ilustron veprimtarinë drejt përhapjes së mësimin të shqipes.

Ky aktivitet mund të ndahet në tri faza: *mësimi i gjuhës shqipe përmes formave individuale, pastaj futja me përpjekje të shumta me ngulm e shqipes në shkollat e huaja që punonin në Kosovë dhe, faza e tretë, çelja e shkollave shqipe, tërësisht të pavarura nga shkollat e huaja.* Shkolla jonë kombëtare në trevën e Kosovës u ndihmua edhe nga klubet shqiptare që vepronin në Shqipëri, Kosovë dhe në diasporë. Kryesisht, ky aktivitet ishte i përqendruar në sigurimin e ndihmave materiale për të gjetur dhe mbajtur mësuesit e shqipes, për të ngritur kurse për mësimin e gjuhës amtare dhe për të siguruar librat e nevojshëm arkivor, të cilat dëshmojnë se pjesa më e madhe e këtyre klubeve ishin shndërruar në qendra shkollore. Sipas shkrimeve që i gjejmë si dëshmi në revistën *"Kalendari Kombëtar"* të Sofjes, bëhet e ditur se në Prizren, Pejë, Gjakovë, Shkup shkollat shqipe për djem janë hapur që në vitet 1848. Ndërsa, në krahinën e Zymit, afër Prizrenit, e njohur nga historianët e arsimit shqip si trevë arsimdashëse, hapet shkolla shqipe në vitin 1864, e cila duket se ka funksionuar që më parë. Popullsia e krishterë katolike, nën ndikimin e madh të kulturës arsimore të Vatikanit, e cila dërgonte herë pas here priftërinj, kryesisht nga Shkodra, që të organizonin mësim me fëmijët e kësaj treve. Ndër kontribuesit e veçantë, në territorin e Republikës së Kosovës, si mësimdhënës të gjuhës shqipe janë patriotë të mëdhenj, si: Atë Shtjefën Gjeçovi, Atë Lekë Filaj e të tjerë. Ndonëse këto shkolla ishin të orientuara në mësimin e fesë, duke pasur për bazë faktin se nxënësit dhe mësimdhënësit (*priftërinjtë*) kryesisht ishin shqiptarë dhe kështu ata ndihmuan në përhapjen dhe kultivimin e gjuhës shqipe dhe kulturës arsimore. E kësaj kohe është dhe *Abetarja e Zymit* e vitit 1900, një libër shqip që përveç vlerave kombëtare paraqet dhe një risi në lëmë të profesionit për të

¹⁹ Enciklopedisti, Sami Frashëri, ideologu e patrioti i spikatur për çlirimin dhe bashkimin kombëtar të popullit shqiptar. Ai ishte ndër organizatorët kryesorë të "Komitetit Qendror për mbrojtjen e të drejtave të kombësisë shqiptare" dhe me themelimin e "Shoqërisë së të shtypurit shkronja shqip" (1879), u zgjodh kryetar i saj. Drejtoi revistat e para në gjuhën shqipe dhe hartoi disa libra shkollor. Libri *"Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet"*, 1899, u bë manifesti i Rilindjes Kombëtare.

²⁰ Xhafer Belegu, *Lidhja e Prizrenit*, Veprat e Sajë 1878-1881, Tiranë, 1939, f.10.

mësuarit e asaj kohe. Kjo abetare është ruajtur në Arkivat Qendrore të Shtetit në Tiranë.²¹ Ajo nuk ka emrat e autorëve, por për nga përmbajtja i ngjason shumë punës së Lazër Lumnezit, ndërsa, nga metodika Mati Logoreci, që dallohej në atë kohë për përgatitjen e teksteve shkollore.²² Për këtë gjendje shkruante, edhe gazeta "Shqipëria" e Bukureshtit²³, se "Nga të tëra anët e Shqipërisë na vijnë letra, të cilat dëftojnë flakën dhe dashurinë e popullit për të ndriçuar fatnë e atdheut. Po e liga është që nuk kemi një qendër, një udhë të përbashkët, të tërë, nuk dijmë se nga vemi. Duam të bëjmë të mira në ndë vent, po nuk e dijmë qysh të punojmë, që të arrijmë ndë këtë qëllim, nuk kemi një qeveri, e cila të na e udhërojë dhe të na ndritojnë mendjen".²⁴ Është kontributi dhe koordinimi i veprimtarisë së këtyre klubeve, që në vitin 1908, në Manastir tuboi elitën e të gjitha klubeve shqiptare dhe u përgatit Kongresi i Alfabetit. Është kjo periudhë e kthesave dhe vendimeve të mëdha, sepse "...tani në radhët e këtyre klubeve vërehet një aktivitet më i organizuar, më i dendur dhe shumë më frytdhënës."²⁵ Patriotët dhe luftëtarët e shquar për shkollën kombëtare shqiptare, si: Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Bajram Curri dhe të tjerë të Kosovës hapën klube të reja, si: në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Gjilan dhe dëget e tyre në Ferizaj, Kaçanik, Podujevë, Drenicë etj.

Me daljen në dritë të abetareve të kësaj kohe ato shumë shpejt u gjenden në Kosovë. Udhën e shkronjave të para shqipe nga këto abetare i mësuan mjaft klerikë shqiptarë, të fesë myslimane e katolike. Kështu ata përmbushën një detyrë të shenjtë ndaj vendilindjes së tyre.²⁶ Mulla Haxhi Zeka pati bërë thirrje për shërbim mësuesie në Kosovë Thirrjes iu përgjigjën patrioti, Andre Logoreci, i cili vendosi t'i dërgonte në Kosovë të dy nipat e tij, Matinë në Prizren dhe Pashkon në Gjakovë. "...Ishin këta mësuesit e parë profesionistë që hapën në Kosovë shkollat e para shqipe, në të cilat futën shpirtin kombëtar të edukatës."²⁷ Është kjo kohë që njihet për rritjen e numrit të mësuesve që punuan e vepruan në Kosovë, ndër të cilët vlen të veçohen: Ivan Berisha, Pashk Prelaj, Lazër Lumezi, Qamil Dula, Pal Quqiaj, Marjan Prelaj, Ndue Lezhja, Frano Lufi, Mikel Tarabulluzi, Luigj Kroniqi, Mëhill Kurti, Ndue Bytyqi, Engjëll Ndocaj, Gjergj Gjinaj, Gaspër Gjurgaj dhe të tjerë, që me punën e tyre vetëmohuese i vonë gurëthemelet e arsimit kombëtar në Kosovë.²⁸ Ardhja e tyre në Kosovë bëri të mundshme që në mjedise të ndryshme të Vilajetit të Kosovës të hapen një numër i kufizuar shkollash. Kështu shkollës së Prizrenit dhe të Gjakovës iu shtuan edhe disa shkolla të tjera, si ajo e Pejës, e Janjevës, e Zymit, e Ferizajit, Letnicës, Stubllës, Pozharanit dhe e Gjilanit. Këtij aktiviteti iu kishte bashkuar edhe Shtjefën Gjeçovi, i cili dha një kontribut të jashtëzakonshëm.²⁹ Shquhet për vënien e bazave teorike të

²¹ Abetarja e Zymit, autor Nikollë Kërhanaj, Zym-Prizren.

²² Robert Gjedia, *Arsimi në Shqipëri në vitet 1925-1939* (tezë doktoraturës, e mbrojtur, në QSA në Tiranë, në vitin 2012, e pabotuar). (Mund të veçohet puna e jashtëzakonshme dhënë nga "Shoqëria shqiptare" e Bukureshtit, ajo e Sofjes, klubi "Bashkimi" i Manastirit dhe Klubi "Arsimi" i Shkupit. Për aktivitetet që zhvilluan këto klube shkroi gazeta "Kombi" e 1 janarit të vitit 1909, se "...në tërë shkollat shqipe të qeverisë në Shqipëri po përgatiten që të vejnë mësonjës për të mësuar djemt gjuhën e tyre".)

²³ Gazeta "Shqipëria", e Bukureshtit, më 30 gusht 1897.

²⁴ Sherif Hoxha, Halit Berzeshta, Tiranë, 1988, f.55.

²⁵ Po aty.

²⁶ Shih për këtë gjerësisht: AKT, *Figura të Rilindjes Kombëtare Shqiptare*. (Sot në këtë arkiv ruhen 130 dosje për veprimtarinë politike, publicistike, kulturore dhe arsimore të Jashar Erebarës.)

²⁷ Musa Kraja, *Mati Logoreci*, Tiranë, 1987, f.6.

²⁸ Jashar Rexhepagiq, *Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*, Prishtinë, 1970, f.234.

²⁹ Gjetja e Abetares së Zymit pa autor, e shtypur në shaptilograf në vitin 1900, është dëshmi më vete se mësuesit dhe pedagogët kosovarë, krahas hapjes së shkollave shqipe, kishin bërë përpjekje edhe për sigurimin e teksteve

mësimdhënies Mati Logoreci, Lazër Lumezit të Shtjefën Gjeçovit, etj., si përpjekje që shquhen nga një frymë e thellë kombëtare.³⁰ Puna që bëhej në hapjen e shkollave shqipe në Kosovë, si kundërpërgjigje, vinin lejet nga Porta e Lartë leje për hapjen e shkollave serbe në Kosovë e kjo vështirësonte çasjen shqiptare, sepse ato shkolla serbe ndërronin misionin dhe shndërroheshin në vatra të propagandës sllave në Kosovë.³¹ Këto çështje do t'i shtronte Kuvendi i thirrur nga H.Zeka, ku u shtruan kryesisht problemet që ishin të natyrës arsimore. Në rend të parë “... *mirret vendimi për futjen e shqipes në shkollat ekzistuese si dhe vet shkollat të merreshin në duart e shqiptarëve. Por, asnjëra nga këto synime nuk u realizua, sepse Porta e Lartë e shtypi Lidhjen e Pejës, për ç'shkak të mësuarit e shqipes sërish iu kthye formës ilegale*”.³² Nevojë e ngutshme u shtrua çështja rihapjes së kurseve për mësimin e gjuhës shqipe.³³ Burimet arkivore të kësaj periudhe, në Vilajetin e Kosovës dokumentojnë se ishin përfshirë 5000 fëmijë të filllores dhe 13.000 burra të moshave të ndryshme.³⁴

Në të gjitha këto kurse mësohej sipas një programi të caktuar, i cili ishte në përdorim edhe në vise tjera të Shqipërisë. Përveç shkrim-leximit fillestar aty mësohej edhe historia e Shqipërisë. Ndërkaq në kurset e fëmijëve, pos këtyre lëndëve, *mësohej të recituarit e vjershave të ndryshme me motive patriotike, pastaj të lexuarit e teksteve të ndryshme, të hartuara në formë dialogësh dhe së fundi mësohej kënga dhe gjimnastika*. Të gjitha këto kurse zhvilloheshin sipas konceptit të mësuesit Logoreci, i cili kishte hartuar edhe “*Udhëzimet ...*” për të gjithë ata që punuan me këto kurse. Një kontribut të veçantë në këtë drejtim dhanë elemntët patriot, që kishin mbaruar më parë shkolla të huaja, por që ndërkohë kishin arritur të mësonin shkrim-leximin e gjuhës shqipe. Ata pastaj ua mësonin të tjerëve këtë gjuhë. Do theksuar së në të gjitha shkollat që ishin nën patronatin e Austro-Hungarisë, si: në Prizren, Janjevë, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Letnicë, Stubëll dhe gjetiu, ku mësimi zhvillohej pjesërisht në gjuhën shqipe, u bënë përpjekje që ato të shndërrohen tërësisht në shkollat kombëtare.³⁵ Duke iu përgjigjur aspiratave gjithëshqiptare, e sidomos dëshirës së nxënësve shqiptarë, mjaft mësues dhe klerikë patriot e kryen me ndërgjegje këtë mision të shenjtë. Një kontribut të çmuar në këtë drejtim dha edhe shtypi i kohës, i cili ndikoi

mësimore për mësuesit dhe pedagogët kosovarë, krahas hapjes së shkollave shqipe, kishin bërë përpjekje edhe për sigurimin e teksteve mësimore për nxënësit e këtyre anëve.

³⁰ Instituti Pedagogjik, *Historia e Arsimit Shqiptar I*, Tiranë 1990, f.101

³¹ Kjo atmosferë u pasqyrua në *Premorjen* e majit të vitit 1896. Meqë kjo promemorje nuk solli atë që pritej, kryetari i Lidhjes shqiptare të Pejës, Mulla Haxhi Zeka, në prill të vitit 1899 thirri Kuvendin e përgjithsmëm “*ku të përcaktohej në mënyrë e përbashkët veprimi në interes të Atdheut*”.

³² Shukri Rahimi, *Vilajeti i Kosovës*, Prishtinë, 1969, f.44. (Kuvendi i mbajtur në shkurt të vitit 1901 në Fushë të Kosovës, ku Mulla Haxhi Zeka shtroi çështjen e shkollave shqipe në këtë Vilajet, krijoi një platformë të re për realizimin e synimeve të kësaj lëvizjeje).

³³ Në një mënyrë më të organizuar këto kurse datojnë që nga viti 1908, kur filloi gjerësisht të mësohej gjuha shqipe. Atëherë në Kosovë qenë organizuar tri lloj kursesh: kurse për fëmijë që nuk dinin shkrim-lexim fillestar, kurse për të rritur të cilët nuk konsideroheshin analfabetë, meqë kishin mbaruar shkolla të huaja, por që dëshironin ta mësonin shqipen, si dhe kurse për të rriturit, që nuk e zotëronin fare shkrim-leximin fillestar. Mbështetur në të dhënat statistikore: kursin për të rritur në Gjiilan e vojonin 63 vijues, prej të cilëve 21 ishin hoxhollarë.

³⁴ A.K.T., *Materiale dhe dokumente për organizimin e kurseve në Kosovë pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*

³⁵ Kështu, shkollat e huaja të kësaj periudhe në Kosovë u shfrytëzuan si çerdhe për t'i hapur rrugë mësimin të gjuhës shqipe. Patriotët shqiptarë në këtë periudhë vëmendjen e tyre e kishin përqendruar drejt shkollave turke dhe këtë për dy arsye: së pari për shkak se ato kishin një shtrirje më të gjerë në këtë Vilajet, dhe se dyti, me vetë faktin e futjes së shqipes në këto shkolla, do të krijoheshin mundësi që të veprohej njësoj edhe me shkollat e tjera të huaja që punonin në këto mjedise.

mjaft në mobilizimin e inteligjencës shqiptare.³⁶ Sipas shtypit të kohës “...miletit shqyptar ka lyp hesap prej jush e prej fëmijës së juaj. Këtë gjë duhet ta kujtoni, se koha e këti hesapi nuk a larg!”³⁷ Pothuaj në gjithë Kosovën, në këtë periudhë, për në organizimin e shkollave, dhe në kualifikimin e mësimit të madh kanë dhënë Hasan Prishtina, Nexhip Draga dhe Bajram Curri e patriotë të shumtë, duke reflektuar te imamët e xhamive dhe mualimët e mejtepeve, që krahas mësimit të “*elifit*” t’ua mësonin nxënësve edhe abetaren e gjuhës shqipe. Vlen të theksohet se të gjitha vendimet që i aprovoi Kongresi i Manastirit më 1908 si dhe të tjerat që u miratuan më pas në Kongresin e Elbasanit më 1909, filluan të viheshin në jetë edhe në të gjitha pjesët e Kosovës. Mirëpo, duket se shkak real i hapjes së shkollave turke ishte që të pengoheshin të gjitha përpjekjet për çeljen e shkollave shqipe dhe për pengimin e mësimit të gjuhës shqipe në këto anë.³⁸

Për të gjithë shqiptarët, shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë ishte ngjarja më e madhe historike e shekullit XX. Për të arritur te akti sublim i 28 Nëntorit 1912, kontribuan shumë atdhetarë e veprimtarë të shquar të arsimit dhe të kulturës kombëtare,³⁹ të cilët bashkë me delegatët e tjerë vendosën njëzëri që “*Shqipëria të bëhet më vete e lirë dhe e mosvarur.*”⁴⁰ Para Qeverisë së parë të shtetit të pavarur në drejtim të fushës së arsimit buruan detyra shumë të mëdha lidhur me organizimin institucional të arsimit. Barrën e parë mbi supë e kishte Luigj Gurakuqi si Ministër i Arsimit. Pasi formohet “*Pleqësia*” e arsimit me 18 anëtarë (Babë Dudë Karabunara, Sali Gjuka, Murat Toptani etj.) Kjo periudhë karakterizohet me përcaktimin e kufijve politikë të shtetit shqiptar, kur me bekimin e Fuqive të mëdha padrejtësisht populli shqiptar, gjendje kjo që u reflektua në kulturë: gjuhë, histori, shkolla, libra, dhe në gjithë lëvizjen nacionale me synime të qarta politike, prandaj ata s’duhej të kishin as troje, as kufij e as shtet të vetin.⁴¹ Në këtë periudhë historike u çelen shkolla të reja, u krijua edhe një fond i caktuar për hartimin e teksteve shkollore.⁴² Për Kosovën dhe territoret tjera shqiptare të cilat mbetën jashtë kufirit nisën represaljet, presioni me përmasa gjenocidi. Në këto troje u ndalua me ligj shkolla në gjuhën shqipe. Ndonëse nuk duhet mohuar se nga Shqipëria vinin rreze diturie për pjesën e popullsisë shqiptare, të mbetur nën pushtimin e Greqisë, Serbisë dhe të Malit të Zi. Në rrjetin e përhapjes së abetareve dhe librave shqip në Kosovë kontribuan mjaft mësues kosovarë, të cilët punuan në anë të ndryshme të Shqipërisë, si Ibrahim Fehmiu, Ibrahim Kolçi, Niman Ferizi, Ferid Imami, Man Shaqiri, Jusuf Puka, Murat Muhaxhiri, Ahmet Gashi, Qamil Bala, etj.⁴³ Kurdo që mësuesit

³⁶ Në gazetën “*Dita*” që botohej në Sofje, të vitit 1906, ndër të tjera bëhej thirrje: “*O ju të parët e Gjakovës e të Pejës, e gjithë t’parët e Shqypnisë anë mbanë ju bejlërë, e pashallarë, efendi e agallarë, ju ulema e hoxhollarë rë Shqypnisë! Pse s’kërkoni gjuhën tuaj t’bukur e shkolla shqipe prej guvernës barbare? Këtu ashtë selameti i kombit e i Shqypnisë, ndryshe s’ka selamet as për ju, as për fëmijën tuaj! (...).*”

³⁷ Mundimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, (përmbledhje artikujsh nga shtypi). Vëllimi II 1908-1910, Tiranë, 1976, f.197.

³⁸ A.K.T. *Dokumente dhe materiale, ç’thonë të tjerët për lidhjen Shqiptare të Prizrenit.*

³⁹ Për kontribut në fushën e arsimit dhe të kulturës kombëtare, u shquan: Luigj Gurakuqi, Hysen Hoxha, Babë Dudë Karabunara, Nikollë Kaçorri, Jani Minga, Sali Gjuka, Murat Toptani, Thanas Floqi, Elmas Boce.

⁴⁰ Instituti i Studimeve Pedagogjike, *Historia e arsimit shqiptar I*, Tiranë, 1990, f.201.

⁴¹ Kjo ishte përmbajtja e Programit arsimor të Qeverisë së Vlorës. Po aty. Luigj Gurakuqi dhe atdhetarë të tjerë shqiptarë, në vazhden e përpjekjeve të shumta, për një Program të Qeverisë së Vlorës me misionin që gjuha shqipe të zinte vendin e gjuhës zyrtare në tërë territorin e shtetit dhe gjithë trojeve etnike, që shkolla shqipe të merrte karakter shtetëror dhe orientim kombëtar, demokratik dhe laik, që arsimit fillor të bëhej i detyruar, ndërkaq mësuesit të përgatiteshin në Shkollën Normale dhe përmes kurseve të ndryshme etj.

⁴² Instituti i Studimeve Pedagogjike, *Historia e arsimit shqiptar I*, Tiranë, 1990, f.220.

⁴³ Abdullah R. Vokri, *Ibrahim Kolçi mësues dhe patriot*, Prishtinë, 1993, f.32.

për pushim vendlindjet e tyre, ata sillnin me vete abetare dhe libra të tjerë për vëllezërit e tyre. Mësuesit kosovarë të kësaj periudhe nuk ishin vetëm mësues, e as vetëm edukatorë. Ata ishin edhe luftëtarë të vendosur për bashkimin dhe ruajtjen e trojeve etnike stërgjyshore. Përpjekjet e atdhetarëve të Kosovës ndihmuan, që në vendlindje të silleshin sa më shumë libra dhe sa më shumë mësues, që të mbillej e përhapej dritë e diturisë. Edhe pse pushtuesit në Kosovë ndaluan mësimin e gjuhës shqipe, ky mësim bëhej në mënyrë ilegale. Kullat shqiptare të Kosovës, teqet, kishat, xhamitë u shndërruan në shkolla, ku zhvillohej mësimi i gjuhës shqipe.⁴⁴

Edhe pas shpalljes së Pavarësisë në Vlorë në Kosovë dolën një sërë sfidash të reja për fatin e gjuhës shqipe dhe lirisë së vendit. Programuesi dhe ideologu i Lëvizjes patriotike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, ishte eruditi Sami Frashëri dhe vepra “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet*”. Trojet e mbetura jashtë kufijve, pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, u vazhdua me këtë platformë. Në vështrim të dokumentacionit arsimor të viteve 1900-1928, “*në disa shkolla të Kosovës, në gjuhën shqipe zhvilloheshin këto lëndë: shkrim, gramatikë, hartim, numëratore, punëdore dhe shkronja, histori, këngë, mësim fetar.*”⁴⁵ Zhvillimi i mësimi ishte tepër klasik dhe i ndikuar nga kultura fetare, si katolike dhe ajo islame, sepse kryesisht zhvillohej në kisha, xhami dhe teqe. Roli i mësuesit ishte gjithëpërfshirës në klasë. Nuk punohej me libra, sepse ato mungonin, e si rrjedhojë mësuesit ishin të lirë në tematikën që zgjidhnin. Mësimdhënie mund të përkufizohej “*Atë që bën mësuesi, më pas ta bëjë nxënësi*”. Sipas statistikave, të cilave iu referohet edhe studiuesi Abdullah Vokri, deri në vitin 1918 mësimi në shumicën e shkollave të Kosovës zhvillohej vetëm në gjuhën shqipe.⁴⁶ *Pas vitit 1918, mësimdhënia në gjuhën shqipe ishte ndaluar dhe të gjitha shkollat në territorin e Kosovës mësimdhënien e zhvillonin vetëm në gjuhën serbe, pasi Kosova u ripushtua dhe mbeti nën sundimin e Jugosllavisë së vjetër (SKS).*⁴⁷ Popullsia shqiptare e Kosovës i ishte nënshtruar dhunës dhe ishte e privuar nga të gjitha të drejtat kombëtare dhe nga përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe. Gjatë kësaj periudhe shqiptarët e territoreve të mbetura nën Mbretërinë Jugosllave ishin të nënvlerësuar dhe nuk gëzonin të drejtat bazë të jetesës e të zhvillimit shoqëror, kulturor dhe arsimor. Edhe pse në Kosovë vepronin shkollat fillore, për nxënësit shqiptarë nuk ishte e drejta e përdorimit të gjuhës amtare, gjuha shqipe nuk lejohej as në komunikimin në mes vetë nxënësve shqiptarë në shkollë e as në atë zyrtar. “*Nxënësit shqiptarë, të cilët fitonin guximin të flisnin në mes vete në gjuhën e tyre, nga mësuesi (daskali) ndëshkoheshin fizikisht dhe përjashtoheshin nga shkolla...!*”⁴⁸ Shqiptarëve të Kosovës iu kanosej asimilimi dhe shfarosja. Ata konsideroheshin të pabesuar për t’u punësuar në administratën e kohës dhe në ushtri. Shqiptarët e Kosovës dhe trojeve të tjera në Jugosllavi nuk kishin të drejtë të kishin mbanin dhe të përdornin flamurin dhe emblemat kombëtare.⁴⁹ E tërë

⁴⁴ Mësimi i gjuhës shqipes zhvillohej ilegalisht edhe në formën individuale, ku ata që dinin shkrim-lexim mësonin njëri-tjetrin dhe në grupe, sidomos këtë punë e bënin hoxhallarët. Kurse të gjuhës shqipe ata organizuan në shumë treva të vendit. Kudo, këto kurse të mësimi të shkrim-leximit të gjuhës shqipe mbaheshin ilegalisht dhe me rreziqe.

⁴⁵ Robert Gjedia, *Arsimi në Shqipëri në vitet 1925-1939*, (tezë doktrature e mbrojtur në QSA, Tiranë, 2012, e pabotuar)

⁴⁶ Abdulla R. Vokri, *Shkollat dhe arsimi në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941)*, Prishtinë, 1990, fq.12-19.

⁴⁷ Mësimdhënia në shkollat e Kosovës zhvillohej vetëm në gjuhën serbe që vijohej nga një numër i vogël i nxënësve shqiptarë, të cilët nuk njihnin gjuhën serbe. Mësimdhënia ishte shumë e thjeshtë dhe qëllimi ishte të mësoheshin elementet e para të shkruarit në gjuhën serbe. Mësimi i fesë për nxënësit shqiptarë, që mësimin e mbanin në gjuhë të huaj ishte i detyruar, ku zbatonin sjellje dhe rregulla fetare.

⁴⁸ Intervistë e H.Likës, H.Gjoshit, dhe F.Isufit (nga Sankoci i Drenasit), nxënësi në shkollën fillore në gjuhën serbe, në Komoran të Drenicës, në vitin 1935, dhënë autorit në vitin 1986.

⁴⁹ Ali Hadri, *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave*, Prishtinë, 2003, fq.30.

administrata dhe shkollimi i kësaj periudhe në Kosovë ishte serbe dhe malazeze, ndërsa gjuha zyrtare ishte ajo serbe. Numri i shqiptarëve në administratën shtetërore qendrore dhe lokale ishte fare simbolike. Në këto rrethana politike, shoqërore, kulturore, sociale u zhvillua dhe arsimiti shqiptar në Kosovë.

Ndërkaq, sidomos nga viti 1919 deri në vitin 1941, mbi shqiptarët kishte pllakosur tmerri, ndërsa për arsimiti shqiptar as mund të flitej. Mësimi i gjuhës shqipe nuk lejohej të zhvillohej në shkollën fillore dhe as në një nivel shkollimi.⁵⁰ Nxënësit shqiptarë, që ishin në numër të pakët të vijonin këto shkolla, një vit duhej të mësonin gjuhën serbe, para se të nisnin klasën e parë në gjuhën serbe dhe për ata shkollimi fillor zgjaste një vit më shumë. Rrjeti shkollor ishte shumë i varfër.⁵¹

Lufta e Parë Botërore apo Lufta e Madhe ishte lufta që përfshiu pothuajse gjithë botën, nga viti 1914 deri në vitin 1918. Gjatë viteve 1914-1919, Shqipëria u përfshi në Luftën e Parë Botërore. “Në tokat shqiptare kjo luftë u përfaqësua nga forcat e ushtrive austro-hungareze, italiane, franceze, greke, bullgare, serbe e malazeze”⁵² Është karakteristikë se qëndrimi i shqiptarëve në këtë kohë, dëshmon qartë në asnjërinë e tyre ndaj ushtrive ndërluftuese. Asnjëria, duket se ka patur qëllim të vetëm ruajtjen e territoreve dhe të integritetit kombëtar, që kishte të bënte me ruajtjen e gjuhës amtare dhe vijimësinë e shkollave shqipe. Me kujdes të veçantë, politikëbërësit e arsimit shqiptar të kësaj periudhe ishin të shtrenguar të hartonin strategji arsimore, të studiuara mirë, që synonin ngritjen e rrjetit shkollor, nxitjen e edukimit, në frymën kombëtare. Tri kultura të ndryshme europereëndimore (*austro-hungareze, franceze dhe italiane*), nëpërmjet organeve ushtarake të pushtimit, ushtruan presione politike për të imponuar sistemet e tyre. Nga ana tjetër, monarkitë ballkanike në zonat e pushtuara prej tyre, pengonin në mënyrë kategorike çdo iniciativë të arsimit në shqip në zonat e mirëfillta natyrale shqiptare, shqipfolëse. Megjithë kufizimet që vendosi statusi i luftës, gjatë periudhës 1914-1918, nuk u shua shkolla shqipe e as përpjekja për shtrirje të reja. Gjendja e krijuar ndërpreu Qeverinë e Vlorës për një zhvillim të njësuar arsimor mbarëkombëtar, por arriti të ruaj të pashuar frymën kombëtare tek shkollat.⁵³ Specifikë e këtyre viteve në fushën e arsimit është fakti se gjuha shqipe u bë gjuhë zyrtare, gjuhë mësimi në shkolla, gjuhë e infrastrukturës, me përjashtim të zonave të shkelura nga monarkitë ballkanike. Gjatë këtyre viteve u krijua rrjeti i shkollave shqipe, i cili shtrihej përkohësisht në një pjesë të Kosovës, dhe në trevat shqiptare. Shkollat, në përgjithësi ishin të përziera dhe laike dhe u udhëhoqën nga fryma e bashkimit, nga mënyra e organizimit perëndimor, si dhe u mbështetën kryesisht në parimet e pedagogjisë herbartiane dhe asaj të Komenskit. Synimi i tyre ishte që arsimit dhe kultura shqiptare të aderojnë në sistemet arsimore evropiane. Këto vite karakterizohen edhe me hapjen kurseve të shpejta për përgatitjen e mësuesve dhe vijuan studimet jashtë vendit shumë nxënës, në shkolla të mesme dhe të arsimit të lartë në Europë, sidomos në: Austri, Itali, Francë e Zvicër. Madje, u zhvilluan tubime me

⁵⁰ Svetozar Canovic, “*Specifcni problemi nastave u skolama Kosova i Metohije*”, Prishtinë, 1967, faqe 78. (Gjithçka zhvillohej duke u mbështetur në planet dhe programet mësimore serbe, ndërkohë që gjuha shqipe nuk u lejua. Kjo politikë ishte karakteristikë e sistemit sundues të periudhës së Jugosllavisë së Vjetër).

⁵¹ Abdulla R. Vokri, “Shkollat dhe arsimiti në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore” (1918-1941), Prishtinë, 1990, faqe 26.

⁵² V. Duka, *Historia e Shqipërisë*, vepër e cituar, f. 89.

⁵³ Zhvillimi i arsimit shqiptar në këtë periudhë pati karakteristikat e veta me zhvillime të pjesshme, me bazë zonale të vendit, por gjithsesi ruajti veçoritë e identitetit kombëtar në saje të qëndrimeve dhe kujdesit të mësuesve, specialistëve të arsimit dhe sidomos të patriotëve shqiptarë. Ky aktivitet jo rrallë arrinte edhe përtej kufijve të imponuar, në Kosovë, ku mësimi bëhej kryesisht ilegalisht.

mësues, specialistë të arsimit në qytete të ndryshme brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë, për problemet e zgjerimit të rrjetit arsimor shqipfolës, për shtypjen e teksteve shkollore, revistave dhe botimit të literaturës pedagogjike; u themeluan shoqata studentore; u ndje rreziku i shkollave të huaja dhe u nxit mendimi për nevojën e një kontrolli shtetëror të veprimtarisë së tyre. Gjatë Luftës së Parë Botërore, mësues dhe specialistë të shumtë të arsimit lëviznin vullnetarisht, sipas nevojave, nga Kosova në Shqipëri dhe anasjelltas duke shërbyer si mësues. Këto vite të rënda janë të rëndësishme sepse në kushtet e luftës nuk u ndërpre asnjëherë lufta për çeljen e shkollave shqipe dhe zgjerimin e rrjetit shkollor, botimit të teksteve mësimore dhe zhvillimin e shkollës shqipe. Gjithçka që u përmend për këtë etapë të shkollës sonë, shpie në përfundimin se edhe në kushtet e Luftës (1914-1918), ajo vazhdoi rrugën e nisur, pa krijuar vakuum në zhvillimin e arsimit shqiptar.⁵⁴

⁵⁴ Ndërkohë, në këtë periudhë u shfrytëzuan mundësitë për të përfutuar nga përvojat dhe modelet e shkollave të vendeve të zhvilluara të Evropës në fushën e didaktikës, por duke ruajtur frymën e shkollës kombëtare.

1.3. GJENDJA E ARSIMIT NË GJUHËN SHQIPE NË ZONAT E ADMINISTRUARA NGA AUSTRO-HUNGAREZËT

Gjatë kësaj periudhe kohore austro-hungarezët në vitin 1916 arritën të vendosnin kontrollin e tyre në disa zona të Shqipërisë.⁵⁵ Në Kosovë gjendja e shkollave në periudhën 1915-1918, territori i saj ndahej në dy zona okupimi, të Austro - Hungarisë dhe të Bullgarisë. Derisa pushteti okupues bullgar ndaloj rreptësisht hapjen e shkollave shqipe. Austro-Hungaria pati një qëndrim tjetër. Pas vitit 1915 në këtë zonë në shumë mjedise të Kosovës filluan të punonin shkollat shqipe. Ishte kjo hera e parë që Kosova të legalizohej shkolla shqipe. Kështu, shkolla të këtilla u hapën në: Zym, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Vushtrri, Pejë, Gjurakoc, Beran, Zllakuqan, Strelc, Istog, Plavë, Guci, Brodosanë, Rakosh etj.⁵⁶ Një situatë e tillë e rëndë ekzistonte dhe në pjesët e tjera të Shqipërisë, të okupuara nga ushtritë ndërluftuese franceze, italiane, bullgare, ndërsa në disa krahina të tjera vijonin të qëndronin forcat ushtarake greke e serbe. Kjo ndarje e territorit shqiptar në parcela të pushtuara, me kahe të ndryshme politike, e thelloi dhe e bëri shumë të vështirë mbështetjen e idesë për të vijuar lirisht me linjën kombëtare.⁵⁷ Secili pushtues u përpoq të impononte në arsim përmbajtjen dhe sistemin e tij të organizimit. Në zonat ku shtrihej sundimi ushtarak austro-hungarez, u ndoq e njëjta politikë arsimore si më parë, por tani, në kushtet e pushtimit ushtarak, *Austro-Hungaria u lejoi shqiptarëve përdorimin e simboleve kombëtare, si: flamurin, njohu gjuhën shqipe si gjuhë mësimi e krahas saj gjermanishten. U pranua festimi i 28 Nëntorit si festë kombëtare dhe u nxit përpunimi i terminologjisë shqipe të administratës, por dhe asaj arsimore në veçanti.*⁵⁸ Ndër masat e rëndësishme që mori intelijenca shqiptare e kohës ishin: përhapja e mësimi të shqipes përmes formave individuale, pastaj futja me përpjekje të shumta më me ngulm e shqipes në shkollat e huaja që punonin në trojet shqiptare dhe, më pas, çelja e shkollave shqipe, tërësisht të pavarura nga shkollat e huaja. Ishin këto tri faza kryesore nëpër të cilat kaloi shkolla jonë kombëtare. Aktivitetet atdhetare dhe arsimore e kulturore zhvilloheshin kryesisht nëpër klube, ku tuboheshin atdhetarët...*në tërë shkollat shqipe të qeverisë në Shqipëri po përgatiten që të vejnë mësonjës për të mësuar djemt gjuhën e tyre*,⁵⁹ ku pati ndikime të ndjeshme “Komisia Letrare Shqipe”, që zhvilloi një aktivitet të gjerë gjuhësor, letrar, artistik e pedagogjik në të cilin punuan autoritete të afirmuara intelektuale shqiptare dhe të huaja. Duke përfitur nga toleranca e autoriteteve austriake, Komisia Letrare i vuri vetes detyrë që të bëhet hartimi dhe botimi i librave shkollorë; qortimi i dorëshkrimeve dhe caktimi i shkronjave teknike dhe unifikimi i ortografisë. Në mbledhjen e datës 11 shtator 1916, u kërkua nga Komisia “*për me ba një gjuhë letrare*”. Lidhur me këtë çështje pjesëmarrësit kërkonin të sqaronin “*në ka Komisia një gjuhë të saj, elementet e nevojshme për me ba një gjuhë administrative, në mënyrë qi të jetë e kuptueshme prej të tana viseve të Shqypniës, mbasi që sot për sot të shkruem janë vetëm dialekti i Shkodrës dhe i Tosknisë*”.⁶⁰ Pas diskutimesh u arrit në përfundimin që Komisia do të zgjidhë ato probleme

⁵⁵ Kanini Ilir, *Arsimi në vitet e LPB, Zona e pushtimit Austro-Hungarez, 1916-1918*, Tiranë, 2001.

⁵⁶ Ragip Gjoshi, *Gjendja e arsimit gjatë Luftës së Parë Botërore*, Prishtinë, 2014.

⁵⁷ Ndarja e Shqipërisë preu përgjysmë dhe aspiratat arsimore të shqiptarëve. Në të vërtetë kështu u përmbys Projekti i kësaj qeverie për ngritjen e një sistemi të njësuar arsimor kombëtar shqiptar.

⁵⁸ Zenun Gjocaj, *Roli i mësuesit dhe i shkollës shqipe në kohën e Rilindjes Kombëtare*, “100 vjetori i shkollës shqipe të vashave në Prizren”, Simpozium shkencor i mbajtur në Prishtinë më 13 nëntor, 1992, f.97.

⁵⁹ Gazeta “Kombi” e 1 janarit të vitit 1909.

⁶⁰ AQSh, *Fondi 847*, viti 1916, dosja 6, faqe 5.

që mundet. Komisia Letrare për problemet e arsimit dhe të gjuhës,⁶¹ pati si këshilltar albanologun e njohur Prof. Nachtigal. “*Nuk ka dyshim se secili prej nesh e di fort mirë se nuk mund të jetë sot për sot qëllimi i ynë i parë ortografia, po pa dyshim, një gjuhë e përbashkme, ajo na mungon e na duhet medoemos. Asht e ditun se ku s’ka gjuhë, s’ka as orthografi*”⁶², pati thënë Kryetari i Komissisë, Gjergj Pekmezi, duke propozuar që, të merrej një dialekt për bazë, prej të cilit të bëhej një skelet e të vishej me frazeologjinë dhe leksikologjinë e tërë dialekteve të tjera. Pekmezi pajtohej të mbeteshin përkohësisht dy dialektet e shkruara, njëri pranë tjetrit, duke i afruar e duke i përhapur të dy me çdo mënyrë në të tëra anët e Shqipërisë, “*qi të bahej një fërkim, i cili do të shkaktojë atë flakë qi dëshirojmë dhe që të merren parasysh ndryshimet tipike ndërmjet dialekteve, “duke parë se ç’ka bërë gjuha vetë në këtë çështje dhe t’i vemi pas*”.⁶³ Ndërsa, Gurakuqi propozoi të zgjidhej një dialekt, duke sugjeruar dialektin e Elbasanit, pikëpamje e pranuar edhe nga Fishta dhe ndonjë tjetër. Komisia Letrare vendosi të zgjedhë si gjuhë të përbashkët për t’u përdorur në shkollë, *dialektin e Elbasanit*. Po këto autoritete vendosën përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare të Shqipërisë.⁶⁴ “*Duam të bëjmë të mira në ndë vent, po nuk e dijmë qysh të punojmë, që të arrijmë ndë këtë qëllim, nuk kemi një qeveri, e cila të na e udhërojnë dhe të na ndritojnë mendjen.*”⁶⁵ thuhej në një shkrim të gazetës “*Shqipëria*”. Austro-hungarezët e organizuan arsimin duke krijuar së pari Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit, me qendër në Shkodër, si institucioni më i lartë në fushën e arsimit. Rrjeti i drejtorive, në varësi përfshinte edhe tri drejtori arsimore të tilla si⁶⁶: Drejtoria arsimore ishte për Shqipërinë e Veriut, me qendër në Shkodër.⁶⁷ Kështu, Gurakuqi, ish-Ministri dhe ish-drejtor i “*Normales*” së Elbasanit u caktua në krye të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit në Shkodër, ndërsa në drejtoritë që vareshin prej saj, u emëruan *Sali Gjuka në Berat, Ali Korça në Tiranë dhe Gjergj Pekmezi në Shkodër*.⁶⁸ Drejtoria arsimore për Shqipërinë e Veriut nxori mjaft akte ligjore dhe shkresa zyrtare për shkollat si: udhëzime, urdhra, qarkore, që synonin të mbështetnin shkollat për: *ndjekjen e detyrimit shkollor, frekuentimin e shkollës nga nxënësit, plotësimin e nevojave të shkollave dhe kontrollin e punës mësimore të mësuesve*. Edhe pse një pjesë e Shqipërisë ishte ende nën sundimin e huaj, qeveria hapi disa shkolla gjatë vitit shkollor 1912-1913 shkollat shqipe vazhduan të rriten. “*Mjerisht edhe në këto nandë muajt e fundit nuk mundëm me banum sa lypsej për çështjen e arsimit. Gjendja e mjerë e Shqipërisë, që ndodhej e shkelur e qarkuar nga të huejtë, nuk na premtoi ta mbaronim si duhej detyrën tonë. Megjithëkëtë, duke pritun që*

⁶¹ V. Duka, *Historia e Shqipërisë*, vepër e cituar, f. 93. (Në mbledhjen e datës 11 dhjetor 1916 u diskutua gjerësisht për krijimin e gjuhës së përbashkët. Kryetari i Komissisë, Gjergj Pekmezi).

⁶² AQSh, *Fondi 847*, viti 1916, dosja 9, faqe 2.

⁶³ Ilir Kanini, *Arsimi shqiptar gjatë periudhës 1912-1920*, vepër e cituar, f. 136.

⁶⁴ Atmosferën politike, synimet dhe angazhimin e patriotëve tanë në prag të Luftës së Parë Botërore dhe orientimet e lëvizjes gjithëshqiptare, i pasqyron edhe shkrimi i gazetës “*Shqipëria*”, ku midis tjerash thuhej se “*Nga të tëra anët e Shqipërisë na vijnë letra, të cilat dëftojnë flaken dhe dashurinë e popullit për të ndriçuar fatnë e atdheut. Po e liga është që nuk kemi një qendër, një udhë të përbashkët, të tërë, nuk dijmë se nga vemi.*”

⁶⁵ Citim nga revista “*Shqipëria*” e Bukuresht, 30 gushtit 1897.

⁶⁶ AQSH, *Fondi 195 i Arsimit*. Viti 1919. Dosja 56, faqe 7-10.

⁶⁷ Drejtoria arsimore mbulonte Shqipërinë e Mesme, me qendër në Tiranë, dhe Drejtoria Arsimore për Shqipërinë e Jugut, me qendër në Berat. Austro-hungarezët e njohën mirë psikologjinë dhe motivin e fortë të shqiptarëve për arsimim, ndaj vendosën në krye të institucioneve arsimore personalitete me reputacion, figura të njohura dhe të shquara politike dhe kulturore të kohës.

⁶⁸ Në këtë etapë historike vazhduan përpjekjet për hapjen e shkollave, duke filluar nga “*Shkolla popullore*”, me rihapjen e shkollave private e të huaja, si: *shkolla françeskanë, jezuite, stigmatine, italiane* derisa më 1916-1917, funksiononin, veç këtyre, edhe 17 shkolla, si dhe kursi pedagogjik për mësuesit e fshatit. Në këtë zonë u punua me programet e hartuara nga Gaspar Beltoja, mbështetur në programet e shkollës austriake.

Shqipëria të lirohet e tanë, duhet të mendohemi e të përkujdesemi për atë pjesë ma fatmirë që ndodhet sot e lirë”, - shkruante Ministri i Arsimit në qeverinë e Vlorës, z. Luigj Gurakuqi.⁶⁹ Nga shqyrtimi i dokumentacionit arsimor të viteve 1914-1918 në shkolla, në gjuhën shqipe në Kosovë zhvilloheshin këto lëndë: shkrim, gramatikë, hartim, numëratore, Roli i mësuesit ishte gjithëpërfshirës në klasë. Ai drejtonte, kontrollonte, disiplinonte fëmijët në çdo çast. Fëmijët zakonisht punonin individualisht në bankat dhe tabelat e tyre, ku të mësuarit zhvillohej përmes një drejtimi të tillë: “Atë që bën mësuesi, më pas ta bëjë nxënësi”. Deri në vitin 1918 si kudo në Shqipëri edhe në Kosovë zhvillohej vetëm në gjuhën shqipe⁷⁰. Ndërsa, në vitin shkollor 1918-1919, në tërë Kosovën kishte gjithsej 68 shkolla fillore.⁷¹ Deri në rianeksimin e Kosovës, sipas të dhënave arkivore shihet se u mbyllën 50 shkolla shqipe, në të cilat mësonin më se 4000 nxënës. Në to punonin 100 mësues. Përmbylljen e shkollave shqipe në Kosovë qenë angazhuar formacione të ndryshme të armatosura, siç ishin: ushtria, xhandarmëria, garda policore, e sidomos e ashtuquajtura “çeta fluturuese”, çeta çetnike, të specializuar për krime dhe masakra mbi shqiptarët e pambrojtur.⁷² Dhunë e tortura të rënda bëhen në Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Prizren dhe gjetiu. Në atë kohë, kërkoheshin me urgjencë listat e mësuesve shqiptarë që kishin dhënë mësim në shkollat, të cilat i kishte hapur Austro - Hungaria. Lidhur me këtë, në një qarkore të xhandarmërisë, e cila qarkullonte nëpër Kosovë, thuhej: “Duhet të likuidohen të gjithë ata mësues që kanë mbetur në Kosovë, si dhe nxënësit e tyre, të cilët po i përhapin me të madhe idetë kombëtare dhe të bolshevizmit në masën e shtypur shqiptare, që është jetësisht e interesuar për çështjen agrare dhe nacionale.”⁷³ Kjo qeveri e egër vendosi mure ndarëse ndërmjet shqiptarëve të Shqipërisë dhe të Kosovës. Ishte vënë ndjekje e depërtimit të librave, gazetave, revistave, të cilat nuk mund të silleshin në Kosovë. Atij që i gjendej libri shqip në këtë periudhë, e paguante me kokë. Libri shqip ishte privilegj vetëm i atyre që shkolloheshin përtej kufirit të Mbretërisë SKS. Në atë kohë, ishin ndërmarrë të gjitha masat që asnjë libër shqip të mos depërtonte në këtë truall. Për këtë ishin angazhuar agjentët e Pashiqit, të cilët abetaren tonë e konsideronin “Barotin më të tharë”...!⁷⁴ Për shqiptarët e Kosovës, ushtrohej një gjenocid i paparë, atyre iu mohojë përdorimi i gjuhës amtare, liria e shkollimit në gjuhën e tyre, etj.

⁶⁹ Gazeta “Përlindja e Shqipërisë”, 24.08.1913. (Citimet e shkruara në këtë punim, ruajnë origjinalin, sipas autorëve.)

⁷⁰ A. R. Vokri, *Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore* (1918-1941), Prishtinë, 1990, f.12-19. (Pas vitit 1918, në këto shkolla filloi të mësohej dhe gjuha serbo-kroatishite, pasi Kosova u ripushtua dhe ra nën sundimin e Jugosllavisë së vjetër.)

⁷¹ V. Duka, *Historia e Shqipërisë*, vepër e cituar, f. 89. (Në tokat shqiptare kjo luftë u bë arenë e ushtrive austro-hungareze, italiane, franceze, greke, bullgare, serbe e malazeze. Shkollat ishin në një gjendje të mjerueshme; u mungonin mjediset mësimore, mjetet didaktike, orënditë e pajisjet dhe shpeshherë ato më të domosdoshmet. Pjesa më e madhe e shkollave ishin shtëpi private apo lokale të tjera të papërshtatshme që ishin përshtatur dhe improvizuar nga xhamitë, teqetë, manastiret etj.)

⁷² Shumë mësues të kësaj periudhe u ndoqën, u burgosën, u intermuan dhe u persekutuan pa mëshirë. Edhe i tërë dokumentacioni pedagogjik i shkollave u zhduk në tërësi. Ekspeditat ndëshkuese të formacioneve serbe mbi institucionet edukativo-arsimor shqiptare kishin për qëllim zhdukjen e çfarëdo gjurme që do të dëshmonte se në këto shkolla ishte mësuar ndonjëherë në gjuhën shqipe.

⁷³ A.J.fig.14.f.102-409, Telegramsko odeljenje o kocackoj aktivnosti na Kosovu. (Ky telegram është fakt se në emër të luftës kundër kacakëve bëhej terror mbi shqiptarët me aksionin barbar kundër arsimit dhe shkollës shqipe e kishin marrë përsipër zbatuesit e politikës së Mbretit Aleksandër, si: Pashiqi, Pribiqeviqi, Drashkoviqi, Toma Popoviqi, Punisha Raçiqi etj.)

⁷⁴ Në raportin e Ministrisë së Jashtme të vitit 1924, dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, në mes tjerash thuhej se: “Sipas informatave që morëm, në Kosovë janë nisur dy kontigjente me libra shqip, njëri nga Shqipëria dhe tjetri nga Vjena. Të merren të gjitha masat paraprake që ato libra kursesi të mos bien në dorë të shqiptarëve,

1.4. GJENDJA E ARSIMIT NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE (1918-1941)

Që në programet e para mësimore të gjuhës amtare për edukimin e nxënësve të Kosovës tregohet dashuria për gjuhën “...detyra e mësuesit të gjuhës shqipe është t’u ushqejë nxënësve dashuri për gjuhën...”⁷⁵ Ndërsa në Shqipëri, mësimi i gjuhës shqipe ishte parësor në shkolla, Kosova pas përfundimit të Luftës së parë Botërore u ripushtua nga mbretëria SKS. Kosovës dhe të trojeve të tjera shqiptare jashtë kufijve politik të Shqipërisë u ndalua shkolla, duke mbetur pa arsim në gjuhën amtare dhe në një gjendje prapambetjeje e diskriminimi ekonomik dhe politik.⁷⁶ Gjatë viteve 1918-1941, me synimin që të mbahej nën kontroll të përhershëm dhe të dundohej më lehtë, edhe territori i Kosovës u nda në pikëpamje territoriale-administrative disa herë.⁷⁷ Nga burimet arkivore përkatëse të konsultuara fshihet fare mirë se para vitit 1914 në Kosovë kishte fare pak popullësi serbo-malazeze. Mirëpo kolonizimi i kësaj treve me serbë e malazez fillon në vitin 1914, sipas dekretligjit të nxjerrë po në këtë vit. Duke dashur të përshpejtonte kolonizimin, më 6 prill të vitit 1919, mbreti Aleksandër, lëshon një proklamata, në të cilën thuhej: “Unë dua që të merret menjëherë në dorë zgjidhja e drejtë e çështjes agrare.”⁷⁸ Ripushtimi i Kosovës, pushteti serb jo vetëm që nuk lejoi shkolla shqipe,⁷⁹ por i mbylli edhe ato pak shkolla që i kishte hapur Austro-Hungaria gjatë viteve 1916-1918. Ndaj shqiptarëve ushtrohej politikë diskriminuese e represive, “... qëllimi i së cilës ishte që ky popull ose të asimilohej e të shkombëtarizohej, ose të humbiste perspektivën e shpërnguljes nga këto troje.”⁸⁰ Hapi i mbylljes së të gjitha shkollave shqipe në Kosovë, nga Ministria e Arsimit, Mbretërisë SKS, pasoi me hapjen e shkollave serbe. Qarqet sunduese vlerësonin se, *shkolla ishte një ndër instrumentet më efikase për kolonizimin e viseve shqiptare*. Hapja e shkollave serbe në Kosovë kishte synim që përmes institucioneve shkollore të bëheshin përpjekje për shkombëtarizimin sistemik të shqiptarëve.⁸¹ Në këto numri nxënësve shqiptar të regjistruar në shkollat serbe ishte simbolik;

në të kundërtën Serbisë do t’i sjellin dëme të paparashikuara, të cilat s’do të jetë në gjendje t’i kompensojë as ari i minjerës së Borit.” (AJ.FMPT,f.197,D.br.1945/9.XI-1930.)

⁷⁵ Programi i gjuhës shqipe, 1914.

⁷⁶ Abdullah R.Vokri, *Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy Luftërave Botërore* (1918-1941), Prishtinë, 1990, f.19.

⁷⁷ Sipas statistikave të kohës llogaritet që gjatë vitit 1920, në Kosovë 90,6% ishin analfabetë. Kosova në këtë periudhë ishte pjesa më e prapambetur e mbretërisë SKS dhe popullsia e saj kryesisht merrej me bujqësi ekstensive. Toka punohej me mjete primitive, kështu që edhe rendimentet ishin tejet të ulëta. Blegtoaria gjithashtu ishte e prapambetur. Llojet më të njohura të zejeve ishin tabakëxhinjtë, opingapunuesit, fraktarët, zdrukthetarët, qërrepunuesit, muratorët, nallbanët, prodhuesit e çerpiqve, drugëdhendësit, berberët, rrjeti i mullijve me ujë, etj.

⁷⁸ Hajredin Hoxha, “Përparimi”, nr.1, 1970,1970,f.316.

⁷⁹ Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizajicja na Kosovu*, 1918-1941, Pristina, 1981, st.6. (Kjo nuk ishte në të vertetë ndonjë reformë agrare, por shqiptarëve u merrej toka me dhunë, që ata dhunshëm të braktisnin trojet e tyre dhe të shpërnguleshin për në Shqipëri e Anadoll.) Kjo proklamata pastaj merr formën e ligjit në parlamentin serb, dhe menjëherë fillon kolonizimi i viseve shqiptare me sllavë. Kolonizimi i Kosovës u bë në tri faza: periudhën e viteve 1914-1920, periudha 1921 e deri më 1931 dhe në fazën e tretë (1931-1939) kur kolonistëve u jepej toka e punuar që u merrej shqiptarëve me dhunë.

⁸⁰ AJ.F.MP,fig.66/ON,f.39;d.br.3094/15-X-,fond u sredjivanje. (Janë të shumta burimet arkivore të kësaj periudhe e dëshmojnë qarqet sunduese serbe asnjëherë nuk e ndalën luftën e tyre kundër gjuhës shqipe, kundër shkollës dhe arsimit tonë kombëtar, kundër kulturës e shkencës sonë, me një fjalë kundër gjithçkaje shqiptare.)

⁸⁰ Abdullah R. Vokri, *Shkolla dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave* (1918-1941) Prishtinë, 1990, f.6-7.

⁸¹ Një synim të këtyre të shprehte haptas edhe inspektori i arsimit të mbretërisë SKS, në një raport të vitit 1923: “Në aspektin nacional në këto qëndrojmë shumë keq. Për këtë arsye, zoti ministër, kam nderin t’u tërheq vëmendjen që t’i ndihmoni sa më tepër ata që shkollohen këtu. Vetëm me ndihmën e shkollave do të mund ta përmirësojmë gjendjen tonë numerike këtu” (AJ.F. MP, Iz godisnjeg za tkolsku 1922/23 god.)

djemtë përbënin 6,5%, ndërsa vajzat shqiptare 0,5% në këto shkolla.⁸² Mosnjohja e gjuhës serbe nga nxënësit shqiptarë i vinte ata në një pozitë të pabarabartë kundrejt nxënësve serbë, që i kishin mësimet në gjuhën e tyre.⁸³ Ndaj nxënësve shqiptarë zbatoheshin në disiplinë e rreptë, tejet e vrazhdë, e shfrenuar dhe primitive, përherë mësuesit serbë i quanin nxënësit shqiptarë; *muhamedanë, myslimanë, turq, arnautë, shiftari*, dhe emratjerë nënçmues, por asnjëherë shqiptarë.⁸⁴ Ideatorët e politikëbërësit serb në fushën e arsimit, në rrethanat të kohës gjendeshin para dilemave se si të vepronin me nxënësit shqiptarë.⁸⁵ Këtë e dokumenton edhe shtypi serb i kohës me orientime majtiste,⁸⁶ ku pasqyrohet pozita e shqiptarëve e keqësuar edhe më tej në periudhën 1929-1941, nën Mbretërinë jugosllave me diktaturë monarko-fashiste. Të gjitha institucionet edukativo-arsimore shndërrohen në instrumente të drejtpërdrejta të shtetit.⁸⁷ Këto veprime rezultuan me ndjekjen masive të shqiptarëve për në Turqi. Kosova në mes dy luftërave botërore, kishte rrjetin, shkollat më të pazhvilluar në shtetin ku ishte aneksuar dhunshëm. Zhvillimi i ulët ekonomik dhe shkalla e lartë e analfabetizimit (*më se 90,6% e popullatës analfabete*) reflektoheshin me gjendjen e rëndë. Do theksuar se për pasojë, kur akordoheshin

⁸² Milovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizajica na Kosovu, 1918-1941*, Pristina, 1981, f.6. (Qeveritë serbe nuk e përfillën asnjëherë rezolutën “Mbi minoritetet”, miratuar nga lidhja e kombeve, si dhe as të ashtuquajturin Traktat të Sen Zhermenit, të cilin më 10 shtator të vitit 1919 e kishte nënshkruar edhe Mbretëria SKS, sipas neneve 7, 8 dhe 9 të kësaj marrëveshjeje, çdo palë nënshkruese obligohej që minoriteteve t’u siguronte jetën, lirinë, të drejtat qytetarëve. (Vërejtje imja, R.Gj.) Shih dhe AJ.F.MP.F.300;d.br.377/3.Ill.1920. spisak mesta u kojima treba podici nove skole (shq.regjistri i vendeve ku duhen te hapen shkolla të reja).

⁸³ AJ.F.MP.F.300,d.377/3.Ill.1920,ka0 I fik. 91/95;d.br.21/4-X-1919. (Sipas dëshmitarëve të kohës nxënësit shqiptarë uleshin në fund të klasës, në bankat më të vjetra, nuk lejoheshin të merrnin pjesë nëpër aktivitete të lira dhe në stërvitje fizike, sepse ishin shqiptarë, që ushtrohej mbi shqiptarët.)

⁸⁴ AJ.F.MP.Pov.d.66.k.59.d.poc.169,d.poc.169.d.pov.2;d.pov.270, (Si dëshmi po sjellim deklaratën e një mësuesi serb, me rastin e marrjes së tij në pyetje nga organet e pushtetit: “Zotrini, unë kamë ardhur këtu në detyrën e mësuesit, më qëllim që t’i edukoj dhe t’i arsimoj fëmijët shqiptarë ashtu siç na preferon pedagogjia e jo t’i vras ata. Unë jam mësues, zotërinj, e jo kriminel. Këtë do ta them para çdokujt.” Atëbotë mësuesi i rrihte fëmijët sikur ata të ishin ata kriminelë.

⁸⁵ Kjo mund të vërehet edhe nga një raport i përmbledhur në 20 faqe të shtypura me makinë, prej të cilit po shkëpusim: “A thua shkolla do të ketë sukses ta çrrënjos nga këta nxënës atë urretjtje ndaj fisit tonë, të cilën këta e thithin me qumështin e parë nga gjiri i nënës shqiptare, dhe ata t’i bëjë qytetarë të mirë, miq të Serbisë, apo të urretjtjen e tyre të lindur shkolla do t’ua thellojë edhe më tepër, S’do harruar se shqiptarët iu kanë rrekur shkollës. Shkolla atyre ua ka hapur sytë.. Vallë, mos është më mirë që fëmijës shqiptarë të ngelnin analfabetë dhe të urtë, apo të shkolluar e me urretjtje të ndezur ndaj nesh?! Për këtë duhet të mendohet mirë.(shih.AJ.F.MP,f.197;d.br.1645/9-XI-1930) Sipas burimeve sekrete, që sot ruhen në Institutin Ushtarak të Beogradit, shihet fare mirë se në vitin 1920, Serbia ishte shteti i parë i Evropës që kishte ngritur kampet e përqëndrimit në Nish dhe në Vranjë për likuidimin e popujve joslavë. Sipas të dhënave statistikore kriminalistike, shihet se në periudhën e viteve 1919-1922 “mbi 20.000 të rinj kosovarë vuanin nëpër burgjet serbe pa kurrfar gjykimi... po në këtë periudhë forcat çetnike serbe kishin djegur edhe masakruar në Kosovë më se 182 fshatra.” (Shkollat dhe arsimit serb ishte në shërbim të realizimit të projektit “Naçertania” të Ilia Garashaninit, dhe projekteve famëkëqija të Vasa Qubrilloviqit e të Ivo Andriqit. Burime të shumta arkivorë të kësaj periudhe dëshmojnë pozitën e shqiptarëve, e cila u keqësua sidomos me “Obznanën” në vitin 1920, si dhe pas nxjerrjes së “Ligjit mbi mbrojtjen e shtetit”, më 1921.)

⁸⁶ Socijalistika zora, nr.1.1920. AJ.MUP.fig.14.Kriminalna statistika, viti 1919-1922; si dhe “Socijalistika zora.”1920. (Për etnocidin dhe gjenocidin serb që ushtrohej mbi shqiptarët e pambrojtur shkruante “Socialisticka zora”, në artikullin me titull “Shkatërrime barbare”, përveç të tjerash thuhej: “Me dhjeta vjet në këto anë të Kosovës po bëhen ndjekje, tortura dhe masakra nga më të ndryshmet kundër popullsisë së pafajshme shqiptare. Qeveria serbe me politikën e vet robëruese askund nuk ishte më e egër se në Kosovë. Krime të kësaj natyre që bëhen në këto anë nuk i njih historia. Shumica se fshatarëve ende u vjen era vdekje dhe barot.)

⁸⁷ Gazeta “Hak”, nr.709,26 janar, 1924. (Në artikullin me titull “Jashtë çdo mase”, përveç të tjerave, thuhej: “Zotrinijtë e Beogradit duhet të shërohen njëherë e përgjithmon prej sëmundjes së tyre, sepse nuk do të arrijnë kurrën e kurrës atë që kanë planifikuar kundër shqiptarëve autoktonë dhe gjithmonë shumicë në këto troje.)

mjetet e buxhetit për shkolla, ndërmjet drejtorit të shkollës dhe anëtarëve të këshillit të shkollës (pjesa dërrmuese e anëtarëve të tij ishin analfabetë) shpeshherë shkakttoheshin konflikte. Në periudhën në mes viteve 1918 -1941 në Kosovë vepronin edhe shkollat fetare, të cilat këtu kishin një traditë mjaft të gjatë.⁸⁸ Nga të gjeturat arkivore të kësaj periudhe rezulton se në të ashtuquajturën “Serbi të jugut” (Kështu e thërrisnin Kosovën, serbët. R.Gj.) problem i shkollimit të shqiptarëve ishte komplikuar shumë.⁸⁹ Sipas dokumenteve të shumta të kësaj periudhe, disa imam dhe mësues të fesë islame shquheshin për orientime kombëtare dhe për përhapjen e gjuhës shqipe. Kjo kishte nxitur nevojën që këta njerëz të mbaheshin nën kontrollin shtetëror serb.⁹⁰ S’ka dyshim se disa nga imamët dhe mualimët e këtyre shkollave, krahas punëve të fesë, vepronin edhe në rrafshin kombëtar e sidomos në përhapjen e mësimit të gjuhës shqipe.⁹¹ Gjuha shqipe kështu kishte hyrë në këto shkolla. Kjo shoqatë ndihmoi shumë për shpërndarjen e librit shqip dhe organizimin e kurseve të mësimit të gjuhës shqipe nëpër xhami dhe oda të Kosovës. Mësimdhënës të kurseve ishin hoxhët. Kjo veprimtari u bie në sy organeve të pushtetit serb, prandaj ato bëhen më vigjilente dhe e shtojnë presionin ndaj mualimëve të mjetepeve. Për këto shkolla, pas një vizite në vitin 1925, duke parë se mualimët, komentimet i bënin në gjuhën shqipe, vizitorët, në raportin e komisionit shprehen revoltën: “në orët e mësimit flitet në gjuhën shqipe. Është vështirë të kuptohet se çfarë mësohet aty. Kjo mënyrë e organizimit të mësimit nuk jep kurrfarë mundësisë që këto shkolla të mbahen nën kontroll..” Administrata e çdo banovine kishte edhe dilasterin e arsimit.⁹² Dikasteri kishte tre sektorë: *sektorin e arsimit fillor, sektorin e arsim të mesëm dhe të shkollave profesionale, si dhe sektorin e arsimit popullor.*⁹³ Por, për shkak të frikës nga përhapja e gjuhës shqipe në këto shkolla, organet e pushtetit serb i kontrollonin shumë shpesh, për të hetuar se çfarë plan-programesh perdoreshin dhe, në cilën gjuhë zhvillohej mësimi,⁹⁴ si dhe çfarë pikëpamjesh e orientimesh kishin mësimdhënësit, etj. Por megjithë këtë

⁸⁸ Abdullah R.Vokri, *Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore* (1918-1941), Prishtinë, 1990, f.189.

⁸⁹ Hasan Rebac, *Nasi muslimani “Juzna Serbija”, knjiga –II-16.Lx.1923 br.3.st.210.* (Sipas Rebacit çështja e shqiptarëve mysliman është diçka krejtësisht tjetër. Tek ata ka filluar zgjimi me të madhe i vetëdijes kombëtare. Po interesohen për origjinën e tyre, për gjuhën dhe shkollën në gjuhën amtare. Për angazhimin në këto pikëpamje shquhen sektet myslimane bektashi, kaderi, helveti etj. Kjo frymë është bërë mjaft joshëse për të gjithë shqiptarët myslimanë.) Për t’ia ndaluar turrin kësaj fushate në shtyllat e revistës “Juzna Srbija” shkroi disa herë Hasan Rebac.

⁹⁰ AJ,f.MP,ON. Iz inspektora skole Kosovske Oblasti poslat Ministarstvu Prosvete u Beogradu 1923.(Pas një vizite e kontrolli të detajuar në këto shkolla, inspektori i Ministrisë së Arsimit në vitin 1923 raportonte: “Në radhët e shqiptarëve po zgjohet me të madhe vetëdija kombëtare... Dhe sot në këto anë mund të dëgjohet që shqiptarët të thonë “unë jam shqiptar”, në të kaluarën kjo nuk është dëgjuar... Do vërtetuar se në ç’gjuhë mësojnë nxënësit në “Sibjan mektebe”... Po duket se shqiptarët i kanë hapur sytë dhe në këto mejtepe kanë filluar të punojnë në gjuhën amtare...!)

⁹¹ AJ,f.MP,fig.66,k.59,pov.1969/13-III-1925; pov.7,k 13, 1923 pov. 129/24-II-1924; pov. 606/22-VIII-1927. (Në raportin e Ministrisë së Arsimit, dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, thuhet se Mustafë Cami dhe Ferid Mehmedi ishin bashkëpunëtorë të revistës “Liria kombëtare”, që dilte në Gjenevë, dhe të revistës “Koha”. Në të dyja këto revista ata shkruanin artikuj të ndryshëm kundër mbretërisë SKS. Këta të dy njëkohësisht u jepnin informata bashkëpunëtorëve të “Federatës Ballkanike”, si dhe anëtarëve dhe udhëheqësve të “Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës”).

⁹² AJ,Ministri i drejtësisë, Zakon o nazivu i dodeli krajlevine na upravna podrucja sa zakonom o banskoj upravi, Bgd.1930.

⁹³ Po aty. Zakon o sluzbenicima, 31-III-1931(E vetmja risi ishte *Ligji mbi nënpunësit i 31 marsit të vitit 1931, ku përfshiheshin edhe punëtorët e arsimit* edhe pse sipas dispozitave ligjore në fuqi, shkolla fillore ishte e detyrueshme, kjo dispozitë nuk u realizua asnjëherë.)

⁹⁴ AJ,f.MP, pov.arivh, fig.66, k.22;pov.br.131/13-X-1934. (Ligjet në fuqi të kësaj periudhe lejonin veprimtarinë e shkollave fetare, sidomos gjendja ndryshon për të mirë në janar të vitit 1930 kur miratohet *Ligji i Bashkësisë Fetare*

kontroll dhe megjithë dhunën përpjekja për mësimin e gjuhës shqipe në Kosovë nuk ishte shuar asnjëherë.

Islame (BFI). Në nenin 18 të këtij ligji thuhet hapja e shkolla fetare islame si dhe emërimi i mësimitdhënësve të tyre janë në kompetencë të BFI. Me aprovimin e këtij ligjit mendohej se shkollat fetare myslimane kishin fituar një pavarësi të plotë. Ndonëse organet shtetërore, Ministria e Arsimit, përpiquej të impononte planet dhe programet mësimore për këto shkolla. Në bazë të dokumentacionit që patëm në dorë megjithëse formalisht këto institucione e patën fituar autonominë e tyre. Por, për shkak të frikës nga përhapja e gjuhës shqipe në këto shkolla, organet e pushtetit serb i kontrollonin shumë shpesh, për të hetuar se çfarë.)

1.5. HAPJA E SHKOLLAVE SHQIPE PËR MËSIMIN E GJUHËS SHQIPE, 1941-1944

Shtatëmbëdhjetë ditë pas sulmit të 6 prillit 1941, Jugosllavia kapitulloi dhe u pushtua e bashkë me viset e tjera edhe Kosova. Pas kapitullimit të Jugosllavisë së vjetër, Kosova, ndahet me vija të demarkacionit në mes pjesës që mbahej nën okupim italian dhe në zonën e okupimit gjerman. Gjermanët shtruan nevojën e ngutshme të ngritjes së pushtetit të ri, që nga shqiptarët e Kosovës u përjetua si çlirim.⁹⁵ Mbi të gjitha, shqiptarëve u kthehej e drejta e shkollimit në gjuhën shqipe, botimi i librave në gjuhën shqipe. Shqiptarët rikthyen të drejtën për përdorimin e simboleve kombëtare, etj. Në Kosovë përsëri hapen shkollat në gjuhën shqipe. Arsimit fillor ishte pesë- vjeçar dhe i detyrueshëm. Gjatë kësaj periudhe, përveç qindra shkollash fillore të porsahapura nisi punën edhe shkolla e mesme në Prishtinë.⁹⁶ Të gjitha këto institucione, duke përfshirë edhe kurset pedagogjike për kualifikimin e mësuesve ndikuan në vetëdijësimin arsimor dhe kombëtar dhe në zbutjen e analfabetizmit dhe përhapjen e mësimit të gjuhës shqipe. Gurthemelin e arsimit faktik në Kosovë e vuri shkrimtari Ernest Koliqi,⁹⁷ atëherë Ministër i Arsimit. Kjo shtronte nevoja për kuadro të shkolluara shqiptare që do plotësonte një boshllëk të madh në këtë mjedis, ku mbi 90% e popullsisë ishin analfabet. Kështu filloi puna rreth organizimit të kurseve, seminareve dhe shkollave, të cilat do të punonin kryesisht në gjuhën shqipe. Pjesa më e madhe e Kosovës iu bashkua Shqipërisë.⁹⁸ Kjo që një periudhë shumë e rëndësishme në historikun e zhvillimit të shkollave dhe të arsimit në gjuhën shqipe në Kosovë. Besoj se janë ilustrative vargjet që u recituan në disa tubime të atëhershme nëpër Kosovë, për atmosferën arsimore e kulturore dhe përkushtimin për gjuhën dhe letërsinë shqipe, si në vargjet: *Ti o dielli i Shqipërisë, Që lëshon rrezet e lirisë, Djem e vajza gjithë sa janë, Do ta mësojnë gjuhën tonë..*⁹⁹ Kosova u nda në tri zona okupimi: *italiane, gjermane dhe bullgare*. Pjesa më e madhe e territorit të Kosovës në këtë periudhë i takoi zonës italiane të okupimit.¹⁰⁰ Në sferën e shtrirjes së arsimit punohej në shumë fronte, me kursistë, me seminaristë dhe me të tjerët, që e mësonin me dëshirë gjuhën shqipe. Në vitin 1941 organizohen disa seminare tremujore për të gjithë ata që më parë kishin mbaruar shkolla në gjuhë të huaja, turqisht, arabisht e serbisht. Kështu, synimi ishte aftësimi i një pjese të kuadrit për administratë; ndërsa pjesa tjetër për mësues të gjuhës shqipe nëpër shkolla. Ligjëratat i mbanin mësuesit që kishin ardhur nga Shqipëria nga zona italiane e okupimit.¹⁰¹ Pas parapërgatitjeve të nevojshme, hapen edhe shkollat në gjuhën shqipe, të cilat punuan, me disa ndërprerje të vogla, nga viti 1941 e deri më 1944. Mësimet filluan në objektet e shkollave të ish-Jugosllavisë. Këto objekte ishin të pamjaftueshme, sepse dëshira për shkollim ishte e madhe, andaj filloi meremetimi i shtëpive dhe shndërrimi tyre në shkolla. Është me interes të thuhet se deri sa ata nuk ishin rregulluar mësimi u zhvillua edhe nëpër shumë xhami. Rrethanat e reja kishin ndikuar shumë që përhapja e librit shqip te mësuesit

⁹⁵ Ali Hadri, *Lufta Nacional Çirimitare në Kosovë, 1941-1945*, Prishtinë, 196, f.134.

⁹⁶ Ndër shkollat e para të mesme dhe profesionale meritojnë të veçohen: Liceu i shtetit “*Gjon Buzuku*” në Prizren, Instituti teknik bujqësor – gjimnazi i Pejës, Shkolla femnore e punës “*28 Nëntori*”, Shkolla Normale “*Gjon Kazazi*” në Gjakovë, Shkolla Normale “*Sami Frashëri*” në Prishtinë.

⁹⁷ Në të përkohshmen “*Shejzat*”, nr.1 gusht 1957 dhe nr. 4-5, nanduer-dhetuer 1957, ky kolos shkruan për arsimin dhe e definoi si “...kroje të reja në parnas shqiptar.”

⁹⁸ Me Dekretligjin Mbretëror dhe me Dekretligjin e mëkëmbësit të Mbretit, nr.264, të 12.VIII, 1941.

⁹⁹ Ali Hadri, *LNC në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë, 1971, f.125.

¹⁰⁰ Ali Hadri, *Lufta nacional çlirimtare në Kosovë, 1941-1945*, Prishtinë, 196, f.134.

¹⁰¹ Intervistë e marrë nga disa-ish nxënësit e këtij seminari, të cilët në shkollën fillore të Komoranit, ku ishin tri mësonjëtorë dhe 52 nxënës (Kjo dokumentohet edhe me *Raportin mbi gjendjen e shkollave shqipe në Qarkun e Prishtinës në vitin shkollor 1943/44*, dosja 72-fleta1-6).

e asaj kohe. Ishte krijuar frymë kur Abetaren dhe libra të tjerë shqip i kërkonin me ëndje edhe ata që nuk dinin fare shkrim - lexim. Dëshira e zjarrtë për të pasur libra shqip u shtri në çdo shtëpi, madje edhe shumë hoxhallarë dhe imamë xhamish filluan të mësonin shkrim-leximin e gjuhës shqipe dhe kështu ata u aftësuan të lexojnë edhe të shkruajnë shqip. Për hapjen e shkollave në këto anë ka rëndësi edhe Qarkorja për inspektorët e arsimit. (*Mbi mësimin e gjuhës në shkollat fillore*), lëshuar nga Ministri i Arsimit, Ernest Koliqi, e 15 nëntorit 1940. Misioni arsimor i Koliqit si ministër i Mbretërisë Shqiptare, i cili për kryetar të Misionit të jashtëzakonshëm e emëroi Ali Hashrovën dhe Januz Blakçorrin, zv.kryetar dhe antarë: Shaban Arra, Zef Pali, Xhavit Nimani e Fadil Hoxha, si dhe Muharrem Musa, sekretar.¹⁰² Ky mision kishte hartuar program të veçantë të misionit të rëndësishëm.¹⁰³ Kështu kryetari i këtij misioni të jashtëzakonshëm, studiues kompetent i nevojave arsimore të shkollës shqipe në Kosovë ishte angazhuar për të sjellë në Kosovë mësues me ndërgjegje të lartë kombëtare. Anë e kënd Kosovës u sollën afër 600 mësues shqiptarë, në disa kontigjente gjatë këtyre viteve, të cilët ndihmuan hapjen e shkollave shqipe dhe mësimin e gjuhës shqipe. Lidhur me realizimin e këtij misioni, Koliqi thotë se “*Në verën e vjetit 1941, dyqind mësues të Shqipërisë së vjetër (kështu e quante autori vendlindjen) u derdhën nëpër popullsi shqiptare të viseve të naltëpermendë. Kupës, i vunë themelet e arsimit kombëtar...*” Disa nga këta mësues, shumica mbetën në Kosovë derisa me një vendim të mëvonshëm një numër i madh i tyre u dëbuan nga politika jugosllave.¹⁰⁴ Në programet mësimore të kësaj kohe, gjuha shqipe kishte peshë dhe rëndësi të veçantë. Sa për ilustrim po shënojmë faktin se Gjuha shqipe si lëndë mësimore në klasën e parë mësohej në 14 orë në javë; zhvillim germash 4 orë në javë, shkrim e këndim (lexim) 5 orë në javë, rrëfime e kallxime 2 orë në javë, ushtrime të të folurit 2 orë në javë, recitacion, 1 orë në javë.¹⁰⁵ Edhe në klasët tjera të shkollimit fillor, gjuha shqipe si lëndë mësimore kishte peshë për nga fondi javor i orëve dhe për nga përmbajtjet mësimore. Në klasën e dytë gjuha shqipe mësohej në 14 orë në javë, në klasën e tretë 14, të katërtën 13 dhe të pestën 13 orë në javë. Ja si iu drejtohej E.Koliqi drejtorive të shkollave fillore dhe të mesme në Viset e Lirue me:

“*Në fillim të vitit shkollor e shof me vend t’i japë këto porosi, të cilat jam i bindun se do t’i çmoni: Mos me u perzi në çashtje politike, fetare e minoritare; Mos me u përzi në çashtje lokale apo administratash tjera; Me u prue mire me popull e me ja fitue zemrën këtij me punë të naltë, të zbatuem me mend e me themel si brenda si jashtë shkolle; Me i trajtue nxanësit e nxanëset, me dashni atnore dhe në mënyrë ma të persosun të një edukatori, tue i ndihmue me durim që të kapërcejnë vështirësinat e fillesës e veçanarisht memësimet e para. Me jetën e juaj private të rregull e të ndershme, të jeni shembull ma i posaçëm e vetive burrnore të shqiptarvet të kulturuem. Kam besim të plotë se me vullneti të pathyeshëm do t’ju delni në krye punës që ju kam besu.*”¹⁰⁶

Për të ilustruar përkushtimin e Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë për arsimin në Kosovë, flet më së miri përmbajtja e *Qarkores, me disa udhëzime për edukatën patriotike të nxënësve në shkollën fillore*, të 15 marsit 1944, ku vihet re se tashmë ministri është tjetër (Koço Muka), por qëllimi është i njëjtë. Këto udhëzime synonin të krijonin atmosferë ku nxënësit shqiptarë të fitojnë ngritje të vetëdijes kombëtare duke bërë thirrje për mësimdhënësit që mos të kufizohen

¹⁰² Abdylaziz Veseli, *Shkollat dhe arsimit shqip në Prefekturën e Prishtinës...1941-1944 II*, Gjilan, 2003, f.85.

¹⁰³ AQSH, *Fondi 295*,viti 1941,dosja 180, fleta 7 dhe 8.

¹⁰⁴ 12 dhjetori 1941 njihet si ditë e shënuar e hapjes së shkollës shqipe në Kosovë.

¹⁰⁵ AQSH, *Fondi 295*,viti 1941,dosja 27, fleta 48.

¹⁰⁶ AQSH, *Fondi 295*,viti 1941,dosja 16 ,fleta 8.

veç në orët e rregullta mësimore. Për të mbjellur e forcuar edukatën dhe ndërgjegjen kombëtare me këto udhëzime kerkohej që: Në periudhën e ulët (*Cikli i ulët i shkollimit*) të mësohen: *Vjershat e thjeshta me frymë kombëtare të përshtatshme për të vegjël; Këngë të lehta patriotike të mësuememe kujdes; Kallxime të thjeshta ngjarjesh kombëtare të prrallëzuese e të paraqitura gjallëmsh prej mësuës; Kallëzime të thjeshta rreth jetës e veprave të njerzvet të permendun të historis lokale dhe historis kombëtare; Legjenda në lidhje me vende e objekte me vlerë historike, që gjenden në krahinën ku vepron shkolla dhe Manifestime e zbulurime klasësh për ditët e festave kombëtare.*¹⁰⁷ Po ashtu edhe për nxënësit e për periudhën e naltë (*ciklin lëndor*) jepeshin udhëzime të gjata, të përmbledhura në shtatë kapituj të rëndësishëm, që të gjitha me theks të veçantë në ndërtimin e ndjenjës sa më të fuqishme atdhetare tek nxënësit. Lidhur me zhvillimet arsimore në Kosovë njoftohej përherë Ministria. Në një raport të 25 korrikut 1941 mbi aktivitet arsimore misioni i Jashtëzakonshëm raportonte për ministrin E.Koliqi, se “*Sapo arritëm në Kosovë, e hecem tanë Kosovën, si pjesën e pushtueme prej trupave italo-shqiptare, ashtu edhe atë prej gjermanëve, e erdhëm në kontakte me autoritet lokale dhe me popullin për t’i caktue qendrat e kurseve dhe numrin e nxansave për seciln kurs të gjuhës shqipe.*”¹⁰⁸ Ishte kjo kohë kur intenzivisht në gjithë Kosovën organizoheshin kurse të gjuhës shqipe dhe forma tjera të arsimit të të rriturve. Në këto kurse mësohej gjuha shqipe-shkrim-leximi dhe historia e Shqipërisë, mësoheshin vjersha, recitime, dramatizime dialogjesh, këngë dhe gjimnastikë. Kuadri mësimor që punonte në këto kurse verore paguhej mirë nga Ministria e Arsimit në Tiranë. Në mesin e mësuësve të spikatur të kohës përmendim Ibrahim Fehmiun, i cili në një fjalim të mbajtur, në Prizren, para se të fillojë mbajtja e kursit, në mes të tjerash theksoi se “*Sot filloi një kohë e re për historinë kombëtare...Kosovës i duhen njerëz të zotë, të ndershëm, të pathyeshëm...Sot për sot...është përhapja e dritës së arsimit në të gjitha strukturat e kombit shqiptar. Lufta kundër padijes është luftë e përgatitjes së rinisë shqiptare për t’u bërë të denjë për emrin e madh të kombit shqiptar...brenda një kohe të shkurtër arritën për t’u mësuar shkrim-leximin e Gjuhës së ëmbël shqipe, jo vetëm fëmijëve por edhe të rriturëve. Vetëm në qytetin e Prizrenit ishin përfshirë në kurset verore 1.200 fëmijë të moshës 7-12 vjeçare, nxënës, liceistë, studentë universitarë, zejtarë dhe njerëz të popullit.*”¹⁰⁹ Kurse tremujore për zhdukjen e analfabetizmit organizoheshin anekënd Kosovës. Ato mbaheshin për ata që nuk dinin shkrim e lexim, moshash të ndryshme. Në këto kurse zhvilloheshin këto lëndë mësimore: gjuhë dhe letërsi shqipe (*shkrim, lexim, ushtrime të të folurit, vjersha*), aritmetikë, këngë kombëtare, histori dhe këshilla higjenike. Kurset ishin për analfabetë, gjysëmanalfabetë, për mësimin e gjuhës shqipe, për nëpunësit administrativë për të rritur mësuan shkrim-leximin e gjuhës shqipe 15.300 të rritur dhe 12.500 nxënës të shkollave fillore.

¹⁰⁷ Pjesë nga përmbajtja e e *Qarkores, me disa udhëzime për edukatën patriotike të nxënësve në shkollën fillore*, 15 mars 1944, e nënshkruar nga Ministri i Arsimit, Koço Muka.

¹⁰⁸ Raporti paraprak mbi gjendjen e Kosovës, mbi kurset e gjuhës shqipe e mbi veprimtarinë e Misionit të Jashtëzakonshëm (AQSH, FMA-295, viti 1941, dosja 137, fleta 185.)

¹⁰⁹ Gazeta “Kosova”, Ibrahim Fehmiu, “*Mbyllja e kurseve të para shqipe në Kosovë-Puna e kryer dhe detyrat e ardhshme të arsimit*”, Tiranë, 1941, nr.16.f.4.

Tabela 1. Përmbajtjet mësimore dhe sasia e orëve javore të gjuhës shqipe në klasat I-V¹¹⁰

<i>Mësimet e gjuhës</i>	<i>Klasat</i>				
	I	II	III	IV	V
Zhvillim germash	4	-	-	-	-
Shkrim e këndim	5	5	5	4	4
Rrëfime e kallxime	2	2	2	1	1
Ushtrime të të folurit	2	1	1	1	1
Recitacion	1	1	1	1	1
Hartim	-	2	2	3	3
Diktim	-	2	2	-	-
Orthografi	-	1	1	3	3
Gjithsej orë/javë	14	14	14	13	13

Sipas dëshmimeve të kohës gjuha shqipe filloi të mësohej gati edhe në të gjitha medresetë, dhe kurse për gra. Vetëm gjatë vitit 1941 këtë punë madhore e kryenin mbi 150 mësues të ardhur nga Shqipëria dhe 27 mësues nga Kosova. Ky potencial arriti për këto vite t'ua mësojë shkrimin dhe leximin e gjuhës shqipe mbi 28.000 vijuesve të të gjitha moshave. Ndërsa në vitin 1942/43 në shkollat fillore të Kosovës vepruan 179 kurse për të rritur, në të cilat i mbajtën 17.165 orë mësimore 179 mësues të shkollave fillore. Për çdo vit shtohesh nevoja për begatimin e përmbajtjeve programore të punës edukativo-arsimore. Po ashtu për shkak të rritjes së nevojave për kuadër arsimor në Kosovë u hapën kurse pedagogjike gjatë verës 1942.¹¹¹ Plani mësimor për këto kurse pedagogjike kishte këto lëndë mësimore: *gjuhë shqipe 9 orë në javë, histori e gjeografi të Shqipërisë 4 orë në javë, këngë 2 orë, Psikologji 2 orë, pedagogji 4 orë, didaktikë e përgjithshme-didaktikë e veçantë (metodikë) 5 orë në javë, ushtrime praktike (praktika mësimore 12 orë në javë), (8 orë hospitime, 2 orë punë e pavarur e kursistit, 2 orë analizë e kritikë për hospitimet)*. Provimet përfundimtare mbaheshin para katër komisioneve veç e veç.¹¹² Në Mitrovicës, më 26 mars të vitit 1942 arrihet një Marrëveshje, me të cilën veç të tjerash thuhet “*u arrit marrëveshja që të gjitha shkollat të fillojnë menjëherë nga puna. Të hapen shpejt shkollat dhe gjimnazet për fëmijët shqiptarë.*¹¹³ Ishte ky një akt, ku zyrtarisht u legalizua shkolla dhe arsimit shqip në pjesën e Kosovës që ishte nën okupimin gjerman, që solli hapjen e shkollave edhe në fshatrat më të thella malore. Gjatë viteve 1941-1944 në Kosovë kishte arritur të ketë një shtrirje të gjerë rrjeti shkollor më të zhvilluarin, përkundër pasojave të së kaluarës së rëndë. Shqiptarët e Kosovës iu përveshën punës me zell për sigurimin e lokaleve për shkolla, dhe për kuadrot që do të punonin në shkollat e sapohapura. Ndonëse ishte një gjendje e rëndë ekonomike e trashëguar, nuk kurseheshin as paratë e as puna vullnetare. Sipas Beqir Bajraktarit, edhe pleqtë e asaj kohe, gjatë ndërtimit të objekteve shkollore pohonin se: “*Ne po e mbarojmë kronin e dijes, ku uji i dijes nuk do të shterret kurrë. Këtu uji do të jetë i pastër si loti dhe do të rrjedhë vetëm*

¹¹⁰ Sipas Qarkores së Ministrisë së Arsimit, Nr. 971-118, datë 13.VI.1941-XIX

¹¹¹ Sipas Dekret Mëkambësues nr.43 të 28 shkurtit 1942 të Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë.

¹¹² Raport rreth kursit pedagogjik në Prishtinë (korrik-tetor 1942)-(AQSH,F-295, viti 1942, dosja 235,f.3.)

¹¹³ Arhiv Vonjo-istorijskog Instituta, Krajskomandatura 838, Kosovska Mitrovica, fig. 360-361. 16-III-1942.

*shqip. Këtu edhe zogjtë e malit do të knojnë veç shqip...!*¹¹⁴ Ishin të pamjaftueshme objektet shkollore të ish-Jugosllavisë. Në shkollat që ndërtoheshin përveç lokaleve të mësimit, kishte edhe lokale banimi për mësuesit.¹¹⁵ E rëndësishmja ishte që në to grumbulloheshin nxënësit dhe shkolloheshin në gjuhën amtare. Kudo nëpër shkollat e kësaj periudhe me rasin e festave kombëtare pranë tyre zhvilloheshin aktivitete të shumta kombëtare; akademi, që fillonin me këndimin e himnit kombëtar për të vazhduar pastaj me shfaqjen e programeve të larmishme siç ishin recitalet, skeqet e deri te koncertet, përgatitur nga nxënësit dhe arsimtarët. Ishte shumë e theksuar në këto programe recitimet e vjershave me përmbajtje patriotike.¹¹⁶ Shkollat e kësaj periudhe përshkonin fund e krye një frymën e patriotizmit. Mësohej për kombin, për flamurin, për vendlindjen, për Atdheun. Ish nxënësit e shkollave të kësaj kohe tregojnë edhe sot se mësimi gjithmonë fillonte dhe mbaronte me këndimin e himnit të Flamurit. Kështu zhvillohej ndjenja e atdhedashurisë, krenarisë kombëtare, zhvillohej dashuria për njëri-tjetrin. Një vëmendje e veçantë u kushtohej luftërave të pareshtura të popullit shqiptar për pavarësi. Në këto shkolla, lartësohesin personalitetet e shquara të Lëvizjes sonë kombëtare si: *Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Shotë dhe Azem Galica, si dhe shumë personalitete të ndritura të kësaj periudhe.*¹¹⁷ Si e gjithë historia e zhvillimit të arsimit në Kosovë edhe kjo periudhë kaloi nëpër kushte specifike, e të vështira. Mungesa e mësuesve ishte nga problemet më serioze. Dyert e shkollave të Kosovës të parët i hapën mësuesit që erdhën nga Shqipëria.¹¹⁸ Ardhja e mësuesve nga Shqipëria në Kosovë kishte filluar qëmoti në periudha të ndryshme. Fillimisht, gjatë viteve 1915-1918 erdhi me një numër simbolik, për t'iu shtuar dukshëm gjatë viteve 1941-1944 dhe për të vijuar më së shumti gjatë viteve 1946-1948. Vështirë të jepet me saktësi numri real, por besohet se numri i përgjithshëm kalonte numrin 700. Dinjitetshëm pranon botërisht rolin e madh të Ernest Koliqit, si ministër, poeti e studiuesi Martin Camaj, në parathënien e librit të novelave të ish ministrit, duke dhënë vendin e dinjitetshëm kësaj etape historike dhe duke vlerësuar lart kontributin e tij për arsimin e Kosovës,¹¹⁹ kur ai në mes tjerash shkruan se “...në kohë të vështira si ishte Lufta e Dytë Botërore, la gjurmë të pashlyeshme në arsimin kombëtar, në organizimin e shkollave dhe në pajisjen e tyre me tekste, për të parën herë trajtuar me kritere moderne, ndërsa qysh tash historia ia njeh se Koliqi mori guximin me përgjegjësi personale të themeloi shkolla shqipe në Kosovë...”¹²⁰ Për kontributin e E.Koliqit në hapjen e shkollave shqipe në Kosovë, Tahir Zajmi në veprën e tij “*Tallazet e jetës dhe lotët e zemrës*”, për profesor Koliqin pohon se: “...Pas shkatrrimit të Jugosllavisë së Karagjorgjeviqëve, në vjetin 1941, një ushtri i arsimtarësh shqiptarë u hodh në tokat e lirue me për të hap shkollat shqipe, të cilat, edhe mbas mbarimit të Luftës së dytë Botërore, nuk u mbyllën

¹¹⁴ Intervistë me mësuesin e vjetër Beqir Bajraktari, nga Kishareka, marrë në vitin 1987.

¹¹⁵ AJ, f. MP. f. 464; d. br. 485/20-IV-1929. (Objektet shkollore të kësaj periudhe do të mund të ndaheshin në tri grupe; shkollat që ishin ngritur gjatë viteve 1918-1941. Objektet e institucioneve fetare, siç ishin xhamitë, vakëfet e lokalet e tjera të tyre dhe, lokalet e meremetuara e të adaptuara nëpër shtëpi private.)

¹¹⁶ Shih rrëfimin e një bashkëbiseduesi në veprën e prof. dr. Abdullah R. Vokri, Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941), Prishtinë, 1990.

¹¹⁷ Hakif Bajrami, *Rrethi i Llapit gjatë viteve 1941-1944*, Prishtinë, 1975, punim i mbrojtur i magistraturës.

¹¹⁸ Musa Kraja, *Mati Logoreci*, Tiranë, 1987, f. 29. (Duke nisur nga Mati Logoreci me të vëllain Pashkon. Derisa Mati hapi shkollën e parë shqipe në Prizren (1888), Pashkoja shkoi në Gjakovë, për të hapur edhe atje shkolla shqipe, si mësuesit e parë profesionistë, që u vunë gurin themelit të arsimit të Kosovës.)

¹¹⁹ Poeti e studiuesi Martin Camaj, në parathënien e librit të novelave “*Tregtar Flamujsh*” të Ernest Koliqit, në mes tjerash thotë se “... si Ministër Arsimit më 1941-1942 dërgoi në Kosovë nga Shqipëria përmbi 200 mësues shqiptar, ndër ta edhe plot kosovar që mbas mbarimit të luftës i vuan themele të forta arsimit në gjuhën shqipe në këtë trevë.”

¹²⁰ Ernest Koliqi, *Tregtar flamujsh*, Prishtinë, 1991.

ma dhe vazhdojnë me dhanë frytin fatbardhë të farës së hedhur, tue prodhue me qinda e qinda të rij diplomuem në fakultetet e ndryshme dhe mija maturant nga shkollat e mesme... E merita kryesore e kësaj veprimtarie patriotike të qeverisë shqiptare, pa dyshim, i përket Ministrit të Arsimit të asaj kohe, prof. Ernest Koliqit, i cili, me vullnetin dhe me shpirtin e një idealisti, nuk kursen energjitë e tij dhe mjetet shtetnore që kishte në dispozicion për ta pajisë sa më mirë aparatit arsimues në viset e lirueme me element të shëndoshë, që i dhanë hov e gjallni shkollës shqipe..”¹²¹ Ngjashëm vlerëson edhe studiuesi Musa Kraja, i cili në mes të tjerash, pohon se “..., breznitë e reja donin shkolla e mësues edhe në ato vite të vështira gjatë të cilave u vendos të dërgohen në Kosovë e në vise të tjera shqiptare, rreth 400 mësues.”¹²² Ndërkaq nga dëshmitë e gjetura në dokumentacionin e Arkivit të Historisë të Kosovës, argumentohet për një numër shumë të madh të mësuesve. Kur, Jugosllavia titiste, në vitin 1948, prishi marrëdhëniet me ish-BRSS dhe vendet e Evropës lindore, dhunshëm dëboi nga Kosova 714 mësime të ardhur nga Shqipëria. Këta mësues zëvendësoheshin me mësues serbë e malazes, pjesa dërrmuese e tyre mësues të pakualifikuar.¹²³ Mësime të ardhur nga Shqipëria kanë merita të madha në organizimin e shkollave dhe të arsimit. Ata ndihmuan edhe përgatitjen e kuadrit arsimor të kësaj treve, sidomos të mësuesit e Kosovës që më parë kishin mbaruar shkolla të huaja, serbisht apo turqisht, por ndërkohë kishin mësuar edhe gjuhën shqipe.¹²⁴ Mësuesit e kësaj periudhe punuan në shumë fronte; me nxënës dhe të rritur, në kurse dhe seminare, me vajza e djem, në shkolla të ditës dhe të natës. Kudo që punuan, ata e mbollën idenë kombëtare, por gjeneratat e reja i pajisën edhe me njohuri shkencore. Ja si e pasqyronte kontributin e tyre patrioti edhe profesori, Zekrije Rexha, duke shprehur mirënjohje për mësime të kohës: “Një përmendore titani zulmëm madhe, syntezë virtytesh Shqiptarije, të pakurrkund shoqe, ngrohet lavdishëm, n’altarin e martirëve t’u, djelmëni kosovar!... Ruaje, amanetin, nga prisi yt martir.. parimin “Shqipninë mbi të gjitha” e shkruaj me gjak, po të jetë nevoja...”¹²⁵ Këtë amanet e quan në vend mjaft mësues të mëvonshëm, të cilët u martitizuan për gjuhën, shkollën dhe qenien tonë kombëtare, si: Gjon Sereqi, Bedri Pejani, Ibrahim Lutfiu, Haki Taha, Fazli Grajçevci, etj. Kurse në veprën e prof.Musa Krajës këta mësime të ardhur marrin epitete të larta, sepse: “Mësuesat, këta apostuj të palodhshëm t’idealit kombëtar, kanë organizuar, ndër të gjitha qendrat të mëdha dhe të vogla, kurset e para, natë e ditë, të gjuhës amtare. Populli, pa dallim moshe dhe seksi, ndjek rregullisht kurset, në masa gjithnjë më të shumta dhe kompakte e, si në fillim ashtu edhe në mbarim të mësimeve, shpërthen vala e hymneve kombëtare.”¹²⁶ Ishte kjo kohë kur gjuha shqipe si lëndë mësimore kishte marrë vendin qendror në programet shkollore dhe kur atdhetarizmi përshkonte çdo sferë të jetës. Madje disa shkolla u pagëzuan emrat e heronjve tanë kombëtar dhe të atdhetarëve e figurave të kombit. Shkollat e fshatrave ishin kryesisht katërklasëshe, ndërsa nëpër qendra në fillim ishin pesëklasëshe. Në klasën e parë mësoheshin këto lëndë: *Gjuhë shqipe, artimetikë, vizatim, fiskulturë dhe këngë*. Në klasën e dytë mësoheshin këto lëndë: *Gjuhë shqipe, artimetikë, mësime feje, vizatim, fiskulturë, këngë*. Në klasën e tretë: *Gjuhë shqipe,*

¹²¹ Tahir Zajmi, *Tallazat e jetës dhe lotët e zemrës*, Bruksel, 1970.

¹²² Musa Kraja, *Mësuesit për kombin shqiptar*, Tiranë, 1993, f.415.

¹²³ Abdullah R.Vokri, *Ibrahim Kolqi, mësues dhe patriot*, Prishtinë, 1993, f.118-119.

¹²⁴ A.J.Fond Ministravo prosvete i Vere, odeljenje za nemacku, nastavu, VI,br.498/17-II-1943

¹²⁵ Zekerja Rexha “Kosova”, 24 maj 1941. (Autori në këtë artikull shënon se “Në ligjëratat e tyre, veç tjerash, ata vinin në dukje me argument, të vërtetën shkencore se shqiptarët ishin dhe mbetën populli më i lashtë i Ballkanit.)

¹²⁶ Musa Kraja, *Mësuesit për kombin shqiptar*, Tiranë, 1993, f.403.

artimetikë, ta njohim botën, bukurshkrim, vizatim, mësimi i fesë, fiskultura dhe kënga. Në klasën e katërt: Gjuhë shqipe, vizatim, këngë, bukurshkrim dhe mësimi i fesë.¹²⁷

Gëzimi i shqiptarëve të Kosovës për shkollat ishte i madh. Ata shpreheshin troç se “*Më parë se turqisht, kam folur shqip. Këtë gjuhë ma ka mësuar nëna. Mungesa e shkollave shqipe bën që ne më parë mësojmë të shkruajmë, të lexojmë në gjuhë të huaja. Por, ja ashtu, erdhi dita që edhe ne të mësojmë në gjuhën tonë*”. Nxënësit mbështeteshin kryesisht në fjalën e gjallë të arsimitarit. Shumë prej tyre mësonin përmendsh. Kishin pak njohuri rreth tipeve të organizimit të orës së mësimi. Madje, aktivizimi i nxënësve në mësim nuk bëhej sipas kërkesave pedagogjiko-didaktike, hartime dhe provime me shkrim bëshin shumë rrallë. Gabimi më i madh metodik që vihej re në atë kohë, ishte se mësimdhënësit aktivizonin kryesisht nxënësit e zgjuar.

¹²⁷Po aty.

1.6. SHTRIRJA E MËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE DHE SFIDAT NË PERIUdhËN 1945-1966

Edhe pse më 1944, Jugosllavia shkeli “premtimet” e dhëna për të drejtën e shqiptarëve për vetëvendosje, mohoi në tërësi Rezolutën e Bujanit dhe degradoi, dënoi juridikisht, politikisht dhe ushtarakisht organizatorët e saj. Vazhdon terrori dhuna, vrasjet, mobilizimet e dhunshme, ndodhën shumë masakra: e Ferizajt, Drenicës, Tivarit, Sremit, Rozhajës, Goricës,¹²⁸ etj. Më 8 shkurt 1945 në Kosovë u vendos Adminstrimi Ushtarak, filloi mobilizimi i të rinjve shqiptarë në aradhet partizane. Në këto aradhe, shqiptarët e mobilizuar dhunshëm ekzekutoheshin dhe masakroheshin nga çetnikët, të cilët ishin rehabilituar nga udhëheqja jugosllave...!¹²⁹ Në fillim të vitit 1945, sistemi shkollor mbështetej në sistemin e ish - Mbretërisë SKS, që funksionoi ndërmjet dy Luftërave Botërore. Rianeksimi i Kosovës nga ana e Jugosllavisë vështrirësoi sërish udhën për krijimin e një sistemi të ri të arsimit dhe të veçantë për shqiptarët e mbetur jashtë trojeve etnike të Shqipërisë londineze. Edhe pse u hapën shkolla të shumta të nivelit të arsimit fillor, kjo ngurohej të bëhej në arsimin e mesëm, që kryesisht shumica e lëndëve mësimore zhvilloheshin në gjuhën serbo-kroate. E rëndësishme është të shënohet se kjo fazë e zhvillimit të arsimit edhe në Kosovë realizohet arsimit fillor i detyruar. Mbi të gjitha është e rëndësishme puna e madhe e zhvilluar me kurset për zhdukjen e analfabetizmit.¹³⁰ Për shkak të realitetit të ri në periudhën e viteve 1946 –1950 u bënë disa ndryshime dhe reforma. Në vitin 1950 në Kosovë për qëllime politike dhe me prapavijë të vazhdimit të shpërnguljes së shqiptarëve për Turqi, hapen shkollat në gjuhën turke. Por në anën tjetër, në këtë periudhë, bëhet luftë dhe punë e madhe për çrrënjosjen e analfabetizmit të trashëguar,¹³¹ punohet drejt shtimit të numrit të shkollave, të paraleleve dhe të nxënësve, arsimit ishte i politizuar dhe përdorej për qëllime negative politike (*serbët ishin të privilegjuar*). Deri në vitin shkollor 1954/55, sistemi shkollor ishte i ndarë në atë shqiptar dhe serb (ekzistonin shkolla shtetërore shqipe - fillore, gjimnaze, shkolla normale dhe shkolla shtetërore serbe - fillore, gjimnaze dhe normale,¹³² ndërsa nga viti 1950 edhe në gjuhën turke.¹³³ Në vitin 1955 Serbia bëri disa herë përpjekje për ndalimin e shkollimit në gjuhën shqipe (*por kjo hasi në rezistencë të shqiptare dhe ky synim nuk u realizua, ani pse në shkollat e përziera, sidomos në shkollat e mesme mbi 70% të lëndëve me mësim në paralelet shqipe zhvilloheshin nga arsimtarët serbo-malazias dhe në gjuhën serbe*). Në vitin 1958 edhe një herë u bë edhe një përpjekje për ndalimin e mësimin në gjuhën shqipe në shkolla të mesme. Falë angazhimit të intelektualëve shqiptarë edhe kjo përpjekje nuk u realizua. Gjatë kësaj periudhe, shtypja politike dhe policore që ushtrohej kundër arsimtarëve shqiptarë ishte shumë e madhe 25% të arsimtarëve kaluan nëpër trajtime të ndryshme policore (*burgosje, rrahje, maltretime, përjashtime nga puna*). Një numër i arsimtarëve u vra dhe u ekzekutua (*Halim Orana, Gjona*

¹²⁸ Ministria e Tokave të Liruar, Raport, AQSH, RSH, F.266, 1943, dos,7. fleta 21.

¹²⁹ Nole Malcolm. v. e përm., f.328 67 , (shih Leo Freudlich, v.përm f.40)

¹³⁰ Në Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore u bë lufta kundër analfabetizmit, që nisi në vitin 1946, vazhdoi përmes kurseve dhe shkollave të natës për disa dekada. Kjo punë e frytshme u kurorëzua me zhdukje të fuqishme të analfabetizmit, që menjëherë pas luftës ishte mbi 90% për shqiptarët.

¹³¹ Sipas regjistrimit të vitit 1948, banorët e Kosovës (*kryesisht shqiptarët*) 74% ishin analfabetë.

¹³² Sulltane Kojčinaj - Ukaj, *Kuadri arsimor shqiptar në Kosovë në shënjestrën e sigurimit shtetëror* (1945 – 1952, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1986).

¹³³ Shih: Hajredin Hoxha, Kosovo in Albanci v novi Jugoslaviji, në librin Albanci, Cankarjeva založba, Lubljana, 1984, f.214-215 (sipas këtij autori në Kosovë janë mbytur mbi 300 shqiptarë dhe janë keqtrajtuar mbi 30000), dhe Shih: Hakif Bajrami, Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë viteve 1875–1966, Rilindja, dt.10.VI.1990. dhe Ferit Shehu & Sadije Shehu, Pastrimet etnike të trojeve shqiptare 1953 –1954, Prishtinë, 1993, f.15.

Serreçi, Bedri Gjinaj, Kolë Parubi, Kolë Margjini, drejtori parë i Liceut shqiptar "Gjon Buzuku" në Prizren, Mustafë Koka, Fazli Grajçevci, Ali Gashi, Shaban Shala, etj. Për pjesën dërrmuese të intelektualëve shqiptarë që përgjohej nga policia hapen mijëra dosje. Prej vitit 1945 deri në vitin 1948 nga Kosova ishin dëbuar 748 arsimtarë shqiptarë¹³⁴. Por as trysnia e madhe, dhuna, represioni dhe terrorin shtetëror, sidomos gjatë *Aksionit të Armëve* më 1956 dhe 1957,¹³⁵ as shpërnguljet masive të shqiptarëve në Turqi,¹³⁶ nuk arritën të ndalin përpjekjet titanike të atdhetarëve, të cilëve *"ju morën pushkët por ju dha topi !"* (*Kështu shpreheshin udhëheqja serbe duke aluduar figurativisht se shqiptarëve ju lejua shkollimi dhe përdorimi i gjuhës shqipe!- R.Gj.*) Megjithatë, kjo epokë në shkollat shqipe dhe në arsimin e Kosovës shënoi rezultate të mëdha, sepse u krijua një bërthamë e mirë intelektualësh, të cilët më vonë do të jenë ideologë e prijës të lëvizjeve të reja atdhetare- progresive në periudhën 1967-1980. Edhe pse, planet dhe programet, tekstet mësimore dhe udhëzimet metodike që i dërgoheshin shkollës shqipe në Kosovë ishte nën diktatin e plotë të politikëbërësve të arsimit në Beograd. Përpjekjet e Prishtinës për realizimin e të veçantave kombëtare dhe gjuhësore të kësaj treve nuk u ndalën në asnjë fazë të zhvillimit, por reagimet qeveritare serbe ishin të egra, me planin dhe programin mësimor të korrigjuar për Gjuhën shqipe në shkollat fillore të 8 korrikut 1964,¹³⁷ në përmbajtjet programore ishte paraparë që *"...me i aftësu nxënësit të shprehin mirë e bukur me gojë dhe me shkrim në gjuhën letrare; me i njoftë nxënësit me ligjshmënitë elementare të gjuhës letrare shqipe, të cilat janë t'afërme për nxënësit e kësaj moshe; me aftësu nxënësit për njohjen dhe përjetimin e letërsisë popullore dhe artistike nëpërmjet veprave me të rëndësishëm dhe me i njoftë me vetitë ma të rëndësishme t'artit letrar; me zhvillue interesimin dhe dashtuninë e nxanësve ndaj librit, si dhe aftësinë e tyre për ta përdorë librinë pamvarsishtë; me kotribue në formimin e figurës morale të nxënësit në frymën e patriotizmit socialist jugosllav të zhvilloj cilsitë e individualitetit të tyre nacional; me u ba të mundëshme nxanësve një zhvillim kulturor dhe me zhvillua ndjenjat estetike; me i njoftë nxënësit me veprat ma të rëndësishme të leterësisë popullore dhe artistike shqipe, me vetitë ma të rëndësishme t'artit letrar; me njohjen ma me lehtësi ma parë të gjuhës amnore të ndihmojë të nësuesitë ma me lehtësi e me themel të serbokoatistes si dhe ato të gjuhëve të hueja.*¹³⁸ Me këtë dokument, për klasën e parë (6 orë në javë) ishin paraparë përgatitja për leximin fillestar:

a) *kontrollimi i dijes së fëmijëve dhe shkallës së tyre psiqike dhe ushtrime të foluni nëpërmjet të këtyne formave të punës: kuvendi i lirë, përpunim i tregimeve dhe recitimi me anë të fotografive.*

b) *përpunimi i ideve: i gjallë send, fjalë, tingull.*

¹³⁴ Sulltane Koçinaj - Ukaj, *Kuadri arsimor shqiptar në Kosovë në shënjestrën e sigurimit shtetëror (1945 – 1952)*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1986.

¹³⁵ Shih: Hajredin Hoxha, *Kosovo in Albanci v novi Jugoslaviji*, në librin Albanci, Cankarjeva zalozhba, Lubljana, 1984, f.214-215 (sipas këtij autori në Kosovë janë mbytur mbi 300 shqiptarë dhe janë keqtrajtuar mbi 30000).

¹³⁶ Hakif Bajrami, *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë viteve 1875–1966*, Rilindja, dt.10.VI.1990 dhe Ferit Shehu & Sadije Shehu, *Pastrimet etnike të trojeve shqiptare 1953–1954*, Prishtinë, 1993, f.15.

¹³⁷ Ky program, me fondin e orëve javore të mësimin nga klasa e parë deri në klasën e pestë kishte nga 6 orë në javë, ndërsa në klasën e gjashtë pesë orë, e në klasën e shtatë dhe tetë 4 orë në javë. Në Krahinën Socialiste të Kosovës-Metohisë (*kështu e emërtonin pushtuesit në dokumente*) Enti Krahinor për përparimin e shkollave kishte përcaktuar detyrat e mësuesit të gjuhës shqipe që përfshinte plani dhe programi i vitit 1964.

¹³⁸ Plani dhe programi mësimor i korrigjuar për Gjuhën shqipe në shkollat fillore, EKPSH, KSAKM, Prishtinë, më 8 korrik 1964. (Përmbajtjet janë shënuar sipas ortografisë së gegërishtës letrare).

Pjesët kryesore të plan programit për këtë lëndë mësimore shtriheshin përbrenda këtyre komponentëve: *leximi dhe shkrimi fillestar (të zotnuemit e leximit dhe të shkrimit), ushtrime në të lexuem dhe në të shkruem. Gjatë leximit me ushtrime teknikën e të shkrimit. Mësimi mbi gjuhën: shkronja e madhe (në fillim të fjalisë dhe ndër emna të përvecëm). Përdorimi i pikës. Të dalluemit e fjalisë dhe tingujve në përdorim, pa përkufizime. Ushtrime sa i përket shqiptimit të rregullt të tingujve, sidomos të c, q, xh, gj, th, dh, h, r, rr, e, ë. Në komponentën ‘ushtrime të të foluni’, etj. Leximi logjik dhe shprehës bëhej përmes teksteve në prozë -copa leximi- tregime popullore dhe artistike, fabulën prrallën, përshkrime, copa shkencore dhe artistike fabulën përralla, përshkrime, copa shkencore të popullarizume (leximi, tregimi i brendisë dhe të mësuemit përmendsh të fragmenteve të shkurta). Leximi i sipas roleve, dramatizmi i hartimeve të përshtashme të shkurta në prozë dhe poezi, ushtrime të të shprehurit me gojë e me shkrim, mësimi mbi gjuhën, ushtrime leximi logjik dhe shprehës, leximi në heshtje. Rëndësi e veçantë i kushtojë për diktimet dhe ushtrimet me shkrim nga mësimi mbi gjuhën dhe gjatë vitit gjashtë hartime shkollore. Madje mbaheshin hartime të lira, të mbajturin e ditarit. Te pjesa e paraparë për mësimin mbi gjuhën, mësoheshin “emnat: emën sendi, kuptimi dhe kolektivi” dhe bëhej dallimi i gjinisë numrit dhe nyjës të emnat kuptimi i nyjës, kuptimi i rasave, si dhe kuptimi i mbiemrave (të nyjshëm dhe të shnyjshëm) dhe shkallët e krahasimit të mbiemrave. Me programin e pasluftës së Dytë kishte zënë fill mësimi i prozës popullore: përrallat, tregimet, legjendat dhe fabulat, dhe prozës artistike.¹³⁹ Gjatë recitimeve në programe festive i kushtojë kujdes theksimit të poezive në gjuhën shqipe nga LNÇ si, kënga: “Marshall Tita”, “Të lumt na për këtë liri”, “Lufta e Cërnalevës”, “Vajza partizane.” Pjesë e mësimdhënies së kësaj periudhe kohore ishte edhe leximi i teksteve sipas roleve dramatizmi i copave të leximit, vjershave dhe fragmenteve të veprave letrare si dhe shpjegimi i çfaqjeve teatrale dhe filmave, të ndëgjuemit e radio emisionit dhe analizimin e tyre. Nga gramatikë, me planet e kësaj kohe mësohej, *gjuha si mjet marrëveshje, dialektet kryesore të gjuhës shqipe, kuptimi i fjalës së zgjanume, fjala e thjeshtë dhe e përbame (kuptimi), rrokja e tingullit dhe diftongjet, zanoret dhe bashktinglloret, ide themelore mbi pjesët e ndryshushme dhe të pandryshushme të ligjeratës. Madje mësoheshin dhe emnat, mbiemrat përemrorë, foljet, ndajfolja, paraafjala lidhëzat dhe pasthirrmat. Përdorimi i shkronjës së madhe: n’emna të kremtave, të rrugëve, te titujt e librave, revistave dhe gazetave.*¹⁴⁰*

¹³⁹ Veprat e Andersenit (“Mbretëresha borëbardha”) dhe përrilla të tjera të V.Grimi (“Tre vllazën” dhe përralla tjera) të Pushkinin (“Përralla mbi Gjelin e art”, “Princesha dhe shtatë vllazën”), të M. Ilinit (“Tregime partizane”). Prej veprave të përmenduna ma nalt me marrë si mbas dëshirës prrallat e tregimet e përkthye, të cilat janë të përshtatshme për moshën e nxanësve. Mark Krasniqi (“Prrallat e gjyshi), etj.

¹⁴⁰ Ky plan program për gjuhën shqipe ofronte edhe dije të tjera të shumta për sintaksën e fjalisë dhe morfologjinë e gjuhës shqipe që kryesisht i kushtojë pjesëve të ndryshueshme të ligjeratës, gjithnjë sipas rregullave të drejtshkrimit të gegërishtes së vitit 1964.

1.7. MËSIMI I GJUHËS SHQIPE NË SHKOLLAT E KOSOVËS, 1966-1981

Ndryshimet politike që ndodhën pas Plenumit të Brionëve u reflektuan edhe në sistemin arsimor të Jugosllavisë e veçanërisht në planet dhe programet e teksteve mësimore të Kosovës. Fryma e re politike mbështetej në boshtin ideologjik marksist-leninist. Ideologjia dhe “*mësimet e partisë e të shokut Tito*” në mësimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë ishin të theksuara, sidomos në shembujt që përdorshin për ilustrimin e teorisë dhe për ushtrimet, merreshin nga letërsia artistike, nga publicistika e folklori, jo pak dhe nga botimet e fjalimëve politike. Në Kosovë bëhen ndryshime pozitive politike që reflektoheshin edhe në fushën e arsimit.¹⁴¹ Pas vitit 1967 fillojnë nismat për ndryshime kushtetuese, me qëllim të avancimit pozitë e statusit autonom e politik të Kosovës, i cili që ngushtuar tërësisht me ndryshimet kushtetuese të vitit 1963. Me këto amandamente Kosova fiton disa kompetenca të reja në fushën e arsimit. Fryt i këtyre ndryshimeve në vitin 1970 ishte themelimi i Universitetit të Kosovës, pavarësimi i Entit të teksteve dhe i mjeteve mësimore të Kosovës, hapja e shumë fakulteteve dhe shkollave të larta. Sistemi shkollor nis gjithnjë më tepër të marrë konturë të një sistemi autonom dhe të pavarur të arsimit. Por, pavarësisht rritjeve, presioni mbi arsimtarët shqiptarë vazhdoi.¹⁴² Zhvillim më dinamik dhe më të hovshëm sistemi i arsimit në Kosovë bëhet kryesisht pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1974.¹⁴³ Detyrat e mësimin të gjuhës shqipe gjatë këtyre viteve, sidomos ato sipas planeve dhe programeve mësimore për shkollat fillore dhe të mesme,¹⁴⁴ ishin të orientuara

¹⁴¹ Në vitin 1968 formohet Pleqësia e Arsimit e Kosovës, e cila kishte një shkallë më të lartë të pavarësisë. Gjuha serbe si gjuhë shtetërore bëhet gjuhë fakultative. Po këtë status e merr edhe gjuha shqipe, vetëm në aspektin formal juridik (*sepse në fakt gjuha shqipe në praktikë vazhdoi të jetë e diskriminuar gjatë tërë kohës, meqë gjatë takimeve zyrtare përdorej dhe flitej vetëm gjuha serbe, me justifikim se serbët nuk e njihnin gjuhën shqipe*).

¹⁴² Një Letër e Titos në vitin 1972, gjatë viteve 1972 dhe 1973, (e ardhur si dokument partiak i PKJ-së) në “frymën” e saj nga procesi arsimor përjashtohen 248 arsimtarë shqiptarë.

¹⁴³ Nga këto ndryshime kushtetuese për herë të parë formësohet dhe ndërtohet sistemi i mëvetësishëm dhe autonom i sistemit të arsimit në Kosovë, që deri në këtë periudhë ishte një nënsistem i sistemit të arsimit të Serbisë. Po në këtë vit fillon reforma e sistemit të arsimit, e cila njihet me emrin Reforma e Shuvarit (sipas Stpe Shuvar). Por, me këto ndryshime në fushën e arsimit, Kosova plotësisht barazohet me republikat e tjera të ish-Jugosllavisë. Ishte barazim formal juridik, sepse nuk realizohej plotësisht në praktikë për shkak të oportunitetit dhe obstrukcioneve që bënte klasa politike serbe, por edhe për shkak të ngathtësisë së institucioneve të udhëhequra nga shqiptarët të cilët në poste vinin sipas çelësit ideologjik - dorë e zgjatur e LKJ - parti dominuese dhe pushtetmbajtëse. Kjo që arsyeja që institucionet drejtuese të arsimit në Kosovë (Sekretariati - Komiteti për Arsim, Shkencë e Kulturë, Pleqësia e Arsimit e Kosovës, Enti Krahinor për Përparimin e Arsimit dhe të Edukimit vijonin të mbështeteshin në paradigmat dhe modelet e Serbisë (ligjet, modelet e dokumentacionit pedagogjik, të akteve nënligjore siç ishin: planprogramet, udhëzimet, rregulloret, etj). Megjithatë këto ndryshime bënë ndikim shumë pozitiv dhe cilësor në sistemin e arsimit në Kosovë. Zgjerohet rrjeti i institucioneve në të gjitha nivelet, rritej përfshirja e fëmijëve, nxënësve dhe e rinisë në shkollim, zvogëlohej sadopak shkalla e diskriminimit të shqiptarëve në punësim dhe në jetën shoqërore e politike. Gjatë kësaj periudhe u nxorën ligje për edukimin dhe arsimin parashkollor, fillor, të mesëm të orientuar, për përsosjen e përhershme profesionale të personelit mësimor edukativ, për shërbimin arsimor pedagogjik, për shërbimin e inspeksionit, për Entin e teksteve dhe të mjeteve mësimore, për arsimin e lartë, Pleqësinë e Arsimit etj. Por, as në këtë etapë nuk u ndal burgosja e arsimtarëve shqiptarë, (më 1975 dhe 1979).

¹⁴³ *Plani dhe programi i gjuhës shqipe*, Pleqësia Krahinore e Arsimit të KSA, më 24 shtator 1971.

¹⁴³ Për të realizuar mësimin në mënyrë sa më të suksesshme dhe në frymën e këtij programi, kërkohej që mësimdhënësit të kenë përgatitjen e duhur profesionale dhe të njohin mirë metodikën e mësimin të gjuhës amtare. Kjo periudhë kishte hapur shtigje të hapjes së mundësive për arsimimin e lartë profesional për mësimdhënësit të gjuhës shqipe ta ndjekin edhe ta studiojnë literaturën profesionale e pedagogjike dhe të frymëzohet nga shembujt e mirë të praktikës.

¹⁴⁴ Plani dhe programi mësimor i gjuhës shqipe, i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, të cilat ishin aprovuar nga Pleqësia Krahinore e Arsimit të KSA, më 24 shtator 1971.

që “t’i aftësojë sistematikisht nxënësit të shprehen mirë e bukur në gjuhën letrare me gojë e me shkrim; që nëpërmjet mësimi të gramatikës t’ua bëjë të njohura nxënësve ligjshmëritë elementare të gjuhës letrare shqipe; që nëpërmjet veprave të zgjedhura të letërsisë popullore dhe të letërsisë së shkruar –të popullit tonë dhe të popujve të tjerë; t’i aftësojë nxënësit të kuptojnë dhe të përjetojnë artin letrar dhe t’i njoh me vetitë e rëndësishme të këtij arti; që të zgjojë e të nxisë interesin e dashurinë e nxënësve ndaj librit dhe t’i aftësojë që ta përdorin atë pavarësisht; që të zhvillojë ndjenjat estetike dhe etike, dashurinë ndaj njerëzve punues dhe të kenë mirkuptim ndaj luftës dhe aspiratave të tyre; që t’i aftësojë nxënësit të kuptojnë realitetin tonë shoqëror, të forcojë vllazërimin e bashkimin e popujve dhe të kombësive të RSFJ, të zhvillojë dashurinë ndaj atedheut socialist...¹⁴⁵ Mësimi i gjuhës shqipe në shkollën fillore dhe të mesme në këtë periudhë mbështetej në realizimin e programit që të sendërtohen detyrat e mësimi të gjuhës amtare, si: *Leximi dhe shkrimi fillestar; përpunimi i tekstit, leximit dhe recitimit ; te shprehurit me gojë e me shkrim dhe dituri mbi gjuhën (gramatikë)*. Njohuritë e nxënësve, lënda që e parashihete ky program për çdo klasë shtrihej në njohuritë mbi gjuhën, gramatikën, përpunimin e teksteve, përvetësimin e njohurive themelore mbi letërsinë, veçanërisht njohja e nocioneve të teorisë së letërsisë, filmit, ushtrimeve të të shprehurit me gojë e me shkrim, etj. Mësimi i gjuhës amtare (gjuhës shqipe) në këtë fazë nis të bëhet me konkretizimin më të avancuar dhe mësimdhënësit i kushtojnë vëmendje gjetjes së metodave dhe formave të punës, si përdorimi i *tablove, të filmit, të dia filmit, të televizionit, të dëgjuarit, të radio emisioneve; përdorimi i manjefonit* (për lexim, recitim, ushtrime, të shqiptuarit, ushtrime të të folurit, sidomos për t’u stërvitur për t’u paraqitur para publikut).¹⁴⁶ Në mësimin e gjuhës amtare për të kultivuar vlerat artistike, nxënësve u kërkohet që të ndjekin radio emisione, radio emisione dramatike për fëmijë, madje bëheshin ushtrime të ndryshme me shkrime, si shkruhen: *lutjet, ankesat, të shkruarit e letrave, të biografisë, të telegrameve të plotësuarit e formularve etj.* Detyrat qendrore të mësimi të gjuhës shqipe gjatë këtyre viteve ishin duke nisur me përvetësimin e leximit dhe të shkrimit fillestar, zhvillimin e kulturës gjuhësore dhe të aftësive shprehëse të nxënësve. Ushtrimet e leximit parashiheshin në program prej klasës I – VIII pikërisht për këtë qëllim. Recitimi, sikurse edhe leximi, kultivoheshin prej klasës I-VIII dhe ai mbështetet në të kuptuarit e tekstit. Nga klasa e III e IV bëheshin përpjekje për dramatizimin e pjesëve më të lehta të teksteve të shkurtura (*të përrallave të anekdotave*), kurse në klasën V, tashmë kërkohet dramatizimi i teksteve.¹⁴⁷ Madje, duke lexuar edhe njohur me shkrimtarët për fëmijë, si: Hil Mosi, Rexhep Hoxha, Mark Krasniqi, Tajar Hatipi, Mehmedali Hoxha, Maksut Shehu, Vehbi Kikaj, Rifat Kukaj, etj., kërkohet që nga klasa VI –VIII të jepeshin njohuri të plota edhe për disa shkrimtarë, tregime, vjersha, madje edhe romane të shkruara. Ndërkaq, qëllimi i ushtrimeve të të shprehurit me gojë e me shkrim nga klasa e parë ishte që, *nxënësit të aftësohen të flasin e pastaj edhe të shkruajnë me fjali të plota, që të zhvillojnë kujtesën, aftësinë e të lidhurit, të mendimeve të kompunuarit e tërësive më të gjera (ritregimin e asaj që kanë lexuar, parë ose dëgjuar, tregimi i përjetimeve, etj.* Preferohej që arsimtari t’i udhëzojë nxënësit mbi mënyrën se si t’i shkruajnë detyrat e shtëpisë. Duke filluar që nga klasa e IV-t, krahas ushtrimeve me gojë e me shkrim, të mbajë hartimet shkollore. *Mësimi i gjuhës dhe i gramatikës* prej fillimit e deri në fund të shkollimit parauniversitar, sipas planeve

¹⁴⁵ *Plani dhe programi i gjuhës shqipe*, Pleqësia Krahinore e Arsimit të KSA, më 24 shtator 1971.

¹⁴⁶ Për ndikimin e politikës dhe ideologjisë në mësimin e gjuhës amtare, sistemi arsimor i kësaj kohe kujdeset që brezi i ri i mësimdhënësve të kenë edukimin në frymën kombëtare.

¹⁴⁷ Përveç shkrimtarëve që kanë shkruar për fëmijë, me këtë plan kërkohet që nxënësit e shkollës fillore të dinë edhe për ata të traditës, si: N. Mjedën, A.Z. Çajupin, Migjenin, Konstandin Kristoforidhin, Jeronim de Radën, Filip Shirokën, Fan Nolin, Sterjo Spasen, Esad Mekulin etj.

dhe programeve mësimore të këtyre viteve dhe praktikës pedagogjike mbështeteshin në ndjenjat gjuhësore dhe në të vërejturit në mënyrë të organizuar të nxënësve. Mësimi i gjuhës dhe i gramatikës kuptohej si mjet, që ndihmon zhvillimin e kulturës së nxënësve në të shkruar dhe në të lexuar e, duke e futur nxënësin në ligjësi elementare të gjuhës sonë. Kudo kërkesë programore gjatë mëimit të gjuhës shqipe në këtë kohë ishte “*zhvillimi i dashurisë së nxënësve ndaj atdheut tonë socialist, ku gjallëria kombëtare e kombësitë e ndryshme me të drejta të barabarta...*”,¹⁴⁸ kërkesa këto që mund të arriheshin gjatë përpunimit të teksteve të ndryshme, qoftë nga letërsia për femijë, nga libër leximi, nga shtypi ose veprat e zgjedhura të letërsisë popullore dhe të shkruar. Veprat, që parashihen për lektyre shkollore sipas klasëve, e sidomos tematika e ushtrimeve e të shprehurit me gojë e me shkrim shfrytëzoheshin “*për t’i edukuar nxënësit në frymën socialiste (dashuria për punë, për traditat e Revolucionit popullor, dashuria ndaj kombit dhe kombësive të bashkësisë sonë socialiste, si dhe njeriu dhe lirive të tij në përgjithësi)*”.¹⁴⁹ Po ashtu edhe ushtrimet ortografike, përsëritja e lëndës dhe diktimet e detyra kontrolli praktikoheshin në çdo klasë. *Format e punës jashtëshkollore*, organizoheshin për nxënësit që kishin prirje dhe aftësi t’i përfshijnë në ndonjë degë të mëimit të gjuhës amtare.¹⁵⁰ Prandaj, puna jashtëshkollore mund të merrte forma organizative: *gjuhësore, dramatike, kinematografike, gazatareske ose të grupit e të seksionit letrar*. Ndërkaq, me leximin e përpunimin e *lekturës shkollore*, mësimdhënësi i gjuhës shqipe, bazuar në fondin e librave të bibliotekës së shkollës,¹⁵¹ realizonte synimin përfundimtar të detyrave kryesore të mëimit të gjuhës shqipe sipas planeve dhe programeve mësimore të kësaj periudhe.¹⁵²

¹⁴⁸ *Udhëzimet didaktike nga plani e programi mësimor për gjuhën shqipe të vitit 1971*, Prishtinë, 1971.

¹⁴⁹ Po aty.

¹⁵⁰ Qëllim specifik ishte orientimi drejt kultivimit të të shprehurit me gojë e me shkrim, drejt interesit më të thellë për gjuhën, për letërsinë, për filmin, ose për shfaqjen e pjesëve dramatike, pastaj për krijimin dhe orientimin e drejt të publikut lexues, teatrale e të fillimit.

¹⁵¹ Përzgjedhja e veprave më të mira për të përpunuar gjatë orëve të mëimit si dhe ato që u rekomandohen nxënësve që t’i lexojnë vetë në shtëpi bëhej nga mësimdhënësit, sepse ata kishin të drejtë të marrin dhe vepra letrare, që nuk i parashihte ky program.

¹⁵² Për të realizuar Programin e gjuhës shqipe në tërësi e mirë do të lexohen udhëzimet dhe të veprohet sipas tyre dhe në mes tjerash të realizoheshin synimet: *Që t’i ftojme nxënësit sistematikisht që të shprehen mirë e bukur me gojë e me shkrim mbi gjuhën e njësuar letrare!; që ndërmjet mëimit të gramatikës t’ua bëjë nxënësve të njohura rregullat elementare të gjuhës së njësuar letrare; që ndërmjet veprave të zgjedhura të letërsisë gojore së shkruar –të popullit shqiptar dhe të popujve të tjerë –t’i aftësojë nxënësit të kuptojnë dhe të shijojnë artin letrar; që të zgjojë e të nxisë interesin dhe dashurinë e nxënësve ndaj librit, t’i aftësojë që ta përdorin atë pavarësisht; që të zhvilloj te nxënësit ndjenjat estetike dhe morale, dashurinë ndaj njerzve punonjësve dhe që të kenë mirkuptim ndaj luftës; që ti aftësoj nxënësit të kuptojnë reletetin shoqëror veq qeverisje, të forcoj vllazërimin e bashkimin e kombeve dhe të kombësive të RSFJ, të zhvilloj tek ata dashurinë ndaj atdheut socialist vetqeverisë, të ndikoj në forcimin e fizionomisë së tyre morale dhe të nxisë të marrin pjesë në aktivitete në jetën shoqërore; që duke njohur veprat letrare me vlerë të popujve të tjerë, të zhvilloj te nxënësit jo vetëm dashurinë ndaj letërsisë si vlerë kulturele e përbashkët e njerzimit, por edhe dashurinë e popujve të tjerë dhe ndaj luftës së tyre për progres; që duke njohur gjuhën amtare të nxënësit të mësojë vetë gjuhët e huaja dhe që t’u ndihmojë nxënësve të formojnë botkuptimin marksist mbi shoqërinë dhe mbi natyrën.*

1.8. PËRPJEKJET SERBE PËR HARTIMIN E “BËRTHAMAVE TË PËRBASHKËTA”, 1981-1989

Vitet 1981 –1989, një periudhë shumë e rëndë për sistemin e arsimit në Kosovë. Në të vërtetë, gjendja ekonomike ishte përkeqësuar shumë, si në Jugosllavi, ashtu edhe në Kosovë. Të rinjtë shqiptarë me diploma fakulteti bredhnin të papunë. Kjo atmosferë është reflektuar në zhvillimet e mëvonshëm politike dhe arsimore që më 11 mars 1981, kur studentët e Universitetit të Prishtinës shpërthyen mllëfin e grumbulluar të padrejtësive ta manifestojnë me protesta të qeta, të cilat u përcollën me dhunë policore, me burgosjen e disa studentëve. Me bekimin e Akademisë serbe të shkencave, Kishës serbe dhe sigurimit serb, organet e Federatës shtypën këtë revoltë, duke i përdorur yshtjet e Serbisë, dhe dukemi marrë për shkas vlerësimet politike të “*veprimeve kontra revolucionare*” të shqiptarëve(!) Këtu nisi sulmi mbi “*faktorët kujdestarë*” mbi autonominë e Kosovës dhe mbi sistemin arsimor.¹⁵³ Pasojë e kësaj politike ishin: përjashtimi nga LKJ-ja, i cili shoqërohej me përjashtime nga puna, me pasojë arrestimet dhe bisedat informative që përcillehin me rrahje e brutalitet të paparë. Gjatë bisedave informative e dhunës policore gjatë “*Pranverës studentore '81*”, u vranë nxënës e mësimdhënës.¹⁵⁴ Si masë tjetër sebe erdhi ndalimi i regjistrimit të nxënësve shqiptarë në shkolla të mesme dhe fakultete për shkak të papërshtatshmërisë ideopolitike. Vlerësimi i përshtatshmërisë morale, ideore dhe politike bëhej në mbështetje të dokumentit: “*Kriteret mbi verifikimin e përshtatshmërisë ideopolitike të studentëve për regjistrim në vitin e parë të studimeve dhe për vendosje në konvikte*”. Sipas këtyre kritereve: “... do t’u shkurohej e drejta në shkollim shumë nxënësve dhe studentëve... që janë marrë me veprime armiqësore... që kanë qenë skriptorë të parullave dhe të pamfleteve.. që kanë marrë pjesë në demonstrata, etj. Në bazë të këtyre kritereve 1820 studentë shqiptarë nuk marrin “vizë” për regjistrim në Universitetin e Prishtinës.”¹⁵⁵

E gjithë kjo atmosferë e rëndë politike antishqiptare, me qëllim rrënimit të arritjeve në sistemin arsimor, u përdor nga Serbia që të hiqen nga programet dhe tekstet e shkrimtarëve, artistëve dhe veprave të tyre të mirëfillta (*Ismail Kadaresë, Dritëro Agollit, etj.*) dhe zëvendësimi i tyre me autorë dhe vepra sllave. Kosova ishte e vetmja njësi federale së cilës i imponoheshin “*Bërthamat e Përbashkëta Programore*”, në të vërtetë, ishin përmbledhje e përmbajtjeve nga historia, kultura dhe trashëgimia serbe, të cilat përmbajtje për shkak të karakterit etnocid të tyre nuk i pranuan as malaziasit, as maqedonasit, as boshnjakët, as kroatët e as sllovenët. Me qëllim realizimi të aspiratave të tyre nacionaliste dhe antishqiptare me vendime politike nga Beogradi ishin miratuar masat represive ndaj arsimimit në gjuhën shqipe.¹⁵⁶ Ky ishte skenar për ndalimin e

¹⁵³ Synimi serb doli sheshazi në përpjekje për të rrënuar këtotribute të shqiptarëve në Kosovë me veprime të koordinuara policore, ushtarake, politike, juridike dhe ekonomike. Pasi, Universiteti i Prishtinës shpallet qendër e separatizmit shqiptar, ndërsa sistemi i arsimit burim i indoktrinimit nacionalist dhe separatist shqiptar, kutu aplikohet vështrimi nën llupë, duke nisur një diferencim ideopolitik (*dallim në mendim dhe mendim i ndryshëm nga platforma nacionaliste serbe*).

¹⁵⁴ U vra Afrm Abazi, Xhemajli Berisha, duke u hedhur i gjallë nga kati i tretë i SPB-së. Gjatë periudhës 1981-1989 nëpër kazamatet jugosllave kaluan 4.600 arsimtarë, studentë dhe nxënës. Ky proces përcillej me përjashtimin e nxënësve nga shkollat fillore, edhe pse kjo ishte e kundërligjshme, përjashtimin e nxënësve nga shkollat e mesme, fakultetet, konviktet, etj. Nga shkollat përjashtohen 1015 nxënës, nga universiteti 568 studentë dhe nga procesi mësimor dëbohen 388 arsimtarë.

¹⁵⁵ Abdyl Ramaj, *Studentët nga listat e zeza*, (1981-1990), Zëri, 15 qershor 1991, f.17.

¹⁵⁶ Ndër këto masa ishin: pensionimi i parakohshëm i arsimtarëve shqiptarë, (fjala ishte për sigurimin e një shkasi juridik për largimin e arsimtarëve më të mirë nga puna), futjen e gjuhës serbe si gjuhë zyrtare dhe shndërrimin e gjuhës shqipe në diglosi në gjuhë familiare, zbatimin e mësimin dygjuhësor dhe të paraleleve të përziera, zvogëlimin

mësimi në gjuhën shqipe dhe kthimin e situatës në Kosovë në gjendjen ndërmjet dy Lufërave Botërore. U shpik “albanizimi” i Kosovës, andaj për të “penguar” këtë “albanizim” u vu në veprim serbizimi i vërtetë (*ndërrimi i emërtimeve të shkollave, heqja e emërtimeve shqipe dhe futja e emërtimeve sllave, përdhosja e bustave, përmendoreve të personaliteteve historike, arsimore dhe kulturore e kombëtare shqiptare para institucioneve shkollore*)¹⁵⁷ si dhe diskriminimi racor.¹⁵⁸ Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1989, Serbia në aspektin formal juridik, sistemi i arsimit në Kosovë u suprimua!

Pas këtyre zhvillimeve Këshilli Arsimor i KSA të Kosovës e ka aprovuar Planin dhe programin e korigjuar mësimor të gjuhës shqipe dhe të gjuhës serbokroate (*gjuhën joamtare dhe amtare*). Ndryshimet dhe plotësimet janë bërë me qëllim që “të lirohen” programet prej atyre përmbajtjeve, të cilat i kanë kontribuar në një masë të duhur, realizimit të qëllimeve ideore dhe edukuese në arsimin dhe edukimin e mesëm të orientuar. Programet janë plotësuar me përmbajtjet të reja, tamam për nevojat e forcimit dhe *pasurimit të përhershme e të vëllazërimit e bashkimit, bashkjetesës së kombeve e kombësive*. Përmbajtjet e reja do t’ i kontribuojnë edhe më shumë të zhvillojnë ndryshimet e patriotizmit dhe internacionalizmit socialist jugosllav dhe do t’u ofrojnë nxënësve dituri të nevojshme për luftën e përbashkët të kombeve e kombësive, në Luftën Nacionalçlirimtare dhe gjatë revolucioneve. Me korigjimet¹⁵⁹ e imponuara programore fillimisht u atakuan qëllimet dhe detyrat e mësimi të gjuhës dhe letërsisë shqipe, të cilat u kornizuan në kërkesat që “...nxanësit të njohin veprat më të rëndësishme dhe shkrimtarët më të njohur të letërsisë shqipe, jugosllave e botërore; që nxanësit të aftësohen për të kuptuar vlerën ideestetike të veprës letrare; ...të ndikojnë në formimin e ndjenjës së patriotizmit socialist vetëqeverisës të nxënësve dhe të zhvillojë ndjenjën e nxënësve për bashkjetesën dhe ndjenjën e përbashkëtisë së kombeve e të kombësive të Jugosllavisë.”¹⁶⁰ Mësimi i gjuhës amtare shqipe në shkollën fillore në Kosovë, në këtë periudhë realizohej kryesisht përmes këtyre lëmenjve: *Përpunimi i teksteve të leximit dhe recitimi; Të shprehurit me gojë dhe me shkrim dhe Njohuri mbi gjuhën (gramatikë), etj.*

e numrit të nxënësve dhe të studentëve shqiptarë në arsimin e mesëm dhe të lartë dhe shtimin e numrit të nxënësve dhe të studentëve serbë.

¹⁵⁷ Objekt sulmi dhe përdhosjeje ishin figurat më të shquara të kombit shqiptar: vëllezërit Frashëri, Luigj Gurakuqi, poet dhe ministër i parë shqiptar i arsimit, Hivzi Sylejmani, poet dhe luftëtar-partizan, Hasan Prishtina, atdhetar i shquar, Azem e Shote Galica, Halit Ibishi i internuar nga nazistët dhe i djegur në krematoriumet naziste, etj.

¹⁵⁸ Këtë e realizoi (*themi pjesërisht, sepse shqiptarët asnjëherë nuk u pajtuan me këtë përdhunim juridik dhe administrativ e policor*) më 28 mars 1989 kur në kushtet e administrimit ushtarak dhe policor, me votime të falsifikuara (në mesin e parlamentarëve ishin futur edhe agjentë të Sigurimit shtetëror, me akte dhune e kundërkushtetuese dhe të falsifikuara e “siguroi” vizën për rrënimin e autonomisë. Meqenëse autonomia e realizuar e Kosovës me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 ishte shpallur shkaktare e indoktrinimit separatist të shqiptarëve, me mitingje të serbëve të Kosovës (*të gjitha të organizuara nga regjimi i Milosheviqit*) bëhen shtypje të mëdha për t’u hyrë ndryshimeve kushtetuese për zbatimin e skenarit për rrënimin e dhunshëm të rendit kushtetues të Kosovës.

¹⁵⁹ Në këtë Plan-program të korigjuar të vitit 1982, janë dhënë tekstet integrale të programit me të gjithë ndryshimet dhe plotësimet për lëndët në fjalë.

¹⁶⁰ Më pastaj, sipas këtij Plani dhe programi, kërkesat u përqendruan kryesisht drejt ideologjizimit dhe porosive politike: “që t’i aftësojë nxënësit të kuptojnë reletetin shoqëror veç qeverisje, të forcojë vëllazërimin e bashkimin e kombeve dhe të kombësive të RSFJ, të zhvillojë tek ata dashurinë ndaj atdheut socialist vetëqeverisës, të ndikojë në forcimin e fizionomisë së tyre morale dhe të nxisë të marrin pjesë në aktivitete në jetën shoqërore dhe që t’u ndihmojë nxënësve të formojnë botkuptimin marksist mbi shoqërinë dhe mbi natyrën.”

1.8.1. Rëndësia e kundërshtimit të bërthamave “të përbashkëta” -Planeve dhe programeve mësimore për gjuhë shqipe

Në këtë periudhë, përpjekjet e politikës shoviniste serbe ishin tepër të egra që përmes Pleqësisë së Arsimit të Serbisë të imponohen plane dhe programe të papranueshme për shqiptarët e Kosovës, pasi me ndryshimet kushtetuese të vitit 1989 i kishte rrëmbyer të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat për hartimin dhe miratimin e programeve mësimore për të gjitha lëndët mësimore dhe për të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë. Në veçanti përpjekjet për ndërhyrje në lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe ishin këmbëngulëse. Në bazë të kësaj “të drejte” institucionet serbe kishin miratuar programet mësimore, në mesin e të cilave edhe atë të gjuhës dhe të letërsisë shqipe për shkolla fillore dhe të mesme. Këto “ndryshime” u kundërshtuan, nga institucionet arsimore të Kosovës, sepse përmbajtjet programore ishin shumë të papërshtatshme dhe të pavolitshme për nxënës dhe mësimdhënës shqiptarë.¹⁶¹ Pas kësaj gjendje, gjatë vitit 1990 u bë hartimi i planeve dhe programeve mësimore për shkollat fillore dhe të mesme tërësisht të pavarura të Kosovës.¹⁶² Filloi vënia e bazamentit të shkëputjes së arsimit dhe pavarësimin e tërësisht të shkollës shqipe (*programeve mësimore, teksteve mësimore, etj.*) të Kosovës. Përpjekja e institucioneve serbe për të rrënuar sistemin e arsimit, dolën sheshazi duke nxjerrë “vrerin” për urrejtjen për ngritjen dhe zhvillimin e shkollës shqipe, dolën shesazi elemente “të fjetura” shoveniste serbe edhe gjatë disa dekadave të kohës së socializmit! Shënjestrimi vinte, për faktin se gjuha dhe letërsia shqipe dhe shkolla shqipe ishte mjet i fuqishëm për mbrojtje të interesave kombëtare, përkatësisht ekzistencës kombëtare të shqiptarëve në Kosovë. Urrejtja dhe përpjekja e institucionalizimit të luftës antishqiptare dhe ushqimit të ndjenjave të alabanofobisë tek qarqet serbe ishte ruajtur e gjallë sepse, ata sikur e dinin mirë se “Mungesa e mësimin të gjuhës amtare sillte errësirën dhe pastaj humbjen e kombësisë.”¹⁶³ Prandaj, shpesh objekt i kritikave politike nëpër forume partiake të atëhershme jugosllave e sidomos atyre serbe, por edhe objekt kritike në shtyp ishin gjoja “glorifikimi i së kaluarës” dhe shpesh theksohej se, po “eksagjerohej bukuria, pasuria dhe lashtësia e gjuhës shqipe.” Ishte kjo një shenjestrime i gjithë punës arsimore dhe arritjeve të periudhës (1945-1981) kur u hodhën themelet e pedagogjisë dhe didaktikës shqiptare e që kjo rilindje e dytë e shqiptarëve ishte bërë halë në sy, sidomos, për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Serbisë. Kërkesat serbe ishin paradoksale, programet për arsimin shqiptar të “korrigjoheshin”, sepse gjoja janë ushqyer së “tepërmi” nga ndjenja e nacionalizmit e iredentizmit shqiptar! Qëmoti ishte kërkuar që edhe shqiptarët të gëzojnë të gjitha të drejtat sikur popujt e tjerë të Ballkanit, që në kohën e Rilindjes Kombëtare, kur përfaqësuesit e saj patën thënë: “...le të shkojmë përpara me ballë të hapur, me guxim, me durim dhe me këmbëngulje.”¹⁶⁴ Shtypi i kohës, dëshmitë e mësimdhënësve dhe dokumentet legjislativ

¹⁶¹ Nga planet dhe programet mësimore të gjuhës shqipe si lëndë mësimore ishin hequr shkrimtarët e njohur shqiptarë, si: Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Mark Krasniqi etj., ndërsa nga gjuha dhe letërsia serbokroate për shkollat fillore ishin hequr shkrimtarët: Rexhep Hoxha, Agim Deva, Migjeni, Naim Frashëri, Esad Mekuli, Rifat Kukaj, ndërkaq në shkolla të mesme ishin hequr: Nazmi Rrahmani, Hivzi Sulejmani, Rexhep Qosja dhe Enver Gjerqeku, Ndre Mjeda, Bedri Dedja, Qamil Batalli, Mehmedali Hoxha etj., të cilët ishin zëvendësuar me autorë të letërsisë serbe dhe jugosllave si, Dragan Kulixhan, Mira Alečković, Oton Zhupançiqi, Ratko Zvetko, Stojan Tarapuzza etj.

¹⁶² Këto programe u miratuan nga Pleqësia e Arsimit të Kosovës në gusht të vitit 1990 dhe kështu, sistemi arsimor i pavarur i Kosovës.

¹⁶³ Gazeta “Korça”, nr.8, Korçë, 20 mars 1909, fq.2.

¹⁶⁴ Naum Veqilharxhi, “Letër Enciklike për të gjithë të pasurit e të mësuarit ortodoksë shqiptarë” (Shih. Enis Sulstarova: Naum Veqilharxhi dhe lindja e kombit, Tiranë, 2012).

e programore të këtyre viteve nxjerrin në spikamë gjithë kompleksitetin e kulmimit të këtyre përpjekjeve të filluara, pothuaj menjëherë, pas ngjarjeve të bujshme të vitit 1981, u “shpalosën” projektet antishqiptare të Serbisë. Synimi ishte i qartë, kolonizimi dhe ndryshimi i strukturës kombëtare, rrënimi i arritjeve në lëminë e arsimit. Në emër të asaj që “*Të arrihet shkallë e unitetit, e njohjes më të mirë reciproke, e zhvillimit, e afirmimit dhe e gërshetimit të vlerave kulturore, letrare, artistike, gjuhësore dhe të tjera të të gjitha kombeve dhe të kombësive të Jugosllavisë,*”¹⁶⁵ ishte tentuar të proklamohet hartimi dhe imponimi i bërthamave të përbashkëta programore për gjuhë dhe letërsi shqipe. Puna në hartimin e bërthamave të përbashkëta, duket të jetë projektuar edhe nja dy vite para ngjarjeve të vitit 1981.¹⁶⁶ Duke qenë në dijeni për gjithë kompleksitetin e planit dhe programit mësimor për lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe, kjo erdhi si një manifestim i gjithë vrazhdësisë e reflektimit të aparatit shtetëror serb të atyre viteve mbi shkollën shqipe. “Zhvillimet e hovshme të shqiptarëve të Kosovës, veçmas zhvillimi i gjuhës shqipe, kulturës, letërsisë, identitetit kombëtar, pasi shoqëria ka lidhje të shumëfishta me to”,¹⁶⁷ ishte pengesa e albanofobëve.

❖ **Vendim që shembi dilemën se, a do të përkthehej edhe Abetarja dhe do të imponohej alfabeti i cirilicës...?!**

Gjuha shqipe dhe letërsia kombëtare (*e traditës dhe ajo bashkëkohore*) letërsia popullore, lektura shkollore, arti skenik, filmi, kanë të veçantat kombëtare andaj ishte paradoksale që të kërkohej unifikim i këtyre segmenteve programore. Praktika pedagogjike kishte dëshmuar se mësimdhënia e gjuhës shqipe nuk është vetëm një proces teknik, por edhe me shumë vlerë atdhetare për brezin e ri. Gjuha amtare është identiteti më i spikatur i një kombi. Andaj, duke pasë në mendje se ne jemi një komb që e kemi shkruar vonë atë dhe shkollimi në gjuhën amtare ka nisur relativisht me vonesë, duhet nënkuptuar se jo rastësisht edhe qarqet nacionaliste fqinje e kanë patur gjuhën tonë shqipe në një shënjestër ku do të godisnin fort, dhimbshëm duke dashur kështu të godisnin të ardhmen tonë. Mesazhi ishte i qartë: “*A jemi nolianë, konicianë, naimjanë përballë Evropës së kulturuar në përdorimin e gjuhës së folur e të shkruar shqipe?*”¹⁶⁸ Në mesin e shumë shkrimeve në gjuhën serbe që përpiqen të argumentojnë

¹⁶⁵ Isak Shema, *Çështje të arsimit kombëtar shqiptar*, Libri shkollor, Prishtinë, 2000.

¹⁶⁶ Vlen të përmendet se në një takim të Komisionit ndërepublikan në vitin 1982 nuk ishin ftuar fare përfaqësuesit e Kosovës. Ndërkaq, në vitin 1983 kishte filluar një diskutim publik, në të cilin ishin ngritur shqetësime dhe vërejtje serioze. *Këtë vit vërejtjet më të argumentuara në kundërshtim të përpjekjeve serbe ishin ngritur nga Grupi punues i Kosovës dhe Sllovenisë, që ishin të orientuara kundër bërthamave programore të përbashkëta për Gjuhë dhe letërsi shqipe.*

¹⁶⁷ Helena Grillo, *Prirje të zhvillimeve gjuhësore në gjuhën e shkruar dhe perspektiva e tyre*, Educologia, nr.5, Prishtinë, 2011.

¹⁶⁸ Po të flasim me gjuhën e shifrave të popullsisë shqiptare që flet shqipen në Ballkan, mund të themi se në Kosovë gjuha flitet nga rreth 2 milion shqiptarë, në Maqedoni ka rreth 500 000 shqiptarë, në Mal të Zi ka rreth 50 000 shqiptarë dhe 70 000 të tillë në krahinat shqiptare që sot varen drejtpërdrejt nga shteti serb në Preshevë, Bujanovc, në Medvegjë. Arritjet gjuhësore, si: Konsulta e Prishtinës 1968, Kongresi i Drejtshkrimit 1972, pas Kongresit të Manastirit 1908 janë vendime të kthesës së madhe gjuhësore e kombëtare. Droja e pushtuesit nga njësimi i të gjithë teksteve të gjuhës amtare, i teksteve të letërsisë, por edhe të historisë, të gjeografisë i kishte shtyrë të ndërmarrin hapa për të *vënë gur të ri të ndarjes!* Besoj se motoja më e mirë që ka udhëhequr drejtuesit institucionalë, por dhe gjithë mësimdhënësit ishte motoja atdhetare dhe fisnike që ushqehet për ruajtjen e identitetit shqiptar në një shoqëri të egër me logjikë shfarosëse e, ishte thënia e një dijetari të shquar gjerman: “*Më jepni një gjuhë të bukur, t’ju jap një komb me qytetari të mbaruar!*” Kërkesë absurde dhe anakronike, që e tillë edhe sot duket, sepse 70 për qind të

veprimet serbe si hapa “të vërteta shkencore dhe të qëndrueshme”!¹⁶⁹ Dokumenti “Vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet e KSA të Kosovës lidhur me bërthamat e përbashkëta programore të Gjuhës dhe letërsisë”¹⁷⁰, si projekt-ligj, krahas ngarkesës së papranueshme me numrin e orëve mësimore për klasë brenda javës, çuditërisht ishte dhënë edhe “mundësia” e prindërve për të zgjedhur se në cilën gjuhë fëmija “dëshiron” të ndjekë mësimin!? Anamali të tjera të kësaj periudhe të projekteve asimiluese ishte fakti se në Kroaci mësoheshin tri gjuhë të mjedisit, ndërsa në Maqedoni nuk mësohej gjuha shqipe si gjuhë e mjedisit, kurse në Kosovë gjuha shqipe si gjuhë joamtare ishte eliminuar tërësisht!¹⁷¹ Kjo vinte si pasojë e përligjjes së miratimit të programeve dhe teksteve mësimore nga “lartë”!¹⁷² Me këto ndryshime të imponuara dhe të dhunshme kushtetuese Serbia tentonte të fitoi “të drejtën” të ndërhyjë në një segment mjaft të ndjeshëm të qenies kombëtare të shqiptarëve të Kosovës. Institucionet e saj “kishin miratuar programet mësimore, në mesin e të cilave edhe ato të gjuhës dhe të letërsisë shqipe për shkolla fillore dhe të mesme...”¹⁷³ Këto ndryshime të përmbajtjeve programore ishin shumë të papërshtatshme dhe të pavolitshme për nxënës dhe arsimtarë shqiptarë. Vërejtjet e shqiptarëve ishin përbuzur dhe në versionin e pestë të këtij dokumenti kërkohej së paku 25 për qind të letërsisë jugosllave të përfshinin programet e letërsisë shqipe në Kosovë. Në këto dokumente ishte rikthyer emërtimi nënçmues “shqiptari” që ishte flakur nga përdorimi, pothuaj për disa dekada. “Nga plani dhe programi mësimor ishte hequr kultura dhe tradita shqiptare dhe historia kombëtare shqiptare.”¹⁷⁴ Ishin të shumta arsyet se plani dhe programi mësimor i hartuar prej organeve “profesionale” të Serbisë për shqiptarët e Kosovës ishte i papranueshëm dhe se ato u refuzuan me këmbëngulje. Për të ilustruar tendencat dhe synimet hegjemoniste të Serbisë, në këto plane dhe programe mësimore në lëndët natyra dhe shoqëria Kosova edhe si Krahinë edhe si emërtim ishte fshirë tërësisht, siç ishin fshirë edhe ilirët! Për të dalur në shesh gjithë paradoksi i synimeve të hartuesve të këtyre programeve, po përmendim edhe faktin se në lëndën e historisë, në klasën VIII ishte paraparë tema mësimore “Lëvizja separatiste shqiptare në Kosovë”. Fusha dhe lënda mësimore ku më së rëndi ishte theksuar kjo vrazhdësi ishte lënda mësimore e Gjuhës dhe letërsi shqipe, që do të jetë objekt i përpjekjeve tona për të hedhur dritë mbi këtë periudhë të

programeve kërkohej të dukeshin dhe të jenë unike! Më vonë “ekspertët zemërbutë” të arsimit serb kishte ulur këtë përqindje në 50 për qind të tërësisë. Duke mos respektuar specifikat letrare, kulturore, gjuhësore e historike, pas debateve të gjera u vlerësua se këto bërthama janë të papranueshme. Vlerat autentike dhe specifikat kombëtare ishin shkelur në mënyrë drastike.

¹⁶⁹ Shkrimi i revistës “NIN” e 17 prillit 1983 të titulluar “Disa poezi të vjetra”. Në shkurt të vitit 1986 në grupin punues për gjuhë dhe letërsi ku nuk ishin të pranishëm përfaqësuesit kroat e slloven u shqyrtua edhe dokumenti *.(Vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet e KSA të Kosovës lidhur me bërthamat e përbashkëta programore të Gjuhës dhe letërsisë.)* (Serb. “Predlog zajednickog programskog jezgra maternjeg jezika i knjizevnosti u sonovnim i srednjem usmerenom obrazovanju i vaspitanju u SFRJ(peta-radna verzija), Beograd, februar 1986. *(Vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet e KSA të Kosovës lidhur me bërthamat e përbashkëta programore të Gjuhës dhe letërsisë.)*

¹⁷⁰ Predlog zajednickog programskog jezgra maternjeg jezika i knjizevnosti u sonovnim i srednjem usmerenom obrazovanju i vaspitanju u SFRJ(peta-radna verzija), Beograd, februar 1986.

¹⁷¹ Si pasojë e këtyre dispozitave tmerrësisht të papara në ndonjë vend të botës, me automatizëm “suprimoheshin të gjitha institucionet e arsimit (Enti Krahinor i Përparimit të Arsimit e të Edukimit, Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore dhe Pleqësia e Arsimit të KSA të Kosovës.)

¹⁷² Rexhep Osmani, “Shkëndija”, 1 maj 1990.

¹⁷³ Bajram Shatri, *Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX* (sfida, dëshmi, fakte) I-II, Libri shkollor, Prishtinë, 2006.

¹⁷⁴ I. Ilazi, *Ç’tha Halim Hyseni pas kthimit nga Beogradi, Më nuk do të bëjmë lëshime*, Shkëndija, 20 qershor 1990.

historisë së arsimit shqip në Kosovë.¹⁷⁵ Me këtë plan ishin mënjanuar përmbajtje shumë programore dhe 19 libra të lekturës shkollore. Duke mos u respektuar kriteret profesionale e shkencore, përmes bërthamës programore, në program hynë 15 autorë maqedonas. Në kuadër të lekturës shkollore u përfshinë këta tituj: “Mësuesja”, G.Bonliovski, “Tito-na shikon ne”-P.Tropovski, “C.Andrijeviski, Biliانا” ...etj.¹⁷⁶ Duket se përmes ndryshimeve kushtetuese, “ekspertët” serb të arsimit kishin krijuar bazë me nenin 300 dhe 301 të Kushtetutës së tyre që këto ndryshime të “trajtohen” si koncept shtetëror për gjuhën.¹⁷⁷ Mësimi i gjuhës serbokrate dhe cirilica do të duhej të mësohej nga klasa e parë...¹⁷⁸ Përbuzja, jotoleranca dhe mospërfillja e gjuhës së tjetrit nuk ka si të trajtohet ndryshe veç si një fyerje e ofendim i rëndë që i bëhej popullsisë, për nga numri ishte e treta në ish-Jugosllavi. Kudo zyrtarisht e medialisht bëhej presion se viti 1991 do të shënonte fillimin e aplikimit të teksteve e programeve të përbashkëta jugosllave.¹⁷⁹ Ishte shkuar deri në ekstrem sa që vlerësuar sipas dispozitave ligjore e përbërjes së Pleqësisë së Arsimit të Serbisë, ose duhet ata të mësojnë gjuhën shqipe, ose duhet hartuar serbisht Abetarja e më pastaj të përkthehej(!) Këto programe kishin synim shkatërrimin e identitetit tonë kombëtar të ruajtur ndër shekuj me sakrificë,gjak e mund! Ky “Vendim” parashihte “Që në Programin e gjuhës dhe letërsisë shqipe, për arsimin fillor, të përfshihet bërthama e përbashkët programore në kuadër të 98 përmbajtjeve dhe të 135 orëve mësimore (të gjithë bërthama e përbashkët programore) ndërsa në pjesën tjetër të fondit të orëve dhe numrit të përmbajtjeve do të caktohet për letërsinë kombëtare shqiptare.”¹⁸⁰

Para së gjithash në shënjestër të politikëbërësve të arsimit në Serbi ishte vënë letërsia shqiptare e në veçanti shkrimtarët e traditës. Me “porositë” e “selamet” politike që vinin nga Beogradi urdhërohej që nga planet dhe programet mësimore të gjuhës shqipe si lëndë mësimore të mënjanoheshin shkrimtarët shqiptarë, si: Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Mark Krasniqi, etj. Ngjashëm edhe nga planet e programet e gjuhës dhe letërsisë shqipe për shkollën e mesme ishin hequr: Nazmi Rrahmani, Hivzi Sulejmani, Rexhep Qosja dhe Enver Gjerqeku.¹⁸¹

Halë në sy e “ekspertëve” serb të arsimit ishin shkrimtarët dhe përmbajtjet letrare që ata mendonin se ndikonin në zgjimin e ndjenjës kombëtare dhe për këtë arsye që nga klasa e parë e shkollës fillore nga lënda mësimore *gjuhë amtare*, nga planet e programet mësimore ishin fshirë: Ndre Mjeda, Bedri Dedja, Qamil Batalli, Mehmedali Hoxha, Zejnullah Halili, Rrahman Dedja,

¹⁷⁵ Ç’është e verteta, një Grup punues “profesional”, ku ishin edhe përfaqësuesit e Kosovës kishte përgatitur këtë “sihariq” për shqiptarët, madje edhe Pleqësia e Arsimit të KSA Kosovës e kishte miratuar si të tillë (!) Me këto ndryshime ishte ndryshuar struktura e programit, ishte bërë ndarja e përmbajtjeve të obligueshme dhe jo të obligueshme, ndarje të tillë nuk ishte bërë për republikat tjera e as për Vojvodinën.

¹⁷⁶ Rexhep Osmani, “Rilindja”, 9 nëntor 1988, Prishtinë.

¹⁷⁷ Farsa mbështetej në rrezikimin e gjuhës serbe! Kështu gjuhët e kombësive ishin vënë në pozitë nënçmuese dhe ishte rikthyer te zgjidhjet kushtetuese të viteve 1921 (Kushtetuta e Vidovdanit).

¹⁷⁸ Propozim-Ligji i arsimit dhe edukimit të Jugosllavisë RS Serbisë 1989.

¹⁷⁹ E gjithë kjo bëhej në emër të kinse një “reformimi” të sistemit arsimor. Bërthamat e “përbashkëta” programore duket se kishin marrë “izën” e cenzorëve apo “ekspertëve” të gjuhës dhe letërsisë shqipe, ku ishte i pranishëm veç një shqiptar dhe të tjerët ishin serbë.

¹⁸⁰ Rexhep Osmani, “Shkëndija”, 1qershor 1990 (Duket se hesapet ishin bërë pa hanxhinë, sepse Kosova anekënd kërkonte barazi dhe flakje të mitomanisë mesjetare serbe që ishte lugatosur! Kosova dhe gjitha institucionet arsimore, në atë kohë kërkonin zbatimin e ligjeve të Kosovës dhe dinjitet për gjuhën, historinë, kulturën autoktone. Rrjedhojë e gjithë kësaj erdhi tek refuzimi i nënshtimit dhe refuzimi i tendencave asimiluese. U themelua Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë “Naim Frashëri” dhe filloi artikulimi i kërkesave dhe qëndrimeve e vendimeve të institucioneve të pavarura të arsimit të Kosovës. Këtu zë fill pavarësimi i sistemit arsimor të Kosovës.)

¹⁸¹ Rexhep Osmani, *Programe që shkatërrojnë identitetin kombëtar*, Shkëndija, 1 qershor 1990; Më gjerësisht shih: H. Hyseni & B. Shatri, *Struktura e punës edukativo-arsimore në shkollën fillore*, Shkëndija, 20 shtator 1990.

Fejzi Bojku, etj. Çuditërisht, në vend të tyre ishin futur shkrimtarë nga letërsia serbe dhe jugosllave: Dragan Kulixhan, Mira Alečković, Oton Zhupançiqi, Ratko Zvetko, Stojan Tarapuzza dhe në vend të “*Kam një harmonikë*” të Xhevat Beqarajt ishte futur Jovan Jovanović Zmaji me “*Vjersha për fëmijë*”. Për ilustrim po përmendim edhe planin dhe programin për klasën e pestë të shkollës fillore prej nga ishin flakur Besim Bokshi, Odhise Grillo, Petraq Zoto, Aleks Çaçi, Nazmi Rrahmani, Fahredin Gunga, Tonin Shiroka, Rexhep Hoxha, Agim Deva, Murat Isaku, Rrahman Dedaj, të cilët ishin zëvendësuar me Ivo Andriqin, Dushan Radovićin, Nikolla Koçishin, Dane Oblakun, Xhek Londonin, Sinan Hasanin dhe Sllavko Vukosavljeviqin. Nga lektura shtëpiake ishin hequr Bedri Dedja, Abdylaziz Islami, Luigj Gurakuqi, të cilët ishin zëvendësuar me shkrimtarë të huaj, si: Video Podgorecin, Miroslav Antiqin etj.¹⁸² Miratimi i këtyre programeve nga ana e Pleqësisë së Arsimit të Kosovës në gusht të vitit 1990¹⁸³, shënon fundin e ndikimit të sistemit serb mbi atë të Kosovës dhe shënon fillimin e pavarësimit të shkollës shqipe në Kosovë. Në atë kohë, me një profesionalizëm të qëndrueshëm ju vu hartimit të përmbajtjeve programore mësimore të Kosovës, tërësisht të pavarura. Ekspertët shqiptarë të hartimit të përmbajtjeve programore të *gjuhës shqipe dhe të letërsisë e ndjenë për obligim që të sjellin një frymë rilindjeje në këtë sferë. Në programet e gjuhës dhe letërsisë u planifikuan të përfshiheshin përzgjedhje nga veprat e shkrimtarëve deri atëherë të anatemuar! Po ashtu, në përmbajtjet programore të gjuhës dhe letërsisë shqipe u përfshinë dhe shumë shkrimtarë të dëshmuar, veprat e të cilëve ishin mënjanuar nga “*ekspertët*” serb.¹⁸⁴ Kjo gjendje faktorin shqiptar e kishte unifikuar, “*popullata shqiptare në përgjithësi dhe personeli mësimor në veçanti ishin këmbëngulës në zbatimin e vendimeve të organeve shtetërore kosovare si kurrë më parë.*”¹⁸⁵ Puna kishte ardhur deri aty sa në një takim të përbashkët të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë, të mbajtur në qershor 1990, saqë Ministri i atëherëshëm i Arsimit, në mënyrë të prerë kishte thënë: “*Është dashur të dihet me kohë se më nuk do të pranojmë kurrfarë plan-programesh mësimore, tekste dhe ligje ku ne nuk kemi qenë të kyçur dhe ku argumentet tona nuk janë marrë në konsideratë. Kur punohet plan-programi për Kosovën, ku ka shqiptarë, turq etj., nuk mund dikush të na imponojë ato zgjidhje që nuk do t'i pranojmë. Do të thotë, shqiptari duhet të shkruajë edhe serbokroatisht, cirilicë, edhe shqip... Kjo, shokë nuk mund të ndodhë kurrë...*”¹⁸⁶*

Kundërshtimi i bërthamave “*të përbashkëta*” programore, me një rëndësi të veçantë për historinë e shkollës shqipe dhe për historinë e Kosovës ishte jo vetëm JO e madhe përpjekjeve shoveniste serbe, por ishte nisma e udhës e sigurtë të pavarësimit të shkollës shqipe ishte viti 1990, kthesa e madhe jo veç në sistemin e arsimit të Kosovës.

¹⁸² S. Salihu, *vep. e cit.* fq. 58. (Ndryshimet përmbajtësore, jo veç i kundërshtoi Enti Pedagogjik i Kosovës dhe ekspertët e tij gjatë vitit 1990, por iu qas hartimit të planeve dhe të programeve mësimore të pavarura dhe në frymën e kërkesave të kohës, për shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës).

¹⁸³ Pleqësia në pamundësi që mbledhjen e miratimit të programeve ta mbajnë në lokalet e veta, u detyruan që të njëjtën ta mbajnë në lokalet e Bashkësisë Vetëqeverisëse Krahinore të Arsimit dhe të Edukimit.

¹⁸⁴ Halim Hyseni, Bajram Shatri, *Udhëzime praktike: Struktura e punës edukativo-arsimore në shkollën fillore, “Shkëndija”,* shtator, 1990. (Sipas dëshmimeve në shkrimet e shtypit të kohës, dhuna mbi institucionet arsimore tashmë ishte intensifikuar duke ftuar në biseda informative drejtorë shkollash, inspektorë, arsimtarë, dhe duke bërë kërcënime përmes policisë dhe sigurimit shtetëror.)

¹⁸⁵ Bajram Shatri, *Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX (sfida, dëshmi, fakte)* I-II, Libri shkollor, Prishtinë, 2006.

¹⁸⁶ Agim Zogaj, Blerim Shala, *Dëshmi për Kosovën 1989-1991*, Prishtinë, 1995, fq. 109.

1.9. HAPAT E PARË TË PËRAFRIMIT KURRIKULAR KOSOVË-SHQIPËRI PËR GJUHËN SHQIPE, 1990-1999

Viti 1990 shënon fillimin e pavarësimit të sistemit arsimor në Kosovë, edhe pse në publikimet e shkruara e përkufizojnë si formulim “*një sistem i krijuar paralel i arsimit.*” Madje, pushteti serb këtë sistem e ka quajtur sistem ilegal dhe paralel, por as njëri as tjetri pagëzim për sistemin e atëhershëm të arsimit shqip në Kosovë nuk është real, sepse ishte ky një sistem i krijuar tërësisht i pavarur.¹⁸⁷ Arsimi në gjuhën shqipe mori udhën e mëvetësisë.¹⁸⁸ Raporti shqiptar - serb në Kosovë ishte 93:07 dhe në këtë raport rëndë cenohet barazia e shqiptarëve, sepse gjuha shqipe dëshirohej të shndërrohej në diglosi - gjuhë familjare (*ky është hapi i parë i asimilimit dhe sjelljes së popullsisë shumicë në qytetarë të rendit të dytë*).¹⁸⁹ Me miratimin e programeve Serbia përshpejton procesin e dhunës mbi arsimin shqip, duke përdorur një sistem kompleks veprimesh administrative, policore- ushtarake, duke thelluar diskriminimin racor në Kosovë.¹⁹⁰ Në Universitetin e Prishtinës diskriminimi në realizimin e të ardhurave personale

¹⁸⁷ Sistemi i arsimit shqip natyrshëm është reflektuar si bazament i ndërtimit të pavarësisë së Kosovës. Duke mos i zbatuar ligjet diskriminuese të miratuara në janar të vitit 1990, në Kuvendin e Serbisë, që ishin në kundërshtim edhe me Kushtetutën e Jugosllavisë dhe për të mos zbatuar ligjet serbedhe planet dhe programet antishqiptare që tërësisht pezullonin trashëgiminë dhe kujtesën kolektive historike e popullit shqiptar.

¹⁸⁸ Për këtë arsye, drejtori i Entit Pedagogjik, në maj 1990, me letërën dërguar organeve të Kosovës dhe të Serbisë (*kuvendeve, pleqësive të arsimit, sekretariateve për arsim, kulturë dhe shkencë*) ua bënte me dije se plan-programet dhe ligjet e miratuara nga Kuvendi i Serbisë cenonin rëndë të drejtat dhe liritë e pjesës dërrmuese të popullsisë së Kosovës, andaj si të tillë nuk mund të zbatohen. Ndërkaq, më 28 maj 1990, Dhoma e Bashkuar e Kuvendit të Kosovës nxjerr një përfundim me të cilin vendos që për vitin shkollor 1990/91 të zbatohen plan-programet ekzistuese mësimore e jo plan-programet e projektuara nga Serbia. Me propozimin e Entit Pedagogjik të Kosovës më 26 qershor 1990, Kuvendi i Kosovës bëri ndryshime të thella në sistemin e arsimit fillor dhe të mesëm. Në arsimin fillor nga klasa V hiqet lënda e arsimit teknik. Mësimi i gjuhëve joamtare (të gjuhës shqipe dhe asaj serbe) vendoset me parimin e reciprocitetit dhe të barazisë. Konform këtij kriteri, Pleqësia e Arsimit merr vendim që mësimi i gjuhës shqipe dhe ai i gjuhës serbokroate të ishte edhe më tutje si lëndë fakultative, por që mësimi i njëjës kushtëzohet mësimin e tjetrës.

¹⁸⁹ Pleqësia e Arsimit e Kosovës më 24 gusht 1990 në mbledhjen e saj kishte paraparë miratimin e planeve dhe programeve mësimore konform ndryshimeve të bëra me reformën e sistemit të arsimit. Në mbledhje, delegatët serbë nuk pranorjnë që këto plan-programet t'i miratojë Pleqësia e Arsimit, edhe pse kjo ishte me ligj e obligueshme ta bëjë këtë. Njëherësh kjo ishte legale dhe legjitime sepse as nuk ishte suprimuar ende nga Serbia. Pas ngulmësisë së përfaqësuesve shqiptarë plan-programet e propozuara nga Enti për Përparimin e Edukimit dhe Arsimit të miratohen, përfaqësuesit serbë e lëshojnë mbledhjen. Meqenëse, Pleqësia kishte forum të paraparë me ligj, kjo i miraton plan-programet mësimore. Me këtë datë sistemi i arsimit në Kosovë përfundimisht ndahet në sistem të veçantë shqiptar. Gjendja bëhet e ngjashme me vitin 1945, por me vendosmërinë e shqiptarëve të mbrojnë pavarësinë e arsimit dhe të shkollës shqipe në Kosovë.

¹⁹⁰ Në mujin gusht 1990, të ardhurat personale u ndalën të gjithë arsimtarëve shqiptarë të Komunës së Istogut dhe të Podujevës pa asnjë arsyetim. Në të gjitha shkollat dhe institucionet parauniversitare fillon zbatimi i masave të dhunshme (me këto masa në vend të udhëheqjes shqiptare emërohej udhëheqja serbe). Në shtator të vitit 1990 nga shkolla fillore në Vitomiricë - Arbneshi i sotëm, Komuna e Pejës, përjashtohen të gjithë nxënësit dhe arsimtarët shqiptarë. Po kështu veprohet edhe në Leposaviq, në Lepi, Gorazhdec, etj. Me formimin e Shoqatës së arsimtarëve serbë “Sveti Sava” arsimtarët serbë marrin nga dy deri tri rroga më shumë se arsimtarët shqiptarë. Në muajin shtator të vitit 1990 nga shkolla e mesme në Trepçë përjashtohen 748 nxënës shqiptarë me 48 arsimtarët e tyre dhe në shkollë mbeten vetëm 60 nxënës serbë dhe malazes. Ky dëbim kishte qëllim pastrimin etnik. Në tetor të këtij viti në Entin për Përparimin e Arsimit dhe të Edukimit zbatohen masat e dhunshme, kështu u veprua edhe me punëtorët e Pleqësisë së Arsimit, të Sekretariatit për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, të Bashkësisë Krahinore Vetëqeverisëse të Arsimit etj. Procesi i dëbimit të nxënësve dhe arsimtarëve shqiptarë vazhdon me mbylljen e shkollave të mesme dhe përjashtimin e nxënësve dhe të arsimtarëve të shkollës fillore, muajve shkurt, mars, prill dhe maj 1991, kuptohet në

fillon të zbatohet nga qershori 1991, kur arsimtarët shqiptarë me të njëjtin kualifikim dhe për të njëjtat punë marrin rroga 30 % më të ulëta se mësimdhënësit me mësim në gjuhën serbe. Gjatë kësaj kohe udhëheqja e Kosovës vendos të formojë organizmin e quajtur Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë “Naim Frashëri”.¹⁹¹ Në funksion të spastrimit të programeve mësimore nga ideologjia komuniste, Enti Pedagogjik (nga viti 1992 *Enti për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit*) bëri ndryshimet e plan-programeve mësimore, hartoi programin për mësimin plotësues të cilin mësim e vijonin fëmijët e Kosovës jashtë vendit.¹⁹² Shkollat dhe Universiteti ishin shndërruar në pengje politike në duar të regjimit politik të Serbisë dhe të “RFJ”-ës.¹⁹³ Pleqësia e Arsimit të Kosovës, më 23 dhjetor 1991 vendosi të fillojë viti shkollor 1991/92, sipas njërës nga variantet dhe modalitetet e mundshme në vartësi nga kushtet e punës dhe rrethanat konkrete në secilën shkollë A (A-1, A-2, B dhe B-1 dhe; C dhe C-1)¹⁹⁴. Kudo shkolla shqipe mbrohej qoftë edhe me më të çmuarën, jetën, siç ngjau në fshatin Uçë të Burimit (*ish-Istogut*), më 31 janar 1992, kur nga policia serbe kishte shkuar për të penguar mësimin.¹⁹⁵ Në këto rrethana, në Kosovë, nga viti

etapa arsimtarëve shqiptarë të shkollave fillore dhe të mesme u ndalen të ardhurat personale. Kështu, tash rreth 20.000 arsimtarë mbeten pa ekzistencë minimale për jetë.

¹⁹¹ Kjo Lidhje formohet në dhjetor të vitit 1990, në bashkërenditje të aktiviteteve me organet që tash ishin suprimuar (Entin për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit, Pleqësinë e Arsimit, etj) udhëhoqi sistemin e arsimit shqip dhe u kundërpërgjigjej veprimeve rrënuese serbe (përgatititi dokumentacionin, caktoi kushte për regjistrim, organizoi takime dhe këshillime me drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme), etj. Në periudhën dhjetor 1990 deri më tetor 1991, kjo Lidhje luajti rol shumë të rëndësishëm (luante edhe rolin e Ministrisë së Arsimit të Kosovës).

¹⁹² Në fillimviti shkollor 1991/92, më 2 shtator, policia dhe ushtria serbe vendosen para ndërtesave shkollore me qëllim të ndalimit të mësimin në gjuhën shqipe. Ishte një veprim sa i papritur, aq edhe paradoksal, sepse siç dihet, arsimit fillor edhe sipas ligjeve serbe ishte i obligueshëm, andaj ishte nonsens të merreshin këto veprime që siç u tha jo vetëm ishin në kundërshtim me Kushtetutën e Jugosllavisë në shturje, por ishte edhe në kundërshtim me konventat ndërkombëtare dhe me Kushtetutën e Serbisë. Në këtë ditë, mësimi në gjuhën shqipe në arsimin parauniversitar tërësisht u ndalua. Kjo ndodh edhe me studentët dhe pedagogët universitarë në fillim të vitit akademik 1991/92. Para dyerve të fakulteteve ishin vendosur mjetet e blinduara të policisë dhe të ushtrisë serbe. Për shqiptarët historia përsëritej për të satën herë. Protestat e organizuar nga LASH-i dhe Shoqata e pavarur e arsimtarëve universitarë në fillim të shtatorit dhe të tetorit të vitit 1991, me të cilat kërkohej lejimi i mësimin në gjuhën shqipe nuk u përfill nga regjimi i Beogradit.

¹⁹³ Për të menazhuar situatën dhe për të kërkuar zgjidhje ishte formuar një këshill koordinues i udhëhequr nga prof.dr. Fehmi Agani (i ekzekutuar nga forcat policore ushtarake serbe, në maj të vitit 1999). Në një takim të mbajtur në tetor të vitit 1991

drejtori i Entit Pedagogjik doli me propozim të bëhen përgatitjet për fillimin e vitit të ri në shtëpi - shkolla sepse, në mbështetje të analizës së bërë nxirrej përfundimi që pasojat e moszhvillimit të mësimin për kombin shqiptar të Kosovës janë të mëdha dhe të pakompensueshme. Në fillim kjo ide u kundërshtua nga pjesëmarrësit (Prof. dr. Fehmi Agani, Prof. dr. Eshref Ademaj, Burhan Kavaja, përfaqësues i sindikatave, Prof.dr. Pajazit Nushi dhe Munish Hyseni, nënkryetar i kryesisë së LASH-it). Pas një insistimi të drejtorit të Entit Pedagogjik u vendos që të gjithë të pranishmit të përgatisin nga një propozim me të cilin do të analizoheshin mundësitë e daljes nga gjendja ekzistuese. Të nesërmen, materialin e kishte përgatitur vetëm drejtori i Entit Pedagogjik. Këtë material e shqyrtoi edhe Kryesia e LDK-ës njëherësh duke e përkrahur pas debateve të shumta (në mbledhje nuk ishte thirrur autori i materialit). Pas shqyrtimit të këtij materiali nga Kryesia e LDK-ës autori dha shpjegime dhe udhëzime nëpër takimet e shumta të drejtorëve të shkollave, të kryesisë të degëve të LASH-it, etj.

¹⁹⁴ Shih. Zeqir Demi, Roli i *Pleqësisë së Arsimit të Republikës së Kosovës në pavarësimin e shkollës shqipe-kushtet dhe rrethanat e jashtëzakonshme*, Prishtinë, f.33-39.

¹⁹⁵ Me këtë rast në mbrojtje të shkollës e gjuhës shqipe, nga policia serbe vriten Bajram Sadik Hysenaj, Muharrem Osman Hysenaj dhe Ejup Hasan Hysenaj. Deri më 15 shkurt 1992 punën në shtëpi private apo në shkolla sipas varianteve të parapara e kishin filluar të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës. Për dallim nga shkollat fillore, të gjitha shkollat e mesme dhe të gjitha fakultetet mësimin e fillojnë në shtëpi private, seps policia dhe ushtria serbe nuk lejonte hyrjen e nxënësve dhe të arsimtarëve shqiptarë në objekte shkollore nga të cilat ata përdhunisht ishin dëbuar. Në enklavat serbe

shkollor 1994/95 bëhen këto ndryshime kurikulare. Zbatimi i këtyre ndryshimeve filloi në vitin shkollor 1994/95 në klasat I dhe V. Me organet arsimore të Shqipërisë bëhet harmonizimi i planeve dhe programeve për lëndët nacionale (*gjuhë shqipe dhe letërsi, histori, gjeografi, muzikë, etj.*). Në vitin 1996 në sistemin e arsimit për herë të parë paraqiten edhe gjimnazet pedagogjike, ndërsa në vitin 1997 hapet edhe Fakulteti i Mësuesisë. Periudha 1990-1997 ishte e vështirë për pjesën dërrmuese të popullsisë së Kosovës. Revolta dhe deprimimi kishin arritur kulmin e durimit. Kjo revoltë shndërrohet në luftë të armatosur, e cila filloi më 26 nëntor 1997 në Drenicë. Pas fillimit të luftës së përgjakshme pasojnë krimet më makabre që ndodhin në historinë njerëzore (*vrasja dhe masakra e anëtarëve të familjeve Jasharaj, Ahmetaj, Delijaj, etj.*).¹⁹⁶ Mirëpo, megjithatë edhe në këto rrethana vazhdon mbajtja e mësimit në gjuhën shqipe, edhe në tenda nëpër malet e Kosovës.¹⁹⁷ Në Kosovë u krijuan dy sisteme paralele të arsimit, duke filluar nga viti shkollor 1990 deri në vitin 1999, kur përfundimisht nga Kosova u dëbuan administrata, policia dhe ushtria serbe. Pas luftës çlirimtare të UÇK-së u hartuan plane e programe të reja mësimore dhe mësimdhënësit e nacionalitetit turk dhe boshnjak që nga viti shkollor 1999/2000 punojnë sipas planeve dhe programeve mësimore të Republikës së Kosovës. Përjashtim bëjnë ende komuniteti serb. Kl. I – IV. Në atë kohë ishte paraparë që lënda e gjuhës dhe letërsisë shqipe nga klasa e I-IV të ketë fond prej 6 orësh në javë, kurse në klasën e pestë 5

(fshatra, lagje dhe qytete të banuara me popullsi të përzier), mësimi në gjuhën shqipe nuk lejohej në objektet shkollore as për nxënës të shkollave fillore. Pengimi i mësimit në këto vendbanime ishte dëshmi e pakontestueshme se serbët tentonin në këto vendbanime pastrimin etnik. Ishte kjo edhe një dëshmi e keqpërdorimit të arsimit për qëllime politike. Në muajin mars 1992, po me këtë skenar fillon viti i ri akademik në Universitetin e Prishtinës. Ishte ky projekt i përbashkët i SBASHKU-ut dhe të LASH-it, u formua Këshilli për Vetëfinancim, të cilin e pranoi Qeveria e Përkohshme e Kosovës dhe kështu u krijuan: Këshilli Qendror për Financim dhe Këshillat Komunale të Financimit. Krijimi i këtyre institucioneve bëri të mundur që arsimtarët shqiptarë nga maji 1992 të marrin paga në shumë 20 DM. Në fillim të vitit shkollor 1992/93, u formua Këshilli organizativ për mbajtjen e protestave, kërkesa themelore e të cilave ishte kthimi i nxënësve dhe i studentëve shqiptarë në objektet shkollore. Në këto protesta morën pjesë rreth 700.000 vetë në qytete të ndryshme të Kosovës. Dhuna që përdori policia serbe ishte shumë e ashpër. Qindra të rinj pësuan lëndime të rënda trupore. Në vitin 1992 në bisedat informative në polici mbytet drejtori i Shkollës fillore “Bajram Curri” në Strelcë, arsimtar i dalluar, Haki Pavataj. Në vitin 1992, në kuadër të Konferencës së Gjenevës formohen grupet punuese shqiptaro – serbe, të udhëhequra nga mediatori ndërkombëtar Gert Arens. Nga pala shqiptare në këtë grup ishin: Fehmi Agani, udhëheqës grupi, Ejup Statovci, rektori i Universitetit të Prishtinës, Hivzi Islami, përfaqësuesi i Partisë Fshatare të Kosovës, Rexhep Osmani, Kryetar i LASH-it “Naim Frashëri” dhe Halim Hyseni, drejtor i Entit Pedagogjik të Kosovës. Nga pala serbe anëtarë ishin: Ivan Iviq, Ministër i Arsimit i “RFJ”, Danillo Zh. Markoviq, Ministër i Arsimit të Serbisë, M.Grubaç etj. Në takimin e fundit në Gjenevë mori pjesë edhe këshilltari për arsim i Dr.Ibrahim Rugovës, z. Xhavit Ahmeti. Në takime të mbajtura në përpjekjet për normalizimin e mësimit në Kosovë në kuadër të kësaj konference nuk u arrit asnjë përparim, andaj edhe u ndërpre puna meqë regjimi i Milosheviqit nuk pranonte që takimet të mbahen jashtë “territorit” të “RFJ”, me këto takime ndërkombëtarizohej çështja e Kosovës. Me qëllim të krijimit të kushteve minimale për punë të suksesshme, ishte hartuar një strategji për vetëfinancimin e arsimit në gjuhë shqipe.

¹⁹⁶ Gjatë vitit 1998 shkatërrohen dhe rrënohen mbi 60 objekte shkollore, vriten 68 mësues dhe arsimtarë shqiptarë. Në janar të vitit 1999 ndodh masakra e Reçakut, kumt i zi për botën e qytetëruar dhe paralajmëruese e kobshme e ofensivës serbe në Kosovë e cila pason në mars të vitit 1999, kur edhe ndërpritet plotësisht viti shkollor edhe ashtu i përgjysmuar për shkak se një pjesë e mirë e shkollave të zonave të përfshira në luftë nuk e kishin filluar vitin shkollor ose e kishin filluar me një vonesë tepër të madhe (në Drenicë disa shkolla e filluan vitin shkollor 1998/99 më 7 janar 1999). Gjatë periudhës mars, prill e maj 1999 nga Kosova u dëbuan rreth 1.000.000 banorë, vriten dhe masakrohen mijëra qytetarë shqiptarë (fëmijë, vajza, gra plaka, pleq, nxënës, studentë dhe civilë të tjerë) të cilët u varrosën në mbi 500 varreza masive. Gjatë kësaj periudhe u vranë 319 mësues dhe arsimtarë, do të arrestohen dhe burgosen mbi 149 arsimtarë dhe do të zhduken mbi 137 arsimtarë, nxënës dhe studentë shqiptarë.

¹⁹⁷ Këto plane mësimore që u gjenden në duart e mësimdhënësve shqiptarë ishin të hartuara nga Enti Pedagogjik i Kosovës dhe të miratuara në Pleqësinë e Arsimit të Kosovës.

orë e në të VI, VII, VIII nga 4 orë. U hartuan planet dhe programet e gjuhës shqipe nëpër kushte të jashtëzakonshme. Në kushte të veçanta dhe të vështira, asnjëherë si më parë populli, institucionet arsimore, mësimdhënës, nxënës, studentë e prindër unik ishin kundër imponimit të bërthamave të përbashkëta. Për këtë qëllim, u ndërmorën Enti Pedagogjik i Kosovës iu përvesh punës¹⁹⁸ për të përgatitur dhe propozuar Ministrisë së Arsimit të Kosovës për miratim materialin me titull “*Struktura e punës edukativo-arsimore për shkollën fillore (mësimi në gjuhën shqipe-kushtet e jashtëzakonshme)*”.¹⁹⁹ Trupa e Ministrisë së Arsimit, që vepronin në Kosovë, e shqyrtuan këtë plan pastaj të njëjtin edhe Pleqësia e Arsimit në mbledhjen e 23 dhjetorit të vitit 1991 e shqyrtoi dhe e miratoi.²⁰⁰ Plani mësimor ishte hartuar sipas disa varianteve (A,B,C) me fonde më të reduktuara për lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe.²⁰¹ U vazhdua me ndryshimet e adaptimet e kohëpaskohshme të planeve. Në vitin shkollor 1992/93, Plani i ri mësimor me plotësim dhe korrigjime u aplikua nëpër shkollat fillore e të mesme.²⁰² Ky plan në edukimin dhe arsimin fillor, me ndryshime të vogla të vitit 1994/95, është zbatuar deri në vitin shkollor 1996/97. Sipas këtij plani, “*në paralelet prej klasës I deri në klasën IV mund të kenë nga katër orë mësimi në ditë, përkatësisht 20 orë në javë. Paralelet prej klasës V deri në klasën VIII mund të kenë deri në pesë orë mësimi në ditë, përkatësisht 25 orë në javë*”.²⁰³ Vetëm në periudhën e

¹⁹⁸ Halim Hyseni, drejtor, në emër të Entit Pedagogjik të Kosovës e kishte hartuar këtë plan të punës me variante dhe nënvariate për kushte të jashtëzakonshme të punës në shkolla.

¹⁹⁹ Enti Pedagogjik i Kosovës: Propozim për miratim Pleqësisë së Arsimit të Kosovës, planin: Struktura e punës edukativo-arsimore për shkollën fillore /mësimi në gjuhën shqipe – kushtet e jashtëzakonshme, janar, 1992.

²⁰⁰ Zeqir Demi, *Roli i Pleqësisë së Arsimit të Republikës së Kosovës në pavarësimin e shkollës shqipe*, Prishtinë, 1995, fq. 31.

²⁰¹ Halim Hyseni, *Praktikë shkollore në kushte të sotme*, “Shkëndija”, janar, 4/1992. (Me këtë variant të punës mund të mësonin dhe të punonin edhe shkollat të cilat punonin në lokale private, por që kushtet e punës i kishin të mira. Ishte paraparë edhe mundësia e kombinimit të varianteve, p.sh., “edhe në shtëpi private mund të organizohet mësimi sipas variantit A në ciklin e klasave të ulëta, ndërsa për klasat e larta – varianti C”.²⁰¹ Për shkollat, të cilat procesin e punës mësimore e kishin të organizuar në 3 e 4 ndërrime, ishte paraparë varianti A/1 dhe A/2. Shkollat të cilat punonin në tri ndërrime kishin paraparë variantin A/1, ndërsa ato që punonin në 4 ndërrime variantin A/2. Edhe në këtë rast ishte lënë mundësia e kombinimit të varianteve. Varianti B ishte paraparë për shkollat të cilat procesin mësimor e zhvillonin në dy e tri gjuhë mësimore, me 3 e 4 ndërrime. Varianti C ishte planifikuar për shkollat të cilat do të largohen nga objektet e tyre shkollore dhe të cilat ishin detyruar që procesin e punës mësimore ta zhvillonin në shtëpi private. Këto këto variante të punës dhe me reduktimin e orëve e numrit të ditëve të punës për vitin shkollor 1992 u publikuan në revistën arsimore “Shkëndija” për të njoftuar opinionin dhe mësimdhënësit. Në pjesën më të madhe të shkollave është punuar me nënvariantet e variantit A, pjesërisht është punuar me variantin B dhe pothuajse asnjë shkollë nuk ka punuar me variantin C. Këto variante të organizimit të mësimin në kushtet dhe rrethanat e jashtëzakonshme më shumë kanë qenë të zbatuara në arsimin e mesëm dhe në shkollat fillore, të cilat procesin mësimor e kanë zhvilluar në shtëpi private.)

²⁰² Zeqir Demi, *vep. e cit.*, fq. 48.

²⁰³ *Rregullore për themelimin dhe veprimtarinë e shkollës*, neni 29, Kumtari i Arsimit 1, Prishtinë, 1994, fq. 13. (Edhe në vitin shkollor 1996/97 bëhen ndryshime dhe korrigjime të planeve dhe të programeve mësimore. Enti Pedagogjik i Kosovës për vitin shkollor 1996/97 kishte hartuar programe të reja mësimore për shkollën fillore dhe shkollën e mesme. Më pastaj, plani dhe programi që ishte miratuar nga Ministria e Arsimit të Kosovës që nga vit shkollor 1998 u aplikua deri në vitin shkollor 2001/02, kurse prej vitit shkollor 2002/2003 fillon zbatimi i planeve dhe i programeve të reja sipas reformës së përgjithshme të arsimit parauniversitar. Prej vitit shkollor 2003/04 ka filluar aplikimi i reformës së arsimit në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Shkollat fillore punojnë me këtë plan dhe program të ri. Përkundër gjithë këtyre vështirësive gjuha dhe letërsia shqipe është ruajtur e kultivuar në shkollën shqipe të Kosovës duke falënderuar mësimdhënësit, prindërit, nxënësit, studentët, ekspertët e arsimit dokumentet e qarta arsimore, krahas ndërtimit të sitemit arsimor tërsisht të pavarur, përkundër dhunës së paparë dhe mungesë të mjeteve financiare u arrit që tekstet ekzistuese që ishin në përdorim deri në vitin 1991, të korrigjoheshin duke i eliminuar përmbajtjet programore të ideologjizuara, të cilat ishin të inkorporuara në tekste shkollore).

pavarësisë së shkollës shqipe (gjatë viteve 1992 deri në vitin 1999) nga Libri Shkollor janë botuar gjithsej 588 tituj të teksteve, të literaturës shkollore, të dokumentacionit pedagogjik shkollor dhe të botimeve të veçanta.²⁰⁴

²⁰⁴ Bajram Shatri, *Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX* (sfida, dëshmi, fakte) I-II, Libri shkollor, Prishtinë, 2006. (Në rrethana të okupimit të hekurit u arrit edhe përgatitja, shtypja dhe shpërndarja e teksteve mësimore. Edhe autorët tekstesve edhe punëtorët e Librit Shkollor edhe shumë të tjerë ndihmuan qëndresën e papërshkrueshme gjithëpopullore të mbijetesës së gjuhës e letërsisë shqipe dhe të shkollës shqipe. Ishte kjo një periudhë e ndritshme sizifiane për nxënësit dhe mësimit në Kosovë).

KREU I DYTË

KËNDVËSHTRIME NË DIDAKTIKËN E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË

- 2.1. Fillesat e mësimdhënies institucionale të gjuhës shqipe-periodizimi
- 2.2. Praktika tradicionale e mësimdhënies të gjuhës shqipe, 1941-2000
2. 3. Ideologjizimi i tejskajshëm pesëdhjetëvjeçar i mësimdhënies së gjuhës shqipes
 2. 3.1.Objekti i metodikës së mësimdhënies së gjuhës shqipe ndër vite në Kosovë
2. 4. Gjuha shqipe në shkollat tetëvjeçare dhe të mesme në Kosovë
 2. 4.1. Planifikimi i lëndës së gjuhës shqipe
 2. 4.2. Metodatat mësimore në lëndën e gjuhës shqipe
 2. 4.3. Parimet didaktike në lëndën e gjuhës shqipe
 2. 4.4. Etapat e procesit të mësimdhënies së gjuhës shqipe
 2. 4.5. Mjetet mësimore në lëndën e gjuhës shqipe
 2. 4.6. Kabineti i gjuhës dhe letërsisë shqipe, rëndësia e bibliotekës
 2. 4.7. Personaliteti i mësimdhënësit të gjuhës shqipe dhe roli i tij
 - 2.4. 8. Lektyra shkollore në raport me ndryshimet në mësimdhënien e gjuhës shqipe
- 2.5. Përpjekjet për reformimin e mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë
 - 2.5.1. Teoria dhe praktika e mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë
- 2.6. Kompleksiteti përmbajtësor dhe didaktik i mësimdhënies së gjuhës shqipe
 - 2.6.1. Integrimi i teorisë me praktikën mësimdhënëse

2.1. FILLESAT E MËSIMDHËNIES INSTITUCIONALE TË GJUHËS SHQIPE-PERIODIZIMI

Sistemi i konsoliduar arsimor i Kosovës²⁰⁵ përfshinte: *arsimin parashkollor, arsimin fillor, arsimin e mesëm dhe arsimin e lartë*, ku në mënyrë të planifikuar zhvillohej mësimi i gjuhës shqipe në të gjitha këto nivele. Mësimi i gjuhës amtare në shkollën fillore dhe të mesme për objekt kishte gjuhën letrare, mësimi i së cilës realizohej përmes dy lëmenjve kryesorë, përmes gramatikës dhe leximit letrar (*letërsisë*).²⁰⁶ Në këtë syth do të paraqitet periodizimi i zhvillimit të Didaktikës së gjuhës shqipe në Kosovë.

- a. Mesjeta dhe roli i dijetarëve (ulemasë) shqiptarë në përhapjen e shkrimit të gjuhës shqipe gjatë okupimit osman;
- b. Lëvizja Kombëtare Shqiptare shtroi si detyrë që të gjithë shqiptarët të mësonin shkrim - lexim në gjuhën amtare;
- c. Gjuha shqipe dhe arsimit ndërmjet dy luftërave botërore;
- ç. Shkollat dhe arsimit gjatë Luftës së Dytë Botërore;
- d. Pozita e gjuhës shqipe dhe mësimdhënia e saj në arsimin e Kosovës 1945 – 1990;
- dh. Arsimit në Kosovë nga viti 1999 – 2014, -Shtëpitë – shkolla – themeli i pavarësisë së sistemit arsimor në Kosovë.

Nga këndvështrimi historik mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë, mendohet se i ka rrënjët nga shek XV, nga shkollat e para kishtarë të hapura pranë manastireve, të njohura si *shkolla të qytetit, shkolla të gramatikës latine, akademi, kolegje, etj.* (si *Stubëll, Pedhanë, Kurbin, Shkodër, etj.*). Në këtë kohë e kanë burimin edhe tekstet mësimore të vjetra të cilat përdorshin në shkolla. E si ndryshe mund të vlerësohet niveli i librit të parë të gjuhës shqipe “*Meshari*” i Gjon Buzukut pa një traditë paraprake të shkrimit të librit në gjuhën shqipe me alfabetë të ndryshme (*kryesisht me atë latin*). Më pastaj vijnë periudha e hapjes së shkollave të huaja pranë kishave, xhamive e teqeve. Për të pasuar me periudhën e Rilindjes Kombëtare lindi misioni i ri për inteligjencën shqiptarë të kohës.²⁰⁷ Kontributi kulmor i Rilindjes Kombëtare Shqiptare përhapja e portës së mësimin të gjuhës shqipe dhe të arsimit shqip. Atdhetarë të shquar me frymën e artikuluar patriotike, të njohur si Rilindja Kombëtare Shqiptare, kjo një lëvizje e gjerë dhe e fuqishme Çlirimtare që u zhvillua në të gjithë trojet shqiptarë dhe në kolonitë shqiptarë e arbëreshe jashtë atdheut, “*që nga vitet '30 të shekullit XIX gjer në vitin 1912, kur u shpall shteti i pavarur kombëtar*”,²⁰⁸ bëri kthesë të rëndësishme në fatin e mirë të zhvillimit të gjuhës shqipe dhe përgjithësisht të zhvillimit të arsimit në gjuhën shqipe. “*Lëvizja Kombëtare Shqiptare, të cilën pionerët e saj, në fund të shekullit të kaluar e pagëzojnë edhe vetërilindje, fillon si revolucionin i brendshëm, i qetë shpirtëror; që përfshin një herë jetën mendore, kulturore të shqiptarëve e, mandej, edhe jetën shoqërore e politike; që, kur e kur, shfaqet përmes kryengritjeve të armatosura kundër pushtuesit dhe që, në vitin 1878, merr formën e organizatës*

²⁰⁵ Etapa e mirëfilltë e zhvillimit të sistemit të arsimit në Kosovë nis pas Luftës së Dytë Botërore.

²⁰⁶ Esat Hoxha, *Metodika e gjuhës dhe e letërsisë shqipe*, (Dispencë për studentët e SHLP) ETMM, KSAK, Prishtinë, 1984, f.8.

²⁰⁷ Ishte kjo një epokë që shënon interesimin e shqiptarëve për shkencën dhe arsimin, për dijen dhe lirinë e çlirimin e vendit. Kjo është kohë edhe e depërtimit të ideve pedagogjike e didaktike evropiane në trevat shqiptarë.

²⁰⁸ Po aty, fq 91.

*së parë politike dhe të luftës me karakter të përgjithshëm kombëtar.*²⁰⁹ Në krye të kësaj lëvizje u vunë udhëheqës të guximshëm, të vendosur, patriotë, iluministë demokratë, që asgjë nuk kishin mbi interesat e atdheut. Ata i dhanë lëvizjes kombëtare një strategji për realizimin e programit të tyre të përmasave kombëtare. Përveç luftës politike e ideologjike, rilindësit kishin objektiv edhe veprimtarinë kulturore e arsimore dhe iniciativat diplomatike. E gjithë kjo lëvizje, kur mori hov edhe zhvillimi i letërsisë, por edhe i hartimit të alfabeve dhe abetareve, por edhe teksteve mësimore dhe hapja e shkollave në gjuhën shqipe njihet me emrin Rilindje Kombëtare Shqiptare. Andaj pikënisje e trajtimit të zhvillimit të mësimdhënies së gjuhës shqipe pikërisht do të jetë kjo periudhë e bujshme kombëtare. *“Tipar themelor i politikës së Rilindjes shqiptare ishte patriotizmi”*²¹⁰ Vija kryesore e Rilindjes ishte lufta për Çlirim kombëtar dhe pavarësi të plotë nga Perandoria Osmane dhe nga çdo shtet tjetër që synonte tokat shqiptare. Këto qëndrime i gjejmë filluar nga *“Qarkorja”* e Naum Veqilharxhit (1846) deri te vepra kryesore ideologjike e Rilindjes e Sami Frashërit *“Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e çdo të bëhet”* (1899). *Deri në këtë kohë, për gjuhën shqipe do të flitej vetëm nga aspekti iluminist-kombëtar, duke filluar nga shkrimet e De Radës e N.Veqilharxhit. Çështja e gjuhës shqipe bëhet çështje iluministe-kombëtare madje politike e dorës së parë në letërsinë shqipe...*²¹¹ Lidhja Shqiptare e Prizrenit lindi nga ky vrull patriotik i masave të trojeve shqiptare që ishte përgatitur në dhjetëvjeçarët e mëhershëm. Kjo lëvizje konceptoi autonominë territoriale-administrative të lidhur ngushtë dhe të pandarë nga autonomia kulturore e arsimore e Shqipërisë. Që në pranverën e vitit 1877 në një memorandum drejtuar Stambollit pasqyrore synimin për shkollën shqipe, se *“kërkohej në të njëjtën kohë që administratat, shkollat dhe gjyqet të ishin në gjuhën shqipe. Kjo kërkesë mori formë të plotë në vitet e veprimtarisë së Lidhjes më 1878-1881.”*²¹² Po ashtu edhe dy pikat e një Memorandumi të 27 nëntorit 1878, i cili pasi u miratua në mbledhjen plenare iu drejtua Portës së Lartë, kërkonin që në pikën dy *“nëpunësit të dinë shqip”* dhe në pikën tre *“Arsimi duhet të përhapet nëpër të gjitha anët dhe nëpër shkolla të mësohet edhe gjuha shqipe.”*²¹³ Zgjerimi i lëvizjes atdhetare hapi shtigje të reja për veprimtarinë e organizuar në fushën e arsimit. Kurorëzim i këtyre përpjekjeve në terror të vitit 1879 u themelua *“Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip”*, me kryetar S.Frashërin, i cili vuri qëllim kryesor hapjen e shkollave shqipe dhe lëvrimin e gjuhës shqipe.²¹⁴ *“Mjeti i vetëm i ndriçimit shpirtëror është gjuha dhe një komb, që nuk shkruan gjuhën e vet, jo vetëm nuk mund të ndriçohet, por përgjithësisht nuk mund as të ndihmojë me anë të gjuhës së tij përparimin e shkencës dhe qytetërimit, - vlerësonte Jani Vreto. Ky autor, që njihet edhe si themelues i didaktikës së gjuhës amtare, në veprën e vet “Mendime mbi shkrimin e gjuhës shqipe” jep bazat e metodikës së shkrim-këndimit të shqipes. Vreto thotë se “Po t’i mësonte...mësuesi në këtë mënyrë fëmijët e vegjël me një alfabet të plotë, të thjeshtë dhe të kuptueshëm, duke mprehur arsyen e tyre natyrale, do të bënte të mundur që ata të*

²⁰⁹ Rexhep Qosja, *Historia e Letërsisë shqipe* (Romantizmi) I, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq.44.

²¹⁰ Po aty, fq.95.

²¹¹ Rexhep Qosja, *Historia e Letërsisë shqipe* (Romantizmi) I, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq.131.

²¹² Grup autorësh, *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, vëllimi I, Tiranë, 2003, fq.112.

²¹³ Edhe pse ky dokument (*si kompromis me krahun feudal shqiptar*) njëjtte sistemin arsimor turk, kërkesën e kufizonte vetëm me futjen e gjuhës shqipe në shkolla që sadokudo ishte një hap i rëndësishëm krahasuar me periudhat e mëparshme.

²¹⁴ Çështjen e gjuhës dhe mësimin shqip e vlerësonte, Abdyl Frashëri ndër reformat më urgjente të Lidhjes. Kjo lëvizje krahas përpjekjeve për alfabet unik të gjuhës shqipe, kishte edhe platformën pedagogjike. Në këtë fushë Jani Vreto, te *“Apologjia”*, duke ngritur zërin për arsimin në gjuhën shqipe, mohimin e mësimin në gjuhën amtare e quan veprim çnjerëzor nga ana e Perandorisë Osmane.

kuptonin lehtë dhe plotësisht së çfarë është këndimi e shkrimi. Kështu ata do t' i hynin të gëzuar punës për t'u stërvitur të lexojnë shpejt dhe për bukurshkrim, në mënyrë që brenda një muaji të mund të lexojnë e të shkruajnë dhe të kenë dëshirë për mësim, gradualisht më të larta.” Madje, “*Alfabetarja e Stambollit*” erdhi si platformë arsimore, pedagogjike e didaktike dhe si një dokument i Lidhjes që pasqyron ndjeshëm politikën në fushën e arsimit. *Kjo nuk është thjesht një libër leximi, por është një përmbledhje tekstesh për shkollën fillore, për arsimin e të rriturve dhe fëmijëve. Ky libër si përmbledhje solli edhe abetaren, gramatikën, historinë, gjeografinë, aritmetikën, dituri natyrën dhe mësimin e moralit.* Duke nuhatur rreziqet shovinsite në tekstin e botuar te “*Alfabetarja*” të pagëzuar “*Gjuha shqipe*”, S.Frashëri, në mes tjerash thotë se “*Kombi i Shqiptarëve, nga të mos shkruarit e gjuhës së vet, ka humbur gjer më sot më të shumtën e njerëzvet; po na ka humbur aq në kaq mijëvjet, ata që kanë mbetur do t' i humbë më fort pak kohë, se koha e sotme nuk ngjan me kohrat e vjetra; sot kombet piqen e përzihen fort shpejt dhe ata, që janë më të fortë e më të ditur, mundin kurdoherë ata që janë më të dobët e më të paditur*”.²¹⁵ Kështu, ideologët e politikës largpamëse kombëtare “*Alfabetaren*” e vunë në qarkullim me një tirazh prej 20.000 copësh, një numër i të cilave kishte depërtuar edhe në trevat e Kosovës. Në këto rrethana “*Shkolla funksionon si një sistem pune shoqërore, e organizuar qëllimisht për interesa të caktuara të shoqërisë.*”²¹⁶ Mirëpo, ditët e mira për një pjesë të shqiptarëve edhe për mësimin e gjuhës së tyre erdhën pas shpalljes së Pvarësisë së Shqipërisë. Duke uruar nga thelbi i zemrës të parin vit shkollor, të Shqipërisë së lirë, Ministrin e Arsimit, profesorët e mësuesit, që po hedhin themelin e parë për arsimin e Shqipërisë, patrioti e shkrimtari i devotshëm, Mihal Grameno, në mes tjerash vlerëson se “*Shkolla është themeli i kombit dhe sot një mësonjë munt të përhapë shkëndijën të diturisë ne i ngrati komb Shqiptar, të cili gjer më sot tiranët dhe armikët e kanë lënë të verbër ose e kanë përdorur për interesat e tyre, duke i farmakosur trutë me mendime antipatriotike.*”²¹⁷ Populli shqiptar bëri qindra vjet luftra të paprera kundër pushtuesve të ndryshëm, mbijetoi qindra vjet ekspedita dhe sundime osmane, që morën me vete nën gërmadhat e tyre, monumente të lashta të letërsisë, dokumente historike dhe vlera të tjera të shumta, por asnjëherë durimin, qëndresën dhe urtinë!²¹⁸ Në mesjetë monopolin arsimor e kulturor plotësisht e kishin në dorë kleri i të tria besimeve. Në veri, pra edhe në Kosovë, për të formuar klerin katolik, u hap ndonjë shkollë. Për nevojat e predikimit fetar klerikëve të ardhshëm u mësohej edhe gjuha shqipe, si: në Stubëll, në Pedhanë, në Kurbin. “*Vatikani lejoi që gjuha latine të zëvendësohej me gjuhën vendase (shqipe) në librat dhe shërbesat kishitare.*”²¹⁹ Gjuha shqipe shkruhej me tri alfabetë (në veri në latinisht, në jug në greqisht dhe në rrjetin kah ish-in shtrirë mejtepet, medresetë gjuha shqipe shkruhej me shkronja arabe e nxënësit mësonin arabisht, turqisht e persisht).

Pas hapjes së shkollave të para kombëtare, këto përpjekje ndjeshëm u hetuan edhe në Kosovë, por me pushtimin e vitit 1912 (*pas shkëputjes nga trugu i Shqipërisë*), kjo trevë u katandis në shtypje e dhunë. Përdorimi i shkronjave shqipe u sanksionua dhe atyre që u gjendej qoftë një abetare shqipe dënoheshin e persekutoheshin rëndë. Në vitin 1914, pjesë e trojeve të Kosovës që kishin mbetur nën okupimin austro-hungarez u lejua që të arsimoheshin në gjuhën

²¹⁵ Grup autorësh, *Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar*, MASH, ISP; Tiranë, 2003, fq.118.

²¹⁶ Tahir Zajazi, *Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies*, Vinsent Graphic, Shkup, 2003, fq.594.

²¹⁷ Kështu shkruan për revistën “*Mësuesi*”, Mihal Grameno, në ditët e fillimit të shkollës, më 16 të shtatorit 2013.

²¹⁸ Trojet shqiptare krahas copëzimit ekonomik e politik e copëzuan edhe në besimin e tyre duke përçarur kështu ndikimet e huaja. Kështu, gati i gjithë zhvillimi kulturor e arsimor në trojet shqiptare gjatë shek. XVI-XIII kryhej nën petkun fetar nën udhëheqjen e klerit.

²¹⁹ *Historia e letërsisë shqiptare*, Rilindja, Prishtinë, 1989, f.16.

shipe dhe lënda mësimore gjuhë dhe letërsi shqipe kishte vend meritor në këto shkolla. Sërish vijnë ditë të rënda për shkollën shqipe dhe për shqiptarët në Kosovë, pas formimit të Jugosllavisë së Versajës (1918 – 1941), në Kosovë dhe për shqiptarët ishte i ndaluar mësimi në gjuhën shqipe dhe administrata në gjuhën shqipe. Perspektivë e re për shqiptarët e Kosovës drejt mësimi të gjuhës shqipe dhe hapjes së shkollave shqipe rinisi në vitin 1941 me ndihmën e Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë. Kurse pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë u lejua mësimi në gjuhën shqipe dhe kurrikula, tekstet mësimore dhe mësimdhënia e gjuhës shqipe për gjysëm shekulli shënoi ngritje e rënie varësisht nga klimat politike që mbretëronin në ish-Jugosllavi. Pavarësimi i mësimi në gjuhën shqipe në Kosovë shënohet nga vitet 1990, të njohura si vitet e mbijetesës së shkollës shqipe. Kurse periudha më e ndritshme për kurrikulën e lëndës së gjuhës shqipe vjen pas viteve 1999 dhe sidomos pas vitit 2014, kur janë shënuar hapa të rëndësishëm drejt unifikimit të kurrikulave dhe teksteve shkollore në mes Shqipërisë dhe Kosovës.

2.2. PRAKTIKA TRADICIONALE E MËSIMDHËNIES TË GJUHËS SHQIPE, 1941-2000

Me rëndësi të veçantë për shqiptarët e mbetur jashtë hartës politike të Shqipërisë, përherë ishte ngritja e nivelit të kulturës gjuhësore të popullit, njëkohësisht edhe ngritja e nivelit të mësimdhënies së gjuhës shqipe në të gjitha nivelet e shkollimit. Ishte kjo njëkohësisht, gjithmonë një detyrë me rëndësi *gjuhësore, arsimore, pedagogjiko-didaktike, politike dhe patriotike*.²²⁰ Dhe që nga fillimet e mësimdhënies institucionale të gjuhës shqipe për ta kryer sa më mirë këtë punë, janë bërë edhe përpjekje për përgatitjen e mësimdhënësve që ata të kenë një përgatitje sa më të lartë dhe më të shëndoshë në zotërimin e mirë të lëndës dhe të jetë i aftë për organizimin e tërë punës mësimore-edukative.²²¹ Mësuesi i gjuhës shqipe në shkollat e Kosovës (*jo në dokumente zyrtare, por sipas atmosferës politike të krijuar*) kërkohej që të jetë jo vetëm një mjeshtër i zoti i zanatit të tij, i apasionuar pas punës së tij shumë fisnike e me përgjegjësi, por duhet të ishte në radhë të parë edhe njeri atdhetar, që problemet e mësimin e të edukimit t'i shohë nga këndvështrimi patriotik, të jetë luftëtar i vendosur për të përgatitur një brez të ri me dije të thella të gjithanshme, por edhe të edukuar me një frymë të lartë atdhedashurie, të lidhur ngushtë “...me aspiratat e popullit të Kosovës.....dhe çështjes së çlirimit e bashkimit kombëtar”²²². Në Kosovë, përkundër kontrollit të pashkëputshëm të pushteteve sunduese mbi mësimin e gjuhës shqipe dhe mënyrën e studimit të saj, mësimdhënësit e kësaj lënde ishin ndër më të dashurit për nxënësit, sepse shumica e tyre, *duke e vlerësuar si një domosdoshmëri objektive të mësuarit e gjuhës shqipe, ishin të bindur se ndër të tjera të mësosh mirë gjuhën tënde, ta shkruash bukur atë, kjo është një nga detyrat kryesore për të gjithë shqiptarët, veçanërisht për brezin e ri. Kosova kishte nevojë për kuadro të shumtë bazë të mirë të njohjes së bazave të gjuhës shqipe*.²²³

Me përfundimin e Luftës së Parë Botërore, shkollat në gjuhën shqipe mbyllen, sepse Kosova u ripushtua nga forcat e Mbretërisë SKS. “*Shtatë dryna*” i ishin vënë shkollës dhe librit shqip. Ndiqeshin, torturoheshin e ndëshkoheshin dhe dënoheshin rëndë ata që mbanin dhe shpërndanin librin shqip. Shërbimi sekret serb kishte angazhuar “*Çetën fluturuese*” në ndjekje të nxënësve dhe mësuesve shqiptarë dhe librave në gjuhën shqipe, kishte organizuar arrestime, tortura, dënime, dhunë deri në likuidim. Njësitë e xhandarmërisë serbe “*Çeta fluturuese*” kishte detyrë të *vrasë, likuidojë, të gjithë ata shqiptarë që angazhoheshin për hapjen e shkollave dhe botimin e librave në gjuhën shqipe*”.²²⁴ Kështu, një pjesë e vogël e shqiptarëve kishte vendosur që fëmijët t'i dërgonte në shkolla në gjuhën serbe, të cilëve paraprakisht u duhej një vit shkollor të humbnin në mësimin e gjuhës serbe. “*Kemi raste kur çetat kaçake në rastet kur ktheheshin nga territori i*

²²⁰Kështu në udhën e mësimin e zotërimin të gjuhës letrare shqipe nga të gjithë faktorët e përfshirë në këtë proces, mësuesve të gjuhës shqipe ju ngarkohej barra më e rëndë.

²²¹ Ishin kërkesat e pushteteve antipopullore e diktatoriale që mësimi i kësaj lënde të vihej në shërbim të politikës ditore. Kështu, para shkollës ishin vënë detyra që t'u jepeshin nxënësve dije e porosi ideologjike me prioritet, para atyre të qëndrueshme gjuhësore, duke e konceptuar mësimin e gjuhës shqipe si një sistem tërësor njohurish të lidhura ngushtë me aspiratat e sunduesve.

²²²Nga Programi i Lëvizjes për Bashkim Kombëtar, Prishtinë, 2011, f. 143.

²²³Njohja e vlerave të mëdha të gjuhës amtare bën që te brezi i ri të forcohet krenaria kombëtare, patriotizmi, dashuria për Atdheun e popullin tonë. Në plan-programet mësimore dhe në librat e gjuhës shqipe të të gjitha niveleve të shkollimit, porositi dhe mësimet e mësimdhënësve për formimin e gjuhës letrare shqipe dhe mësimin e saj në shkollë mbi bazën e parimeve të gjuhësisë e të didaktikës moderne, si dhe të normës letrare të gjuhës së sotme shqipe ishin synim e qëllim i përhershëm në Kosovë

²²⁴ Halim Hyseni, Bajram Shatri, Jonuz Salihaj, Dukagjin Popovci, *Shifra e fakte për arsimin në Kosovë*, Prishtinë, 2000, f.56.

*Shqipërisë, sillnin abetare dhe gazeta të ndryshme në gjuhën shqipe.*²²⁵ Dhe se sa ishte e interesuar pjesa e shqiptarëve të mbetur jashtë Shqipërisë londineze e ilustron ky fakt i shtypit të kohës. *“Sipas një artikulli të gazetës “Populli”, në korrik të vitit 1919, një abetare shitej disa herë dorë më dorë sa arrinte çmimi deri në 200 dinarë, kurse një ekzemplar i gazetës “Populli” u shit, po ashtu disa herë, dorë më dorë dhe më në fund arriti të shitet 100 dinarë. Situata ishte e njëjtë në gjithë Kosovën.*²²⁶ Kjo gjendje e rëndë për shqiptarët e mbetur jashtë Shqipërisë politike vazhdoi deri në vitin 1941. Pas okupimit të trojeve tona nga Italia e Gjermania erdhën ditë më të mira për shkollën shqipe, sidomos për shqiptarët që jetonin në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Ministri i atëhershëm i arsimit, shkrimtari Ernest Koliqi kishte vendosur në shtrirjen e pushtetit të arsimit cep më cep të trojeve etnike. Kështu me vendimin e tij, në përpjekje për shtrirjen e rrjetit të shkollave shqipe, kudo ku flitej shqip, në Kosovë, fillimisht, dërgohen rreth 200 mësues shqiptarë, vullnetarisht për hapjen e shkollave shqipe. Ky numër deri në vitin 1944 rritet në mënyrë të vazhdueshme duke arritur deri në 700 mësues. Ishte kjo një periudhë shumë e rëndësishme për fatin e mësimdhënies së gjuhës shqipe. Mësimi i gjuhës shqipe gjatë viteve 1941-1944 është ndër epokat e shënuara në historinë e didaktikës së gjuhës shqipe. Ndërkaq, përkundër sfidave nga viti 1945-2014, gjuha shqipe në Kosovë ishte lënda kryesore mësimore dhe me fondin më të pasur gjatë javës mësimore.

²²⁵ Limon Rushiti, *Lëvizja Kacake në Kosovë*, Prishtinë, f.56.

²²⁶ Po aty, f.50.

2.3. IDEOLOGJIZIMI I TEJSKAJSHËM PESËDHJETËVJEÇAR I MËSIMDHËNIES SË GJUHËS SHQIPE

Fillesat reale institucionale të mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë i gjejmë në vitin 1914, për të vijuar institucionalisht me një seriozitet të shtuar në vitet 1941-45. Ndërsa, vitet e para të pas Luftës së Dytë Botërore, ndonëse për shqiptarët e Kosovës ndodhi ripushtimi nga sllavokomunistët, partia dhe shoqëria socialiste jugosllave kishte vendosur një bashkëpunim të ngushtë në mes vete dhe në Kosovë u vazhdua mësimi në gjuhën shqipe, për dallim nga Jugosllavia e Krajlit. Rritja e nivelit të mësimdhënies së gjuhës shqipe në shkollën pesëvjeçare dhe zhdukja e analfabetizmit dukej një detyrë me rëndësi politike dhe patriotike. Për përvetësimin dhe zotërimin e gjuhës letrare shqipe nga të gjithë, barra kryesore u binte mësuesve të gjuhës shqipe. Për ta kryer sa më mirë këtë punë, mësimdhënësit, detyrë të parë i caktohej përgatitja e “shëndoshë” ideologjike, e më pastaj që të zotërojnë mirë lëndën dhe të jetë i aftë për organizimin e tërë punës mësimore-edukative. Mësimdhënësit e gjuhës shqipe edhe pse nuk kishin përgatitje të mjaftueshme shkollore ishin tepër të përkushtuar në punën e tyre.

Me vendime partiake nëpër kongrese dhe vendimet e udhëheqjes së lartë të KQ të PKJ për pesëdhjetë vjet rresht në Kosovë “prehej këmisha” për gjithë hapat e mëtejshme të përmbajtjes ideore të programeve dhe cilësisë së punës mësimore-edukative në shkollë edhe për lëndën e gjuhës shqipe merreshin si “busull” orientuese për hartimin e programeve mësimore, teksteve mësimore dhe për metodologjinë e mësimdhënies. Shkollës i ishte vënë detyra që t’u jepte nxënësve dije gjuhësore e letrare të kontrolluara nga shteti, duke e konceptuar mësimin e gjuhës shqipe si një sistem tërësor njohurish që do të ndihmonte ndërtimin e “vëllazërim-bashkimit” me popujt e tjerë joshqiptarë. Në këto rrethana, ndonëse me vështirësi dhe kujdes të veçantë për mësimin e gjuhës letrare shqipe në shkollë, nga patriotë arsimdashës, të shquar në Kosovë u arrit të “përbiroheshin” nën hijen e dokumenteve bazë ideologjike të kohës. Nëpër programe e tekste, por edhe në procesin mësimor-edukativ realizoheshin edhe objektiva atdhetarë që ndikuan dukshëm në kultivimin, ngritjen dhe forcimin e vetëdijes kombëtare në Kosovë. Gradualisht, në mënyrë sistematike orientime themelore për mësimin e gjuhës shqipe bazoheshin në argumentin se të mësosh mirë gjuhën tënde, ta shkruash bukur atë, kjo është një nga detyrat kryesore atdhetare për të gjithë, veçanërisht për brezin e ri. Kosova kishte nevojë për kuadro të shumtë që njohin mirë e me baza gjuhën shqipe, e këtë e bëri shkollimi pesëdhjetëvjeçar në gjuhën shqipe, i cili ndonëse përjetoj kalvarin e rëndë, mbijetoj dhe arriti “... që shkolla të bëjë atë që nuk e bëri as topi...”! Edhe në programet mësimore edhe në tekstet mësimore, gradualisht, në mënyrë sistematike orientimet themelore për mësimin e gjuhës shqipe bazoheshin në argumentin atdhetar, se të mësosh mirë gjuhën tënde, ta shkruash bukur atë, kjo është një nga detyrat kryesore atdhetare për të gjithë, veçanërisht për brezin e ri. Kosova kishte nevojë për kuadro të shumtë që njohin mirë e me baza gjuhën shqipe, e këtë e bëri shkollimi pesëdhjetëvjeçar në gjuhën shqipe në Kosovë, i cili ndonëse përjetoj kalvarin e rëndë, mbijetoj dhe arriti “... që shkolla të bëjë atë që nuk e bëri as topi!”²²⁷ Kështu, në të gjitha kategoritë e shkollave po gjenin vend idealet e Rilindasve, porositë dhe mësimet e tyre për formimin e gjuhës letrare shqipe dhe mësimin e saj në shkollë. Edhe pse në rrethana specifike dhe tepër të vështira në Kosovë, u arrit të

²²⁷Njohja e vlerave të mëdha të gjuhës amtare gjatë procesit të mësimdhënies bën që te brezi i ri të forcohet krenaria kombëtare, patriotizmi, dashuria për çlirim e bashkim kombëtar.

përmirësohet edhe mësimi i gjuhës amtare mbi bazën e parimeve të gjuhësisë e të didaktikës moderne, si dhe të normës letrare të gjuhës së sotme shqipe, sidomos pas Kongresit të drejtshkrimit të vitit 1972, në Tiranë.

2.3.1. Objekti i metodikës së mësimdhënies së gjuhës shqipe ndër vite në Kosovë

Udha e shkronjave shqipe në Kosovë ka kaluar nëpër stuhi e udhëkryqe të vështira dhe është e lidhur ngushtë me fatin e gjithë popullit shqiptar të kësaj treve. Përpyekjet për futjen e mësimit të gjuhës shqipe në shkollat fetare në Kosovë i takojnë mesjetës. Por, historia e mirëfilltë e mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë është e re. Fillimisht, mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë kishte për synim përhapjen e shkronjave shqipe dhe zhdukjen e analfabetizmit, pra bazohej në përvetësimin e lexim-shkrimit në gjuhën shqipe, në arritjet teorike gjuhësore e letrare të kohës, në përvojat e pararendësve dhe në ndikimet e teorive europiane, *në formimin gjuhësor të nxënësve, në formimin mendor, politik, moral dhe estetik të tyre*. Rrugët dhe mënyrat e mësimdhënies *dhe kushtet pedagogjike e psikologjike në zbatimin e programit, tekstit shkollor, orës mësimore, zgjidheshin varësisht nga rrethanat historike, por edhe nga mosha e nxënësve*. Arti i mësimdhënies së gjuhës shqipe, si shkencë e zbatuar, ka ndihmuar edhe shkencat tjera, mirëpo si lëndë mësimore është mësuar në rrafshin e zhvillimit historik të saj, me *veçoritë fonetike, gramatikore, leksikore, fjalëformuese dhe stilistike të saj*. Kërkesat lëndore të planeve dhe programeve mësimore të gjuhës shqipe, teksteve shkollore, veçanërisht gramatikave shkollore përfshinin njohuri teorike me rëndësi praktike për përvetësimin e gjuhës amtare. Përpyekja ishte e vazhdueshme që gjuha shqipe t’u mësohej nxënësve në mënyrë akademike, mbi përdorimin e saj praktik. Mësimdhënia e gjuhës shqipe lidhej me rolin udhëheqës të mësuesit, si dhe parimin e tendenciozitetit ideologjik, pa harruar atë shkencor, lidhjen e teorisë me praktikën, parimi i qëndrueshmërisë, i konkretizimit, përshtatja e lëndës moshës dhe veçorive psikologjike. Këto parime ishin udhërrëfyese për mësimdhënësit e gjuhës shqipe. Lënda e gjuhës shqipe gjatë historisë, kishte të bënte jo veç me përvetësimin e rregullave gramatikore, nocioneve gjuhësore, por kryesisht me kthimin e njohurive në shprehje praktike dhe me aftësimin për t’i zbatuar ato në praktikë.

Metodika e gjuhës shqipe në Kosovë, si shkencë pedagogjike që merret me studimin, zbrëthimin, përpunimin dhe zbatimin në praktikë dhe merrej “ *...me teorinë e mjeshtrisë metodike, me dijeni e shprehje të nevojshme për realizimin me sukses të detyrave që na dalin përpara*”²²⁸ përpunimin dhe përmirësimin e metodave e të formave të mësimdhënies së gjuhës shqipe, me problemet e shumta organizative që dalin për zbatimin e tyre në shkollë, tregonte rrugët dhe kushtet që sigurojnë përvetësimin dhe zotërimin aktiv të njohurive gjuhësore nga nxënësit dhe krijimin e shprehive gjuhësore.

Në mësimdhënien tradicionale metodika e gjuhës shqipe në Kosovë përfshinte tërë veprimtarinë metodike, njohuritë teorike dhe praktike, përgjithësonte përvojën e shkollës (*kryesisht teorisë jugosllave*) për procesin mësimor dhe punën edukative që bëhet në orët e gjuhës shqipe. Ajo si udhërrëfyese e punës praktike “ *u sqaron atyre detyrat e përgjithshme që duhet të kryejë dhënia e mësimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe për formimin ideologjik, gjuhësor, letrar dhe mendor të nxënësve, rrugët që duhet të ndjekin për realizimin e këtyre*

²²⁸ K. Vasili; Faik Luli, I Radovicka, *Metodika e letërsisë dhe e leximit letrar*, Tiranë, 1971, f.14.

*detyrave...*²²⁹ dhe ndihmonte mësuesin në përgatitjen e tij teorike, lëndore e profesionale, e udhëzonte për të ndërtuar e zbatuar drejt tërë sistemin e mësimdhënies duke përfshirë punën brenda dhe jashtë klasës. Duke njohur metodikën, mësuesi i gjuhës shqipe i kishte të qarta detyrat që shtronte mësimi i gjuhës shqipe në shkollat tetëvjeçare dhe në shkollat e mesme për formimin gjuhësor të nxënësve, për zhvillimin e gjithanshëm dhe edukimin politik, mendor, moral e estetik të tyre.²³⁰ Metodika ishte e ndikuar shumë nga teoria jugosllave dhe kështu përcaktonte rrugët, mënyrat dhe kushtet konkrete pedagogjike e psikologjike të lidhura me zbatimin e programit, me tekstin, orën, klasën, pa harruar porositë programore “*edukimi në frymën e patriotizmit jugosllav dhe internacionalizmit proletar!*”²³¹ Në Kosovë gjatë ndikimeve ideologjike-moniste pesëdhjetëvjeçare metodika e gjuhës shqipe përfshinte edhe:

- *Shkoqitjen dhe planifikimin e lëndës mësimore;*
- *Përgatitjen për mësim;*
- *Organizimin e orës mësimore;*
- *Përpunimi i përmbajtjeve mësimore;*
- *Përdorimi i mjeteve mësimore;*
- *Mënyra e përforcimit të lëndës;*
- *Përpunimi i lektyrës;*
- *Format jashtëmësimore nga gjuha amtare etj.*²³²

Për vitet që po trajtojmë në këtë studim (*që nuk bëjnë një shekull të mësimdhënies institucionale*) të mësimdhënies së gjuhës shqipe, në Kosovë janë hartuar shumë pak tekste të metodikës dhe didaktikës së gjuhës shqipe dhe tekste që përfshijnë veprimtarinë metodike, njohuritë teorike dhe praktike, të cilat pasqyrojnë përvojën e shkollës sonë për procesin mësimor dhe punën edukative që bëhet në orët e gjuhës shqipe. Sepse, ndihma për mësimdhënësit në përgatitjen e tyre teorike, lëndore e profesionale, e udhëzuese për të ndërtuar e zbatuar drejt tërë sistemin e mësimdhënies duke përfshirë punën brenda dhe jashtë klasës ishte e mangët.²³³ Ndërkaq, ndihmesë të madhe në këtë drejtim kanë dhënë edhe *Shkollat Normale në Kosovë, Shkollat e Larta Pedagogjike dhe Fakulteti Filologjik dhe Fakulteti i Edukimit*, për të njohur metodikën dhe për të kultivuar te mësuesit e gjuhës shqipe ndjesinë e qartë të detyrave që shtronte mësimi i gjuhës shqipe në shkollat tetëvjeçare dhe shkollat e mesme, për formimin gjuhësor të nxënësve, për zhvillimin e gjithanshëm dhe edukimin politik, mendor, moral e estetik të tyre.²³⁴

²²⁹ Fatmir Agalliu; Faik Luli, *Metodika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1971, f.1.

²³⁰ Detyrat e metodikës së gjuhës shqipe gjatë historisë në Kosovë ishin të shumta dhe të rëndësishme, por përherë nën diktatin ideologjik.

²³¹ *Plani dhe programi i gjuhës dhe letërsisë shqipe*, 1982.

²³² Dushan Bozanoviq, *Metodika nastave srpskohrvatskog jezika I nizevnost* (dispencë), Prizren, 1979, f.4-5.

²³³ Për pesëdhjetë vite të mësimi të gjuhës shqipe nën Jugosllavi, në Kosovë ishin botuar tekste të rralla të metodikës së gjuhës shqipe, në mes të cilave: “*Metodika ...*” e Kolë Xhumarit, “*Metodika ...*” e N. Azizit, “*Metodika ...*” e R. Bradës dhe ajo e Esat Hoxhës.

²³⁴ Puna e mësimdhënësve të gjuhës shqipe lidhej me problemet e shumta rreth rrugëve për përvetësimin sa më të qëndrueshëm e sistematik të njohurive gjuhësore e letrare dhe për këto shkaqe ata jo rrallë ishin objekt i ndjekjeve, arrestimeve dhe dënimeve politike.

2.4. GJUHA SHQIPE NË SHKOLLAT TETËVJEÇARE DHE TË MESME NË KOSOVË

Gjatë gjithë kohërave qëkur është mësuar gjuha shqipe në institucionet arsimore të Kosovës, ajo ishte dhe vijon të jetë një nga lëndët kryesore në shkollë. Ajo kishte dhe vazhdon të ketë rëndësi të madhe *arsimore, edukative dhe praktike*. Lënda e gjuhës shqipe i pajis nxënësit me njohuri shkencore gjuhësore, i aftëson ata për ta përvetësuar gjuhën amtare në shkallën më të lartë, u formon shprehitë gjuhësore në të folur dhe në të shkruar. Nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe, nxënësit njohin format dhe ndërtimet e gjuhës së gjallë të popullit, mjetet e saj shprehëse, bukurinë dhe begatinë e saj, përvetësojnë gjuhën letrare, edukohen me ndjenjën e patriotizmit e të dashurisë për gjuhën amtare. Lënda e gjuhës shqipe luan rol të veçantë edhe në zhvillimin mendor të nxënësve, ndikon në veçoritë psikologjike të tyre dhe “...në dashurinë për gjuhën amtare, ndjenjën e përgjegjësisë dhe qëndrimi i ndërgjegjshëm ndaj saj.”²³⁵ Sipas programit mësimor të lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe²³⁶ janë përcaktuar edhe detyrat e mësimi dhe studimi i gjuhës që forcon arsyetimin gjuhësor dhe të menduarit logjik dhe kritik të nxënësve, sepse mbështetet në një punë të vazhdueshme që kërkon analizë e sintezë, vëzhgime, krahasime, ballafaqime dhe përgjithësim të fakteve e të dukurive gjuhësore, sistematizim të materialit gjuhësor të mësuar. Puna e vazhdueshme, sistematike dhe e shkallëzuar, këmbëngulëse dhe e programuar për të siguruar jo vetëm përvetësimin e shëndoshë e aktiv *për të formuar e për të forcuar shprehitë gjuhësore, në të folur e në të shkruar*, forcon kujtesën dhe vëmendjen e nxënësve, zgjon interesin për punë, shton pjesëmarrjen aktive në mësim dhe në punën e pavarur, nxit aftësitë e tyre krijuese.

Qëllimi i të mësuarit të gjuhës shqipe në shkollë nuk ishte vetëm studimi i teorisë së gjuhës, i strukturës gramatikore të shqipes, por kryesisht krijimi i shprehive gjuhësore praktike të mbështetura mbi një bazë të vetëdijshme. Prandaj, “*mësimdhënësi gjatë procesit të përvetësimit të gjuhës, të ndërtimeve të saj, të mënyrave të operimit me njësitë e saj, është e nevojshme që elementet përbërëse të sqarojnë mirë. Për këtë duhet praktikë e bollshme dhe ushtrime që sigurojnë automatizimin e formave dhe krijimin e shprehive gjuhësore dhe formimin e personalitetit të nxënësve.*”²³⁷

Gjuha shqipe, si lëndë mësimore në klasat V-VIII të shkollës tetëvjeçare dhe në shkollë të mesme I-IV, nga klasa në klasë i pajiste nxënësit me njohuri fillestare rreth *fonetikës, morfologjisë e sintaksës, leksikut e stilistikës gjuhësore*, si dhe *me shprehitë praktike shqiptimore, drejtshkrimore e të pikësimit, me shprehi të ligjëratës: së folur dhe të shkruar*. Kështu, nëpërmjet kësaj lënde nxënësit familjarizohen me natyrën dhe me ndërtimin e fjalës në gjuhën shqipe, me përdorimin e saktë të saj në ligjërim.

²³⁵ Idriz Ajeti, *Gjuha dhe mjetet e informimit në ngritjen e kulturës gjuhësore*, Çështje të normës letrare, Prishtinë, 1980, f.15.

²³⁶ *Plani dhe programi unik i punës arsimore-edukative në shkollën fillore për KSAK*, Prishtinë, 1977.

²³⁷ Menduh Begolli, *Nga shënimet e ligjëratave*, Lektyra e detyrueshme dhe ora e saj në shkollë, “Buletini”, Prishtinë, 1962.

2. 4.1. Planifikimi i lëndës së gjuhës shqipe

a. Hallkat kryesore të orës së mësimit në lëndën e gjuhës shqipe

Në lëndën e gjuhës shqipe, programi mësimor përfshinte vëllimin e njohurive sipas lëminjve nga klasa I-VIII në shkollat fillore dhe nga I-IV në shkollat e mesme të Kosovës.²³⁸ Pasi planifikoheshin përmbajtjet programore nga mësimdhënësit, duke u mbështetur në kërkesat e programit duhej të lexohej literaturë ndihmëse dhe tekstet shkollore (*libër leximi, gramatika, teoria e letërsisë*, etj). Më pastaj nxirren lënda mësimore nga këto tekste për gjuhë dhe për letërsi. Për të realizuar qëllimin dhe synimet e planit dhe programit në shkollat e Kosovës janë aplikuar disa tipe të orëve të mësimit:

- *Ora e mësimit të paraqitjes së njohurive të reja -shpjegimi i lëndës (së re),*
- *Ora e mësimit të kombinuar,*
- *Ora e mësimit të përsëritjes (ushtrime dhe përforcime),*
- *Ora e verifikimit (kontrollit) të njohurive të nxënësve.*²³⁹

Shpjegimi i lëndës (së re) përbën hallkën themelore, nga e cila varet rendimenti i orës së mësimit. Për këtë, vëmendja përqendrohej:

- *Në trajtimin dhe në shpjegimin shkencor të njohurive gjuhësore, në kapjen pas çështjeve themelore të çdo teme;*
- *Në vendosjen e raporteve të drejta ndërmjet njohurive teorike dhe materialit praktik, ilustrues dhe ushtrues;*
- *Në shpjegimin e qartë dhe në zbërthimin e çështjeve kyçe të mësimit, të rregullave dhe të përkufizimeve;*
- *Në paraqitjen e lëndës me një gjuhë të pastër, të kuptueshme e letrare.*

Mësimdhënësi, para se të shpjegojë lëndën e re, duhej të hartonte plankonspektin (përgatitjen me shkrim për çdo orë mësimore), sipas dispozitave ligjore e hartonin mësimdhënësit e gjuhës shqipe (*dhe në 42 orëshin e punës javore 12 orë pune i përlllogariteshin për përgatitjet e bëra me shkrim*).

b. Etapat (Struktura) e zhvillimit tradicional të mësimit të gjuhës shqipe

Etapat (Struktura) e zhvillimit të mësimit të gjuhës, të cilat përcaktoheshin në mësimdhënien e gjuhës shqipe për nxënësit (*varësisht nga mosha-klasat dhe plan- programi mësimor*) ato dalloheshin nga rëndësia, disa ishin më kryesore nga ato më pak të rëndësishme. Në shkollën tetëvjeçare (*sipas planeve dhe programeve mësimore që ndërronin shpesh*), lënda e gjuhës shqipe përsëritej nga klasa në klasë, duke u shtuar dhe duke u zgjeruar rrethi i njohurive gjuhësore deri në klasën e XII-të (*përfundimin e shkollimit të mesëm*). Etapat kryesore nëpër të

²³⁸ Esat Hoxha, *Metodika e gjuhës dhe e letërsisë shqipe* (Dispencë për studentët e SHLP)ETMM të KSAK, Prishtinë, 1984, f.14.

²³⁹ Po aty, f.35.

cilat kalonte zhvillimi i mësimdhënies tradicionale në lëndën e gjuhës shqipe në Kosovë gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, ishin:

I. *Hyrja dhe pjesa përgatitore e orës:*

Kontrollimi i detyrave të shtëpisë (a.individual, b.frontal)

II. *Pjesa kryesore e orës mësimore:*

III. *Pjesa përfundimtare e orës mësimore*

Dhënia e detyrave të shtëpisë

Përforcimi (gojor dhe me tekstin.)

2. 4.2. Metodatat mësimore në lëndët e gjuhës shqipe

Vetë fjala metodë vjen nga greqishtja *methodos*, që do të thotë mënyrë, rrugë ose procedim me të cilin arrihet të qëllimi për realizimin e detyrave të caktuara. “Mënyra me anë të të cilave gjatë procesit të të mësuarit mësimdhënësi i mëson dhe edukon nxënësit, u jep dituri, i kontrollon ato dhe i forcon, mënyra se si ai i bën nxënësit të zotë për punë të pavarur duke zhvilluar aftësitë dhe fuqitë e tyre mendore, si dhe mënyrat me anë të të cilave nxënësit pajisen me dituri, shkathtësi dhe shprehi, quhen metoda të të mësuarit.”²⁴⁰ Mbështetur, kryesisht në arritjet teorike të didaktikës jugosllave, në Kosovë gjatë viteve 1945-1990, kryesisht janë përdorur këto metoda të mësimi:

1. *Metoda monologe (kallëzimi i mësimdhënësit)*

2. *Metoda dialoge (e bashkëbisedimit)*

3. *Metoda e tekstit*

4. *Metoda e demonstrimit (konkretizimit)*

5. *Vëzhgimi i fakteve gjuhësore.*²⁴¹

Varësisht nga tipi i orës mësimore praktikoheshin edhe metodat në mësimdhënien e gjuhës shqipe në Kosovë. Çështja shtrohej në nevojën si të formohen nxënësit, si qytetarë të përgatitur për ndryshimet që po ndodhin me hapa në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, rrjedhimisht edhe në strukturat organizative të institucioneve. Gjithçka për një qëllim: *Aftësimi i individit për një jetë cilësisht më të mirë, zhvillimi i shoqërisë dhe i ekonomisë, duke zhvilluar kompetencat e burimeve njerëzore në nivelin që kërkon shoqëria demokratike dhe tregu i punës.*²⁴² Gjithçka përcaktohet në metodë. Rëndësia qëndron jo vetëm në informacione, por edhe në mënyrën si ato përcillen te nxënësit.

²⁴⁰ K.Vasili, Faik Luli, L.Radovicka, *Vepra e cituar*, f.14.

²⁴¹ Esat Hoxha, *Metodika e gjuhës dhe e letërsisë shqipe* (Dispencë për studentët e SHLP) ETMM të KSAK, Prishtinë, 1984, f.28.

²⁴² Besnik Rama, « *Metodat e mësimdhënies dhe ndikimi i tyre në të nxënë* », IZHA, Revista pedagogjike, Tiranë 2011, fq.26.

Qëllimet e njësisë mësimore dhe format e punës gjatë mësimdhënies

Ndër qëllimet e mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqipe zbatoheshin:

1. *Qëllimi arsimor,*
2. *Qëllimi edukativ,*
3. *Qëllimi funksional*
4. *Qëllimi praktik.*²⁴³

Në procesin mësimor tradicional, në orët e gjuhës dhe letërsisë shqipe, si në gjithë gjuhët amtare të republikave të një shteti, në të cilin Kosova “*bashkëjetoi*” dhunshëm u aplikuan këto forma të punës mësimore:

1. *Forma frontale,*
2. *Forma individuale,*
3. *Forma e punës në grupe,*
4. *Forma tandem ose dyshe.*²⁴⁴

Secila nga këto forma të punës kishin përparësitë dhe mangësitë, për të cilat mësimdhënësit kujdeseshin që të zbatonin atë që i përshtatej përmbajtjes së njësisë mësimore.

2. 4.3. Parimet didaktike në lëndën e gjuhës shqipe

Megjithëse studiues të ndryshëm japin parime të ndryshme të didaktikës, të gjithë kanë afërsisht një emërues të përbashkët. Në praktikën pedagogjike të Kosovës shquhet përdorimi i *parimit të ndërlidhjes, i konkretizimit, përshtatshmërisë, sistematizimit e shkallë-shkallëshmërisë, racionalizimit e ekonomizimit, i aktivitetit të vetëdijshëm, dhe parimi lidhmërisë së teorisë me praktikën.*²⁴⁵ Por, secili prej tyre solli diçka të re në fushën e didaktikës, e pasuroi atë me dukuri, parime e ligjësi të ndryshme të të gjithë procesit të edukimit.²⁴⁶ Tek ne do të shquhej Aleksandër Xhuvani, i cili ndër parimet didaktike themelore pati përcaktuar: të mësuarit në mënyrë të natyrshme, sipas psikologjisë së fëmijëve; të mësuarit në mënyrë intuitive, të kuptueshme, interesante, në mënyrë që nxënësit të vetëveprojnë; të mësuarit në mënyrë të qëndrueshme dhe praktike etj. Parimet që karakterizuan shkollën e Kosovës ishin: *karakteri shkencor dhe sistematik i të mësuarit, të mësuarit e vetëdijshëm dhe aktiv, të mësuarit e qëndrueshëm; të përshtaturit e të mësuarit sipas moshës dhe trajtimi i diferencuar i nxënësve; lidhja e teorisë me*

²⁴³ Vepra e cituar, f.37.

²⁴⁴ Esat Hoxha, *Metodika e gjuhës dhe e letërsisë shqipe* (Dispencë për studentët e SHLP) ETMM të KSAK, Prishtinë, 1984, f.37-38.

²⁴⁵ Prero Shimlesha, *Parimet didaktike, Pedagogjia 2*, Prishtinë, 1977, f.342. (Shih më gjerësisht, *Pedagogjia II*, Prishtinë, 1977, f.335.)

²⁴⁶ P.sh., Pestaloci hodhi bazat e të mësuarit nëpërmjet vetëveprimin të fëmijës, pra *nëpërmjet punës*, Rusoi e trajtoi teorinë e të mësuarit si një veprimtari të drejtpërdrejtë të *ndikimit të nxënësi për të njohur natyrën* si domosdoshmëri për të jetuar, Piage përcaktoi *nivelet e të mësuarit sipas moshave*, Montesori e *mbështeti mësimin tek prirja për vetëveprim (puna me projekte)*, duke zhvendosur qendrën e të mësuarit nga mësuesi tek nxënësi, Vigotski e Makarenko nxorën në pah rolin e *kolektivit gjatë të mësuarit*, Fullan përshkallëzoi *fushat e përmbajtjes së kurrikulës shkollore* etj.

praktikën, pra të mësuarit sipas modeleve jetësore, dhe të mësuarit nëpërmjet argëtimit, lojës, kërkimit etj.

Në Kosovë, me vullnetin politik dhe kombëtar e shtetëror të përafrimit të mësimdhënies dhe të programeve, (*por edhe në mungesë të teksteve të didaktikës dhe metodikës, por edhe të librave të mësuesit*) aktualisht dominon përdorimi i teksteve të didaktikës nga Republika e Shqipërisë. Kështu për t'u realizuar synimet në mësimin e gjuhës shqipe respektohen këto parime:

- *Parimet e përgjithshme;*
- *Parimet shkencore;*
- *Parimet didaktike.*²⁴⁷

Çdo parim përbën në vetvete një sintezë kërkesash. Parimi i përshtatjes së të mësuarit, i cili mbështetet në vlerësimin e drejtë të veçorive të moshës, si dhe në nivelin e zhvillimit të përgjithshëm të nxënësve, kërkon edhe përshtatjen e përshtatshme të dhënies së njohurive dhe të shprehive, duke u mbështetur dhe në rregulla të tilla, si: kalimi nga e lehta tek e vështira, nga e afërta tek e largëta, nga e njohura tek e panjohura etj. Në procesin e të mësuarit marrin pjesë dy aktorë kryesorë: *mësuesi, pra drejtuesi, udhërrëfyesi në kuptimin figurativ, dhe vetë objekti i këtij procesi, pra nxënësit.* Në vështrim të përgjithshëm, didaktika jep teorinë e të mësuarit, në planin e veprimtarisë së organizuar të një sistemi arsimor të përcaktuar, veprimtarinë konkrete të punës së shkollës brenda kurrikulës së miratuar, tashmë, Korniza kurrikulare, sipas linjave të studimit: *Të parit, Të dëgjuarit, Të folurit, Të lexuarit, Të shkruarit dhe Njohuritë gjuhësore.*

2.4.4. Etapat e procesit të mësimdhënies tradicionale të gjuhës shqipe

Pra, mësimdhënia që shënon veprimtarinë e mësuesit është tërësia e strategjive, të taktikave dhe të procedurave pedagogjike që përdor mësuesi për të mësuar nxënësit. Qëkur janë hapur shkollat në gjuhën shqipe mësimdhënia ishte proces i qëllimshëm, që do të thotë se me këtë proces synohej të realizohen objektiva të caktuara, gjithmonë të orientuar drejt të nxënës, në këto etapa:

1. *Përcaktimi i qëllimeve dhe i objektivave mësimorë;*
2. *Zgjedhja e përmbajtjes;*
3. *Zgjedhja e metodave dhe e procedurave të përshtatshme mësimore;*
4. *Zhvillimi i mësimin (dhënia e mësimin);*
5. *Matja dhe vlerësimi i arritjeve.*

1. *Të mësuarit e gjuhës shqipe është proces i planifikuar*

Mësimdhënia është një *proces i planifikuar.*²⁴⁸ Kjo do të thotë se mësimdhënia nuk ndodh rastësisht, por është rezultat i një programimi dhe studimi të kujdesshëm. Në Kosovë planifikimi dhe vlerat e tij, ishin një parakusht i domosdoshëm për një realizim të efektshëm të tërë procesit

²⁴⁷ Mimoza Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, Shblu, Tiranë, 2012, f.49-60.

²⁴⁸ Esat Hoxha, *Metodika e gjuhës dhe e letërsisë shqipe* (Dispencë për studentët e SHLP) ETMM, KSAK, Prishtinë, 1984, f.8.

të mësimdhënies. Mësimdhënësit mbështetur në planet e miratuara nga shteti, ishin të obliguar që në drejtoritë e tyre të dorëzonin planet e tyre vjetore, mujore, javore dhe ditore (*plan - konspektin*),²⁴⁹ që ishin përbërësit kryesorë të procesit të planifikimit. Ky proces kompleks shtegtonte nëpër këtë udhë: *planifikimi i mësimdhënies dhe vlerësimi është një aspekt tjetër i mësimdhënies.*

Mësimdhënia është edhe një kompleks marrëdhëniesh ndërrnjët mësuesit dhe nxënësve, ndërmjet vetë nxënësve, ndërmjet mësuesve, ndërmjet nxënësve dhe prindërve të tyre, ndërmjet nxënësve dhe administratës së shkollës. Mësimdhënia kërkon një kompleks mjeshtëri, aftësi dhe sjellësh të mësuesit. Gjatë përvojës sime pedagogjike kam vërejtur se një student i porsadiplomuar në fushën e gjuhësisë si mësimdhënës, ende nuk mund të jetë mësues në kuptimin e plotë të fjalës, edhe nëse ka qenë student i shkëlqyer, pa përmbushur obligimin që t'i realizojë me sukses kërkesat dhe detyrat arsimore edukative që dalin nga plan-programi mësimor.²⁵⁰ Praktika do të shërbejë për përgatitjen e vërtetë. Shumë herë është dëshmuar se mësimdhënia është një mjeshtëri dhe aftësi. Ajo në vetvete përmbledh sasinë e njohurive, mënyrën si do të jepen.

Në Kosovë procesi i përgatitjes së programeve kalon pesë faza: *Përse?; Çfarë?; Kujt?; Si?; Vlerësimi.*

Sipas logjikës së këtyre pyetjeve:

- a. *Dhënie ose transmetimin e njohurive.* Pyetja që shtrohet në këtë rast është: "*Çfarë?*".
- b. *Organizimin e veprimtarisë së nxënësve.* Pyetja që shtrohet në këtë rast është: "*Si?*".
- c. *Mundësim i realizimit të procesit të të nxënësve.* Pyetjet këtu janë: "*ku?*" dhe "*Sa?*"²⁵¹, që do të thotë se mësimdhënia dhe të nxënësve lidhet me gjendjen konkrete të përbërjes së klasës. Këto pyetje merren të ndërthuren dhe shkrihen në një veprimtari të njëzuar me qëllim që mësuesit të jenë sa më të suksesshëm. Për këtë, kërkohej që ata të kenë:

- *Njohuri të gjera dhe të thella për lëndën që japin.*
- *Njohuri të mira për psikologjinë e nxënësve.*
- *Njohuri pedagogjike.*
- *Aftësi metodike.*
- *Aftësi për vlerësimin e çdo situatë që mund të dalë në klasë etj.*

Tipat e orëve të mësimi në lëndën e gjuhës shqipe

Çdo orë mësimi ndërtohej e zhvillohej në përshtatje me përmbajtjen e lëndës. Kështu, orët e gjuhës shqipe ndryshonin nga njëra-tjetra, sepse lënda e gjuhës shqipe ishte dhe është mjaft e gjerë. Ajo, sipas programeve zyrtare përfshinte njohuritë rreth *fonetikës, leksikologjisë, morfologjisë, sintaksës, pikësimit etj.*,²⁵² përmbante edhe një numër të madh orësh *për ushtrime, përfshin diktime, detyra e punë të ndryshme të pavarura me shkrim.* Çdo orë mësimi kishte një qëllim të veçantë të caktuar mësimor. Pikërisht për këto arsye, çdo orë mësimi ka një ndërtim të

²⁴⁹ Mehmet Gjevari, *Kujtime e shënime rreth punës së shkollave të para shqip në Kosovë gjatë dhe pas luftës së Dytë Botërore*, Prishtinë, 1998, f.75-86.

²⁵⁰ Esat Hoxha, *Vepër e cituar*, f.13.

²⁵¹ Tahir Zajazi, *Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies*, Vinsent Graphic, Shkup, 2003, f.712.

²⁵² Përafërsisht të gjitha planet dhe programet mësimore 1945-2000 përfshinin këto komponentë.

veçantë, i cili përcaktohet nga faktorë pedagogjiko-metodikë dhe lëndorë dhe kalon nëpër disa etapa:

Etapat kryesore për çdo orë në lëndën e gjuhës shqipe:

- *Kontrolli i detyrave të shtëpisë;*
- *Kontrolli i përvetësimit të njohurive të mëparshme;*
- *Paraqitja e lëndës së re;*
- *Ushtrimet përforcuese (ushtrime për përforcimin e lëndës, për plotësimin dhe përsëritjen);*
- *Sqarimi i detyrës së shtëpisë.*

Etapa më kryesore dhe shumë e rëndësishme e orës së mësimin të gjuhës është dhënia e njohurive të reja gjuhësore - paraqitja e lëndës së re. Praktika e shkollës së Kosovës, që bazohej në pedagogjinë e bllokut të lindjes (sidomos asaj jugosllave), në varësi nga përmbajtja e programit dhe qëllimi i orës së mësimin, janë zbatuar disa tipa orësh për lëndën e gjuhës shqipe. Tipat e orëve mësimore tradicionale të gjuhës dhe letërsisë në shkollat e Kosovës ishin:

- *Ora e mësimin për paraqitjen dhe fitimin e njohurive të reja gjuhësore;*
- *Ora e ushtrimeve gramatikore dhe drejtshkrimore;*
- *Ora e mësimin të përzier;*
- *Ora e mësimin për kontrollin e njohurive, të shkathtësive e të shprehive gjuhësore të nxënësve (me gojë e me shkrim, detyrat në klasë);*
- *Ora për përforcimin dhe për përsëritjen e njohurive gjuhësore.*

a. Ora e mësimin për paraqitjen dhe fitimin e njohurive të reja gjuhësore

Në këto orë, në mësimdhënien tradicionale në Kosovë, nxënësit njiheshin me lëndën e re nga secila fushë e gjuhësisë apo letërsisë së gjuhës shqipe, zgjerojnë rrethin e njohurive gjuhësore duke u njohur me nocione e dukuri gramatikore të reja, të pamësuara më parë. Jo rrallë ky tip orësh ka ngjashmëri me tipin e orëve të kombinuara, “*por ndyshimi është i vogël*”.²⁵³ Ky tip i orëve ndihmon nxënësit nga lënda e mësuar më parë, mbi të cilin do të vendosen njohuritë e reja. Vetëm kështu sigurohen njohuri sa më të thella e më të plota rreth një fakti ose një dukurie gjuhësore. Ndërkaq, kur kishte, “*përpunim*” (analizë) të pjesës së leximit, si lëmi themelore pune, në të cilën bazoheshin dhe prej së cilës rrjedhnin edhe format e përmbajtjet e tjera të mësimin të gjuhës amnore në shkollën fillore, tregohej kujdes i veçantë”.²⁵⁴ Reformat e shkollës në Kosovë, duke qenë në një proces të vazhdueshëm respektonin pikëpamjet e ekspertëve dhe metodicienëve të njohur gjatë viteve shtatëdhjetë dhe pajtoheshin se “*përpunimi i tekstit letrar në shkollën fillore është një prej formave kryesore për studimin sistematik të gjuhës dhe se kjo i nxit nxënësit që të mendojnë dhe konkludojnë me logjikë në lidhje me dukuritë gjuhësore, t’i fitojnë dijet me anë të të kuptuarit, etj.*”²⁵⁵ Një ekspert ka thënë se “*ndjenja gjuhësore, kultura dhe*

²⁵³ Esat Hoxha, *Metodika e gjuhës dhe e letërsisë shqipe* (Dispencë për studentët e SHLP) ETMM të KSAK, Prishtinë, 1984, f.35.

²⁵⁴ *Plani dhe programi mësimor për shkollat fillore*, botimi i IV, Beograd, 1964, f. 28.

²⁵⁵ M. Pavloviqi, “*Osnovi metodike nastave srpskohrvatskog jetika i knjizevnosti*” (“*Bazat e metodikës së mësimin të gjuhës dhe letërsisë serbokroatishte*”), f.75.

*interesimi gjuhësor janë elemente themente për zhvillimin e kulturës gjuhësore të nxanësve. Kjo duhet të bajë të mundshme që të zotnohet gjuha e drejtë letrare. Për ket qëllim nxanësit e shkollës fillore e mësojnë gramatikën, lexojnë dhe analizojnë pjesë tekstesh letrare, e tjera.*²⁵⁶ Për nxanësit e shkollës fillore duke qenë me rëndësi që ta kuptojnë rëndësinë dhe ta ndiejnë bukurinë e shprehjeve, gjatë analizave të teksteve letrare kërkohej që të “zhvillojnë mendimin, i precizojnë gjanat e vërejtura, vendosin rregullin, zhvillojnë ndjenjat e formulimit dhe të shprehjes së bukur, përmirësojnë stilin e nxanësve dhe i pasunojnë mundësitë e shprehjes së tyre”.²⁵⁷ Në klasat e larta të fillores kërkohej qartësia dhe të kuptuarit e tekstit letrar që përpunohet. Për përpunimin e teksteve letrare zbatohet forma e punës dialogjike. Pra, arsimtari e organizonte orën e mësimi në mënyrë që në pjesën e hyrjes të bëhen përgatitjet e domosdoshme pedagogjike dhe psikologjike për analizë, e pastaj vjen puna për analizën ideore-tematike dhe punët e tjera. “Tekstin letrar në shkollën fillore duhet me e përpunue kështu: së pari teksti lexohet si duhet, mandej spjegohen fjalët dhe shprehjet e panjohtuna, komentohet përmbajtja, theksohet ajo që asht kryesore, bahen shënimet e nevojshme (titujt dhe nëntitujt, fjalët e panjohtuna, etj). Edhe ma parë asht thanë se veprimi metodik mvaret prej karakterit të tekstit, pra ndej asht e domosdoshme që arsimtari ta zgjedhë në fillim tekstin letrar për përpunim, ta caktojë qëllimin dhe ta zgjedhë formën e punës.”²⁵⁸ Në qoftë se mësimdhënësi kishte të bënte me ndonjë fragment të një veprë të madhe, nxënësve mund t’ua tregojmë veprën prej së cilës është marrë fragmenti dhe t’ua rrëfejë përmbajtjen deri në fragmentin që analizohej e përpunohej, e më pas lexohej fragmenti. Ndërkaq, shpjegimi i fjalëve të panjohura, sipas autorëve jugosllavë propozohet që sqaroheshin në fazën e parë të punës, para leximit të tekstit. Në pjesën e parë të orës së mësimi, por pa i shkruar fjalët e panjohura në dërrasë të zezë. Nga kjo shkollë e didaktëve ishte e rekomandueshme që tekstin ta lexojë arsimtari, e nxënësit ta dëgjojnë me vëmendje. *Leximi duhet të ishte shprehimor: plastik, i gjallë, i ngrohtë, dramatik, relief, bindës dhe ekspresiv.* Kjo ka të bëjë me tekste të shkurtra. Mirëpo, tekstet e gjata të libër-leximeve preferohej të përpunoheshin si detyrë shtëpie. “Mund të flitet edhe për autorin e veprës që lexohet, por zakonisht mbas leximit. Kur të kryhen të gjitha këto punë, mund të fillojë përsëri leximi për me u shprehë nxanësit sa ma bukur e me stil letrar.”²⁵⁹

Paraqitja e lëndës së re, për interpretimin e teksteve letrare, orët kalonin nëpër këto faza:

1. Pjesa hyrëse (introduktive)
2. Leximi shprehës (ekspresiv),

²⁵⁶ M. Pavllloviqi, “Osnovi metodike nastave srpskohrvatskog jetika i knjizevnosti”, (“Bazat e metodikës së mësimi të gjuhës dhe letërsisë serbokroatishte”), f. 63.

²⁵⁷ Vepra e cituar, f.39.

²⁵⁸ Procedurën metodike të përpunimit të tekstit letrar e trajton edhe Ton Perushko në veprën “Materinski jezik u osnovnoj skoli” (“Gjuha amnore në shkollën fillore”) dhe si çështje ma të randësishme e thekson se arsimtari ma parë e zgjedh tekstin, e mandej organizohen përgatitjet për përjetimin e këtij teksti, me qëllim që të zgjohet interesimi dhe të mbërrihet orientimi emocional. Ky autor pohonte se “teksti letrar mund të lexohet edhe pa përgatitje të maparshme, pa pjesën hymëse të kësaj pune, nëqoftëse teksti asht shum plastik.” (Shih: P. Moaçanini, autor i Metodikës së mësimi elementar të gjuhës serbokroatishte, 1964.)

²⁵⁹ Ton Perushko në veprën, “Materinski jezik u osnovnoj skoli” (“Gjuha amnore në shkollën fillore”) shkruan këto porosi për mësimdhënësit jugosllav. (Prej tyre vlen me përmendë veçanërisht M. Llalleviqin dhe I. Mamuziqin. Që të dy këta janë teoricienë dhe praktikanë të mrekullueshëm. Në një varg punimesh ata i paraqesin pikëpamjt e veta ndaj përpunimit të tekstit letrar. I. Mamuziqi në veprën e tij, “Novi prilozi nastave maternjeg jezika u srednjim skolama”, kur flet për përpunimin e pjesëve të leximit, thotë se nxanësit duhet të përgatiten patjetër për lexim, e mbas kësaj behet një pushim i shkurtër, e mandej arsimtari e lexon tekstin.)

3. Analizë ideo-artistike,
4. Përfundimi
5. Detyrat e shtëpisë.²⁶⁰

Etapa të veçanta në këtë tip mësimi janë edhe kontrolli i dijes dhe dhënia e detyrave të shtëpisë, përmbajtja dhe ecuria e të cilave varen nga qëllimi i orës së mësimi. Pra secila etapë e tipit të orës së mësimi për paraqitjen dhe fitimin e njohurive të reja letrare e gjuhësore ka karakteristikat e veta dhe rëndësinë e vet, që përcaktohen nga përmbajtja e lëndës, nga shkalla e vështirësisë së saj dhe nga qëllimi i çdo ore. Sepse, “*Leximi shprehës është shkalla me e lartë e aftësisë në të lexuar....që zbulon gjendjen emocionale të shkrytarit, duke venë në pah jo vetëm atë që e ka shprehur, por edhe mënyrën se si e ka thënë atë.*”²⁶¹ Gjatë përpunimit të teksteve letrare ishte praktikë pedagogjike që t’i kushtohej kujdes:

- *Funksionit të frymëmarrjes gjatë leximit shprehës,*
- *Diksionit dhe drejtshqiptimit (ortoepisë),*
- *Ngjyrës së zërit,*
- *Tempi si cilësi zëri,*
- *Intonacionit,*
- *Pauzave logjike, psikologjike, e gramatikore,*
- *Theksit logjik*
- *Melodikës.*

Ora e mësimi të përzier

Në traditën e mësimdhënies në Kosovë, ky tip mësimi ndryshonte nga ora e mësimi për paraqitjen dhe fitimin e njohurive të reja gjuhësore. Në këto orë *gërshetoheshin shpjegimi i njohurive të reja me përsëritjen dhe me thellimin e njohurive të mësuara më parë, nxënësit kontrolloheshin dhe ushtroheshin më shumë se në orët kur zhvillohet vetëm tema e re, vend më të madh zë puna e pavarur e nxënësve dhe kontrolli rreth përvetësimit të lëndës së shpjeguar në orët e mëparshme.* Megjithatë, shpjegimi i lëndës së re qëndronte në themel të tërë punës.

Orë të përziera zhvilloheshin në të gjitha klasat, për orë të përziera preferoeshin tema, si: *lakimi i emrave dhe rasat, formimi i emrave dhe i m'biemrave, gjinia e mbiemrave, lakimi i përemrave, la- krmii i numërorëve, emërimi i mbiemrave dhe probleme të lidhura me drejtshkrimin e tyre, zgjedhimi i foljeve, formimi i foljeve, llojet e shkallët e ndajfoljeve, formimi i ndajfoljeve, parafjalët e përdorimi i tyre, fjalë që shërbejnë si pjesë të ndryshme të ligjëratës, fjalëformimi, kryefjala, kallëzuesi, përcaktorët, rrethanorët, fjalitë me pjesë të nënrenditur vendore, kohore, shkakore, qëllimore etj.*

Në mësimdhënien tradicionale tipi i përzier ora e mësimi kishte këto etapa:

- 1) *Parapërgatitja e nxënësve për të kuptuar temën e re nëpërmjet kontrollit të dijes dhe ushtrimeve;*
- 2) *Shtjellimi i lëndës së re (duke u shkrirë shpesh edhe me kontrollin e ushtrimeve);*

²⁶⁰ Esat Hoxha, *Metodika e gjuhës dhe e letërsisë shqipe* (Dispencë për studentët e SHLP) ETMM të KSAK, Prishtinë, 1984, f.64.

²⁶¹ Tone Perusko, *Materinski jezik u osnovnoj skoli*, Zagreb, 1962, f.139.

3) *Ushtrime përforcimi dhe punë e pavarur përgjithësuese.*

Gërshetimi i kontrollit të dijes me dhënien e njohurive të reja dhe me punën e pavarur përbënte veçorinë kryesore të orëve të përziera, prandaj zgjedhja e ushtrimeve, si për kontrollin e dijes, ashtu edhe për etapat e tjera të orës, kishte rëndësi të veçantë.

Sipas disa autorëve, ora mësimore e përpunimit të tekstit letrar porositej të organizohej sipas kësaj ecurie:

- a. *leximi me za të naltë, shprehimor dhe ekspresiv i tekstit,*
- b. *lokalizimi i tekstit,*
- c. *përmbajtja e shkurtër e tekstit-rezumea*
- ç. *plani i fragmentit që lokalizohet*
- d. *vërejtja dhe caktimi i idesë e ndjenjës kryesore*
- dh. *shqyrtimi i idesë kryesore, analiza e ideve dhe personave,*
- e. *analiza e formës (kompozicionit, stilit, versifikimit dhe gjuhës),*
- f. *përfundimi.*

2. 4.5. Mjetet mësimore në lëndën e gjuhës shqipe

Derisa pas Luftës së Dytë Botërore, pothuaj vetëm fjala e gjallë e mësimdhënësit, shkurmësi dhe tabela e zezë ishin mjeti me të cilin organizoheshin orët e mësimin të gjuhës e letërsisë shqipe, gradualisht gjendja ka ndryshuar. Rolin parësor në procesin e mësimdhënies që mësimdhënësit ta ndihmojnë transmetimin e dijeve tek nxënësi e kishte edhe përdorimi i mjeteve të konkretizimit. Sipas disa kritereve, mjetet mësimore ndaheshin kryesisht në tri grupe:

1. *Mjetet mësimore auditive,*
2. *Mjetet mësimore vizuale,*
3. *Mjetet audiovizuale.²⁶²*

Vlen të theksohet se në shkollat e Kosovës gjatë viteve shtatëdhjetë janë blerë dhe një sasi mjetesh nga Republika e Shqipërisë (prodhimi i shtëpisë botuese “Mihajl Duri” në Tiranë), të cilat me urdhër shtetëror u hoqën nga përdorimi pas vitit 1981! Madje, mjeti mësimor inovator (*për kohën*) ishte Racionalizatori, i konstruktuar nga pedagogu Sadik Ukella. Tani, në mësimdhënie rolin dominant e ka teknologjia e re e mësimdhënies dhe kompjuteri.

2. 4.6. Kabineti i gjuhës dhe letërsisë shqipe, rëndësia e bibliotekës

Rrethanat ekonomike nëpër të cilat ka kaluar Kosova vështirësonin çështjen e ngritjes së kabineteve për lëndën mësimore të gjuhës dhe letërsisë shqipe. Mirëpo kishte raste, kur në disa komuna ishin ngritur dhoma të veçanta për mësimdhënien e gjuhës shqipe. Kjo ndihmonte përdorimin e materialeve dhe përvetësimin e gjuhës amtare më me lehtësi. Këto kabinete grumbullonin jo vetëm materialet mësimore, por lehtësonin mësimdhënien. Ato përdorshin edhe për *aktivitete jashtëmësimore gjuhësore, si për punën e grupit letrar, dramatik etj.* Po ashtu, këto

²⁶² *Vepër e cituar, f.40.*

kabinete përdoreshin edhe për mbajtjen e *mësimit të shtuar* dhe *mësimit plotësues*. Në këto ambiente renditeshin fjalorët, libra të lekturës, mjetet mësimore, disqet, magnetofoni, grafoskopi, gramafoni, videoprojektori, etj.

Për realizimin e plan-programit mësimor të gjuhës shqipe, veçanërisht të lekturës shkollore, bibliotekat shkollore kanë luajtur një rol të rëndësishëm. Për funksionimin e bibliotekave sipas kriterëve të viteve 1945-1990 duhej të kishte hapësirë prej më shumë se 60 m², 30 vende për ulje dhe fond të caktuar librash. (10-15 libra për nxënës), si dhe kuadër të kualifikuar.²⁶³ Profesionistët e këtij profili kërkonin të zotëronin arsimim solid pedagogjik dhe afinitet për punë edukativo-arsimore.²⁶⁴ Bibliotekat në Kosovë ishin me fond të varfër librash edhe pse ato përcaktoheshin të jenë në funksion të programit arsimor të shkollës.²⁶⁵ Në vitin 1954 ishin evidentuar 103 biblioteka, kryesisht në shkollat fillore. “Ky numër shënon rritje gjatë vitit 1955/56/, kur në Kosovë vepronin 313 biblioteka me gjithsej 8700 libra”.²⁶⁶ Në vitet 60-të, fondi i librave nis të pasurohet edhe me autorë shqiptarë (R. Hoxha, M. Krasniqi, A. Shkreli, T. Hatipi, etj.) Në vitin 1974 në Kosovë vepronin 234 biblioteka shkollore me afro 570.000 libra. Roli i bibliotekave ishte i shumëfishtë, por rëndësia primare ishte realizimi i përpunimit të lekturës shkollore të detyruar.

2.4. 7. Personaliteti i mësimdhënësit të gjuhës shqipe dhe roli i tij

Në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, personaliteti i mësimdhënësit të gjuhës shqipe në Kosovë ishte shumëdimensional. Mbështetur në trajtimet e mësipërme, mund të përcaktojmë disa vlerësime për mësuesin dhe dhe rolin e tij në punën e shkollës. Në specifikën e Kosovës ai ishte më shumë se udhëheqës, organizator dhe drejtues i punës mësimore. Vështruar nga këndi historik i kontekstit të Kosovës ai ishte një figurë e pazëvendësueshme, personaliteti i të cilit është i lidhur me tërë problemet mësimore-edukative në shkollë, por edhe ato politike në rrethinë. Për Luigj Gurakuqin mësuesi ishte “*përhapës i dritës*”, sepse “*mbi mësuesit e mbi shkollat varen shpresat e atdheut e të kombit tonë*”.²⁶⁷ Mësimdhënësit e gjuhës shqipe në veçanti, ishin idhuj për nxënësit dhe hallka kryesore e veprimtarisë atdhetare, krahas asaj didaktike. Ai nuk ishte vetëm ligjërues i lëndës së vet, por në të njëjtën kohë është edhe edukator.²⁶⁸ Mësimdhënësit armikun e luftuan me pendë e pushkë. Vetëm gjatë luftës së fundit u martirizuan rreth 300 mësues. Një didakt kroat thotë se “*mësimdhënësi duhet t’i zotërojë 150 cilësi*.”²⁶⁹ Mësimdhënësi i gjuhës shqipe, në Kosovë, fillimisht ishte ai që dinte shkrim - lexim, pastaj ai që kishte mbaruar kurse pedagogjike, madje ata që mbaronin shkollën normale, dikur ata që kryenin grupin përkatës të Shkollës së Lartë Pedagogjike dhe tani Fakultetin e Mësisisë ose atë Filologjik.

Në kohën e institucionalizimit të sistemit arsimor, në Kosovën e pas vitit 1945, sipas ligjeve dhe strategjive arsimore, një mësues i gjuhës vlerësohej të ishte i suksesshëm, kur:

²⁶³ Grup autorësh, *Pedagoska enciklopedija*, 1989, Beograd, f.59.

²⁶⁴ Panto Sekulic, *Kako organizovati skolskih i nastavnickih biblioteka*, Pedagoska stvarnost, Novi sad, 1964, f.523.

²⁶⁵ Desanka Ristic, *Skolske biblioteke*, revista “Ekonomika obrazovanja”, Beograd, nr.5/82, f.20.

²⁶⁶ Bajram Shatri, *Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX*, Prishtinë, 2006, f.652.

²⁶⁷ Musa Kraja, *Mësuesit për kombin shqiptar*, Tiranë, 1993.

²⁶⁸ Iljaz Gogaj, *Punëtorë të shquar të shkollës shqip*, Tiranë, 2001, f.243.

²⁶⁹ Znte Vuksanovic, *Pedagogija*, Zagreb, 1995, f.238.

- Kishte përgatitje të përgjithshme shkencore dhe kulturore,
- Ishte i thelluar në lëndën e tij, në profilin e ngushtë,
- Kishte përgatitje pedagogjike, didaktike dhe metodike,
- Njihte domosdoshmërisht problemet themelore pedagogjike,
- Kishte pasion për punën me fëmijët, dashuri dhe repekt për personalitetin e nxënësit,
- Të mos ishte dogmatik, por të prirët drejt një pune krijuese,
- Të ketë domosdoshmërisht një figurë shoqërore dhe morale të dalluar.

Për shumë dekada është ende aktual vlerësimi i Luigj Gurakuqit, me rastin e hapjes së Shkollës Normale në Elbasan, kur pati thënë, se “*Po mos kujtoni se vetëm zemrat tona këndojnë e lulëzojnë në ditë të sotme...Sot zemra e Shqypnisë së tanë rrahin për një herë me tonat.*”²⁷⁰ Këto fjalë ilustronë rolin e fuqishëm që kishte mësimdhënësi i gjuhës edhe në Kosovë.

Rolet e tjera të mësimdhënësit të gjuhës shqipe gjatë viteve në Kosovë lidhen edhe me çështje të të qenit: *ekspert mësimor, drejtues dhe udhëheqës, motivues, këshilltar, model etj.* Didaktika e gjuhës shqipe në Kosovë ishte njëra ndër fushat më me përparësi të pedagogjisë, por rezultatet e saj ishin tepër modeste.²⁷¹ *Mësimdhënia si komunikim mes palësh, ndërtohej për qëllime të caktuara.* Të mësuarit ishte i lidhur me edukimin dhe realizohej krahas shkollës, edhe nga një sërë faktorësh e mjeteve të tjera, që shoqëria ka në dispozicion. Lidhur me këto qëllime përpunoheshin një përmbajtje e caktuar (*e shprehur në plane, programe, tekste*), që realizohet mes dy palësh: mësues-nxënës, në kushte të caktuara (*mjediset shkollore, mjetet didaktike etj.*) dhe të përdoren mjete e burime të ndryshme.

❖ Aktivitetet jashtëmësimore në lëndën e gjuhës shqipe

Për mësuesin e gjuhës ora e mësimi është forma themelore e punës dhe brenda saj nxënësit duhet të përvetësojnë lëndën që parashikon programi. Megjithatë mësuesit nuk kufizohet vetëm me punën në klasë. Kjo punë duhet të shtrihet edhe jashtë saj. Me punë jashtëklase kuptojmë tërë veprimtarinë që zhvillohet me nxënësit jashtë orëve të mësimi për formimin e shprehive praktike të gjuhës letrare.

Format e punës jashtë klase që përdonin mësimdhënësit në lëndën e gjuhës shqipe, ishin: *bisedat e lira, puna e pavarur me karakter krijues, ngritja e rretheve dhe aktivizimi i tyre, vizita dhe ekskursione, takime me shkrimtarë e gjuhëtarë të ndryshëm, konkurse dhe aksione me karakter gjuhësor.* Në punën jashtëklase mësuesit sipas planit mësimor për këto forma kryesisht formonin grupet letrare, grupin e gjuhëtarëve, grupin e gazetarisë, grupin e mbledhësve të folklorit, etj.

Mësimdhënësit e gjuhës tradicionalisht me këto forma të punës jashtëmësimore, si formë pune përdorëshin edhe konkurset mësimore, letrare, etj.

²⁷⁰ ISP, *Historia e arsimit shqiptar*, Tiranë, 1990, f.133.

²⁷¹ Janë bërë disa përpjekje për hartimin e metodikave të gjuhës, por në nivel dhe numër tepër modest. Kjo është kompensuar me botimet periodike në shtypin e kohës, sidomos të “Shkëndija”, “Përparimi”, “Rilindja”, por edhe të “Gjuha jonë”, “Studime albanologjike” (Seria e gjuhës) etj.

2.4.8. Lektyra shkollore në raport me ndryshimet në mësimdhënien e gjuhës shqipe

Mësimi i letërsisë në shkolla dhe jashtë saj kërkonte harmonizimin e kërkesave me ndryshimet dhe zhvillimet shoqërore, ekonomike, teknologjike e kulturore. Pra, edhe mësimi i letërsisë, si çdo aspekt tjetër i mëimit, kërkon përshtatshmërinë e vet me kohën dhe zhvillimet e gjithanshme të jetës. Në kuadër të kësaj, duhet ndryshuar edhe lista e lekturës letrare shkollore, që u ofrohet nxënësve të arsimit parauniversitar për ta lexuar. Lektyra, e cila për sa kohë u ofrohet nxënësve në Kosovë është si e konservuar dhe me dekada e pandryshuar, apo vetëm e reduktuar, shkëputur nga librat ideologjikë që kanë qenë më herët.²⁷² Një mangësi e hetuar që te lektyra shkollore ishte mospërfshirja e duhur e letërsisë botërore. Nga lista e lekturës shkollore për klasat VI, VII, VIII, IX, vetëm një numër i vogël janë letërsi e huaj. Përpiluesit e programeve, në veçanti ata të planifikimit të lekturës shkollore, vështirë të respektojnë, përveç kritereve të tjera edhe atë të ndryshimeve të kohës, në mënyrë që të mos mbeten prapa kërkesave, shijeve dhe preokupimeve të moshës së nxënësve. Vetë natyra e fëmijës përmban aftësi-shkathtësi dhe kureshtje që kushtëzon përshtatjen edhe të teksteve të letërsisë edhe të lekturës shkollore me kohën, që ajo të mos jetë jointeressante dhe e tejkaluar, gjë që mund t'u shkaktojë nxënësve monotoni, mosinteresim. Siç ka ndodhur, që vepra “*Albumi*”, e Nolit është vendosur në lekturën obliguese të klasës VII, kur akoma nuk janë të avancuara aftësitë perceptuese të nxënësve për të deshifruar artin letrar me përmbajtje siç është “*Albumi*” e me figuracion krejtësisht politik, social, filobiblik, e filozofik. Të gjitha poezitë e kësaj përmbledhjeje, që nga titujt: “*Marshi i Krishtit*”, “*Marshi i barabajt*”, “*Krishti me kamgjik*”, “*Shën Pjetri në mangall*”, “*Tamsoni e kuçedra*”, “*Sofokliu*”, “*Marshi i kryqëzimit*”, etj. kanë figuracion filobiblik, kishtar dhe përmbajtje e aludime politike të kohës.²⁷³ Tashmë mjetet e komunikimit masiv: *televizioni, kompjuteri-interneti, mediat dedikuar fëmijëve*, janë mjete shumë dinamike informative dhe faktorë me ndikim të fuqishëm në edukimin dhe arsimimin e përgjithshëm të nxënësit, si dhe në edukimin estetik të tij. Lista aktuale (*që aplikohet tani*), në shkollat e Kosovës, shikuar përgjithësisht, si listë e lekturës shkollore jo se nuk performon vlera të letërsisë shqiptare dhe asaj botërore, por në shumë raste nuk zgjon shumë interesim të nxënësit, kurse disa tituj (“*Albumi*”, “*Andrra e jetës*”, “*Njëqind vjet vetmi*”, *janë edhe jashtë kapaciteteve deshifruese të artit letrar që zotëron fëmija i moshës 13-14-vjeçar, e në këtë rast nxënësit e klasës së shtatë, të cilëve u janë dedikuar këto vepra. Po ashtu, edhe lektyra e klasës së nëntë (fëmijët e moshës 15-16 vjeç)* përmban tituj që janë jashtë kapaciteteve perceptuese të nxënësve për aspektin artistik e përmbajtjesor të veprës letrare. Kështu, mund të konkludohet se kriteret e përzgjedhjes së veprave letrare si lekturë shkollore, janë jo shumë profesionale. Po përmendim listën e lekturës shkollore në klasët e larta të shkollimit të mesëm të ultë.²⁷⁴

²⁷²Është ndryshuar vetëm pjesa e listës me romane e vepra, *sidomos atyre që i përkisnin periudhës së pasluftës së Dytë Botërore dhe të kohës së ndërtimit socialist*. (Lista e lekturës shkollore jo për vite, por për dekada të tëra është e papërtërirë për nga përmbajtja e saj dhe e papërshtatur në disa raste me moshën, në disa raste me kohën, e në shumë raste edhe me vlerën estetike që është si objektivi i lëndës së letërsisë.)

²⁷³Për ta kuptuar simbolikën e këtyre poezive duhet pasur një bagazh të tërë paranjohurish të gjithanshme, intelektuale, politike, historike, kishtarë, etj. Një nxënës 13-14 vjeç pak nga këto mund t'i ketë. Qoftë edhe me ndihmën e mësimdhënësit, deshifrimi e kuptimi i këtyre poezive nuk është diçka që fëmijës mund t'i interesojë shumë apo që mund ta gjejë veten aty në mënyrë që ta përjetojë ta dojë e ta mbajë mend një libër të tillë.

²⁷⁴Plani dhe programi mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe për kl.VI-IX të arsimit parauniversitar të Kosovës të vitit 2004.

Lektyra për klasën e gjashtë: “Tregime të moçme shqiptare” - Mitrush Kuteli , “Luli i vocërr” – Migjeni, “Zogu dhe kulla” - Rrahman Dedaj, “Poezia të zgjedhura” - Ymer Shkreli, “Sarajet e bardha” - Vehbi Kikaj, “Tom Sojeri” - Mark Tuen dhe “Nita” - Josip Relat.

Lektyra për klasën e shtatë: “Njëqind vjet vetmi” - Sabri Hamiti, “Albumi” - Fan Noli, “Trimi i mirë me shokë shumë” - Sylejman Pitarka, “Robinson Kruso” - Daniell Defo, “Përtej largësive” - Bilall Xhaferi, “Kush do ta vrasë ujkun” - Ali Podrimja, “Andrra e jetës” - Ndre Mjeda, dhe “Zemra” - Edmond de Amicis.

Lektyra për klasën e tetë: “Lulet” - Naim Frashëri, “Juda makave” - Gjergj Fishta , “Poezi” - Ali Podrimja, “Lutjet e mbrëmjes” - Anton Pashku, “Malësorja” - Nazmi Rrahmani dhe “Udhëtim arbdhetar” - Zejnullah Rrahmani.

Lektyra për klasën e nëntë: “Plaku dhe deti” - Ernest Heminguei, “Iliada e Odiseu” – Homeri, “Besa” - Sami Frashëri, “Lirikat e vjeshtës” - Dritëro Agolli, “Juvenilia” - Ndre Mjeda, “Eneida” – Virgjili, “Dhembja e pikës” - Azem Shkreli, “Lulet e së keqes” - Charl Bodler dhe “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet” - Sami Frashëri.

Që lektyra shkollore të përpunohet sa më mirë, mësimdhënësi i gjuhës amtare harton planin mujor të punës, duke u bazuar në fondin e librave të bibliotekës në shkollë, të asaj në qytet dhe të bibliotekave individuale të nxënësve. Mësimdhënësi, listën e lektyrës ua jep nxënësve në mbarim të çdo viti shkollor. Me atë rast, në listën e lektyrës përfshiheshin të gjitha librat të parapara me planin dhe programin mësimor dhe libra të tjerë të botuara më vonë por që kanë vlerën artistike, edukative dhe që i përgjigjen moshës së nxënësve. Nxënësit merrnin për detyrë se, çfarë të shënojnë mbi veprat e lexuara. Bashkarisht me nxënësit caktohen, për secilin muaj të vitit shkollor, ditët kur do të përpunohen veprat dhe të diskutohet rreth tyre. Grupet në ditët e parapara për përpunimin, para klasës referonin me gojë ose me shkrim, varësisht nga klasa, mbi veprën e lexuar mbi: *Përmbajtja e veprës, Ideja e veprës, Personazhet dhe qëndrimet e tyre, Gjuha dhe stili i shkrimtarit dhe çfarë është pëlqyer më shumë.* Referimi bëhej radhazi, duke plotësuar njëri-tjetrin pjesëtarët referues të grupit. Referuesit shtrojnë edhe gjërat që nuk i kuptojnë në vepër, lexonin para klasës detajet më të rëndësishme që nuk kanë rënë në sy si: *shprehjet më të qëlluara të personazheve, mendimet e ndjenjat e tyre; ndonjë përshkrim ambient, rrethi, peisazhi, portreti; ndonjë dialog interesant etj.* Sipas plan-programit mësimor, të gjithë nxënësve u jepet për detyrë në fletoret e shënimeve të lektyrës shtëpiake, të shënojnë: emrin e autorit, titullin e veprës, llojin, përmbajtjen (*syzhenë*) veprës, personazhet dhe çfarë u pëlqen më tepër etj.

2.5. PËRPPJEKJET PËR REFORMIMIN E MËSIMDHËNIES SË GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË

Aktivitetet teorike dhe praktike në mësimdhënien e gjuhës shqipe në Kosovë janë të hershme, por zbatimi institucional i tyre është i ri. Ky këndvështrim me karakter historiko-teorik reflekton edhe përvojën tradicionale të studimeve gjuhësore, pedagogjike, didaktike, metodike dhe të teksteve shkollore, mbi mësimdhënien e gjuhës shqipe në Kosovë. Kjo pjesë e punimit vjen si analizë krahasuese teorike me arritjet në këtë fushë në gjuhën *gjermane, franceze, italiane dhe ruse*, dhe së fundi në *gjuhën anglo-amerikane*, dhe të gjuhëve të popujve të shteteve të hapësirave të ish-Jugosllavisë. Edhe pse gjuha shqipe është e veçantë nga gjuhët tjera, janë shumë standarde të rëndësishme për mësimin e gjuhëve të ndryshme, të cilat gjatë traditës së shkollës shqipe janë transferuar në mënyrë jokritike në praktikën e mësimdhënies në Kosovë. Njohuritë e fituara nga shkenca e gjuhësisë evropiane dhe didaktikës së gjuhës dhe letërsive ishin frymëzuese dhe të dobishme në kërkimin për mënyrat më të mira për mësimin e gjuhës shqipe në shkolla ku nxënësit e kanë për gjuhë standarde dhe gjuhëe parë. Kjo pjesë e hulumtimit është hartuar në atë koncept, që të shërbejë për pasqyrim të didaktikës historike të gjuhës shqipe në këtë pjesë të trojeve shqiptare, por njëkohësisht të shërbejë edhe për studentët e filologjisë dhe të mësimdhënies, në Fakultetin Filologjik, Departamenti i studimeve të gjuhës shqipe dhe për studentët e Fakultetit të Edukimit. Këto kërkime vijnë si një tekst me përmbajtje në interesim për këndvështrimin historik e didaktikës dhe historinë e gjuhësisë e të mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë, sepse “...shkolla u bë mjet kryesor i përhapjes dhe i ngulitjes së normës letrare kombëtare...”²⁷⁵ përmbajtje, të cilat në kohët e fundit në Evropën Qendrore shpesh quhen gjuhësi didaktike përkatëse didaktikë kombëtare (*shqipe, gjermane, sllovene, etj. .*) Tek ne, këto përmbajtje kanë qenë të rrënjosura si përkufizim tradicional me emërtimin, *metodika e mësimdhënies në gjuhën shqipe*. Arritjet në fushën e mësimdhënies së gjuhës shqipe gjatë periudhave të trazuar të historisë, janë bazë e mirë që krahas pasqyrimin të mësimdhënies tradicionale, të gërshetohen me përqendrim në zhvillimet bashkëkohore dhe në përcaktimin e drejtimeve për të ardhmen e afërt, në zhvillimin e teorisë dhe praktikës drejt qëllimit të përmirësimit të mësimdhënies së gjuhës shqipe. Hulumtimi historik i mësimdhënies së gjuhës shqipe në këtë pjesë të trojeve shqiptare (*në Kosovë*) këtu del edhe si një monument mirënjohjeje për të gjithë ata që kanë kontribuar në zhvillimin e mësimdhënies në gjuhën shqipe dhe si një testament për gjeneratat e reja, të cilëve kjo kohë e re, ju ofron më shumë liri dhe më shumë mundësi. Përkushtimi i teoricienve të rinj kërkon angazhim për pasurimin e fjalorit të didaktikës dhe për ngritjen e nivelit të dijeve teorike didaktike. Për të vijuar me analizën e gjendjes teorike të mësimdhënies në Kosovë, duhet kërkuar përgjigje te pyetjet: *Si mësohej dikur dhe si u mësohet sot nxënësvë në shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë gjuha shqipe si gjuhë e parë dhe gjuhë standarde (sipas emërtimit tradicional), gjuhë amtare?* Përgjigja në këtë pyetje e përmban thelbin dhe subjektin e trajtuar në këtë kërkim shkencor, i përmbledhur nëpër fazën e hulumtimit, gjykimit dhe aplikimit të mësimdhënies e gjuhës shqipe sipas programeve shkollore të zbatuara në Kosovë.

Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë, pra të mësuarit si kategori themelore e didaktikës lidhet ngushtë me dy kategori të tjera: me edukatën dhe me arsimin. Këto dy misione, në Kosovë, institucionalisht kishin filluar nga viti 1914, për të vijuar më seriozisht në vitin 1941, e për të

²⁷⁵ Mimoza Gjokuta, *Didaktika e gjuhës shqipe*, Shblu, Tiranë, 2012, f.11.

marrë drejtim pas Luftës së Dytë Botërore,²⁷⁶ kur ndodhi ripushtimi nga sllavokomunistët. Ndonëse, këtu janë rrënjët e një shtrirjeje të gjerë të arsimit shqip dhe me ligj të lejuar për përdorim dhe mësim të gjuhës shqipe, ideologjia (*partia*) dhe shoqëria socialiste jugosllave, në raport me të gjitha kohërat e pushtimit, kishte vendosur një qasje të re të mësimdhënies.²⁷⁷ Prandaj edhe ngritja e nivelit të mësimdhënies së gjuhës shqipe, fillimisht, në shkollën pesëvjeçare dhe përmasat e aksionit për zhdukjen e analfabetizmit dukeshin si një detyrë me rëndësi politike dhe patriotike për kohën(!) Për përvetësimin dhe zotërimin e gjuhës shqipe nga të gjithë, barra kryesore u binte mësuesve të gjuhës shqipe, por ndihej mungesa e mësimdhënësve të kualifikuar.²⁷⁸ Mësimdhënësit e gjuhës shqipe edhe pse nuk kishin përgatitje të mjaftueshme shkollore ishin tepër të përkushtuar në punën e tyre, duke i kushtuar kujdes zhvillimit të tyre profesional (*pa shkëputje nga puna*) dhe zhdukjes së analfabetizmit të masave.

2.5.1. Teoria dhe praktika e mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë

Lënda mësimore: Gjuha dhe letërsia shqipe - Kompleksiteti themelor i didaktikës i specifikuar në mësimdhënien e gjuhës shqipe është marrë në konsideratë që në fillim të trajtimit të kësaj periudhe të mësimdhënies së gjuhës shqipe. Gjuha shqipe si lëndë mësimore qëkur ka filluar të mësohet institucionalisht (*e dokumentuar është periudha e vitit 1914*) në praktikë dhe në planprogramet mësimore njihej me disa emra, si: *Gjuhë amnore, gjuhë shqipe, gjuhë amtare, gjuhë dhe letërsi shqipe, etj.*²⁷⁹ Mësimi i gjuhës shqipe në Kosovë ishte pothuaj përherë i integruar (*gjuhë dhe letërsi bashkë*) dhe duket se shkonte ekstremisht përtej qëllimit të mësimt, dhe kjo kërkonte një përkushtim të detyrueshëm të mësimdhënësve në njërën anë, dhe në « *përkushtimin* » e pushteteve antipopullore për ta penguar mësimin sipas diametrit të dëshiruar dhe përhapjen e kësaj gjuhe. Mësimdhënësit atdhetarë orvateshin që përveç koncepteve, *përmbajtjeve, planeve dhe programeve mësimore, teksteve shkollore, lekturës shkollore, ushtrimeve me shkrim e me gojë, gramatikës, dialektologjisë, lekskologjisë,*²⁸⁰ të mos lihet anash përkushtimi për formësimin atdhetar të nxënësve përmes mësimdhënies së gjuhës (*në veçanti letërsisë*) me mesazhe patriotike. Mësimdhënësit ishin të përkushtuar edhe për të studiuar dhe për t'u formësuar e përgatitur sa më fuqishëm në rrethanat specifike, në të cilat është mbajtur mësimi në gjuhën shqipe në Kosovë. Kështu mund të thuhet se, *mësimdhënia e gjuhës shqipe përfshin organizimin akademik të mësimdhënies, por si përkufizim gjuhësor e didaktik përfshin kryesisht theksin e praktikës didaktike.*

Shkenca mbi mësimdhënien e gjuhës shqipe. Mësimdhënia e gjuhës amtare, përfshin aktivitetet praktike si pjesë përbërëse të mënyrave institucionale të organizuara të mësimdhënies. Ndonëse nga këndi i ngushtë *shkencor mësimdhënia e gjuhës shqipe* në mënyrë universale

²⁷⁶ Pikënisja e mësimdhënies së gjuhës shqipe, sipas statistikave dokumentohet të ketë nisur mirëfilli në Kosovë në vitin 1945, kur kjo trevë kishte një popullsi prej 92 për qind analfetesh.

²⁷⁷ Pra, përkundër rianeksimit të kësaj pjese të Shqipërisë nga ana e Serbisë, në Kosovë u lejua përdorimi i gjuhës shqipe dhe në shkollat shqipe dhe u vazhdua mësimi në gjuhën shqipe, për dallim nga Jugosllavia e Krajlit, duke i dhënë rëndësi të veçantë ngritjes së nivelit të kulturës gjuhësore të popullit.

²⁷⁸ Krahas kualifikimeve, vëmendja e drejtuesve të arsimit ishte e orientuar në ideologji dhe për ta kryer sa më mirë këtë punë, mësimdhënësit, detyrë të parë i caktohej përgatitja e “ *shëndoshë*” ideologjike, e më pastaj që të zotërojnë mirë lëndën dhe të jetë i aftë për organizimin e tërë punës mësimore-edukative.

²⁷⁹ Bajram Shatri, *Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX* (Sfida,dshmi,fakte)I-II,Libri shkollor,Prishtinë,2006.

²⁸⁰ Po aty.

ështësi shkencë e gjuhës sonë, në Kosovë është bërë punë e pamjaftueshme për ta ngritur në nivel të duhur. E gjithë teoria e mësimit të gjuhës shqipe që për subjekt shkencor përmban përkufizimin *shkenca mbi mësimdhënien e gjuhës shqipe*, kryesisht është mbështetur në arritjet në Republikën e Shqipërisë dhe në zbatimin analog të metodologjive të gjuhëve tjera. Metodologjia e mësimdhënies së gjuhës shqipe korrespondon me emërtimet, për afërsisht, të përbashkët me disa gjuhë, si: *instructional methodology*, *méthodologie de Tenseignement*, *metodologia d'insegnamento* etj. Këto emërtime nuk përshtaten gjithnjë me metodologjinë e mësimdhënies, madje nganjëherë krijon edhe dykuptimshmëri, sepse *metodologjia* nënkupton *disiplinën mbi metodat e kërkimit shkencor në mësimdhënie*.²⁸¹ Duke analizuar mësimdhënien dhe të nxënit gjatë shekujve hetohet se në Kosovë nuk kemi pasur një shkencë të veçantë për metodat e mësimdhënies (*përrjashtë disa përpjekje*), siç nuk kemi pasur as shkencën e të mësuarit (*psikologjinë e të mësuarit*) etj. Në këtë mision prijtar ishin mësuesit e gjuhës shqipe dhe një lagje e vogël metodistësh të Kosovës, edhe pse tashmë kanë kaluar dyzet vjet, kur është kodifikuar gjuha shqipe. Zgjerimi dhe forcimi i dijeve për mësimdhënien e gjuhës shqipe është e dobishme për shkak të ndërlidhjeve të arsimit tonë me bashkësinë ndërkombëtare. Madje është e dobishme, sepse shekuj me radhë janë shtruar dilema nga albanologë të huaj për vetë emërtimin e gjuhës shqipe.²⁸² Kur rikthehemi në histori të gjuhës hetohet lehtë se dokumentet e para të shkruara në gjuhën shqipe, shqiptarët gjuhën e tyre e kanë quajtur *gjuha shqipe*, gjuhën në të cilën ata e flasin, shkruajnë dhe krijojnë. Ajo është me vlerë, sepse tani edhe filologët e huaj janë të bashkuar të gjithë me ushtrinë e shkencëtarëve, artistëve, politikanëve, zyrtarëve të ndryshëm publikë që përherë gjuhën e tyre të quajtur *gjuhë shqipe*. Ngjashëm duhet të ndodhë edhe me përkufizimin e dijeve nga sfera e mësimdhënies së gjuhës shqipe. Ashtu siç ngjau që pas përpjekjeve të unifikimit të shkronjave shqipe dhe pas njësimimit të gjuhës shqipe, pas miratimit të standardit që premtonte realizimin e sintagmës “*një gjuhë-një komb*”,²⁸³ ashtu duhet të ndodhë edhe me njësimin e teorisë së mësimdhënies andej dhe këndeje kufirit dhe kudo ku flitet shqip, sepse më nuk janë ata që për arsye politike kanë kundërshtuar në Kosovë unifikimin, asnjëherë për arsye gjuhësore.²⁸⁴ Dhe kur është fjala për kufijtë mes dialekteve, duhet të kujtojmë thënien e gjuhëtarit De Saussure: “*Në kushte ideale, të cilat ne i paramendojmë kufijtë e identifikueshëm mes dialekteve: shtrirja territoriale e tyre nuk luan asnjë rol. Ashtu si nuk mund të them se ku përfundon "hochdeutsch" dhe ku fillon "plattdeutsch", kështu që nuk mund të tërheqim vijë kufizuese në mes gjermanishtes dhe holandishtes, në mes frëngjishtes dhe italishtes.*” Ka pika fundore ku ne mund të themi sigurt se “*Ja këtu qeverisë frangjishtja, dhe këtu italishtja*”, por sa më shpejt që shkohet në këto zona, le të kuptohet se diferenca zhduket(...). Kështu që ndarja arbitrare në dialekte në të gjithë sipërfaqen e gjuhës dhe ndarja me kufijë e dy gjuhëve mund të jetë vetëm konvencionale. (...) Megjithatë tranzicionet e papritura nga një gjuhë

²⁸¹Në gjuhën shqipe, për huazimin **metodologji**, f.kemi shpjegimin « *Teoria mbi metodën e përgjithshme të njohjes shkencore dhe të shndërrimit të botës reale. Tërësia e metodave që përdoren në shkencën të veçanta a në një fushë të caktuar të shkencës. Ajo nuk zhvillohet as vetëm si teori apo vetëm si praktikë, këto dy koncepte janë të ndërlidhura gërshetë dhe bashkëveprojnë, janë të ndara me një "gardh të vogël."* Pra metodologjia e mësimdhënies është një shkencë e të mësuarit opo shkencë e mësimdhënies. »

²⁸²Është e qartë se emrin e gjuhës së tyre e përcaktojnë dhe vendosin njerëzit të cilët flasin atë gjuhë, dhe kjo është kryesisht një çështje politike. Sa i përket vetëdijes së shqiptarëve për emërtimin e gjuhës së tyre është shqetësuese se edhe ata vetë nuk e kanë shënuar gjithnjë me emërtimin e sotëm.

²⁸³Ali Hadri, si delegat në Kongresin e Drejtshkkrimit në Tiranë, në vitin 1972, mbajti një fjalim me këtë titull.

²⁸⁴Dialektet e gjuhës sonë ishin të fortifikuara në gegnisht e toskëtrisht, përkundër dallimeve është dëshmuar se ajo është një gjuhë e vetme, dhe kështu natyrshëm buroi unifikimi, i cili ka sjellë me të vërtetë në progres, në një mënyrë të natyrshme, dhe tani mbështetet me fuqi të qeverive, administratës shtetërore kudo ku flitet shqip.

*në një tjetër janë shumë e zakonshme... Prandaj rrethanat janë të pafavorshme për të parandaluar mbijetesën e huazimeve graduale. Aty qëndron faktor i madh në lëvizjet gjuhësore.*²⁸⁵Mendimet e Sosyrit përputhen në mënyrë të përkryer me situatën në gjuhën shqipe dhe në dallimet në mes dialekteve (akademik Gjovalin Shkurtaç i krahason me “*ujërat e ëmbëla të lumenjve që kur derdhen në det bëhen të njelmëta...!*”).²⁸⁶Përqindja e dallimeve në mes dialekteve të gjuhës shqipe në *fonologji, morfologji, sintaksë, fjalor dhe stilistikë* është jo fort e ndjeshme. Rrethanat politike i detyruan që, sidomos pas vitit 1912 shqiptarët të bëjnë udhë të ndara e të veçanta e të pavarura, shpesh edhe të dallueshme në *rrugën e zhvillimit arsimor, kulturor e politik, por pa hequr dorë asnjëherë nga ideja e bashkimit shpirtëror e politik për themelimin e një gjuhe, një sistemi arsimor dhe një shteti të përbashkët*. Në këtë periudhë afër dy shekulle do të trajtohet zhvillimi i mësimdhënies së gjuhës shqipe veç gjatë kohës kur në shkollat e tekstet e përdorura në Kosovë gjuha shqipe ishte gjuhë e mësimi të të gjitha lëndët shkollore. Kështu, nga ky këndvështrim për mësimdhënien e gjuhës shqipe do të mund të krijohej dhe *didaktika historike e mësimdhënies së gjuhës shqipe*, por edhe për shkencat tjera sipër mësimdhënien e historisë, matematikës,²⁸⁷ etj. Nga kjo pikëpamje, *mësimdhënia e gjuhës shqipe, në kuptim më të gjerë, do të përfshijë mësimdhënien e gramatikës, letërsisë, të të shprehurit me shkrim e me gojë, të lekturës shkollore e formave jashtëmësimore të mësimi të gjuhës shqipe*, etj. këndvështruar nga kuadri gjuhësor, me vëmendje drejt zonave që ndërlihen me mësimdhënien.

²⁸⁵Ferdinand De Saussure, *Cours de Linguistique Générale*, f. 278-279.

²⁸⁶Edhe mësimi, tekstet, planet por edhe shkrimtarët tanë krijojnë në të dy dialektet andej e këndeje kufirit, edhe planet programet mësimore, edhe tekstet shkollore edhe ato të gramatikave një kohë të gjatë ishin të hartuara në të dy dialektet, dallime këto të cilët përshtur për propagandën jugosllave ishin terren i përshtatshëm për të mos hequr dorë nga thirrjet e tyre se gjuha dhe traditat në mes shqiptarëve të Shqipërisë dhe të trojeve të mbetura nën Jugosllavi janë të ndryshme dhe se ata (në Shqipëri) janë *albanci* dhe gjuha e tyre është *albanski*, ndërsa këta shqiptarët e tjerë të mbetur jashtë Shqipërisë londineze janë *shiftari* dhe gjuha që flasin ata është *shiptarki* ...!

²⁸⁷Pra, varësisht nga degët e shkencave, të cilat eksploron se si dhe sa mësimi i këtyre lëndëve të tjera të mësuar gjuhën letrare shqipe. Por, në këtë kerkim shkencor, këto çështje me bazë solide konkrete janë të orientuara vetëm për mësimin e gjuhës shqipe, që kanë të bëjnë me tekstet e përdorura të gjuhësisë, pastaj me letërsinë, teorinë pedagogjike dhe literaturën ndihmëse mësimore.

2.6. KOMPLEKSITETI PËRMBAJTËSOR DHE DIDAKTIK I MËSIMDHËNIES SË GJUHËS SHQIPE

Kompleksiteti përmbajtësor dhe didaktik i mësimdhënies së gjuhës shqipe si lëndë mësimore shkakton shtresime didaktike, sepse, ligjshmëria e mësimdhënies së gramatikës, jo domosdoshmërisht zbatohet për mësimin e letërsisë, të lekturës, apo të filmit. Andaj, kjo krijon të veçantat e mësimdhënies dhe zhvillon dimensione të reja teorike, të cilat mund të radhiten në nëndisiplina të veçanta, si:

- *Didaktika e gjuhës shqipe në kuptimin e ngushtë, (Didaktika gjuhësore shqipe).*
- *Didaktika e mësimin të letërsisë,*
- *Didaktika e filmit,*
- *Didaktika e arteve skenike.*

Por kur dihet se është një dallim shumë i qartë në mes teorisë dhe praktikës, në rastin tonë në mes të gramatikës së gjuhës shqipe, si një sistem gramatikor (*gramatikën, stilistikën*) dhe zbatimin e saj (*Të shprehurit me gojë dhe të shprehurit me shkrim*), pavarësisht nga ndërvarësia e tyre është e nevojshme dhe mund të dallohen edhe këto nëndisiplina:

- *Didaktika e gramatikës shqipe (në kuptimin më të gjerë)*
- *Didaktika e të shprehurit me gojë (retorikë)*
- *Didaktika e të shprehurit me shkrim (shkrim-leximit dhe shkrimin krijues).*

Për më tepër, mund të krijohet një sistem të tillë i një varg Didaktikash të gjuhës shqipe:

- *Didaktika e fonetikës dhe fonologjisë,*
- *Didaktika e morfologjisë dhe fjalëformimit,*
- *Didaktika e sintaksës,*
- *Didaktika e leksikologjisë,*
- *Didaktika e stilistikës gjuhësore,*
- *Didaktika e të shprehurit me gojë (ars dicendi),*
- *Didaktika e të shprehurit me shkrim (ars scribingendi).²⁸⁸*

Tani për tani ne në Kosovë mund të flasim vetëm për fillimet e një didaktike të shtresuar të gjuhës shqipe, por numri i këtyre disiplinave didaktike të nënrenditura si të pavarura nuk do të thotë që domosdoshmërisht është nevojë imediate e Didaktikës së gjuhës shqipe.²⁸⁹

²⁸⁸ Stjepko Tezak, *Teoija i praksa nastave hrvatskog jezika I*, Zagreb, 1996., f.14-18.

²⁸⁹ Ndër format e punës jashtëmësimore në lëndën e gjuhës shqipe mund të përmenden: grupi i gjuhëtarëve, grupi letrar, i gazetarisë, grupi dramatik, etj.

2.6.1. Integrimi i teorisë me praktikën mësimdhënëse

Teoria dhe praktika mësimdhënëse në mësimin e gjuhës shqipe si gjuhë e parë e nxënësve, mund të shtresohet në *teori apo reflektim* ose në *praktikë ose aplikim*. Në praktikën pedagogjike mësimdhënia tradicionale është zbatuar në parim, nëpër këto etapa:

- Shkoqitja dhe planifikimi i lëndës mësimore,
- Përgatitja e mësimdhënësit për mësim,
- Organizimi i orës mësimore,
- Përpunimi i përmbajtjeve mësimore,
- Përdorimi i mjeteve mësimore,
- Zbatimi i metodave mësimore,
- Mënyra e përforcimit të lëndës,
- Përpunimi i lektyrës,
- Format e punës jashtëmësimore nga gjuha amtare, etj.²⁹⁰


Në pjesën teorike apo reflektim duhet bërë përpjekje për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme, si çështje kyçe të programeve mësimore: *Çfarë?, Pse?, Ku?, Kur?, Sa?, Kush?, Si?* Në procesin e mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë dallojmë tre nivele të mësimin të mësimdhënies si proces dhe si art: *niveli i mësimin teorik shkencor të mësimdhënies; niveli profesional i zbatimit i njohurive teorike (duke bërë projekte, plane, programe, mostra didaktike, udhëzim metodike, tekste dhe mjeteve mësimore) dhe niveli i mësimin të praktikave; (të kryejnë të gjitha llojet e aktiviteteve të mësimdhënies).*

Niveli i parë dhe i dytë mund të quhen *didaktikë*, dhe niveli i dytë dhe i tretë mund të quhet *metodikë (mësimdhënie)*.²⁹¹ Brenda përkufizimit të emërtuar, si mësimdhënie e gjuhës shqipe përfshin: *Emërtimi, caku, qëllimi, objektivat, detyrat e lëndës mësimore të gjuhës shqipe që janë të bazuara në arritjet shkencore teorike e praktike, si dhe rrugët për të arritur qëllimet dhe parimet e caqeve teorike fillestare të sprovimit të arritjeve teorike, si dhe sistemit, qasjeve, projekteve, planeve, programeve, origjinës, formave, metodave të vlerësimit, madje zbatimit të kërkesave profesionale, puna përgatitore, drafti, skenari i shkruar i njësisë mësimore, dizajnimi i orës mësimore, kontrollimi i arritjeve në mësimnxënie të nxënësve dhe rishikimi zbatimin e procedurave.* Grafiki këto emërtime, këto nëndarje të didaktikës marrëdhënie mund të përshkruhen kështu:²⁹²

²⁹⁰ Dushan Borzanović, *Metodikasrpskohrvatskog jezika i knizivnosti* (dispencë), Prizren, 1979, f.4-5.

²⁹¹ Tahir Zajazi, *Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies*, Vinsent Graphic, Shkup, 2003, f.701-713.

²⁹² Shih edhe: Stjepko Tezak, *Teoija i praksa nastave hrvatskog jezika 1*, Zagreb, 1996., f.20.).



Ndërlidhja funksionale e teorisë dhe praktikës së mësimdhënies së gjuhës shqipe

Mësimdhënia e gjuhës shqipe, si shkencë e zbatuar, ndihmohet nga disa shkencë të tjera. Ajo lidhet me “... didaktikën e përgjithshme, filozofinë, historinë, gjuhësinë, psikologjinë, sociologjinë, pedagogjinë dhe artet pamore dhe muzikore.”²⁹³ Kjo lidhje i siguron asaj mundësinë për t’i realizuar të gjitha detyrat që u përmendën më lart, te objekti i metodikës. Në shkollat tetëvjeçare dhe të mesme në Kosovë gjuha shqipe nuk mësohej shumë në rrafshin e zhvillimit të saj historik, por për veçoritë fonetike, gramatikore, leksikore, fjalëformuese dhe stilistikore që ajo me vullnetin e mësimdhënësve (ndodhte edhe jashtë programit të përcaktuar në letër!-R.Gj.) paraqiteshin përmbajtje mësimore, tekste, poezi, romane, tekste historike në rrafshin e atëhershëm letrar, duke mos harruar kultivimin e gjuhës letrare. Në çdo orë mësimi lidheshin kërkesat lëndore të programit me shpjegimet shkencore të dukurive gjuhësore. Shkenca gjuhësore pas Kongresit të Drejtshkrimit të Tiranës (1972) në Kosovë qëndrohej afër problemeve të shkollës, gramatikat shkollore hartoheshin në një nivel më të lartë metodiko-shkencor. Linguistët, shkencëtarë apo mësimdhënësit, nuk reshtën me prirjen për t’u mësuar nxënësve gjuhën shqipe në mënyrë akademike të nevojshme për jetën. Shkenca gjuhësore në Kosovë e ndihmuar nga Universiteti i Prishtinës, Instituti Albanologjik, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe nga shtypi e periodiku i kohës kanë ndihmuar shumë shkollën shqipe për një përvetësim me baza më të shëndosha dhe një aftësi më të madhe të përdorimit praktik të gjuhës amtare. Metodika, si shkencë e zbatuar, është ndihmuar nga disa shkencë të tjera, sepse ajo lidhet me filozofinë, gjuhësinë, pedagogjinë dhe psikologjinë.

²⁹³ Mimoza Gjokutaj, *Didaktika e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2012, f.18.

Në Kosovë, didaktika e gjuhës shqipe si disiplinë shkencore po merr fizionomi bashkëkohore duke futur në procesin e mësimdhënies, në përputhje me qëllimet e arsimit kosovar, kompetencat kryesore të parapara për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit, Kompetenca e të menduarit, Kompetenca e të mësuarit, Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis, Kompetenca personale dhe kompetenca qytetare*. Tani, përmbajtjet mësimore, metodat, parimet didaktike, format dhe mjetet mësimore gjatë procesit dhe teknikat e të mësuarit, janë të bazuara në *Kompetencën e komunikimit dhe e të shprehurit*, e cila përcaktohet, si:

- *Komunikimi nëpërmjet gjuhës amtare;*
- *Komunikimi nëpërmjet gjuhëve të huaja;*
- *Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike;*
- *Komunikimi nëpërmjet teknologjisë informative;*
- *Angazhimi dhe kontributi për dialog produktiv;*
- *Respektimi i rregullave të komunikimit.*²⁹⁴

²⁹⁴ MASHT, *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Kosovës*, Prishtinë, 2012, f.16-19.

KREU III

TRAJEKTORJA E ABETAREVE NË GJUHËN SHQIPE NË KOSOVË

- 3.1. Abetarja, libri i parë për formimin e shprehive të lexim - shkrimit
- 3.2. Abetaret gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare
 - 3.2.1. Kontributi i klerit në hartimin e alfabeve dhe të abetareve të gjuhës shqipe
- 3.3. Disa nga tekstet e veçanta të abetareve
- 3.4. Rrugëtimi i abetareve në Kosovë
 - 3.4.1. Nga Abetarja e parë tek Abetarja e përbashkët Shqipëri – Kosovë
 - 3.4.2. Bibliografi e Abetareve të para shqipe
- 3.5. Programet, metodikat dhe tekstet ndihmëse për abetare
 - 3.5.1. Programet e abetareve dhe vendi i mësimit të lexim - shkrimit në planet mësimore
 - 3.5.2. Metodatat e mësimit të abetares
 - 3.5.2.1. Metodatat tradicionale të mësimit të lexim-shkrimit në Kosovë
 - 3.5.2.2. Metodatat sintetike të mësimit të shkrim-leximit fillestar
 - 3.5.2.3. Metodatat analitike të mësimit të shkrim-leximit fillestar
 - 3.5.3. Disa aspekte të praktikave didaktike tradicionale për përdorimin e abetares
 - 3.5.4. Plani dhe Programi mësimor për gjuhën shqipe, për klasën e parë në shkollat fillore (1973)

KREU III

TRAJEKTORJA E ABETAREVE NË GJUHËN SHQIPE NË KOSOVË

3.1.ABETARJA, LIBRI I PARË PËR FORMIMIN E SHPREHIVE TË LEXIM - SHKRIMIT

Arsimi shqip në Kosovë ka një traditë të vjetër, por ka kapërcyer nëpër sfida e udhë të vështira. Në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit mësimi mori karakter të theksuar kombëtar. Atëherë, gjysma e tirazhit të “*Alfabetares së gluhës shqype*”, që u botua në Stamboll më 1879 u shpërnda në viset e Kosovës, si në Prizren në vitin 1879, kur u hap shkolla shqipe, shembullin e së cilës e ndoqën shkollat tjera në: Pejë, Gjakovë, Zym, Ferizaj, Letnicë etj.²⁹⁵ Udhë e shkronjave drejt alfabetit unik që i parapriu udhës për njësimin e gjuhës letrare shqipe kaloi edhe nëpër viset e Kosovës. Në këtë përpjekje alfabeti unik ishte një faktor me rëndësi të madhe. Vlerësuar nga veprat e periudhës para Rilindjes, të cilat ishin shkruar me alfabetin latin e shumë rrallë edhe me alfabetin grek dhe vlerësuar nga shkrimtarët e shekullit XVI-XVII që përdorën pa përjashtim alfabetin latin, mund të thuhet se ata kishin krijuar një traditë të mirë të përdorimit të tij në shqipen e shkruar edhe te arbëreshët. Në mesin e arsyeve se pse kaq gjatë nuk u zgjidh problemi, për një alfabet unik në gjuhën shqipe ishte, se alfabeti latin kishte vetëm 26 tinguj dhe po aq shenja grafike për shënimin e tyre, ndërkaq gjuha shqipe kishte 36 tinguj. Disa autorë kërkuan zgjidhje duke aplikuar alfabetin grek, alfabetin arabo-turk për shkrimin e shqipes.²⁹⁶ Në aktivitetet për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe u dallua veçanërisht Konstandin Kristoforidhi, me veprat e tij të përkthyer dhe origjinale. Ndër kontribuesit e rëndësishëm për alfabetizimin e shqipes, ishte edhe Sami Frashëri, i cili pati përgatitje gjuhësore dhe krijoi një alfabet të rëndësishëm, që do të bëhej për një kohë të shkurtër alfabet me karakter të vërtetë kombëtar. Alfabeti i Samiut, i cili qe quajtur edhe alfabeti i Stambollit, ka bërë ndikim edhe në Kongresin e Manastirit. Me kalimin e kohës, paralelisht me alfabetin e Stambollit, do të pëdoren edhe një varg alfabetesh të tjera, por më të rëndësishëm qe bërë alfabeti i shoqërisë “*Bashkimi*”.²⁹⁷ Në fillim të shekullit XX gjendja në shkrimin e shqipes ishte kaotike, deri në vitin 1908, kur, shoqëria “*Bashkimi*” e Manastirit organizoi Kongresin e abesë në Manastir, me të ftuar përfaqësues nga të gjitha viset shqiptare. Kongresi i Manastirit, i fillimshkullit të ri, më 1908, qe ngjarje e rëndësishme në kulturën shqiptare, që zgjidhi problemin e alfabetit të shqipes. Çështja e njësimimit të shqipes letrare doli në kohën e Rilindjes Kombëtare. Këtë punë e bënë De Rada,²⁹⁸ Faik Konica, S.Frashëri, etj., por, mungesa e shtetit shqiptar ishte një faktor më shumë, që pengonte njësimin e shqipes në një periudhë më të hershme.²⁹⁹ Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani dhanë kontribute të çmuara.³⁰⁰ Në kohën e Luftës së Parë Botërore (1914-18) falë qëndrimit miqësor të Austrisë qenë krijuar disa kushte të favorshme për kulturën shqiptare dhe u organizua *Komisia Letrare Shqipe në Shkodrës*, e cila punoi me ndërprerje të herëpashershme gjatë viteve 1916-18. Veç *Rregullave të drejtshkrimit* nuk u botua një gramatikë normative mbi të folmen e Elbasanit dhe as një fjalor normativ e rregullat e drejtshqiptimit si mjete të domosdoshme kodifikuese, që do ta përkrahnin këtë normëzim. Pas Luftës së Dytë Botërore

²⁹⁵ Grup autorësh, *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, (vëllimi I), MASH-ISP Tiranë, 2003, f.345.

²⁹⁶ Mahir Domi, *Gramatika e Jani Vretos e vitit 1866*, Gjurmime albanologjike 1977, f. 51 .

²⁹⁷ Tomorr Osmani, *Udhë e shkronjave shqipe*, Shkodër, 1999, f. 316 .

²⁹⁸ Androkli Kostallari, *Rreth një pikëpamjeje të De Radës për gjuhën letrare*, SF 1981, nr. 3.

²⁹⁹ F. Raka, *Sami Frashëri dhe shqipja e shkruar*, Vëzhgime rreth shqipes së shkruar, Prishtinë 2009, f. 189 .

³⁰⁰ M. Blaku, *Rreth trajtimit të gjuhës letrare në disa nga organet e shtypit të Rilindjes*, Seminari 1978, nr. 4 .

ndryshuan edhe raportet politike në Shqipëri dhe norma letrare mbi bazën e elbaskanishtes dalëngadalë u hoq krejtësisht nga përdorimi. Kjo normë letrare nuk arriti as të realizohej plotësisht. Pikërisht nga vitet '20 e gjer në vitet '40 të shek. XX një numër i madh gjuhëtarësh shqiptarë edhe dijetarë të tjerë, të huaj, u interesuan jo vetëm për historinë e shqipes si në shekullin e kaluar, por edhe për strukturën e shqipes së folur: Pedersen, Jokli, Nahtigali, Lamerci etj.³⁰¹ Grupit të studiuesve të shqipes, të cilët në mënyra të ndryshme ndihmuan normëzimin dhe njësimin e shqipes, duhet t'i shtohet një mori e tërë gjuhëtarësh, shkrimtarësh e njerëzish të tjerë të kulturës, të cilët me problemet e normëzimit dhe të njësimin të shqipes letrare u morën, në të shumtën, nga ndjenja e lartë e përgjegjësisë që kishin për gjuhën letrare kombëtare si Aleksandër Xhuvani, i cili, në mënyrë shkencore kishte shtruar çështjen e vënies së dialektit të toskërishtes në themelet e gjuhës së njësuar letrare shqipe.³⁰² Kjo teori, e shtruar në baza të shëndosha shkencore, mbështetej nga dy faktorë: në rolin historik që kishte luajtur letërsia e krijuar në variantin e toskërishtes letrare në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe në epërsinë që kishte ky variant letrar në punën e ruajtjes së trajtave të plota të fjalëve, d.m.th. në një formë më të plotë dhe më integrale të vetë strukturës së gjuhës letrare shqipe. Kjo teori pati shumë përkrahës, sidomos nga shkrimtarët dhe intelektualët e Jugut, madje doli edhe në Sesionin e Dytë Shkencor të 1952-s, por pas këtyre viteve u krijuan raporte të tjera në shoqërinë shqiptare dhe këto kërkesa për ngritjen e toskërishtes në nivel të standardit letrar kombëtar nuk u realizuan. Ka pasur edhe faktorë të tjerë, krahas bazës dialektore, që kanë penguar njësimin e gjuhës letrare shqipe gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare e më pas në kohën e Pavarësisë (1912-44).³⁰³ Të gjithë armiqtë e gjuhës shqipe e shikonin me sy jo të mirë njësimin e shqipes letrare.³⁰⁴ *“Rreziku më i madh për Turqinë nga të gjitha kombet që jetojnë nën Perandorinë tonë janë shqiptarët. Është frikë e madhe nga ky komb mos zgjohet e mëkëmbet e merr dituri në gjuhën e vet; dhe atëherë e mori lumi Turqinë e Evropës. Shqiptarët kanë nisë t'i vënë themelet e kombësisë me anë të shkrimit e këndimit, dhe një ditë mund të shtijnë në dorë gjithë Turqinë. Kanë një gjuhë të lehtë e të plotë që mund t'i përparojë shpejt. Historia e tyre, po doli në shesh, është prishje e Turqisë. Me të shpallur të Hyrietit, shqiptarët deshën mësim, hapën shkollat të mëdha e të vogla, çelën klube, ngritën shtypshkronja, mbajtën kongrese, dhe bënë aq punë sa nuk na e priste mendja. Prandaj ky hov duhet t'u pritët; Duhet t'i ndajmë e t'i përçajmë, t'i shtypim e t'i dërmojmë të mos kenë fuqi të ngrihen.”*³⁰⁵

Në Shkodër botohet *“Fjalori i Bashkimit”*, si një vepër e konsiderueshme për gjuhësinë shqiptare, e leksikografisë shqiptare. Për Rilindjen Kombëtare Shqiptare botimi i këtij fjalori shënonte një hap prapa, sepse ishte rezultat i lojës diplomatike të fuqive të mëdha dhe të borgjezive të Ballkanit, të cilat tërë aktivitetin e kishin drejtuar për t'iu kundërvënë Rilindjes

³⁰¹Rexhep Ismajli, *Rreth koncepteve gjuhësore të Luigj Gurakuqit*, Përparimi 1978, nr. 5, f. 681 .

³⁰²Tomorr Osmani, Komisia Letrare e Shkodrës, Shkodër 2009, f. 33 . A. Xhuvani, Për themelimin e një gjuhe letrare, Albania, Bruksel 1906, nr. 11 .

³⁰³Androkli Kostallari, *Rreth një pikëpamjeje të De Radës për gjuhën letrare*, SF 1981, nr. 3.

³⁰⁴F. Raka, *Teoritë për standardizimin e shqipes, Normëzimi i shqipes ndër shekuj*, Prishtinë. 2004, f. 117.(Disa kundërshtar të njësimin të gjuhës shqipe, madje, me mjetet e tyre propagandistike dolën edhe në mënyrë të hapur, duke trumbetuar në revistat dhe gazetat e kohës, se shqiptarët nuk mund të kishin gjuhën e tyre letrare, sepse gjuha e tyre nuk qenqesh gjuhë origjinale, por qenqesh një mozaik huazimesh të marra nga gjuhët e huaja si nga latinishtja, greqishtja, gjuhët sllave, gjuhët neolatine, turqishtja etj.)³⁰⁴

³⁰⁵S. Luarasi, *Kongresi II i Manastirit, Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kong. i Manastirit*, Tiranë 1972, f. 114 .

³⁰⁶F. Raka, *Teoritë për standardizimin e shqipes, Normëzimi i shqipes ndër shekuj*, Prishtinë. 2004, f. 118.

(Nga fundi i shekullit XIX Veziri madh i Turqisë, kryeministri Haki Pasha, ish-profesor i Universitetit të Stambollit, në një nga mbledhjet e qeverisë së Turqisë konstatonte rrezikun e gjuhës shqipe.)

Kombëtare Shqiptare dhe qëllimeve të saj.³⁰⁷ Edhe *Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës* u ndihmua nga këto qarqe po për të njëjtat qëllime, veçse me një ndryshim të rëndësishëm, se tani viset veriore të Shqipërisë ishin pushtuar nga Austro-Hungaria dhe duhej të sigurohej sundimi i qetë, sidomos aleanca me intelektualët shqiptarë. Një metodë të lojës diplomatike e përdori edhe Italia gjatë Luftës Dytë Botërore, sidomos në Kosovë. *Ajo e kishte shpallur veten si çlirimtare të të gjitha trojeve shqiptare: hapi shkollë në gjuhën shqipe, lejoi përdorimin e flamurit kombëtar shqiptar, organizoi administratën në gjuhën shqipe etj.*³⁰⁸ Por përpjekjet për një alfabet të njësuar nuk pushuan nga viti 1908 me përpjekje të përbashkëta për një gjuhë standarde deri në vitin 1972, kur u kurorëzuan të gjitha përpjekjet shekullore që të gjithë shqiptarët të shkruajnë e flasin në mënyrë unike. Kjo punë kolosale i parapriu hartimit të abetarës unike për të gjithë shqiptarët në vitin 2012. Kjo dëshmoi se qëkur janë hartuar abetaret e para në trevat shqiptare dhe jashtë tyre si në Bukuresht, Stamboll, Bruksel, Sofje, Vjenë, Napoli, Selanik, Athinë, Paris, Milano, Bari, Worcester, Laipçig, Konstancë, Aleksandri të Egjiptit etj. Në këtë udhë të gjatë e të vështirë "*Abetaret qenë armë nga më të fuqishmet dhe më të efektshmet për të shkëputur arsimin tonë nga varësia e shkollave të huaja. Me përmbajtjen e tyre ato ndikuan fuqishëm në edukimin e gjeneratave të tëra me ndjenjat më të larta atdhetare dhe fisnike... Shumica e autorëve të abetareve shqipe qenë njëkohësisht pedagogë e luftëtarë, shkencëtarë dhe veprimtarë të lëvizjes kombëtare, tekstologë dhe organizatorë të arsimit.*"³⁰⁹ Një plejadë e tërë e autorëve të abetareve shqipe, u ndoqën e u persekutuan, disa ranë dhe dëshmorë për idealet e tyre në rrugën e çlirimit e të bashkimit kombëtar. Këtë fat e kishin Naum Veqilharxhi, Anastas Kullurioti, Luigj Gurakuqi, Jashar Erebara, etj. Këta breza atdhetarësh lanë një fond të begatshëm në thesarin e bibliotekës shqiptare, duke vënë themelet në disa metoda të lexim- shkrimit të gjuhës sonë. Puna e tyre bëri dritë në Gegëri e Toskëri, në Kosovë e Çamëri, në Dibër e Kumanovë, në Hot e Grudë, në Ulqin e Tivar, në Preshevë e Bujanovc. Abetarja tek shqiptarët ende nuk ka mbushur dy shekuj. Por funksionet që kanë kryer ajo gjatë kësaj periudhe për mësimin e gjuhës së shkruar shqipe, si libri i parë i shkollës janë të një rëndësie, të vecantë. "*Me asnjë libër tjetër si me abetaren nuk e lidhën jetën dhe fatin e tyre kaq shumë autorët, tipografët, redaktorët, shpërndarësit, doganierët, librarët, mësuesit dhe komitetët atdhetarë.*"³¹⁰ Ky libër ishte i ndjekur kudo në Kosovë nga regjimet antipopullore. Gjatë pushtimit turk, bullgar e serb, abetarja shqipe u vu në listat e zeza të botimeve të ndaluara, për dhjetëra vite me radhë. Ky libër aq i dashur për shqiptarët (*abetarja*) hapi portat e kullave shqiptare, të xhamive, kishave e teqeve si dhe arriti deri në qelitë e ftohta në burgje. Ishte ky libri më popullor. Autorët e këtyre abetareve kanë dhënë kontribute të veçanta edhe për historinë e arsimit dhe të mendimit pedagogjik shqiptar dhe janë metodistët e parë origjinalë në mjeshhtërinë e mësimdhënies, si: Naum Veqilharxhi, Konstandin Kristoforidhi, Jani Vreto, Sami Frashëri, Gaspër Benusi, Jan Risto Terova, Parashqevi Qiriazi, Luigj Gurakuqi, Jani Minga, Simon Shuteriqi, Jashar Erebara, Nikolla Lako, Mati Logoreci, Gaspër Beltoja, Ndue Paluca, Aleksandër Xhuvani, Pertef Pogoni, Qamil Guranjaku, Kolë Xhumari, Mehmet Gjevori, Qamil Batalli, Shezai Rrokaj, Mimoza Gjokutaj, Islam Krasniqi, etj. Ishte roli i shumanshëm i abetareve, por ishte edhe niveli i vlerave të abetareve tona, që në kushtet e rrethanat historike

³⁰⁷ Jup Kastrati, *Për historinë e ortografisë shqipe*, Përparimi 1971, nr. 1, f. 607.

³⁰⁸ Ajeti, *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare në Kosovë, Kongresi i Drejtshkrimit*, Prishtinë 1974, f. 127.

³⁰⁹ Më 18 maj 1854, kur shkencëtari dhe albanologu i dëgjuar gjerman Franc Bop (Franz Bopp) mbajti para autoriteteve të Akademisë së Shkencave të Berlinit kumtesën e tij të njohur "*Mbi shqipen në lidhjet e saj të afërisë*", ku argumentonte se gjuha shqipe i përket familjes së gjuhëve indeoevropiane dhe me këtë tezë hapte një faqe të re në historinë e gjuhës, atëherë "*Evetari shqip...*" i Naum Veqilharxhit kishte mbushur vetëm 10 vjet qëkur ishte botuar.

³¹⁰ Shefik Osmani; Njazi Kazazi, *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*, Tiranë, 2000.

Ragip GJOSHI MËSIMDHËNIA E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË
(Nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)

kanë përmbushur mision të veçantë historik, për arsye të njohura nëpër të cilat ka kaluar Kosova.

3.2. ABETARET GJATË PERIUdhËS SË RILINDJES KOMBËTARE

Historia e abetareve shqipe është e lidhur ngushtë me historinë e shkollës kombëtare shqiptare. Abetarja është teksti i parë mësimor shqip. Numërohen 156 vjet që nga botimi i saj i parë. Me dhjetëra janë botimet e saj, me dhjetëra dhe autorët.³¹¹ Unifikimi i alfabetit të gjuhs shqipe krijoi mundësinë e zhvillimit të arsimit shqip në shkollë dhe njëkohësisht u hapi rrugën për hartimin e abetareve dhe të teksteve të tjera shkollore. Roli i abetareve në Kosovë ka qenë shumë i madh në historinë e arsimit shqiptar. Nxënësit shqiptarë, duke përvetësuar lexim-shkrimin shqip u bënë të vetëdijshëm për vlerat e gjuhës sonë amtare. Duke mësuar të shkruajnë dhe të lexojnë në këtë gjuhë ata u njohën me historinë e kombit. Abetarja ndihmoi në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve, vuri pragun në mes të shkollës shqipe dhe shkollave të huaja.

3.2.1. Kontributi i klerit në hartimin e alfabeve dhe të abetareve të gjuhës shqipe

Kleri shqiptar ka luajtur rol me rëndësi edhe në lëmin e hartimit të alfabeve, në lëvrimin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Pikërisht nga kjo letërsi doli edhe tradita gjuhësore e letrare shqipe, e cila sipas burimeve që i zotërojmë deri më sot, nisi me *“Formulën e Pagëzimit” më 1462*. Është i njohur edhe kontributi i humanistëve të tjerë të njohur në tërë Evropën që nuk e përdorën në të shkruar gjuhën e tyre amtare, por shkruan në latinishten e kohës. Edhe libri i parë në gjuhën shqipe *“Meshari” (Messale)*, dritën e botimit e ka parë në Romë në vitin 1555. (Librat e shtypur atëherë ishin kryesisht për shërbesa fetare dhe botoheshin në Romë.)

Pas Paqes së Karllovacit në vitin 1699 ndikimi dhe patronati austriak hetohet fuqishëm mbi të gjithë të krishterët nën sundimin turk dhe sidomos ndaj popullsisë katolike shqiptare. Në këtë kohë Austrisë iu lejua që në vitin 1791 të hapte një konsullatë në Shkodër dhe një nën konsullatë në Durrës, qytete këto nën juridiksionin e kishës katolike. Të drejtat e Austrisë mbi katolikët shqiptarë i njihte edhe Selia e Shenjtë, ku si rezultat u realizua *Konkordati në mes të Vatikanit dhe Austrisë* të arritur në vitin 1855. Numri më i madh i tyre u ndërtua në toka shqiptare. *“Prej 240 themelatave katolike nën Perandorinë Turke, 220 ishin vetëm në Shqipëri..., në shtatë dioqeza katolike: Shkodër, Lezhë, Durrës, Prizren, Sapë, Pult dhe Mirditë. Shkodra si seli ipeshkvnore, ishte qendra e katoliçizmit shqiptar”*.³¹²

Në mbështetje të burimeve të kohës, që dalin sidomos nga provenienca Perëndimore, kishte para vitit 1840 shkolla katolike për djem e vajza në Pejë, Gjakovë dhe Prizren. Mësimi në to deri në vitin 1876, zhvillohet në gjuhën italiane, me disa biseda e shpjegime në gjuhën shqipe. Në shkollën e Pejës, një godinë ngjitur me Kishën katolike të qytetit kryesisht mësohej për fenë, që të gjithë mësuesit ishin priftërinj, si dom Mark Sopi, dom Tom Gusiqi, dom Nikollë Mazreku, dom Shtjefën Krasniqi, dom Zef Harapi etj. Përveç librave në gjuhën latine, italiane, janë përdorur edhe libra shqipe. Në Gjakovë shkolla vepronte që nga vitit 1851 dhe ishte ngritur afër kishës katolike. Kjo shkollë “ishte në një gjendje mesatare, veç sa me i krye nevojat e mësimi”. Dhe këtu mbante mësimet (*besohet në gjuhen shqipe-R.Gj.*) dom Pjetër Doda e dom Filip Kanxhxi, dom Pjeter Zara, dom Ndue Bytyqi, etj. Në Prizren vepronte shkolla “*për të gatue meshtarë*”. Në këtë shkollë fillimisht punonin disa famullitarë, si dom Simon Lumezi, dom

³¹¹ Shefik Osmani; Njazi Kazazi, *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*, Tiranë, 2000.

³¹²Në këtë aspekt kontribut të rëndësishëm, krahas ndihmës së Austrisë dhe të Vatikanit, kanë dhënë edhe *urdhrrat kishtare, si jezuitët, françeskanët, salezianët, stigmatinet, servianet, Motrat e mëshirës*, etj.

Mazreku, ndërkaq nga vitit 1889 punonin mësuesit profesionist, si Mati Logoreci dhe Lazër Lumezi. U shqua edhe shkolla katolike e Janjevës, që vepronte nga mesi i shek. XVII, shkolla katolike e Stubllës (*kjo shkollë kishte vepruar që nga viti 1584 -e rihapur më 1846*), shkolla katolike në Shestan dhe Ljare (*nga gjysma e parë e shek. XIX*), shkolla e Tivarit e themeluar gjatë viteve 1863-1890. “*Në to zhvillohej mësimi, në fillim në italisht, më vonë në italisht dhe shqip, e në fund vetëm në shqip*”.

Aktiviteti në zhvillimin e zgjerimin e shkollave dhe futjen e mësimit të gjuhës shqipe në këto institucione kërkonte jo vetëm përgatitje intelektuale, por edhe një alfabet për të gjithë shqiptarët. Kjo ishte punë delikate dhe e vështirë, duke pasur në mend argumentin se në Shqipëri vepronin disa alfabete, si alfabeti i “*Bashkimit*”, “*Elbasanit*”, “*Stambollit*”, “*Agimit*”, etj. Me nismën e abatit të Mirditës, Prenk Doçi, në vitin 1899 ishte themeluar në Shkodër, Shoqëria “*Bashkimi*”. Para kësaj kohe në tërë Shqipërinë, publikimet e çdo teksti në shqip ishin të ndaluara.³¹³ Qëllimi ishte hartimi i të parit alfabet shqip. Alfabeti i Shoqërisë “*Bashkimi*” më vonë pësoi ca ndryshime të konfirmuara edhe në Kongresin e Manastirit.³¹⁴ Kjo shoqëri, veç tjerash, hartoi edhe një alfabet të shqipës me shkronja latine, sipas traditës së shkrimtarëve të Veriut, duke përfshirë këtu edhe alfabetin e Pashko Vasës.

Gjatë dhjetë vjetëve të para (1899-1908), pra deri në kohën e mbajtjes së Kongresit të Manastirit (14-22 nëntor 1908), Shoqëria “*Bashkimi*” botoi 32 vepra, si: libra *shkollore, abetare, libra këndimi, katekizëm, fjalorë dhe bëri përpilimin e teksteve profesionale*.

Me nismën e jezunitit dom Ndre Mjedës në vitin 1901 isshte themeluar në Shkodër Shoqëria “*Agimi*”. Me këtë alfabet u botuan dhe kalendari “*Dija*” (Vjenë më 1906), fletorja “*Dashamiri*” në Trieste, etj. Alfabeti i “*Agimit*” ka vazhduar rrugën të cilën e ndiqnin një pjesë e albanologëve me rastin e transkriptimeve të teksteve, si *Brugmann, G. Mayer. Pedersen*, etj. Pjesëtarët e klerit katolik shqiptar, përveç traditës së bujshme në lëvrimin e gjuhës shqipe nga fillimet e saj në mesjetë, u shquan edhe me kontribut në Kongresin e Manastirit më 1908. Edhe nga grindjet e klerikëve katolikë, që propozonin dy variante të alfabetit, atë të “*Agimit*” dhe të “*Bashkimit*” hetohen ndasitë. Kleri u vu në shërbim të drejtpërdrejtë që të ndikojë mbi ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve nëpërmjet fesë. Kleri ortodoks grek nuk e njihte kombin shqiptar dhe gjuhën shqipe. Këtë e motivonte me pohimin e paargumentuar e qesharak se gjoja *gjuha shqipe s’është gjuh’ e perëndisë, është e mallkuar nga Zoti*³¹⁵. Kleri mysliman me institucionet e tij fetare dhe ato shtetërore kishte për qëllim që shqiptarët e këtij besimi t’i identifikojë nëpërmjet fesë si “*turq*” dhe motoja e tyre ishte se “*të kënduarit shqip është mëkat*”, ndërsa ata që shkruajnë libra me shkronja latine janë “*kaurë*”, por kishte edhe të tjerë që mendonin e vepronin ndryshe.

³¹³Madje edhe publikimet e librave që nuk ishin thjesht me lutje fetare, nga ana e Qeverisë Turke konsideroheshin porsì vegël politike me qëllime kryengritjeje dhe ligjërisht dënohet autori dhe shpërndarësi. Abati, Prenk Doçi në formimin e shoqërisë letrare të re që u themelua në vitin 1899, mori iniciativën porsì një shoqëri fetare dhe pjesëtarët e saj ishin nga radhët e inteligjencies së klerit katolik e një çështje e pazgjidhur mire.

³¹⁴Është për t’u theksuar, se At Gjergj Fishta u shqua edhe për bashkëthemelues të shoqërisë në fjalë së bashku me një varg atdhetarësh të shquar, si Imzot J. Serreçi dhe L. Mjeda. Ky i fundit u nda prej Shoqërisë “*Bashkimi*” për t’i përkrahur vëllanë dom N. Mjedën, Imzot Gj. Kolecin, L. Gurakuqin, Dom N. Nikajn, Dom D. Kolecin, At P. Bardhin, Dom N. Sheldijen dhe Dom M. Çunin.

³¹⁵ Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit, Tiranë 1972, f. 120-122.

c. Kontributi i klerit mysliman shqiptar në hartimin e alfabeteve dhe të abetareve

Një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe arsimit kombëtar në kapërcyell të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, krahas klerikëve të besimeve të tjera fetare, edhe kleri mysliman shqiptar. Pavarësisht faktit se deri vonë, për arsye ideologjike ka pasur një lloj tendence për t'i vënë në plan të kundërt komponentët “shkollë”, “gjuhë” dhe “identitet kombëtar” me fjalën “kler”, “klerikë” apo në rastin konkret “hoxhallarë”,³¹⁶ e vërteta qëndron ndryshe. Një numër alfabetesh dhe abetaresh të gjuhës shqipe na rezultojnë të jenë hartuar pikërisht nga këta personalitete.³¹⁷ Që në fundin e viteve 30 të shekullit të kaluar, në një artikull të revistës “Zani i Naltë” pasi theksohej roli i klerit mysliman shqiptar në lëmejtë ndryshëm të çështjes kombëtare, kur vinte fjala për shkrimin e gjuhës shqipe shkruhej se: “Ndofta mund të thotë dikush se këta kanë shkruar me alfabet arab! Ani, mjafton që kanë shkruajtur shqip; mjafton që këtij populli i kanë dhanë të kuptojë se edhe gjuha e tyre, -shqipja-mund të shkruhet. Mbasandaj, çfaj kanë këta shkrimtar të moçëm që kanë shkruar në një kohë kur shqipja s’ka pasë alfabetin e saj, jo kanë asnjë faj këta shkrimtarë; ashtu sikurse kanë faj ata që kanë shkruar me alfabetin grek e me ndonjë alfabet tjetër”.³¹⁸ Ndërkohë simpatizuesit e shkronjave turko-arabe nga klubi i Aksarajit “Mahfel” dërguan Arif Hiqmetin, kinse gazetar, nga fshati Llojan i Kumanovës që ta studiojë gjendjen dhe të kontaktojë me parinë myslimane për të krijuar një besim se shkronjat turko-arabe janë shkronjat e Zotit dhe ai di vetëm ato t’i lexojë, kurse shkronjat “gjahure”, Zoti nuk i pranon dhe i dërgon të gjithë në xhehenem.³¹⁹ Në mesin e autorëve të abetareve do të shquhej edhe Abdulhaqim Hiqmet Dogani (1880-1955), i cili vjen nga një familje me tradita të hershme fetare dhe patriotike, për shumë vite me radhë babai i tij kishte shërbyer si myfti i Gostivarit. Pasi përfundoi studimet e larta në Stamboll, ndoqi rrugën e mësuesisë. Ai ushtroi detyrën e profesorit të gjuhës shqipe në shkollën Normale (*Darulmu`allimin*) të Shkupit. Por, kontributi i tij kryesor konsiston në fushën e tekstologjisë, si didakt ai mban autorësinë e të paktën 16 teksteve shkollore, të cilat janë të shkruara në gjuhën turke.³²⁰ Në këtë kuadër ai hartoi dhe një “Abetare shqip me gërma arabe” (“Arnavutça elifba-arap harlariyla”), ndërsa në vitin 1946 hartoi një “Abetare”³²¹ të gjuhës shqipe. Sidoqoftë është e evidente që klerikët myslimanë shqiptarë në periudhën e Rilindjes Kombëtare kanë luajtur një rol të rëndësishëm për shkrimin, mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe. Për këtë, tregues i qartë është fakti se një alfabet origjinal me gërma latine siç ishte ai i Hoxhë Hasan Tahsinit dhe gjashtë abetare të gjuhës shqipe mbajnë autorësinë e këtyre klerikëve. Pa folur pastaj për libra, fjalorë, tekste mësimore dhe ndikimin e madh që ato patën për zhvillimin e gjuhës shqipe.

³¹⁶ *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1984, f. 429-436.

³¹⁷ Megjithëse kleri mysliman me kontribut në përpjekje për hartimin e alfabeteve dhe unifikimin e gjuhës shqipe nuk përbëjnë një numër të madh për nga sasia, përsëri në raport me peshën specifike dhe kohën kur u hartuan dëshmojnë për shkallën e lartë të preokupimit dhe rëndësinë që klerikët myslimanë shqiptarë i jepnin zhvillimit dhe mësimin të gjuhës shqipe.

³¹⁸ “Veteranët e Klerit Mysliman”, *Zani i Naltë*, nr. 11, Nanduer 1937, f. 330.

³¹⁹ Avzi Mustafa, *Gjurmë ndër vite*, UISHN, Shkup, 2014, f.107.

³²⁰ Shih: Hasan Kaleshi, *Kontributi i shqiptarëve...*, f.79-80;

Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX*, Tiranë: Insituti i Mendimit dhe Qytetërimin Islam, 1997, f.315.

³²¹ Abdulhaqim Hiqmet Dogani, *Abetare*, Shkup: Kultura, 1946.

3.3. DISA NGA TEKSTET E VEÇANTA TË ABETAREVE

a. *Evëtarët e parë shqip, 1844 – 1845, Naum Veqilharxhit*

Abetarja e parë e gjuhës shqipe, ajo e vitit 1844, me titull "*Fort i shkurtër e i përdorshëm Evëtar shqip*", u përgatit nga personaliteti i shquar e Rilindjes Kombëtare, Naum Veqilharxhi. Hartimi dhe realizimi i kësaj abetareje e vuri Shqipërinë në radhën e vendeve të qytetëruara. Autorin e "*Evëtares...*" së parë e helmuan dhe kopjet e këtij "*libri të mallkuar*" që kishte marrë udhët e Evropës, i dogjën për t'i zhdukur. Në Kosovë ishte tepër specifike lufta kundër abetares e përcjellë nga pushtuesit, me një antishqiptarizëm të paparë. Evëtar"-i ("*Fort i shkurtër e i përdorshim Evëtar shqip për çdo si cillë që do të mposnjë të kënduarit e të shkruarit bukur shqip*"), i Naum Veqilharxhit, abetarja e parë e gjuhës shqipes, ishte një libërth prej 8 faqesh, shkruar me një alfabet të veçantë. "*Evëtar*" i N. Veqilharxhi i përket vitit 1844.³²² Ky program i parw kulturor-arsimor u ribotua me 1845 me titull "*Fare i ri Evetar shqip per djem nismetare*", me 50 faqe dhe me disa copa leximi.

b. *Tri abetaret e Konstandin Kristoforidhit, 1867 - 1872*

Punën e Veqilharxhit e vijoi Kostandin Kristoforidhi, një figurë tjetër e shquar e Rilindjes Kombëtare, i cili në vitin 1867, rreth 23 vjet pas Naumit, botoi një abetare gegërisht dhe një toskërisht dhe u mësoi me këto libra gjuhën shqipen shumë bashkëatdhetarëve gjatë udhëtimeve nëpër Shqipëri. Alfabeti i Kristoforidhit me bazë latine, që përdorej për shkrimet në variantin e gegërishtes letrare, kishte një bazë të fortë shkencore. Ai nuk kishte shkronja digrafe, sepse disa shkronjave latine u kishte vënë edhe shenja diakretike. Kristoforidhi në alfabetin e tij latin përdori vetëm tri shkronja të alfabetit grek. Ky alfabet i kishte të gjitha mundësitë të bëhej alfabet kombëtar, por nuk u bë i tillë, sepse nuk pati përkrahje të nevojshme.³²³

c. *Një tekst i rrallë - Abetarja e Dr. Ludvig von Thalloczy, 1898*

Në Arkivin e Kosovës, si fotokopje të sjellura nga Arkivi i Bosnjës dhe Hercegovinës, është një tekst prej 92 faqesh, që flet për alfabetin shqip,³²⁴ përgatitjet hulumtuese, projektin, korrespondencën e L. Thalloczy me organet shtetërore, personalitetet etj. Dr. Ludvig von Thalloczy ishte i vetëdijshëm me faktin se një popull nuk mund të zhvillohet në aspektin kulturor nëse nuk e ka të shkruar historinë e vet në gjuhën e vet dhe nëse nuk e ka abetaren nga e cila të rinjtë mund të mësonin në gjuhën dhe shkrimin e vet.³²⁵ Ai është angazhuar shumë edhe për


³²² Një vit më vonë, më 1845, botoi abetaren e dytë prej 50 faqesh me titull "*Fare i ri Evetar shqip për djelm nismëtarë, nxjerrë e dhënë mbë dritë tani herën e parë për djem të vegjël me një të zgjedhur nga disa gjë të mirash e të fitimshme*". Parathënia e botimit të dytë ka si titull "*E parthënme për mbi djemt e rinj shqiptarë*". Ishte një manifest i vërtetë i Rilindjes sonë Kombëtare. Përveç të tjerave, kjo parathënie ka vlera edhe për mendimet që jep për zhvillimin e gjuhës dhe të arsimit kombëtar. Me interes është edhe gjuha e përdorur në dy abetaret e N. Veqilharxhit. Vihet re një prirje për t'i afruar dialektet e shqipes, prirje që rilindësit tanë të shquar e ngritën në veprat e tyre.

³²³ F. Raka, *Teoritë për standardizimin e shqipes, Normëzimi i shqipes ndër shekuj*, Prishtinë. 2004, f. 39.

³²⁴ Në bazë të dokumenteve arkivore që ruhen në Arkivin e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe një pjesë në Arkivin Shtetëror të Kosovës, shihet se Thalloczy projektin për Abetaren e ka filluar në vitin 1894 e finalizon në vitin 1898.

³²⁵ Si zyrtar i lartë, dr. L. Thalloczy është angazhuar që te organet kompetente të MPPJ dhe MPF të siguron mjete financiare ku do të mund të shtypët Historia e Shqiptarëve në gjuhën shqipe dhe Abetarja shqipe në dy pjesë. Sipas

shtypjen e abetares në gjuhën shqipe, e cila është shpërndarë nëpërmjet të konzulatis austriak në Shkodër në të gjitha shkollat fillore.³²⁶ *Abetarja shqipe*— Pjesa e I-rë është shtypur në 1000 kopje në Shtypshkronjën Halzhausen në Vjenë³²⁷, për t’u dërguar në Shkodër, në Konsulatën Austro-Hungareze, e cila mori si obligim që Abetarja të shpërndahej nëpër shkollat shqipe të Veriut edhe në Kosovë. Kopja në origjinal, një kopje e librit të parë të Abetares shqipe ka 42 faqe. Titulli i Abetarës është *Selteri i par per sco□a fi□ore t’scc□piniis, libri i par*.³²⁸ Libri fillon me shkrimin e shkronjave me një shkrim të bukur, siç janë **o, a, e, i, j, u, t, r, m, v, c** dhe më tutje duke bërë lidhjen e tyre, fillimisht me rrokje e pastaj më fjali më të gjata dhe pastaj me tekste, duke shtuar shkronjat e reja nëpër tekstet vijuese të përfshira me shkronjën e re, si p.sh. **k, l, s, g, h** etj. Në fund jep disa emra të personave, qyteteve dhe disa tekste, si p.sh. *Runiu fmii!* Të gjitha këto tekste janë të ndara në dy kapituj, të shkruara me një shkrim shumë të bukur, kryesisht me shkronja të shkrimit dhe më pak me shkronja të shtypit.



Faksimilet e Abetares³²⁹

shkresës së Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ludvig von Thalloczy datë 22 nëntor 1898, e cila i është dërguar Ministrisë së Përbashkët të Financave (B. von Kallaju) mund të shihet se si ka ardhur deri të shtypja e pjesës së parë të Abetarës shqipe. Shih: Mina Kujoviq, Sarajevë. *Kontributi i Lajosh Talloçzya historisë shqiptare*, Arkivi Shtetëror i Kosovës, nr. 39-40/2008, Prishtinë, fq. 527.

³²⁶ ABH, ZMF, prez. 1494/B.H. 1898. Këtë kopje të kësaj lënde (një kopje e Abetares shqipe) Mina Kujovic, *Kontributi i ...*, p. i c., fq. 531.

³²⁷ Idenë për shtypjen e këtij libri e ka dhënë konsulli austro-hungarez në Shkodër, z. Ippen.

³²⁸ Në shkresën nr. 1494/B.H. të Ministrisë së financave (Fondi: ZMF), të vitit 1898, ruhet kopja e vetme e kësaj Abetareje.

³²⁹ Teksti i Abetares në formën digjitale ruhet në Mikrotekën e Arkivit Shtetëror të Kosovës, për të cilin autori ka mbajtur një kumtesë në Seminarin ndërkombëtar për Gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2014.

c Abetari dhe Plotësori i Abetarit të Mati Logorecit

Ndër figurat e pedagogjisë shqiptare, historian, publicist, linguist e pedagog i shquar është edhe Mati Logoreci. Ai si mësues u shqua me aktivitete në Prizren, Shkodër e Tiranë. Puna e tij në sferën e didaktikës është e shënuar. Ai ka hartuar tekste për shkollat në gjuhën shqipe: “Abetar”, Vlorë, me 92 faqe, “Plotësori i Abetarit”, Vlorë, 50 faqe dhe “Libër i mësuesit për përdoruesit e Abetarit”, Vlorë, 55 faqe. Kjo abetare është shpërndarë edhe në shumë vise të Kosovës. Logoreci i hyri hartimit të teksteve shkollore në kohën kur për shkollën shqipe kjo ishte punë shumë e çmuar. Ai kishte njohuri të larta shkencore didaktike. Logoreci, ndryshe nga hartuesit tjerë të abetareve, mësimin e gjuhës shqipe e fillon me dhënien e 2-3 zanoreve ose edhe e të gjithave dhe pastaj kalohej në formimin e rrokjeve. Madje, përvetësimi i shkronjave të mëdha të dorës dhe të shtypit bëhet menjëherë pas përfundimit të shkronjave të vogla. Në tekstet e tij krahas mësimëve mbi gjuhën shqipe dhe mësimdhënien lexuesit i jep rol me rëndësi edhe edukimit moral dhe atdhetar.


ç. Abetarja e Zymit

Pas hapjes së mësonjëtores në gjuhën shqipe në Prizren e treva të tjera të Kosovës u shtrua nevoja për tekstet e abetareve. Kështu vjen Abetarja e Zymit³³⁰ prej 80 faqesh, e cila fillon me shkronjën **i** dhe **u** të vogël, por në krye të faqes me alfabetin që është zbatuar në vepër është shënuar me dorë, Zym, 20 Mâj 1900, Prizren. Kjo faqe dhe disa faqe të tjera kanë edhe vulën e Bibliotekës Kombëtare, Tiranë. Përndryshe, Zymi që në vitin 1900 e ka pasë Abetaren e vet. Mirëpo, duke mos mundur të sigurohet teksti origjinal i kësaj Abetareje, në vitin 2007 zymjanët e ngritën lapidarin e “Abetarja e Zymit, 20 maj 1900”. Ndërkaq, në vitin 2013 me angazhimin e Frrok Kristajt dhe të don Ndue Ballabanit, u botua teksti origjinal i tekstit fillestar “Abetarja e Zymit, 20 maj 1900”.³³¹ Është i gjatë vargu i mësimdhënësve, krijuesve, atdhetarëve, nxënësve, por edhe prindërve shqiptarë që kontribuan në mbajtjen gjallë të Shkollës së Zymit, të hapur qysh para 150 vjetësh. Abetaret qenë armë nga më të fuqishmet dhe më të efektshmet për të shkëputur arsimin tonë nga varësia e shkollave të huaja. Pranë abetares shqipe bënte roje pushka e B. Currit, I. Boletinit, N. Dragës, H. Prishtinës, etj. Pushka i jepte forcë abetares, abetarja i jepte krahe pushkës dhe shkronjave të gjuhës shqipe. Ky tekst vlerësohet si Abetarja më e vjetër në Arkivin e shtetit, që si trashëgimi kulturore ka vlerë të veçantë për historinë e kulturës dhe të arsimit tonë kombëtar.³³²

³³⁰Në fondet e AQSH të Shqipërisë ruhet një abetare e vjetër shqipe, e shaptilografuar, pa autorësi, e cila ka vetëm disa shënime me dorë, për datën dhe vendin e përdorimit: “Zym, 20 maj 1900. Zymi është vendbanim afër Prizrenit ku ka traditë të pasur kulturore, kombëtare e arsimore.

³³¹Nikollë Kërhanaj ka botuar dy monografi për Shkollën e Zymit – “Abetarja e Zymit” (monografi – pjesa e parë), 1997, dhe “Kronistoria e shkollës në Zym” (monografi – pjesa e dytë), 2014. Kurse, me iniciativën e Frrok Kristajt, në Zym, në vitin 1970, është themeluar Shoqëria kulturo-artistike “Katarina Josipi”, përkatësisht në vitin 1971, është themeluar Klubi letrar “Shtjefën Gjeçovi”, si dhe manifestimi letrar, kulturor e shkencor “Takimet e Gjeçovit”.

³³²Këto vepra që lidhen me një të kaluar të largët, pak ose aspak të njohur, paraqesin interes për atë fushë dijeje që i përkasin. Vite më parë prof.dr. Shefik Osmani na bëri të njohur përmes një artikulli të botuar, më 31 mars 1982 në gazetën “Mësuesi”, me titull “Abetarja e Zymit”, se në Arkivin e Shtetit ruhet një abetare e vjetër e shaptilografuar. (Për mësimin e gjuhës shqipe, kudo u vazhdua me abetare të tjera të hartuara nga Konstandin Kristoforidhi, Daut Boriçi, Shoqërisë e Stambollit (1879) etj., si dhe u botuan disa gramatika për gjuhën dhe në gjuhën shqipe. Gjithashtu, më 1879 ishte miratuar alfabeti i Stambollit, ai i shoqërisë “Bashkimi”, më 1899 dhe në Veri vazhdon të përdorej alfabeti i autorëve të vjetër.)



Në këto rrethana kulturore u botua edhe abetarja e Zymit.³³³ Ky tekst nga faqja 22, që autori e konsideron si *pjesë të dytë*, ka përsëritur edhe njëherë alfabetin, por tashmë duke paraqitur, përveç shkronjave të dorës të vogla dhe të mëdha, edhe shkronjat e shtypit. Në vazhdim jepen fjalë të ndryshme me vlerë njohëse ose edukative. Në faqen 75 shënon përdorimin e apostrofit për shkronjat **N, M, C, S, Sc**, ndërsa në f. 78 ka dhënë numrat nga 1-10 edhe me fjalë. Në vazhdim në f.79-80 është paraqitur pasqyra e alfabetit e përdorur në abetare, praktikë për çdo botim kur nuk ishte i miratuar alfabeti i përbashkët i shqipes. Duke qenë se ky ishte një abetare, ishte e detyruar të ndiqej tradita e botimeve të kësaj natyre, pasi qëllimi ishte të mësonte shkrim-leximin e shkronjave të gjuhës sonë.

Abetarja ka një strukturë , ku përveç shkronjave, siç e theksuam më sipër, jepen fjalë të ndara në rrokje, ushtrime duke përdorur fjalë të plota, në disa raste edhe fjalë me ose pa lidhje kuptimore njëra me tjetrën, por më shumë me vlerë edukative ose fjalë të urta, si: *Djali i mir e nderon prinden; kush do shum, jet pa kurgja; zoti vonon, por nuk harron; mos rri kot, por puno; bora asht e bardh; shkollari mson fmit; Zefi asht një fmi i paster. Kmishen edhe petkat e tjera i ma dlir. Ftyren e lan per dit. Gjith shtati i ban drit prej paqllikut..., T'mendoj shum-pak t'flas; T'bah mir, t'bahem i urt; Uku e ndrron qymen por vesin jo; Fol pak e mir; I lumi aj qi punon.* Autori i abetares në shumë pak raste jep edhe shembuj fjalish të përbëra: *Perpara se me e fillue një pun a mir me menduem pak. Siç e kanë vërejtur edhe ata studiues që kanë shkruar për këtë abetar, disa nga këta shembuj kanë jo vetëm karakter njohës, praktik dhe edukativ, por edhe patriotik, si: Niri e do vendin ku ka le; Un jam shqyptar e flas shqyp. Shqypnija asht e dashtuna, atdheja e jon. Në këtë botim janë paraqitur edhe pak tekste të shkurtra që ilustronjë shkronjën e dhënë.*³³⁴ Abetarja e Zymit ka 32 shkronja, si dhe dyfishon bashkëtingëlloren **n** për **nd** (32 + 1),

³³³Ribotim i kësaj vepre hapet me një shkrim të Don Ndue Ballabanit “Abetarja, mrekullia e shtatë e Zymit”, ku shënohen shtatë mrekullitë kulturore të kësaj zone, duke përmendur autorët më me emër që kanë dalë ose kanë shërbyer në Zym.(Te kopja e gjetur e Abetares së Zymit është shënuar me dorë, Zym, 20 Mâj 1900, Prizren. Kjo faqe dhe disa faqe të tjera kanë edhe vulën e Bibliotekës Kombëtare, Tiranë.)

³³⁴Në faqen 81, shkruar me shkrim dore dhe me alfabetin e sotëm ka këtë shënim: Alfabeti i litografuem i Jak Specit ia fali Lumos prof. Luigj Shala që e gjet në Prizrend me 20 maj 1900. Një faqe me pas ka përsëri një shënim tjetër: M'a fali Z.Luvixh Shala (alias Bogdani) profesor i didaktikës në Institutin Femnor. E ka përdorur vetë në Prizren. Alfabeti i vjetër i thanë ay i Jak Specit. 5.Janvier 1935.Në fund të Abetarës së ribotuar, botuesi ka përfshirë një shkrim të Frok Kristaj “Abetarja e Zymit dhe abecejat shqipe”, si dhe jepet një listë bibliografike prej 20 titujsh..(Në abetaren e Zymit ndeshim edhe disa emra gjeografikë, si Afrikë, Evropë, Shkup dhe Prizren e Zym, por edhe Shkodër, Bunë dhe Drin. Autori nuk është shtrirë më tej në gjeografinë e vendit përmes shembujve që ka dhënë, ku qëllimi nuk ka qenë të evidentojë emra gjeografikë, por ka shënuar ato emra që mendojmë se nxënësit i kanë njohur. Ky mund të jetë edhe një argument se autori i saj mund të jetë nga ato zona.)

siç e kanë përgjithësisht autorët gegë të shek.XIX dhe së fundi alfabeti i shoqërisë “*Bashkimi*”, por, që në sistemin alfabetik të shqipes nuk përfshihet. Në abetaren e Zymit kemi tri shkronja të posaçme për **dh** (**th**), (*Kjo shkronjë tek të gjithë autorët e vjetër është e stilizuar, e tillë paraqitet edhe në këtë abetar*), **y** (*Te abetarja e Zymit është një 8 e mbyllur, por kur është e dorës ka edhe një vijë në kokë dhe një poshtë për t’u lidhur me shkronjat e tjera*), **z**, si dhe një shkronjë greke për **ll**. Nuk dallohet grafikisht zanoren **ë**, e cila ose nuk pasqyrohet ose shënohet me **e**, si dhe me një grafemë paraqet dy tinguj-fonema, si **c** për **ç** dhe **q, g** për **gj** dhe **xh, z** për **c** dhe **x**. Ka tre dyshkronjësja: gh për g, gn për nj, si dhe dyfishon grafemën e posaçme **dh** për **th**. Në abetar ndeshim në një fjalë të vetme edhe **oe: voe** (f.34) dhe përsëri në një fjalë grafemën **nj** si në alfabetin e sotëm njeri (f.68).

3.4. RRUGËTIMI I ABETAREVE NË KOSOVË

Abetarja nuk hap vetëm një dritare nga bota, ajo për rrethanat që ka kaluar Kosova është diçka më shumë. Që nga viti 1941 në Kosovë janë përdorur gjithsej 33 tekste të reja dhe të ribotuara me plotësime e ndryshime për një gjysëm shekulli deri te abetarja e përbashkët me Shqipërinë. Derisa menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore tekste të abetareve ishin të imponuara dhe hartoheshin çuditërisht edhe nga autorë serbë, të cilat duhej përkthyer e përshtatur për zbatim. Çuditërisht ngjante që në emër të “*vëllazërim-bashkimit*”, që edhe personazhet e teksteve të abetareve të ishin emra sllavësh...!³³⁵ Kjo atmosferë reflektohej edhe në shtypin e kohës dhe në debatet e atëhershme.³³⁶ Për të debatuar për rrugën e hartimit të një abetareje në Kosovë, do të ndalemi te Abetarja e vitit 1978, e cila nxiti organizimin e një tryezë debati të pagëzuar “*Abetarja e re dhe përdorimi i saj*”, ku morën pjesë elita e arsimit tonë, u shtrua kjo çështje nga shumë aspekte, sepse siç u tha. “*Është gjë e vështirë të vlerësohet në mënyrë të gjithanshme një tekst vetëm në një gjysmë viti jetë në praktikë, aq më parë kur në kushtet e krijimit të librit tonë shkollor ende nuk kemi eksperimente praktike, madje as përciellie sistematike apo kërkues te jetës së tij në praktikën konkrete.*” Meqenëse ende nuk ishte filluar të eksperimentohet me tekste shkollorë dhe të gjitha analizat në këtë drejtim bazoheshin në kontributin në bazë të vështrimeve analitike – teorike dhe në bazë të rezultateve të punës së përditshme në praktikën konkrete se “*...ç’tregoj, pra, abetarja e re e Mehmedali Hoxhës në praktikën gjysëmveçare, duke u vlerësuar nga rezultatet që u arritën në punën e jetës së saj fillestare në një anë edhe nga aspekti i kërkimeve profesionale nga ana tjetër.*”³³⁷ Për të ilustruar më mirë rrugën (*procesin*) e hartimit të një abetareje në Kosovë, që është një punë e vështirë dhe komplekse po marrim rastin e rrugës së aprovimit të abetares së vitit 1978, secila i duhej të kalonin nëpër disa “*filtra*” profesional, por vështroheshin edhe me dioptri politike. Ishte për ligjur që abetarja duhej fituar me konkurs.³³⁸ Njëri dorëshkrim kishte fituar dy recensione pozitive (*një pedagog dhe një mësues*) dhe tjetri dorëshkrim kishte fituar një recension pozitiv. Mirëpo ata ende nuk kishin mendim të prerë, me arsyetim se “*nuk i njihnin drejtpërdrejt dorëshkrimet për të cilat bëhej fjalë (vetëm përmes recensioneve).*”³³⁹ Rrjedhimisht nga kjo lindi edhe propozimi për rivlerësimin e këtyre dorëshkrimeve ta bënin tre anëtarët e këtij komisioni, në mënyrë që në mbledhjen e ardhshme të mund të merrej mendimi i prerë për njërin dorëshkrim edhe u caktuan tre recensorët e ri: Q. Batalli, I. Krasniqi dhe J. Zherka.

Rrugën e hartimit të abetares e vështirësonte edhe mungesa e hulumtimeve për fjalorin frekuentiv të të folurit të fëmijëve, s’kemi fjalor themelor etj.³⁴⁰ Po ashtu nuk ishin të njohura

³³⁵ Mirëpo, pas Plenumit të Brionëve, e veçanërisht ndryshimeve kushtetuese të vitit 1974 gjërat ndryshuan së mbari dhe jo vetëm shkronjat ishin në gjuhën shqipe, por edhe frymimi brenda abetareve ishte i tëri shqip.

³³⁶ Në vitin 1978, për të debatuar për rrugën e hartimit të një abetareje në Kosovë, u mbajt një tryezë- debat i emërtuar “*Abetarja e re dhe përdorimi i saj*”, ku morën pjesë rreth njëzet punonjës të arsimit të Kosovës.

³³⁷ “*Abetarja nuk hap vetëm një dritare nga bota, revista “Shkëndija”, Nr. 3-4 *, më 15 shkurt 1978, Prishtinë. (Në vitin 1978, në vigjilje të 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit revista pedagogjike “Shkëndija” në Kosovë kishte organizuar një tryezë të rumbullakët, gjatë pushimeve dimërore në temën, “Abetarja e re dhe përdorimi i saj”.)*”

³³⁸ Nga Tryeza e revistës “*Shkëndija*”, botuar në nr. 3—4 shkurt 1978 .

³³⁹ “*Shkëndija*” nr.3-4, më 15 shkurt 1978.

³⁴⁰ Sa i përket frekuencës së tingujve nuk kishte studime të duhura pos një tentimi të Faruk Beshos (shih Buletini i USHT, Seria e Shkencave Natyrore, 1969, nr. 2.). Të dhënat e Beshos për nevojën e hartuesve të abetareve – për renditjen e tingujve në abetare për shumë arsye të tjera, nuk mund të shërbejnë si model përfaqësues. Por, sido që të jetë, këto të dhëna duhet të kihet parasysh së paku si orientim.

llojet e rrokjeve të hapura, e kjo do t'i ndërronte disa qëndrime metodike të formuara nga literaturën pedagogjike të gjuhës serbokroate, e cila ishte me ndikim në Kosovë. Mosnjohja e strukturës së rrokjeve ndihmonte të zgjedhnim rrugën më të drejtë në mbarështrimin e abetares. Mirëpo, edhe nga disa të dhëna të tërthurta për këtë çështje shërbenin si orientim, sepse dihej se mbi strukturën rrokjesore nxierrë nga 24.048 fjalë më të përdorshme të Fjalorit të shqipes të vitit 1954. Pra, siç thekson më të drejtë prof. A. Kostallari, “*boshti i leksikut të shqipes së sotme dhe tendenca e tij është në radhë të parë, struktura dyrrokëshe e fjalës*”. Kështu, hartuesi i abetares, nëse e nje psikologjinë e lexim-shkrimit fillestar do të kishte më lehtë që në tekstin e abetares t'i harmonizojë kërkesat psikologjike mbi pikat fiksative, pasi që 84,75 për qind të leksikut të shqipes e përbëjnë fjalët një , dy e trirrokëshe.

Hartuesit e abetareve në Kosovë, në zgjedhjen e metodave të lexim-shkrimit fillestar bazoheshin prej fondit të gjithëmbarshëm të fjalëve të *Fjalorit të gjuhës shqipe të 1954*. Në këtë Fjalor 76,7 për qind të fjalëve shkruhen sipas parimit fonetik, e kjo e dhënë diktonte hartuesin e abetares, në zgjedhjen e metodave dhe të mënyrës së shtruarjes së lëndës në abetare.³⁴¹ Me hartimin e abetareve në Kosovë janë marrë ,njerëz që nuk janë të njohur sa duhet me të mbërrimet e shkencës në këtë lëmë. Bile disave prej tyre u dukej se hartimi i abetares është punë fort e lehtë, prada edhe i hynin asaj pune pa menduar shumë. Kjo metodë ndryshonte edhe nga vendet tjera socialiste. Duke nisur nga nga pikëpamja që ekzistonte në Kosovë, nuk ndodhte krejt rastësisht që kur bëhet fjalë për ndonjë zgjidhje konkrete në abetare, prej autorëve vetë, prej recensorëve, madje dhe prej kritikëve më së shpeshti e ndeshim fjalën „... *mua ma merr mendja së kështu duhet ...*”.³⁴² Kjo do të thotë se punohej me hamendje e herë-herë edhe urdhëra të prera! Planifikohej kalimi më i shpejtë në lexim-shkrimin fillestar jo vetëm si përparësi e një efekti më të shpejtë nga aspekti psiko-pedagogjik, por edhe nga përmbushja shumë më e shpejtë e kështerisë për lexim e shkrim si ideal disavjeçarë i , “*mbjellë*” në shpirtin e fëmijës.³⁴³ Arsyeya tjetër e kësaj mënyre është përgatitja më e shkurtër, do të mund përmendeshin; *koncipimi i abetares në mbështetje të anëve pozitive të më shumë metodave dhe ecurive të shkrim-leximit fillestarishte arsyeja tjetër pse pa dilema u përcaktuar për botim kjo abetare*. Autori , për metodë kryesore të mbarështrimit të përmbajtjes kishte caktuar metodën tingëllore analitiko-sintetike të shoqëruar në moment me metodën e fjalës normale dhe atë fonetike. Ky tekst paraqet një përpjekje për futjen e së resë në abetaren dhe në mësimin e shkrim-leximit fillestar në gjuhën shqipe .

³⁴¹ Fatkeqësisht, hartuesit abetareve në Kosovë shumë pak e kanë respektuar parimin fonetik e kjo krejt është rezultat i mbështetjes në metodikat e gjuhës serbokroate të shkruara për një tjetër gjuhë.

³⁴² Nga diskutimet në “*Truezën e Shkëndijës*” 1978.

³⁴³ Në pjesën sistematike të abetares fillohej me grafemat e mëdha si forma më të thjeshta për t'i , “*shkruar*”, respektivisht për t'i vizatuar ato: A, I, M, O, U, N, E, H, gjithsejt tetë. Megjithatë të dyja metodat kishin të metat e tyre. Të metat e zhvillimit paralel të shkronjave dhe të mënyrës se zhvillimit veçmas të shkronjave, lehtë mund të hetojë se me këtë mënyrë jemi përpjekur t'u shmangemi të metave të njërës, respektivisht të tjetrës mënyrë. Për këtë çështje ka edhe arsytimit të mjaftueshme edhe në teorinë metodike, po edhe në realizimin praktik. Njëri prej arsytimitve për mënyrën e kombinuar të shtruarjes së shkronjave në abetare ishte se faza më e rëndë e lexim-shkrimit—hapi i parë në lexim-shkrim (shkronjat e para) lehtësohet shumë nëse mësohen veçmas , do të thotë nëse zhvillohen veçmas dhjetë-pesëmbëdhjetë shkronjat e para. Në disa burime ndeshim se duhet të punohen ndaras 1/3 e shkronjave të shtypit. Këtë lehtësi hartuesit e kanë shfrytëzuar edhe më tepër duke i marrë vetëm shkronjat e mëdha të shtypit (*nëse do të llogaritet matematikisht vetëm ana grafike, do të dilte 1/4 e shkronjës së tërë me katër grafema.*)

3.4.1. Nga Abetarja e parë tek Abetarja e përbashkët Shqipëri – Kosovë

Shumë hartues, por edhe metodistë e didaktë të gjuhëve amtare pajtohen se, Abetarja është libri i librave sepse, që të hysh në botën e dijes, duhet të mësosh shumë mirë lexim dhe shkrim. Disa pohojnë se Abetarja është libri i parë i klasës së parë dhe me përmbajtjen e saj ajo krijon përshtypjet e para tek fëmija për natyrën e shkollës dhe të teksteve mësimore. Disa dijetarë thonë se , abetarja duhet të ketë një logjikë të shëndoshë në çdo aspekt të saj. Ushtrimet, tekstet, ilustrimet kerkohej të ishin në funksion të forcimit logjik të fëmijës dhe të duhet të jetë e thjeshtë në të mësuar.³⁴⁴ Synimet edukative janë të shumta: një tekst mund të edukojë me dashurinë për punën, një tjetër me dashurinë për të afërmit, një tjetër mund të dënojë veset e kështu me radhë. Megjithatë abetarja pasqyrore edhe kërkesat edukative që lindin nga përkatësia ndaj një kombi. Te shumica e popujve të Ballkanit historiku i hartimit të abetareve nuk ishte i hershëm. Greqia, është hartuesja e parë e abetares në Ballkan, për të vazhduar me atë të Rumanisë (1820), të Bullgarisë (1824) dhe të Serbisë (1827). Patjetër edhe ky faktor ka pasur ndikimin e vet te N. Veqilharxhi, punën e së cilit e vjoi Kostandin Kristoforidhi, një figurë tjetër e shquar e Rilindjes Kombëtare, i cili në vitin 1867 botoi një abetare gegërisht dhe një toskërisht. “*Autorët e abetares sillnin modele të ndryshme tekstesh mësimore në varësi nga formimi shkencor e didaktik që kishin marrë në vendet ku kishin kryer studimet, nga literatura didaktike që zotëronin dhe nga abetaret e huaja që kishin në dorë. Por ata kanë meritën se bënë maksimumin për të hartuar abetare për fëmijët shqiptarë, abetare që i shkonin për shtat gjuhës sonë.*”³⁴⁵ Përpjekjet e shumta dhe të vjetra për hartimin e abetareve me një qasje serioze të mirëfilltë shkencore, pedagogjike e gjuhësore u kurorëzuan pas vitit 1944. Ndërsa, Abetaret e bashkëkohore në Kosovë e Shqipëri janë përpunuar duke u mbështetur në arritjet e gjuhësisë dhe të përvojës së fituar nga shkolla shqiptare, të shoqëruara me ilustrime, të cilat u përshtaten veçorive psikologjike të moshës dhe kërkesave gjuhësore të fëmijëve. Mënyra e hartimit të abetareve në Kosovë ka ndryshuar vazhdimisht. Në Abetaret e para u përdor metoda fonetiko-silabike (rrokjesore), pas Kongresit të Manastirit iu dha përparësi parimit fonetik.³⁴⁶ Nga fundi i viteve ’20 të shekullit të kaluar, u përcaktua zyrtarisht për herë të parë metoda e përzier (*kombinim i metodës analitiko-sintetike me atë të fjalëve normale*). Sikur edhe në Shqipëri edhe në Kosovë, metoda që u rezistoi më shumë kohëve, është metoda analitiko-sintetike, e zbatuar nga metodisti Kolë Xhumari që nga fundi i viteve ’40 deri në fillim të viteve ’90 të shekullit XX. Në Kosovë metodika e Xhumarit ishte e vetmja busull orientuese për mësuesit e klasave të ulëta, sepse ky metodist ishte autor i metodikës së gjuhës shqipe, nga i cili u mësua “*arti i mësimdhënies*” në shkollat normale në Kosovë.

³⁴⁴Mbizotëron edhe mendimi se, Abetarja duhet të jetë e bukur dhe argëtuese, sepse më shumë se çdo shkollë, nxënësi i klasës së parë tërhiqet nga bukuria e tekstit dhe argëtimi, kur mëson. Bukuria fillon që nga cilësia e botimit, nga ilustrimet e bukura, nga faqosja e mirë etj. Argëtimi ka të bëjë me lojërat e bukura mësimore, këngët, vizatimet, ngjyrosjet dhe tekstet tërheqëse në përputhje me nivelin e fëmijës. Mbi të gjitha, Abetarja duhet të jetë edukative, me anë të teksteve nxënësit duhet të marrin një edukatë të shëndoshë.

³⁴⁵ Besnik Rama, “*Mësimdhënia e gjuhës shqipe në një vështrim bashkëkohor*”, (temë doktrature,- online), UT, 2013, Tiranë.

³⁴⁶Me kalimin e viteve, vijoi zbatimi i metodave sintetike-analitike dhe i atyre analitike-sintetike. Por, si në vende të tjera, edhe te ne, ka ndodhur të mënjanohej metodat fonetiko-silabike e ato analitike, duke i lënë vendin metodës globale.

3.4.2. Bibliografi e Abetareve të para shqipe

(Për 170 vjet u hartuan mbi 150 Abetare në gjuhën shqipe³⁴⁷)

Që nga abetarja e parë e Naum Veqilharxhit, (e shtypur në vitin 1844), bibliografia është nxjerrë nga katalogët elektronikë të dy bibliotekave kombëtare, (referenca të nxjerra nga *evidentimi i njësive fizike të abetareve në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë*).³⁴⁸

Bibliografia është dhënë në mënyrë kronologjike, duke i ndarë veç botimin e abetares në gjuhën shqipe të botuar në Kosovë apo vende të tjera të ish-Jugosllavisë për nxënësit shqiptarë. Më poshtë po japim fillimisht *abetaret e para* me dedikim për nxënësit shqiptarë, më pastaj të periudhave politike e historike të shtetit shqiptar, ndërsa në një kapitull të veçantë janë përshkruar abetaret e botuara në Kosovë, përkatësisht në ish-Jugosllavi.

Mbështetur nga gjurmimet në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, krojohet një pasqyrë e plotë e bibliografive e abetareve shtetërore shqiptare të përdorura që nga fillimi i hartimit të këtyre librave të parë shkollorë. Këto përpjekje për abetare për shkollat popullore shqipe³⁴⁹ përveç N.Veqilharxhit, S.Frashërit, K.Kristoforidhit ndihmoi edhe Aleksandër Xhuvani³⁵⁰, Kolë Xhumari³⁵¹, Sh.Rrokaj e M.Gjokutaj e hartues të tjerë. Këtu është dhënë gjithë panorama e gjeografisë, por edhe e historisë së abetareve të gjuhës shqipe, gjithë bibliografia e abetareve shqipe e ndarë në:³⁵²

a-Bibliografi e Abetareve të para shqipe të botuara jashtë dhe brenda Shqipërisë, filluar nga N.Veqilharxhi, *Fort i shkurtër e i përdorçim Evëtar shqip*, botuar në vitin 1844, për shkak të rrethanave të njohura në trojet shqiptare, u botuan dhe ribotuan 39 tekste abetaresh.

b-Bibliografi e Abetareve gjatë Periudhës së Pavarësisë së Shqipërisë, nisur nga autori Nikolla Lako, Stërviçetore për nxënësit shqiptarë, Abetare, Paris, 1913 janë botuar dhe ribotuar 47 tekste abetaresh. Ndërsa nga Bibliografi e Abetareve në periudhën e sistemit socialist në

³⁴⁷ Burimi: *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*, f. 240 (Shih: Revista pedagogjike-informative “Mësuesi i Kosovës”, Bukuriye Haliti, “Bibliografia e abetareve shqipe, Prishtinë, maj 2012.)

³⁴⁸ Ky interesim për të hartuar këtë bibliografi të shkurtër për abetaret në gjuhën shqipe, vjen nga nevoja për të informuar lexuesin shqiptar për këtë kod kulturor e arsimor të shqiptarëve, duke dhënë të dhëna më të detajuara, se sa të dhënat vetëm për autorët e hartimit të abetareve të gjuhës shqipe nëpër vite.

³⁴⁹ Në një periudhë prej 20 vjetësh, N. Paluca përgatiti dhe botoi abetaren e tij tetë herë. Botimi i tetë, 1938, mban titullin “Libri i klasës së parë”. Kjo abetare kishte 77 faqe (Burimi: *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*, f. 240)

³⁵⁰ Nga viti 1922 deri në vitin 1938, A. Xhuvani botoi tekste e abetares, në fillim vetëm (1922-1930) e më pas (1931-1939) në bashkëpunim me Pertef Pogonin. Abetarja e vitit 1939 ishte më e arrirë nga ana teknike, por pjesët e leximit ishin të politizuara në përmbajtje dhe në ilustrime (Burimi: *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*, f. 245, 248)

³⁵¹ Ndër autorët me të spikatur që më së gjati qëndroi në “tregun” e shkrim-leximit është Kolë Xhumari (01.05.1912-30.04.2006). Me të drejtë vlerësohet veterani i Abetares shqipe. K. Xhumari është autor ose bashkautor i parë i abetares që nga viti 1945 deri në vitin 2004. Ai është autor i disa punimeve me karakter metodik për arsimin fillor, si: *Shkrimi skript* (1945), *Leksione pedagogjike për prindët* (1946), *Metodika analitiko-sintetike* (1947), *Edukimi i fëmijëve të moshës së vogël* (1958), *Lidhja e shkollës fillore me jetën, me punën, me ndërtimin e socializmit* (1986), *Libri i mësuesit për klasën e parë* (1994)

(Burimi: *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*, f. 252, 254 dhe: <http://www.forumshqiptar.com/>)

³⁵² Në këtë punim është prezantuar e plotë vetëm Bibliografia e abetareve të përdorura në Kosoë.

Shqipëri kemi nxjerrë se *Abetare për të rritun*, Tiranë, 1945 deri te autori G.Bedhija, *Abetare*, për ciklin e ulët të shkollës 8-vjeçare pa shkëputje nga puna – Tiranë, 1972 janë botuar e ribotuar 21 tekste abetaresh. Kurse, nga bibliografia e Abetareve të periudhës së sistemit pluralist në Shqipëri janë botuar e ribotuar 24 tekste abetaresh, nga autori Kolë Xhumari, *Abetare*, libër i mësuesit – Tiranë, 1994e deri të Abetare e përbashkët Shqipëri-Kosovë, Tiranë-Prishtinë, 2012. Ndërkaq, tekstet e botuara në Kosovë i kemi ndarë në:

Abetaret e para të përdorura në Kosovë;
Abetaret e pas Luftës së Dytë Botërore;
Abetaret pas pavarësisë së Kosovës
*Abetaret e gjuhës shqipe në Maqedoni dhe në Mal të Zi.*³⁵³

Tabela 2. Abetaret e gjuhës shqipe në Maqedoni dhe në Mal të Zi

Nr.	Titulli	Autori	Vendi	Viti
1.	Abetare	A. Dogani, K. Xheria. M. Dumani	Shkup	1946
2.	Abetare...	Xhevat Gega	Shkup	1969
3.	Abetare	Gj. Gjokaj, F. Camaj	Podgoricë	1984
4.	Abetare	Xhevat Gega	Shkup	1991
5.	Abetare	Gj. Gjokaj, F. Camaj	Podgoricë	1993
6.	Abetare	Gj. Gjokaj, F. Camaj	Podgoricë	1998

Tabela 3. Abetaret në diasporën e vjetër dhe të re shqiptare

Nr.	Titulli	Autori	Viti
1.	Abavator arbëror	Anastas Kullurioti	1882
2.	Abecedario	Jeronim de Rada	1896
3.	Abetari i të mërguemit	Shpend Bardhi (pseudonim: M. Merlika)	1952
4.	Abetare e posaçme për nxënësit shqiptarë jashtë Republikës së Shqipërisë	Urti Osmani	2011

Abetaret e para shqipe në Kosovë

Pas përpjekjeve të përmendura gjatë periudhave të mëhershme për hartimin dhe botimin e abetareve, në Kosovën e pas Luftës së Dytë, abetarja e parë është botuar në vitin 1946 *Abetare për të rritun*, Prizren.³⁵⁴ Këtu përfshihet botimi i abetareve jo vetëm në Kosovë, por edhe në kryeqytet e ish-republikave të tjera jugosllave, si: në Shkup, Beograd, Titograd etj.

Njësitë bibliografike janë të dhëna në mënyrë kronologjike, duke përfshirë periudhat e historisë së Kosovës që përkohjnë me rezistencën dhe luftën e saj për pavarësi. Në periudhën e para pavarësisë(1945-1999) në Kosovë janë botuar dhe ribotuar 23 abetare. Ndërkaq, gjatë kohës së sistemit paralel janë përdorë 5 abetare, kurse nga pavarësia deri te abetarja e përbashkët, në Kosovë janë botuar po ashtu 5 tekste abetaresh (të reja dhe të ribotuara). Pra, 33 lloje abetaresh janë përdorur në Kosovë, si tekste autentike të kësaj treve, pa llogaritur abetaret e botuara në Shqipëri dhe jashtë saj në periudha e para Luftës së Dytë Botërore.

³⁵³Burimi: *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*, f. 272-282.

³⁵⁴Abetare për të rritun: Këshilli Populluer Krahinuer për Kosovë e Metohi Drejtorati arsimuer, Prizren,1946.

a. Bibliografia e Abetareve shqipe të hartuara dhe të përdorura në Kosovë

1. Abetare per te rritun. Prizren: Keshilli Populluer Krahinuer për Kosovë e Metohi Drejtorati arsimuer, 1946. - 58 f. : ilustr. ; 20 cm;
2. Abetare : për klasën e parë të shkollave fillore / [punue prej Mehmet Gjevorit, Stathi Kostari dhe Jani Gjinos ; vizatimet i ka punue Jelica Popoviq]. - Beligrad : Botimi i Drejtoratit t' Arsimit për Kosovë e Metohi : Komisioni Pedagogjik, 1947. 100 f. : ilustr ; 23 cm;
3. Abetare : për të rritun. - Beograd : Ditunija, 1948. - 110 f. ; 23 cm;
4. Abetare : për të rritun / Punue prej Mehmet Gjevorit, Shevqet Veliut, Stathi Kostarit e Talat Paçarizit. - Beograd: Znanje, 1950. - 100 f. ; 22 cm;
5. Abetare : për klasën e parë të shkollave fillore / Punuen : Mehmet Gjevori e Stathi Kostari. - Prishtinë : Mustafa Bakija, 1951.- 116 f. : ilustr ; 22 cm;
6. Gjevori, Mehmet , Abetare : për klasën e parë të shkollave fillore / Mehmet Gjevori dhe Jusuf Shushka, ilustroi : Ferdo Drabek. - Prishtinë : Mustafa Bakija, 1955. -133 f. : ilustr ; 24 cm; Abetare për klasën e 1-rë të shkollës fillore. - Prishtinë : Pa em., 1962. – 70 f.
7. Hoxha, Ramiz , Abetare : zhvillimi veças i germave të shtypit e të dorës / Ramiz Hoxha ; [ilustrimet dhe kaligrafinë i punoi Mateja Rodiqi]. - Prishtinë : Enti i Botimeve Shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, 1968. - 116 f. : ilustr. ; 24 cm;
8. Hoxha, Ramiz , Abetare : zhvillimi paralel i germave të shtypit e të dorës / Ramiz Hoxha ; [ilustrimet dhe kaligrafinë i punoi Mateja Rodiqi]. - Prishtinë : Enti i Botimeve Shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë, 1969. - 116 f. : ilustr. ; 24 cm;
9. Tahir-Gega, Xhevat , Abetare : zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës / Xhevat Tahir-Gega ; [ilustrimet Smajo Musoviq]. - Shkup : "Prosvetno Dello", 1970. - 119 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
10. Tahir-Gega, Xhevat , Abetare : zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës / Xhevat Tahir-Gega ; [ilustrimet Smajo Musoviq].- Shkup : "Prosvetno Dello", 1971. - 119 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
11. Hoxha, Mehmedali , Abetare / Mehmedali Hoxha ; ilustrimet i punuan Smajl Kryeziu, Tafil Kryeziu.- Prishtinë : Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, [1977]. - 96 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
12. Gega, Xhevat , Abetare : zhvillimi paralel i shkronjave të shtypit e të dorës / Xhevat Gega ; ilustrimet Smajo Musoviq. - Shkup : Prosvetno Dello, 1978. - 119 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
13. Hoxha, Mehmedali , Abetare / Mehmedali Hoxha ;[ilustrimet i punuan Smajl Kryeziu, Tafil Kryeziu]. Prishtinë : Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1979 96 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
14. Hoxha, Mehmedali , Abetare / Mehmedali Hoxha ; ilustrimet i punuan Smajl Kryeziu, Tafil Kryeziu. - Prishtinë : Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, [1980]. - 93 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
15. Batalli, Qamil , Abetare / Qamil Batalli ; ilustroi Fatmir Krypa.- Prishtinë : Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1983. - 93 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
16. Batalli, Qamil , Abetare / Qamil Batalli ; ilustroi Fatmir Krypa. - Prishtinë : Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të KSA të Kosovës, 1984. - 93 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
17. Gjoka, Gjekë , Abetare / Gjekë Gjokaj, Fran Camaj. - Titograd : Enti Republikan për Përparimin e Edukimit dhe Arsimimit, 1984. - 82 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
18. Batalli, Qamil , Abetare / Qamil Batalli ; ilustroi Fatmir Krypa. - Prishtinë : Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1985. - 93 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
19. Batalli, Qamil , Abetare / Qamil Batalli ; ilustroi Fatmir Krypa. - Prishtinë : Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinave Socialiste Autonome të Kosovës, 1986. - 93 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
20. Batalli, Qamil , Abetare / Qamil Batalli ; ilustroi Fatmir Krypa. - Prishtinë : Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinave Socialiste Autonome të Kosovës, [1987]. - 101 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;

21. **Batalli, Qamil**, Abetare / Qamil Batalli ; ilustroi Fatmir Krypa. -Prishtinë : Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinave Socialiste Autonome të Kosovës, [1988]. - 101 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;

3.2.3.1. Abetaret në periudhën e pavarësimit të sistemit arsimor dhe shkollës shqipe në Kosovës

1. Batalli, Qamil , Abetare / Qamil Batalli ; ilustroi Fatmir Krypa. - Prishtinë : Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, [1990]. - 101 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
2. Batalli, Qamil , Abetare / Qamil Batalli ; ilustroi Fatmir Krypa. - Prishtinë : Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, [Pa.vt]. - 93 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
3. Batalli, Qamil , Abetare / Qamil Batalli ; ilustroi Fatmir Krypa. - Prishtinë : Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, [1991]. - 101 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
4. Batalli, Qamil , Abetare / Qamil Batalli ; ilustroi Fatmir Krypa. - Prishtinë : Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1996. – 103 f. : ilustr. me ngjyra, 24 cm;
5. Batalli, Qamil , Abetare / Qamil Batalli ; ilustroi Fatmir Krypa. - Prishtinë : SHBLSH, 1998. – 103 f. : ilustr. me ngjyra, 24 cm;

Abetaret në periudhën e pas çlirimit të Kosovës

1. Batalli, Qamil , Abetare / Qamil Batalli ; ilustroi Fatmir Krypa. - Prishtinë : Libri Shkollor, 2000. - 101 f. : ilustr. me ngjyra ; 24 cm;
2. Batalli, Qamil , Abetare / Qamil Batalli ; piktor Shyqri Nimani. - Prishtinë : Libri Shkollor, 2003. - 88 f. : ilustr me ngjyra. ; 30 cm;
3. Batalli, Qamil , Abetare / Qamil Batalli ; piktor Shyqri Nimani. - Prishtinë : Libri Shkollor, 2004. - 88 f. : ilustr me ngjyra. ; 28 cm;
4. Deva, Agim , Abetare / Agim Deva, Islam Krasniqi ; [Ilustrimet Ylber Cërvadiku]. - Botimi 1. - Pejë : Dukagjini, 2008. - 82 f. : ilustr. me ngjyra ; 29 cm.

Udha e njësimimit të shkronjave dhe udha e njësimimit të gjuhës shqipe të përbashkët

Në udhën e gjatë të shkronjave shqipe larmia e abetareve të përdorura në shkollat shqipe është shumë e theksuar.³⁵⁵ Përkundër vonesës së shqiptarëve në këtë udhë të vështirë, fondi i botimeve të librit të parë të shkollës është shumë i pasur, nëse do të kemi parasysh periudhën 170-vjeçare që nga botimi i “*Ëvetar*”-it, kur vështrojmë bibliografinë e botimit të abetareve të njohura zyrtarisht në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, dhe diasporë. Gjithsesi, nuk duhet menduar se kemi të bëjnë me lista të shteruara, po vetëm për aq sa na japin studimet e deritanishme dhe njohja që kemi rreth historikut të abetares sonë. Në mesin e të gjitha abetareve të gjuhës shqipe në Shqipëri, Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi dhe abetaret në diasporën e vjetër dhe të re shqiptare më e qendrueshmja në mësonjëtoare ka qenë abetarja e Kolë Xhumarit 1945-2009, (është ende në përdorim, por me një tirazh të kufizuar. Alterteksti e ka si titull, por përzgjedhja behet nga vetë mësuesit e shkollave) dhe në Kosovë abetarja e hartuar nga shkrimtari e pedagogu Qamil Batalli 1987-1997, por edhe abetarja e A Deva dhe Islam Krasniqi deri në 2011) duke mbërritur deri te abetarja e përbashkët Shqipëri-Kosovë e autorëve M. Gjokutaj, Sh. Rrokaj, I. Krasniqi, S. Pozhegu e vitit 2012.³⁵⁶

³⁵⁵ Shefik Osmani; Njazi Kazazi, *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*, ShBLSh, Tiranë, 2000.

³⁵⁶ *Abetarja e përbashkët Shqipëri-Kosovë* është e shoqëruar dhe nga *Abetarja e punës*. Abetarja *Shkronjë pas shkronje* përbëhet nga tri pjesë: *Paraabetare*, *Abetare*, *Pasabetare*. Dy abetaret e tjera të viteve të fundit shoqërohen me *Fletore pune*.

Para njësimi të abetares në Kosovën e pavarur, abetarja e autorëve Deva, Krasniqi, shoqërohej me më shumë burime e materiale mësimore: *paraabetarja, abetarja, fletorja e punës fletorja e diktimit (1 dhe 2), abetarja rrotulluese, shkronjëtorja, tabelën magnetografike, CD me animacione, me recitime e lexime artistike të vjershave dhe të teksteve të shkurta, si dhe librin e mësuesit*.³⁵⁷ Kjo abetare është hartuar në harmoni me kërkesat e programit zyrtar të klasës parë dhe në funksion të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit. Është mjaft e kompletuar dhe ka ndryshime pozitive, si në përmbajtje ashtu edhe në aspektin metodologjik dhe anën vizuale, gjë që për fëmijët duket të jetë mjaft atraktive. Kjo Abetare, ka përbrenda të përgjedhura, si: *vjershat, tregimet, gjëgjëzat, vizatimet* dhe situatat e tjera, të gjitha janë në funksion të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit. Për secilin nga tekstet e paraqitura në abetare, paraprakisht jepet qëllimi. Kjo është një përparësi tjetër që nxënësit mësohen të përshkruajnë, duke u mbështetur në vizatime përkatëse, natyrisht në funksion të realizimit të shkronjës përkatëse. Përveç kësaj, procedura shkon nga e përgjithshmja tek e veçanta. Duke përshkruar vizatimin nxënësit krijojnë fjalë, pastaj fjalë ndahet në fjalë, në rrokje dhe në fund mbetet shkronja që do të mësohet. Sipas autorëve, edhe pse fjalë si strukture gjuhësore është më e ndërlikuar, si nocion didaktik- metodik është më e lehtë dhe më e kapshme për fëmijët e kësaj moshe. Gjithashtu ata i referohen edhe programit zyrtar të klasës përkatëse, mirëpo një gjë e tillë nuk është e dukshme në programin zyrtar të klasës së parë.³⁵⁸ Programi i klasës së parë as nuk e pengon dhe as nuk e favorizon një qasje të tillë të mësimi.

Nga të gjitha tekstet e paraqitura në këtë abetare, 10 tekste janë në funksion të shkathtësisë së dëgjimit, 20 tekste janë në funksion të shkathtësisë së leximit, 14 vjersha mësohen përmendësh. Situatat e të folurit janë përfshirë zakonisht në pjesën hyrëse të çdo teksti, duke përshkruar vizatimet, por në tekste të veçanta është më pak e theksuar.³⁵⁹ Nga kjo që u pa në abetare, mundësia për t'i zhvilluar shkathtësitë e komunikimit është mjaft e madhe. Edhe në udhëzuesin metodik për mësimin e abetares – *Librin e mësuesit*, jepen udhëzime për procedurën e zhvillimit të shkronjave, duke caktuar edhe objektivat për secilën pjesë, që në fakt të gjitha janë në funksion të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit e që janë në harmoni me programin mësimor të klasës përkatëse.³⁶⁰ Në lidhje të ngushtë me “*Abetaren*” dhe në funksion të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit, është hartuar edhe para abetarja.

Në funksion të realizimit me sukses të kësaj pakoje të abetares është edhe një fletore pune, e cila jep udhëzime mjaft të mira për të ushtruar drejt shkrimin e shkronjave, përmes shigjetëzave.³⁶¹ Edhe pse, ideja ishte e mirë, realizimi në shkollat e Kosovës, sa ishte në

³⁵⁷ Agim Deva, Islam Krasniqi, Abetare, Dukagjini, Pejë, 2008. (Kjo abetare u shpërnda falas, për të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës, nga Qeveria e vendit)

³⁵⁸ Shih më gjerësisht në Plani dhe programi mësimor, Gjuha shqipe 1, faqe 19 – 27, Prishtinë, 2003.

³⁵⁹ Shkathtësia e të shkruarit përfshihet gjithashtu në secilin tekst, me paraqitjen e detyrave për nxënës, duke shkruar fjalë, nga një për secilin tekst, natyrisht në funksion të realizimit të shkronjës përkatëse. Gjithashtu shkathtësia e shkrimit zhvillohet edhe përmes diktimit, që edhe kjo pjesë është paraqitur në këtë abetare.

³⁶⁰ Libri i mësuesit ishte një udhëzues për mësimdhënësin, ndër të tjera, me rëndësi të veçantë është edhe objektivi që mësuesi tregon shqiptimin model të tingullit të ri, apo edhe të fjalës përkatëse që shtë në funksion të realizimit të tingullit përkatës. Në fakt, nxënësit vijnë me njohuri paraprake nga leksiku dhe gjithashtu me vete sjellin modele të ndryshme të të folurit, variacione të ndryshme të shqiptimit të tingujve dhe të fjalëve, që i kanë mësuar në vende dhe rrethana të ndryshme. Për këtë arsye, mësuesi do të jetë model për nxënësit dhe duhet të ndërhyjë aty ku është nevoja.

³⁶¹ Përmes Fletores së punës, nxënësit ushtrojnë shkathtësinë e të shkruarit. Për realizimin me sukses të përmbajtjes programore janë edhe shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla, përmes së cilave, përveç shkronjave, nxënësit i

përdorim nuk kishte kompjuterë të mjaftueshëm, andaj mundësia për përdorimin praktik të kësaj CD-je ishte e vogël.

Abetarja e parë e përbashkët Kosovë - Shqipëri

Pas një Marrëveshjeje të firmosur në mes dy Ministrive të Arsimit (*Shqipërisë dhe Kosovës*) u shpall konkursi për hartimin e abetares së njehsuar. Kjo për dy arsye, se ishte takim i përhershëm dhe së fundi nga qarqe intelektualësh ishte kërkuar një abetare mbarëshqiptare, që do të përdorej si brenda kufijve dhe në Kosovë, Maqedoni, diasporë. Për realizimin e kësaj ideje ishte shpallur konkurs publik, ku u paraqitën dhjetëra abetare me autorë nga Shqipëria dhe nga Kosova. U arrit një Abetare e përbashkët mes Shqipërisë dhe Kosovës, por pa Maqedoninë. Shtëpitë botuese nga Kosova dhe Shqipëria që kishin dërguar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës versionin e tyre të abetares, u vlerësuan nga një komisionin i posaçëm vlerësues me 10 profesorë të njohur nga të dy vendet. Abetarja e unifikuar do të jetë teksti i parë ligjor mes Shqipërisë dhe Kosovës, botimi i të cilës ka dhe një vlerë simbolike në kuadër të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Abetarja e parë e përbashkët, pas shumë përpjekjesh dhe pas gjakimeve shekullore për të mësuar nga një tekst unik dhe në gjithë trojet ku flitet shqip u arrit në maj të vitit 2012. Abetarja e përbashkët vjen nga grupi i autorëve nga Shqipëria dhe Kosova:

Gjokutaj-Çano, Mimoza; Krasniqi, Islam; Rrokaj, Shezai; Kumnova Pozhegu, Saranda; Abetare për klasën e 1-të të arsimit fillor³⁶² Në vitin 2012, u arrit, për herë të parë, hartimi dhe miratimi zyrtar i Abetares së përbashkët Shqipëri – Kosovë. Kjo abetare u bë e mundur si rezultat i bashkëpunimit mes dy ministrive të arsimit, në kuadrin e përafrimit të programeve dhe teksteve shkollore. Hartimi i Abetares së përbashkët provoi se, edhe kur mungon një program i përbashkët, kapërcehen pengesat për të hartuar një tekst shkollor të përbashkët. Në konkurs kishin arritur dhjetëra tekste abetaresh, por para komisionit për miratimin të Abetares së përbashkët u paraqitën shtatë tekste alternative të kompletuara që plotësonin kriteret formale për garë, prej të cilave vetëm tri vazhduan garën në përputhje me standardet dhe kriteret e përcaktuara në paketën përkatëse. Abetarja e shtëpive botuese “PEGI “(*Shqipëri*) dhe “Dukagjini” (*Kosovë*) dalloi si më e arrira dhe u vlerësua me pikë maksimale.

Komisioni vlerësues ka raportuar se “*Metoda bazë e hartimit të kësaj abetareje është metoda analitiko-sintetike e tingullit, e shoqëruar me metodën mikste.*”³⁶³ Hetohet se, në *Abetaren e përbashkët* kanë gjetur zbatim edhe *metoda globale*, por dhe *metoda të mirëfillta analitike*, si metoda e fjalëve dhe fjalive normale, dhe *metoda të mirëfillta sintetike*, si metoda e tingujve natyralë, *metoda fonetike*, *metoda fonografike* etj. Ndërkaq, renditja e tingujve dhe e shkronjave në këtë Abetare është bërë në bazë të parimeve të metodologjisë bashkëkohore, siç janë: *parimi fonetik* (parimi i vështirësisë së shqiptimit të tingujve), *parimi grafik* (vështirësia e grafike e shkronjave) dhe parimi i dendurisë ose i frekuencës së përdorimit të tingujve në gjuhën e folur dhe të shkruar. Kjo Abetare i përshtatet mirë moshës së 6-vjeçarëve, me nivelin e zhvillimit të kulturës së tyre të folurit dhe me veçoritë shqiptimore të gjuhës sonë në treva të ndryshme dialektore. Është ky një hap i rëndësishëm drejt integritimeve kombëtare, që hap

mësojnë edhe emrat e sendeve dhe objekteve që i shoqërojnë shkronjat, kurse përmes aberates rrotulluese, nxënësit mund të krijojnë rrokje dhe fjalë të ndryshme.

³⁶²Bibliografia e Abetares është mbështetur nga një punim më gjatë i pabotuar i autores Bukurije Haliti, punonjëse në Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë dhe nga pjesa e botuar tek revista “*Mësuesi i Kosovës*”, maj 2012, Prishtinë

³⁶³*Nga Raporti i Komisionit për vlerësimin e teksteve të abetares të Konkursit publik për Abetaren epërbashkët Shqipëri-Kosovë, 2012*”.

shtigje ndërmjet lëndëve shkollore lexim, shkrim, matematikë, arte, shkenca etj. Ajo ka në qendër të vëmendjes universin e fëmijës. Libri “*Abetare*” dhe libri “*Abetare pune*” përmbushin objektivat e mësimi gjithëvjetor. Pasurimi i fjalorit të nxënësve dhe zhvillimi i të folurit të tyre ndihmohen edhe përmes përshkrimit të figurave dhe ilustrimeve të shumta, përmes metodës “Shiko dhe trego çfarë sheh”. Përmes Abetares së punës, nxënësit kryejnë shumë ushtrime gjuhësore për të zbërthyer e përvetësuar Abetaren. Teksti i Abetares së përbashkët është strukturuar në tri pjesë: *Paraabetarja*, e cila mbështetet në metodën fonike, alfabetike dhe globale; *Abetarja*, e cila mbështetet në metodat analitike e sintetike dhe *Pasabetarja*, që është vazhdim i të lexuarit të kuptimshëm.

Abetarja e përbashkët Shqipëri-Kosovë është shembulli më i mirë i bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore, autorëve e botuesve të të dy vendeve. Përvoja me këtë abetare i hap rrugën procesit të përafrimit deri në njësim të programeve mësimore e teksteve shkollore edhe për lëndët e tjera, sidomos të gjuhës shqipe, letërsisë, historisë, gjeografisë etj. Nga 1 shtatori 2012, të gjithë nxënësit e klasave të para në Shqipëri dhe Kosovë nisën të mësojnë të shkruajnë dhe lexojnë shqip nëpërmjet një abetare të përbashkët.

3.5. PROGRAMET, METODIKAT DHE TEKSTET NDIHMËSE PËR ABETARE

3.5.1. Programet e abetareve dhe vendi i mësimi të lexim - shkrimit në planet mësimore

Sipas planeve dhe programeve mësimore në Kosovë, veçanërisht nga viti 1941, mësimi i gjuhës shqipe ishte dhe vazhdon të jetë një nga objektivat parësorë në tërë arsimin e detyruar të shkollës shqipe. Ajo fillon të mësohet në familje, vazhdon më pas në arsimin parashkollor përmes ushtrimeve të të folurit dhe aftësimi të fëmijëve për të lexuar e për të shkruar dhe pasurohet më tej në arsimin fillor, me përvetësimin e aftësive të plota të të lexuarit dhe të shkruarit. Në klasën e parë të shkollës fillore, gjuha shqipe përherë niste të mësohet në mënyrë sistematike përmes të ushtruarit për lexim-shkrimin fillestar. Nxënësit ushtroheshin të lexojnë dhe të shkruajnë gjuhën shqipe përmes nyjetimit (*shqiptimit*) dhe bashkimit të tingujve dhe shkronjave të saj në rrokje e fjalë dhe bashkimit të fjalëve në fjali të thjeshta, por të kuptimshme, nëpërmjet leximit të historive (*rrëfimeve, copëzave, tregimeve*) dhe materialeve të tjera të shkruara, të përgatitura për nxënësit në tekstet shkollore, si dhe në botime të tjera ndihmëse. Mësimi i gjuhës shqipe në klasën e parë fillonte të shfaqet me modelin e gjuhës së shkruar dhe drejtshkrimi i saj. Në klasë të parë, fillojnë të mësohen në mënyrë intuitive nocione gjuhësore, si: *tingulli, rrokja, fjala, fjalia, zanoret, bashkëtingëlloret, shenjat e pikësimit, përdorimi i shkronjës së madhe* etj. Mësimi i lexim-shkrimit fillestar ndiqte një ecure didaktike që lidhet me respektimin e tri fazave:

Faza e parë: Periudha përgatitore për lexim-shkrimin;

Faza e dytë: Fitimi i shprehive elementare të teknikës së lexim-shkrimit;

*Faza e tretë: Përforcimi i teknikës së lexim-shkrimit.*³⁶⁴

Në praktikën e përditshme këto tri faza në periudhën e pasluftës janë emërtuar: *paraabetare, abetare, pasabetare*,³⁶⁵ derisa në praktikën metodike të mëhershme njiheshin me emërtime dhe qëllime paksa më ndryshe si: *periudha përgatitore, mësimi i shkronjave, periudha pas mësimi të shkronjave*.

a. Mësimi i gjuhës shqipe (abetarja) në klasën e parë të arsimit të detyruar 9-vjeçar

Mësimi i gjuhës shqipe (Abetarja) në Kosovë, si kudo përherë synonte aftësimin dhe krijimin e shprehive fillestare të nxënësve për zhvillimin e të folurit, të të lexuarit dhe të shkruarit në gjuhën shqipe. Nëpërmjet programit, i cili tradicionalisht është përcjellë në shkollën e Kosovës me abetaren, si libri i parë shkollor, synohej që të formohen nxënës të aftë si folës, lexues dhe shkruar të gjuhës shqipe, në nivelin e përshtatshëm për moshën e tyre. Kjo ngjan dhe sot në mësimdhënien bashkëkohore ku nxënësi është në qendër.

Synimet e mësimi të shkrim-leximit në mënyrë specifike lidhen me përcaktime shkencore dhe të qarta shkencërisht dhe metokisht. Kështu nëpër programe theksohet se “*Mësimi i gjuhës shqipe (abetarja) në klasën e parë të arsimit të detyruar 9-vjeçar synon të aftësojë dhe të krijojë shprehitë fillestare të nxënësve për zhvillimin e të folurit, të të lexuarit dhe të shkruarit në*

³⁶⁴ Grup autorësh, *Libër për mësuesin “ABETARE”* (Abetare e përbashkët Shqipëri-Kosovë), botues “Pegi” dhe “Dukagjini”, Tiranë, Pejë, 2012, f.6.

gjuhën shqipe. ³⁶⁶ Njëpërmjet programit, i cili tradicionalisht është përcjellë në shkollën tonë me abetaren, si libri i parë shkollor, *synohet që të formohen nxënës të aftë si folës, lexues dhe shkruar të gjuhës shqipe, në nivelin e përshtatshëm për moshën e tyre.* ³⁶⁷

Qëllimi i mësimin të gjuhës shqipe në klasën e parë, tradicionalisht ishte:

- Përvetësimi i shkathtësive për të komunikuar në situata të ndryshme.
- Krijimi i aftësive vetjake për formim gjuhësor e kulturor.
- Përvetësimi i disa normave e gjuhës standarde shqipe.
- Përgatitja e nxënësve për ta përdorur gjuhën në formën e saj standarde gjatë të folurit, të lexuarit dhe shkrimit të saj.
- Përgatitja e nxënësve për ta njohur jetën në pamje të ndryshme të saj.
- Përgatitja e nxënësve për të njohur dhe për të marrë pjesë me emocion dhe gatishmëri për tema të ndryshme me karakter edukativ dhe shoqëror.
- Edukimi dhe motivimi i nxënësve me ndjenjën dhe edukatën e punës, për të mësuar dhe për të nxënë në mënyra dhe forma të ndryshme.

Kështu, përmes gjuhës shqipe dhe lëndëve që rrjedhin prej saj: *abetare, gjuhë e lexim, aftësohen nxënësit për ta përdorur gjuhën shqipe (gjuhën amtare) në nivelin që e kërkon shoqëria sot. Njëpërmjet arteve të gjuhës (të thëna ndryshe edhe fusha studimi apo linja e nënlinja) në shkollën shqipe, në klasën e parë, lënda e gjuhës shqipe(abetarja) synon t'i aftësojë nxënësit:*

- a- për zhvillimin e dëgjimit të vëmendshëm;
- b- për zhvillimin dhe pasurimin e fjalorit dhe të folurit me përpikmëri;
- c- për zhvillimin e të lexuarit dhe të kuptuarit e pjesës që lexon;
- d- për zhvillimin e të shkruarit të gjuhës standarde shqipe.

Duke e veçuar mësimin e gjuhës shqipe nga njëra klasë në tjetrën, synimi i të mësuarit të kësaj lënde në klasë të parë në mënyrë të përmbledhur, është: *Mësimi i gjuhës shqipe në klasën e parë synon t'i aftësojë nxënësit dhe të krijojë shprehitë fillestare që ta flasin, ta lexojnë dhe ta shkruajnë bukur gjuhën shqipe.*

3.5.2. Metodatat e mësimin të abetares

Metodat më të përdorshme për mësimin e lexim-shkrimit fillestar, mbështetur në përvojën bashkëkohore dhe në traditën e shkollës sonë, janë:

1. Metoda sintetike (këtu përfshihen edhe ato fonetike, globale)fonike-alfabetike;
2. Metoda globale “Shiko dhe lexo”;
3. Metoda analitike-sintetike.
4. Metoda mikste. ³⁶⁸

³⁶⁶ Programi i Abetares, Prishtinë, 2004.

³⁶⁷ Po aty.f.12

³⁶⁸ Grup autorësh, *Libër për mësuesin “ABETARE”*(Abetare e përbashkët Shqipëri-Kosovë), botues “Pegi” dhe “Dukagjini”, Tiranë-Pejë, 2012, f.29.

Metoda dëgjimore dhe pamore (*fonike-alfabetike*) lidhet me aftësimin e nxënësve për të shqiptuar dhe për të lexuar drejt tingujt e gjuhës shqipe, duke i lidhur me shkronjën përkatëse. Zakonisht kjo metodë nxit njohjen e veçuar të tingujve dhe të shkronjave.³⁶⁹ Metoda “*Shiko dhe lexo*” (globale) gjatë mësimit të abetares, ishte karakteristike për t’u përdorur në fazën përgatitore, por mund të përdoret edhe në hapat e parë të mësimit të abetares.³⁷⁰ Metoda analitike-sintetike është metoda bazë në të cilin mbështetet mësimi i lexim-shkrimit. Koncepti për këtë metodë lidhet me analizën dhe sintezën e tekstit, të fjalisë, të fjalës, të rrokjes dhe të tingullit. Ashtu si një fëmijë zbrërthen dhe mbërthen një makinë lodër, ashtu duhet të punojë edhe me gjuhën (*tekstin, fjalinë, fjalën, rrokjen, tingullin*). Kjo metodë, e ndërthurur edhe me metodat e tjera, mundëson, për vetë natyrën e gjuhës sonë, arritjen e objektivave të mësipërm dhe një cilësi të mirë të nxënësve në lexim-shkrimin fillestar.

Struktura e Programit të Abetares

Programi i abetares është shumë i rëndësishëm për përfshirjen e nxënësit në veprimtari të nxëni, që lidhen me fitimin e shprehive fillestare për lexim-shkrimin e gjuhës amtare. Për këtë qëllim, që në hapat e tij të parë, mësuesi të përqendrohet në një komunikim të ngrohtë me nxënësit dhe të synojë gjithëpërfshirjen e tyre në përvetësimin e këtij programi.

Faza e parë - Periudha përgatitore, që zakonisht shoqërohet me fletore punë dhe materiale të tjera didaktike me ndikime të drejtpërdrejta të dallueshme për lexim-shkrim, me veprimtari që i shërbejnë mësimit të lexim-shkrimit fillestar në gjuhën shqipe. Kjo periudhë në Kosovë zgjat 4 javë x 7 orë=28 orë.

Faza e dytë - Faza e dytë lidhet me përvetësimin e teknikës së lexim-shkrimit. Ajo zakonisht shoqërohet me tekstin e abetares dhe fletore pune të përshtatshme për këtë tekst. Njëkohësisht, shoqërohet edhe me mjete didaktike që e lehtësojnë mësimin e lexim-shkrimit.

Faza e tretë - Kjo periudhë përforcon shprehitë e lexim-shkrimit fillestar të nxënësve, duke i pajisur ata edhe me njohuri të thjeshta gjuhësore. Ajo shoqërohet me pjesë leximi të shkurtra tërheqëse për moshën dhe me ushtrime gjuhësore.

Metodologjia e zbatimit të këtij programi lidhet ngushtë me veprimtaritë që duhet të udhëheqë mësuesi në bashkëpunim me nxënësit për ta realizuar dhe përvetësuar atë plotësisht. Në përfundim të periudhës së tretë së Pasabetares, nxënësi kërkohej që të jetë në gjendje të lexojë 50-60 fjalë në minutë, të kuptojë dhe të përdorë intonacionin. Madje, për mësuesit e klasave të para rekomandohen disa *veprimtari didaktike*. Programi i ri i abetares këshillon që mësimitdhënia e saj të mbështetet në parimin: “*Mësimdhënie me nxënësin në qendër*”. Për të arritur këtë objektiv metodologjik, këshillohet që gjatë punës mësimore për realizimin e objektivave për

³⁶⁹Si metodë është shumë e rëndësishme në hapat e parë të ushtrimit të nxënësve për lexim-shkrim. Ajo fillon në kopsht dhe mund të shtrihet edhe në fazën përgatitore të mësimit të lexim-shkrimit.

³⁷⁰Është e rëndësishme që gjatë ushtrimit të saj, mësuesi t’i ushtrojë nxënësit për të lexuar e për të shkruar në mënyrë globale fjalë të fjalorit të nevojshëm dhe të domosdoshëm, i cili do t’u duhet nxënësve për të lehtësuar më tej procesin e të lexuarit dhe të shkruarit. Në këtë kuptim, mësuesi mund ta ndërtojë vetë këtë fjalor

lëndën “*Gjuha shqipe 1*” të zbatohen veprimtari të larmishme mësimore, të cilat realizojnë objektiva të caktuar.³⁷¹

3.5.2.1. Metodatat tradicionale të mësimimit të lexim-shkrimit në Kosovë

a. Metoda zanoro- analitiko- sintetike

Metoda zanoro-analitiko-sintetike të zotërimit (*mësimimit të shkronjave dhe lexim-shkrimit*) të abetareve për një kohë të gjatë në Kosovë është përkrahur nga shumë metodicientë dhe nga vetë mësuesit, sepse mendohej se ajo përfshinë të gjitha metodat e lexim-shkrimit fillestar. Wshtw quajtur “*zanore*” se kishte të bëjë me shqiptimin e drejtë të zërave (*tingujve*). Analitike quhej se kishte të bëjë me analizën e tregimit (*përmbajtjes së tekstit*), fjalisë dhe të fjalës; sintetike quhej se bëhej sintheza e tingujve gjatë shqiptimit të ngadalshëm të fjalëve, respektivisht gjatë leximit të nga dalshëm të shkronjave që formojnë një fjalë, apo gjatë shkrimit të shkronjave në fjalë, të fjalëve në fjali dhe të fjalive në tekst.³⁷² Gërshetimi i të gjitha metodave të lexim-shkrimit fillestar, garantonte përgatitjen për lexim të bukur, estetik dhe shkrim të drejtë. Vetëm gërshetimi i metodave analitike dhe sintetike mendohej se do të na përgatisin lexues që kërkonte shkolla bashkëkohëse, prandaj të mos kufizohemi vetëm në një metodë. Metodatat analitike dhe sintetike kërkohej të kenë korrelacion midis tyre dhe të duhet të kenë koncentrimin në metodën zanoro-analitiko-sintetike. Në periudhën e përgatitjes përdorehin të gjitha metodat, por dominonte metoda zanoro-analitiko-sintetike, të cilën e përdorim edhe gjatë zhvillimit të shkronjave. Në fillim zhvillohen biseda të lira, tregime dhe vjersha që u përgjigjen aftësive fiziko-psikike të fëmijëve, çdo bisedë kërkohej të ketë përmbajtje të këndshme, të konkretizohet me fotografi ose me aplikacione, tablo. Prej këtyre tregimeve nxjerrim fjalitë, që janë pjesë e tregimit. Fjalja na njeh me personazhet e tregimit, që janë: njerëz, kafshë apo sende. Kjo bëhej që “...fëmija duhet të kuptojë se mund të shprehë mendimin për çdo objekt, psh: nëna punon, baba lavron, lopa hanë sanë, qeni leh, etj. Por duhet të dimë atë se fjalja nuk është e shkëputur prej një terësie logjike, por është pjesë e saj. Për të kuptuar fjalinë dhe tregimin është e nevojshme që të bëhen sqarime tërë vitin shkollor, por në fazën e përgatitjes duhet t’u kushtojmë së paku tri katër orë.”³⁷³

Prej tregimit, respektivisht fjalisë duhet të ndahet një fjalë. Fjala duhej të jetë një emër i njeriut kafshës apo i sendit, të jetë një prej personazheve të tregimit. Fjala duhej të konkretizohet me vizatim të atij objekti. Tingujt e fjalës, që po i analizojmë, duhej të jenë të lehtë për shqiptim dhe të kenë mundësi zgjatje në të shqiptuar, e të mos jenë tinguj pëlcitës, si: **t, p, k, o** etj.³⁷⁴ Shembull, nëse dëshirohej të dallohej dhe të shqiptohej tingulli “**n**”, mësuesi si fjalë e merrte fjalën *nëna*, paraqesin fotografinë e saj, fëmijët e thonë fjalën duke shqiptuar tingujt ngadalë e duke zgjatur zërin (*nnnëënnnaaa*), në çdo tingull ndalen duke shqiptuar nga tre shkronja. Fëmijët tregojnë se tingulli është “**n**” i pari dhe i treti. Kështu i gjenin fjalët e tjera që kishin këtë tingull në fillim të fjalës, në mes dhe në fund. Si burim për dallimin e disa tingujve, shërbenin

³⁷¹ Kështu, në mënyrë të grupuar këshillohet tw pwrdozen lojëra didaktike që lidhen me lexim-shkrimin, riprodhim pjesësh (ritregim kuptimi të pjesëve të dëgjuara, ritregim kuptimi të pjesëve të lexuara.) dhe lojëra me lëndën gjuhësore të lexuar në tekst (Vendos titull tjetër, krijon një fillim dhe / ose një fund të ri.)

³⁷² “Udhëzime metodike, Revista pedagogjike “Shkëndija” - nr. 1, më 1 janar 1978.

³⁷³ Po aty.

³⁷⁴ Gjatë të shqiptuarit duhej të hetohej tingulli që kërkohet. Fjala, e cila përmban tingullin që dëshirojmë ta dallojmë duhet të konkretizohet me objekte ose fotografi dhe shenjat që i zëvendësojnë tingujt.

edhe zërat normal që lëshojnë njerëzit: bariu thërret:ooo, kur mjeku, vëren fytin, lëshohet tingulli AAAA, por për të qenë më i qartë, mësuesi e tregon shembullin e parë duke paraqitur një objekt të vizatuar. Nxënësi e thoshte emrin e atij objekti, dallonte tingullin (o, a, i).³⁷⁵ Duke treguar se ku ndodhej ai tingull (në fillim, në mes dhe në fund).³⁷⁶ Mendohej se duhet t'u bashkangjitej mendimeve të disa metodicienëve që fjalë të lexohej në atë mënyrë që të bëhej shkrimi e tingujve në fjalë, duke dalluar çdo tingull të asaj fjale, e kjo mënyrë në fazën e parë të leximit (kur i mësojnë dhjetë shkronja), do të ishte si urë kalimtare dhe bazë e leximit më të shpejtë teknik. Kur fëmija e hetonte tingullin, kërkohet që ta vërejnë njeri-tjetrin se çfarë pozite marrin organet e të folurit gjatë shqiptimit të atij tingulli. Vëtem të shqiptuarit prej mësuesit nuk mjaftonte. Kishte fëmijë që akustika e tij don të ndiejë edhe ngjyrën e zërit të shokut të vet, që do të thotë se duhej të bëheshin ushtrime të kombinuara. Paraqitja grafike e fjalëve ndihmonte në vënien e bazës për lexim,pasi aty do të bëhet sinteza e fjalëve dhe e fjalive.³⁷⁷ Figurativisht disa metodistë, "tregimin e paraqesin me dru të madh, fjalinë me degë më të trasha, fjalën e tingujt me degë më të holla."³⁷⁸ Kjo mënyrë e paraqitjes nuk është e drejtë përdoret vetëm në sintezë.Mënyra më e mirë që ka vërtetuar praktika, ishte kur "tregimi paraqitet me shumë vija,fjala me dy tri vija, fjala me një vijë të shkurtër, tingujt me pika. Tingullin që e kërkojmë, e paraqesin me pikë që ka ngjyrë tjetër."³⁷⁹ Sipas kësaj metode, mënyra e paraqitjes grafike bën që fëmija të njihet me tërësin logjike (tregimin), me një „skenë” të asaj tërësie logjike (fjalia),me emër që është në personazhin e tregimit (fjala) dhe me elementet e fjalës (tingujt). Por, kujdes i posaçëm duhet kushtuar në atë që„leximi” të jetë në formë të këndimit dhe të shqiptojmë të drejt të çdo fjale, hetimi i tingullit që e kërkojmë dhe e tregojnë se ku gjindet me radhë (në fillim, ne ,mes apo në fund të fjalës) – hetimi i atyre tingujvet në fjalët e ndryshme, - vërejtja e organevet të gojës gjatë shqiptimit të tingujve, --sintezë e tingujve të paraqitur me fjalë dhe numri i tyre.Në periodën e përgatitjes bëhej analiza dhe sintezë e dhjetë tingujtve të parë të paraqitur në abetare. Metoda zanoro-analitiko-sintetike, e cila përdorej në periodën e përgatitjes, mbështetej vetëm në parafytyrimet akustike dhe pjesërisht në parafytyrimin vizuel (kur të paraqitet grafikisht), çdo tingull duhet ta shqiptojmë aq kohë sa ka zgjatur shqiptimi i tingullit të parë, përndryshe nuk do të kemi parafytyrime të drejta.³⁸⁰ Përkitazi me zgjedhjen e metodave janë bërë shumë konsultime dhe diskutime. Secili metodist mundohet dhe e arsyeton njërin apo tjetrin metodë dhe për piqet t'ia përshtasë natyrës së gjuhës për të cilën është fjala. Disa metodistë janë nisur nga tingujt, gjegjësisht shkronjat. Me to kanë formuar rrokje, fjalë, fjali dhe tregime (tekste), kurse të tjerët janë nisur nga teksti i tërë duke analizuar në fjali dhe tinguj, gjegjësisht në shkronja. Të parët kanë qenë sintetikët, kurse të dytët analitikët. Në studimet e didaktikës

³⁷⁵Sadik Ukella, Diskutim në "Trueza e Shkëndies",i botuar te Shkwndija",nr. 18 ,më 1 nëntor 1977 .

(Ky autor kishte konstruktuar mjetin mësimor të emërtuar Racionalizator, brenda të cilit ishin qindra ilustrime,mjete e figura për konkretizimin e mësimit të shkrim-leximit. Racionalizatori, si mjet mësimor për disa dekada gjeti përdorim të gjerë në Kosovë.)

³⁷⁶Kjo praktikohet sipas përvojës shumëvjeçare dhe eksperimenteve të bëra në Pejë (1964, 65, 66, 67, 68 dhe 1969), ndarja e fjalëve në rrokje nuk është e mirë ,pasi ekziston rreziku që nxënësit të lexojnë në rrokje.

³⁷⁷ Për model analize është marrë puna e lexim-shkrimit në klasën e parë, sipas Abetares së autorit Mehmedali Hoxha e vitit 1978.

³⁷⁸“Udhëzime metodike”, Revista pedagogjike “Shkëndija” - nr. 1 ,më 1 janar 1978.

³⁷⁹ Po aty.

³⁸⁰Në klasat eksperimentale ishte vërtetuar edhe ky moment : mësuesi kërkoi që nxënësi të shkruajë fjalën Moni, fëmija e shkroi në tabelë: (.o.i), kur e pyeti mësuesi pse i ka vënë pikat, të gjithë nxënësit u përgjigjen se ato zëvendësojnë një tingull, shenjën e të cilit nuk e kemi mësuar.

jugosllave, përkitazi me metodat e lexim shkrimit fillestar dallohej dr.Muhamed Muratbegoviqit (1968), tek i cili gjejmë një klasifikim të këtillë të metodave:

1. **Metoda zanoro-analitiko-sintetike** në mënyrën monografike në zhvillimin e shkronjave grup, e cila e bashkangjet analizon zanoren në fazën e përgatitjes për lexim, tingujt përvetësohen grup, duke i indentifikuar me shenja grafike-shkronja.
2. **Metoda globale**
3. **Mënyra komplekse në përvetësimin e shkronjave dhe të leximit**³⁸¹.

Gërshetimi i këtyre metodave garantonte shumëllojshmërinë në punë, i aktivizon nxënësit, vjen në shprehje puna kreative e mësuesit dhe e nxënësit, etj.

3.5.2.2. Metodatat sintetike të mësimit të shkrim-leximit fillestar

a) Metoda zanore. Kjo metodë është shumë e vjetër, qe viteve të shtatëdhjeta gjenë përdorim në shkollat e Kosovës dhe një numër i mirë i mësuesve e përdorinin. Si element i kësaj metode mund të përdoret shqiptimi i zanoreve. Shqiptimin mund ta bëjnë të gjithë fëmijët dhe ta dëgjojnë prej secilit shok. Pastaj me shqyptimin e tingujve në formë të këndimit e bëjnë leximin e fjalëve të shkurta, por duhet të kemi kujdes që fëmijët të mos e zgjasin shumë zërin në formë të këndimit, ngaqë mund ta deformojnë fjalën, pastaj të mos përdoret pasi të zhvillohen dhjetë shkronja, sepse nuk ka nevojë të bëhet sinteza e ngadalshme e tingujve.

b)Metoda fonetike. Kjo metodë gjen përdorim gjatë zhvillimit të të gjitha shkronjave. , “Procesi i përvetësimit të të shqiptuarit të drejtë të tyre është i varur nga konkretizimi i pozitës së gojës gjatë kohës kur kryhet shqiptimi i tyre. Për këtë arsye fotografitë e pozitës së gojës kur shqiptohet zanorja e shqipes lujnë rol të rëndësishëm...” Kjo metodë përdoret në fazën e përgatitjes dhe kur të zhvillohen shkronjat e shtypit dhe të shkrimit. Fëmijët duhet të njihen me disa elemente të fonetikës. Ai e mendon pozitën e organeve të gojës gjatë zhvillimit të shkronjës, gjegjësisht të tingullit. Për këtë fëmija kupton se për 36 tinguj, goja merr tridhjetë e gjashtë pozita të ndryshme. Këto pozita të pjesëve të gojës duhet t’ i shohin dhe t’i përdorin vetë.³⁸² Puna kreative dhe aftësitë pedagogjiko-metodike të mësuesit bëjnë të mundshme që fëmija të njihet dhe t’i dallojë këta tinguj dhe këto shkronja duke angazhuar tri parafytyrimet akustike, motorike dhe vizuale, nuk duhet të harrojmë se të gjitha elementet e kësaj metode nuk do t’i marrim si kryesore.

c) Metoda e zëreve normal. Kjo metodë është përdorur për të gjitha zanoret dhe bashkëtinglloret, për këtë edhe nuk ka pasur sukses. Metodistët i kanë marrë zëret dhe bashkëtinglloret që kanë lëshuar njerëzit dhe kafshët, por sa do që themi se bleta zukatë zz zz nuk i përgjigjet të folurit të njeriut, për këtë nuk mund të llogarismi se britmat e kafshëve janë zëre

³⁸¹Sadik Ukella, “Udhëzime metodike ,revista pedagogjike,, Shkwndija” ,nr. 21,më 15 dhjetor 1977 .

³⁸²Plani dhe programi vënte si detyrë që të aftësojmë në shqiptimin e drejtë të tingujve Ç, Q, DH, TH, LL, etj. Këta tinguj nuk mund t’ i shqiptojnë drejt as njerëzit e rritur-të cilët nuk kanë pasur kujdes që këtë ta mësojnë në shkollimin e ulët.

normale.³⁸³ Për shembull nëse e përdorim shprehjen e dhembjes, atëherë duhet të kemi qëllimin edukativ. Është mjaft keq nëse duam të nxjerrim tingullin *uuuu* duke krijuar frikë, urrejtje apo ndjenja negative, si hakmarrje etj.³⁸⁴ Kur fëmija e sheh bariun e di se për ta thirrur shokun, duhet të përdoret pasthurma e zgjatur *oooo*. Një ndër shkronjat që mund të zhvillohet me metodën e zërave normale është edhe shkronja, “Ë”.

ç) **Metoda fonografike.** Përkitazi me metodat sintetike duhet të cekim edhe këtë metodë, e cila është përdorur para sa vjetësh. Elementet e saj na paraqiten edhe tani në Abetaret më të reja. Kjo vjen në shprehje kur formën e shkronjës e lidhim me një objekt të ngjashëm. Psh. Shkronjën “A” e krahasojmë me shkallët, shkronjën “O” si rrota apo buzët, për shkronjën “Ë” janë marrë dy pika loti, etj.

d) **Metoda e interjekcionit**³⁸⁵ Kjo metodë është rezultat i dy metodave: zërave normale dhe të asaj fonomimike. Kjo preferon që gjatë zhvillimit të një shkronje të lëshohet zëri që e përfaqëson shkronja, por njëherit edhe e bëjmë lëvizjen e një pjese të trupit, për të mundësuar dhënien e formës së një shkronje. Kjo mund të përdoret vetëm për disa shkronja, në raste kur duam të zhdukim monotoninë në mësim, prandaj mund ta përdorim në rastet e veçanta, kur duam të japim konceptin e shkronjës, “F”, në një herit e mbajmë trupin drejt dhe themi se era frynë *ffff*, kur të japim formën e shkronjës F të madhe të shtypit njëherë dorë e zgjasim më shumë e tjetrën më pak. Këto metoda janë dialektikisht të lidhura në mes tyre dhe me metodat analitike dhe atë zanoro-analitiko-sintetike.

3.5.2.3. Metodat analitike të mësimin të shkrim- leximit fillestar

Gjatë procesit mësimor mësuesit bazoheshin edhe në analizën e lëndës që është objekt mësimi, në veçanti në këtë klasë ka diçka specifike. Fjala është element i të folurit me të cilën duhet të fillojmë mësimin fillestar të lexim-shkrimit. *Tash e gjithmonë ka qenë pyetje e madhe në literaturën pedagogjiko-metodike se çka duhet të analizojmë? Çka mund të jetë e qartë për fëmijët e klasës së parë? Si mund të bëhet e qartë ajo që duhet të mësohet? Mendimet e pedagogëve dhe të metodicientëve, e sidomos të psikologëve, janë të shumta, disa nisen nga tregimi, duke analizuar çdo element të gjuhës dhe duke pasur parasysh disa aspekte: se fëmija mund të kuptojë çdo gjë që sheh dhe ndjen (secili metodist e arsyeton mendimin e vet dhe e mbron me të drejtë apo pa të drejtë). Sipas mendimit të metodistëve përkitazi me analizën³⁸⁶ hetohen disa mendime të rëndësishme teorike. Në pjesën e dytë të orës bëhej analiza e fjalive e*

³⁸³ Sipas kësaj metode tingujt mund të hetohen në fjalët e thjeshta që i thoshte mësuesi, prandaj kalohej në analizën e fjalëve e gjatë leximit të ngadalshëm i sintetizon, se kjo metodë është më e përsosur se ato që u përmendën, zëri normal është shprehja e një veprimtarie që manifestohet në kryerjen e një detyre që imponohet prej së jashtëmi. Njeriu që lëshon një tingull, është i detyruar prej diçkahit. Tingullin e lëshon nga dhembja e shkaktuar nga jashtë apo nga kërkesa e organizmit, lëshimi i zërave është çfaqje ndjenjash të mbrendshme, gëzim, dhembje, frikë, urrejtje, dëshirë hakmarrje, etj. Mësuesi duhet të ketë kujdes që fëmija të përjetojë atë që të mbështetet në emocionet pozitive, prandaj më mirë është që protagonist që shpreh atë tingull të jetë i gëzuar, të shprehë dashurinë

³⁸⁴ “Disa Udhëzime metodike për përdorimin e Abetarës”, në “Shkëndija”, nr.17, Prishtinë, më 15 tetor 1977.

³⁸⁵ Këtë metodë e mbronte autori kroat Tone Perushka në librin e vet dhe si e tillë ishte përfshirë në përdorim edhe në shkollat e Kosovës.

³⁸⁶ “Disa Udhëzime metodike për përdorimin e Abetares”, në “Shkëndija”, nr.17, Prishtinë, më 15 tetor 1977.

fjalëve në tinguj dhe duke sintetizuar prej tingujve në fjalë, fjali e thënia e shumë fjalivet sjellte deri te koncepti i tregimit.

Metodat analitike, të cilat i përdorim në procesin mësimor janë:

a) Metoda e tekstit ose e Jocotit. Edhe pse ashtu po e quajmë nuk është tekstualisht e tillë sikurse e ka paraqitur Jocoti. Kjo duhet të kuptohet me një përmbajtje tjetër, për çdo tingull apo shkronjë të re që mësohet kërkohet të gjendet në brendinë e tekstit të abetares, ai tekst është hartuar me qëllim që të përdoret më së shumti ai tingull respektivisht shkronjë. Nëse është teksti edhe me dy fjalë, është një tregim i shkurtër që na e paraqet të tërësishme. Ajo tërsi foljore përbën në vete: fjali, fjalë dhe tinguj.

b) Metoda e fjalive normale. Kjo është metodë mjaft e mirë atëherë kur mësuesi kërkon të thellojë në njohuritë për fjalinë, të cilën e nxjerrin prej tërësisë (*tregimit*). Pavarësisht prej fjalive që ka në tekst, mësuesi mund të krijojë fjali në lidhje me protagonistët e tregimit. Fjalitë duhet të jenë të thjeshta: *Isa luan. Isa mëson...* etj. Nëse duam të zhvillojmë shkronjën , “S” si tingull përsëritet në fjalët e fjalive. I numërojnë tingujt “S” në fjalët e paraqitura, por para se thonë fjalinë, i numërojnë fjalët, ato fjalë i analizojnë në tinguj, hetojnë tingullin e ri, me atë tingull gjejnë fjalë të tjera, me të cilat prapë formojnë fjali. Paraqesin një fjali të shkruar. Fëmijët e dallojnë shkronjën e re në fjalët e saj. Shkronja e re mund të jetë në fillim të fjalës së parë, në mes apo në fund të fjalës së dytë etj. E shkruajnë në tabelë... Me shkronja e krijojnë në tabelë... Me shkronja e krijojnë në hapsirën e shkronjëtores të Racionalizatorit , “SU”-1. Kjo metodë mund të përdoret pasi të jenë zhvilluar dhjetë shkronjat e para, kur mund të krijohen fjali me dy fjalë.

c) Metoda e fjalëve normale. Thelbi i metodës së fjalëve norma le qëndron në atë se për zhvillimin e tingujve dhe të shkronjave merret fjala. Si fjalë normale mund të jetë një emër që tregon personazhet, më të dalluar të ngjarjes, respektivisht të tregimit. Fjala normale duhet të jetë më e afërt, më konkrete dhe më e kuptueshme për fëmijë. Ajo përfaqëson një njeri, një kafshë, apo diçka, që njihet dhe kuptohet lehtë prej fëmijës. Fjala normale është simbol i ngjarjes së konkretizuar me aplikacione, tablo etj.³⁸⁷

ç) Ushtrime të tjera analitike- sintetike

*“Kultura gjuhësore e nxënësit të shkollës fillore si dhe përparimi i tij në këtë drejtim. Në rradhë të parë manifestohet me anë të shprehurit ne gojë-gjuhës së folur e pastaj ane me anë të të shprehurit me shkrim. Dihet mirëfilli se të shprehurit me shkrim është superstrukturë e të shprehurit me gojë. Prandaj kjo varet së sa nxënësit është aftësuar në të shprehurit me gojë. Aftësia e të shprehurit me gojë në shkollat fillore ka dhe rëndësinë e saj të veçantë, sepse nxënësi me anë të gjuhës së folur mëson mësimet tjera.”*³⁸⁸ konkludonte Mehmet Gjevori, njëri ndër pedagogët e parë të ardhur nga Elbasani për të shpërndarë shkronjat shqipe në territorin e Kosovës, i njohur edhe si hartues abetaresh e tekstesh mësimore. Nxënësit gjatë komunikimit, si në procesin mësimor si jashtë tij, nuk kanë fituar akoma aftësinë e të shprehurit të lirë, të shprehurit të bukur e të drejtë as të atyre njohurive që i kanë të njohura. Shumë nxënës nuk janë

³⁸⁷Nga diskutimi i pedagogut inovator Sadik Ukella, te “Trueza e Shkëndijës”, në “Shkëndija”, nr.18, 1 nëntor 1977.

³⁸⁸Mehmet Gjevori, “Shkrim-leximi fillestar në kl. I”, në “Shkëndija” nr. 15-16, Prishtinë, më 1 nëntor 1975 .

në gjendje të formojnë fjali të drejta rreth një mendimi, rreth një ngjarjeje të përjetuar etj. Edhe fondin e fjalorit e kanë të cekët, duke përshkruar një ndodhi përdorin shumë lokalizma.

3.5.3. Disa aspekte të praktikave didaktike tradicionale për përdorimin e abetares

Nga të gjitha mësimet që zhvilloheshin në shkollën fillore me rëndësi të veçantë pa dyshim është mësimi i gjuhës amnore e në suazë të kësaj lëndeje *Puna e lexim-shkrimit në klasën e parë*. Duke analizuar punën me *Abetaren*, e autorit Mehmedali Hoxha, në shtypin pedagogjik të kohës vërehet se janë botuar udhëzime metodike për përdorimin e saj. Në botimet e kohës pas kohshme është prezantuar i tërë procesi i punës me e përpunimit të shkronjave dhe të teksteve të leximit,³⁸⁹ i cili pasqyron mënyrën e mësimdhënies së këtyre viteve në Kosovë.

-Periudha e përpunimit të shkronjave, teksteve, në abetare

Kjo periudhë e punës me abetare, dallohet prej periudhës përgaditore për nga zgjatja e intervalit të kohës, të qëllimeve të procesit të punës, ngase në këtë periudhë lypset realizuar këto komponentë: *përpunimin e ilustrimeve të tekstit, përpunimin e shkronjës së re- të panjohur, përpunimin e copave të leximit që gjendet në tekst si dhe ushtrime shkrimi me nxënës*.³⁹⁰ Metodika bashkëkohëse e viteve shtatëdhjetë e lexim-shkrimit fillestar si dhe vetë Abetarja parashtronin këto çështje:

- a) *mënyrat e përvetësimit të shkronjave,*
- b) *renditja e përpunimit të shkronjave në tekst,*
- c) *ecuria e orës mësimore kur përpunojmë ilustrimin e tekstit, kur përpunojmë shkronjën e re dhe kur përpunojmë tekstin e ri- copën e leximit me karakter letrar-artistik, popullor-zbavitës si dhe instruktiv- shkencor.*

Thelbësore në përpunimin e shkronjave, duke u bazuar në veçoritë përvetësimit të shkronjave nga nxënësit e klasës së parë, në procesin e punës ishte përdorimi i mënyrës apo metodës monografike ose metodën paralele të përpunimit të shkronjave. *Metoda monografike* preferonte që përvetësimi i shkronjave nga nxënësit të bëhen me një rend- plan pune që nga fillimi e deri në fund, konkretisht përpunimi i shkronjave nga mësuesi të bëhet veçmas për secilën shkronjë. Kështu, çdo nxënës duhet të punojë-mësojë sipas planit të mësuesit mbi përpunimin e shkronjave, duke mësuar shkronjë pas shkronje veçmas.³⁹¹

Çështjet esenciale që e përbëjnë këtë metodë, janë:

- a) *dhënia e konceptit fjalë,*
- b) *dhënia e konceptit tingull,*
- c) *ushtrimet sintetike të tingujve në fjalë.*

³⁸⁹“Disa Udhëzime metodike për përdorimin e Abetares”, botuar në revistën pedagogjike “Shkëndija”, nr.17, Prishtinë, më 15 tetor 1977.

³⁹⁰Për t’i realizuar të gjitha këto komponente lypset ditur çështjet teorike nga Metodika e gjuhës shqipe, se cila janë çështjet thelbore të punës me abetare në përvetësimin e shkronjave, respektivisht leximit nga filloristët e parë.

³⁹¹“Disa Udhëzime metodike për përdorimin e Abetares”, në “Shkëndija”, nr.17, Prishtinë, më 15 tetor 1977.

Ushtrimet sintetike të tingujve në fjalë janë si çështje e dytë e përgatitjes së përvetësimit të shkronjave nga filloristi i parë.

Kur sinteza e tingujve jep bazën e saj, me siguri kjo fitohet përmes ushtrimeve sintetike të tyre. Sipas metodës monografike, sinteza e tingujve bëhet kështu:

a) *Sintezat e tingullit lidhet me shenjat grafike-shkronjën, në fillim, në formimin e fjalës, kurse më vonë në formimin e fjalisë.*

b) *Koha e përvetësimit të shkronjave e renditja e përpunimit të shkronjave në tekst.*

Për dallim prej mënyrave apo metodave të tjera, konkretisht metodës analitike - sintetike zanore, metodës komplekse, metoda monografike preferon që koha e përpunimit si dhe e përvetësimit të shkronjave që janë të prezentuara në tekst—abetaren e re, të zgjasë brenda 4 muaj, ose 16 javë, ose 96 ditësh.³⁹² *Grupimi i shkronjave në tekst—abetare*, ka disa veçori: se të gjitha shkronjat (36) janë të ndara në tri grupe:

Grupi I – 8 shkronja (A, I, O, M, U, N, E, H),

Grupi II—7 shkronja (R, L, Ë, K, T, P B),

Grupi III—21 shkronja (RR, S, SH, V, LL, D, F, Q, C, ç, G, NJ, Y, TH, DH, Z, XH, ZH, GJ).

Në literaturën e metodikës të mësimin të lexim-shkrimit fillestar në renditjen e shkronjave janë dhënë shumë drejtime, mirëpo po aq konfrontime ekzistojnë midis tyre në mospajtshmëri.

Ecuria e orës kur përpunojmë shkronjën e re

Kjo ishte dhe është njëra ndër kërkesat më të mëdha në periudhën e dytë të punës me abetare. Ecuria e orës në përpunimin e shkronjës së re, ecën gradualisht me ecurinë e orës në përpunimin e copave të leximit, respektivisht pasi të përpunohen 3 shkronja. Kësaj çështjeje, duhet kushtuar kujdes që në fillim. Fazat e ecurisë së orës kur përpunojmë shkronjën e re të detalizohen më tepër, t'u jepet interval kohe më i gjatë. Kështu, për javën e tretë dhe të katërt të muajit shtator, zhvilloheshin vetëm nga 2 shkronja, ose për secilën shkronjë kur përpunohej, të kemi në dispozicion 3 orë të plota mësimore. Kurse muajt e tjerë, gjegjësisht tetor, nëntor, dhjetor e janar koha e përpunimit të shkronjave gradualisht fillonte të rritej, që të thotë paralel me përvetësimin e tyre rritet edhe numri i përpunimit të shkronjave brenda javës në 3 ose 4 shkronja. Një gjë të tillë e cilëson edhe plani orientues i njësive mësimore nga gjuha amare. Kur përpunohej shkronja e re tradicionalisht punohej sipas këtij modeli të ecurisë së orës mësimore:

Si duhet të jepet ideja - kuptimi i shkronjës, fazat:

a) *hyrja,*

b) *të vërejturit,*

c) *të nxjerrurit e zërit,*

³⁹²Kështu, sipas kësaj dinamike planifikohej që përpunimi i shkronjave fillonte në javën e tretë të muajit shtator e të përfundonte në javën e dytë të muajit janar të vitit të ri kalendarik.

d)ushtrime,

Si duhet të përpunohet shkronja e re-fazat:

a)hyrja,

b) të kërkuarit e zërit apo koncepti i tingullit të ri,

c)pozita e gojës kur shqiptojmë tingullin e ri,

d) të kërkuarit e tingullit të ri në fjalë,

e) kalimi në shkronjë që e përbëjnë: pamja grafike e shkronjës, përbërja e shkronjës si dhe mënyra e të shkruarit të shkronjës së re.³⁹³

3.5.4. Plani dhe Programi mësimor për gjuhën shqipe, për klasën e parë në shkollat fillore (1973)

Mësimdhënësit e Kosovës, duke respektuar Planin dhe Programin mësimor për gjuhën shqipe, për shkollat fillore për vitin 1973, dhe në bazë të *Abetares* (së re) autor: Mehmet Gjevori, *Libër leximi Guxo-* për klasën e parë të shkollës fillore, autor Rexhep Hoxha, *Libër leximi për klasën e parë të shkollës fillore*, autor: Beqir Kastrati, Shefqet Veliu e Mehmet Gjevori, *Fletore pune e gjuhës shqipe për klasën e parë të shkollës fillore*, autor: Nadire Dida dhe të *revistave, gazetave fletushkave për fëmijë* e duke parë nevojën për një punë të harmonizuar fillimisht bënëin shkoqitjen e planit orientues për lëndën mësimore Gjuha shqipe të klasës parë fillore. Në shtypin pedagogjik të kohës dhe në arkivat komunale gjendet i botuar dhe i pabotuar një vistër udhëzimesh e planesh orientuese. Që plani dhe programi i gjuhës shqipe të kësaj kohe të kuptohet e përvetësohet dhe përpunohej mirë nga mësuesi i klasës, atëherë kërkohej që mësuesi t'i kuptonte këto udhëzime:³⁹⁴

1. Për format e gjuhës së shkruar, si: kopjim, diktim e hartim i lirë me nxënës t'i praktikojmë fletore shkrimi me vijë të ngushta e laps të zi. Kursesi mos të përdoret lapsi kimik apo fletorja me vija të gjera.
2. Pas zhvillimit të grupit të dytë të shkronjave që janë mbarështruar në Abetare, respektivisht pas zhvillimit të shkronjës "LL" të fillohet gradualisht mënjanimi i përdorimit të gomës shlyes të nxënësit.
3. Që edhe teksti i shkruar me shkronja shtypi në Abetare nga nxënësit e klasës në disa raste apo sipas planifikimit të mësuesit të kupjohet nga ai tekstualisht me shkronja dore.
4. Për të pasur sukses të dalluar në punën mësimore-edukative nga lënda e gjuhës shqipe në klasë të parë, mësuesi i klasës është i obliguar që të posedon pos librit të parë të fëmisë, Abetares edhe me tekste tjera për lexim. Pa të ai kursesi nuk mund të jetë në gjendje të realizojë planin orientues nga gjuha e jonë për klasën e parë fillore.

³⁹³Besim Dyla, "Praktikë shkollore" në "Shkëndija" nr. 15—16, f.20, Prishtinë, më 1 nëntor, 1975.

³⁹⁴"Disa Udhëzime metodike për përdorimin e Abetarës", në "Shkëndija", nr.17, Prishtinë, më 15 tetor, 1977.

5. Mësimi i paraabetares random të zgjasë 4-5 javë.
6. Që periudha e zhvillimit të shkronjave të zgjasë prej muajit tetor 1975 e deri në mbarim të muajit mars 1976.
7. Mësuesi i klasës i detyrohet që të pasurojë bibliotekën e nxënësve sipas listës së literaturës së përcatuar dhe këto të shfrytëzohen sistematikisht nga nxënësit e klasës.
8. Nga mësuesi i klasës të respektohet numri i fondit të orëve mësimore të përcaktuara për tema apo njësitë mësimore qoftë brenda një jave apo tërë muajit.
9. Në orët mësimore, ushtrime: kopjim, diktim apo hartim i lirë, mësuesi shfrytëzon përveç fletoreve të nxënësve edhe tekstin *Fletorja e punës e gjuhës shqipe*. Këto mund të jepen qoftë për detyra klase apo shtëpie.
10. Mësuesi duhet pasur kujdes të duhur në zhvillimin e shkronjave të grupit të parë e veçanërisht të tri shkronjave të para, si: “A”, “M” e “I” dhe shkronjave dyshe, si: “TH”, , “DHE”, “SH”, “LL”, “XH”, etj.
11. Shkronja “NJ”, sipas planit orientues dhe të Abetares është planifikuar të zhvillohet në javën e dytë të muajit shkurt. Kjo mënyrë e zhvillimit nuk i përgjigjet mësimin të rastit, bie fjala, kur është festa e Një Majit të zhvillohet edhe shkronja , “Nj”. Mirëpo, për shkak të nevojës së rritjes së kohës së zhvillimit të shkronjave dhe të shfrytëzimit të plotë të Librave të leximit që të veprojmë në këtë mënyrë, dhe besojmë se do të kemi mirëkuptim nga ju për këtë.
12. Për punën mësimore edukative nga gjuha jonë, menjëherë pas mbarimit të zhvillimit të shkronjave, respektivisht në fillim të muajit prill, tekstin—Abetaren nuk e praktikon dhe kështu vendin e saj e zënë dy librat e leximit për klasë të parë fillore, teksti Fletorja e punës, dhe revistat, fletushkat për fëmijë. Zgjedhja e copave të leximit për nxënës bëhet me literaturë përkatëse por duke u bazuar në kërkesat e metodikës së gjuhës shqipe, në aftësitë intelektuale dhe psikikë –fizike të nxënësve.
13. Për shkak të orëve të përcaktuara me plan të pamjaftuar e për shkak të literaturës së gjerë nga gjuha jonë, nuk kemi pasur mundësi që të planifikohen për përpunimin e të gjitha copave të leximit të parapara në Libër leximi (të dyja).
14. Nga faqet e fundit të abetares, që nga faqja 54 e saj e deri në fund për çdo shkronjë janë paraparë edhe nga 2 copa të leximit për përpunim. Këto për nga volumi e gjerësia e tyre janë tepër të mëdha për nxënës për përvetësimin e tyre brenda një ore mësimore. Mësuesit të klasës kjo i lihet në dispozicion të veprimi sipas arsyes.

Reflektimi i përmbajtjeve të Abetares në formësimin atdhetar të nxënësve

Për të pasqyruar disa dimensione të reflektimit drejtëpërdrejtë në formësimin (*arsimimin dhe edukimin*) atdhetar të nxënësve të klasëve të para po marrim për analizë tekstin “*Abetarja*”, e autorit Mehmet Gjevori,³⁹⁵ hartuesit të abetarës së parë në Kosovë, e cila ishte në përdorim gjatë vitit shkollor 1974/75. Në këtë Abetare nga faqja 5-16 përfshihen ilustrime dhe është karakteristikë se asnjë prej tyre nuk shpreh ndonjë element me porosi dhe vlerë kombëtare. Në mesin e 77 njësive të përfshira në këtë abetare, si teksti i psarë mësimor, vetëm dy nga ato janë më përmbajtje kombëtare: “*Festa*” (fq.39), ku në ilustrim paraqitet edhe flamuri kombëtar por krahas atij qendron edhe ai ish-jugosllav dhe poezia “*Vendlindja ime*”, që i kushtohet vendit të lindjes dhe gjithë ambientit që ndërlihet me të:³⁹⁶

“*E dua vendin ku kam lindur,
E dua djepin ku jam rritur*”
(*Vendlindja, f.69*).

Nese mendohet për ideologjinë dhe për përpjekjen e “*ndërtimit të ndjenjës së patriotizmit jugosllav*” në këtë Abetare, gjithashtu, janë përfshirë edhe 4 njësi që janë në frymën e ideologjisë politike të kohës, (“*Armata*”, fq.61. “*Pionerët*”, fq.96). Për nxënësit e klasës së parë në Kosovë, nga viti shkollor 1977/78 deri 1981/82 në përdorim ka qenë Abetarja e autorit Mehmedali Hoxha.³⁹⁷ Është interesant “*autocenzura*” e autorëve të këtyre teksteve, siç ngjanë edhe me këtë Abetare, e cila nga faqja 5-16, përmban ilustrime dhe asnjëra prej tyre nuk pasqyron ndonjë aspekt që do të reflektonte në zgjimin, ndërtimin dhe ngritjen e vetëdijes kombëtare, krahas ilustrimeve që shprehin aspekte nga puna, mjetet jetësore, shkolla etj. Siç ishte traditë për vendet socialiste e diktatoriale, në këto tekste vend të posaçëm ju kushtohet “*madhërimin*” të “*vlerave*” ideo-politike, si: *flamuri me yll, çekan e drapër* (fq.14), *ylli i kuq* (fq.15). Po ashtu në këtë tekst të abetares janë dhënë edhe katër njësi (*dy prej të cilave përcillen me fotografi*) që shëmbëlajnë kultin e individit diktatorit “*prijësin shtetëror e partiak*” (“*Tito*”, fq.42, “*Me Titon përpara*”, fq.44, “*J.B.Tito*”, fq.93, “*Emri i shokut Tito*”, fq.94). Në këtë Abetare, janë përfshirë edhe dy njësi me motive nga Lufta e Dytë Botërore (LNÇ), (“*Zana partizane*”, fq.81 dhe “*Qyteti Hero*”, fq.95), të cilat në brendinë e tyre shpalosin disa vlera njerëzore-kombëtare. Në të parën është domethënëse sintagma “*Liria nuk dhurohet, por fitohet*”, ndërsa në të dytën, shprehet dashuria ndaj kryeqytetit - Prishtinës dhe është dhënë edhe një gjëegjezë që reflekton dashurinë ndaj atdheut: “*Kush më thotë, kush e di? Ç’është një vend plotë begati;*

Më të bukur s’e gjen- Gjakun, djersen s’ja kursen;

Për të zemra rreth me mall, Për të punon sa je gjall”. (Atdheu, fq.95)

Përgjithësisht, nga 74 njësi (*pjesë tekstuale, vjersha, gjë e gjëza*) që përfshihen në këtë tekst (*të mbarështruar sipas rendit të mësimin të shkronjave*) tri që i veçuem më lart pasqyrojnë aspekte që i reflektohen edukimit kombëtar. Në Kosovë, nga viti shkollor 1982/83 e deri në vitin 1998 e deri më 2001 në përdorim ishte *Abetarja* e autorit Qamil Batalli.³⁹⁸ Deri në hartimin e *Pakos së Abetares* nga A.Deva e I.Krasniqi, kjo Abetare ka përjetuar dymbëdhjetë ribotime, deri në vitin 1990 pa ndryshime kurse në vitin 1991 e tutje janë bërë disa plotësime por jo edhe aq

³⁹⁵ Mehmet Gjevori, *Abetare*, ETMM të KSAK, Prishtinë, 1974.

³⁹⁶ Naser Zabeli, *Ndikimi i Planeve dhe Programeve mësimore dhe teksteve të gjuhës e letërsisë shqipe të kl.I-IV të shkollës fillore në kultivimin e edukimit kombëtar gjatë 1974-1998*, Fakulteti Filozofik, UP, Prishtinë, 2001. (*Tema e magistraturës-tekst i pabotuar*).

³⁹⁷ Mehmedali Hoxha, *Abetare*, ETMM të KSAK, Prishtinë, 1979.

³⁹⁸ Qamil Batalli, *Abetare*, ETMM të KSAK, Prishtinë, 1987.

përmbajtësore. Kjo Abetare prej faqes 5-17 përmban ilustrime. Sikurse dhe në ato paraprake edhe në këtë nuk shprehet asnjë aspekt kombëtar.³⁹⁹ Edhe këtu është paraqitur flamuri i klasës punëtore me yll, çekan e drapër (fq.12), ylli i kuq (fq.15). E veçanta qëndron në faktin se, në pjesën e dytë të saj, *në mesin e katër flamujve (RSFJ, LKJ dhe RS) zë vend edhe flamuri ynë kombëtar* (fq.76).

Nga 75 pjesë tekstuale e vjersha që mbarështrohen sipas rendit të mësimit të shkronjave vetëm dy prej tyre janë në funksion të edukimit kombëtar. Në të parën shprehet dashuria ndaj nënës (“*Nëna qëndresë*”, fq.78), ku shfaqen disa tipare patriotizmi: qëndresa, trimëria etj., ndërsa në të dytën (“*Gjuha jonë*”, fq.87) shprehet dashuria ndaj gjuhës amtare siç shprehet poeti ynë i madh N.Frashëri: “*të mirë, të ëmbël, të dliirë...*”. Disa nga përmbajtjet e tjera janë me tematikë nga Lufta Dytë (LNÇ) si “*Valojnë flamujt tanë*”, “*Boro e Ramizi*”, fq.76. *një vjershë për J.B.Titon*, fq.71.), por që krahasuar me *Abetaren* paraprake janë më të pakta. Edhe ribotimet e kësaj Abetarje deri në vitin 1991 nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim, deri te botimi i pestë (1991)⁴⁰⁰ ku pas depertimit të frymës së demokracisë dhe valës së përpjekjeve për çlirim në Kosovë, vihen re disa ndryshime. Kështu, nga ilustrimet janë mënjeluar: *Flamuri i klasës punëtore* (fq.15), *ylli i kuq* (fq.15) e janë zëvendësuar me disa ilustrime tjera por jo me ndonjë symbol kombëtar. Ndërsa, prej njësite, është hequr vjersha “*Rruga e Titos*” dhe është zëvendësuar me vjershën “*Rruga jonë*” e të tjerat kanë mbetur ashtu si në botimet e mëparshme. Kjo është përpjekja e parë që të mënjanohej disa nga përmbajtjet ideore por që, prapëseprapë, nuk janë eliminuar në tërësi sikurse edhe zëvendësimi i tyre nuk është adekuat dhe i dëshiruar.⁴⁰¹

Ndërkaq, pas vitit 1991⁴⁰² (*në ribotimet tjera*) janë mënjeluar edhe përmbajtjet e tjera ideore dhe janë zëvendësuar me përmbajtje të reja, por jo me ndonjë zëvendësim që do të vihej në funksion të edukimit kombëtar. Kështu, në *Abetaren e fundit* (që ishte në përdorim deri më 2001) nga faja 5 – 17 asnjë prej tyre nuk shpreh ndonjë aspekt kombëtar! Ndërsa, nga 85 njësi vetëm dy, që kanë qenë edhe më parë, (“*Nëna qëndresë*”, fq.86 dhe “*Gjuha jonë*”, fq.95) janë me përmbajtje kombëtare. Gjendja ka ndryshuar në vitet e mëvonshme tek Abetaret që ishin në përdorim deri te Abetarja e përbashkët Kosovë-Shqipëri.

³⁹⁹ N.Zabeli, Tema e magjistraturës, e mbrojtur më 2001 në F.Filozofik të UP (tekst i pabotuar).

⁴⁰⁰ Qamil Batalli, *Abetare*, ETMM i Kosovës, Prishtinë, 1991.

⁴⁰¹ N.Zabeli, Tema e magjistraturës, e mbrojtur më 2001 në F.Filozofik të UP (tekst i pabotuar).

⁴⁰² Qamil Batalli, *Abetare*, Libri shkollor, Prishtinë, 1999.

KREU IV

PLANET DHE PROGRAMET E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË (Nga periudha e Rilindjes Kombëtare deri në vitin 2014)

4.1. Vështrim i përgjithshëm mbi programet mësimore dhe kurrikulën shkollore në Kosovë

4.1.1. Këndvështrim historik i kurrikulës së gjuhës shqipe në Kosovë

4.2. Planet dhe programet mësimore të gjuhës shqipe në Kosovë, 1915-2015

4.2.1. Plani mësimor austriak, 1915-1918

4.2.2. Plani mësimor i Mbretërisë të Jugosllavisë, mësimi i detyruar në gjuhën serbe, 1918-1941

4.2.3. Plani mësimor i Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë, 1941-1945

4.2.4. Planet dhe programet mësimore, vitet '60

4.2.5. Planet dhe programet mësimore, vitet '70

4.2.6. Planet dhe programet mësimore, vitet '80

4.2.7. Planet dhe programet mësimore, vitet '90

4.2.7.1. Plani dhe programi mësimor për kushte të jashtëzakonshme

4.2.8. Planet dhe programet mësimore, pas vitit 2000

4.1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PROGRAMET MËSIMORE DHE KURRIKULËN SHKOLLORE NË KOSOVË

Programi mësimor është dokument zyrtar i organeve shtetërore të arsimit me të cilin përcaktohen përmbajtjet programore mësimore për çdo lëndë dhe për çdo klasë të shkollës fillore. Programi mësimor përmban tema dhe njësi mësimore.⁴⁰³ Programet mësimore shpeshherë ndërroreshin si rezultat i arritjeve më të reja shkencore në fusha të ndryshme të lëndëve mësimore. Përmbajtjet programore të lëndëve mësimore përcaktohen në bazë të moshës dhe të aftësive psiko-fizike të nxënësve.

Në literaturën pedagogjike, termat më të përdorur janë: “*program*”, “*kurrikulum*” dhe “*përmbajtje*”.⁴⁰⁴ Në terminologjinë e re të mësimdhënies dhe mësimnxënies tashmë ka hyrë fjala e re “*kurrikul*”, e cila ka gjetur përdorim të gjerë.

Programet mësimore në Kosovë shpeshherë ndërroreshin, fatkeqësisht jo gjithnjë si rezultat i ndryshimeve shkencore, por më shumë ishin të motivuara politikisht, si:

- Planet austriake 1915-1918,*
- Plani mësimor i Mbretërisë të Jugosllavisë, i detyruar të mësohej në gjuhën serbe 1918-1941,*
- Plani mësimor i Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë për gjuhën shqipe 1951-1945,*
- *Plani i ri mësimor i pasluftës në Kosovë për lëndën gjuhë shqipe 1945-1946,*
- *Plani mësimor për lëndën gjuhë amnore 1960,*
- *Plani dhe programi mësimor për gjuhën amtare 1971,*
- *Plani dhe programi mësimor për gjuhën amtare 1977,*
- *Plani dhe programi mësimor për gjuhën dhe letërsi shqipe i vitit 1985,*
- *Plani dhe programi mësimor për gjuhën dhe letërsi shqipe i vitit 1990,*
- Plani dhe programi mësimor për gjuhën dhe letërsi shqipe për kushte të jashtëzakonshme,*
- *Plani dhe programi mësimor për gjuhën dhe letërsi shqipe i vitit 1992-93,*
- *Plani dhe programi mësimor për gjuhën dhe letërsi shqipe i vitit 1996-97,*
- *Plani dhe programi mësimor për gjuhën dhe letërsi shqipe i vitit 1998-2001,*
- *Plani dhe programi mësimor i ri për gjuhën dhe letërsi shqipe i vitit 2003,*
- Korniza e kurrikulës për arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës, 2011.)*⁴⁰⁵

Këto ndryshime të shpeshta i ka shtyrë nevoja e përafrimit dhe unifikimit të planeve dhe programeve mësimore me Shqipërinë. Në mbështetje të përmbajtjeve programore, hartohen tekstet shkollore për nxënës dhe arsimtarë. Në praktikën tonë të përditshme pedagogjike, didaktike e metodike, shumë herë ngatërrohen dhe jo rrallë bëhet identifikimi i emërimit *plan mësimor* me *program mësimor*. Në fjalorin e didaktikës tradicionale nocioni “*program*” asocion në “*plan mësimor*”, ndërsa në fjalorin e didaktikës moderne nocioni “*plan*” nuk ekziston.⁴⁰⁶ Përdorimi i gabuar, përsëritet kudo në komunikimin tonë, gjatë formës së shkruar në dokumente zyrtare dhe në trajtesa që mëtojnë të jenë shkencore. Madje, edhe përdorimi i emërimit *planpro-*

⁴⁰³ *Pedagogjia*, redaktor Dr. Pero Šimleša, Zagreb, 1971, fq. 310.

⁴⁰⁴ Tahir Zajazi, *Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies*, UEJ, Shkup, 2003, f.697.

⁴⁰⁵ Përmbajtjet programore të lëndëve mësimore, tradicionalisht përcaktoreshin në bazë të moshës dhe të aftësive psiko-fizike të nxënësve. Në mbështetje të përmbajtjeve programore, hartoheshin tekstet shkollore për nxënës dhe arsimtarë. Kjo praktikë vazhdon ende.

⁴⁰⁶ Vepra e cituar, f.697.

grame mësimore është i gabuar. Përkufizimi më i drejtë dhe më i plotë është emërtimi *plane dhe programe mësimore*. Plani dhe programi mësimor janë dy koncepte, të cilat nga përmbajtja ndryshojnë mes tyre.⁴⁰⁷ Lëndët mësimore përcaktohen sipas niveleve të arsimit, ndërsa fondi javor apo vjetor i orëve sipas rëndësisë që kanë ato për nivelin e caktuar të arsimit.

Me planet mësimore përcaktohen raportet e lëndëve mësimore të një niveli të arsimit.⁴⁰⁸ Gjatë gjithë historisë së didaktikës së lëndës së gjuhës shqipe në Kosovë synim i planeve dhe programeve ishte pajisja e nxënësve me njohuri shkencore gjuhësore, duke i aftësuar ata për ta përvetësuar gjuhën amtare në shkallën më të lartë, duke formuar shprehitë gjuhësore në të folur dhe në të shkruar. Qëllimi i të mësuarit të gjuhës shqipe në shkollat tetëvjeçare dhe në shkollat e mesme nuk është vetëm studimi i teorisë së gjuhës, i strukturës gramatikore të shqipes, por kryesisht krijimi i shprehive gjuhësore praktike të mbështetura mbi një bazë të vetëdijshme. Gjuha shqipe, si lëndë mësimore në klasat V-VIII të shkollës tetëvjeçare (*sot nëntëvjeçare*) dhe në shkollat e mesme, nga klasa në klasë i pajiste nxënësit me njohuri fillestare rreth fonetikës, morfologjisë e sintaksës, leksikut e stilistikës gjuhësore, si dhe me shprehitë përkatëse praktike shqiptimore, drejtshkrimore e të pikësimit, me shprehi të ligjëratës së folur dhe të shkruar. Kështu, nëpërmjet kësaj lënde nxënësit familjarizoheshin me natyrën dhe me ndërtimin e fjalës në gjuhën shqipe, me përdorimin e saktë të saj në ligjërim të përditshëm”, por, programi mësimor nuk është model obligativ për tërë gjeneratën dhe për çdo mjedis...çdo shkollë bën zgjedhje të programeve që i përshtaten kulturës së mjedisit të vet...”⁴⁰⁹ Lëndët mësimore në planin mësimor kanë status të ndryshëm, p.sh., lëndët kryesore, lëndët dytësore, lëndët e përgjithshme (*në arsimin e mesëm*), lëndët e obligueshme, lëndët zgjedhore, lëndët fakultative.⁴¹⁰ Planet mësimore të gjuhës dhe letërsisë shqipe në Kosovë kishin mbështetje në kriteret shkencore, dhe në ato pedagogjike dhe psikologjike e të parimit të moshës. Në didaktikën e gjuhës shqipe, por edhe praktikën tonë të përditshme në Kosovë, jo vetëm shkollore, shumë herë bëhet identifikimi i planit mësimor me programin mësimor.⁴¹¹ Ky gabim përsëritet si në të folur ashtu edhe në të shkruar. Edhe emërtimi – planprograme mësimore është jopërkatës. Më i përshtatshëm është emërtimi *plane dhe programe mësimore*. Plani dhe programi mësimor janë dy koncepte, të cilat nga përmbajtja ndryshojnë mes vete. Plani mësimor shkollor është dokument shtetëror, të cilin e aprovon organi më i lartë kompetent i arsimit, me të cilin përcaktohen lëndët mësimore me fond të caktuar javor të orëve për lëndë veç e veç. Lëndët mësimore kanë status të ndryshëm, si: lëndët kryesore, lëndët dytësore, lëndët e përgjithshme (*në arsimin e mesëm*), lëndët e detyrueshme, lëndët me zgjedhje, lëndët fakultative.⁴¹²

⁴⁰⁷Plani mësimor shkollor është dokument shtetëror, të cilin e aprovon organi më i lartë kompetent i arsimit, me të cilin përcaktohen lëndët mësimore me fond të caktuar javor të orëve për secilën lëndë veç e veç dhe sipas cilit rend ato lëndë do të mësohen.

⁴⁰⁸ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, fq.848. (Fjala, *programim m. ka kuptimin e* “Veprimi sipas kuptimeve të foljeve *programoj, programohet*. Programimi i punëve bujqësore (i prodhimit). Programimi i veprimtarisë arsimore,artistike (kulturore).” Ndërkaq, fjalës plan,-i m.,do t’i përgjigjej më së miri kuptimi: “Tërësi masash të menduara e të caktuara që më parë, që parashikojnë ecurinë a mënyrën e zhvillimit të një pune a veprimtarie, vëllimin e afatit e saj etj.” Plani i punës. Plani i mbjelljeve (i ndërtimeve). Plani i punës edukative. Plani i stërvitjes. Punë me (pa) plan. Punojnë (ecin) me plan. Bën plane në hava. keq., bised. “ ose dhe “Përmbledhje paraprahe e një mësimi, e një studimi etj., e cila përmban pikat ose vijat kryesore, ecurinë e shtjellimit a të hartimit etj.; skicë.” Plani i orës së mësimit. Plani i hartimit. Plani i copës së leximit. Pikat e planit. Bëj planin.

⁴⁰⁹ Tahir Zajazi, *Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies*, UEJ, Shkup, 2003, f.698.

⁴¹⁰ Grup autorësh, *Pedagoška enciklopedija*, II, vep. e cit., fq. 99.

⁴¹¹ Tahir Zajazi, *Vepra e cituar*, Shkup, 2003, f.698.

⁴¹² Grup autorësh, *Pedagoška enciklopedija*, II, vep. e cit., fq. 99.

4.1.1. Këndvështrim historik i kurrikulës së gjuhës shqipe në Kosovë

Mësimi i gjuhës shqipe në Kosovë është dokumentuar, duke nisur qysh herët nga mesjeta e largët. Ka dëshmi se mësimi i gjuhës shqipe ka ndodhur edhe në institucione arsimore- edukative e fetare. Njihet tashmë fakti se Shkolla e Stubllës së Vitisë (1584)⁴¹³, që dëshmon për një fakt të tillë. Kurrikula shqiptare dhe ajo e Kosovës, i ka rrënjët nga shek XV, nga shkollat e para kishtarë të hapura pranë manastireve, të njohura si shkolla të qytetit, shkolla të gramatikës latine, akademi, kolegje, etj. (si: *Stubëll, Pedhanë, Kurbin, Shkodër, etj*). Në këtë kohë e kanë origjinën edhe tekstet mësimore të vjetra, të cilat përdorshin në shkolla. Këtë gjë e dëshmon edhe niveli i librit të parë të gjuhës shqipe “*Meshari*” i Gjon Buzukut i shkruar para një tradite paraprake të dokumentimit të shkrimit të librit në gjuhën shqipe me alfabetë të ndryshme (*kryesisht me atë latin*). Në mënyrë analoge mund të konkludohet edhe për traditën e mësimin të gjuhës shqipe. Por edhe mësimi i gjuhës shqipe me alfabet arab në Kosovë është e besueshme të ketë ekzistuar. Ishte kjo periudhë e hapjes së shkollave të huaja pranë *kishave, xhamive e teqeve*. Për të pasuar me periudhën e Rilindjes Kombëtare lindi misioni i ri për inteligjencën shqiptare të kohës. Është një epokë që shënon interesimin e shqiptarëve për shkencën dhe arsimin, për dijen dhe lirinë e çlirimin e vendit. Kjo është kohë edhe e depërtimit të ideve pedagogjike e didaktike evropiane në trevat shqiptare. Pas hapjes së shkollave të para kombëtare, këto përpjekje ndjeshëm u shtuan edhe në Kosovë, por me pushtimin e Kosovës pas vitit 1912 (*pas shkëputjes nga trungu i Shqipërisë*) kjo trevë u katandis në shtypje e dhunë. Përdorimi i shkronjave shqipe u sanksionua dhe atyre që u gjendej qoftë një abetare shqipe dënoheshin e persekutoheshin rëndë. Në vitin 1914, pjesët e trojeve të Kosovës që kishin mbetur nën okupimin austro-hungarez u lejuan që të arsimoheshin në gjuhën shqipe dhe lënda mësimore gjuhë dhe letërsi shqipe kishte vend kryesor në këto shkolla. Ndërkaq në pjesët e tjera të tokave të Kosovës që ishin nën administrimin e sundimit bullgar nuk lejohej mësimi në gjuhën amtare. Sërish vijnë ditë të rënda për shkollën shqipe dhe për shqiptarët në Kosovë, pas formimit të Jugosllavisë së Versajës. Kështu, nga viti 1918 deri në vitin 1941 në Kosovë dhe për shqiptarët ishte i ndaluar mësimi në gjuhën shqipe dhe administrata në gjuhën shqipe. Perspektiva e re për shqiptarët e Kosovës drejt mësimin të gjuhës shqipe dhe hapjes së shkollave shqipe rinisi në vitin 1941 me ndihmën e Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë.

Një gjendje më e mirë dhe rrethana shumë më të favorshme, për popullatën shqiptare në Kosovë, u krijuan pas vitit 1941, kur planet dhe programet mësimore, por edhe tekstet mësimore të Shqipërisë dhe trevave tjera shqiptare, ishin pothuaj, identike. Mirëpo, pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova u ripushtua dhe gjatë periudhës 1945-1974 kishte pozitë specifike kushtetuese, tepër nënçmuese, në kuadër të ish-Jugosllavisë dhe të Serbisë dhe për këtë arsye planet dhe programet mësimore për fëmijët shqiptarë, nga ana e “*specialistëve përgjegjës*” (gati gjithnjë joshqiptarë) për arsim në nivel të Kosovës u “*gatuoheshin*” pa asnjë debat në mënyrë të centralizuar.⁴¹⁴ Këto plane nga “*specialistët*” ideologjikë e antishqiptarë fillimisht hartoheshin në gjuhën serbokrate e madje përktheheshin tekstualisht, pa asnjë përshtatje.⁴¹⁵ “*Kështu, ishte*

⁴¹³ Ragip Gjoshi, “*Shkolla e parë shqipe-shkolla e Stubllës*”, “*Malësia*”, 2014, f.175.

⁴¹⁴ Në Kosovë zbatohet një praktikë paradoksale, deri në vitet '60 të shek.XX, përdorej për hartimin e planeve dhe programeve të të gjitha lëndëve mësimore. Ato vinin të gatuar nga Beogradi!

⁴¹⁵ Sa për ilustrim po përmendi programin e historisë, në vitet e para të pasluftës, i cili ishte identik me historinë serbe, pa asnjë adaptim.

*absurde që mësuesit e shkollave shqipe ta zhvillonin me përpikëri lëndën e historisë, sipas programit të përkthyer, sepse atëherë edhe nxënësit shqiptarë duhej të mësonin, (shembull) "... se të parët tanë janë sllavët e jugut".*⁴¹⁶ Çdo gjë ishte e mbështjellë me petkun ideologjik, por edhe me ndikimin e politikës serbomadhe, antishqiptare dhe programet e lëndëve shoqërore mund të përshtateshin vetëm atë sa lejonin "*politikëbërësit*" e ditës. Dhjetëvjeçari (1950-1960), dora e fortë e "*sigurimit shtetëror*" ishte shtrirë edhe mbi përmbajtjet programore të lëndëve shoqërore.

Një frymëmarrje e re nisi pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1974, kur u avancua pozita kushtetuese e Kosovës dhe shqiptarëve që jetonin në këto treva. Adresa e hartimit dhe miratimit të planeve dhe programeve mësimore nisi të jetë Prishtina dhe institucionet profesionale të organeve shtetërore të Kosovës. Kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim dha Pleqësia Arsimore e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, e themeluar në vitin 1970.⁴¹⁷ Me formimin e këtij organi Kosova fitoi të drejtën të bëjë hartimin dhe miratimin e planeve dhe të programeve mësimore për shkolla fillore edhe të planeve e të programeve mësimore për shkollat e mesme. Tekstet shkollorë për këto lëndë mësimore filluan t'i hartonin ekspertët e institucioneve shkencore e profesionale të Kosovës dhe ekspertët e tjerë shqiptarë.⁴¹⁸

Enti për Përparimin e Edukimit dhe të Arsimit të Kosovës nuk mbeti veç në suaza të mbikëqyrjes së shkollave në realizimin e planeve dhe të programeve mësimor, por, edhe në hartimin dhe përpunimin e përmbajtjeve të arsimit për lëmenj të caktuar të punës dhe për lëndë konkrete mësimore.⁴¹⁹ Është kjo kohë e depërtimit të literaturës nga Shqipëria e këmbimit të profesorëve të universiteteve, është kohë kur Serbi "*u zhvesh*" nga ndikimi i drejtpërdrejt në hartimin e planeve dhe të programeve mësimore, sidomos të lëndëve kombëtare mësimore si: *histori, gjuhë, muzikë, art figurativ* etj. Kjo është një epokë e investimeve intelektuale dhe e përparimit të anës teorike të mësimdhënies, sepse pas revistës "*Përparimi*" dhe rolit të së përditshmes "*Rilindja*" nisi menjëherë botimi i revistës pedagogjike "*Shkëndija*".

Pra, edhe pse ngjau rianeksimi i Kosovës, Jugosllavia socialiste, reflektoi "*fitoren*" e idesë së socializmit në këto treva. Por përkundër faktit se pushtuesit "*veshën një petk të ri*", të mbështjellë me gënjeshtat e barazisë kombëtare, në brendi, rivazhdoi urrejtja, diskriminimi, dhuna dhe shtypja kombëtare. Në sferën e arsimit është i hetueshëm ndryshimi, sepse platforma e sistemit politik ishte "*ndërtuar*" mbi bazat e respektimit dhe mbi bazën e platformës së Luftës së Dytë Botërore për "*dhënien*" e së drejtës edhe për "*pakicat*", për arsimim në gjuhën amtare dhe për mësimin e gjuhës amtare në shkolla. Mirëpo, ndonëse ishte lejuar mësimi i gjuhës shqipe në shkollat e Kosovës dhe trojeve shqiptare në ish-Jugosllavi, kjo periudhë identifikohet me ideologjizimin e tejskajshëm marksist-leninist të fizionomisë së shkollës shqipe. Megjithatë, sërish mund të vlerësohet si periudhë më pozitive dhe më e rëndësishme për fatin e përhapjes së shkronjave shqipe dhe zhdukjes së analfabetizmit. Sipas dokumenteve zyrtare shtetërore e partiake të kohës së diktaturës në programet mësimore, vlerësohej se "*Përveç orientimit të drejtë politik dhe ideologjik, duhet të ekzistojnë lidhjet organike në të gjithë gamën e lëndës që jepet në klasat e ndryshme dhe asnjëherë të mos ketë shkëputje dhe përsëritje mekanike. Kështu, nxënësi në formimin e tij shkollor, nuk do të harrojë asgjë në rast se teksti është i qartë, i*

⁴¹⁶ Mehmet Gjevari, *Kujtime e shënime rreth punës së shkollave të para shqipe në Kosovë gjatë dhe pas Luftës II Botërore*, Prishtinë, 1998, fq. 85-86.

⁴¹⁷ "Fletore zyrtare e KSAK" Prishtinë, 1970, numër 3/70.

⁴¹⁸ Pas këtyre ndryshimeve pozitive Enti për Përparimin e Edukimit dhe të Arsimit të Kosovës, që ishte themeluar që nga viti 1958, si institucion profesional, ju shtuan një varg detyrash e kompetencash të reja.

⁴¹⁹ Ishin këto vite tepër të rëndësishme, për fatin e mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë, duke u shënuar ngritje në cilësi dhe thellësi të mësimit të lëndës mësimore të gjuhës dhe letërsisë shqipe.

thjeshtë dhe i plotë, dhe do të jetë në gjendje të ndërtojë me baza njohuritë që i jepen.⁴²⁰”

Për shkollat tetëvjeçare të Kosovës, pas administratës së Autro-Hungarisë dhe Gjermanisë e Italisë edhe Jugosllavia për herë të parë lejoi përdorimin e gjuhës shqipe, edhe pse në shkollat e mesme shumica e lëndëve mësimore profesionale mbaheshin në gjuhën serbe, me arsyetim të mungësës së kuadrit mësimor. Programet e para mëtuan të jenë programe të ndërtuara mbi kritere *shkencore, pedagogjike, psikologjike dhe metodike*, por tepër shumë të mbështetura në ideologjinë marksiste dhe nën ndikimin e shkollës ruse. Programi i gjuhës shqipe përcaktonte brendinë e mësimit të kësaj lënde në shkollë. “*Nëpërmjet studimit të saj, synohet që nxënësit të njihen shkallë-shkallë me normën e gjuhës letrare, ...si mjet zhvillimi e përparimi; njihen me rrugën e formimit dhe të zhvillimit të pandërprerë të gjuhës letrare shqipe gjatë periudhave të ndryshme historike; edukohen me qëndrimin aktiv ndaj dukurive gjuhësore, përgatiten për të përdorur një gjuhë sa më të pasur dhe të pastër si në të folur, ashtu edhe në të shkruar.*”⁴²¹ Përmbajtja e programit të gjuhës shqipe për klasat V-VIII të shkollës tetëvjeçare përfshinte një vëllim të caktuar njohurish gjuhësore *për fonetikën, leksikologjinë, morfologjinë, fjalëformimin, sintaksën, stilistikën dhe historinë e gjuhës* dhe siguronte lidhjen midis tyre, lidhje që kushtëzohet nga brendia e të mësuarit të gjuhës shqipe në shkollë.⁴²² Lidhjet midis disiplinave të gjuhës kërkohej të njiheshin mirë nga mësimdhënësit, që të bëhej një gërshetim i vazhdueshëm, në përputhje me temat e nëntemat.⁴²³ Programi i gjuhës shqipe caktonte tërë lëndën që mësohej nga kl. V-VIII, të ndarë në orë javore dhe vjetore, sipas planit mësimor. Për secilën klasë programi parashikonte, përveç orëve për njohuritë e reja, edhe disa orë për përsëritjen në fillim të vitit dhe gjatë vitit, orë për përsëritje, sipas nevojës dhe gjendjes së klasës dhe disa orë për detyra kontrolli dhe për dikttime.⁴²⁴ Prandaj zberthimi i programit në planin semestral ose vjetor dhe planifikimi i lëndës ishte kusht i domosdoshëm për të realizuar gjer në fund qëllimet e pikësnyimet e të mësuarit të lëndës së gjuhës shqipe.⁴²⁵ Kështu bëhej një shpërndarje sa më e drejtë e më e plotë e lëndës gjatë tërë vitit, nga ora në orë, e nga tema në temë, duke u mbështetur edhe në parimet themelore të didaktikës, në varësi nga veçoritë e lëndës së gjuhës shqipe, veçoritë e moshës së nxënësve, gjendja e niveli i klasës. Për këtë duhet pasur parasysh fakti se rrethi i njohurive gjuhësore të marra në klasat I-V zgjerohej, thellohej dhe përforcohej në klasat V-VIII.⁴²⁶ Edhe pse pa përgatitje të mjaftueshme shkollore, mësimdhënësit

⁴²⁰ Plani i ri mësimor i pasluftës në Kosovë për lëndën gjuhë shqipe 1945-1946.

⁴²¹ Programi i gjuhës shqipe, për shkollën fillore 1945.

⁴²² Të gjitha këto njohuri, me tërë këto lidhje, i pajisin nxënësit me nocionet themelore për gjuhën shqipe, me ato elemente teorike që kanë mbështetje shkencore dhe krijojnë një bazë të shëndoshë për njohjen më të thellë të gjuhës dhe për zotërimin e saj, për formimin e shprehive gjuhësore, duke siguruar përvetësimin e gjuhës letrare nga nxënësit.

⁴²³ Në këtë mënyrë për nxënësit mundësohej që ata të dinë t’i kapin e t’i kuptojnë këto lidhje, për t’i futur pastaj me radhë në sistemin e përgjithshëm të njohurive të tyre për gjuhën, sepse këto fusha studimi përbëjnë një unitet të pandarë në tërësinë e njohurive gjuhësore që përvetësohen në shkollë. Në këtë mënyrë përbusheshin plotësisht detyrat për forcimin cilësor të procesit mësimor në lëndën e gjuhës shqipe.

⁴²⁴ Sasia e këtyre orëve ndryshonte sipas klasave dhe në përputhje me qëllimin për të cilin ishin përcaktuar. Për zhvillimin e tërë kësaj lënde rëndësi të madhe kishin hartimi i planeve semestrale ose vjetore, sepse procesi mësimor ishte proces i programuar dhe me pikësnyime të caktuara.

⁴²⁵ Planifikimi i mirë i lëndës e ngrinte mësimin e gjuhës shqipe në një shkallë më të lartë, siguron njohuri të reja të programuara për nxënësit, të marra në mënyrë sistematike e të shkallëzuar, por edhe këtu ishte e “fortë” dora e pushtetit, i cili në mënyrë centraliste mbikqyrte dhe impononte përmbajtjet me inspektorët e arsimit, të cilët deri vitet shtatëdhjeta të shek.XX kishin autorizime të mëdha!

⁴²⁶ Mësimdhënësit e gjuhës shqipe gjatë planifikimit dhe shpërndarjes së lëndës vëmendjen e përqendronin kryesisht në problemet thelbësore, që lënda e gjuhës shqipe të trajtohet në një mënyrë të re duke e forcuar karakterin e saj

e gjuhës shqipe në Kosovë ishin të përkushtuar të shfrytëzonin mirë lidhjet e brendshme në gjithë lëndën që jepet në klasat e ndryshme, duke siguruar *gërshetimin e njohurive gjuhësore të fonetikës, të morfologjisë të sintaksës, të leksikologjisë* në klasat V-VIII. Shpëmdarja e lëndës siguronte formimin gjuhësor të nxënësve *nëpërmjet njohurive gramatikore të programuara nga viti në vit*, bëri që të mos ketë shpëputje midis pjesëve përbërëse të programit dhe të shfrytëzohen në mënyrë sa më racionale raporti i drejtë ndërmjet njohurive gramatikore e atyre drejtshkrimore dhe ndërmjet zhvillimit të folurit me gojë e me shkrim.⁴²⁷ Vetëm nëpërmjet një rruge të tillë, programi do të përvetësohej plotësisht dhe do të zotërohej nga nxënësit. Ndërkaq, pavarësimi i mësimin në gjuhën shqipe në Kosovë shënohet nga vitet 1990, të njohura si vite të mbijetesës së shkollës shqipe. Kurse periudha më e ndritshme për kurrikulën e lëndës së gjuhës shqipe vjen pas viteve 1999 dhe sidomos pas vitit 2014 kur janë shënuar hapa të rëndësishëm drejt unifikimit të kurrikulave dhe teksteve shkollore në mes Shqipërisë dhe Kosovës.⁴²⁸

shkencor, që përmbajtja e çdo ore të caktohet drejt dhe në përputhje me tërë programin, sepse ishin shumë të kontrolluar.

⁴²⁷ Siç mund të konkludohet nga leximi i raporteve të autoriteteve të arsimit. Ja se çfarë shkruan në raportin e një këshilltari pedagogjik të Rahjonit të Prishtinës: “...në planifikimin e lëndës s’duhet të ketë përsëritje të saj mekanike, por duhet të dallohen mirë e të vlerësohen elementet e reja në temat që rimerren nga klasa në klasë. Me kujdes të veçantë duhet planifikuar dhe shpëmdarë puna e pavarur e nxënësve brenda e jashtë klase që të krijohen mundësi për përvetësimin e njohurive dhe për ushtrimin e nxënësve në mënyrë sistematike.”

⁴²⁸ Kjo sa vjen dhe bëhet realitet për shkak se fushat kurrikulare kanë një bazë të përbashkët historike, filozofike, psikologjike e sociologjike dhe zbatimi i saj dhe vlerësimi i saj i përbashkët do të ishte veprim më pak i kushtueshëm dhe me i fuqishëm në praktikë, duke hedhur edhe një hap të rëndësishëm drejt bashkimit kombëtar.

4.2. PLANET DHE PROGRAMET MËSIMORE TË GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË, 1914-2014

4.2.1. Plani mësimor austriak, 1915-1918

Harta e Kosovës gjatë Luftës së Parë Botërore “*ishte prerë me gërshërët e krajlive*”, sepse nën juridiksionin e forcave të Austro-Hungarisë, mbeti Dukagjini dhe një pjesë e Kosovës Veriore, kurse nën Bullgarisë ju dha pjesa më e madhe e Kosovës. Në drejtim të lejimit të arsimit në gjuhën amtare, Austro-Hungaria ishte më liberale. Në pjesët ku kishte shtrirë pushtetin, *kjo perandori lejoi shkollën fillore në gjuhën shqipe, por sipas planeve dhe programeve sintetike të hartuara në Vjenë të Austrisë. Këto programe nga gjermanishtja i përkthente dhe i përshtaste Gaspër Beltoja.*⁴²⁹ Për shkollat fillore ishin paraparë disa lëndë mësimore, në mes tyre *rolin dominant e kishte lënda e gjuhës shqipe. Ishte paraparë edhe mësimi i bukurshkrimit.*⁴³⁰ Në këtë periudhë historike në shkollat fillore të trojeve të Shqipërisë neutrale është punuar me planet dhe programet mësimore të Austrisë, të Italisë dhe të Francës.⁴³¹ Pra, nuk punohej me plan dhe program unik të punës mësimore në të gjitha trevat. Krahas mësimave që bëheshin sipas planit mësimor për gjuhën shqipe (*në dokumente ishte i përkufizuar si gjuhë mësimi-R.Gj.*), në këto shkolla mësohej paralelisht edhe gjuha gjermane. Këto shkolla fillore nën pushtimin e Austro-Hungarisë, ishin pesëvjeçare dhe për këto dy gjuhë kishin fondin më të madh të orëve mësimore.⁴³²

Tabela 4. Orët mësimore sipas planit mësimor sintetik austriak për mësim gjuhe, 1915 – 1918

Lëndët mësimore ⁴³³	Klasat				
	I	II	III	IV	V
2. Gjuhë mësimi	12	10	8	8	6
3. Gjuhë gjermane	0	2	4	5	5
G j i t h s e j	12	12	12	13	11

Në këtë etapë shënohet fillimi më serioz i mësimdhënies së gjuhës shqipe, të përkufizuar si *Gjuhë mësimi (mësim shkrimi)*, ku planifikohej të përpunoheshin tërësi përmbajtjesh të veçanta mësimore, si: *këndim, shkrim e ortografi, ushtrime gramatikore dhe hartim.*⁴³⁴ Këto plane e tekste mësimore hartoheshin në Vjenë, e në Kosovë dhe për herë të parë shënonin institucionalizimin e mësimin të gjuhës shqipe.

⁴²⁹ H.Koliqi, *Shkollat dhe arsimit në Kosovë në vitet 1915 – 1918*, Shkëndija, nr. 4, maj 1994.

⁴³⁰ Jašar Redžepagić, *Školstvo i prosveta na Kosovu od kraja XVIII stoleća do 1918. godine*, Priština, 1974, str. 168; *Po aty*, 13 shtator 1995.

⁴³¹ Instituti i Studimeve Pedagogjike, *Historia e arsimit shqiptar*, Tiranë, 1990, fq. 279.

⁴³² Ilir Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës Parë Botërore*, Tiranë, 2001, fq. 104.

⁴³³ Abdulla R. Vokri, *Shkollat dhe arsimit në anën e Llapit brenda viteve 1878 – 1944*, Prishtinë, 1995, fq. 173.

⁴³⁴ Ilir Kanini, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës Parë Botërore*, Tiranë, 2001, f. 104. (Lënda mësimore e gjuhës shqipe në këtë periudhë shënon përpjekjen më serioze në Kosovë me përfshirjen e atdhetarëve shqiptarë si H.Prishtina, B.Curri e atdhetarë të tjerë.)

4.2.2. Plani mësimor i Mbretërisë të Jugosllavisë, mësimi i detyruar në gjuhën serbe 1918-1941

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore vijnë ditë të vështira për pozitën e gjuhës shqipe. Të gjitha shkollat e hapura në gjuhën shqipe mbyllen rrufeshëm!⁴³⁵ Gjuha shqipe dhe shpërndarësit e shkronjave shqipe ndiqeshin egërsisht. Duke filluar nga viti 1919 në Jugosllavinë e Versajës deri në vitin 1940 ishin të vetmit shqiptarët që ishin privuar nga e drejta në gjuhën amtare dhe kështu, të gjitha shkollat fillore në Kosovë ishin vetëm në gjuhën serbe.⁴³⁶ Në këtë periudhë është punuar me planet e Mbretërisë SKS dhe në këto shkolla mësimdhënia zhvillohej vetëm në gjuhën serbe.⁴³⁷ Serbishtja kishte këtë fond të orëve mësimore:

Tabela 5. Orët mësimore sipas Planit mësimor të Mbretërisë së Jugosllavisë, në gjuhën serbe, 1918-1941

<i>Lëndët mësimore</i> ⁴³⁸	<i>Klasat</i>				
	<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III</i>	<i>IV</i>	<i>Gjithsej</i>
<i>1. Serbokroatisht dhe sllovenisht</i>	7	7	7	7	28
<i>2. Bukurshkrim</i>	-	1	1	1	3
Gjithsej	7	8	8	8	31

4.2.3. Plani mësimor i Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë, 1941-1945

Një shpresë drite për shkronjat shqipe dhe shqiptarët e Kosovës dhe trojeve të tjera shqiptare nën Jugosllavi erdhi gjatë Luftës së Dytë Botërore. Fillimi i vitit shkollor 1941-42, solli gëzim të madh për fëmijët shqiptarë dhe për të gjithë arsimdashësit. Ishte kjo kohë, kur sërish territori i Kosovës u nda në tri zona. Në shkollat në gjuhën shqipe, në Kosovë mësimdhënia zhvillohej sipas tri planeve dhe programeve mësimore, varësisht nga zonat okupuese të pushtuesve. Gjatë periudhës 1941 deri në vitin 1944 pjesa më e madhe e territorit të Kosovës i takonte pushtimit italian, andaj në shkollat fillore në këto zona mësimi zhvillohej sipas *Planeve dhe programeve mësimore të Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë*.⁴³⁹ Në këtë periudhë historike, plani mësimor i shkollës fillore ishte i planifikuar të ishte pesëvjeçar (*pesëklasëshe*).⁴⁴⁰

⁴³⁵ Për shqiptarët lejohej vetëm mësimi i fesë, së cilës i është dhënë rëndësi e veçantë. Në shkollat fillore, në të cilat kanë mësuar nxënësit shqiptarë të fesë islame, këtë lëndë mësimore e kanë ligjëruar hoxhallarët të premtëve.

⁴³⁶ Nxënësit shqiptarë, që vendosnin të vijonin shkollën, ishin të detyruar të mësonin gjuhën serbe një vit shkollor.

⁴³⁷ Në Mbretërinë Serbo-kroato-sllovene të vetmit ishin shqiptarët që nuk e kishin të drejtën e shkollimit në gjuhën amtare.

⁴³⁸ A. Vokri, *Shkollat dhe arsimit në anën e Llapit brenda viteve 1878 – 1944*, Prishtinë, 1995, f. 173.

⁴³⁹ Abdylaziz Islami, *"Arsimi në gjuhën shqipe në Kosovë 1941-1945"*, Prishtinë, 2001.

⁴⁴⁰ Sipas këtij Plani për gjuhën shqipe nga Ministria e Arsimit të Shqipërisë ishte paraparë një fond orësh mësimore, 13 dhe 14 orë në javë për nxënësit shqiptar të Kosovës.

Tabela 6. Orët mësimore sipas Planit mësimor të Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë,⁴⁴¹ 1941-1945

<i>Lëndët mësimore</i>	<i>Klasat</i>				
	<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III</i>	<i>IV</i>	<i>V</i>
1. Gjuhë shqipe	14	14	14	13	13
Gjithsej	14	14	14	13	13

Me nismën e Ministrit shqiptar Ernest Koliqi, në Kosovë u dërguan një kontingjent mësuesish, sepse Kosova kishte mungesë kuadrosh arsimore-pedagogjike. Kjo punë kompensohej edhe me angazhimin e hoxhallarëve dhe të gjithë atyre që njihnin alfabetin e Manastirit. Në këtë veprimtari të çmueshme, përveç mësuesve të ardhur nga Shqipëria angazhoheshin edhe ish-nxënësit shqiptarë që kishin mësuar shkrim-leximin në gjuhën serbokroate apo ndonjë gjuhë tjetër.⁴⁴² Organizoheshin dhe kurse të veçanta për zhdukjen e analfabetizmit dhe kështu ishte rritur shumë dëshira për mësimin dhe përdorimin e gjuhës së shkruar shqipe. Në shkollën shqipe, rëndësi të veçantë i është kushtuar mësimin të gjuhës shqipe si lëndë mësimore. Lënda e Gjuhës shqipe për nxënësit e shkollës fillore pesëklasëshe ishte ndarë në tetë lëminj mësimor.

Tabela 7. Orët mësimore sipas lëminjve

<i>Lëmenjtë mësimorë të gjuhës shqipe</i>	<i>Klasat</i>				
	<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III</i>	<i>IV</i>	<i>V</i>
1. Zhvillim germash	4				
2. Shkrim e këndim (lexim)	5	5	5	4	4
3. Rrëfime e kallxime	2	2	1	1	1
4. Ushtrime të të folurit	2	2	2	1	1
5. Recitacion	1	1	1	1	1
6. Hartim	-	2	2	3	3
7. Diktim	-	2	2	3	3
8. Orthografi	-	1	1		
Gjithsej	14	15	14	13	13

Plani i ri mësimor i pasluftës së Dytë Botërore në Kosovë, 1944-1945

Në kohën kur shqiptarët prisnin bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare, që e natyrshëm të jetonin në një shtet të përbashkët. Sërish ndodhi rianeksimi i Kosovës, e cila për dy vite të pasluftës së Dytë u mbajt nën administrim të egër ushtarak. Rrethanat politike e shoqërore kishin ndryshuar, por nuk kishte ndryshuar mentaliteti gjenocidal e abanofobik, sepse me vështirësi pranohej përdorimi i gjuhës shqipe në administratë, ndërsa në shkolla ishte lejuar se kështu e

⁴⁴¹ AQSH, Fondi 295, dosja 112.

⁴⁴²Por, duhet theksuar se në Kosovë dhe në trojet jashtë Shqipërisë deri në vitin 1941 përhapja e shkrim-leximit sanksionohej dhe dënohej, sepse mësimi ishte i lejuar vetëm në gjuhën serbe apo maqedonase.

kërkonte politika e “vëllazërim-bashkimit” dhe kërkesat e sistemit të ri politik të veshur me “petk të ri komunist”.

Në këtë sferë, pasi marrëdhëniet me Shqipërinë e pasluftës ishin “të mira” deri në vitin shkollor 1944/45 në shkollat e Kosovës, ku mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe është punuar sipas planit dhe programit mësimor, i cili ishte në përdorim që nga viti shkollor 1941/42, kudo në trojet shqiptare mësimi zhvillohej në mënyrë unike. Ndërkaq, siç dokumentojnë burimet arkivore, duke filluar nga viti shkollor 1945/46 në shkollat fillore të Kosovës punohej me plane dhe programe të reja mësimore.⁴⁴³ Kështu, gjuha shqipe si lëndë mësimore, vazhdonte të zhvillohej në disa lëmenj mësimorë:

Tabela 8. Orët sipas Planit të ri mësimor i pasluftës së Dytë Botërore në Kosovë për lëndën gjuhë shqipe 1944-1945

<i>Lëmenjtë mësimorë të gjuhës shqipe</i>	<i>Klasat</i>				
	<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III</i>	<i>IV</i>	<i>V</i>
1. Gjuhë shqipe:	+	+	+	+	+
1.1. Këndim			+	+	+
1.2. Shkrim e ortografi			+	+	+
1.3. Gramatikë				+	+
1.4. Hartim			+	+	+

Nga viti 1945/46 në shkollat e Kosovës punohej sipas Planit dhe programit të Këshillit Krahinor për Kosovë e Metohi.⁴⁴⁴ Ky plan mësimor ishte hartuar vetëm për shkollën katërklasëshe dhe ishte i ndarë në dy lëndë të veçanta mësimore për mësimin e gjuhës amtare, duke përbajtur një fond të madh orësh që shkonte në favor të mësimin të gjuhës dhe letërsisë shqipe. Fondi i orëve sipas planit i ri mësimor i pasluftës së Dytë Botërore në Kosovë (për shkollën katërklasëshe) ishte i ndarë në dy lëndë të veçanta mësimore për mësimin e gjuhës amtare:

Tabela 9. Fondi i orëve sipas Planit i ri mësimor i pasluftës së Dytë Botërore

<i>Lëndët mësimore</i> ⁴⁴⁵	<i>Klasat</i>				
	<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III</i>	<i>IV</i>	<i>Gjithsej</i>
1. Gjuhë amtare	10	10	7	6	33
2. Bukurshkrim	1	1	-	-	2
Gjithsej	11	11	7	6	35

⁴⁴³ Mehmet Gjevori, *Kujtime e shënime rreth punës së shkollave të para shqipe në Kosovë gjatë dhe pas Luftës II Botërore*, Prishtinë, 1998 (në versionin në dorëshkrim), ASHK. (Sipas një dokumenti të gjetur nga studiuesi i historisë së arsimit Bajram Shatri, ai pohon se “në Librin amë, i cili gjendet në shkollën fillore “Emin Duraku” të Prishtinës, ai thotë se nuk dihet saktësisht si ka arritur në këtë shkollë, meqë shkolla në vitin 1945 nuk ka ekzistuar, janë të evidencuar nxënësit dhe sukcesi i tyre në fund të vitit shkollor 1944/45, për më se 300 nxënës.”

⁴⁴⁴ Ky Plan mësimor i përkohshëm mbante nr. 9905, të datës 9.09.1946. (Konstatimet janë nxjerrë nga Libri i klasës (Ditarët), ku ishin shënuarorët mësimore sipas planeve të asj periudhe.) Sipas këtij B.Shatrit, këta nxënës janë regjistruar në librin amzë më 1 janar 1945 dhe sukcesi i tyre figuron për secilën lëndë veç e veç.

⁴⁴⁵ *Novi nastavni plan za osnovnu školu*, Ministarstvo prosvete Srbije, Beograd, 1945, fq. 3. Kopje e planit mësimor dërguar organeve komunale dhe shkollave fillore. (Shih: Abdullah Vokrri, *Zhvillimi i shkollave dhe i arsimit në komunën e Mitrovicës (1945 – 1975)*, Prishtinë, 1981, dhe Zeqir Demi, *Zhvillimi i shkollave dhe i arsimit në territorin e sotëm të Anamoravës (1945-1950)*, Prishtinë, 1977.

Sipas këtij plani, në klasën e parë dhe të dytë nxënësit kanë mësuar me të njëjtin fond të orëve, nga 20 orë në javë, në klasën III - 25 orë dhe në klasën IV - 26 orë. Pra, gjithsejt për katër vjet kishin fondin javor 91 orë. Ky plan ishte hartuar nga Ministria e Arsimit e Serbisë dhe me të është punuar vetëm në vitin shkollor 1945/46, ndërsa për shkollat fillore katërklasëshe hartohet dhe nxirret në pah “Programa e re mësimore për shkollat fillore shqipe katërklasëshe”, i cili përmbante një plan për gjuhën shqipe ku ishte paraparë fondi javor i orëve mësimore, i cili ishte me nënndarje sipas lëminjve lexim, drejtshkrim, ortografi, bukurshkrim.

Tabela 10. Fondi i orëve sipas Programit të ri mësimor për shkollat fillore katërklasëshe, 1945

<i>Lëndët mësimore</i> ⁴⁴⁶	<i>Klasat</i>				
	<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III</i>	<i>IV</i>	<i>Gjithsej</i>
<i>I. Gjuhë amtare-abetare</i>	10				10
<i>1.1. Lexim</i>	-	5	4	3	12
<i>1.2. Drejtshkrim</i>	-	2	2	1	5
<i>1.3. Ortografi</i>	-	2	2	2	6
<i>1.4. Bukurshkrim</i>	1	1	1	1	4
Gjithsej	11	10	9	7	37

Ky plan e program mësimor, në krahasim me atë të mërrparshmin, ka dallime mjaft të mëdha, si në emërtimin ashtu edhe në numrin e lëndëve mësimore.⁴⁴⁷Në të njëjtin vit shkollor, në shkollat fillore të komunës së Mitrovicës është punuar me një plan, i cili ka ndryshime nga ky plan,⁴⁴⁸ çka bën të kuptohet se në të gjitha shkollat fillore të Kosovës në këtë vit shkollor nuk është punuar me plane dhe programe të njëjta mësimore.

⁴⁴⁶ Akademik Jašar Redžepagić: *Školstvo i Prosveta u Kosovskoj Mitrovici i Okolini od druge polovine 19. veka do 1975. godine*, Studime (ASHAK), Prishtinë, 1980, fq. 59.

⁴⁴⁷ Mehmet Gjevorri, *vep. e cit.*, f. 85.(Sipas pohimeve të Mehmet Gjevorrit, gjuha serbe, si gjuhë joamtare, ishte përcaktuar të mësohej qysh nga klasa e parë, kur nxënësit shqiptarë ende nuk e njihnin gjuhën amtare dhe mësonin një gjuhë krejtësisht të huaj. Këtë plan e kishin kundërshtuar, me arsytim pedagogjik e profesional, disa metodicientë shqiptarë nga Kosova.). Mirëpo, edhe pse kishte hasur në kundërshtim nga qarqet vendosëse të Serbisë, ishte përkrahur propozimi që gjuha serbe si gjuhë joamtare të mësohet që nga klasa III, e jo nga klasa e parë fillore.

⁴⁴⁸ Abdullah Vokri, *Zhvillimi i shkollave - arsimit në komunën e Mitrovicës (1945 – 75)*, Prishtinë, 1981, f. 70.

Tabela 11. Fondi i orëve në shkollat fillore të komunës së Mitrovicës⁴⁴⁹

<i>Lëndët mësimore</i> ⁴⁵⁰	<i>Klasat</i>				
	<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III</i>	<i>IV</i>	<i>Gjithsej</i>
<i>1. Këndim-shkrim</i>	7	4	4	3	18
<i>2. Hartim</i>	-	2	1	1	4
<i>3. Ortografi</i>	-	1	1	1	3
<i>4. Gramatikë</i>	-	-	-	1	1
<i>5. Serbisht</i>	-	-	3	3	6
<i>13. Bukurshkrim</i>	1	1	-	-	2
Gjithsej	19	19	24	25	87

Një plan dhe program më i kompletuar mësimor për shkollat në gjuhën shqipe është miratuar e nxjerrë në vitin shkollor 1948/49⁴⁵¹ dhe kishte një fond javor të orëve mësimore më të pasur.

Tabela 12. Fondi javor të orëve mësimore sipas Planit dhe programit për shkollat në gjuhën shqipe, 1948/49

<i>Lëndët mësimore</i> ⁴⁵²	<i>Klasat</i>				
	<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III</i>	<i>IV</i>	<i>Gjithsej</i>
<i>1. Gjuhë shqipe</i>	10	10	5	5	30
<i>2. Bukurshkrim</i>	-	1	1	1	3
Gjithsej	10	11	6	6	33

Sipas dispozitave ligjore të kësaj kohe ishte e rregulluar se nxënësit pas mbarimit të shkollës fillore katër vjeçare të mund të vijonin mësimet në klasën e pestë ose në klasën e parë të progjimnazit. Në Jugosllavi, në këtë kohë shkollat fillore ishin shtatëvjeçare.⁴⁵³ Nga lëmi i gjuhësisë në Gjimnazin e ulët ishin të planifikuara të mësoheshin këto gjuhë: *Gjuhë shqipe*, *Gjuhë serbe*, *Gjuhë ruse* dhe nëntë lëndë tjera mësimore. Për shkollat fillore të Kosovës (*Me zgjidhjet kushtetuese të kohës Kosova njihej me emra të ndryshëm, si: KSAKM, KSAK-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës-R.Gj.*) Programet mësimore për gjuhë dhe letërsi shqipe të ciklit të klasave të larta janë nxjerrë, plotësuar e ndryshuar në vitet 1952, 1954, 1956, 1960 dhe 1964. Edhe pse ishte lejuar mësimi i gjuhës shqipe, në shkollat shqipe në trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë (*edhe në Kosovë*) në këto programe ishte përcaktuar raporti i disfavorshëm në mes letërsisë shqipe me asaj jugosllave dhe botërore. Ky raport ishte mjaft i papranueshëm për letërsinë shqipe. Gjendja ishte e rëndë dhe këtë e ilustrojnë përmbajtjet programore nga letërsia. Veçmas kur analizohet plani mësimor i vitit 1952, e sidomos pas reformës, në nivel të Serbisë,

⁴⁴⁹Në këtë vit shkollor nga shumica e shkollave të Kosovës është punuar me këtë plan mësimor.

⁴⁵⁰ Akademik Jašar Redžepagić: *Školstvo i Prosveta u Kosovskoj Mitrovici i Okolini od druge polovine 19. veka do 1975. godine*, Studime (ASHAK), Prishtinë, 1980, f. 59.

⁴⁵¹ Zeqir Demi, *Zhvillimi i shkollave dhe i arsimit në territorin e sotëm të Anamoravës (1945-1950)*, Prishtinë, 1977, Plani dhe programa mësimore për shkollat fillore shqipe për vitin shkollor 1948-49, Prishtinë, 1949, f. 3.

⁴⁵² Akademik Jašar Redžepagić: *Školstvo i Prosveta u Kosovskoj Mitrovici i Okolini od druge polovine 19. veka do 1975. godine*, Studime (ASHAK), Prishtinë, 1980, fq. 59.

⁴⁵³ Ato vepronin kryesisht në qendra më të mëdha komunale apo në qytete, ndërsa në zona rurale kryesisht ishin hapur shkolla katër klasëshe

për shkolla fillore të miratuar në vitin 1957. Lëndët shoqërore për “*pakica kombëtare*” u miratuan në vitin 1960. Kjo zvarritje, kryesisht ishte bërë për arsye politiko-ideologjike, sepse vështirë “*përbirohej*” diçka që dërgonte ujë në “*mullirin*” e kultivimit të ndjenjës kombëtare të shqiptarëve.

4.2.4. Planet dhe programet mësimore, vitet '60

Fryma ideologjike dhe “*zemërgjerësia*” e sistemit politik të këtyre viteve duket se solli një plan dhe program mësimor të ri për shkollat, në të cilat procesi mësimor është organizuar dhe zhvilluar në gjuhën e “*pakicave*”. Ky Plan është miratuar, më 28 qershor të vitit 1960, në Kuvendin e Republikës Popullore të Serbisë.⁴⁵⁴ Ky ishte akt i parë ligjor, i cili rregullonte punën e shkollave të kombësive⁴⁵⁵. Korrigjimet e këtij plani dhe programi janë bërë edhe në vitin 1962, por ato nuk kanë të bëjnë me planin, por me programin mësimor.⁴⁵⁶ Mirëpo, mësimin e gjuhës shqipe, sërish duket se si hije e ndiqte mësimi i gjuhës serbe në këto shkolla. Kjo shkaktonte telashe bilingulizmi, por vlerësohej se edhe fillimi i mësimin të gjuhës së dytë ishte i hershëm.

Plani mësimor, 1962

Sipas vendimit të *Pleqsisë s' Arsimit të RS të Serbisë* aprovue më 26 dhjetor të vitit 1962, në shkollat dhe paralelet ku mësimi zhvillohet në gjuhët e pakicave, mësimi i gjuhës serbokroatishte futet prej klasës së parë. “*Në klasën I dhe II mësimi i gjuhës serbokroatishte nuk zhvillohet në orë të posaçme, por në kuadër të mësimin të njohuri natyrës e shoqnisë, t'edukatës s'artit figurativ, t'edukatës muzikore dhe t'edukatës fizike e shëndetsore gjatë kohës prej 120 minutave në javë. Në klasën e III dhe të IV mësimi i gjuhës serbokroatishte mësohet tri orë, kurse prej klasës së V deri në klasën e VIII katër orë në javë. Në shkollat dhe paralelet e tilla mësimi i gjuhës amnore, i gjuhës serbokroatisht dhe i historisë zhvillohet simbas programit të posaçëm*”.⁴⁵⁷ Nga ky arsyetim i planit mësimor mund të konkludohet se nxënësit joserbë, përkatësisht nxënësit shqiptarë, përveç asaj që ishin të diskriminuar dhe të nënçmuar me mësimin e detyrueshëm të gjuhës joamtare, ishin të ngarkuar edhe me fond javor të orëve më shumë se moshatarët e tyre serbë me nga tri (3), përkatësisht katër (4) orë në javë. Në krahasim me planin e mëparshëm kishte zvogëlim të fondit të orëve në disa lëndë mësimore, si: njohuri natyre dhe shoqërie, bazat e moralit socialist etj. Në këtë kohë shtohet fondi i orëve të gjuhës amtare në klasat IV dhe V prej 5 në 6 orë në javë.⁴⁵⁸ Në shtimin e fondit të orëve nuk kishte asnjë ndryshim në programin mësimor të këtyre lëndëve mësimore.⁴⁵⁹

⁴⁵⁴ Zakon o organizaciji škola u kojima se nastava izvodi na jezicima nacionalnih manjina.

⁴⁵⁵ Svetozar Čanović, *Specifični problemi nastave u školama Kosova i Metohije*, Priština, 1967, f. 137.

⁴⁵⁶ *Plani dhe programi mësimor për shkollën fillore në Republikën Socialiste të Serbisë*, Beograd, 1965, f. 9.

⁴⁵⁷ Po aty.

⁴⁵⁸ Narodni Odbor opstine Pristina, Odsek za prosvetu i kulturu, 06/1 br. 18035, 16 avgusta 1962. godina: Zaključke Saveta za prosvetu NRS, o izmeni programa.

⁴⁵⁹ Po aty, f. 8.

Tabela 13. Plani mësimor për gjuhë amtare dhe për gjuhë serbe (joamtare) i vitit 1962

Nr.	Lëndët mësimore	K l a s a t								Gjithsej
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	
1.	Gjuhë amnore	2	6	6	6	6	5	4	4	39
2.	Gjuhë serbe (joamtare)			3	3	4	4	4	4	22
Gjithsej		2	6	9	9	10	9	8	8	61

Enti për Përparimin e Shkollave të KSAKM-së, Prishtinë, më 8 korrik 1964, kishte miratuar planin dhe programin mësimor për shkollat fillore, për lëndën mësimore gjuhë shqipe kishte përcaktuar këtë fond më të madh orësh mësimore.

Tabela 14. Fondi i orëve sipas Planit dhe Programit për shkollat fillore, 1964

Lënda	Numri javorë i orëve të mesimit sipas klasave							
Klaset	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
Gjuhë dhe letërsi shqipe	6	6	6	6	5	4	4	4

Me këtë dokument, detyrat e mësuesit të gjuhës shqipe ishin përcaktuar të ishin: “Me i aftësua nxanësit të shprehen mirë e bukur me gojë dhe me shkrim në gjuhën letrare; me i njoftë nxanësit me ligjshmenitë elementare të gjuhës letrare shqipe, ... me aftësua nxanësit për njohjen dhe përjetimin e letërsisë popullore dhe artistike nëpërmjet veprave me të rëndësishëm dhe me i njoftë me vetitë ma të rëndësishmet artit letrar; me zhvillue interesimin dhe dashtuninë e nxanësve ndaj librit, si dhe aftësinë e tyre për ta përdorë librinë pamvarsisht; me kotribue në formimin e figurës morale të nxënësit dhe në frymen e patriotizmit socialist jugosllav të zhvilloj cilsitë e individualitetit të tyre nacional; me u batë mundëshme nxanësve një zhvillim kulturor dhe me zhvillua ndjenjat estetike; me i njoftë nxënësit me veprat ma të rëndësishme të letërsisë popullore dhe artisitike shqipe, me vetitë ma të rëndësishme t’artit letrar; me njohjen ma me lehtësi ma parë të gjuhës amnore të ndihmojë të mësuesitë ma me lehtësi e me themel të serbokoatishtes si dhe ato të gjuhëve të hueja.”⁴⁶⁰

Detyrat e mësimit të Gjuhës amnore, sipas Planit e programit mësimor të vitit 1964

Mësimi gjuhës “amnore” siç quhej atëherë gjuha shqipe kishte një vend me rëndësi në procesin mësimor-edukativ në shkollën fillore. Gjuhën amnore, për nxënësit e shkollës fillore kishte të përcaktuara këto detyra:

- njohja me ligjshmenitë elementare të gjuhës letrare, aftësinë në njohjen e përdorimin e letërsisë popullore dhe artistike, zhvillimi i dashtunisë ndaj librit dhe kultivimit i ndjenjes estetike të nxënësve;
- duhet me i kuptue dhe realizue në mësimin n’atë mënyrë, në aftësimin nxanësve që njohurit e veta, mendimet dhe ndjenjat t’i shprehin drejt në gjuhën letrare, me shprehjet e bukura

⁴⁶⁰ Enti për Përparimin e Shkollave, Plani dhe programi mësimor për shkollën fillore në KSAKM, miratuar, më 8 korrik 1964, Prishtinë, f. 3.

gojore dhe me shkrim, po ashtu edhe në sigurimin e kushteve që njohurit e këtilla, të fitume në shkollë dhe jeten e përditshme, t'i pasunojnë e zbatojnë edhe matutje dhe

- *Që të realizohet sa ma me sukses kjo detyrë komplekse, asht e nevojshme që edhe lamit tjera mësimore çdo njana spas mundësive të veta specifike, t'orientohet edhe kah zhvillimi i të shprehurit me gojë të nxanësve, pun kjo e cila mund të realizohet vetëm me angazhimin e të gjitha landëve përkatëse mësimore në procesin mësimoro-edukativ me nxanësit e shkollës fillore .”⁴⁶¹*

Pas kryerjes së përgaditjeve të përgjithshme duhet të kalohej në leximin dhe shkrimin fillestar. Më pastaj plani parashihte leximin logjik dhe leximin e rrjedhshëm si një prej detyrave themelore në mësimin e gjuhës amnore në shkollën fillore.⁴⁶² Në klasën e dytë mund të fillohej me leximin sipas roleve dhe zbatimin e teksteve të thjeshta e edukative dhe për moshën e nxënësve -në prozë dhe në poezi.⁴⁶³ Për nxënësit planifikohej të jetë e dobishme me dëgjue leximin estetik edhe nga magnetofoni ose radioaparati. Nga klasa e III-të planifikohej filmi me kultivimin sistematik të leximit në heshtje. Po ashtu, në klasën e III-të duhej vijuar që fëmijët të lexojnë pavarësisht shtypin dhe librat e përshtatshëm për fëmijët. Në klasën IV, V dhe VI planifikohej kalimi në ushtrime sistematike të leximit logjik. Zgjedhjen e teksteve, përkrah librit të leximit dhe të shtypit për fëmijët, gradualisht duhet me i zgjerue edhe në vepra (*fragmente*) nga letërsia popullore dhe artistike, si dhe veprave që rekomandohen si lektyrë shkollore për këtë moshë.

Në klasën e VII-të, duke zgjeruar dhe thelluar kërkesat nga klasët e mëparshme, kërkohet të bëheshin ushtrime sistematike në leximin shprehimor dhe idenë e tekstit që lexohet (*përpunohet*). Në klasën e VIII-të, duke vazhduar me këto ushtrime, duhet arritur që nxënësit të lexojnë rrjedhshëm, në mënyrën ritmike, me akcentin dhe diksionin e pastërt, ta interpretojnë besnikisht e emocionalisht, si në pikëpamje gjuhësore po ashtu edhe për nga vlera e brendshme (*psikologjike dhe emocionale*), të veprës (teksti) së përpunimit letrar.⁴⁶⁴ Me rastin e përpunimit të teksteve të shkruara nga shkrimtarët tanë të vjetër dhe bashkëkohorë, përveç tjerash, parashihej që në pika të përgjithshme me shpjegim të brendisë (*përmbajtjeve*) edhe për shënimet biografike të tyre.

⁴⁶¹Ky plan jepte udhëzime edhe për periudhën përgaditore (*përgaditjet e përgjithshme*) që ishte e mbushur me ushtrime për përgaditjen e fëmijëve në kalimin e leximit dhe shkrimit fillestar. Pas njohjes së nxënësve, në ditët e para kryesisht, ata pasi njiheshin, me rregullat e nevojshme të jetës shkollore, fillohej të bëhej përgaditja për kalimin e nxënësve në leximin e shkrimit fillestar.

⁴⁶² Zgjedhjen e teksteve për lexim plani i mundësonte të bënin mësuesit në harmoni me moshën e nxënësve, preferoheshin tregimet e shkurta të ilustruara, popullore dhe artistike, fabula e përrallëza si dhe tema në lidhje me lojërat, natyrën, jetën e njerëzve të vendlindjes dhe ngjarjet nga Lufta Nacionalçlirimtare.

⁴⁶³ Leximi i poezive dhe prozave, mund të merreshin si nga libri i leximit, po ashtu e dhe nga shtypi për fëmijë.

⁴⁶⁴ Sipas Planit mësimor të vitit 1964, përpunimi i teksteve-(analiza) e pjesëve të leximit paraqet lëmin themelore të procesit mësimoro-edukativ, në të cilën bazohen dhe prej të cilës rrjedhin edhe të gjitha format tjera të punës në lëndën e mësimin të gjuhës amnore në shkollën fillore.

Në të tri klasët e ulta, e sidomos duke filluar nga e II-ta, përpunimin e copave të leximit kërkohet për të zhvilluar duke bërë leximin dhe tregimin e përmbajtjes së vjershave të shkurtra ose tregimeve (*vjersha për fëmijë , tregimi popullor, fabulat, tekste të përshtatshme nga revistat për fëmijë - “Pioneri”, “Gëzimi”, “Fatosi” etj.*).

Mësimi i gjuhës sipas planit e programit mësimor, 1964

Bazën e re kualitative të këtij programi mësimor të gjuhës amnore e përbënte edhe kultivimi organizuar dhe sistematik i kulturës së të shprehurit me gojë dhe me shkrim të nxënësve. Ushtrimet gojore praktikisht fillonin të zhvilloheshin në klasën e parë-me kallëximim e lirë të përjetimeve, me tregimin e lojave të ndryshme fëmijore, ritregimin e kallëzimit të shkurtër (*fabulave dhe përrallave*), si dhe me përshkrimin e objekteve dhe fotografive të përshtatshme (*lojërat, bisedat, me lidhje me filmat e shikuar, shfaqjet teatrale për fëmijë, kremtimet dhe programet tjera shkollore.*)⁴⁶⁵ Në klasën IV, V dhe VII, për ushtrimet gojore kërkohej të zhvilloheshin sipas tematikës, me kujdes të posaçëm pasurimit të fjalorit të nxënësve në fjalë dhe shprehje adekuate. Ushtrimet e të shprehurit me gojë dhe me shkrim rekomandohej që të jenë të përshtatshme për edukimin e nxënësve në frymën socialiste (*“dashunia ndj punës, dashunia ndaj traditave të revolucionit popullor, dashunia ndaj të gjitha popujve të bashkësisë sonë socialiste, si dhe ndaj njeriut dhe lirisë së tij në përgjithësi.”*)⁴⁶⁶ Edhe kjo pjesë e planit e programit mësimor të vitit 1964 siguron mundësinë që përmbajtja e lëndës mbi gjuhën dhe gramatikën të orientohet drejt normave të gjuhës letrare, ligjshmëritë e sintaksës etj.

Lektyra shkollore tregues i diskriminimit të përfshirjes së shkrimtarëve shqiptarë

Për veprat e parapara si lekturë shtëpiake, nxënësit e klasës VII dhe VIII duhej të shkruanin referate dhe sipas udhëzimeve të arsimtarit. Veprat që lexojnë ata kërkohej t'i përgjigjen moshës së tyre dhe kenë vlerë të mirë arsimore- edukative.

Nga lektyra shkollore e planifikuar prej klasës së I-IV, është e planifikuar vetëm libri i *Rexhep Hoxhës: “Mbi krahët e Fluturës”*, ndërkaq, në klasën e pestë katër autorë shqiptarë; *Rexhep Hoxha: “Picimuli”, Vebi Kikaj: “Gurrat”, Mark Krasniqi: “Dritat e para” dhe Don Ndre Mjeda: “Guxo”*, për kl.VI ishin planifikuar këto vepra të autorëve shqiptarë: *Rexhep Hoxha: “Vjersha”, Maksut Shehu: “Kunora e kuqe”, Mehmetali Hoxha: “Te kroni”, Kristoforidhi: “Gjahu i malësoreve”, Anton Çeta: “Në prehen të gjuhës”, Mark Krasniqi: “Tosta e porositun”*. Ndërkaq në klasën e VII ishin planifikuar për lekturë këto tri vepra të autorëve shqiptarë: *Rexhep Hoxha: “Luxhet e verdha”, Tajar Hatipi: “Rrethimi”, Çajupi: “Katërbëdhjetë vjeç dhëndërr” dhe Naim Frashëri: “Vjersha”*. Dhe për nxënësit e klasës së VIII, ishin paraparë vetëm vepra e *Rexhep Hoxhës: “Gjethet e reja”*. Ky është treguesi më i mirë i pozitës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë shqipe në raport me letërsinë slave dhe atë botërore. Duke filluar prej klasës së V e deri në të VIII-t, arsimtari gjatë vitit shkollor ishte i detyruar të përpunojë prej tri -gjashtë vepra. Në të gjitha klasat planifikohej se mund të përpunohen edhe fragmente të përshtatshme nga revista *“Jeta e re”* e *“Zani i rinisë”*.

⁴⁶⁵Në kuadrin e ushtrimeve gojore kujdes të veçantë duhet me kushtue recitimin. Krahas me recitimin dhe leximin simbas roleve, në klasën e III, gradualisht duhet, me kaluar edhe në ushtrime të përbëra-në përshkrimin dhe krahasimin e objekteve, fotografive ose personave kryesore të filmave ose çfaqjeve teatrale.

⁴⁶⁶ Sipas Planit mësimor të vitit 1964, në lëndën e mësimi të gjuhës amnore në shkollën fillore, kërkohej se çdo veprim i mësimdhënësit të jetë i orientuar drejt frymës së “revolucionit”, dhe “patriotizmit jugosllav”.

4.2.5. Planet dhe programet mësimore, vitet '70

Përmbajtjet programore sipas planit mësimor të vitit 1971 të miratuar nga Pleqësia e Arsimit të KSAK, në mbledhjen e mbajtur më 24 shtator të vitit 1971,⁴⁶⁷ në gjuhën amtare kishin filluar të “zgjerojnë këmishën e ngushtuar”. Sipas këtij plani mësimor të gjuhës shqipe në shkollat fillore kishin jetë fond javor prej 56 orësh për të gjitha klasat e shkollës fillore. Me këtë plan hetohet se nxënësit ishin të tejngarkuar me fond javor të orëve. Edhe pse gjatë këtyre viteve është punuar me orar 6 ditor të mësimit, nxënësit e ciklit të klasave të larta për çdo ditë kishin së paku nga 5 orë mësimi, ndërsa dy apo tri ditë në javë kishin nga 6 orë mësimi.

Tabela 15. Fondi i orëve mësimore të gjuhës amtare sipas Planit dhe programit mësimor, 1971

Nr	Lëndët mësimore	K l a s a t								
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	Gjithsej
1.	Gjuhë amtare	6	6	6	6	6	5	4	4	43
2.	Gjuhë joamtare				3	3	3	3	3	15
Gjithsej		6	6	6	9	9	8	7	7	58

Plani dhe Programi mësimor i Gjuhës shqipe për shkollën fillore⁴⁶⁸ i vitit 1971 kishte përcaktuar, *detyrat e mësimit të gjuhës shqipe*, të cilat ishin kornizuar me orientim që: “*Që t’i aftësojë sistematikisht nxënësit të shprehën mirë e bukur në gjuhë letrare me gojë e me shkrim; Që nëpërmjet mësimit të gramatikës t’ua bëjë të njohura nxënësve ligjshmëritë elementare të gjuhës letrare shqipe; Që nëpërmjet veprave të zgjedhura të letërsisë popullore dhe të letërsisë së shkruar (të popullit tonë dhe të popujve tjerë) t’i aftësojë nxënësit të kuptojnë dhe të përjetojnë artin letrar dhe t’i njohë me vetitë e rëndësishme të këtij arti;....Që t’i aftësojë nxënësit të kuptojnë realitetin tonë shoqëror, të forcojë vllazërimin e bashkimin e popujve dhe të kombësive të RSFJ, të zhvillojë dashurinë ndaj atdheut socialist, të ndikojë në formimin e fizionomisë së tyre morale dhe t’i nxisë të marrin pjesë aktivisht në jetën shoqërore; që, duke i njohur veprat letrare me vlerë të popujve të tjerë, të zhvillojë jo vetëm dashurinë e tyre ndaj letërsisë, si vlerë kulturore e përbashkët e njerëzimit, por edhe dashurinë ndaj popujve të tjerë dhe luftës së tyre për progres që duke njohur gjuhën amtare të mësojë më lehtë gjuhët e huaja.*”⁴⁶⁹

Detyrat e mësimi të gjuhës amtare në shkollën fillore të Kosovës sipas planit mësimor të vitit 1971

Mësimi i gjuhës shqipe në shkollën fillore mbështetej në të vërejturit e objekteve të veprimeve të frymorve, të gjithë asaj që gjendet në natyrë dhe në shoqëri. Përmbajtjet e mësimit të gjuhës amtare ndaheshin në lëmi me qëllim që lënda mësimore të përbënte një tërësi unike.

⁴⁶⁷ *Planet dhe programet mësimore për shkollat fillore dhe të mesme*, Prishtinë, 1974. Në këtë libër nuk janë përfshirë të gjitha lëndët mësimore as në shkollën fillore dhe as në atë të mesmen. Për shkollën fillore është përfshirë plani dhe programi për lëndët: gjuha shqipe, gjuha shqipe si gjuhë joamtare, dituri natyre dhe shoqërie, dituri shoqërore, historia dhe gjeografia, si dhe gjuha serbe si gjuhë joamtare.

⁴⁶⁸ Këtë Plan dhe programe mësimore i aprovoi Pleqësia Krahinore e Arsimit të KSAK në mbledhjen e mbajtur më 24 shtator 1971.

⁴⁶⁹ *Plani dhe Programi mësimor i Gjuhës shqipe për shkollën fillore*, i vitit 1971.

Ndarja në lëmi bëhej që të bëhej realizimi i programit në tërësi dhe të sendërtoheshin detyrat e mësimit të gjuhës amtare. Mësimi i gjuhës amtare në shkollën fillore të Kosovës përfshinte këto lëminj: *Leximi dhe shkrimi fillestar, Përpunimi i tekstit, leximit dhe recitimit; Të shprehurit me gojë e me shkrim dhe Dituri mbi gjuhën (gramatikë)*.

Në mësimin e gjuhës amtare vlerësohej aktiviteti dhe vetëveprimi i nxënësve në rrugën e përbashkët që shpinte drejt qëllimit nën udhëheqjen e mësuesit. Edhe në mësimin e njohurive mbi gjuhën (*gramatikën*) ishte parim themelor, që nxënësit të njohin gjuhën e vet. Qëllimi themelor ishte kultura e fjalës së folur dhe të shkruar, të mësojnë se fjalia fillon me shkronjë të madhe, se emrat e njerëzve, qyteteve e të fshatrave duhet gjithashtu, të shkruhet me shkronja të madhe në fillim. Lënda që e parashihte ky program për çdo klasë duhet të zhvilloheshin njohuritë mbi gjuhën, gramatikën. Ky plan parashikonte ushtrime të ndryshme me shkrime me anë të të cilave nxënësit aftësohen për jetë, *për të shkruar lutjet, ankesat, të shkruarit e letrave, të biografisë, të telegrameve, të plotësuarit e formularve* etj. Mësimi i gjuhës amtare kërkohet që të ndikojë në edukimin e drejtë dhe formimin e drejtë të personalitetit të nxënësit: *ai duhet t'i kontribuojë edukimit të personalitetit të njeriut të ri në frymën komuniste, internacionaliste të jetë humane, të ketë karakter të fortë dhe botëkuptime të drejta etike dhe estetike*.⁴⁷⁰ Plani shtronte kërkesë që të paktën 2 -3 herë gjatë vitit të organizoheshin leximi, recitimi ushtrimi i të folurit duke përdorur patjetër manjeto fonin, duke hartuar për çdo vit plane të reja të shkoqitura. Ushtrimet e leximit parashiheshin në program prej klasës I -VIII pikërisht për këtë qëllim "*Pra mësimi i leximit i aftëson nxënësit gradualisht për leximin logjik. Elementet e leximit logjik janë: të zbatuarit dhe të kuptuarit, e domethënje, shprehjes së shenjave të pikësimit, të zbuluarit e intonacionit të fjalisë dhe të shquarit e fjalëve. Leximi logjik është thellimi i leximit, një lexim i atillë që bën të mundur që dëgjuesi "të pranojë të gjitha ato që i përmban teksti i lexuar"*.

Ky plan i parashihte edhe dramatizimin- leximin sipas roleve që gradualisht të kalohet edhe në dramatizim e teksteve që kanë karakter tregues, që kanë elemente dramatike. Kështu, në klasën III, IV bëhen përpjekje për dramatizimin e pjesëve më të lehta dhe të teksteve të shkurtër (*të përrallave, të anektdave*), kurse në klasën V kërkohet dramatizimi i teksteve më të gjera, por më të thjeshta-gjithnjë nën udhëheqjen e arsimitarit.⁴⁷¹ Gjatë shkollimit në shkollën fillore, nxënësit kanë pasur raste të lexojnë vjersha, përralla, madje edhe romane, veprat e disa shkrimtarëve i njohin më parë, *prej klasës I – VIII dhe programi shtronte kërkesa për njohje të reja të krijimtarisë së shkrimtarëve tanë*.

Programi i gjuhës shqipe shtronte kërkesë që pos shkrimtarëve për fëmijë, nxënësi i shkollës fillore duhet të dijë për Naim Frashërin, *Konstandinin Kristoforidhin, Jeronim de Radën, Filip Shirokën, Fan Nolin, Migjenin, Sterjo Spassen, Esad Mekulin*, etj. Duke lexuar edhe njohur bie fjala, prej klasës I- VIII vjershat, arsimitari në çdo klasë do të flasë diçka të re mbi këtë shkrimtar, duke ndikuar dhe thelluar për herë dhe më tepër (*e në bazë të veprave, të cilat do t'i njohin nxënësit, që t' i përpunojnë*) personalitetet e shkrimtarit dhe veprat e tij. Kështu ndodhi edhe me shumë shkrimtarë të tjerë e, sidomos kur është fjala për shkrimtarë që shkruanin për fëmijë, si: *Hil Mosi, Regjep Hoxhe, Mark Krasniqi, Tajar Hatipi, Mehmedali Hoxha, Maksut Shehu, Vehbi Kikaj, Rifat Kukaj, etj*. Në grupin tjetër hynin shkrimtarët me të cilët nxënësit i

⁴⁷⁰Gjatë konkretizimit të lëndës lypsej të mbështetej puna në librin e leximit, si tekst shkollor themelor, në fundin e librave të bibliotekës së shkollës dhe mjetet e tjera mësimore që i kishte shkolla.

⁴⁷¹Mësimi i gjuhës amtare sipas këtij programi kërkonte që nxënësit e shkollës fillore të njihen edhe me disa shkrimtarë shqiptarë edhe të popujve të tjerë më të njohur, klasikë e bashkëkohorë që në përqindje ishin më të shumtë.

njihnin për herë të parë në klasët e larta duke filluar nga klasa VI –VIII –mbi ta pastaj do të flitet në këtë klasë. Ky program parashihte të jepen njohuri të plota edhe për disa shkrimtarë, tregime, vjersha, më pas edhe romane të: (Mjeda, Çajupi, Migjeni, Spasse). Ndërsa, si shkrimtarë të grupit të dytë konsideroheshin: *Klasa VI: Çajupi, Asdreni, M.Grameno, F.Shiroka, L.Gurakuqi, H.Mosi, A.Varfi. Klasa VII: K.Kristoforidhi, S.Frashëri, Mjeda, F. Konica, Dh.Shuteriqi, N.Bulka, F.Gjata. Klasa VIII: De Rada, G.Dara i Riu, F.Noli, K. Floqi, A.Asllani, Migjeni, L.Poradeci, S.Spasse, K.Jakova, E. Mekuli.*⁴⁷²

Përveç mësimit të rregullt të gjuhës shqipe, me planin mësuesor ishin planifikuar edhe punët e aktivitetet jashtëshkollore, të cilat ndikonin në zhvillimin e aftësive të pazgjuara. Prandaj, puna jashtëshkollore planifikohej të merrte forma organizative: *gjuhësore, dramatike, kinematografike, gazatareske ose të grupit e të seksionit letrar*. Për secilin grup do të kujdesej nga një arsimtar i gjuhës shqipe. Nxënësit e klasës VII, VIII duhet të shkruajnë referate dhe duhet të mbajnë shënime mbi librin e lexuar sipas udhëzimeve të mësimit të gjuhës shqipe.⁴⁷³

Dihet se Planet dhe programet mësimore (*për të gjitha nivelet e edukimit dhe arsimit*) ishin dhe vijojnë të jenë dokumentacion i rëndësishëm profesional, administrativ e pedagogjik dhe të obligueshme për shkollën. Këto dokumente pedagogjike përfshinë përmbajtjen e pas kapërcimit nëpër këto stadi të “filtra”, rekomandohen që të aprovohen nga ana e organeve kompetente për përdorimin e tyre.⁴⁷⁴ Për të pasqyruar ndikimet eventuale në edukimin atdhetar të nxënësve dhe në formësimin e personaliteteve të tyre, për shqyrtim janë marrë Plan – programet mësimore të gjuhës e letërsisë shqipe (*për klasat I – IV, sipas Plan – programit mësuesor i vitit 1974, 1977, 1982, 1989, 1990 dhe ai i vitit 1996 deri në vitin shkollor 2000/01.*)⁴⁷⁵, ku kryesisht përfshihen përmbajtjet nga *gjuha amtare, letërsia kombëtare, letërsia popullore, letërsia botërore, lektura shkollore, arti skenik, filmi* etj. Derisa, te plani dhe programi në vija të trasha përcaktohen edhe qëllimet që synohen të realizohen gjatë vitit shkollor, ku në bazë të tyre sajohen edhe përmbajtjet programore, të cilat duhet të korrelojnë me ato qëllime.

Plan-programi mësuesor i vitit 1974

Në këtë planprogram,⁴⁷⁶ çuditërisht nuk përcaktohet qëllimi por vetëm detyrat e mësimit të gjuhës e letërsisë shqipe. Kështu, ndër detyrat tjera,⁴⁷⁷ si e veçantë, synohet edhe zhvillimi ndjenjës “... i dashurisë ndaj Atdheut socialist.” Sipas kësaj, detyrë e programit të mësimit të gjuhës e letërsisë shqipe ishte “*që t’i aftësojë nxënësit të kuptojnë realitetin tonë shoqëror, të forcojë vëllazërimin e bashkimin e popujve dhe të kombësive të RSFJ, të zhvillojë dashurinë ndaj atdheut socialist, të ndikojë në formimin e fizionomisë së tyre morale dhe t’i nxisë të marrin*

⁴⁷²Njohuritë mbi shkrimtarët kërkohej të kenë më tepër karakter anekdote, fragmentar, me rëndësinë kushtuar çështjeve edukative.

⁴⁷³ Krahësuar me Planet e programet e mëparshme, ky i vitit 1971 shënon avancim në raportin e përfshirjes së autorëve shqiptarë në raport me ata sllavë e të huaj.

⁴⁷⁴ Nijazi Zylfiu, *Didaktika*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1977, fq. 133.

⁴⁷⁵ Në këtë punim, për analizë janë marrur në shqyrtim të gjitha Plan – programet mësimore që kanë qenë në zbatim gjatë periudhës 1974 – 1998 si: Plan – program mësuesor i vitit 1974, 1977, 1982, 1989, 1990 dhe ai i vitit 1996 deri në vitin shkollor 2000/01.

⁴⁷⁶ Planet dhe programet mësimore për shkolla fillore dhe të mesme, ETMM i KSAK, Prishtinë, 1974.

⁴⁷⁷ Detyrat e tjera: *t’i aftësojë sistematikisht nxënësit të shprehin mirë e bukur ...t’u bëhen të njohura ligjshmëritë elementare të gjuhës letrare ... të përjetojnë artin letrar, të nxisin interesimin e dashurisë ndaj librit, të zhvillojnë ndjenjat estetike, etike, dashurisë ndaj njerëzve, ndaj punës etj.*

pjesë aktivisht në jetën shoqërore”.⁴⁷⁸ E gjithë kjo siç thuhet më tej “mund të sendërtohet gjatë përpunimit të teksteve të ndryshme, të marra qoftë nga letërsia për fëmijë, qoftë nga libër leximi, nga shtypi ose vepra të zgjedhura të letërsisë popullore dhe të shkruara.”⁴⁷⁹ Në formulimet e detyrave të përmendura vërehet, se tërësisht dominon fryma ideologjike nga fakti i thjeshtë, se edhe kur përmendet atdheu, flitet për “*atdheun socialist*” dhe siç përcaktohet, më tej, qëllimi përfundimtar i mësimi të gjuhës amtare duhet të ndikojë “*medoemos në edukimin e drejtë dhe formimin e drejtë të personalitetit të njeriut të ri në frymën komuniste, internacionaliste, të jetë human, të ketë karakter të fortë dhe botëkuptime të drejta etike e estetike.*”⁴⁸⁰

Plani dhe programi mësimor për gjuhë amtare, 1977

Me planin dhe programin mësimor për shkollën fillore të vitit 1977, që është miratuar Pleqësia e Arsimit e KSA të Kosovës, në mbledhjen e saj të dt. 7 janar të vitit 1977, vërehen disa ndryshime, si: zvogëlimi i fondit të orëve të gjuhës amtare në tri orë më pak nga gjithsejt orë, të llogaritur për të gjitha klasat dhe zvogëlimi i fondit të orëve të gjuhës serbe, për pesë orë në të gjitha klasat. Ky plan kishte këtë fond javor orësh mësimore prej 64 orësh për të gjitha klasat e arsimit të detyrës:

Tabela 16. Fondi i orëve mësimore për gjuhë amtare sipas Planit dhe programit mësimor, 1977

Nr. ren.	Lëndët mësimore	K l a s a t								
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	Gjithsej
1.	Gjuhë amtare	6	6	6	5	5	4	4	4	40
2.	Gjuhë joamtare				2	2	2	2	2	10
3.	Gjuhë e huaj					3	3	3	3	12
Gjithsej		6	6	6	7	10	9	9	9	62

Me këtë dokument zyrtar (*plan dhe program*) është filluar të punohet në vitin shkollor 1977/78 për I, II dhe V, ndërsa në çdo vit vijues edhe në çdo dy klasa (III dhe VI dhe në vitin shkollor 1979/80 klasat IV dhe VII, dhe në fund, në vitin shkollor 1980/81 klasa VIII).⁴⁸¹ Mësimi dhe format e tjera të punës edukativo-arsimore gjatë vitit shkollor ishin të përcaktuara të zgjasin së paku 190 ditë mësimi. Plani dhe programi i vitit 1977, në vitin 1982, kishte pësuar ndryshime. Ndryshime, plotësime dhe korrigjime kishte vetëm në program, ndërsa plani (*me fond të njëjtë të orëve*) ka mbetur i pandryshuar. Qëllimi i ndryshimeve ishte që “*programet të lirohen nga përmbajtjet të cilat nuk kishin kontribuar në masë të duhur në realizimin e qëllimeve ideore dhe edukative në shkollën fillore..., ndërsa përmbajtjet e reja kishin për qëllim të kontribuonin në zhvillimin e internacionalizimit dhe të patriotizmit socialist jugosllav...*”⁴⁸² Nga programet

⁴⁷⁸ Po aty, fq.9.

⁴⁷⁹ Po aty, fq.37.

⁴⁸⁰ Po aty, fq.29.

⁴⁸¹ Plani dhe programi unik i punës arsimore edukative në shkollën fillore, Prishtinë, 1977.

⁴⁸² Plani dhe programi i korrigjuar i punës arsimore edukative në shkollën fillore, Prishtinë, 1982. Me propozimin e Entit Krahinor për Përpbatimin e Arsimit e të Edukimit, Pleqësia e Arsimit e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e datës 18 nëntor të vitit 1982, e kishte aprovuar Rregulloren mbi planin dhe programin e korrigjuar të punës arsimore-edukative në shkollën fillore për lëndët: gjuhë amtare, gjuhë turke, gjuhë joamtare, dituri natyre e shoqërie, dituri shoqërie dhe histori me baza të socializmit vetëqeverisës.

mësimore të lëndës mësimore (*gjuhën shqipe*) ishin mënjanuar përmbajtjet, të cilat kishin nxitur paraqitjen e “*nacionalizmit dhe të seperatizmit*” shqiptar dhe që” *kishin glorifikuar të kaluarën historike*”! Sipas kërkesave nacionaliste serbomadhe ata në plenumet e veçanta partiake e shtetërore kërkohej që nxënësit shqiptarë më tepër duhej të mësonin letërsinë dhe historinë e popujve të ish-Jugosllavisë sesa letërsinë dhe historinë e popullit shqiptar, sepse kjo sipas tyre kishte ngritur “*kundërrevolucionin*”. Me një joprofesionalizëm dhe me diktat nga Beogradi, nga përmbajtjet e lëndës mësimore *gjuha shqipe* ishin hequr shkrimtarët e dalluar shqiptarë, duke u zëvendësuar me shkrimtarë më pak të njohur ose edhe me shkrimtarë sllavë.

Plani dhe programi unik i punës arsimore edukative në shkollën fillore, të Kosovës, për vitin 1977, kishte përcaktuar këto detyra të mësimin të gjuhës shqipe: “*Që t’i ftojme nxënësit sistematikisht q që të shprehen mirë e bukur me gojë e me shkrim mbi gjuhën e njësuar letrare!.. ,që ndërmjet të veprave të zgjedhura të letërsisë gojore së shkruar (të popullit shqiptar dhe të popujve të tjerë) t’i aftësojë nxënësit të kuptojnë dhe të shijojnë artin letrar; që të zgjojë e të nxisë interesin dhe dashurinë e nxënësve ndaj librit..., që t’i aftësojë nxënësit të kuptojnë rilitetin shoqëror vetëqeverisjes, të forcojë vllazërimin e bashkimin e kombeve dhe të kombësive të RSFJ, të zhvillojë tek ata dashurinë ndaj atdheut socialist vetëqeverisës, të ndikojë në forcimin e fizionomisë së tyre morale dhe të nxisë të marrin pjesë në aktivitete në jetën shoqërore; që duke njohur veprat letrare me vlerë të popujve të tjerë, të zhvillojë te nxënësit jo vetëm dashurinë ndaj letërsisë si vlerë kulturele e përbashkët e njerëzimit, por edhe dashurinë e popujve të tjerë dhe ndaj luftës së tyre për ...”.*

Leximi dhe shkrimi fillestar përfshinte këta lëmenj: *Përpunimi i teksteve leximi dhe recitimi: Të shprehurit me gojë dhe me shkrim: Njohuri mbi gjuhën (gramatikë).*

Për të realizuar mësimin sa në mënyrë sa më të suksesshme dhe në frymën e këtij programi duhej që arsimtari, jo vetëm të ketë përgatitje të duhur profesionale, por edhe të njohë mirë metodikën e mësimin të gjuhës amtare.⁴⁸³ Sipas këtij programi kërkohej që mësimin të gjuhës amtare t’i kontribuojë ushtrimeve të leximit dhënies së njohurive themelore mbi letërsinë, si edhe në orët e ushtrimeve të të folurit etj. Qëllimi themelor i mësimin të gjuhës shqipe sipas këtij dokumenti, ishte kultura e fjalës së folur dhe të shkruar, kultura në përgjithësi nuk mund të fitohen menjëherë. Asnjë program mësimor i këtyre dekadave nuk ishte i liruar nga sllogani ideologjik, që “...t’i të kontribuojë edukimit të personalitetit të njeriut të ri në frymën, komuniste internacionale, të jetë human”, e më pastaj të ketë karakter të fortë etike dhe estetike. Gërshetimi i detyrave të njërës lëmë me tjetrin, ndërthurja e tyre logjike dhe funksionale, kërkohej të sigurojë unitetin e mësimin por njëkohësisht kërkohej të sigurojë edhe bashkimin të formave dhe të kuptimeve të gjuhës dhe të letërsisë. Leximi dhe recitimi kishin rëndësi të madhe për zhvillimin e kulturës gjuhësore dhe të aftësive shprehëse të nxënësve. Recitimi, sikur dhe leximi, kultivohej prej klasës I-VIII dhe mbështetej në të kuptuarit e tekstit.⁴⁸⁴ Prej leximit sipas roleve kalohej gradualisht edhe në dramatizimin e teksteve. Kështu, në klasën III, IV bëhen përpjekje për dramatizimin e pjesëve më të lehta dhe të teksteve të shkurta (të përrallave, të anaktodave), kurse në klasën V kërkohej dramatizimi i teksteve më të gjera, gjithnjë nën

⁴⁸³Prandaj, ishte kërkesë e Planit e programit mësimor që arsimtarët ta ndjekin dhe ta studiojnë literaturën profesionale pedagogjike dhe të mësojë nga shembuj të e mirës të praktikës. Ky freskim i njohurimeve dhe synimi i perhershem për profesionale duhet të bëhet qenësore e çdo arsimtari

⁴⁸⁴Rekomandohej që në orët e ushtrimeve të leximit e të recitimit të perdoren kohëpaskohe disqe e gramafonit e sidomos manjeto fonit ,në mënyrë që çdo nxënës të dëgjojë veten si është duke lexuar apo recituar dhe kështu t’i mënjanojë më lehtë të metat që mund t’i ketë.

udhëheqjen e arsimitarit.⁴⁸⁵ Për nxënësit e shkollës fillore kërkohet të njohin edhe disa shkrimtarë shqiptarë dhe të popujve të tjerë, më të njohur-klasikë e bashkëkohës. Gjatë shkollimit në shkollën fillore, nxënësit planifikohej të lexojnë vjersha, përralla, madje edhe romane. Nxënësit duhej të hartojnë 1-2 referate, duke filluar nga klasa e pestë.

Qëllimi i ushtrimit të të shprehurit me gojë e me shkrim ishin definuar të mbahen që duke filluar prej klasës së parë “...nxënësit të aftësohen të flasin, e pastaj edhe të shkruajnë me fjalë të plota; të zhvillohen kujdesen, aftësinë e të lidhurit të mendimit e të hartimit (ritregimi i asaj që kanë lexuar, parë ose dëgjuar; tregimi i përjetimeve të ndarë, gjësë qensore nga ajo jo qenësore-prej klases I-VIII);aftësia e të vrejtuarit (të vrejtuarit dhe përshkrimi i objekteve , i dashurive etj..p.sh. prej klasës I-VIII dhe ,në fund ,që t’ i aftësoj nxënësit për t’u paraqitur para publikut – prej klasës VI-VIII (recitimi prej kalsës I –VIII).Megjithëse forma e ushtrimeve me gojë e me shkrim , duke filluar prej klasës III-VIII , janë pothuajse të njëjta –kjo s’do të thotë se çdo ushtrim i të shprehurit me gojë duhet të kalojë me doemos drejtpërdrejt në ushtrime me shkrim.”⁴⁸⁶Vetëm pasi nxënësit ta kanë përvetsuar mirë një formë të të shprehurit me gojë, mund të kalohet në ushtrime me shkrim.

Disa kërkesa specifike të Plan-Programit të vitit 1977

Edhe pas ndryshimeve të bëra pas tri vitesh përdorimi, sa i përket përcaktimit të detyrave të mësimi të gjuhës dhe letërsisë shqipe, edhe te ky planprogram mësimor⁴⁸⁷ duket të jetë pothuajse identik me atë të vitit 1974. Pra, është përcaktuar e njëjta detyrë me të vetmin ndryshim se “zhvillimit të dashurisë ndaj atdheut socialist”, shtrohet “korrigjohet” tani edhe atributi “vetëqeverisës”, ndërsa gjithçka tjetër mbetet tërësisht e njëjtë. Ky dokument, edhe në pjesën “Sqarime”, formulimi mbi ndikimin e gjuhës amtare është i njëjtë “ai duhet t’i kontribuojë edukimit të personalitetit në frymën komuniste...”⁴⁸⁸ As ky plan – program nuk i shpëton dominimit të frymës ideologjike, kjo dëshmohet edhe në “Udhëzime...”, ku konfirmohet se “ me rastin e zgjedhjes së përmbajtjes mësimore edukative është marrë parasysh baza ideologjike e edukimit në shoqërinë tonë socialiste, që mbështetet në shkencën ideologjike “marksiste”.⁴⁸⁹ Për të kërkuar edhe konkretisht që arsimtari “ta këtë të qartë faktin që çdo subjektivizëm dhe neutralitet politik duhet të jetë gjë e huaj për të.”⁴⁹⁰ Mësimi i gjuhës dhe i gramatikës sipas planit e programit të vitit 1977, nga njëra anë, duhej të kuptohet si mjet që të ndihmojë zhvillimin e kulturës së nxënësve në të shkruar dhe në të lexuar, e nga ana tjetër, si mjet për t’i futur nxënësit në ligjësitë elementare të gjuhës shqipe. Sipas këtij dokumenti zyrtar, kërkohet që gjatë shpjegimit të tingujve, t’i kushtohet kujdes i veçantë njohjes së funksionit të organeve të të folurit nga ana e nxënësve, si dhe karakterin e llojeve të tingujve të ndryshëm të cilët duhet vërejtur gjithmonë në të folur dhe gjatë leximit. Pra, gjatë përpunimit të fonetikës

⁴⁸⁵Leximi, recitimi e dramatizimi kerkohej të zhvillohen në mënyrë që të arrihet, jo vetëm që nxënësit të futen sa më thellë në tekst.

⁴⁸⁶Plani dhe programi unik i punës arsimore edukative në shkollën fillore, Prishtinë, 1977.

⁴⁸⁷ Ky plan ka hyrë në zbatim në fillim të vitit shkollor 1977/78 në klasat e para, të dyta dhe të pesta. Nuk jepen përmbajtjet programore. Janë përcaktuar detyrat e përgjithshme por jo sipas klasave (I – IV). Është dhënë numri javor por jo vjetor : I=6 , II=6 , III=6 , IV=5.

⁴⁸⁸ Po aty, fq.35 , krahaso me planprogramin (1974) fq.9-29.

⁴⁸⁹ Udhëzime didaktiko metodike për realizimin e planit dhe programit unik të punës

Arsimore – edukative në shkollën fillore, Buletini Arsimor i KSAK, Prishtinë, Janar, nr.1, 1978, fq.5.

⁴⁹⁰ Po aty, fq.5.

arsimtari duhej të ketë parasysh faktin se kjo s'mund të përpunohet veçmas, siç ndodh me njësitë e tjera mësimore; por, me rastin e përpunimit të teksteve nga pikëpamja gjuhësore të përqendrohej vëmendja me rastet që kanë të bëjnë më ndërrimet tingullore të gjuhës shqipe.

Në të gjitha klasat e sidomos në klasën parë, t'i kushtohet kujdes i veçantë shqiptimit të drejtë të tingujve; *q, ç, gj, xh, th, dh, ll, rr, ë*. Po ashtu, kërkohej që kujdes i veçantë t'i kushtohet sintaksës së fjalisë. Në strukturën e periudhës ka rëndësi që nxënësit t'i dallojnë mardhëniet midis fjalive të varura dhe të pavarura, si domethënien e drejtë të tyre. Skajshmëria e ideologjizimit të planeve dhe programeve ilustron edhe me faktin se ushtrimet e të shprehurit me gojë e me shkrim kërkohej që *"...të jenë të përshtatshme po ashtu për t'i edukuar nxënësit me frymën socialiste (dashuria për punë, për traditat e revolucionit popullor, dashuria ndaj kombeve dhe kombësive të bashkësisë sonë socialiste vetëqeverisëse, si dhe ndaj njeriut e lirive të tij në përgjithësi)."*⁴⁹¹ Mësimi mbi gjuhën (*gramatika*) siguronte mundësi të gjera për edukimin intelektual, estetik dhe moral të nxënësve. Edhe me këtë plan dhe program mësimor parashihej puna jashtëshkollore që në forma organizative, manifestohej në punën e *grupeve gjuhësore, dramatike, kinematografike, gazetareske ose të grupit e të seksionit letrar.*⁴⁹²

4.2.6. Planet dhe programet mësimore, vitet '80

Për shkak të rrethanave politike të vitit 1981 ishte *"ngritur në këmbë"* gjithë aparati shtetëror e partiak i Beogradit i orientuar mbi shkollën në gjuhën shqipe. Arsimin e kishin shpallur *"fajtor kujdestar"* për shpërthimin e revoltës gjithëpopullore në Kosovë. Në bazë të rrethanave të krijuara, dukej e *"nevojës"* për të bërë ndryshimin dhe plotësimin e planeve dhe programeve në punë edukative –arsimore të arsimit fillor dhe edukimit të mesëm të orientuar.⁴⁹³ *"Ndryshimet dhe plotësimet ishin bërë me qëllim që të lirohen programet prej atyre përmbajtjeve, të cilat i kanë kontribuar në një masë të duhur, realizimit të qëllimeve ideore dhe edukuese në arsimin dhe edukimin e mesëm të orientuar, si dhe me qëllimin që nxënësit të shkarkohen prej fakteve të tepërta, prej përmbajtjeve, të cilat nuk janë në harmoni me mundësitë e tyre psikofizike."*⁴⁹⁴

Njëkohësisht programet u *"plotësuan"* me përmbajtjet e reja, që te nxënësit të zhvillojnë vetëdijen për nevojat e forcimit dhe pasurimit të përhershëm të *"vllëzërimit e bashkimit, bashkjetesës"* të kombeve e kombësive. Përmbajtjet e reja planifikohej se do t' i kontribuonin edhe më shumë të zhvillojnë ndryshimet e *"patriotizmit dhe internacionalizimit socialist jugosllav"* dhe do t'u ofrojnë nxënësve dituri të nevojshme për luftën e përbashkët të kombeve e kombësive tona në Luftën Nacionalçlirimtare dhe gjatë revolucioneve, do t'u ofrojnë dituri për përpjekjet dhe të arriturat në ndërtimin e RSFJ-së si *"bashkësi vetëqeverisëse e kombeve dhe e kombësive."* Në këtë planprogram të korigjuar ishin dhënë tekstet integrale të programit me të gjithë ndryshimet dhe plotësimet për lëndët në fjalë. Sidomos ishin *"modifikuar"* qëllimi dhe

⁴⁹¹ *Plani dhe programi unik i punës arsimore edukative në shkollën fillore*, Prishtinë, 1977.

⁴⁹² Për secilin grup caktohej të kujdesej nga një arsimtar. Këto grupe do të bashkpunojnë edhe me grupet e tjera të shkollës, sa herë që të shfaqet nevoja; fjala vjen, me rastin e dhënies së shfaqjeve të gjera shkollore.

⁴⁹³ Me propozimi e Entit Krahinor për përmbajtjen e Arsimimit dhe të Edukimit dhe të komisioneve profesionale, Këshilli Arsimor i KSA të Kosovës e ka aprovuar Planin dhe programin e korigjuar mësimor të gjuhës shqipe dhe të gjuhës serbokroate (gjuhën joamtare dhe amtare), të gjuhës turke, të bazave të marksizmit dhe socializmit vetëqeverisës si dhe të historisë.

⁴⁹⁴ Ky arsytim ishte një farsë politike, sepse qëllimi kryesor i politikës serbe ishte rikthimi i gjendjes së arsimit në Kosovë në rrethanat e kohës së "krajlave"!

detyrat e mësimi të gjuhës dhe letërsisë shqipe. Me këto ndryshime si qëllim e detyrë përbrenda planit ishin dhe synimet e pushtuesit. Kështu në mes tjerash ishin paraparë këto detyra: “*Që nxanësit të njohin veprat më të rëndësishme dhe shkrimtarët më të njohur të letërsisë shqipe, jugosllave e botërore; që nxanësit të aftësohen për të kuptuar vlerën ideoestetike të veprës letrare; ... të zhvillojnë dhe të formojnë botëkuptimin marksist të nxënësve ndaj letërsisë e ndaj botës; të kontribuojë për formimin e vlerave morale dhe të vetive të karakterit të nxënësve; të ndikojnë në formimin e ndjenjës së patriotizmit socialist vetëqeverisës të nxënësve dhe të zhvillojë ndjenjën e nxënësve për bashkëjetesën dhe ndjenjën e përbashkësisë së kombeve e të kombësive të jugosllavisë.*”⁴⁹⁵

Plan-programi (i “*korrigjuar*”) i vitit 1982

Pas ngjarjeve të njohura të vitit 1981, “*Pranverës studentore*” edhe përpjekja e sunduesve sllav shtrihet mbi gjithçka shqiptare edhe mbi planprogramet mësimore.⁴⁹⁶ Kështu, edhe me ndryshimet e radhës shtrohen po ato detyra⁴⁹⁷ si në plan – programet paraprake (1974 dhe 1977) dhe haptas kërkohet që ndryshimet e plotësimet e bëra t’i kontribuojnë qëllimeve ideore e politike të alanofobëve. Kështu që, në “*Vërejtjet hyrëse*”, veç të tjerash hetohet tehu i angazhimeve të politikëbërësve. Kjo argumentohet me formulimin e thënë, gjoja se “*programet janë plotësuar me përmbajtje të reja, të cilat janë shprehje e lëvizjeve bashkëkohore në shoqërinë tonë e që nxënësit zhvillojnë vetëdijen për nevojën e forcimit dhe pavarësimi të përhershëm e të vazhdueshëm të vëllazërimit dhe bashkëjetesës së kombeve dhe kombësive tona. Përmbajtjet e reja, do t’i kontribuojnë edhe më shumë zhvillimit të patriotizmit dhe internacionalizmit jugosllav . . .*”⁴⁹⁸

Për t’u sendërtuar një edukim i tillë në këtë frymë në këtë planprogram (për dallim nga ai i vitit 1974 dhe 1977) parashikohen edhe detyra të veçanta për secilën klasë (I- IV).⁴⁹⁹ Disa kërkesa të reja kishin përcaktuar ndryshimet e bëra nga plan - programi paraprak. Në këtë planprogram (të *korrigjuar*) edhe më shumë forcohen kërkesat për afirmimin e vlerave ideore dhe edukimin e personalitetit mbi këtë bazë ideologjike.

⁴⁹⁵ Plani dhe programi i korrigjuar mësimor i gjuhës shqipe dhe të gjuhës serbokroate (gjuhën joamtare dhe amtare) të gjuhës turke, të bazave të marksizmit dhe socializmit vetëqeverisës si dhe të historisë.

⁴⁹⁶ Plani dhe Programi i korrigjuar i punës arsimore – edukative në shkollën fillore, Buletini Arsimor i KSAK, Prishtinë, 1982. (Ky plan-program është aprovuar nga pleqësia e Arsimi të KSAK, nëntor 1982, ku nuk jepen përmbajtjet programore. Është dhënë plani javor i orëve : I=6 , II=6 , III=6 , IV=5. Janë operacionalizuar detyrat sipas klasave.

⁴⁹⁷ Po aty, fq.7, krahaso: me Planprogramin (1974) fq.9 dhe Planprogramin (1977) fq.11.

⁴⁹⁸ Po aty, fq.5.

⁴⁹⁹ Klasa e parë: “*Arsimtari duhet ta shfrytëzojë çdo njësi mësimore që të arrijë efekt të përcaktuar në frymën e vëllazërimit e të bashkimit të kombeve e kombësive tona, të patriotizmit jugosllav, të përbashkësisë e të internacionalizmit .*” (Po aty, fq.9.)

Klasa e dytë: “*Arsimtari duhet të marrë tema nga LNÇ e kombeve dhe e kombësive tona, nga realiteti ynë shoqëror e vetëqeverisës, nga ndërtimi socialist i vendit tonë, kombësive tona, nga jeta dhe nga puna e “shokut Tito” .* (Po aty, fq.11.)

Klasa e tretë: “*... duhet të merren tema nga LNÇ e kombeve dhe e kombësive të RSFJ nga vetëqeverisja dhe ndërtimi socialist i vendit tonë, nga përbashkësia e kombeve dhe e kombësive tona, nga jeta dhe puna e shokut Tito, nga aktiviteti i njerëzve” .* (Po aty, fq.14.)

Klasa e katërt: “*të merren tema nga LNÇ e kombeve dhe kombësive tona, nga Revolucioni nga ndërtimi socialist i vendit tonë, nga jeta dhe vepra e shokut Tito, nga vëllazërim e bashkimi i kombeve dhe kombësive tona, nga aktiviteti i vendit tonë në lëvizjen e të painkuadruarve” .* (Po aty, fq.17.)

Udhëzime didaktiko-metodike për programin mësimor të vitit 1982

Viti 1981 shënon shndërrimin e mësimdhënësit në “përçues të mesazheve” të politikëbërësve të arsimit se “...ky ndryshim del nga nevoja e transformimit të sistemit tonë shkollor, sidomos e atij të mesëm. Në fazën e parë të arsimit të mesëm të orientuar (klasa I, II) kemi përfshirë materialet mësimore, sidomos nga letërsia, në mënyrë të përgjithësuar dhe kështu është bërë njëfarë rrumbullaksimi sa i përket përfshirjes së lëndës për arsye objektive.” Jo rastësisht tehu i “shpatës së Demokleut” ishte ngritur mbi “qafën” e nxënësve të fazës së parë të arsimit të mesëm të orientuar, për të cilët kërkohej që të jepej e përmbledhur dija mbi krejt letërsinë. Pas periudhës së Rilindjes, periudha në mes dy luftrave botërore shënohej një pjesë të letërsisë së viteve ’30, që t’i njohin një numër më të madh shkrimtarësh të kësaj periudhe. Në këtë kapitull kjo detyrë i mbetej arsimtarit, i cili do të zgjedhë nga 3-4 poezi (nëse shkrimtari është poet), ose nga një roman (nëse shkrimtari është romancier), apo nga 2-3 novela (nëse shkrimtari është novelist), të shkrimtarëve të paraparë dhe t’ua japë nxënësve detyrë që t’i lexojnë e pastaj të analizohen.

Në kapitullin ‘Letërsia bashkëkohore shqipe’ (në klasën e IV) janë paraparë për interpretim përmbledhje tregimesh e poezish të autorëve të ndryshëm. Kjo nuk do të thotë se duhet të përpunohen e të analizohen të gjitha tregimet apo të gjitha vjershat që përfshihen në ato përmbledhje, por të zgjedhen 2-3 tregime apo 4-5 vjersha më tipike, më karakteristike të secilit autor. Gjuhës dhe kulturës së të shprehurit i është kushtuar kujdes i duhur.

Duke u mbështetur në shkallën e njohjes së gjuhës amtare të nxënësve ishte parë e arsyeshme që “prej 66 orëve të mësimin për një klasë, 25, respektivisht 26 orë t’i kushtohen gjuhës, përvetësimin të saj përmes këtyre orëve, nxënësit duhet ta përvetësojnë gjuhën e njehsuar letrare, të aftësohen që ta flasin e ta shkruajnë drejt, të aftësohen që të shprehen rrjedhshëm e bukur si me gojë ashtu edhe me shkrim.”⁵⁰⁰ Kjo punë planifikohej të arrihej përmes ushtrimeve me shkrim e me gojë, përmes hartimeve, diskutimeve, referateve e detyrave të ndryshme, nxënësit duhet të aftësohen që të shprehen në gjuhën amtare me gjuhë të drejtë e të pastër dhe me stil të qartë e të rrjedhshëm.⁵⁰¹

Plani dhe programi mësimor për gjuhë dhe letërsi shqipe i vitit 1985

Plani dhe programi mësimor për vitin 1985, u miratua në mbledhjen e Pleqësisë së Arsimit të Kosovës, më 23 gusht të vitit 1985.⁵⁰² Ky plan ishte paraparë të realizohet për 38 javë, përkatësisht për 190 ditë të punës së përbashkët arsimore–edukative. Në klasën V – 190 ditë mësimi, në klasën VI - 185 ditë, kurse në klasat VII dhe VIII - nga 175 ditë të mësimin. Ditët e tjera, deri në gjithsejt 205 ditë pune ishin planifikuar për aktivitete të tjera shkollore dhe jashtëshkollore.

⁵⁰⁰ Pothuaj shumica e ndryshimeve të bëra në Planin dhe programin e korigjuar mësimor të gjuhës shqipe dhe të gjuhës serbokroate (gjuhën joamtare dhe amtare) të gjuhës turke, të bazave të marksizmit dhe socializmit vetëqeverisës si dhe të historisë, ishin bërë si presion i politikës jugosllave (lexo: serbe-vërejtje ime R.Gj.).

⁵⁰¹ As arsyetimet e zyrtarëve të arsimit të KSAK, nuk ishin të besueshme se gjoja se “Për hir të kontinuitetit dhe për të realizuar sa më mirë programin mësimor të gjuhës shqipe e të letërsisë të fazës së dytë të arsimit të orientuar si dhe për të parë arsyen pse në të nuk janë përfshirë disa shkrimtarë të periudhës në mes dy luftrash dhe të letërsisë bashkëkohore, është e domosdoshme që të lexohet me kujdes dhe të njihet programi mësimor i gjuhës shqipe dhe i letërsisë për fazën e parë të arsimit të mesëm të orientuar.”

⁵⁰² Plan–programi i njësuar i punës edukativo–arsimore në shkollën fillore, ETMMK, Prishtinë, 1989.

Plani mësimor për gjuhë dhe letërsi shqipe i vitit 1985⁵⁰³ erdhi nga presionet politike mbi shkollën shqipe sa vinin e shtoheshin mbi shkollën, ku qëllimi i punës edukative -arsimore të mësimin të gjuhës dhe të letërsisë shqipe kërkohet të orientohet drejt “përvetësimin dhe kultivimin të gjuhës shqipe, letërsisë dhe kulturës shqiptare”, mirëpo duket se qëllimi ishte më shumë i orientuar për mësimin e imponuar të “letërsive dhe kulturave të kombeve dhe të kombësive të RSF të Jugosllavisë dhe të popujve të tjerë; zhvillimi i dashurisë për atdheun – RSFJ-së shoqërinë tonë socialiste vetëqeverisësen dhe për frytet e LNÇ –së ; formimi i vetëdijes për rolin historiko- shoqëror e kulturor të gjuhës dhe të letërsisë për afrimin e popujve dhe të kulturave të tyre: formimi i gjithanshëm i personalitetit të nxënësve, edukimi i nxënësve në frymën e përcaktimeve socialiste dhe vetëqeverisëse të patriotizmit socialist jugosllav e të internacionalizmit prtoletrar; zhvillimi i interesimit të qëndrueshëm të nxënësve për gjuhën e letërsinë dhe për artin në përgjithësi.”⁵⁰⁴

Tabela 17. Fondi i orëve mësimore për lëndën gjuhë dhe letërsi shqipe i vitit 1985

Nr. ren.	Lëndët mësimore ⁵⁰⁵	K l a s a t								
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	Gjithsejt
1.	Gjuhë e letërsi shqipe	6	6	6	5	5	4	4	4	40
2.	Gjuhë joamtare				2	2	2	2	2	10
3.	Gjuhë e huaj					3	3	2	3	11
Gjithsej		6	6	6	7	10	9	8	9	61

Detyrat e punës edukativo-arsimore për mësimdhënësit e gjuhës shqipe, sipas këtij “pamfleti” politik, ishin që “nxënësit duhen të përvetësojnë në mënyrë sistematike normën e gjuhës letrare shqipe, t’i njohin format dhe mundësitë shprehëse të saj për zbatuar drejt me gojë e me shkrimtë njihen nxënësit me veprat letrare që kanë në vlera të qëndrueshme artistike e kulturore, të krijuara në gjuhën shqipe dhe në gjuhën e kombeve dhe të kombësive të jugosllavisë e më gjerë. Të aftësohen nxënësit për të lexuar në mënyrë të pavarur, që t’i kuptojmë, t’i përjetojmë dhe t’i vlerësojmë në mënyrë kritike veprat letrare (të letërsisë së traditës dhe të letërsisë së sotme). Kjo ishte përkufizuar për të kamufluar qëllimin final, imponimin e një kulture dhe një letërsie të huaj mbi atë kombëtare.

Madje në këtë program nuk ngurohej që krahas kërkesës që të kultivohen dashuria për librin, si një nga burimet e njohurive dhe të përjetimeve artistike, prapavijë ideologjike të planifikohej që “të zhvillohet puna kërkimore, shprehitë e punës, mendimi kritik dhe pikëpamja shkencore, marksiste për botën.”

Madje, duke u orvatur të ndërhyhej në horizontet shpirtërore dhe të humanizmit të personalitetit të nxënësve, kërkohet që “Të binden nxënësit se e ardhmja do të jetë e atillë e krijuar vetë me punën e përditshme; të kultivohen vllazërimi-bashkimi e bashkëjetesa e kombeve dhe e

⁵⁰³Pleqësia e Arsimit e KSA të Kosovës në vitin 1985 kishte miratuar Plan-Programin e njësuar të punës edukativo-arsimore në shkollën fillore, dokument i cili shkonte përtej planit e programit të vitit 1982. (Kështu në vitin 1985 Pleqësia e Arsimit e KSA të Kosovës kishte miratuar Plan-Programin e njësuar të punës edukativo-arsimore, në rrethana të disfavorshme politike!)

⁵⁰⁴ Këto detyra dhe qëllime në vete fshihnin tërë mllëfin e tubuar të shovinizmit serb, duke u vërsulur mbi identitetin shqiptar, mbi kulturën, letërsinë dhe gjuhën shqipe, duke favorizuar atë jugosllave!

⁵⁰⁵ Pleqësia e Arsimit e KSAK, *Plan-programi i njësuar i punës edukativo-arsimore në shkollën fillore*, Prishtinë, 1989.

kombësive të jugosllavisë dhe marrëdhëniet socialiste vetëqeverisëse, të respektohen trashëgimia kulturore, traditat liridashëse dhe frytet e LNÇ-së.”

Përvetësimi gradual i nocioneve teorike -letrare dhe qëllimi themlor ishte që nxënësit ta ndiejnë, ta përjetësojnë e pastaj ta kuptojnë veprën, mendimin e shkrimtarit dhe në këtë mënyrë të futen gradualisht në botën letrare. Nxënësit e shkollës fillore kërkohej të kenë njohuri edhe për disa shkrimtarë klasikë e bashkëkohorë të kombeve e të kombësive të Jugosllavisë dhe të popujve të tjerë por jo në nivel historik -letrar.

Gjatë mësimit në shkollën fillore nxënësit kishin rastin të lexojnë poezi, prozë, dramë dhe lloje të tjera letrare-shkencore. Në çdo klasë, që nga klasa I-VIII, nxënësit planifikohej të njohin prozën dhe poezinë popullore shqiptare. *(Këto njohuri arriheshin në mënyrë të përgjithshme e pa hollësi dhe ndarje në grupe.)* Nxënësit duhej të hartonin 1 -2 vështrime, duke filluar që nga klasa V. Mësimi i gjuhës dhe i letërsisë shqipe shtronte edhe kërkesën që t'i njohë nxënësit edhe me elementet e artit filmor e skenik.⁵⁰⁶ Gjatë procesit mësimor planifikohej ë mësuesi t'u përkujtojnë herëpashere nxënësve se cilën vepër duhet ta lexojnë edhe, kur do të analizohet ajo. Analiza e veprës së paraparë në lektyrë përpunimi i saj, bëhej me gojë e me shkrim, pavarësisht nga moshë e nxënësve.⁵⁰⁷

Gjatë ndriçimit të kontekstit shoqëror-historik në të cilin është krijuar një vepër letrare me tematikë nga Lufta Nacionalçlirimtare, arsimtari kërkohej që të ketë kujdes që të vërtetat e ngjarjes historike, shpjegohen në mënyrë objektive shkencore. Ky proces i mësimit duhet të zhvillohet në mënyrë të përshtatshme didaktike duke pasur parasysh moshën, psikikë dhe botën emocionale të nxënësve.⁵⁰⁸ Që nga klasa VI, nxënësit mësonin për artin filmor dhe dramatik, për teorinë e tij, por në mënyrë të thjeshtë. Programi cakton detyrat që nga klasa III –VIII.

Një pjesë e rëndësishme në këtë plan ishte rezervuar për realizimin e qëllimeve të ushtrimeve të të shprehurit me gojë e me shkrim, duke filluar prej klasës së parë , “... nxënësit të aftësohen për të folur e pastaj edhe për të shkruar me fjali të plota, të zhvillojnë kujtesën, aftësinë e të lidhurit të mendimeve e të hartimit (ritregimi i asaj që kanë lexuar, që kanë parë ose dëgjuar, tregimi i përjetimeve, dallimi i gjërave qenësore nga ato joqenësore –prej klasës I-VIII), të aftësohen për të vrejtur (të vrejturit dhe përshkrimi i objekteve, i dukurive etj., p.sh. prej kalsës I-VIII) dhe në fund t'i aftësohen për t'u paraqitur para publikut –prej klsasës I-VIII (recitimit prej klasës I-VIII).”,⁵⁰⁹

⁵⁰⁶ Ishte kërkesë programore që nxënësit të aftësoheshin për të shikuar e kuptuar filmin dhe shfaqjen teatrore, që nga klasa III. Duhej të zhvilloheshin biseda për filmin.

⁵⁰⁷ Në orën e mësimit kur përpunohej lektyra shkollore zhvillohej bisedë e diskutim rreth veprës së lexuar. Këtë bisedë e udhëhiqte arsimtari. Me atë rast planifikohej të flitet për përmbajtjen dhe për formën artistike të veprës letrare.

Nxënësit e klasës V-VIII kërkohej të hartojnë punime hartime (*vështrime*) dhe të mbajnë shënime për librin e lexuar sipas udhëzimeve të arsimtarit. Punimet e nxënësve duhej të lexoheshin në klasë dhe pastaj zhvillohej diskutimi rreth tyre. Në fund arsimtari, planifikonte të jepte vlerësimin e vet lidhur me punimin, diskutimin dhe veprën e trajtuar.

⁵⁰⁸ Edhe me këtë plan dhe program mësimor vend i rëndësishëm ishte dhënë për punën jashtëmësimore, në interesimin më të thellë për gjuhën e letërsinë, për filmin a shfaqjen e pjesëve dramatike, pastaj për krijimin dhe orientimin e drejtë të publikut lexues teatrore e të filmit.

⁵⁰⁹ Megjithëse format e ushtrimeve me gojë e me shkrim, duke filluar prej klasës III-VIII , ishin pothuajse të njëjta, çdo ushtrim i të shprehurit me gojë nuk duhej të kalojë medoemos drejtpërdrejt në ushtrimin me shkrim. Vetëm pasi nxënësit të kenë përvetësuar mirë një formë të të shprehurit me gojë mund të kalonin në ushtrime me shkrim. Mirëpo, kjo mënyrë e ushtrimeve me shkirm nuk duhej të ishte e vetmja. Kjo vlente për klasat e larta, ku nxënësit kërkohej të kenë pavarësinë më të madhe. Planifikohej të bëhej përpjekje që nxënësit të zhvillojnë të shprehurit me shkrim gjatë gjithë arsimit të detyruar.

Përvetësimi i njohurive gjuhësore vihej në funksion të ngritjes së kulturës dhe të përvetësimit të sigurt e praktik të gjuhës. Filluar nga roli dhe rëndësia e pjesëve të ndryshme të ligjëratës dhe të trajtave të tyre, të gjymtyrëve, të fjalës, të renditjes së fjalëve e të fjalive, planifikohej që nxënësit t'i vërejnë më së miri në situata të ndryshme të të folurit të gjallë. Po ashtu, planifikohej që edhe lidhur me vetitë tingullore dhe të tingujve të gjuhës shqipe të jepen vetëm idetë themelore për zanoret dhe bashkëtingëlloret, si dhe dallimet që ekzistojnë midis tyre. T'i kushtohet kujdes i veçantë ë –së dhe përdorimit të drejtë të togjeve zanore **ua, ue, ie, ye**. Gjatë përpunimit të fonetikës, arsimtari duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë nyjetimit të drejtë të tingujve: **q, ç, gj, xh, th, dh, ll, rr, ë**. Gjithashtu, gjatë leximit, nxënësit duhet të ushtrohen për t'i dalluar shenjat e pikësimit. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet sintaksës së fjalisë.⁵¹⁰

Plan – programi (i njësuar) i vitit 1989

Edhe në planprogramin (e njësuar) të vitit 1989⁵¹¹ përcaktohen, pothuaj të njëjtat detyra sikurse në atë paraprak (1982). Për dallim nga ai, këtu bie në sy një terminologji më profesionale dhe përveç detyrave përcaktohet edhe qëllimi. Aty thuhet se “*Qëllimi i punës edukative – arsimore të mësimt të gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollën fillore është përvetësimi dhe kultivimi i gjuhës shqipe, i letërsisë dhe i kulturës shqiptare, si dhe i letërsive dhe kulturave të kombeve e kombësive të RSF të Jugosllavisë dhe të popujve tjerë: zhvillimi i dashurisë për atdheun – RSFJ... patriotizmit socialist jugosllav e të internacionalizmit proletar.*”⁵¹² Nëse e analizojmë mirë këtë formulim, hetohet paksa një përparim në lidhje me edukimin e vlerave kombëtare, sepse për herë të parë brenda këtyre viteve, qëllimi i mësimt të kësaj lënde është edhe “*përvetësimi dhe kultivimi i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare*”, gjë e cila nuk ndodh në planprogramet e mëparshme ('74, '77, '82). Mirëpo, ende nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë qëllim që do të nënkuptonte mirëfilli edukimin e vlerave kombëtare, sepse çdo gjë ishte ende e mbështjellur me petkun ideologjik të kohës, e cila konfirmohet me rastin e përcaktimit të detyrave (sipas klasave I-IV) e të cilat janë identike me ato të planprogramit paraprak të vitit 1982.⁵¹³

4.2.7. Planet dhe programet mësimore, vitet '90

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 1989 të gjitha institucionet e Serbisë ishin vënë në përpjekje për të suprimuar të gjitha ato arritje me autonominë e Kosovës. Kështu, Pleqësia e Arsimit e Serbisë kishte nxituar me marrjen e të gjitha ingjencave për hartimin dhe miratimin e programeve mësimore për të gjitha lëndët mësimore dhe për të gjitha nivelet e arsimit edhe në Kosovë. Këto ndryshime të përmbajtjeve programore ishin shumë të papërshtatshme dhe të pavolitshme për nxënës dhe arsimtarë shqiptarë. Plani dhe programi mësimor i Serbisë për shqiptarët

⁵¹⁰ Në shkollat e vogla fillore planifikohej që këto grupe mund të shkrihen në një grup të vetëm p.sh. në atë letrar, në gjirin e të cilit do të kultivoheshin të gjitha këto veprimtari.

⁵¹¹ Plan program i njësuar i punës edukative – arsimore në shkollën fillore. ETMM i KSAK, Prishtinë, 1989. (Është miratuar nga Pleqësia e Arsimit e KSAK, më 23 gusht 1985 dhe ka hy në zbatim në vitin shkollor 1985/86 për kl. I dhe të V të shkollës fillore. Thirret plan “ i njësuar “ sipas së atëhershme midis krahinave dhe republikave të ish Jugosllavisë. Për dallim nga ato paraprake këtu jepen përmbajtjet programore për zgjedhje. Jepet po ashtu numri javor e vjetor i orëve: 5/6=228, II/6=228, III/6=228, IV/5=190 .

⁵¹² Shih, po aty, fq.18,22,26,31 dhe 36 dhe krahaso: Planprogrami i vitit 1982, fq.9,11,14 dhe 17.

⁵¹³ Shih, po aty, fq.18,22,26,31 dhe 36 .

e Kosovës ishte i papranueshëm për shumë arsye. Me ironi, shqiptarët quhen “shiptari”, nga plani dhe programi mësimor ishte hequr kultura dhe tradita shqiptare dhe historia kombëtare shqiptare.⁵¹⁴ Në planin dhe në programin mësimor, i cili ishte miratuar nga Pleqësia e Arsimit e Serbisë e i cili “vlente” për shqiptarët e Kosovës, në secilën lëndë mësimore ishin bërë ndryshime rrënjësore në përmbajtjet programore. P.sh., në lëndët natyra dhe shoqëria askund nuk përmendej Kosova. Edhe në disa njësi të tjera mësimore, p.sh., *Paraardhësit tanë. Ardhja e paraardhësve tanë në këto vise, pastaj Ekonomia dhe degët e saj, askund nuk përmendën shqiptarët dhe Kosova*. Në lëndën e historisë, në klasën VIII ishte paraparë tema mësimore “Lëvizja separatiste shqiptare në Kosovë”. Në të gjitha lëndët mësimore ishte nënçmuar historia dhe kultura shqiptare. Nga planet dhe programet mësimore të gjuhës shqipe si lëndë mësimore ishin hequr shkrimtarët e njohur shqiptarë, si: *Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Mark Krasniqi* etj., ndërsa nga gjuha dhe letërsia serbokroate për shkollat fillore ishin hequr shkrimtarët: *Rexhep Hoxha, Agim Deva, Migjeni, Naim Frashëri, Esad Mekuli, Rifat Kukaj*, ndërsa në shkolla të mesme ishin hequr: *Nazmi Rrahmani, Hivzi Sulejmani, Rexhep Qosja dhe Enver Gjerqeku*.⁵¹⁵ Me programet e Serbise që nga klasa e parë të shkollës fillore nga lënda mësimore gjuhë amëtare, ishin hequr shkrimtarët si *Ndre Mjeda, Bedri Dedja, Qamil Batalli, Mehmedali Hoxha, Zejnullah Halili, Rrahman Dedja, Fejzi Bojku* etj. të cilët ishin zëvendësuar me autorë të letërsisë serbe dhe jugosllave si *Dragan Kulixhan, Mira Alečković, Oton Zhupançiqi, Ratko Zvetko, Stojan Tarapuzha* dhe në vend të “*Kam një harmonikë*” të Xhevat Beqarajt ishte futur *Jovan Jovanović Zmaji* me “*Vjersha për fëmijë*”. Në klasën e pestë të shkollës fillore ishin hequr: *Besim Bokshi, Odhise Grillo, Petraq Zoto, Aleks Çaçi, Nazmi Rrahmani, Fahredin Gunga, Tonin Shiroka, Rexhep Hoxha, Agim Deva, Murat Isaku, Rrahman Dedaj*, të cilët ishin zëvendësuar me *Ivo Andriqin, Dushan Radovićin, Nikolla Koçishin, Dane Oblakun, Xhek Londonin, Sinan Hasanin dhe Sllavko Vukosavljeviqin*. Nga lëktyra shtëpiake ishin hequr *Bedri Dedja, Abdylazis Islami, Luigj Gurakuqi* të cilët ishin zëvendësuar me shkrimtarë të huaj, si: *Video Podgorecin, Miroslav Antiqin* etj.⁵¹⁶

Si kundërpërgjigje këmbëngulëse erdhi puna e veprimtaria e zhvilluar te Enti Pedagogjik i Kosovës, i cili me shumë bashkëpunëtorë në vitin 1990 iu përkushtua hartimit të planeve dhe të programeve mësimore për shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës. Këto programe u miratuan nga Pleqësia e Arsimit të Kosovës më datën 24 gusht të vitit 1990⁵¹⁷. Programi mësimor i Kosovës, në krahasim me atë të mëparshmin, ishte më i avancuar dhe kishte disa risi. Përmbajtjet programore të gjuhës shqipe dhe të letërsisë begatohen me përmbajtje të reja programore, përfshihen veprat e shkrimtarëve të anatemuar dhe të afirmuar, veprat e të cilëve ishin hequr në mënyrë arbitrare nga programet mësimore.⁵¹⁸ *Gjuha serbokroate si gjuhë joamtare* deri në këtë vit kishte karakter obligues në shkollën fillore dhe të mesme, sidomos për nxënësit shqiptarë, ndërsa nga ky vit kishte trajtim reciprok.⁵¹⁹

⁵¹⁴ I. Ilazi, *Ç’tha Halim Hyseni pas kthimit nga Beogradi, Më nuk do të bëjmë lëshime*, Shkëndija, 20 qershor 1990.

⁵¹⁵ Rexhep Osmani, *Programe që shkatërrojnë identitetin kombëtar*, Shkëndija, 1 qershor 1990; Më gjerësisht shih: H. Hyseni & B. Shatri, *Struktura e punës edukativo-arsimore në shkollën fillore*, Shkëndija, 20 shtator 1990.

⁵¹⁶ Mr. S. Salihu, *vep. e cit.* fq. 58.

⁵¹⁷ Pleqësia në pamundësi që mbledhjen e miratimit të programeve ta mbajnë në lokalet e veta, u detyruan që të njëjtën ta mbajnë në lokalet e Bashkësisë Vetëqeverisëse Krahinore të Arsimit dhe të Edukimit.

⁵¹⁸ Halim Hyseni, Bajram Shatri, *Udhëzime praktike: Struktura e punës edukativo-arsimore në shkollën fillore*, “Shkëndija”, shtator, 1990.

⁵¹⁹ *Po aty*.

Këto programe u mirëpritën në gjithë Kosovën, por, Serbia, përmes disa misionarëve brenda organeve të saj që vepronin në Kosovë, bënte presion të vazhdueshëm për ta mbajtur arsimin nën kthetrat e saj. “Ekspozitura e arsimit në Kosovë, më tepër se tre muaj është duke bërë presion të paparë në arsimin kosovar... që të aplikojë ligjet dhe planprogramet mësimore të Serbisë”.⁵²⁰ Me qëllim të aplikimit të tyre nga shqiptarët, Ministria e Arsimit e Serbisë bëri shumë apele, ftesa, shumë biseda informative me drejtorë, inspektorë, arsimtarë, bëri shumë kërcënime përmes policisë, sigurimit shtetëror etj., në mënyrë që t’i joshte nxënësit dhe arsimtarët shqiptarë. Të gjitha këto kërcënime dhe masa ishin të kota, sepse *popullata shqiptare në përgjithësi dhe personeli mësimor në veçanti ishin këmbëngulës në zbatimin e vendimeve të organeve shtetërore kosovare si kurrë më parë*.⁵²¹ Muhamet Bicaq, anëtar i Qeverisë, në mënyrë të prerë pati thënë se: “Është dashur të dihet me kohë se më nuk do të pranojmë kurrfarë planprogramesh mësimore, tekste dhe ligje ku ne nuk kemi qenë të kyçur dhe ku argumentet tona nuk janë marrë në konsideratë. ... nuk mund dikush të na imponojë ato zgjidhje që nuk do t’i pranojmë. Do të thotë, shqiptari duhet të shkruajë edhe serbokroatisht, cirilicë, edhe shqip... Kjo, shokë nuk mund të ndodhë kurrë...”.⁵²² Planet dhe programet mësimore të Serbisë janë kundërshtuar fuqishëm në të gjithë Kosovën nga të gjitha strukturat e popullatës, nga drejtorët e shkollave shqipe, nga mësimdhënësit dhe nxënësit shqiptarë, përkundër dhunës së shfrenuar serbe.⁵²³

Plani dhe programi mësimor i vitit 1990

Plani mësimor (në ciklin e klasave të ulëta) për vitin 1990 paraqitet si më poshtë:

Tabela 18. Fondi i orëve mësimore për lëndën gjuhë dhe letërsi shqipe i vitit 1990

Nr. Lënda mësimore Kl. I – IV				
	<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III</i>	<i>IV</i>
1. Gjuhë dhe letërsi shqipe	6	6	6	6
Gjithsej	6	6	6	6

Plani i ciklit të klasave të larta:

Lënda Klasa V-VIII					
<i>Nr.</i>	<i>Lënda mësimore</i>	<i>V</i>	<i>VI</i>	<i>VII</i>	<i>VIII</i>
1.	Gjuhë dhe letërsi shqipe	5	4	4	4
	Gjithsej	5	4	4	4

⁵²⁰ Zijadin Gashi, *Refuzohen planprogramet mësimore të Serbisë*, “Shkëndija”, nëntor 1990.

⁵²¹ Kjo kishte ndodhur edhe në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës dhe të Qeverisë së Serbisë, të mbajtur më 9 qershor të vitit 1990 (në *Gërmi*), u shqyrtua edhe çështja e planeve dhe e programeve mësimore.

⁵²² Agim Zogaj, Blerim Shala, *Dëshmi për Kosovën 1989-1991*, Prishtinë, 1995, fq. 109.

⁵²³ *Po aty*.

Me këto plane dhe programe vihen themelet e pavarësisë së sistemit të arsimit në Kosovë. Mësimdhënësit e Kosovës, varësisht nga nacionaliteti, në vitin shkollor 1990/91 punuan me dy lloje planesh dhe të programesh mësimore, si në shkollat fillore ashtu në ato të mesme.⁵²⁴ Kështu, në Kosovë u vendos sistemi i pavarur i arsimit sipas të cilit është punuar që nga viti shkollor 1990 deri në vitin 1999.

4.2.7.1. Plani dhe programi mësimor për kushte të jashtëzakonshme

Duke këndvështruar zhvillimet politike në hapësirat e ish-Jugosllavisë dhe duke parandjerë se po vinin ditë të vështira edhe për shqiptarët e Kosovës, ekspertët e Entit Pedagogjik i Kosovës⁵²⁵ e patën hartuar e përgatitur, duke ia propozuar Ministrisë së Arsimit të Kosovës për miratim materialin e pagëzuar: *Struktura e punës edukativo-arsimore për shkollën fillore /mësimi në gjuhën shqipe – kushtet e jashtëzakonshme*.⁵²⁶ Ky dokument u miratua nga Pleqësia e Arsimit, më 23 dhjetor të vitit 1991.⁵²⁷ Sipas këtij plani mësimor parashiheshin disa variante të fondit të orëve mësimore, varësisht nga rrethanat në terren.

Tabela 19. Disa nga Variantet e Planeve dhe programeve mësimore të gjuhës dhe letërsisë shqipe për kushte të jashtëzakonshme

Variantet: A, A/1, A/2 Kl. I – IV

Nr	Lënda mësimore	I			II			III			IV		
		A	A/1	A/2	A	A/1	A/2	A	A/1	A/2	A	A/1	A/2
1.	Gjuhë dhe letërsi shqipe	6	5	5	6	5	5	6	5	5	6	5	5

Variantet: A, A/1 dhe A/2 Kl. V – VIII

Nr.	Lënda mësimore	V			VI			VII			VIII		
		A	A/1	A/2	A	A/1	A/2	A	A/1	A/2	A	A/1	A/2
1.	Gjuhë dhe letërsi shqipe	5	5	5	4	4	4	4	4	4	4	4	4

⁵²⁴ Mësimdhënësit shqiptarë punuan me plane mësimore të hartuara nga Enti Pedagogjik i Kosovës dhe të miratuara në Pleqësinë e Arsimit të Kosovës, kurse procesi mësimor në gjuhën serbokroate dhe në gjuhën turke u zhvillua sipas planeve dhe programeve mësimore të Pleqësisë së Arsimit të Serbisë...!

⁵²⁵ Halim Hyseni, drejtor, në emër të Entit Pedagogjik të Kosovës e kishte hartuar këtë plan të punës me variante dhe nënvariate për kushte të jashtëzakonshme të punës në shkolla.

⁵²⁶ Enti Pedagogjik i Kosovës: Propozim për miratim Pleqësisë së Arsimit të Kosovës, planin: *Struktura e punës edukativo-arsimore për shkollën fillore /mësimi në gjuhën shqipe – kushtet e jashtëzakonshme*, janar, 1992.

⁵²⁷ Zeqir Demi, *Roli i Pleqësisë së Arsimit të Republikës së Kosovës në pavarësimin e shkollës shqipe*, Prishtinë, 1995, fq. 31.

Variantet: B dhe B/1 (cikli i klasave të ulëta)

Kl. I – IV

Nr.	Lënda mësimore	I		II		III		IV	
		B	B/1	B	B/1	B	B/1	B	B/1
1.	Gjuhë dhe letërsi shqipe	5	5	5	5	5	5	5	5

Variantet: B dhe B/1 (cikli i klasave të larta)

Nr.	Lënda mësimore	V		VI		VII		VIII	
		B	B/1	B	B/1	B	B/1	B	B/1
1.	Gjuhë dhe letërsi shqipe	4	3	4	3	4	3	4	3

Varianti C

Nr.	Lënda mësimore	I	II	III	IV
1.	Gjuhë dhe letërsi shqipe	5	5	5	5

Varianti: C (mësimi mentorik – konsultativ)

Nr.	Lënda mësimore	V	VI	VII	VIII
1.	Letërsi	15	20	25	25

Varianti C/1

Nr.	Lënda mësimore	V	VI	VII	VIII
1.	Gjuhë shqipe	3	3	3	3

Varianti A-Sipas këtij planifikimi parashihej të punojnë të gjithë nxënësit shqiptarë, të cilët nuk ishin të ndjekur nga objektet shkollore; në shkollat fillore dhe të mesme, në të cilat nuk ishin futur masat e dhunshme; në shkollat fillore dhe të mesme, të cilat kanë kuadër të mjaftueshëm mësimor dhe të cilat i kanë të siguruara kushtet elementare për punë.⁵²⁸ Ishte paraparë edhe mundësia e kombinimit të varianteve, p.sh., “*edhe në shtëpi private mund të organizohet mësimi sipas variantit A në ciklin e klasave të ulëta, ndërsa për klasat e larta- varianti C*”.⁵²⁹

Varianti B⁵³⁰-Ky variant ishte paraparë për shkollat të cilat procesin mësimor e zhvillonin në dy e tri gjuhë mësimore, me 3 e 4 ndërrime. Me këtë variant është menduar të punonin eventualisht shkollat e mesme, të cilat do të punonin në objektet e shkollave fillore.

Varianti C-ishte paramenduar për shkollat të cilat do të largohen nga objektet e tyre shkollore dhe të cilat ishin detyruar që procesin e punës mësimore ta zhvillonin në shtëpi private.⁵³¹

Plani dhe programi mësimor 1992-93

Emërtimi i kësaj lënde mësimore me planet dhe programet mësimore disa herë ka ndryshuar. Gjatë Luftës Dytë Botërore ajo ishte emërtuar si *këndim-lexim, gjuhë amnore, gjuhë amtare, gjuhë e letërsi shqipe* dhe në fund, prej vitit 1990 e këndej, *gjuhë shqipe e letërsi*. Gjatë historisë së arsimit shqip në Kosovë në periudhën 1941-1999 emërtimet e lëndëve mësimore kanë pësuar ndryshime.

⁵²⁸ Halim Hyseni, *Praktikë shkollore në kushte të sotme*, “Shkëndija”, janar, 4/1992. (Me këtë variant të punës mund të mësonin dhe të punonin edhe shkollat të cilat ishin në lokale private, por që kushtet e punës i kishin të mira.)

⁵²⁹ *Po aty*.

⁵³⁰ Ky variant kishte mundësi të kombinohej me variantet apo nënvariantet e tjera.

⁵³¹ *Planifikimi i kohëzgjatjes së orëve* të mësimin ishte paraparë të jetë fleksibël, varësisht nga variantet në të cilat punohej. Reduktim i kohëzgjatjes së orës së mësimin vliente vetëm për stinën e dimrit, ndërsa në pranverë dhe në verë ajo do të zgjatej në 45 minuta. Sipas variantit C, ora e mësimin ishte e reduktuar në 30 minuta. Kjo kohëzgjatje e orës së mësimin do të vliente vetëm për lëndët bazë mësimore. Për lëndët e tjera, ora e mësimin kishte mundësi të shkurtohej edhe nën 30 minuta (*mësim konsultativ*).⁵³¹ Këto variante të organizimit të mësimin në kushtet dhe rrethanat e jashtëzakonshme më shumë kanë qenë të zbatuara në arsimin e mesëm dhe në shkollat fillore, të cilat procesin mësimor e kanë zhvilluar në shtëpi private. Sipas variantit A, A/1 dhe A/2 ora e mësimin do të zgjaste 45 minuta. Mirëpo, nëse shkollat punonin në tri e katër ndërrime edhe me këtë variant ishte lënë mundësia që ora e mësimin të reduktohej në 30 minuta. Konform me këto reduktime, me këto variante të punës dhe me reduktimin e numrit të ditëve të punës për vitin shkollor 1992 ishin shkoqitur edhe programet për disa lëndë mësimore, të cilat ishin publikuar në revistën pedagogjike “Shkëndija” (Gjatë vitit 1992 në revistën arsimore “Shkëndija”. Në pjesën më të madhe të shkollave është punuar me nënvariantet e variantit A, pjesërisht është punuar me variantin B dhe pothuajse asnjë shkollë nuk ka punuar me variantin C.). Në Kosovë në shkolla –shtëpi ishin shndërruar rreth 3000 objekte, shumica të liruara gratis.

Tabela 20. Emërtimet e lëndës së gjuhës shqipe gjatë historisë së arsimit shqip në Kosovë në periudhën 1941-1999

<i>Emërtimi i dikurshëm i lëndëve mësimore</i> ⁵³²	<i>Emërtimi i tanishëm i lëndëve mësimore</i>
1. <i>Këndim – shkrim</i> 1.1. <i>Gjuhë amnore</i> 1.2. <i>Gjuhë amtare</i> 1.3. <i>Gjuhë dhe letërsi shqipe</i>	1. Gjuhë shqipe dhe letërsi

Ndryshimet në orët javore për lëndën gjuhë dhe letërsi shqipe

Siç ka ndërruar emërtimi i lëndës, ashtu ka ndryshuar edhe orët javore. Në periudhën gjatë luftës katërvjeçare, 1941-1945, gjuha shqipe në ciklin e klasave të ulëta (I – IV) është mësuar me 34 orë në javë. Prej vitit 1946 deri në vitin 1959 për gjuhën shqipe prej klasës I deri në klasën VIII ishte rreth 50 orë në javë. Me planin dhe programin mësimor të vitit 1977 e deri në vitin 1999 nga klasa I-VIII orët javore mbërrijnë në 53 orë.

Tabela 21. Fondi javor i orëve të gjuhës shqipe sipas klasave dhe viteve 1941-2000

<i>Vitet</i>	<i>Fondi javor i orëve sipas klasave</i>								<i>Gjithsej</i>
	<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III</i>	<i>IV</i>	<i>V</i>	<i>VI</i>	<i>VII</i>	<i>VIII</i>	
1941-44	14	14	14	13	13				68
1945	10	9	8	7	5 (I)	5 (II)	5 (III)	4 (IV)	53
1947/48	10	9	6	6	6	5	4	4	50
1951	9	10	6	6	5	5	5	5	51
1959	6	6	5	4	4	4	4	4	37
1962	6	6	6	6	6	5	4	4	43
1971	6	6	6	6	6	5	4	4	43
1977	6	6	6	5	5	4	4	4	40
1985	6	6	6	5	5	4	4	4	40
1990	6	6	6	6	5	4	4	4	41
1992	5	5	5	5	5	4	4	4	37
1996	8	8	8	8	5	5	5	5	52
1999	8	8	8	8	6	6	6	6	56

Fondi javor i orëve në edukimin dhe në arsimin fillor, prej vitit 1962 deri në vitin 1990, ishte përafërsisht i njëjtë, ndërsa në vitin 1992 deri në vitin 1996 numri i orëve, për shkak të kushteve dhe rrethanave të vështirësuar në arsimin shqip, ishte reduktuar. Ndërsa nga viti 1996 fondi i orëve në lëndën mësimore *gjuhë shqipe dhe letërsi* ishte shtuar dukshëm, prej 37 orëve, në vitin 1992, në 52 orë në javë, në vitin 1996. Dhe, më në fund, prej vitit 1999 fondi i orëve të gjuhës amtare është shtuar për katër orë në javë në ciklin e klasave të larta. Tani prej klasës I deri në klasën IV mësohej me fond 8 orë në javë, kurse në ciklin e klasave të larta nga 6 orë në javë.

⁵³² Sipas Planit e programit mësimor, në kuadër të lëndës mësimore Gjuhë amtare, në vitin shkollor 1941-45, mësoheshin si lëndë të veçanta: *këndim-lëxim, hartim, ortografi dhe gramatikë*.

Duke i analizuar planet mësimore sipas klasave dhe sipas viteve shkollore, mund të vërehet se mbingarkesa më e madhe e nxënësve me fond javor të orëve, në ciklin e klasave të ulëta (mësimi klasor), ishte në vitin 1957, kurse fondin më të vogël të orëve e kishin në vitin 1998.

Tabela 22. Lëvizjet e sasisë së orëve brenda viteve dhe klasave I-IV

<i>Klasat</i>	<i>1957</i>	<i>1998</i>	<i>2003</i>
I	22	16	20
II	25	16	21
III	30	18	23
IV	28	18	24

Në vitin 1957, nxënësit shqiptarë ishin të stërngarkuar me orë javore (*derisa nxënësit shqiptarë mësonin gjuhën serbe si gjuhë joamtare, nxënësit serbë nuk e mësonin gjuhën shqipe si gjuhë joamtare*). Kështu, për secilën ditë nxënësit e klasës III është dashur t'i mbanin nga 5 orë në ditë. Ky fond i orëve ka ndryshuar sipas viteve, kurse fondin më të vogël të orëve e kanë pasur në vitin 1998.

Në ciklin e klasave të larta (mësimi lëndor) fondi më i madh javor i orëve ishte në vitin 1971, kurse më i ulëti në vitin 1991/92. Edhe nga tabela e sipërme vërehet se fondin më të madh të orëve të përgjithshme mësimore me planin e vitit 1971 e kishte klasa e shtatë, gjithsej 33 orë. Tri ditë brenda javës nxënësit e kësaj klase kanë pasur nga 6 orë dhe tri të tjera nga 5 orë në ditë.

Tabela 23. Lëvizjet e sasisë së orëve brenda viteve dhe klasave V-VIII

<i>Klasat</i>	<i>1971</i>	<i>1991/2</i>	<i>2003</i>
V	30	25	25
VI	32	25	28
VII	33	25	29
VIII	31	26	30

Plani dhe programi mësimor për gjuhë dhe letërsi shqipe i vitit 1990

Duket se viti 1990 është fillimi i ndarjeve, fillimi i kthesës së madhe, me sistemin serb dhe fillimi i pavarësisë së hartimit të programeve mësimore. Po ashtu, edhe plan – programi i vitit 1990⁵³³ shënon avancim në vijën kombëtare, edhe pse për nga qëllimi dhe detyrat është identik me atë paraprak (1989)⁵³⁴. Është kjo kohë e suprimimit të dhunshëm të autonomisë së Kosovës dhe me këtë edhe e organeve drejtuese arsimore. Ky apart i dhunës duket se ka prodhuar një qëndrim statik, ndryshe nuk ka sesi të shpjegohet vendnumërimi i kësaj çështjeje. Po të bëjmë një analizë të hollësishme dhe një komparacion midis përmbajtjeve programore të vitit 1989 dhe

⁵³³ Plani dhe Programi i gjuhës shqipe për shkollën fillore, Pleqësia e Arsimit e Kosovës, Prishtinë, 1990 (Ky dokument gjendet vetëm në shpiltografim). Ai është miratuar nga P.A.K. në gusht të vitit 1990. Karakteristika tjera janë të njëjta me ato të plan – programit paraprak (1989.)

⁵³⁴ Po aty, f.1,2,7,19 dhe 26 dhe krahaso me planprogramin e vitit 1989, f.17,18,22,26,31 dhe 36.

atij 1990 atëherë del se, nga program janë mënjeluar pothuajse të gjitha krijimet e autorëve jugosllavë dhe ato janë zëvendësuar me krijime të autorëve shqiptarë.

Kështu, në plan-programin për klasën e parë, nga program janë hequr tre autorë jugosllavë dhe janë zëvendësuar me dy krijime të autorëve shqiptarë (B. Gaço dhe A. Mamaqi) dhe një tregim popullor,⁵³⁵ në klasën e dytë, janë hequr nëntë krijimet e autorëve jugosllavë (ka mbetur vetëm një, V. Nazor: *Lunda e artë*) dhe janë zëvendësuar me autorë shqiptarë (si: S. Frashëri, O. Grillo, M. Gjevori) dhe krijime nga letërsia popullore (gjë e gjëza, fjalë të urta etj.); në klasën e tretë, janë hequr njëmbëdhjetë krijime të autorëve jugosllavë dhe janë zëvendësuar me krijime të autorëve shqiptarë (Y. Elshani, R. Ramabaja, B. Gaço)⁵³⁶, si dhe në klasën e katërt, janë hequr poashtu njëmbëdhjetë krijime të autorëve jugosllavë (dhe një shqiptar, F. Hoxha –poezia "Emin Duraku") dhe janë zëvendësuar me krijime të autorëve shqipëtar (si A. Gajtani, Z. Sako, A. Z. Çajupi M. Krasniqi, I. Kadare etj.) dhe tregime tjera nga krijimtaria popullore. Mirëpo, kur këndvështrohen gjithanshëm këto ndryshime fitohet përshtypja se ato ishin të ngutshme dhe se këto ndërhyrje për kriter kanë pasur vetëm autorësinë e krijimeve e jo edhe përmbajtjen e tyre sepse, kanë mbetur në program, krijime të autorëve shqiptarë e që për nga vlerat e tyre janë me bazë ideologjike. Po përmendim disa nga këto raste, si: Në klasën e parë, është hequr – F. Bojku: "Titos" është zëvendësuar, A. Deva: "Titos"; në klasën e dytë, "Është e bukur vallja e shokut Tito", e cila është zëvendësuar, Tito: "Nga fëmijëria ime". Këta shembuj janë treguesi më i mirë se ende mungonte guximi i mirëfillt intelektual i politikëbërjes shqiptare në Kosovë, se ende kishte hamendje, sepse këto korrigjime të bëra, shumë më tepër ishin të natyrës teknike, mekanike se sa përmbajtësore por që në fakt, do të shënonin avancim në përfshirjen e krijmtarisë kombëtare kundrejt asaj jugosllave që zinte vend të ekzagjeruar në strukturën programore të gjuhës e letërsisë shqipe.

Por, ky dokument për nga rëndësia mund të vlerësohet se përbën përpjekjen e parë reale e "institucionale" që Kosova të shkëputej përfundimisht nga një sistem arsimor i huaj përherë. Ky program së bashku me plan – programet e tjera mësimore të lëndëve shoqërore, pas miratimit nga ana e Pleqësisë së Arsimit të Kosovës u kundërshtua dhe u sulmua nga organet dhe mediat serbe, sepse hetohet qartazi hapi i parë i ndryshimeve më të theksuara dhe nismën e mëvetësimit të organeve arsimore (dhe të tjera) të Kosovës të cilat më vonë, (edhe pse të sulmuara në çdo hap) punuan drejt hartimit të plan – programeve në një frymë të re kombëtare dhe të pavarur tërsisht.⁵³⁷ Kështu, viti shkollor 1991/1992 mund të cilësohet ndër më të rëndit për shkak të pengimit të veprimtarisë arsimore në çdo nivel e në çdo vend në Kosovë, prandaj edhe vendoset të aplikohet i ashtuquajtur "Plani i punës edukative – arsimore për shkollën fillore në kushte të jashtëzakonshme". Ndërsa, gjatë viteve vijuese, për lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe (për klasat e ulta të shkollës fillore) u hartuan programet për ndonjërin nga klasat, por jo për të gjitha.⁵³⁸

⁵³⁵ Shih e krahaso: Planprogramin e vitit 1989, f.20 me Planprogramin e vitit 1990, f. 4-5.

⁵³⁶ Shih e krahaso: Planprogramin e vitit 1989, f.27-28 me Planprogramin e vitit 1990, f.14-15.

⁵³⁷ Zeqir Demi, Roli i Pleqësisë së Arsimit të Republikës së Kosovës në pavarësimin e shkollës shqipe, Prishtinë, 1995, fq.30. (Për të sendërtuar deri në fund qëllimin, në këtë drejtim frymë "më 27 gusht 1991, Pleqësia e Arsimit, sipas vendimit paraparak të përbashkët me Entin Pedagogjik, e më qëllim që planet dhe programet mësimore me përmbajtjet e tyre të përputhen me rrjedhat e aktivitetit politik, momentin dhe qëllimin kombëtar-bëri korrigjimin e planeve dhe të programeve të arsimit fillor.)

⁵³⁸ Shih, Programi i Gjuhës dhe letërsisë shqipe për klasën e II-të të shkollës fillore, Prishtinë, 1994 dhe Programi i gjuhës e letërsisë shqipe për klasën e tretë, Prishtinë, gusht, 1995.

Plani dhe programi mësimor 1996-97

Në drejtim të shtrirjes më të gjerë të përmbajtjeve reale kombëtare përbrenda kornizave të plan-programeve të gjuhës shqipe në Kosovë, në vitin 1996,⁵³⁹ me një çasje të re, sa i përket qëllimit, kërkesave, detyrave por edhe strukturës e përmbajtjes programore, vërehet në programet mësimore (I – IV) të këtij viti.

Në këtë plan – program përcaktohen synimet për edukimin e vlerave kombëtare dhe specifikohen sipas klasave duke bërë përjashtim për klasën e tretë, ku asnjë kërkesë nuk i referohet edukimit kombëtar. Ndër synimet dhe kërkesat e tjera, në këtë planprogram pra, përcaktohen edhe ato që kanë të bëjnë me edukimin e vlerave kombëtare. Në këtë plan-program thuhet se programi ka për qëllim *“të zhvillojë te nxënësit vetëdijen për rëndësinë dhe domosdo në përvetësimin e të komunikimit në gjuhën shqipe, si parakusht themelor për zhvillimin e ndjenjës e të ndërgjegjes kombëtare.”*⁵⁴⁰ Pra, gjuha shqipe konsiderohet faktor themelor për formimin e ndërgjegjes kombëtare, për të shtuar më tej se *“leximi”* (duhet, R.Gj.) *të ndikojë në formimin kulturor, atdhetar e moral të nxënësve dhe të ndihmojë në përvetësimin e normës drejtshkrimore*.⁵⁴¹

Për klasën e dytë, thuhet se programi (*për letërsi*) synon të arrijë disa qëllime dhe ndër to kërkohet që *“nëpërmjet leximit, nxënësit të njohin aq sa mundin disa vlera të krijimtarisë së popullit tonë, krijime të bukura e të përshtatshme të shkruara posaçërisht, ta duan vendlindjen dhe atdheun, gjithçka që kanë më të dashur”*.⁵⁴² Derisa (*siç u shprehëm më lart*) për klasën e tretë nuk shtrohet asnjë kërkesë në lidhje me edukimin kombëtar, për klasën e katërt bëhet fjalë qartë për forcimin atdhetar, kombëtar të nxënësve. *“Programi i kësaj klase – thuhet aty – nëpërmjet teksteve me vlerë artistike, por edhe nga e kaluara, nga e sotmja, nga historia, nga jeta e njerëzve tanë, nga natyra, arti, shkenca etj. Të ndikojë në formimin qytetar dhe në edukimin në frymën atdhetare etj. Nëpërmjet leximit, nxënësi të njohë vlerat e krijimtarisë letrare artistike të krijuara nga shkrimtarët tanë, disa vlera të shquara të letërsisë botërore përmes krijimeve përfaqësuese . . . Leximi të ndikojë në formimin e përgjithshëm kulturor, kombëtar e moral të nxënësve dhe të ndihmojë në përvetësimin e normës drejtshkrimore dhe pasurimin e fjalorit .”*⁵⁴³ Për ndryshim nga programet e mëparshme (1974, 1977, 1982, 1989, 1990) ky është liruuar tërësisht nga fryma ideologjike duke u ndjerë fryma kombëtare e qytetare edhe pse qëllimi e kërkesat nuk janë të formuluar në mënyrë harmonike për të gjitha klasat (*në klasën e tretë*) për të cilën mendojmë se është pasojë e jokoordinimit të punës midis hartuesve të këtij plan – programi. Në këto programe janë eliminuar në tërësi përmbajtjet që avanconin vlerat ideore aq shumë të fokusuar në plan -programet e mëparshme, duke dalluar esencialisht si për nga qëllimi, kërkesat ashtu edhe për nga struktura e përmbajtja programore. Po të krahasohet me atë të vitit 1990 (*meqë ky u krahasua me atë të vitit 1989*) rezultojnë ndryshime të mëdha.

⁵³⁹ Plani dhe programi i gjuhës shqipe dhe letërsisë për shkollën fillore (klasa I-IV, Ministria e Arsimit Shkencës dhe kulturës, Prishtinë, 1996. (*Jepen përmbajtjet programore për zgjedhje: Është e shkoqitur struktura programore sipas ë lëmenjve. Numri javor dhe vjetor i orëve I/8=304, II/8=304, III/8=304, IV/8=304.*)

⁵⁴⁰ Po aty, f.4.

⁵⁴¹ Po aty, f.10.

⁵⁴² Po aty, f.35.

⁵⁴³ Po aty, f.35.

4.2.8. Planet dhe programet mësimore, pas vitit 2000

Me planet dhe programet mësimore të hartuara nga Ministria e Arsimit të Kosovës, luftës çlirimtare nga hartuesit *gjuha shqipe trajtohet si element kryesor i identitetit individual e kombëtar*. Prandaj, mësimi i gjuhës amtare në shkollë konsiderohej me peshë të veçantë duke vlerësuar se ajo kryen funksion të dyfishtë: *si lëndë parësore mësimore dhe si gjuhë mësimore për lëndët e tjera shkollore*. Mësimi i gjuhës amtare në shkollë, si lëndë me karakter kombëtar, kishte të caktuar për synim krijimin e vetëdijes mbi rëndësinë e gjuhës dhe përvetësimin e saj gradual. Në këtë funksion ishte konceptuar programi i kësaj lënde për arsimin bazë, të detyruar. Programi ishte organizuar në kuadër të kategorive: *të dëgjuarit dhe të folurit; të lexuarit; të shkruarit dhe të nënkategorive: kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, kulturë e të lexuarit dhe kulturë e të shkruarit; tekste letrare dhe joletrare si dhe njohuri gjuhësore*.⁵⁴⁴ Po paraqesim një krahasim të rezultateve të pritura në klasën e parë dhe në klasën e nëntë të arsimit të detyruar të Kosovës.

a. *Në fund të klasës së nëntë, rezultatet e pritura për nxënësit ishin planifikuar të jenë:*

Lënda mësimore ‘Gjuhë shqipe’ (I-IX), qëllim të mësimit kishte: *Përvetësimi i shkathtësive për të komunikuar në situata të ndryshme; krijimi i pavarësisë individuale dhe formimi kulturor; përvetësimi i gjuhës letrare; përgatitja e nxënësit për të njohur jetën në të gjitha aspektet e saj; zhvillimi i ndjenjës për të dëgjuar tema të ndryshme me karakter edukativ dhe arsimor dhe nxitja dhe motivimi i nxënësve për të mësuar*.⁵⁴⁵

Organizimi i përmbajtjes programore (shkathtësitë e komunikimit) realizohej sipas këtyre linjave:

Të dëgjuarit dhe të folurit, me nënkategoritë: Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit; Tekstet letrare dhe joletrare; Njohuri gjuhësore.

Të lexuarit, me nënkategoritë: Kulturë e të lexuarit; Tekstet letrare dhe joletrare; Njohuri gjuhësore.

Të shkruarit, me nënkategoritë: Kulturë e të shkruarit; Tekstet letrare dhe joletrare; Njohuri gjuhësore.⁵⁴⁶

⁵⁴⁴Përmes këtyre aktiviteteve realizoheshin përmbajtjet programore, të cilat ishin në përputhje me moshën dhe nivelin e nxënësve. Përvetësimi i njohurive themelore për sistemin e gjuhës shqipe për tekstet letrare e joletrare, formimi kulturor, komunikimi, toleranca, argumentimi etj. Këto ishin vetëm disa nga kërkesat themelore të këtij programi që të ndikohet dhe mundësohet rritja dhe zhvillimi i përgjithshëm e individual i nxënësit.

⁵⁴⁵Mësimi i gjuhës shqipe në klasë të parë vijon dhe plotëson punën e nisur në arsimin parashkollor. Nxënësit fillojnë t’i mësojnë, t’i dëgjojnë e t’i dallojnë tingujt që në kopsht. Që atje ata fillojnë të kuptojnë se si paraqiten tingujt me anë të shkronjave. Në klasë të parë të shkollës fillore fillon përvetësimi serioz dhe sistematik i leximit dhe shkrimit. Lidhja e këtyre dy etapave është një moment delikat për mësuesin që ka për detyrë t’i mësojë fëmijët të lexojnë e të shkruajnë. Në këtë kuptim duhet të ketë vazhdimësi në kalimin nga arsimi parafillor në arsimin fillor. Sipas të gjitha Planeve dhe programet e gjuhës shqipe pas vitit 2003-2011.

⁵⁴⁶Kështu, pas mbarimit të arsimit të mesëm të ulët (klasës së nëntë), nxënësit përmes tri kategorive të planifikuara (të dëgjuarit dhe të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit) për të arritur *shkathtësitë e komunikimit në fushat e përmendura kërkohej që në fushat (tërësitë tematike) përmes të cilave do të zhvillohen shkathtësitë e komunikimit, të bëhej organizimi dhe zhvillimi i komunikimit, të kuptuarit e teksteve, diskutim për tekstin, analiza e fjalës, zhvillimi i fjalorit, strategjia e shkrimit dhe shkrimi i aplikuar, norma gjuhësore e shqipes dhe zotërimi i standardit*

Qëllimi kryesor i mësimi të gjuhës shqipe në arsimin fillor kishte për qëllim që nxënësi:
*Të përvetësojë dhe të zgjerojë mënyrat e komunikimit; Të përvetësojë dhe të thellojë njohuritë themelore gjuhësore; Të kuptojë dhe të dallojë tekstet letrare dhe joletrare.*⁵⁴⁷

Pra, rezultatet e pritura sipas këtij plani e programi mësimor për gjuhën shqipe ishin hartuar në atë mënyrë që në fund të klasës së nëntë, nxënësi: *“Zotëron shkathtësi të veçanta individuale për organizimin dhe zhvillimin e komunikimit gjatë punës individuale dhe në grup; Kupton, identifikon dhe analizon informacione të ndryshme kulturore e letrare; Analizon, vlerëson dhe organizon informata nga burime të ndryshme, duke i paraqitur dhe sistemuar ato; Kupton strategjinë e shkrimit dhe praktikon përmes shkrimit forma të ndryshme letrare dhe joletrare; Kupton format dhe idetë themelore të kulturës dhe të letërsisë së periudhave të ndryshme dhe të zotëron dijet dhe standardin e sistemit të gjuhës, duke praktikuar atë në lloje të ndryshme të komunikimit, të analizave dhe të shkrimit.”*⁵⁴⁸ Kërkesë e veçantë ishte që mësimdhënësi duhet të jetë model për nxënësit në mënyrën e përdorimit të shkathtësive gjuhësore.⁵⁴⁹

Po ashtu, ky program për klasën e I-IX shtronte kërkesë që vlerësimi nga mësimdhënësit në vazhdimësi të bëheshin për njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç’shkallë kanë zotëruar fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t’i përdorë shkathtësitë gjuhësore gjatë komunikimit; për shkallën e zotërimit të njohurive me qëllim eliminimin e të gjitha pengesave dhe të vështirësive në nxënie dhe për integrimin e njohurive të fituara që nxënësit i realizojnë edhe jashtë programit shkollor. Theks të veçantë gjatë vlerësimit kërkohej që mësimdhënësi t’i kushtojnë *përdorimit të fjalorit, pyetjeve dhe përgjigjeve, iniciativave dhe mendimeve të pavarura, përshkrimeve dhe shpjegimeve, radhitjes së fjalëve në fjali, aktiviteteve individuale dhe grupore dhe fjalorit (leksiku) të nxënësve sipas moshës.*⁵⁵⁰

Rezultatet e pritura për nxënësit në arsimin parauniversitar, ishin që të *njihej poetika bashkëkohore; praktikoheshin format e ndryshme shkrimore letrare dhe joletrare; të kuptoheshin format dhe idetë themelore të kulturës dhe të letërsisë së gjysmës së dytë të shek. XX; të kuptoheshin tiparet e letërsisë e të kulturës shqiptare bashkëkohore dhe të arriheshin e vlerësoheshin dhe të argumentonin për kulturën dhe për letërsinë bashkëkohore.*⁵⁵¹

Rezultatet e pritura në përmbyllje të shkollës fillore të mesme të ulët në lëndën e gjuhës shqipe, sipas këtyre planeve dhe programeve mësimore, objekti është i caktuar që nxënësi « *Të përforcojë, të zhvillojë dhe të zbatojë shkathtësitë e komunikimit në shkollë dhe në situata të ndryshme jashtë shkollës; të rrisë shkallën e analizës, të vlerësimit dhe të kritikës për tekstet letrare dhe joletrare dhe të zotërojë dhe të praktikojë drejt njohuritë e sistemit gjuhësor.* » Nga shkathtësitë e komunikimit (*të dëgjuarit dhe të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit*), fushat (*tërësitë tematike*) përmes të cilave do të zhvillohen shkathtësitë e komunikimit: *Organizimi dhe*

⁵⁴⁷ **Vërejtje:** Përmbajtja e nënkategorive realizohet në funksion të të tri kategorive kryesore (Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, kulturë e të lexuarit, kulturë e të shkruarit, Tekstet letrare dhe joletrare dhe njohuri gjuhësore).

⁵⁴⁸ Derisa gjuha shqipe është mjet komunikimi për të gjitha lëndët. ajo kishte ndërlidhje të drejtpërdrejta me historinë, me gjeografinë, me edukatën qytetare, me artet. Andaj këto dokumente përcaktonin mirë edhe rolin e mësimdhënësve për metodologjinë e mësimdhënies në realizimin e përmbajtjes programore.

⁵⁴⁹ Kërkesat programore të Planit dhe programit mësimor për lëndën mësimore Gjuhë dhe letërsi shqipe ishte: përqendrimi në komunikim (*shkathtësitë e komunikimit: të dëgjuarit dhe të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit*). E tërë përmbajtja ishte në funksion të zhvillimit të këtyre shkathtësive (*Përqendrimi në zhvillimin e gjuhës dhe përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënit e tij*). Kërkohej që nxënësi duhet të jetë në qendër të vëmendjes. Kërkohej që aktivitetet që zhvilloheshin në klasë të jenë në funksion të mënyrës së komunikimit, luajtjes së roleve, punës në grupe, në çifte dhe përdorimi i teknikave të reja të mësimdhënies.)

⁵⁵⁰ Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR-KEC, Prishtinë 2003

⁵⁵¹ Deri në fund të vitit 2013 arsimit i mesëm i lartë kishte edhe klasën e trembëdhjetë.

zhvillimi i komunikimit; Të kuptuarit e teksteve; Diskutim për tekstin; Analiza e fjalës, zhvillimi i fjalorit; Analizë dhe interpretim i teksteve letrare; Strategjia e shkrimit dhe shkrimi i aplikuar dhe norma gjuhësore e shqipes dhe zotërimi i standardit .

b. Në fund të klasës së trembëdhjetë, rezultatet e pritura për nxënësit ishin planifikuar të jenë:

Qëllimet, objektivat, rezultatet e pritura, shkathtësitë e komunikimit, lidhja ndërlëndore, metodologjia, vlerësimi, si dhe literatura ishin të përbashkëta në shkollën e mesme të lartë,⁵⁵² si vazhdim i shkollës së mesme të ulët, dhe synonin t'i pavarësojë nxënësit dhe të kultivojë tek ata frymën kritike.⁵⁵³ Për nxënësit e kësaj moshe si rezullta të pritura planifikohej të ishin : « *zhvillimi i shkathtësive të veçanta individuale, njohëse dhe komunikative, duke punuar në grupe dhe individualisht. Në fund të shkollimit të mesëm nxënësi do të duhej të bëjë dallimin në mes diskurseve dhe në mes formave të ndryshme letrare e joletrare ; të njohë format dhe idetë themelore të letërsisë antike, të Mesjetës dhe të letërsisë së vjetër shqipe; të njohë esencat e kulturës tradicionale shqiptare; të zhvillojë aftësitë argumentuese dhe vlerësuese për përmbajtjet e zhvilluara; të lexojë, të analizojë e të interpretojë krijime letrare të kohëve të ndryshme - të zgjedhura, brenda konteksteve kulturore të caktuara; të zhvillojë dijet gjuhësore, kryesisht në aspekt të krijimit dhe analizës së sentencës, të stilistikës gjuhësore etj ; të kultivojë shijen për letërsinë dhe për gjuhën shqipe dhe do të rrisë interesimin dhe dijen për kulturat e tjera, nëpërmjet krahasimeve dhe shembujve. »⁵⁵⁴*

Rezultatet e pritura, sipas planeve gjatë këtyre viteve, në fund të klasës së trembëdhjetë, ishin që nxënësi të: « *zotërojë përfundimisht shkathtësi të veçanta individuale; shfrytëzon dhe organizon informata nga burime të ndryshme, duke i problematizuar; njeh poetikat bashkëkohore; praktikon format e ndryshme shkrimore letrare dhe joletrare; kupton format dhe idetë themelore të kulturës dhe të letërsisë së gjysmës së dytë të shek. XX; kupton tiparet e letërsisë e të kulturës shqiptare bashkëkohore dhe arrin të vlerësojë dhe të argumentojë për kulturën dhe për letërsinë bashkëkohore, duke përfshirë edhe modelet kulturore ».⁵⁵⁵*

⁵⁵² Programi për shkollat e mesme profesionale dallonte nga gjimnazet e të gjitha llojeve.

⁵⁵³ Synimet themelore të mësimin në këtë nivel shkollimi ishin: *përvetësimi i dijeve, formimi gjuhësor, formimi kulturor, formimi si individ dhe si qytetar. Si synime të lidhura drejtpërdrejt me shkollën e mesme të lartë, do të veçonim zotërimin e gjuhës amtare, njohjen e letërsisë dhe përvetësimin e një kulture.*

⁵⁵⁴ Sipas Planeve dhe programet e gjuhës shqipe pas vitit 2003-2011, standardet dhe përmbajtjet nga kjo lëndë dhe për këto klasa, realizoheshin duke u mbështetur në zhvillimin e shkathtësive të komunikimit dhe në ngritjen e vetëdijes së komunikimit: *të dëgjuarit, të lexuarit, të shkruarit.* Sipas këtyre planeve mësimore, nxënësit që përfundonin arsimin e detyruar në Kosovë do të kenë arritur të zhvillojnë, zotërojnë dhe zbatojnë shkathtësitë e komunikimit. Ata duhet të aftësohen për përdorimin e saktë të gjuhës, formimit kulturor dhe përvetësimin të shkathtësive të komunikimit. Nxënësit duhet të zotërojnë t'i praktikojnë dijet e përvetësuar nga letërsia, kultura, gjuha, përmes formave të ndryshme të krijimtarisë individuale dhe grupore: përmes eseve, projekteve, punimeve të ndryshme, të cilat u mundësojnë nxënësve strukturimin e mendimeve, gjykimeve dhe zhvillimin e imagjinatës.

⁵⁵⁵ Theks të veçantë gjatë vlerësimit të nxënësve, për të vlerësuar rezultatet e pritura për mësimdhënësit vihej mbi rëndësinë që kërkohej t'i kushtonin: *përdorimit të fjalorit; pyetjeve dhe përgjigjeve; iniciativave dhe mendimeve të pavarura; përshkrimeve dhe shpjegimeve; radhitjes së fjalëve në fjali; aktiviteteve individuale dhe grupore dhe fjalorit (leksikut) të nxënësve.*

KREU V

VËSHTRIM HISTORIK MBI MËSIMDHËNIEN E GRAMATIKËS NË KOSOVË

5.1. Mësimdhënia e gramatikës nga shek. XIX, deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore

5.2. Mësimdhënia e gramatikës në vitet 1945-1970

5.3. Mësimdhënia e gramatikës pas viteve '70

5.3.1. Programet e gramatikës së gjuhës shqipe për shkollat 8 vjeçare në Kosovë, vitet '60

5.3.2. Programet e gramatikës së gjuhës shqipe gjatë viteve 2000

5.4. Përvoja e shkollës së Kosovës në mësimdhënien e gramatikës

5.4.1. Norma letrare dhe roli i institucioneve për përgatitjen e kuadrove arsimore

5.5. Metodologjia e mësimit të gramatikës së gjuhës shqipe

5.5.1. Metodika e mësimdhënies së morfologjisë

5.5.2. Metodika e mësimdhënies së sintaksës

5.5.3. Metodika e mësimdhënies së drejtshkrimit

5.5.4. Modele planesh mësimore, klasa VIII

5.5.6. Roli i tekseteve shkollore për mësimin e gramatikës

VËSHTRIM HISTORIK MBI MËSIMDHËNIEN E GRAMATIKËS NË KOSOVË

Zhvillimi i mësimdhënies e mësimnxënies së gramatikës dhe gjuhës shqipe, gjatë periudhave të ndryshme historike ka patur ulje dhe ngritje përsa i përket efektivitetit në përdorimin e gjuhës në funksion të komunikimit. *“Përmbajtjet e disiplinave gjuhësore (të fonetikës, të morfologjisë, të sintaksës) zinin vend qendror në programet mësimore të gjuhës dhe letërsisë shqipe,*⁵⁵⁶ gjatë dekadave në shkollat e Kosovës në të gjitha nivelet. Detyra kryesore e mësimi tradicional të gramatikës ishte mësimi i gjuhës dhe krijimi i shprehive për t’u shprehur bukur gjatë komunikimit. Mësimi i gramatikës për nxënësit e arsimit parauniversitar nga klasa e parë e shkollës fillore e deri në mbarim të shkollës së mesme të lartë mbështetej në të vërejturit në mënyrë të organizuar. Njohuritë gjuhësore dhe shprehitë praktike të nxënësve fitoheshin gradualisht. Dituritë e fituara gjuhësore të përvetësuara vetëdijshëm në bazë të të menduarit logjik ngjallnin edhe dashurinë për gjuhën amtare. Por është ndjerë mungesa e metodikave të veçanta për mësimin e gramatikës, si:

- Metodika e mësimi të fonetikës dhe fonologjisë,
- Metodika e mësimi të morfologjisë dhe fjalëformimit,
- Metodika e mësimi të sintaksës dhe shenjave të pikësimit,
- Metodika e leksikologjisë, stilistikës linguistike,
- Metodika e ushtrimeve me shkrim dhe me gojë.⁵⁵⁷

Shumë didaktë pajtohen me mendimin, se bazamenti i cilësisë në mësimdhënie dhe arritjes së rezultateve të pritura për dituritë gjuhësore të mësimdhënësve, është mjeshtria (*arti*) i mësimdhënies, në të cilin padyshim do të kishin ndihmuar edhe tekstet e didaktikave të fushave të munguara të sipër përmendura.

5.1. MËSIMDHËNIA E GRAMATIKËS NGA SHEK. XIX DERI NË MBARIM TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Gjatë pushtimit turk, gjuha shqipe nuk u lejua të mësohej në shkollë. Megjithatë, falë punës së rilindasve shqiptarë, krahas përpjekjeve për botimin e librave shqip, për vendosjen e një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët, u bënë përpjekje, edhe për mësimin e gjuhës shqipe dhe për hapjen e shkollave shqipe, të cilat ndikuan në përhapjen e diturisë, por edhe të bashkimit politik. Por për shkak të kushteve të vështira në të cilat zhvillohej mësimi (*i fshehtë, me kuadër pedagogjik të papërgatitur, me mungesë të mjeteve mësimore*), procesi i arsimit në gjuhën shqipe përparonte me ritme të ngadalta.⁵⁵⁸ Gjithashtu duhet theksuar dhe fakti që gjatë gjysmës së parë të shek. XIX, në gjuhën shqipe ekzistonin vetëm përkthime dhe shkrime fetare, por jo libra gramatikorë. Për këtë arsye, siç pohon Myzyri, *“është e vështirë të flasësh për programet*

⁵⁵⁶ Metodika e gjuhës amtare për shkollat normale dhe për mësuesit e shkollës fillore, Prishtinë, 1971, f.129.

⁵⁵⁷ Stjeko Tezak, *Teoria i praksa hrvatskog jezika 1 (Teorija dhe praktika e mësimi të gjuhës kroate I)*, Shkolska knjiga, Zagreb, 1996, f.18.

⁵⁵⁸ Richard Hudson & J. Walmsley, *The English Patient: English grammar and teaching in the twentieth Century*, Journal of Linguistics, 41(3), 2005, f. 593-622.

*mësimorë dhe nivelin e shkollave shqiptare në atë periudhë*⁵⁵⁹. Megjithatë, Myzyri shton se “*shkollat shqipe të Korçës ishin të një niveli mjaft të ngritur për kohën*”.

Në shekullin XX, pas Kongresit të Manastirit (1908) me njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe dhe pas Kongresit të Elbasanit (1909) me vendimin për krijimin e Shkollës Normale u hodhën bazat për arsimimin në gjuhën kombëtare. Hapja e Shkollës Normale si shkollë e parë e mesme shqipe, nxiti hapjen e shumë shkollave të tjera në vend, në të cilat të gjitha lëndët zhvilloheshin në gjuhën shqipe. Shkolla Normale u bë vatër e përgatitjes së mësuesve shqiptarë në gjuhën shqipe.⁵⁶⁰ Ndërkohë, kujtojmë, që në fillim të shek. XX, studiuesit shqiptarë hartuan gramatika të reja.⁵⁶¹ (*çka u intensifikua pas shpalljes së pavarësisë, në përpjekje për standardizimin e gjuhës*).⁵⁶²

Në periudhën e viteve 1912 deri në ato 1940, mësimdhënia e mësimnxënia e gjuhës shqipe u orientua nga mendimi bashkëkohor gjuhësor, psikologjik e didaktik për mësimin e gjuhës amtare, dhe në Kosovë u karakterizua nga mësimi i shqipes në forma individuale dhe në grupe të vogla. Pas vitit 1941 që në klasën e parë, edhe në shkollat e hapura në gjuhën shqipe, sipas planit të atëhershëm, në disiplinën e gjuhës shqipe integroheshin këto nëndisiplina: *këndim-shkrim (abetare dhe këndim) bashkë me ushtrime gjuhësore, mësim-shkrim (zhvillimi i të folurit rreth mjedisit) dhe përmendsh*. Përmes këtyre nëndisiplinave synohej që nxënësit të mësonin jo vetëm të lexonin, të shkruanin dhe të zhvillonin njohuritë e tyre gjuhësore, por edhe të shpreheshin “*logjikisht në kuvendim e në shkrim*.” Për këtë qëllim, në klasat pasardhëse, nëndisiplinat e disiplinës së gjuhës shqipe dhe leximit: *si gramatika, mësim-shkrimi, mësim jete, shkrimi dhe ortografia*, nuk shikoheshin si më vete, por të integruara, deri në njësim. Në këtë periudhë, mësuesit e ardhur nga Shqipëria në Kosovë sollën praktikatat e normalistëve lidhur me përdorimin e pjesëve të leximit në klasat II-V të fillores. Konceptimi dhe realizimi i gramatikës bëhej shkallë-shkallë, me shtrirje koncentrike e lineare të materialit gjuhësor dhe orientohej nga aspekti funksional e praktik për zhvillimin e aftësive komunikuese. Gramatika gërshetohej me nëndisiplinat e *mësim jete, këndimit, drejtshkrimit dhe hartimit*; madje hartimi shihej si një mundësi jo vetëm për zhvillimin gjuhësor, por edhe për zhvillimin mendor, konjitiv, moral dhe etik të nxënësit. Sipas shtypit pedagogjik të kohës “*Qëllimi i gramatikës është që të hyhet në shpirtin e gjuhës amtare, pra fëmija nuk duhet të kufizohet vetëm në shembulla dhe rregullat e librit; librin ta ketë si këshillonjës, por udhën ta gjejë vetë, se atëherë do të gjejë të vërtetën. Ndërsa “mësuesi duhet të interesohet t’i nxisë nxanësit të interesohen vetë për fjalët që flasin në shtëpi dhe për fjalët që flet vetë populli, që të hyjë në shpirtin e gjuhës; atje ka për të nxanë mënyrën e lidhjeve të konstrakteve krejt shqipe*.”⁵⁶³

⁵⁵⁹H. Myzyri, *Shkollat e para kombëtare shqipe*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1978, f. 82.

⁵⁶⁰Në këtë shkollë kanë punuar si mësues personalitete të arsimit kombëtar si: Aleksandër Xhuvani, Simon Shuteriqi, Salih Çeka, Kostaq Cipo, Mahir Domi, Eqrem Çabej, Thanas Floqi, e të tjerë.

⁵⁶¹Hysni Myzyri, *Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912)*, ETMM, 1996, Prishtinë, f.42.

⁵⁶²Ali Shashaj, *Metodikë e Mësimin të Gjuhës Amtare*, Tiranë, ADA, 2007, f. 16-23.

⁵⁶³Po aty, f. 19.

5.2. MËSIMDHËNIA E GRAMATIKËS NË VITET 1945-1970

Pas Luftës së Dytë Botërore, në Kosovë krahas publikimit të gramatikave të tjera të gjuhës shqipe, mungonin metodika për mësimin e gjuhës e të leximit, dhe materiale të tjera të karakterit praktik e didaktik. Mësimi i gjuhës shqipe sipas programit ishte linear, fillonte me fonetikën dhe vazhdonte me morfologjinë dhe sintaksën. Në planin dhe programin mësimor të gjuhës theksohej: “Për ta folur e për ta shkruar mirë gjuhën, duhet të mësohet mirë fonetika, morfologjia..., prandaj gramatika në shkollën tonë zë një vend me rëndësi.”⁵⁶⁴ Në Kosovë, drejtuesit e atëhershëm të arsimit, të cilët ndonëse përballeshin me sfida të lloj-llojshme, vunë konturet në mësimdhënien tradicionale të gramatikës, sepse besonin se “... mësimi i gramatikës ndihmon në zhvillimin e të menduarit... Në ligjëratë, nëpërmjet gramatikës shprehen mendimet.”⁵⁶⁵ Por, në shkollat e kësaj treve, zotërimi i gramatikës ishte specifik dhe “politikëbërsit” e dëshironin vetëm si “riprodhim konceptesh” me shembuj dhe realizim të ushtrimeve të karakterit mekanik. Nga studimi i kujdeshëm i përmbajtjeve programore të këtyre viteve, vihet re se njohurive gramatikore u jepej mbështetje në programet dhe tekstet shkollore në përdorim. Në këtë mënyrë mësimi i gramatikës u shndërrua gati si qëllim në vetevete dhe pak i orientuar drejt aspektit funksional e praktik të gjuhës “...e tërë përmbajtja e mësimimit të gjuhës amtare në shkollë deri në vitet gjashtëdhjetë ka qenë njohuri për sistemin gramatikor, pra, teori gramatikore e pastër.”⁵⁶⁶

Për të pasqyruar sa më besnikërisht përmbajtjen, shtrirjen dhe thellësinë e gramatikës, për ilustrim kemi marrë planin dhe programin e gjuhës shqipe për klasën e tetë. Sipas planit dhe programit mësimor të vitit 1964, për klasën e tetë në përmbajtjet e përkufizuara, si Gramatikë, ishte planifikuar të mësoheshin: “dialektet kryesore të shqipes, theksi me përsëritë, plotësu, sistematizu, pjesët e ndërrueshme të ligjeratës (emnat, përemnat, nyjet dhe mbiemnat).” Madje, planifikohej zgjerimi i njohurive për: Emnat: gjinia gramatikore dhe natyrore nyjet, kuptimi themelor i rasave dhe përdorimi i drejtë i tyre; “Mbiemnat: trajta e shqueme dhe e pashqueme; Mbiemnat numerorë themelorë dhe rreshtorë (lakimi i tyre) dhe Përemnat: (në përgjithsi).”⁵⁶⁷ Ndërsa, në vitin 1971, sërish me përkufizimin “Gramatikë” në klasën e tetë ishte planifikuar të mësohej: “Sintaksa e periudhës; Periudha dhe mënyra e bashkimit të fjalive në të, fjalitë e pavarura, kryesore dhe të varura; Fjalitë e bashkrenditura dhe të nënrenditura, fialia kryefjalore, kundrinor, lidhore, caktuese, vendore, kohore, qëllimore, mënyrore, krahasore, kushtore, lejore dhe rrjedhore; Fialia e ndermjetme, periudha me shumë fiali të varura; Ushtrime përmbledhëse; Ligjëratë e drejtë dhe e zhdrejtë; Shenjat e pikësimit dhe përdorimi i tyre. Më pastaj ishin paraparë edhe thellim lënde: a) Formimi i fjalve: fjalë të parme, të prejardhura e të përbëra. Përbëria e fjalës: rrënja, parashtesa e prapashtesa, mbaresa. Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe dhe mënyra e formimit të tyre. Rasat dhe funksionet e tyre. Shkallët e mbi emrave dhe substantivimi i tyre. Trajtat e shkurtura të përemrave vetore (vetvetore) e kuptimi i tyre, foljet kalimtare e mose kalimtare. Shprehet foljore. Mënyrat dhe kohët e folies dhe

⁵⁶⁴ Plani dhe programi mësimor për gjuhë amnore, KSAKM, 1964.

⁵⁶⁵ A. Paralloi, Kontributi i Shkollës Ushtrimore në mendimin pedagogjiko-didaktik shqip. Marrë nga Normalja në traditë, Elbasan, 1995.

⁵⁶⁶ Bahri Beci, Probleme të mësimimit të gjuhës amtare në shkollë. Ligjëratë me mësuesit e shqipes në shtetet skandinave, 15 -16 maj 2007, Landskrona, Suedi. <http://modersmal.skolverket>.

⁵⁶⁷ Teksti i përmbajtjes së plan-programit mësimor të vitit 1964 është shënuar në mënyrë origjinale sipas Ortografisë së gjuhës shqipe (gegërisht) të vitit 1964.

*kuptimi i tyre .b)Ushtrime per zhvillimin e te folurit.*⁵⁶⁸ Në palnin dhe programin mësimor të gjuhës dhe letërsisë shqipe për vitin 1977, nga pjesa e dedikuar për “Gramatikë” në klasën e tetë ishte paraparë të mësohet: “Sintaksë; Fjalë; Llojet e fjalëve sipas kuptimit të tyre (dëftore, pyetëse, urdhërore etj.). Llojet e fjalëve sipas përbërjes së tyre (fjalë e thjeshtë, e zgjeruar dhe e përbër –periudha: fjalë mungesore). Ushtrime rreth intonacionit e theksit të drejtës të fjalëve trajtash të ndryshme. Pjesët e fjalëve: kryefjalën (kuptimi. llojet e saj); kallëzuesi (kuptimi , llojet e tij). Të përshtaturit e kallëzuesit me kryefjalën. Kundrina e drejtë (kuptimi, ndertimi i saj). Cilësori (kuptimi, llojet dhe pershtatjet e tij.). Ndajshkrimi (kuptimit, llojet dhe pwrshatjet e tij). Ushtrime sintaksore. Plotësit e dallimit (plotësi i pronës, i lëndës, i cilsisë, i kufizimit i çfarësis dhe i pjesës). Plotësit e rrethanës (plotësi i vendit, i kohës, i mënyrës, i shkakut, i qëllimit , i mjetit, i sasisë, i shoqërizimit, i krahasimit, i vepruesit etj.). Ushtrime sintaksore.⁵⁶⁹

Ndërkaq, në dokumentin zyrtar, plani e programi shkollor për vitin 1971, pjesa e përmbajtjeve mbi gjuhën ishte emërtuar “Gjuhë” dhe ishte planifikuar që gjatë vitit të shtjelloheshin pjesët e: Sintaksës: Fjalë me gjymtyrë homogjene. Fjalë me gjymtyrë të veçuar. Thirrmore. Fjalë e fjalit e ndërmjetme. Fjalët e thjeshta (të pazgjeruar e të zgjeruar) përseritje nga klasa VII, Fjalë e përbër – vështrimi i përgjithshëm. Fjalë e përbër dhe mënyrat e rënditjes së fjalëve në të. Fjalë e përbërë e bashkrenditjes e nënrenditjes. Fjalitë përcaktore. Fthilluese, (sqaruese), fjalitë vendore, kohore, shkakore, qëllimore mënyrore, krahasore, sasiore, rrejedhore, kushtore, dhe lejore. Fjalë e përbërë pa lidhza. Fjalë e përbërë me më shumë se dy fjalë. Ligjëratat e drejta dhe ato të zhdrejta. Shenjat e piksimit dhe përdorimi i tyre. Ushtrime sintaksore. Kurse për thellimin e lëndës ishte planifikuar të rizgjeroheshin njohuritë e nxënësve të kësaj gjenerate (klasës së tetë) për: “Dialektet e gjuhës shqipe (ilustrimet me shembuj). Formimi i fjalëve: fjalë të parme, të prejardhura e të përbëra. Pjesët përbërse të fjalës: rrënja, parashtesa, prapashtesa e mbaresat. Rasat dhe funksionet e tyre. Emërtimi i mbiemrave. Trajta e shkurtërta të përemrave vetor. Foljet kalimtare dhe ato jo kalimtare. Shprehjet foljore. Format (të shtjelluera e të pashtjelluera) të foljes dhe funksioni i tyre. Kohët e foljes dhe funksionet e tyre. Drejtshqiptimi: Shqiptimi i drejtë dhe llojet e shqiptimit të fjalëve. Shqiptimi letrarë dhe ai komunikues. Drejtëshkrimi: Shkrimi i dy pikave dhe i presjeve në renditjen e fjalëve të varura. Shkrimi i fjalëve bashkë e ndaras. Shenjat e piksimit (viza, viza lidhëse, tri pikat, yllthi, (asteriksi), apostrofi, kllapat, thojzat,) dhe Sistematizimi i lëndës së zhvilluar.⁵⁷⁰ Nisur nga konstatimi i profesor Androkli Kostallarit dhe një numri studiuesish të tjerë, vihet re shqetësimi për përqindjen e lartë të gabimeve drejtshkrimore tek nxënësit (ky konstatim vlente edhe për nxënësit e Kosovës). Këta didaktë, përvetësimin e drejtshkrimit e shihnin në lidhje më të ngushtë me strukturën fonetiko-gramatikore e fjalëformuese të gjuhës shqipe. Sipas Kostallarit, “... drejtshkrimi, kjo fytyrë e jashtme e gjuhës pasqyron... procesin e thellë e të ndërlikuar të brendshëm të ngjizjes e të ngulitjes së strukturës fonetike, gramatikore, fjalëformuese e leksikore të gjuhës kombëtare letrare.”⁵⁷¹ Kurse studiuesi Jup Kastrati, shprehet se: “Probleme të normës gramatikore në gramatikat e pasçlirimit”, ngriti një tjetër problem që lidhej, siç shprehet autori,

⁵⁶⁸ Plani dhe programi mësimor për shkollën fillore, 1971.

⁵⁶⁹ Plani dhe programi mësimor për shkollën fillore, 1977.

⁵⁷⁰ Plani e proramit shkollor për vitin 1985.

⁵⁷¹ Androkli Kostallari, *Gjuha e sotme shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Akademia e Shkencave të RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1973. f. 7.

me “mospërvetësimin e mirë të lëndës gramatikore.”⁵⁷² “Mësimi i gjuhës në Kosovë asnjëherë nuk ishte i integruar. Është kjo periudhë kur hartimin e gramatikave të ndryshme e bënin fillimisht autorë serbë (!!!) e më pastaj dhe autorët Idriz Ajeti, Hasan Vokshi, etj. Tekstet e gjuhës të shkollës fillore, 7- 8-vjeçare ishin të shkruara në gjuhën standarde gegërishte deri në vitin 1972.

5.3. MËSIMDHËNIA E GRAMATIKËS PAS VITEVE '70

Në Kosovë, me entuziazëm të madh u përqaftuan vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet që buruan nga Kongresi i Drejtshkrimit. Kudo, në shkollat e kësaj treve hetohej një garë se kush më shpejt e më mirë po zotëron shkrimin dhe shqiptimin e gjuhës së njësuar (apo gjuhës letrare), siç quhej në Kosovë. Nisën ndryshimet e përdorimit të normës letrare në shkollë, media, libra, në administratë. Sidomos në qendër të përkushtimit të mësimdhënësve ishte zotërimi i njohurive të reja gramatikore dhe njohurive për drejtshkrimin dhe pikësimin. Në këtë periudhë mësimi i gjuhës u hartua në tri fusha: *Fjalë dhe shprehje, Gramatikë dhe Drejtshkrim*. Fjalë e shprehje, si fushë nënkuptonte kultivimin e aftësive komunikuese: *të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit*.⁵⁷³ Në mësimin e gjuhës amtare në shkollën e Kosovës, përveç traditës shkencore dhe pedagogjike, në një mënyrë ose në një tjetër ka ndikuar edhe tradita shkencore e pedagogjike jugosllave, evropiane dhe botërore, pa mohuar kulturën e ardhur nga librat që depërtonin nga Shqipëria dhe nga TV Shqiptar.⁵⁷⁴ Po ashtu, në epiqendër të ndryshimeve të programeve dhe teksteve të gjuhës shqipe ishte parimi i të nisurit nga funksioni i aktit të ligjërit, për të dalë në njohuritë e sistemit të gjuhës.⁵⁷⁵ Programet e reja synonin jo vetëm formimin gjuhësor të nxënësve por dhe aftësimin e tyre në përdorimin e gjuhës për qëllime komunikimi.

Në programin e gjuhës shqipe të këtyre viteve, kërkesat kryesore ishin: *përdorimi i drejt i normës drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore të gjuhës sonë letrare, si dhe përdorimin e pikësimit; zotërimi i nocioneve themelore leksikore dhe fjalëformuese, njohja e leksikut bazë dhe aktiv të gjuhës sonë letrare, si dhe modelet kryesore fjalëformuese e t'i përdorin ato në përputhje edhe me veçoritë e stileve të gjuhës sonë letrare; të zotërojnë nocionet themelore fonetike, morfologjike e sintaksore, modelet themelore strukturore të gjuhës sonë letrare dhe të aftësohen t'i përdorin ato në përputhje me veçoritë stilistike dhe me situatat konkrete komunikuese me gojë dhe me shkrim*.⁵⁷⁶ Për të arritur këtë qëllim të mësimin të gjuhës, pas viteve 2000 struktura e çdo mësimi përfshinte katër përbërës: “*Të dëgjuarit dhe të folurit*”, me nënkategoritë: Kulturë e të dëgjuarit dhe e të folurit, Tekstet letrare dhe joletrare, Njohuri gjuhësore. Te kategoria “*të lexuarit*”, planifikoheshin nënkategoritë: Kulturë e të lexuarit; Tekstet letrare dhe joletrare; Njohuri gjuhësore dhe te kategoria “*të shkruarit*”, planifikoheshin nënkategoritë: Kulturë e të shkruarit; Njohuri gjuhësore.” Njohuritë gjuhësore kishin karakter intuitivo-praktik d.m.th. koncepte pa përkufizime e zberthime të karakterit teorik, por thjesht praktik. Në një situatë konkrete komunikative, nxënësit, viheshin në pozita vëzhgimi të faktit gjuhësor (*që do të*

⁵⁷² Jup Kastrati, “Probleme të normës gramatikore në gramatikën e pasçlirimit..”, në “Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë .. Materiale të konferencës shkencore të mbajtur në Tiranë më 7-8dhjetor, 1984, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, 1988, f.239.

⁵⁷³ Ali Shashaj, *Metodikë e Mësimin të Gjuhës Amtare*, Tiranë, ADA, 2007, f. 24.

⁵⁷⁴ Bahri Beci, *Probleme të mësimin të gjuhës amtare në shkollë*, Ligjëratë me mësuesit e shqipes në shtetet skandinave, 15 -16 maj 2007, Landskrona, Suedi. <http://modersmal.skolverket.se>

⁵⁷⁵ Ali Shashaj, *Metodikë e Mësimin të Gjuhës Amtare*, Tiranë, ADA, 2007, f. 28.

⁵⁷⁶ Këto ishin vetëm disa nga kërkesat që shtrëngonin planet dhe programet mësimore të këtyre viteve.

trajtohej në përbërësin Gramatikë apo Drejtshkrim) dhe të zbulimit të tij në fjalë dhe fjali të ndryshme. Pas familjarizimit me faktin gramatikor, nxënësit nxiteshin t'i zbatonin këto njohuri në përbërësin *Të shkruajmë*. Në këtë mënyrë induktive, duke u nisur nga funksioni për të arritur tek forma, ndryshe nga metoda tradicionale që nisej nga forma për të arritur tek funksioni, përmes përbërësve *Të flasim dhe Të shkruajmë*, synohej jo thjesht zhvillimi i aftësive ligjërimore të nxënësve, por dhe zhvillimi dhe integrimi i njohurive gjuhësore. Përsa i përket përmbajtjes së lëndës, ajo kishte një shtrirje koncentrike dhe lineare: njohuritë rimerreshin nga një klasë në tjetrën, por duke u zgjeruar, thelluar përmes trajtimeve më të detajuara dhe duke dhënë njohuri të reja.

Faktin e përmirësimit të programeve dhe teksteve të gjuhës shqipe të hartuar pas viteve '70, e përmendin gjuhëtarë të njohur. Sipas tyre "*Në programin e vitit 1984, kemi një shtrirje më të mirë të lëndës, ka ngritje të nivelit shkencor teorik, shtim të orëve të mësimit të gjuhës shqipe që mundëson zgjerimin e disa temave dhe ushtrimeve*".⁵⁷⁷ Nga përvoja disa vjeçare e zbatimit të tyre, krahas arritjeve që pati (*në krahasim me programet e tekstet paraardhëse*) pati dhe probleme: nuk u arrit një harmonizim organik ndërmjet njohurive për sistemin e gjuhës dhe të aktit të ligjërimit; në shumë mësim, tematika dhe situata konkrete e komunikimit në rubrikën '*Të flasim*' nuk u paraprinte njohurive në përbërësin pasardhës '*Gramatikë apo Drejtshkrim*'.⁵⁷⁸ Në Kosovë pothuaj përherë ekziston ndarja e gjuhës nga letërsia, si lëndë të veçanta, e vështirësonte këtë problem, përdorimin e gjuhës në varësi të situatës së komunikimit. Kjo bëhej, në përputhje me këtë program të hartoheshin tekste të reja, në të cilat të kishte një shtrirje harmonike të njohurive të të gjitha rrafshëve të gjuhës: (*fonetikë, morfologji, sintaksë, fjalëformim, drejtshkrim, drejtshqiptim, fjalor dhe frazologjizma*)⁵⁷⁹. Reformimi i sistemit arsimor në vitet e fundit, ku sistemi 4+4+4 u zëvendësua me sistemin 5+4+3, solli si rezultat nevojën e hartimit të programeve e teksteve të reja për mësimin e gjuhës amtare. Përmbajtja është e strukturuar në katër linja: *Të dëgjuarit dhe të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit*.⁵⁸⁰ Materiali gjuhësor me të cilin punojnë nxënësit është kryesisht nga gjuha e gjallë (*autentike*) dhe situata konkrete komunikimi. Programi dhe tekstet mësimore të gjuhës shqipe inkurajojnë mësuesit të trajtojnë çështjet gjuhësore në mënyrë induktive: përmes pjesëve letrare dhe situatave konkrete komunikative, nxënësit natyrshëm mund të vërejnë shembuj konkretë të fakteve gjuhësore që trajtohen në linjën '*Njohuri mbi gjuhën*'. Me rritjen e moshës zbatohet dhe mënyra deduktive. Përherë në shkollën e Kosovës, deri në dekadën e fundit, sfida për mësuesit e gjuhës si një figurë qendrore dhe krijuese në procesin e mësimit mbetej integrimi i mësimdhënies së gramatikës me aftësitë e komunikimit.

⁵⁷⁷Mehmet Çeliku "*Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe shkolla*" në "Konferencë shkencore", Tiranë, 7- 8 dhjetor 1984, Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, 1988, f.118.

⁵⁷⁸ Ali Shashaj, *Metodikë e Mësimit të Gjuhës Amtare*, Tiranë, ADA, 2007, f. 36.

⁵⁷⁹Bahri Beci, *Probleme të mësimit të gjuhës amtare në shkollë*, Ligjëratë me mësuesit e shqipes në shtetet skandinave, 15 -16 maj 2007, Landskrona, Suedi. 9<http://modersmal.skolverket.se>

⁵⁸⁰*Vërejtje*: Përmbajtja e nënkategorive realizohet në funksion të të tri kategorive kryesore. Për lëndën e gjuhës shqipe, për kl.VIII të shkollës fillore, sipas Planit dhe programit të vitit 2003, ishin paraparë këto kategori: Kulturë e të dëgjuarit dhe e të folurit, kulturë e të lexuarit, kulturë e të shkruarit 45 orë; Tekstet letrare dhe joletrare 60 orë; Njohuri gjuhësore 70 orë dhe Në dispozicion 10 orë.

5.3.1. Programet e gramatikës së gjuhës shqipe, për shkollat 8-vjeçare në Kosovë, vitet '60

Vendi i gramatikës dhe i njohurive për gjuhën në programet në shkollën e Kosovës ndryshonte varësisht nga politikat gjuhësore në këtë trevë, sepse, “*shkolla fillore është institucion ku arsimohen dhe edukohen fëmijët e moshës 7-15 vjeçare*”,⁵⁸¹ ku punohej sipas ligjeve dhe plan-programeve të hartuara nga ekspertët për lëmenjt e caktuar. Kështu, mbështetur në këto dokumente zyrtare shtetërore dhe në përvojën e përgatitjen teorike mësimdhënësit kishin në dorë “*mjeshtrinë*” e artit të mësimdhënies dhe të gramatikës. Me trajtimin e mësimdhënies tradicionale të gramatikës në shkollat e Kosovës (me përkufizimin *gramatikë*), në këtë pjesë të punimit do të përfshihen jo vetëm mësimi i *morfologjisë dhe sintaksës, por edhe të fonetikës, fonologjisë, lingistikës*, pa të cilët nuk mund të mendohet mësimi i gjuhës shqipe. Qëkur filloi mësimi i institucionalizuar nuk kanë pushuar përpjekjet për një mësimdhënie sa më të mirë të gjuhës shqipe. Gjatë vjeljes së materialeve (*programeve, teksteve, materialeve arkivore e dokumentacionit pedagogjik*) pasqyrohen edhe përpjekjet për përmirësimin, plotësimin dhe reformimin e përmbajtjeve programore por edhe të teksteve të gramatikës. Duke patur për bazë se “*...sa më tepër që të komplikohen përmbajtjet teorike gjuhësore edhe qëllimet e mësimin të gjuhës, ndryshohet edhe më shumë cilësia e mësimin të disa shtresave gjuhësore.*”⁵⁸² Këtë reflektim e shpjegojnë praktikatat e mësimin përmendsh të teksteve dhe nocioneve edhe pse luftoheshin vështirë të flakeshin në shkollat e Kosovës. Këtë e sqaron edhe dijetari francez J.Witwer, i cili në mënyrë eksperimentale ka vërtetuar se “*mësimi mekanik dhe abstrakt i gramatikës në mes klasës së tetë dhe të dymbëdhjetë rezulton me mësim të zbrazët teknik pa përmbajtje, dhe edhe më keq-mund të shkaktojë edhe ‘lidhje të shkurtë mentale’, e cila kurdo do të paralizojë zhvillimin e mendimit tek fëmijët.*”⁵⁸³ Për të hedhur dritë mbi këto pikëpamje është krahasuar përmbajtja programore e vitit 1964 me ato të pas viteve 2000.

Tabela 24. Fondi i orëve mësimore për gjuhë dhe letërsi shqipe, të vitit 1964.

Lënda	Numri javorë i orëve të mesimit sipas klasave							
	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
Gjuhë dhe letërsi shqipe	6	6	6	6	6	5	4	4

Në arsimin e detyruar të Kosovës ky fond i orëve mësimore ishte i ndarë edhe për mësimin e gramatikës. Mësimi i gramatikës ishte i ndarë, nuk ishte i integruar. Po hedhim një vështrim përmbajtjesor sipas klasave.

Klasa e parë - Në linjën ‘leximi dhe shkrimi fillestar’, (“*të zotnuemit e leximit dhe të shkrimit*”) në këtë klasë ishin planifikuar “*Ushtrime në të lexuem dhe në të shkruem. Gjatë leximit me*

⁵⁸¹ Plani dhe programi mësimor unik i punës arsimore-edukative në shkollën fillore të KSAK, Prishtinë 1977.

⁵⁸² Sipas: M.Jasen, Der Fremdsprachenunterricht und die muttersprachliche Bildung, f.5-10, dhe Metodika e mësimin të drejtshkrimit (ortografisë) dhe të drejtshqiptimit (ortoepisë) Sipas: M.Dierks,-F.Zander, Sprachgebrauch und Erfahrung, f.9.

ushtrive tekniken e të shkrimit. Mësisimi mbi gjuhën: shkronja e madhe (në fillim të fjalisë dhe ndër amna të përveçëm). Përdorimi i pikës. Të dalluemit e fjalisë dhe tingujve në përdorim, pa përkufizime. Ushtrime sa i përket shqiptimit të rregullt të tingujve, sidomos të c, q, xh, gj, th, dh, h, r, rr, e, ë.⁵⁸⁴ Kurse në linjën 'Ushtrime të të foluni', kërkohej përshkrimi i fotografive, sendeve, lodrave dhe lojave fëmimore. Por për të kultivuar kulturë gjuhësore planifikoheshin edhe këto forma të mësimi, si: 'Kopjime, diktime të shkurta, hartime të shkurta (dy deri tri fjali), simbas përmbajtjes së fotografive (përshkrime).'⁵⁸⁵

Klasa e dytë - Në linjën 'Mësimi mbi gjuhën', planifikoheshin që pas mësimi të shkrim leximit të mësohej e të bëhej "Dallimi i fjalisë pohore, mohore e pytëse dhe përdorimi i tyre. Fjalët që tregojnë emra (pa përkufizim). Fjalët që tregojnë punë (pa përkufizim). Shkronja e madhe në shkrimin e emrave gjeografike. Përdorimi pikës, pikpytjes, pikçuditjes, dy pikave gjatë numrimit. Shqiptimi i rregullt dhe shkrimi i tingullit: J, I (ai dhe jo dhe aji). Me viju ushtrimet e shqiptimit të drejt të tingujve. Diktimit dhe ushtrime me shkrim prej mësimi mbi gjuhën."⁵⁸⁶

Klasa e tretë - Kategoria kryesore e mësimi të gramatikës për këtë klasë, sipas planit mësimor që kemi në analizë quhej "Mësimi mbi gjuhën", ku parashihej mësimi për "Emnat: të përveçëm e të përgjithshëm, gjinia dhe numri (ide) dallimi i njëjësit dhe shumësit në fjali. Foljet (ide) Koha e tashme e kalum e dhe ardhëshme (ide). Dallimi i emrave dhe foljeve të rolit të tyre në fjali (kryefjala dhe kallxuesi). Fjalët që tregojnë cilësi (përkufizimi). Fjalët e thjeshta –mendimi ma i shkurtë mbi një veprimi ose send. Përdorimi i shkronjës së madhe (titujt e arteve dhe sipërmarrjeve), Përdorimi i dy pikave dhe thonjzave (numrave citimi i fjalëve të huaja). Shkrimi i fjalëzave do të (shkojë e jo do të shkoj). Me u a ba shprehi nxënësve bartjen e pjesëve të fjalisë në rresht të ridhe me ushtrive ndjenjën e natyrshme sa i përket kufinit të rrokjes. Dy zanore (diftongjet) ue, ie, ye."⁵⁸⁷ Po ashtu, në klasën e tretë, planifikoheshin që duhet të vijohej me ushtrimet e shqiptimit të drejtë të titujve dhe diktimit dhe ushtrimet me shkrim nga mësimi mbi gjuhën. Ndërkaq, parashihej të mbaheshin edhe hartimet shkollore (gjashtë hartime shkollore në vit.)

Klasa e katërt - Në klasën e fundit të mësimi klasor linja për gramatikën ishte e përkufizuar si 'Mësimi mbi gjuhën', sipas së cilës planifikoheshin të mësoheshin këto përmbajtje mësimore nga gramatika: "Emnat; emën sendi, kuptimi dhe kolektivi; Dallimi i gjinisë numrit dhe nyjës të emnat kuptimi i nyjës, kuptimi i rasave. Kuptimi i mbiemrave (të nyjshëm dhe të shnyjshëm). Shkallët e krahasimit të mbiemrave. Gjinia dhe Numri i mbiemrave. Përemrat vetorë dhe numri i tyre (kuptimi). Përdorimi dhe shkrimi i përemnit 'ju' gjatë ndërtimit. Mbiemnat numërorë, themelor dhe rreshtor (kuptimi). Fjalja e zgjanueme. Plotësit e emni (atributi) dhe ata të foljes (plotësori i vendit, i kohës, i mënyrës dhe i mjetit)."⁵⁸⁸ Në këtë klasë nga gramatika parashihej të bëheshin ushtrime ("me stërvitë ndjenjën e natyrshme sa i përket kufinit të rrokjes.") dhe të mbaheshin gjatë vitit gjashtë hartime shkollore.

⁵⁸⁴Plani dhe programi mësimor për shkollën fillore, KSAKM, 1964.

⁵⁸⁵Po aty.

⁵⁸⁶Plani dhe programi mësimor për shkollën fillore, KSAKM, 1964.

⁵⁸⁷Po aty.

⁵⁸⁸Po aty.

Klasa e pestë - Gjatë vitit shkollor në këtë klasë ishte planifikuar që linja e mësimi të gjuhës shqipe të përmbledhej në nocionin “Gramatikë”. Përmbajtja programore fillonte me mësimin: “Gjuha si mjet marrëveshje. Dialektet kryesore të gjuhës shqipe. Kuptimi i fjalës së zgjanume. Fjala e thjeshtë dhe e përbame (kuptimi). Rrokja e tingullit dhe diftongjet. Zanoret dhe bashktinglloret. Ide themelore mbi pjesët e ndrushme dhe të pandrushme të ligjeratës: Emnat: sendi, kuptimi, numri, gjinia natyrore dhe gramtikore. Nyjet e mbrapme te emnat. Kuptimi themelor i rasave tu e lidhë me lakimin e emrave. Mbiemrat: cilësor dhe caktorë. Numri, gjinia dhe shkallët e mbiemrit cilësor. Lakimi i mbiemrave cilësor që. Mbiemrat përemrorë: pronor, dëftorë dhe pyetës (kuptimi dhe përdorimi). Numrorët themelor dhe rreshtor dhe lakimi i tyre. Përemnat: Llojet e përdorimit i drejtë i tyre (kuptimi). Lakimi i përemrave vetorë. Foljet: që të tregojnë punë dhe qëmë. Foljet ndihmtare. Koha e tashme e foljeve te rregullta koha e kalume dhe e ardhme. Ndajfolja, paraafjala lidhëzat dhe pasthirrmat.”⁵⁸⁹ Me programin e klasës së pestë hartuesi kishte planifikuar që edhe më tutje të mësohej përdorimi i shkronjës së madhe: në emrat e krentave, të rrugëve, të titujve të librave, revistave dhe gazetave. Një pjesë e mirë e programit ishte rezervuar edhe për linjën ‘Ndririmet tingëllore’, nga e cila dilnin porosi për mësimdhënësin e gjuhës shqipe që nxënësve t’ua mësonin:

a) Të çfaqunit dhe zhdukja e tingullit te emnat, përemnat dhe te mbiemnat, të cilët në rastin e parë të trajtës së pashqume të mbarojnë me: ër, ël, ëm: libër-libri, vogël, vogla, i vetëm - i vetmi, thekën- thekna.⁵⁹⁰

b) Në rasat –çfaqja e tingulit ë normtivë, akuzative dhe vukative të trajtës së pashueme njëjsë dhe zhdukja e tij nëpër ras tjera te emrat dhe përemrat të cilët mbarojnë: ël, ël, ëm, ën.

c) Ndërrimet tingëllore

- Në numër –shëndrimi i bashktingllores **g** dhe **k** në **gj** dhe në **q** (në shumës), për shembull: zogë-zogjë, mikë-miqë.
- Ndrimi i **a** në **e** (duakt-duket, plak –pleq).
- Ndrimi i **ll** në **j**: (grumbull-grumbuj, bullet-buj).

Gjatë vitit shkollor planifikohet të mbaheshin katër hartime.

Klasa e gjashtë - Edhë në këtë klasë, linja qendrore e mësimi të gjuhës shqipe quhej me emrin ‘Gramatikë’. Ndërkaq në përmbajtjet programore zinin vend këto pjesë të gramatikës, të cilat fillimisht riktheheshin si plotësim e përsëritje e njohurive rreth fjalisë së “zgjanume” (apozicioni, plotësitë, ndajfoljor). Pastaj, plotësim i njohurive rreth pjesës te “ndrrueshme” të ligjeratës, si emrat: rasat dhe lakimi. Emrat si kunderinë. Mbiemrat: cilsor dhe cakëtor. Lakimi i mbiemrave cilësor. Mbiemrat si cilësor (cilesues.) dhe vijohej të mësoheshin “Peremnat: perdorimi i trajtave te peremrave vetorë. Foljet sipas kalimit (kundrina e drejt dhe e zhdrejt), (aktive dhe refleksive. Menyret e foliesë, perseritje e tri kohëve themelore. Koha e pakryme, e kryme e thjeshtë dhe e kryme e plotë. Ndajfoliet: ndajfoliet dhe lokucionet ndajfoljore. Periudha: marëdhënja e fialive (e mevarme dhe e pa mvarme-kuptimi i përgjithshëm). Drejtshkrim: perdorimi i preses ne fjalitë e zgjanueme.”⁵⁹¹ Në këtë klasë disa orë mësimore i kushtohet sërish mësimi se si të bëhej përdorimi i mëtejshëm i shkronjës së madhe, si shkruhen trupat qiellor, ofiqet, emrat e kafshve, si dhe shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras.

⁵⁸⁹ Plani dhe programi mësimor për shkollën fillore, KSAKM, 1964.

⁵⁹⁰ Në Kosovë, gjatë këtyre viteve zbatohet Ortografia e gegërishtës e vitit 1964. (Andaj po i shenojmë besnikërisht në gegërishte edhe këto pjesë nga Programi).

⁵⁹¹ Plani dhe programi mësimor për shkollën fillore, KSAKM, 1964.

Klasa e shtatë - Nën nocionin ‘Gramatikë’ sipas planit dhe programit mësimor planifikohej të përseriten dhe të plotësohen njohuritë mbi fjalinë e “zgjanume” (llojet e kryefjalëve dhe të kalxusëve). Më pastaj vazhdohej të mësohej “*Periudha dhe marrëdhënjet e fjalive në të. Llojet e fjalive të panvaruna dh të nvaruna. Shenjat e piksimit në fjalinë e permbame (presja, pikëpresja, disa pika, pikat e pushimit).* Pelqimi i pjesve të fjalisë (kongruenca). Me i plotsue njohunitë në lidhje me emrat, mbiemnat, përemnat (lakimi i tyre). Foljet: Kuptimi kryesur i trajtave të foljeve, zgjedhimi i foljeve të rregullta në të gjitha trajtat.”⁵⁹² Edhe në klasën e shtatë, gjatë vitit shkollor mbaheshin katër hartime.

Klasa e tetë - Sipas programit mësimor për gjuhë shqipe të kësaj klase në pjesën e dedikuar për “Gramatikë” ishte planifikuar të mësoheshin, dialektet kryesore të shqipes, theksi. Më pastaj “*me përsëritë, plotsue sistematizue pjeset e nderrueshme të ligjeratës (emnat, përemnat, nyjet dhe mbiemnat).* “Për të vijuar sërish me zgjerimin e njohurive për “*Emnat: gjinia gramatikore dhe natyrore, nyjet, kuptimi themelor i rasave dhe perdorimi i drejt i tyre. Mbiemnat: trajta e shqueme dhe e pashqueme. Mbiemnat numerorë themelorë dhe rreshtorë (lakimi i tyre). Përemnat: (në përgjithsi).*”⁵⁹³ Kjo ishte përmbajtja e programit të viteve gjashtëdhjeta, i cili ishte në përdorim zyrtar deri në vitin 1972, kur gjuha shqipe u njësuua dhe u miratuan një vistër dokumentesh, të cilat rregulluan dhe stabilizuan gramatikën dhe normën letrare.

5.3.2. Programet e gramatikës së gjuhës shqipe gjatë viteve 2000

Sipas planeve mësimore të hartuara pas luftës çlirimtare në Kosovë, u vërejt një hap konkret drejt një transformimi të planifikimit. Vihet re depërtimi i frymës së didaktikës evropiane pas vitit 2003. Pas viteve 2000 nga lëmija e “Gramatikës” në planet mësimore planifikohej të mësohej për: “*Ndërrimet historike (metafonia, apofonia, metateza, elizioni, përngjitja, shkrirja, kontraksioni); Ndërrimet e gjalla në gjuhën shqipe (pozicionale dhe kombinatorike; Formimi i emrave dhe i mbiemrave (me parashtesa dhe prapashtesa); Fjala, grupi emëror dhe grupi foljor; Fjalitë dhe formimi i tyre (analizë gramatikore); Lakimi i përemrave vetvetorë, pronorë, pyetës dhe të pacaktuar; Mënyra kushtore, dëshirore, habitore dhe urdhërore e foljes dhe kohët e tyre, zgjedhimi, diatezat; Pjesëzat, Pasthirrmat; Fjalitë e përbëra me bashkërenditje (këpujore, kundërshtore); Fjalitë e përbëra me nënrenditje (fjilluese, kohore, shkakore, kushtore, krahasore – mënyrore, rrjedhimore, lejore, kundvënëse); Fjalët me shumë kuptime (identifikimi dhe përdorimi i tyre në tekste të ndryshme); Dialektet në territoret ku flitet shqipja, dallimet mes tyre dhe shqipes standarde; Zhvillimi historik i gjuhës shqipe dhe ndërndikimet me gjuhët e tjera.* Sipas klasave shpërndarja e lëndës paraqitet e tillë:

Në **klasën e parë**, me 7 orë në javë dhe 259 orë në vit bëhej organizimi i përmbajtjes programore. Të planifikuar si ‘*Shkathtësitë e komunikimit*’, këto përmbajtje ishin ndarë në: të dëgjuarit dhe të folurit - 70 orë; të lexuarit-85 orë; të shkruarit- 94 orë dhe në dispozicion- 10 orë.

Në **klasën e dytë**, mësimi i gjuhës shqipe ishte ndarë në këto kategori: Të dëgjuarit dhe të folurit (me nënkategoritë): Kulturë e të dëgjuarit dhe e të folurit; Tekstet letrare dhe joletrare;

⁵⁹²Po aty.

⁵⁹³Plani dhe programi mësimor për shkollën fillore, KSAKM, 1964.

Njohuri gjuhësore. Ndërsa të kategoria: *Të lexuarit (nënkategoritë)*: kulturë e të lexuarit; tekstet letrare dhe joletrare dhe njohuri gjuhësore.

Ndërkaq të kategoria: *Të shkruarit (nënkategoritë)*: kulturë e të shkruarit; tekstet letrare dhe joletrare; njohuri gjuhësore. Përmbajtja e nënkategorive realizohet në funksion të tri kategorive kryesore. (Kulturë e të dëgjuarit dhe e të folurit, kulturë e të lexuarit, kulturë e të shkruarit 74 orë); Tekstet letrare dhe joletrare 85 orë; Njohuri gjuhësore 90 orë dhe në dispozicion 10 orë.

Në **klasë e tretë**, në arsimin e detyruar në Kosovë në këtë periudhë në lëndën e gjuhës shqipe ishin të planifikuara tri kategori. Kategoria e të dëgjuarit dhe të folurit, përfshinte nënkategoritë: 1 Kulturë e të dëgjuarit dhe e të folurit; Tekstet letrare dhe joletrare; Njohuri gjuhësore. Ndërkaq, të kategoria: *Të lexuarit (nënkategoritë)*; Kulturë e të lexuarit; Tekstet letrare dhe joletrare; Njohuri gjuhësore dhe në kategorinë: *Të shkruarit (nënkategoritë)*: Kulturë e të shkruarit; Tekstet letrare dhe joletrare dhe Njohuri gjuhësore. Përmbajtja e nënkategorive realizohej në funksion të tri kategorive kryesore. Për këtë qëllim hartuesi i planit kishte planifikuar që për: Kulturë e të dëgjuarit dhe e të folurit, kulturë e të lexuarit, kulturë e të shkruarit 74 orë; për tekstet letrare dhe joletrare 85 orë, për njohuri gjuhësore 90 orë dhe në dispozicion 10 orë mësimi. Për këtë lëndë mësimore ishin paraparë 6 orë në javë, 222 orë në vit.⁵⁹⁴

Në **klasën e katërt**, për të realizuar ‘*Shkathtësitë e komunikimit*’, planifikohej që kjo të arrihej përmes kategorive: *të dëgjuarit; të folurit; të shkruarit dhe të lexuarit*. Përmbajtjet nga linja “*të dëgjuarit*” realizohej përmes nënlinjave, si: *të dëgjuarit informativ; të dëgjuarit efektiv; të dëgjuarit e teksteve joletrare dhe letrare; të dëgjuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës; të dëgjuarit në funksion të zgjerimit të leksikut*.⁵⁹⁵ Në këtë klasë linja të folurit arrihej përmes nënlinjave: *Të folurit informativ; të folurit aktiv në grup; të folurit në funksion të teksteve letrare dhe joletrare; të folurit në funksion të përvetësimit të gjuhës; të folurit në funksion të zgjerimit të leksikut; të folurit joverbal*. Kurse kategoria “*të lexuarit*” sendërtohej në këto tërësi tematike: *Të lexuarit e teksteve joletrare; të lexuarit e teksteve letrare; të lexuarit në funksion të teknikave të leximit; të lexuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës; të lexuarit në funksion të zgjerimit të leksikut*. Po kështu edhe të kategoria “*të shkruarit*” mësohej për këto tërësi tematike: *Të shkruarit funksional; të shkruarit personal imagjativ; të shkruarit në funksion të përvetësimit të gjuhës; të shkruarit në funksion të përvetësimit të leksikut; të shkruarit në funksion të përvetësimit të drejtshkrimit; të shkruarit në funksion të pikësimit*.

Në **klasën e pestë**, ishte ndërtuar një plan mësimor, ku përmbajtja e nënkategorive realizohej në funksion të tri kategorive kryesore (*Të dëgjuarit dhe të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit*). Për t’u arritur ky qëllim mësimor, për kulturën e të dëgjuarit dhe të folurit, kulturë e të lexuarit, kulturë e të shkruarit 74 orë, për tekstet letrare dhe joletrare 85 orë, për njohuri gjuhësore 90 orë dhe në dispozicion të mësimdhënësit ishin 10 orë mësimore. Të kategoria “*Të dëgjuarit dhe të folurit*” nëpërmjet nënkategorive: Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit, tekstet letrare dhe joletrare dhe njohuri gjuhësore realizoheshin synimet programore. Kurse të kategoria “*Të lexuarit*” në nënkategoritë: Kulturë e të lexuarit; tekstet letrare dhe joletrare dhe njohuri gjuhësore. Pjesa tjetër e lëndës sendërtohej në kategorinë “*Të shkruarit*”, e cila shtrihej në nënkategoritë: Kulturë e të shkruarit; tekstet letrare dhe joletrare dhe njohuri gjuhësore.

⁵⁹⁴ Plani dhe programi mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe për shkollën fillore të Kosovës, 2004.

⁵⁹⁵ Po aty.

Klasa e gjashtë - Organizimi i përmbajtjes programore në këtë klasë ishte planifikuar të realizohej me nga 5 orë në javë, dhe 185 orë në vit. Lënda për mësimin e gjuhës shqipe ishte emërtuar si « Shkathësitë e komunikimit ». Ajo ishte shtrirë në këto kategori:

Tabela 25. Fondi i orëve për klasën e VI, sipas kategorive

Të dëgjuarit dhe të folurit.....	45 orë
Të lexuarit.....	55 orë
Të shkruarit.....	75 orë
Në dispozicion.....	10 orë

Për kategorinë, të dëgjuarit dhe të folurit, mësimi për gjuhën shqipe arrihej në përmbajtjet e këtyre nënkategorive: *Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit; tekstet letrare dhe joletrare; njohuri gjuhësore.* Ndërsa kategoria ‘*të lexuarit*’ mësohej përmes nënkategorive: *Kulturë e të lexuarit; tekstet letrare dhe joletrare dhe njohuri gjuhësore.*

Klasa shtatë, në planin dhe programin mësimor të viteve të pas luftës çlirimtare në Kosovë ishte paraparë që gjuha të mësohej e të realizohej nga përmbajtja e nënkategorive në funksion të të tri kategorive kryesore.

Tabela 26. Fondi i orëve për klasën e VII, sipas kategorive

Kulturë e të dëgjuarit dhe të folurit,	50 orë
Tekstet letrare dhe joletrare	60 orë
Njohuri gjuhësore	65 orë
Në dispozicion të mësimdhënësit	10 orë

Klasa e tetë, përmbajtja e nënkategorive realizohej në funksion të të tri kategorive kryesore.

Tabela 27. Fondi i orëve për klasën e VIII, sipas kategorive

Kulturë e të dëgjuarit dhe e të folurit.....	45 orë
Tekstet letrare dhe joletrare.....	60 orë
Njohuri gjuhësore.....	70 orë
Në dispozicion.....	10 orë

Sipas kategorive në këtë klasë, për „të dëgjuarit dhe të folurit,, ishin paraparë përmbajtje konkrete për nënkategoritë: Kulturë e të dëgjuarit dhe e të folurit; tekstet letrare dhe joletrare dhe njohuri gjuhësore. Po ashtu te kategoria, të lexuarit planifikoheshin nënkategoritë; Kulturë e të lexuarit; tekstet letrare dhe joletrare dhe njohuri gjuhësore. Ndërsa në kategorinë, “*të shkruarit* ,, mësoheshin nënkategoritë: Kulturë e të shkruarit; tekstet letrare dhe joletrare dhe njohuri gjuhësore.

Klasa e nëntë, në fund të arsimit të detyruar në Kosovë, sipas planeve mësimore të pas vitit 2000 lënda mbi gjuhën shqipe ishte përfshirë me emërtimin “*Shkathtësitë e komunikimit*„. Ajo realizohej në fushat (tërësitë tematike) përmes të cilave do të zhvillohen shkathtësitë e komunikimit: Organizimi dhe zhvillimi i komunikimit; Të kuptuarit e teksteve; diskutim për tekstin; analiza e fjalës, zhvillimi i fjalorit; analizë dhe interpretim i teksteve letrare; strategjia e shkrimit dhe shkrimi i aplikuar dhe norma gjuhësore e shqipes dhe zotërimi i standardit. I gjithë *organizimi dhe zhvillimi i komunikimit, përveç të kuptuarit e teksteve, diskutimit për tekstin, analizës së fjalës, zhvillimi i fjalorit; analizës dhe interpretim i teksteve letrare; strategjisë së shkrimit dhe shkrimi i aplikuar, e në veçanti përmes linjës “Norma gjuhësore e shqipes dhe zotërimi i standardit*„, realizohej formësimi gjuhësor i nxënësve dhe arriheshin rezultatet e pritura të këtij programi që dukej të jetë më i përparuar dhe i ndërtuar sipas përvojave të shkollave evropiane.,,

Klasa e trembëdhjetë, e shkollimit të mesëm të lartë tashmë është hequr, por e morëm për analizë për të nxjerrë në pah rezultatet e pritura për nxënësit që mbaronin shkollimin e mesëm në Kosovë. Sipas planit të fundit, i cili po i lëshon vend *Kornizës së re të kurrikulit*, për këtë klasë kanë qenë të planifikuara 4 orë në javë, dhe 128 orë mësimore për një vit shkollor. Realizimi i këtyre objektivave nënkupton zhvillimin e këtyre shkathtësive të komunikimit: të dëgjuarit, leximi dhe shkrimi. Ndërkaq, *fushat tematike* të derivuara nga vetë standardet dhe objektivat e kësaj klase ishin: Modelet kulturore; tekstet letrare dhe joletrare; kulturë gjuhe; letërsia shqipe dhe e përgjithshme/autorë dhe fenomene dhe kultura e komunikimit. Përveç shumë përmbajtjeve që nuk po i përmendim, për këtë klasë parashihej të mësohej edhe « *mendimi kritik dhe kulturor*”(Mendimi socrealist në Shqipëri, mendimi socrealist në Kosovë, socrealizmi i tipit jugosllav), mendimi strukturalist, mendimi aktual, revistat dhe konteksti kulturor në Shqipëri dhe në Kosovë. Ndërkaq, pjesa qendrore e lëndës për gjuhën shtrihet përbrenda kategorisë « *Kulturë gjuhe* ». Puna me gjuhën përqendrohej në aspektin kuptimor dhe kishte si synime themelore:

- *analizën leksiko-morfologjike dhe sintaksore të teksteve;*
- *përdorimin e gjuhës në funksione poetike;*
- *përdorimi i aparaturës shkencore (referencat etj.) gjatë shkrimit të një eseje a punimi;*
- *pasurimi i fjalorit letrar, kritik dhe analitik.*
- *format e ligjërit letrar dhe joletrar/ zbatimi i standardit si gjuhë e letërsisë;*
- *shkathtësitë e teknikave narrative dhe të punës me gjuhën;*
- *gjuha dhe mediat;*
- *drejtshkrim, drejtshqiptim, përdorim kreativ i gjuhës.*⁵⁹⁶

Në këtë klasë planifikohej të jepeshin tekste, ushtrime dhe detyra, duke nënkuptuar këtu edhe shkrimin e eseve, me qëllim zhvillimin e shkathtësive gjuhësore nga stilistika gjuhësore, gjuha standarde, gjuha dialektore etj. Jepeshin shembuj të dimensioneve stilistike të shqipes; sequenca, stili, diskurset; gjuha kritike dhe ajo kreative. Në këtë prezantim pasqyrohen rrathët koncentrikë të ofrimit të dijeve gramatikore për nxënësit e arsimit paraniversitar në Kosovën e viteve 1964 dhe të viteve 2004. Ishin këto dyzet vjet të mësimdhënies së gjuhës shqipe në shkollat e Kosovës, duke reflektuar rezultatet, kudo, në shkollë, media, administratë është rrënjësuar shkrimi dhe të folurit e gjuhës së njësuar. Kjo si rezultat i kulturës gjuhësore të fituara në orët e mësimit të

⁵⁹⁶ Stjeko Tezak, *Teoria i praksa hrvatskog jezika I (Teorija dhe praktika e mësimit të gjuhës kroate I)*, Shkolska kniga, Zagreb, 1996, f.18.

gjuhës shqipe dhe lëndëve të tjera në bankat e shkollimit fillor dhe të mesëm, me kujdes të posaçëm për mësimin e drejtshkrimit, por pa harruar drejtshqiptimin..sepse “...*Përhapja dhe ngulitja e normave të drejtshqiptimit mbetet prapa, vonohet në krahasim me drejtshkrimin.*”⁵⁹⁷

⁵⁹⁷ Anastas Dodi, *Drejtshkrimi dhe shqiptimi letrar*, Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe, Prishtinë 1974, f.144.


5.4. PËRVOJA E SHKOLLËS SË KOSOVËS NË MËSIMDHËNIEN E GRAMATIKËS

Në procesin e mësimdhënies së gjuhës shqipe, për një mësimdhënës të suksesshëm, krahas formimit të tij profesioanal, pedagogjik dhe shkencor gjuhësor një rëndësi të madhe kishte dhe vazhdon të ketë edhe aftësia e tij në dhënien (*transmetimin*) e këtyre njohurive. Në praktikën mësimore të Kosovës, shpesh ka ndodhur që një mësimdhënës të jetë një metodist shumë i mirë, por jo me njohje dhe aftësi të mira gjuhësore. Dhe për këto arsye, “*Kur është fjala për mësimin e gramatikës në shkollën fillore, qëndrimi i gjuhëtarëve dhe didaktëve të gjuhësisë dhe pedagogëve së mësimi i gramatikës në shkollën fillore është e kënaqëshme, por ka dhe mendime se gramatika dhe rregullat e drejtshkrimit mësohet përmendësh si tabela e shumëzimit*”.⁵⁹⁸ Për këto dilema, shumë studiues shtrojnë pyetjet, se: “*A është mësues i mirë ai që është një metodist i mirë, por njohuritë e tij gjuhësore nuk janë të qëndrueshme dhe të thella?*”⁵⁹⁹ Edhe nëse ky mësues përdor një mësimdhënie bashkëkohore, është menazhues i mirë i klasës, mundohet ta shpjegojë sa më qartë dhe në mënyrë të kuptueshme mësimin etj., por kur i drejtohen pyetje jashtë tekstit për ndonjë ushtrim a çështje gjuhësore, megjithëse mundohet të japë një përgjigje, ose nuk ndihet i sigurt ose shpjegimi i tij është i pakuptueshëm dhe i pamjaftueshëm për t’u kuptuar nga nxënësi. Madje, antipodi i rastit të parë, rastis, kur një mësues ka njohuri shumë të mira gjuhësore, por nuk është metodist i mirë, çalon në artin e mësimdhënies. Edhe ky mësimdhënës, edhe pse ka zotëruar shumë njohuri, i duhet të zotërojë teknikën e mësimdhënies, strategji mësimdhënëse të larmishme për të arritur synimin për të përvetësuar sa më mirë këto njohuri gjuhësore nga të gjithë nxënësit. Ai nuk i trembet asnjë pyetjeje gramatikore të nxënësit, sepse dijet e tij janë të qëndrueshme. Djetari Simon Borg shprehet se: “*Unë nuk kam ç’të bëj me gramatikën pa mësimdhënien, çdo gjë që është gramatikore për mua lidhet me mësimdhënien.*” Mirëpo didaktët bashkëkohorë, në mësimdhënie kryesisht identifikohen dy tipe të mësimdhënësve të gjuhës: *Mësimdhënësi teorik (mësuesi me njohje të thella gjuhësore) dhe Mësimdhënësi praktik (mësuesi me aftësi pedagogjike)*. Në fakt, praktika pedagogjike ka dokumentuar se një mësues i mirë duhet të ketë krahas njohurive të thella gjuhësore edhe aftësinë mësimdhënëse. Asnjëra nuk mund të qëndrojë pa tjetrën. Mësuesi duhet të jetë vazhdimisht në kërkim dhe zotërim të njohurive teorike dhe domosdoshmërisht njohës dhe praktikues i mirë i gjuhës, siç thotë teoria e Herbartit: “*Praktika pa teori kalon në rutinë, ndërsa teoria pa praktikë kalon në mjegullnajën e abstraksionit.*”⁶⁰⁰

⁵⁹⁸ Sipas T.Perusko, *Materinski jezik u osnovnoj skoli*, f.10.

⁵⁹⁹ Shih më gjerë, Irida Hoti, “*Mësuesi, njohës dhe praktikues i mirë i gjuhës shqipe*”. Revista “Mësuesi”, Nr.6 (2552), shtator 2010, f.17.

⁶⁰⁰ Po aty.



5.4.1. Norma letrare dhe roli i institucioneve për përgatitjen e kuadrove arsimore

Derisa për kohë të gjatë në përdorim zyrtar dhe në tekstet shkollore ishte gjuha letrare gegërishte, e cila kishte lëshuar rrënjë, çështja e kultivimit të normës së gjuhës së standardizuar ishte bërë shumë imediate gjatë fillimit të viteve shtatëdhjetë. Problemi i mësimi të normës letrare në Kosovë kishte një rëndësi të madhe sidomos për mësimdhënësit e në veçanti mësimdhënësit e gjuhës shqipe, për futjen në programe mësimore në Shkollat normale (*më vonë Akademitë pedagogjike, Shkollat e Larta Pedagogjike*) edhe çdo institucion tjetër që nxjerr kuadro arsimore.⁶⁰¹ Pas vitit 1972, ishin bërë përmirësime në programet, në tekstet, në forma të punës. Madje një ndihmesë të fuqishme në formësimin gjuhësor dhe përhapjen e rrafshme të standardit i jepnin shkollës edhe shtypi, radioja, kinematografia, teatri, biblioteka etj. Ndonëse “...hapi vendimtar për kristalizimin e gjuhës letrare kombëtare (përkundër përpjekjeve gjatë Rilindjes Kombëtare), u bë pas çlirimit, kur filloi një punë shkencore, e organizuar, e mbështetur në metodologjinë e shëndoshë. Kjo edhe është karakteristika kryesore e gjuhës letrare shqipe: ajo ka marrë formën e saj të përcaktuar, në përgjithësi, në perjudhën e posçlirimit. Vendosija e normës gjuhësore është tipari kryesor i saj. Ajo përhapet me anën e letërsisë, shtypit, radios, teatrit etj. Një rol shumë të rëndësishëm luan shkolla, që është, si të thuash, edhe laboratoriu ku norma letrare formohet, përpunohet dhe pastaj përhapet.”⁶⁰² Që norma letrare e gjuhës të mësohej siç kërkon programi i shkollës, ishte e domosdoshme të mënjanohej pengesat. Ndër pengesat prioritare ishte mospërgatitja me kulturë të mjaftueshme gjuhësore e kuadrove të diplomuara në shkollat normale, përkatësisht në akademitë pedagogjike, si dhe në shkollat e larta. Në shkollat e mesme pedagogjike ndihej nevoja e ngutshme të forcohej puna e mësimi të drejtshkrimit e drejtshqiptimit të ri të njësuar letrar. Në këtë, kohë edhe librat e gjuhës çalonin sa u përkët rregullave të drejtshkrimit. Mirëpo aktivitetin qendror e bartin institucionet arsimore dhe “Figura qendrore këtu është mësuesi, që udhëheq gjithë punën shkollore dhe jashtëshkollore. Në qoftë se sod nuk mund të flasim ende për një gjuhë letrare unike të kristalizuara plotësisht.”⁶⁰³ Për mësimin dhe përvetësimin e normës gjuhësore letrare një rol të rëndësishëm luanin shumë faktorë, të cilët herë-herë nuk mbahen sa duhet parasysh, siç janë: *mësimi përmendsh i pjesëvet letrare, leximi jashtë klase, lidhja e gramatikës me drejtshkrimin e, anasjelltas, lidhja e letërsisë*

⁶⁰¹Luigj Franja, “Shkëndija”, nr.20, Prishtinë, më 15 dhjetor, 1978.

⁶⁰²Këndi i gjuhës, *Gjuha letrare dhe shkolla*, nr. 15-16, më 15 tetor, “Shkëndija”, 1978.

⁶⁰³Po aty.

*me gjuhën etj.*⁶⁰⁴ Përkundër entuziazmit e sukseseve në çdo shkollë në këtë fushë ndryshimet ishin të varura shumë nga mësuesit që diplomohen në këto institucione, prandaj përgjegjësia për zgjidhjen e problemit të normës letrare, binte mbi Shkollat Normale, Shkollat e Larta Pedagogjike, Akademitë Pedagogjike, Fakultetin e Edukimit (dikur F.Mësuesisë) Fakultetit Filologjik. Një ndihmesë të rëndësishme e jepnin edhe punimi i Temave të diplomës në këto institucione, të cilat punoheshin nga nxënësit dhe studentët, të cilët shkolloheshin për t'u bërë mësues.

⁶⁰⁴Luigj Franja, "Shkëndija" nr.20, Prishtinë, më 15 dhjetor 1978.

5.5. METODOLOGJIA E MËSIMIT TË GRAMATIKËS SË GJUHËS SHQIPE

5.5.1. Metodika e mësimit të morfologjisë

Në të gjitha programet mësimore të gjuhës shqipe në Kosovë, kryesisht pas vitit 1945 vend të rëndësishëm zinte mësimi i morfologjisë. Mësimi i morfologjisë i njëjti nxënësit me format që marrin fjalët gjatë fleksionit për të shprehur kuptimin gramatikor. Lënda e morfologjisë, në programe e tekste, kryesisht ishte e ndarë në tri pjesë që të mësohej më mirë. Teoria pedagogjike jugosllave mësimdhënësve, gjatë viteve 1945-2000 sugjeronte që për të zotëruar sa më mirë mësimdhënien, metododika e morfologjisë të ketë këto nëndarje:

- *Metodikën e mësimit të pjesëve të ligjëratës,*
- *Metodikën e mësimit të përbërjes së fjalës,*
- *Metodika e mësimit të drejtshkrimit (ortografisë) dhe drejtshqiptimit (ortoepisë).*

Metodika e mësimit të përbërjes së fjalës, si bazë e gjuhës, realizohej nëpërmjet këtyre përmbajtjeve programore: *rrënja e fjalës, parashtesat e prapashtesat, fjalët e parme, të prejardhura dhe të përbëra.* Metodika e mësimit të pjesëve të ligjëratës, për bazë merrej *fjalja, pjesët e ligjëratës mësoheshin përbrenda fjalisë.* Këto njohuri sipas rathëve koncentrik zgjërroheshin e thelloheshin nga klasa në klasë. Në vijim po japim disa informacione mbi zhvillimin e punës gjatë procesit të mësimit të *emrit,mbiemrit dhe foljes.*

Mësimi i pjesëve të ligjëratës

Mësimi i pjesëve të ligjëratës, në shkollimin e detyruar në Kosovë fillonte që në ditët e para të shkollës dhe vazhonte gjatë gjithë periudhës shkollore, në përputhje me planet dhe me programet mësimore. Konceptet dhe nocionet epara për pjesët e ligjëratës mësoheshin nga klasat II,III,IV. Ndërsa,qëllimi i mësimit të morfologjisë në klasën V dhe VI të shkollës 8-vjeçare, ishte i drejtuar në thellimin dhe zgjerimin shkencor të njohurive të nxënësve. Mësimdhënia e pjesëve të ligjëratës fillonte me dallimin e tyre në pjesë të *ndryshueshme* dhe të *pandryshueshme.* Në procesin e mësimdhënies tradicionale në orët e gjuhës shqipe paraqitja e përkufizimeve kalonte nëpër tri etapa kryesore:

Në etapën e parë, e cila quhet etapa përgatitore, mësimdhënësi i njëjti nxënësit me temën dhe analizonte me kujdes materialin ilustrues të lidhur me përkufizimin.

Etapa e dytë, kishte të bënte me paraqitjen e përkufizimit. Kryesisht ky moment vinte pas analizës së shembujve (në klasën V dhe VI) dhe para dhënies së shembujve (në klasën VII dhe VIII), por kjo gjithmonë në përshtatje me temën që do të shpjegohej.

Për paraqitjen e përkufizimit mësimdhënësit ndjeknin rrugë të ndryshme. (*Paraqiteshin me gojë, me shkrim në dërrasë të zezë ose me ndonjë mjet mësimor.*)

Në etapën e tretë, mësimdhënësit përmes përsëritjes kërkonin të dinin se sa ishte përvetësuar brendia e përkufizimit. Ngulmohej që përkufizimi të përvetësohej jo në mënyrë mekanike, por logjike. Për këtë qëllim përdroreshin edhe *mjete mësimore, skica, skema* etj.

Praktikat e mësimdhënies së emrit

Shtrirja e njohurive të para rreth bazës së morfologjisë në shkollat e Kosovës fillonte me mësimin e nocionit *për emrin*. Nxënësit i kanë fituar njohuritë për këtë pjesë të ndryshueshme të ligjëratës që në klasat II, III, IV të shkollës 8-vjeçare (*tash nëntëvjeçare*). Nxënësit njiheshin me *klasifikimin e emrave në emra njerëzish, kafshësh, sendesh etj.*, janë njohur me disa kategori gramatikore të emrit, si: *gjinia, numri, rasa e trajta*⁶⁰⁵. Po ashtu, është mësuar edhe ndarja e emrave në *të përgjithshëm dhe në të pëveçëm* si dhe disa rregulla drejtshkrimore që lidhen me ta. Me kalimin e nxënësve në ciklin lëndor, kur gjuhën shqipe si lëndë e mbante një mësimdhënës i veçantë, detyra e mësimin të gjuhës në klasën pestë e në klasat që vijojnë, është që t'i thellojë këto njohuri, të zgjerojë horizontin e dijeve të nxënësve lidhur me emrin, t'i bëjë ata të ndërgjegjshëm për rregullat teorike dhe t'i aftësojë për t'i përdorur këto njohuri në ligjërim, me gojë ose me shkrim. Një formë e tillë pune ndiqej edhe gjatë dhënies së njohurive rreth gjinisë dhe numrit të emrit, gjininë (formimi i gjinisë femërore nga ajo mashkullore, p.sh.: *fshatar-fshatare, luan-luaneshë, plak-plakë, ujk-ujkonjë (ose ulkonjë)*) dhe ato raste kur disa emra frymorësh kanë rrënjë të ndryshme për të dy gjinitë, (p.sh. *vëlla-motër, i ati-e ëma, dash- -dele etj.*)

Në program planifikohet të përpunoheshin *rasat dhe lakimi i emrit*, nxënësit kishin rast të zgjeroheshin njohuritë lidhur me kuptimet dhe me format rasore të emrit dhe të fitonin shprehje praktike për përdorimin e tyre të drejtë. Shembujt e lakimit merreshin nga librat e gramatikës për lëndët përkatëse për të katër lakimet (p.sh. *lis-i, breg-u, këngë-a, djath-të*). Në skemat (*si mjet mësimor*) mësimdhënësit paraqitnin larminë e mbaresave rasore, të cilat në skemë shënohen me ngjyrë të kuqe. Këto njohuri për emrin, tradicionalisht zgjeroheshin dhe përforcohen, gjithashtu, me detyra dhe ushtrime të ndryshme, kur “*Këto orë...mund të shfrytëzohen tekste, të cilat përveç që i drejtohen bashkëbiseduesit, e tregojnë përparësinë e vlerave vokative të mësimdhënësit në harmoni me tekstin ose situatën.*”⁶⁰⁶

Praktikat e mësimdhënies së mbiemrit

Edhe në mësimin e mbiemrit, puna e mësimdhënësve kishte synim që të krijojnë vazhdimësi me njohuritë që ka fituar nxënësi në klasat II, III, IV *për kuptimin e mbiemrit, kategoritë e numrit, e gjinisë dhe e shkallës së mbiemrit*. Në klasën e pestë, njohuritë e fituara, tentohet, të thelloheshin dhe të zgjeroheshin. Kujdes i veçantë i kushtohet mësimin të *gjinisë së mbiemrave*, si për përshtatjen e mbiemrit me emrin. Praktikohej të paraqitej një tabelë me disa emra nga nxënësit kërkohej që pranë këtyre emrave të vënë mbiemrat përkatës, duke kaluar në punimin e ushtrimeve me gojë ose me shkrim, si:

- Të formohen disa fjali me mbiemra të përdorur para dhe pas emrash, tregoni rasën e tyre (*me nyjë ose pa nyjë*).
- Të vendosen mbiemrat përkatës pranë emrave *bukë, mal, aksion, dri- thë etj.*, p.sh.: *bukë e shijshme, e ngrohtë, e bardhë, e pjekur, e grunjte etj.*
- Detyrë të mblidhen emërtimet e tokave të fshatit ku jetonte nxënësi (p.sh.: *tokë e bardhë, tokë e zezë etj.*).

Lidhur me mbiemrat parashihej edhe mësimi i shkallëve e mbiemrit (*pohore, krahasore dhe sipërrore*.) Pastaj nga morfologjia parashihej, pothuaj në të gjitha programet edhe mësimi i *formimit të mbiemrave*, si (p.sh. mbiemra të parmë, si: *i bardhë, i mirë, trim etj*; mbiemra të

⁶⁰⁵ Plani dhe programi mësimor i gjuhës shqipe për shkollat fillore, 1964.

⁶⁰⁶ S. Tezak, *Vokativ jednine imenica E vrste*, Radovi zavoda za slavensku filologiju, 7, Zagreb, 1982, f.31-42.

prejardhur të formuar nga foljet: *lodhur - i lodhur, ndreq - i ndreqshëm, duroj - i durueshëm* etj; mbiemra të formuar nga emrat: *hekuri- i hekurt, luftë - lufta- rak* etj.; mbiemra të formuar nga ndajfoljet: *poshtë - i poshtëm, sot - i sotëm* etj.)

Praktikat e mësimdhënies së foljes

Duke vlersuar mirë hartuesit e programeve shkollore dhe ata të teksteve të gramatikës, kudo edhe në opinionet e tyre në shtypin pedagogjik pajtoheshin se *folja* ishte pjesa më e gjerë dhe më e vështirë e morfologjisë në arsimin e detyrueshëm dhe atë të mesëm. Njohuritë për këtë pjesë të ligjëratës nxënësit kanë filluar t'i fitojnë që në ditët e para të shkollës, jo të shkëputura, por radhazi. Sidomos në klasën e gjashtë, mësoheshin përveç kuptimeve gramatikore të foljes (*mënyrat, kohët, vetat* etj.). Folja si pjesë të ligjëratës, mësohej detajisht: *llojet e mënyrave, kohëve, format veprorë dhe joveprorë* etj. Gjatë analizës së foljes praktikoheshin analiza e mënyrave dhe e kohëve të foljes. *Shembull:*

- Ne luftuam për lirinë e Kosovës. (*Mënyra dëftore*).
- Ata erdhën të luftojnë kundër neve. (*Mënyra lidhore*).
- Ne do të luftonim trimërisht, sikur ta kishim armë...(*Mënyra kushtore*).
- Sa shumë luftuaka komandanti ynë! (*Mënyra habitore*).
- Lufto, se lufta është lavdi! (*Mënyra urdhërore*).

Mësimdhënësit me dije dhe përvojë tradicionalisht në formate të mëdha letre punonin ndonjë skicë ku pasqyroheshin mënyrat e foljeve:

- mësoj (*dëftore*).
- të mësoj (*lidhore*)
- do të mësoja (*kushtore*)
- mësuakam (*habitore*)
- mësofsha (*dëshirore*)
- mëso (*urdhërore*)

Për të mësuar detaje të tjera mbi foljet gjatë mësimdhënies për bazë merrej, përgjithësisht, mënyra dëftore, e cila i ka të tri kohët: *të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen*. Mësimdhënia bëhej në bazë të shembujve kishte mundësi të ofrojë të gjitha format, vetat, kohët, mënyrat e diatezat e foljeve. Kurse, *metodika e mësimin të drejtshkrimit dhe drejtshqiptimit* kishte për synim mësimin e rregullave të drejtshkrimit (*ortografike*) dhe pasi gjuha është mjeti më i rëndësishëm i komunikimit midis njerëzve, ka rëndësi të madhe edhe zotërimi i normave drejtshqiptimore (*ortoepike*). Në praktikat mësimore të shkollave në Kosovë kam hetuar se ortoepia është një nga pikat e dobëta..

5.5.2. Metodika e mësimdhënies së sintaksës

Si në arsimin e detyruar edhe në shkollat e mesme në Kosovë, programi parashikon zhvillimin e një moduli të plotë të sintaksës së gjuhës shqipe. Sipas, programeve mësimore, me ndryshime gjatë viteve, (*sepse ndryshoheshin, rikonstruoheshin dhe rikonceptoheshin jo rrallë*)

jepeshin njohuri për togfjalëshin, fjalinë e thjeshtë, gjymtyrët kryesore dhe të dyta të saj, për fjalinë me gjymtyrë homogjene, për fjalinë e përbërë me bashkërenditje dhe nënrenditje⁶⁰⁷ etj. E gjithë kjo punë në mësimin e gjuhës bëhej që nxënësit të njihen me mënyrat e lidhjes së fjalëve në fjali dhe me strukturën e pjesëve të fjalisë së përbërë. Përvetësimi i mirë e sintaksës ndihmonte edhe për përvetësimin e shenjave të pikësimit si dhe leximin korrekt dhe shprehës. Njohuri të përgjithshme elementare të sintaksës që nxënësit i merrnin që në klasat II, III, IV të shkollës 8-vjeçare, por në klasat VII, VIII këto njohuri zgjeroheshin, kurse në klasën e III dhe IV të shkollës së mesme ato thelloheshin. Në mësimet e sintaksës mësimdhënësit nxënësve ua mësonin nocionin e rregullat e drejtshkrimit, të cilat ndihmonin në përvetësimin e këtyre rregullave. Madje, vijohej edhe me mësimin e mënyrave të tjera të foljeve, për rastet kur shpreheshin veçoritë e përbashkëta me një ndjenië habie, si dhe fjalisë pyetëse, dëshirore edhe fjalia nxitëse. Kërkohej që domosdo nxënësit të mësonin rëndësinë e ndryshimeve që sjell intonacioni dhe shenjat e pikësimit.

Shembull:

- Nxënësit e punuan këtë ekspozitë. (fjali dëftore)
- Nxënësit e punuan këtë ekspozitë? (fjali pyetëse)

Shumica e nxënësve në fund të mësimit të kësaj pjese të sintaksës zotëronin për t'i dalluar fjalitë nga njëra-tjetra, kur analizoheshin edhe fjalët përbërëse, si: fjalët pyetëse, pasthirrmat etj., (p.sh.: A shkuat të gjithë? (A, fjalë pyetëse) Oh, sa bukuri ka tufa! (Oh! pasthirrmë me kup-tim habie). Për të bërë krahasim të evolimit të kërkesave programore gjatë viteve po prezantojmë përmbajtjet e Planit dhe programit mësimor të gjuhës shqipe për shkollat fillore tetëvjeçare të vitit 1964 dhe atij të vitit 2004. Kjo distancë kohore 40 vjeçare besoj është e mjaftushme për ilustrimin e ndryshimeve.

Praktikat e mësimdhënies së sintaksës

Në shkollën fillore dhe të mesme në Kosovë kishte rëndësi, sepse derisa morfologjia njoftonte nxënësit për pjesët e ligjëratës, me sistemin e formave që marrin fjalët gjatë fleksionit, sintaksa i njofton më tërsinë e mënyrave të bashkimit të tyre në togfjalësha e në fjali dhe të fjalive në periudhë, si dhe me tipat ndërtime të tyre.⁶⁰⁸ Pas dhënies së njohurive për fjalinë e thjeshtë dhe për gjymtyrët kryesore dhe të dyta të saj, mësimdhënësi prezantonte para nxënësve fjalinë e përbërë. Nxënësve u bëhej e ditur se, dallimi ndërmjet këtyre fjalive është ky: fjalia e thjeshtë ka zakonisht dy fjalë kryesore, prej të cilave fillojnë lidhjet me fjalët e tjera, kurse fjalia e përbërë formohet prej dy a më shumë pjesësh të ngjashme nga forma me fjalitë e thjeshta. Nocionin e fjalisë së përbërë që nxënësit e kanë fituar që në klasat e para, në klasën VIII, këto njohuri zgjeroheshin e plotësoheshin. Vështirësi paraqiteshin në të kuptuarit e llojeve të këtyre lidhjeve, të cilat, siç dihet, mund të jenë bashkërenditëse ose nënrenditëse.

⁶⁰⁷ Plani dhe programi mësimor për gjuhën i gjuhës shqipë për klasën e VII dhe VII-të të shkollave fillore, 1964.

⁶⁰⁸ Esat Hoxha, Metodika e gjuhës shqipe, (Dispencë për studentët e SHLP) ETMM, KSAK, Prishtinë, 1984.

a. Mësimi i Fjalisë së përbërë

Njohuritë rreth fjalisë së përbërë duhet të jepen me shembuj të ndryshëm. Këta në fillim duhet të jenë të thjeshtë, pastaj të kalohet në shembuj më të ndërlikuar.

Ja dy shembuj të thjeshtë, që mund të jepen për fjalitë e përbëra me bashkërenditje dhe me nënrenditje.

a) *Fjali e përbërë me bashkërenditje* – (Oshëtima e lumit na shoqëronte në çdo çast dhe ne ecnim shpatit të malit duke kënduar një këngë për Adem Jasharin.)

b) *Fjali e përbërë me nënrenditje* – (Aty gjeti shokët me të cilët kishte luftuar për çlirimin e trojeve.)

Organizimi i mësimi bëhet përmes *evokimit, realizimit të kuptimit, reflektimit dhe detyrave të shtëpisë*.⁶⁰⁹ Në analizën e fjalisë së përbërë, nxënësit mësimdhënësit fillimisht i ndanin pjesët, pastaj lidhëzat e fjalët lidhëse, dhe kërkonin nga nxënësit që të përcaktonin nëse është *fjali e përbërë me bashkërenditje ose me nënrenditje*, dhe, në bazë të llojit të lidhëzave dhe të funksioneve të pjesëve të fjalisë, të përcaktojnë grupet e fjalisë së përbërë.

Gjatë dhënies së njohurive *për fjalinë e përbërë me nënrenditje*, para së gjithash duhej dalluar *pjesa kryesore* dhe ajo *e nënrenditur*. Në këto fjali pjesa e nënrenditur plotëson ose një gjymtyrë të pjesës kryesore, ose pjesën kryesore në tërësi.

Skema më e thjeshtë e *fjalisë së përbërë me nënrenditje* që para nxënësve prezantohej nga mësimdhënësit bëhej në këtë mënyrë:

*A shënohej pjesa kryesore
dhe*

B pjesa e nënrenditur.

Në paraqitjen e njohurive rreth fjalive të përbëra me nënrenditje mësuesi kishte parasysh disa kërkesa:

- *Cilës pyetje i përgjigjet pjesa e nënrenditur?*
- *Ç'gjymtyrë të pjesës kryesore fillon kjo pjesë?*
- *Cilat shenja pikësimi përdorim?*
- *Cili është vendi i pjesës së nënrenditur?*

Gjatë trajtimit të fjalive të përbëra me nënrenditje analizoheshin *dhe shkalla e varësisë* së pjesës së nënrenditur ndaj pjesës kryesore. Mësimdhënësi kalonte shkallë-shkallë nga fjalia e përbërë me dy pjesë, të fjalitë e përbëra me më shumë se dy pjesë. Tradicionalisht praktikohesh qe të bëheshin ushtrimet për fjalitë e bashkërenditura dhe të nënrenditura dhe ato ishin të larmishme.

Shembuj:

- *Jepej ndonjë fragment. U kërkohet nxënësve të ndajnë fjalitë, të paraqitin fjalitë e thjeshta dhe të përbëra, me nënrenditje dhe me bashkërenditje etj.*

⁶⁰⁹ Mimoza Gjokutaj; Nexhip Mërkuri, *Modele të sukseshme të mësimdhënieje*, Libër mësuesi, Europrint, Tiranë, 2005, f.73.

- *Kërkohej të bëhej skema e një fjalie të përbërë.*
- *Jepeshin skema të gatshme dhe u kërkohej nxënësve që, mbi bazën e këtyre skemave, të gjejnë fjali.*
- *U kërkohej nxënësve të bëjnë një hartim, duke përdorur fjali të përbëra me nënrenditje dhe me bashkërenditje.*

Forma më e përshtatshme dhe më praktike e mësimdhënësve për ngulitjen e njohurive sintaksore ishte analiza sintaksore e fjalisë së thjeshtë dhe të përbërë, e gjymtyrëve kryesore e të dyta duhet të gërshetohet edhe me analizën morfologjike. Njohuritë mbi sintaksën shtriheshin në këto përmbajtje mësimore, nga klasa e tretë në shumicën e klasave të shkollimit fillor e të mesëm, si: mësimi i fjalisë, fleksioni, fjalitë shërbyese, rendi i fjalive, togfjalëshi, fjalitë sipas modaliteteve, sipas qëllimit të thënies (*dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse, thirrmore.*) Pjesa tjetër e mësimi të sintaksës përfshihej me mësimin e periudhës, periudha me fjali të bashkërenditura, periudha me fjali të nënrenditura.

b. Mësimi dhe përvetësimi i shenjave të pikësimit

Dihet mirëfilli se kur ligjërojmë, e kemi të pamundur të ligjërojmë pa ndërprerjen ligjëratën. Dhe për pushimet e shkurta dhe të gjata, për intonacionin, për modalitetin e fjalive ishte e domosdoshme mësimi i përdorimit të shenjave të pikësimit. Njohuritë e para lidhur me përdorimin e shenjave të pikësimit nxënësit e fitoheshin praktikisht qysh në klasat II, III, IV të shkollës 8-vjeçare. “*Shenjat e pikësimit kanë rëndësi të veçantë sidomos në ato raste kur mjetet leksikore e sintaksore nuk janë të mjaftueshme për të dhënë qartë lidhjen e fjalëve e të fjalive*”.⁶¹⁰ Gjatë gjithë shkollimit parauniversitar, tradicionalisht mësoheshin dhe bëhej ushtrimi i përdorimit të shenjave kryesore të pikësimit, si: *pika, pikëçuditja, pikëpyetja, presja* etj. Nga klasa në klasë detyra e mësuesve ishte t’i zgjerojnë dhe t’i thellojnë këto njohuri, si dhe të formojnë shprehje të qëndrueshme praktike për t’i përdorur me vend dhe me bindje shenjat e pikësimit. Shenjat e pikësimit tradicionalisht nuk mësoheshin në orë të veçanta, por gjatë dhënies së njohurive teorike dhe praktike në morfologji e, sidomos, në sintaksë, si dhe në mësimet e leximit letrar. Nga mësuesit e gjuhës, tek nxënësit janë identifikuar gabimet më të shpeshta në pikësim:

- *Mosvënia e shenjës së pikësimit që duhet, ose përdorimi i saj pa arsye.*
- *Përdorimi i një shenjë pikësimi për një tjetër ose luhatja në vënie e shenjave të pikësimit.*

Në praktikën e mësimdhënies, e sidomos në hartimet shkollore mësimdhënësit në Kosovë, kryesisht kanë evidentuar disa gabime në përdorimin e shenjave të pikësimit, si:

- *Kur nxënësit kanë mësuar mekanikisht përdorimin e tyre ;*
- *Kur nxënësit nuk janë ushtruar si duhet me intonacionin ;*
- *Kur nxënësit nuk njohin mirë ligjëratën e drejtë, përbërjen dhe pjesët e saj.*

Praktika mësimore në shkollat shqipe në Kosovë tregon se jo të gjitha shenjat e pikësimit kanë të njëjtën vështirësi për t’u përvetësuar dhe përdorimi i tyre i gabuar bëhej kryesisht te këto çështje: *me rendin e pjesëve të nënrenditura; me lidhëzat e mjetet lidhëse që përdoren ; me foljen-kallëzues të pjesës së nënrenditur; me fjalën e pjesës kryesore që plotëson ajo.*

⁶¹⁰ *Rregullat e pikësimit në gjuhën letrare shqipe* (projekt), Tiranë, 1981, f.4.

Për t'i aftësuar nxënësit në përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit, bëheshin ushtrime të ndryshme, siç parashihte edhe plani mësimor. Metodologjia më efikase për ngulitjen e njohurive rreth shenjave të pikësimit praktikoheshin në punë të pavarur të nxënësve.:

• *Diktimit me kërkesa për vendosjen e shenjave të pikësimit.*

• *Hartime në bazë të një tabloje, duke kërkuar përdorimin e detyrueshëm të një shenje pikësimi, p.sh., të pikëçuditjes, presjes, pikës etj.*

Veç këtyre rasteve, mësimdhënësit e gjuhës në shkollat e Kosovës për mësimin e përdorimit të shenjave të pikësimit shfrytëzonin edhe kohën gjatë dhënies së njohurive për fjalët me shumë kuptime, (*sinonimet, homonimet dhe antonimet* etj.) që nxënësit të mësojnë si t'i përdorin këto fjalë, kur hartojnë tregime ose krijime të shkurtra, me gojë ose me shkrim, sepse duke respektuar shenjat e pikësimit, nxënësit e kapnin më lehtë kuptimin e fjalive dhe "orientohen më mirë në përmbajtjen e copës."⁶¹¹

c. Rrugë frytdhënëse për pasurimin dhe zgjerimin e fjalorit të nxënësve

Në pasurimin e fjalorit (*leksikut*) të nxënësve në praktikën e mësimdhënies së gjuhës shqipenë Kosovë përdorehin rrugë të ndryshme. Fillimisht nga mësuesit e gjuhës bëhej analizë e fjalorit të nxënësve, si dhe njohja dhe përvetësimi i gjuhës së gjallë të popullit, të trashëguar nga familjet e tyre. Nxënësit në shkollë vinin me një fjalor nga gjuha e bukur të popullit, kryesisht me emërtimet e ndryshme nga fusha e bujqësisë, blegtorisë etj., dhe nga thesari leksikor. Gjatë formave të rregullta të mësimin dhe format jashtëmësimore, mësuesit, me synim që, nxënësit të bëhen gjurmues të palodhur të këtij thesari, praktikonin vjeljen e gurrës së pashterrshme të leksikut nga terreni. Organizoheshin edhe eskursione për të njohur leksikun e sferave të ndryshme:

- *Emra: vegla bujqësore, bimë të arave: grurë, misër, tërshërë, egjër etj.*
- *Mbiemra: cilësi: i bardhë, i verdhë, i pjekur, i papjekur, i shijshëm etj.*
- *Folje: procese pune, si: lëroj, ujit, tëharr, thërrmoj, lesoj, plugoj, korr, mbjell, vjel etj.*
- *Ndajfolje: veçori të kryerjes së punëve: herët, vonë, thellë, cekët etj.*
- *Togfjalëshja: kau i arës, qetë e parmendës, farë gruri, bukë misri etj.*
- *Frazeologji: tokë ku rritet- gruri det, farë e zgjedhur kokërr për kokërr etj.*

Mësimdhënësit e gjuhës shqipe gjatë viteve që po i analizojmë shkollat e Kosovës aktivitetet për zhvillimin e të folurit në qendër të vëmendjes pothuajse në çdo orë mësimi. Ata gërshetonin këto kërkesa në etapat e ndryshme të orës së mësimin, sidomos:

- *Në kontrollin e njohurive të nxënësve,*
- *në paraqitjen e lëndës së re,*
- *Në detyrat e shtëpisë.*

Edhe gjatë analizës së ndonjë pjese letrare, krahas idesë së saj, vlerës artistike, karakteristikave të personazheve etj., shqyrtohej edhe gjuha e autorit. Kështu, gjatë analizës së

⁶¹¹ *Rregullat e pikësimit në gjuhën letrare shqipe* (projekt), Tiranë, 1981, f.5.

figurave artistike (*metafora, epitete, krahasime, hiperbola* etj.), mësoheshin fjalë e shprehje të reja stilistike.

5.5.3. Metodika e mësimdhënies së drejtshkrimit

Të shkruarit (ortografia) dhe të folurit (ortoepia) e nxënësve në raport me normën standarde të shqipes

Përvetësimi të normës letrare drejtshqiptimore në mësimdhënien e gjuhës në Kosovë i është kushtuar një rëndësi të veçantë, por asnjëherë nuk është arritur të tejkalohet sidomos dallimi i shqiptimit të tingujve “ç” dhe “q,”si dhe “gj”e “xh”.Në Kosovë ende ka probleme serioze me drejtshqiptimin, jo vetëm nga nxënësit por edhe nga mësimdhënësit.

Përpyekja e parë e mësuesve të klasave të para ishte identifikimi i çrregullimeve eventuale të folurit nga shkaqe fiziologjike. Ka raste, kur për arsye fiziologjike, fëmija nuk shqipton ose shqipton keq tinguj të ndryshëm: ngatërrohen tingulli “th” me tingujt «s» e «sh» dhe anasjellas, (*skolla për shkolla; shushta për susta* etj). Madje, janë gjetur raste, kur fëmijët kishin çrregullime drejtshqiptimore në tingujt “r” dhe “rr”; raste të çrregullimeve në drejtshqiptim gjendeshin edhe për tingujt “1”, “11”- e “dh”. Në zona të ndryshme të Kosovës mësimdhënësit e gjuhës shqipe gjenin shmangie të tilla nga norma e përbashkët drejtshqiptimore:

- Në disa zona (*në pjesët që kufizohen me trojet shqiptare të Maqedonisë* etj.), nxënës të ndryshëm nuk shqiptojnë zanoren «y», por e zëvendësojnë atë me zanoren “i”, p.sh.: *si për sy, di për dy, illi për ylli* etj.
- Në disa zona të gegërishtes qendrore (*Sharrit, Kaçanikut, Elez Hanit,etj.*) nxënësit nuk shqiptojnë si duhet zanoren “i”. Zakonisht kjo dëgjohej e shpërbërë në *ai, oi, aei, aoi* etj., p.sh. *shpai për shtëpi, dhai për dhi, maiër për mirë* etj.⁶¹²

Veç këtyre shmangieve nga norma e përbashkët drejtshqiptimore, mësimdhënësit e gjuhës dhe jo vetëm ata bënë përpjekje që të evitonin variante të ndryshme fonemash, nga pozita fonetike në fjalë dhe format e të folmes së tipareve dialektore të gjuhës së Veriut. Rastet më të vështira të këtyre tipareve dialektore shmangeshin shumë më lehtë në gjuhën e folur. Kishte raste kur, bashkëtingëllorja “nj” dhe togu zanor “ua” hyjnë më lehtë në gjuhën e shkruar dhe të folur të nxënësve në disa zona të Kosovës, kur e kërkon norma e gjuhës letrare (p.sh.: *ullinj, rrënjë, grua, kam punuar* etj.); sepse ato ekzistojnë në të folmet e atyre zonave; bashkëtingëllorja “nj” ekziston si tingull dhe si fonemë (*njeri, njoh, një* etj.), po edhe togu «ua» ekziston në disa të folme të zonave anësore (p.sh.: *grua, krua, kavi shkuar* etj.). Më shumë punë mësuesit arrinin për të mënjeluar, p.sh., zanoren «a» dhe për ta zëvendësuar atë me “ë”, p.sh.: *nanë-nënë, lamë-lëmë* etj., sepse fonema «ë» pothuaj nuk ekziston në dialektin verior, si dhe tinguj të këtillë karakteristikë për disa të folme veriore, si: “a” (*a e mbyllur e përparme*): *nalt, larg* etj., sepse shqiptimi i këtyre tingujve është i lidhur me bazën e artikulimit në ato të folme, me kushtet fonetike në të cilat ndodhen brenda fjalës.

Në punën për ngulitjen e normave të shqiptimit letrar, mësimdhënësit e gjuhës shqipe në Kosovë me shumë përkushtim e kishin marrë (*sidomos gjatë viteve shtatëdhjete e tetëdhjetë*) *kultivimin e njësimi të plotë të normave dhe një pjesë të aktivitetit e përqendronin në njohjen sa*

⁶¹² Ragip Gjoshi, *Disa veçori fonetike në të folmen e Sankocit të Drenicës*, Konferenca ndërkombëtare, “Java e shkencës 2014”, Prishtinë, 2014.

më të mirë të shmangieve nga norma drejtshqiptimore, që buronte nga ndikimi i së folmes së krahinës ku nxënësit kanë lindur dhe jetojnë.

Metodika tradicionale e të shprehurit me gojë dhe me shkrim

Ndër detyrat kryesore të mësimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollat e Kosovës tradicionalisht vlerësohej të jetë aftësimi i nxënësve të shprehen drejt dhe bukur me gojë dhe me shkrim në gjuhën e njësuar letrare. Kultura gjuhësore në shkollën e kësaj treve formohej gradualisht në mbështetje të planeve dhe programeve mësimore. Të shprehurit me gojë dhe me shkrim gjithnjë konsideroheshin dy elemente të pandara të mësimit të gjuhës amtare. “Përmes ushtrimeve të të shprehurit me gojë më lehtë kuptohet permbajtja e asaj që shkruhet.”⁶¹³ Ndër format tradicionale që aplikoheshin në orët e përcaktuara për ushtrime me gojë dhe me shkrim gjatë procesit mësimor ishin: *Ritregimi-sipas planit; Ritregim-me ndërrimin e vetës së treguesit; Të paraqitur e syzhesë së veprës; Tregimi (narracioni) i përjetimeve dhe i ngjarjeve; Përshkrimi (diskripcioni) i pavarur i objekteve, ngjarjeve; Sprovë për përshkrimin me shkrim të personazheve të veprave.* Gjatë orëve të planifikuara për ushtrimet me gojë dhe me shkrim, nxënësit aftësoheshin, për:

- Të shkruarit e letrës;
- Të shkruarit e urimeve të ndryshme;
- Të plotësuarit e mandapostave, pakove;
- Paraqitja e raporteve të punës;
- Të mbajturit e procesverbaleve, etj.

Format e punës me gojë dhe me shkrim, duke filluar nga klasa III-VIII ishin pothuaj të njëjta. Mësimdhënësit ushtrimet me shkrim vetëm pasi përvetësonin të shprehurit me gojë. “Kjo vlen për klasët e larta, në të cilat nxënësit duhet të kenë pavarësi më të madhe.”⁶¹⁴

a. Të shprehurit me gojë

Këtë komponent të gjuhës amtare edhe programi mësimor e trajtonte si “qëllim kryesor në zhvillimin integral të nxënësit.”⁶¹⁵ Edhe pse kjo kërkesë nga gjuha amtare realizohet nëpërmjet të gjitha disiplinave të gjuhës. Programi mësimor i ka caktuar dhe orë të veçanta që të ushtrohen nxënësit (njësoj siç ushtrohen të këndojnë), të fitojnë shprehi në të shprehurit e lirë me gojë në gjuhën letrare shqipe. Se sa ishte me peshë ky komponent i mësimit të gjuhës flet fakti se, programi mësimor i gjuhës amtare nga fondi i përgjithshëm i orëve të gjuhës amtare, prej 1.365 orëve, sa ishin të parapara gjatë shkollimit fillor, 355 orë ishin caktuar vetëm për ushtrime me gojë dhe me shkrim.⁶¹⁶ Me këtë kuptohet se aftësia e të shprehurit bukur me gojë, drejt dhe pastër, gjatë shkollimit fillor, fitohej jo vetëm duke lexuar dhe jo vetëm nga disiplinat e tjera të gjuhës amtare. Kulturën gjuhësore të të folurit bukur dhe lirisht, nxënësit e realizonin vetëm nëpërmjet të ushtrimeve të kohë paskohëshme. Gjuha e arsimitarit shërbente gjithmonë

⁶¹³ Çedomir Popović, *Metodika na nastavata po majcin jezik za osnovnitate ucilista*, Shkup, 1967, f.155.

⁶¹⁴ *Udhëzime didaktiko-metodike*, f.21.

⁶¹⁵ *Sipas Planit dhe programit mësimor të gjuhës dhe letërsisë shqipe për shkollat fillore të vitit 1977.*

⁶¹⁶ Po aty.

shembull në çdo komunikim me nxënësit. Në klasët e ulëta të shkollës fillore më shumë caktoheshin *biseda rreth jetës së nxënësve në shkolla, në familje, në rrugë nga literaturë fëmijërore, nga teatri i kukullave, nga emisionet e radios, filmat e vizatuar në television, rreth tregimeve, përrallëzave (kl.I dhe II) përshkrime personazhash, dramatizime, mësimi i vjershave dhe të pjesëve të bukura përmendësh (kl. III dhe IV) etj.* Në klasët e ulta gjatë, përveç të shprehurit e bukur, dhe pasurimit të fjalorit të nxënësit si, mësimdhënësit ndaleshin më gjatë te kultivimi i shqiptimit të drejtë të disa tingujve: *gj-xh-q-ç* etj., (*me të cilat shqiptarët e Kosovës si folës të dialektit të Veriut kanë problem*). Në klasat e larta, lënda zgjerohej edhe më përfshiheshin *përshkrime ngjarjesh, përjetimesh, përshkrime fytyrash, përshkrime të pjesëve teatrale, filmash, përkrime të kremtimeve të ndryshme, analiza të lektyrave, të revistave për fëmijë* etj.⁶¹⁷ Në këtë klasë, përveç ngjarjeve të vërteta bëheshin edhe përshkrime të imagjinuara.

b.Të shprehurit me shkrim

Një ndër elementet më të rëndësishme të lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë është të shprehurit me shkrim. Qëllimi i këtij komponenti në mësimdhënien tradicionale arrihej duke i aftësuar nxënësit që mendimet e tyre t'i shfaqnin me shkrim dhe të hartojnë bukur në gjuhën e njëjësuar letrare. Llojet dhe format e të shprehurit me dhe zbatimi në shkollat e Kosovës bëhej përmes *kompjimit, diktimit, vetëdiktimit, diktimit me të zgjedhur, diktimit krijues, diktimeve kontrolluese, hartimeve* dhe punëve tjera me shkrim. Ndër format e shpeshta të ushtrimeve me shkrim në përdorim haset diktimi. Kjo formë e punës vlerësohet si *“reprodukimi i vetëdijshëm i diturive, përsëritja e përforcimi i tyre në mënyrë të organizuar janë veçori didaktike kualitative të diktimit, që përdoret në organizimi bashkëkohor të ushtrimeve me shkrim.* „⁶¹⁸ Madje në mesin e formave veçohej edhe diktimii fjalisë së zgjeruar bëhej në mënyrë të ngjashme si i fjalisë së thejshtë dhe me zgjerimin e fjalisë.⁶¹⁹

5.5.4. Modele planesh mësimore, klasa VIII

Duke respektuar planin dhe programin mësimor të gjuhës shqipe për shkollë fillore (1971) dhe në bazë të Libër leximit për klasën VIII të shkollës fillore (*botim i katërt i përmirësuar-1970*) të autorit *Abdulla Zaimi, Gramatikën për klasën e VIII, metodikat që ishin në përdorim dhe praktikën e deri atëhershme, në revistën pedagogjike “Shkëndija” ishte botuar një plan të shkoqitur orientues, për klasën VIII, për vitin shkollor 1973/74.*⁶²⁰ Ishte kjo një praktikë, ku mësimdhënësi, drejtorë, këshilltarë pedagogjik e shkencëtarë të kohës shpalosnin pikëpamjet e tyre me ide për përmirësimin e mësimdhënies.

⁶¹⁷ Po aty.

⁶¹⁸ Riza Brada, *Diktimet në klasët e ulëta të shkollës fillore,*“Shkëndija”nr. 12 , më 1tetor, 1971.

⁶¹⁹ Shih: Riza Brada, *Revista pedagogjike, “Shkëndija”* nr. 8, 1971.

⁶²⁰Musa Nushi, *Këshilltar i arësimit, Plani i shkoqitur mësimor, (orientues) për Klasën e tetë (VIII) të shkollës fillore, botuar te “Shkëndija”nr 17-18 ,më 20 nëntor, Prishtinë,1973.*

Tabela 28. Plani i shkoqitur mësimor (orientues) për Klasën e tetë (VIII) të shkollës fillore

MUAJI SHTATOR (5-29) -15 ORË	
<i>Udhëzime për punë</i>	-----1 orë
<i>Përpunim tekstesh</i>	-----5 orë
<i>Gramatikë</i>	-----6 orë
<i>Ushtrime në të shprehurit me gojë</i>	-----1 orë
<i>Lektyrë shtëpiake</i>	-----1 orë
<i>Analizë e detyrave shtëpiake</i>	-----1 orë
Java ora Njësia mësimore	
<p><i>I 1. Udhëzime për blerjen e teksteve dhe dhënja e lektyrës shtëpiake për klasën VIII.</i> <i>2. Përsëritja e lëndës nga klasa VII: Fjalja e thjeshtë, e zgjeruar, mungesore.</i> <i>3. Përpunimi i këngëve popullore: Lulevera; farët e pozisë lirike popullore (shkurt.)</i></p>	
<p><i>II 1. Përpunimi i tekstit: Arësimi-R. Tagore</i> <i>2. Përsëritja e lëndës nga klasa VII: Trajtat e fjalivet (dëftore, pytëse, urdhërore, dëshirore).</i> <i>3. Leximi shprehës i tekstit: Arësimi-R. Tagore (poashtu edhe thënja përmendësh e disa rreshtave).</i> <i>4. Përsëritja e lëndës nga klasa VII: Pjesët kryesore të fjalisë (kryefjala-kuptimi, farët; kallëzues-kuptimi, farët).</i></p>	
<p><i>III 1. Përpunimi i këngëve popullore: Ndotë vdes, ndo të roj; Hajredin Pasha po vjen Radikës.</i> <i>Lexim plotësues: Gjergj Elez Alia-karakteristikat e poezisë epike popullore (këngët legjendare dhe historike-shkurtimisht).</i> <i>2. Përsëritja e lëndës nga klasa VII: Pjesët e dyta të fjalisë së zgjeruar (kundrina, cilësori, ndajshtimi).</i> <i>3. Lektyrë shtëpiake: Historia e Skënderbeut-F.Noli, lexim sipas zgjedhjes.</i> <i>4. Përsëritja e lëndës nga klasa VII: Plotësit e rrethanës Detyrë në shtëpi: Të shkruhen nga dy fjali me plotës vendi, kohe. Mënyre dhe shkaku.</i></p>	
<p><i>IV 1. Përpunimi i këngës popullore: Nama e gruas</i> <i>--poezi lirike-epike</i> <i>2. Përsëritja e lëndës nga klasa VII: Plotësit e rrethanës</i> <i>3. Përpunimi i përrallës popullore: Dy binjakët dhe e bukura e dheut.</i> <i>- ndarja e prozës popullore</i> <i>- karakteristikat e përrallës (shkurtimisht)</i> <i>4. Analiza e detyrave shtëpiake.</i></p>	
MUAJI TETOR (1-3)-18 ORË	
<i>Përpunim tekstesh</i>	-----4 orë
<i>Gramatikë</i>	-----7 orë
<i>Ushtrime në të shprehurit me gojë</i>	-----2 orë
<i>Ushtrime në të shprehurit me shkrim</i>	-----1 orë
<i>Hartim</i>	-----1 orë
<i>Lektyrë shtëpiake</i>	-----2 orë
<i>Analizë e detyrave shtëpiake</i>	-----1 orë
Java ora Njësia mësimore	
<p><i>I 1. Përpunimi i fragmentit : Fjala e Skënderbeut—F. Noli</i> <i>2. Sintaksë: Periudha dhe mënyrat e bashkimit në te (fjalitë e pavarura, kryesore dhe të varura).</i> <i>3. Thënja përmendësh e 10-15 rreshtave nga fragmenti: Fjala e Skënderbeut-F. Noli -jeta dhe veprimtaria letrare e F. Nolit (shkurtimisht)</i> <i>4. Analiza e detyrave shtëpiake: Periudhat me fjali të pavarura, kryesore dhe me fjali të pavarura, kryesore dhe të varura.</i></p>	

<p>1. <i>Lektyrë shtëpiake: Nëna-Maksim Gorki, referim me shkrim</i> 2. <i>Sintaksë: Fjalitë e bashkërenditura (këpujore, ndasore).</i> 3. <i>Lektyrë shtëpiake: Nëna-Maksim Gorki, lexim sipas zgjedhjes</i> 4. <i>Sintaksë: fjalitë e bashkërenditura (kundërshtore, përmbyllëse).</i></p>
<p>III 1. <i>Përpunimi i tekstit: Bukë e krypë e zemër-Mark Gurakuqi</i> 2. <i>Sintaksë: Ushtrime përmbledhëse përkitazi me fjalitë e bashkërenditura.</i> 3. <i>Analiza e tekstit: Bukë e krypë e zemër-Mark Gurakuqi</i> 4. <i>Ushtrime në të shprehurit me shkrim: Virtytet shqiptare në veprat e shkrimtarëve tanë dhe të huaj.</i> IV 1. <i>Sintaksë: Fjalitë e nënrenditura-fjalial kryeffalore</i> 2. <i>Përpunimi i vjershës: Popullit tim, E. Mekuli</i> 3. <i>Sintaksë: Fjalial kryeffalore-ushtrime</i> 4. <i>Recitimi i vjershës; Popullit tim-E. Mekuli - jeta dhe veprimtaria letrare e E. Mekuli (shkurtimisht)</i></p>
<p>V 1. <i>Hartimi i parë me shkrim</i> 2. <i>Sintaksë: Fjalial kundrinore</i></p>
<p>MUAJI NËNTOR (1-28)-17 ORË</p>
<p><i>Përpunim tekstesh-----5 orë Gramatikë-----</i> <i>-----6 orë</i> <i>Ushtrime në të shprehurit me gojë-----2 orë</i> <i>Ushtrime në të shprehurit me shkrim-----1 orë</i> <i>Korrigjim i hartimit-----1 orë</i> <i>Lektyrë shtëpiake-----1 orë</i> <i>Analizë e detyrave shtëpiake-----1 orë</i></p>
<p>Java Ora Njësia mësimore</p>
<p>I 1. <i>Përpunimi i prozës: Mollë e ndalueme—Migjeni</i> <i>Kontrastet që përdor autori për ta dhënë më qartë gjendjen e të papunëve. Retiçenca dhe sarkazimi që përdor Migjeni ndaj padrejtësive shoqërore të kohës.</i> 2. <i>Korrigjimi I hartimit të parë (frontal)</i></p>
<p>II 1. <i>Analizë (vijim) dhe lexim shprehës: Mollë e ndalueme-Migjeni –jeta dhe veprimtaria letrare e Migjenit (shkurtimisht)</i> 2. <i>Sintaksë: Fjalial e varur lidhore</i> 3. <i>Ushtrime në të shprehurit me shkrim: Të shkruarit e lutjeve dhe ankesave.</i> 4. <i>Përpunimi i vjershës: Dje dhe sot M. Hoxha</i></p>
<p>III 1. <i>Sintaksë: Fjalial caktuese(Detyrë për në shtëpi: Të shkruhen 5 periudha me fjali caktuese)</i> 2. <i>Recitimi i vjershës: Dje dhe sot M. Hoxha</i> 3. <i>Sintaksë: Fjalial e varur vendore</i> 4. <i>Përpunimi i prozës: Legjenda e misrit—Migjeni</i></p>
<p>IV 1. <i>Sintaksë: Fjalial e varur kohore (Detyrë për në shtëpi : Të shkruhen tri periudha me fjali-Njëkohore, parakohore dhe paskohore.)</i> 2. <i>Lektyrë shtëpiake: Era dhe kolona-H. Sulejmani, referim me shkrim</i> 3. <i>Sintaksë: Fjalial e varur kohore (ushtrime)</i> 4. <i>Përpunimi i tekstit: Demonstrata-Dhe. Shuteriqi</i> <i>Lexim plotësues: 29 Nëndori-S. Mato</i> V 1. <i>Sintaksë: Fjalial e veprur qëllimore(Detyrë për në shtëpi: Të shkruhen 5 periudha me fjali të varura qëllimore)</i> 2. <i>Analiza e detyrave shtëpiake</i> 3. <i>Recitimi i vjershës: 29 Nëndor-S.Mato (poashtu edhe bisedë rreth Ditës së Republikës.)</i></p>
<p>MUAJI DHJETOR (1—31) –16 ORË</p>
<p><i>Përpunim tekstesh-----5 orë</i> <i>Gramatikë-----7 orë</i> <i>Ushtrime në të shprehurit me shkrim-----1 orë</i></p>

<i>Ushtrime në të shprehurit me gojë</i> -----	1 orë
<i>Lektyrë shtëpiake</i> -----	1 orë
<i>Analizë e detyrave shtëpiake</i> -----	1 orë
Java Ora Njësia mësimore	
<i>I 1. Përpunimi i fragmentit: Stavri Lara partisan (nga romani „Këneta”-F.Gjata-karakteristikat e romanit</i>	
<i>2. Sintaksë: Fjalja krahasore</i>	
<i>3. Elementet kryesore të një vepre letrare: tema, ideja kryesore, personazhet, subjekti, kompozicioni, gjuha (shkurtimisht, duke i ilustruar në romanin „Këneta” të F.Gjatës)</i>	
<i>4. Sintaksë: Fjalja kushtore</i>	
<i>II 1. Përpunimi i vjershës: Lirisë-J. V. Rela</i>	
<i>2. Sintaksë: Fjalja lejore</i>	
<i>3. Recitimi i vjershës: Lirisë-J. V. Rela</i>	
<i>-- jeta dhe veprimtaria letrare e Relës (shkurtimisht)</i>	
<i>4. Sintaksë: Fjalja rrjedhore</i>	
<i>III 1. Përpunimi i fragmentit: Hajdutët (nga tregimi „Sokolesha”)-S.Spasse</i>	
<i>- karakteristikat e tregimit artistik</i>	
<i>2. Sintaksë : Ushtrime të përziera në lidhje me fjalitë e varura</i>	
<i>3. Ushtrime në të shprehurit me shkrim: Të shkruarit e recensionit</i>	
<i>4. Sintaksë: Fjalja ndërmjetësore</i>	
<i>IV 1. Lektyrë shtëpiake: Ata nuk ishin vetëm-S. Spasse, referim me shkrim</i>	
<i>2. Përpunimi i vjershës: Letra e nanës-S. Jesenjin</i>	
<i>3. Sintaksë: Periudha me shumë fjali të varura</i>	
<i>Detyrë për në shtëpi: Të shkruhen 3 periudha me më shumë se një fjali të varur.</i>	
<i>4. Analiza e detrave shtëpiake.</i>	
MUAJI JANAR (3—15)—8 ORË	
<i>Përpunim tekstesh</i> -----	2 orë
<i>Gramatikë</i> -----	2 orë
<i>Ushtrime në të shprehurit me gojë</i> -----	1 orë
<i>Hartim dhe korigjim</i> -----	2 orë
<i>Lektyrë shtëpiake</i> -----	1 orë
Java Ora Njësia mësimore	
<i>I 1. Hartimi i dytë me shkrim</i>	
<i>2. Ushtrime rreth të kthyerit e priudhave në fjali të zgjeruara dhe anasjelltas.</i>	
<i>II 1. Lektyrë shtëpiake: Tufa-Latif Berisha, lexim sipas zgjedhjes</i>	
<i>2. Përsëritja dhe sistemim i lëndës së zhvilluar nga sintaksa</i>	
<i>3. Korigjim i hartimit të tretë (frontal)</i>	
<i>4. Përpunimi i tekstit: Stuhi në stepë-A. S. Pushkin-pejsazhi</i>	
<i>III 1. Elementit kryesore të një vepre letrare: tema, ideja, etj-përsëritja</i>	
<i>2. Leximi shprehës i tekstit: Stuhi bore në stepë-A. S. Pushkin</i>	
MUAJI SHKURT (6—28)—13 ORË	
<i>Përpunim tekstesh</i> -----	3 orë
<i>Gramatikë</i> -----	6 orë
<i>Ushtrime në të shprehurit me gojë</i> -----	2 orë
<i>Ushtrime në të shprehurit me shkrim</i> -----	1 orë
<i>Lektyrë shtëpiake</i> -----	1 orë
Java Ora Njësia mësimore	
<i>I 1. Ushtrime në të shprehurit me gojë: Një ditë e paharrueshme gjatë pushimeve dimërore (përshkrim i pavarur)</i>	
<i>2. Sintaksë: Periudha me shumë fjali të varura-përsëritje</i>	
<i>II 1. Përpunimi i tekstit: Dashuri-Nonda Bulka</i>	
<i>2. Sintaksë: Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë</i>	

<p>3. Përpunimi i vjershës : <i>Kangët e pakëndueme-Migjeni-metafora</i> 4. Sintaksë: <i>Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë-ushtrime</i> III 1. Recitimi i vjershës: <i>Kangët e pakëndueme-Migjeni</i> 2. <i>Shenjat e pikësimit : pika, pikëpyetja, pikëçuditja.</i> 3. <i>Lektyrë shtëpiake : Si u kalit çeliku-Nikollaj Ostrovski, referim me shkrim</i> 4. <i>Shenjat e pikësimit: dypikat, thojzat.</i> IV 1. Përpunimi i tekstit: <i>Gjikanti ynë-reportazhi gazetaresk</i> 2. <i>Shenjat e pikësimit: presa</i> 3. <i>Ushtrime në të shprehurit me shkrim:Figura e Pavël Korçaginit</i></p>
MUJI MARS (1-30)-18 ORË
Përpunim tekstesh-----3 orë
Gramatikë-----8 orë
Ushtrime në të shprehurit me gojë-----2 orë
Ushtrime në të shprehurit me shkrim-----1 orë
Hartim dhe korigjim-----2 orë
Lektyrë shtëpiake-----1 orë
Analizë e detyrave shtëpiake-----1 orë
Java Ora Njësia mësimore
<p>I 1. Përpunimi fragmentit: <i>Dita e madhe (nga drama „Toka jonë”)-Kolë Jakova - drama</i> 2. <i>Shenjat e pikësimit: pikëpresa, viza</i> II 1. Analiza e fragmentit: <i>Dita e Madhe Kolë Jakova Analiza e shkurtër e dramës. Problemi i rëndësishëm që shtrohet. Qëndrimi që mbajnë klasat e ndryshme. Besimi në të ardhmen e lumtur. Karaktere të ndryshme.-jeta dhe veprimtaria letrare e Kolë Jakovës (shkurtimisht)</i> 2. <i>Morfologjia: Fjala dhe përbërja e saj</i> 3. <i>Ushtrime në të shprehurit me shkrim: Diktim kontrolli (përkitazi me shenjat e pikësimit)</i> 4. <i>Dramatizimi (me magnetofon) i fragmentit: Ditë e madhe-K. Jakova</i> III 1. Përpunimi i fragmentit: <i>Hanko Halla-Ali Asllani</i> <i>Lexim plotësues: <i>Dëshira e Labit-Ali Asllani</i></i> 2. <i>Morfologji: Tema dhe rrënja e fjalës</i> 3. <i>Recitimi i vjershës: <i>Dëshira e Labit-Ali Asllani -- jeta dhe veprimtaria letrare e Ali Asllanit (shkurtimisht)</i></i> 4. <i>Hartimi i tretë me shkrim</i> IV 1.Morfologji: <i>Parashtesat dhe prapashtesat</i> 2. <i>Korigjim i hartimit të tretë (frontal)</i> 3. <i>Morfologji: Mbaresat</i> 4. <i>Lektyrë shtëpiake: <i>Cuca e Maleve-Loni Papa, refetim me shkrim</i></i> V 1. Morfologji: <i>Fjalë të parë e të prejardhura</i> 2. <i>Drejtshkrimi i fjalëve të prejardhura</i> 3. <i>Analiza e detyrave shtëpiake</i> 4. <i>Morfologji: Fjalët e përbera dhe të përngjitura</i></p>
MUJI PRILL (1—30) – 18 ORË
Përpunim tekstesh-----6 orë
Gramatikë-----7 orë
Ushtrime në të shprehurit me gojë-----2 orë
Hartim dhe korigjim-----2 orë
Lektyrë shtëpiake-----1 orë
<p>Java Ora Njësia mësimore <i>G. D. të Riut (shkurtimisht)</i> 2. <i>Morfologji: Drejtshkrimi i fjalëve të përbera dhe të përngjitura</i> 3. <i>Përpunim i vjershës: <i>Aty ku ranë dëshmorë-E. Mekuli, Lexim plotësues: Shtatë prilli-P. Marko</i></i></p>

<p>4. Morfologji: Rasat dhe funksionet e tyre II 1. Recitimi i vjershës: <i>Aty ku ranë dëshmorë-E. Mekuli</i> 2. Morfologji: Rasat dhe funksionet e tyre-ushtime 3. Lektyrë shtëpiake: <i>Kasollja—B. Ibanjez, referim me shkrim</i> 4. Morfologji: <i>Shkallët e mbiemrave cilësorë</i> III 1. Përpunimi i fragmentit: <i>Festa e pranverës në katund-S. Spasse</i> 2. Morfologji: <i>Të substantivuarit e mbiemrave cilësorë</i> 3. Përpunimi i një fragmenti nga komedia: <i>Burri burri-K. Floqi –jeta dhe veprimtaria letrare e Kristo Floqit (shkurtimisht)</i> 4. Morfologji: <i>Bashkimet e trajtave të shkurtëra të përemrave vetorë</i> IV 1. Përpunimi i vjershës: <i>Vallja e luleve-L. Poradeci</i> 2. Hartimi i katër me shkrim 3. Recitimi i vjershës: <i>Vallja e luleve-L. Poradeci- jeta dhe veprimtaria letrare e L. Poradecit (shkurtimisht)</i> 4. Drejtëshkrimi i trajtave të shkurtëra të përemrave vetorë V 1. Korrigjim i hartimit të katërt (Frontal) 2. Përpunimi i tekstit: <i>Dy miq-dy njerëz të mëdhenj në historinë e njerëzimit-Markisi dhe Engelsi-Pol Lafarg</i> <i>Lexim plotësues: Dita e majit të kuq-L. Berisha</i></p>
<p>I 1. Përpunimi i një fragmenti nga : <i>Kënka e sprasme e Balës—G. Dara i Riu –jeta dhe veprimtaria letrare</i></p>
<p>MUAJI MAJ (3-20)-10 ORË</p>
<p><i>Përpunim tekstesh-----3 orë</i> <i>Gramatikë-----4 orë</i> <i>Ushtime në të shprehurit me gojë-----2 orë</i> <i>Lektyrë shtëpiake-----1 orë</i></p>
<p>Java Ora Njësia mësimore</p>
<p>I 1. Përpunim i një fragmenti nga <i>Këngët e Milosaos—De Rada -- jeta dhe veprimtaria letrare e De Radës (shkurtimisht)</i> 2. Morfologji: <i>Folja , trajta e saj (veprore, pësore, vetëvetore), foljet kalimtare dhe jokalimtare.</i> II 1. Përpunim i vjershës: <i>Mëngjezi—Omar Khajami</i> <i>Lexim plotësues: fjala jonë—Rrahman Dedaj</i> 2. Morfologji: <i>Shprehjet foljore</i> 3. Recitimi i vjershës: <i>Mëngjezi—Omar Khajami</i> 4. Morfologji: <i>Mënyrat dhe kohët e foljes dhe kuptimit e tyre (përaëritje dhe sistemin nga klasët e tjera).</i> III 1. Përpunimi i tekstit: <i>E bija e mbretit dhe trëndafijt—F. Konica</i> 2. Lektyrë shtëpiake: <i>Shtatë Shaljanët—Ndrekë Luca, referim me shkrim</i> 3. Morfologji: <i>Zgjedhimi i foljeve ndihmëse në të gjitha mënyrat dhe kohët (përsëritja dhe sistemin nga klasët e tjera)</i> 4. <i>Ushtime në të shprehurit me gojë: Profesionit im i ardhshëm</i></p>

Modeli i plankonspektit tradicional për një orë mësimore - gramatikë

Plankonspekti në mësimdhënien tradicionale ishte plani i detajuar i përgatitjes me shkrim për një orë të mësimin. Ky ishte detyrim jo veç për mësimdhënësit fillestar, dhe shërbente si njëri nga elementet për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve. Plankonspekti më shumë hartohet

nga studentët që përgatitëshin për mësimdhënie, ndërsa përgatitja ditore për orë mësimore e mësimdhënësve dallonte për faktin se ajo bëhej mëshkurt pa detaje të theksuar.⁶²¹

Tabela 29. Plankonspekti i mësimdhënësve të gjuhës shqipe për një orë mësimore

Plankonspekti i mësimdhënësve të gjuhës shqipe për një orë mësimore
i mësimdhënësve të gjuhës shqipe për një orë mësimore
<p>Klasa e pestë (V) fillore Lënda: Gramatikë Tema: Lakimi i mbiemrave cilësonjës</p>
<p>Qëllimi arsimor: <i>Të mësojnë rregullat gramatikore sipas të ciave do të bëhet lakimi i mbiemrave cilësonjës.</i></p>
<p>Qëllimi edukativ: <i>Formimi i cilësive pozitive njerëzore dhe zhvillimi i të gjykuarit logjik.</i></p>
<p>Metodat mësimore: <i>a) Metoda bashkëbiseduese, b) metoda e demonstrimit, c) metoda monologue.</i></p>
<p>Mjetet mësimore: <i>Pasqyrat e lekimit të mbiemrave cilësonjës të nyjshëm (pas e para emrit) dhe të panyjshëm; Teksti i përgaditur, dërrasa e zezë dhe Libri i gramatikës.</i></p>
STRUKTURA E ORËS
<i>HYRJA</i>
<p><i>(Për hyrje do të mëshërbejë teksti i përpiluar nga unë përmes të të cilit, duke përsëritur njësitë e kaluara, dal në qëllimin e orës).</i></p> <p>....Pasi e shënoj njësinë mësimore në ditë, ekspozoj tekstin e përgatitur: NJË PLAKËE thinjurU TAKUA NË RRUGË ME NJË DJALË. Djali i mençurIA LËSHOI RRUGËN PLAKËS DUKE E NDERUAR. PLAKA I THA: „ O DJALË i mirë, LUM PRINDËRIT QË TË KANË! I miriDJALË NJIFET KUDO. DJEMTËE mirëDHE VAJZATe miraKUDO ZBARDHIN. DJEMTË Ë TILLË JANË SI të bukurit QINGJA.</p> <p>Këtë e lexojnë dy nxënës, Kërkoj nga të gjithë nxënësit t' i gjejnë mbiemrat, të tregojnë vendin, gjininë, numrin se a janë të nyjshëm a të panyjshëm. Pas një vështrimi të shkurtër nxënësit paraqiten për të dhënë përgjegjet... Pasi konstatohet se mbiemrat cilësonjës ndeshen pas dhe para emrit, se me emrin përshtaten në gjini e në numër pyes nxënësit se edhe në çka tjetër përshtatet mbiemri me emrin të cilin e cilëson. Kur marrë përgjegjen se mbiemri cilësonjës merr nga emir edhe rasën, do t' u them; Për të parë se mbiemri cilësonjës merr rasën e emrit, sot do ta mësojmë lakimin e tyre <i>(e shënoj në tabelë).</i></p> <p><u>Lakimi i mbiemrave cilësonjës.</u></p>
ZHVILLIMI I MËSIMIT TË RI
<p>Meqë mbiemrat cilësonjës përshtaten me emrin në gjini në numër e në rasë, edhe lakimin e tyre do ta bëjmë të pandarë, bashkë me emrin.</p> <p><i>(Ekspozoj pasqyrën e lakimit të mbiemrave të ndryshëm-pas emrit. Nxënësit vështrojnë shembujt e lakuar të të tri gjinivet, ku bien në sy qartë ndryshimet që ka në pësuar emrat dhe nyjet para mbiemrave, sipas numrit dhe rasës.)</i></p> <p>ç'është paraqitur në këtë pasqyrë?-pyes nxënësit. (Lakimi i mbiemrave të nyjshëm pas emrit)-thonë ata. Pasi konstatohet se gjinia, numrat nuk pëlqejnë me emrin në trajtë. Mandej shtroj pyetjen: ç'ndryshim po pasuaka gjatë lakimit mbiemri i nyjshëm pas emrit?... <i>(Mbiemrat e nyjshëm pas emrit gjatë lakimit ndryshokan vetëm nyjen e përparme)-përgjegjen disa nxënës. Bëjë shpalosjen e përfundimit në pasqyrë: (Mbiemrat cilësojës të nyjshëm, kur vihen pas emrit , ndryshojnë vetëm nyjen e përparme si pas numrit dhe rasës). -E lexojnë përfundimin 2-3 veta, kerkoj nga nxënësit të lakojnë nga një mbiemër të të tri gjinivet, në dy trajtat të numrit njëjës dhe shumës,-sipas shembullit në pasqyrë. (Gjatë gjithë punës i kushtoj kujdes të posaçëm dallimit të trajtës, duke kërkuar të mbajnë mirë në mend se veç në trajtë nuk përshtaten këto dy pjesë të ligjeratës).</i></p>

⁶²¹ Esat Hoxha, *Metodika e gjuhës dhe e letërsisë shqipe*, (Dispencë për student), ETMM të KSAK, Prishtinë, 1984, f.19.

-Kur konstatoj se kjo pjesë është kuptuar nga nxënësit, ekspozoj pasqyrën e lakimit të mbiemrave para emrit dhe Bashkëbisedohet për gjininë, trajtën, numrin e rasën e tyre. -Mandëj pyes për ndryshimin që ka pësuar gjatë lakimit mbiemri i nyjshëm para emrit. Duke bashkëbiseduar përfundohet se mbiemri i nyjshëm para emrit lakohet mu si emir. Atëherë zbuloi përfundimin në pasqyrë: (*Mbiemrat cilësonjës të nyjshëm , kur vihen përpara emrit, lakohen si emrat*). Përsëritet përfundimi nga ca nxënës e mandëj lakohet nga një mbiemër në dy gjinitë, njëjës dhe shumës.

-Tash e paraqes pasqyrën e tretë **LAKIMI I MBIEMRAVE TË PA NYJSHËM**. Veproji si me ato të parat, duke kërkuar nga nxënësit t'i gjejnë mbiemrat, të përcaktojnë vendin, trajtën, gjininë, numrin dhe rasën. Bëj krahasimin me shembujt në dy pasqyrëzat e para...
(*Mbiemrat në pasqyrën e parë dhe të dytën janë të nyjshëm, kurse tash janë të panyjshëm. Mbiemrat e nyjshëm zënë vend pas dhe para emrit, kurse të panyjshmit ndodhen pas emrit. Mbiemrat e nyjshëm pas emrit kanë trajtën e pashquar, gjithashtu edhe mbiemrat e nyjshëm para emrit kanë trajtën e shquar.*). Në vijim lyp t'i lexojnë, në heshtje shembujt në pasqyrë. Pyes për ndryshimin që ka pësuar mbiemri sipas rasës dhe numrit. Duke bashkëbiseduar përfundojmë se mbiemrat cilësonjës të panyjshëm pas emrit gjatë lakimit nuk ndryshojnë lakohet vetëm emir. Atëherë zbuloi përfundimin në pasqyrë: (*Mbiemrat cilësonjës të panyjshëm pas emrit nuk ndryshojnë, lakohet vetëm emër*). Mandëj lakohet nga një mbiemër në dy gjinitë, njëjës dhe shumës.

PËRSËRITJA

Përsëritja e tërë njësisë mësimore me anë të këtyre pyetjeve:

-c'ka mësuat ju? (lakimin e mbiemrave cilësonjës) .c'ndryshim përsojnë mbiemrat cilësonjës të nyjshëm pas emrit kur të lakohen?(ndryshojnë vetëm nyjen e përparme) Si lakohen mbiemrat cilësonjës të nyjshëm kur gjenden përpara emrit?

(*lakohen mu sikur emrat*) **Si lakohen mbiemrat cilësonjës të panyjshëm pas emrit?**

(*nuk lakohen fare, atyre u lakohen veç emrat që kanë përpara*).

Nëse lyp nevoja për sqarime, ato i bëj duke u mbështetur në pasqyrat e ekspozuara.

Njoftoj nxënësit që t'i hapin librin e Gramatika, në faqen 104, ku është kjo njësi mësimore. I njoftoi që pjesën e vërejtjeve ortografike do ta bëjmë në orën e përsëritjes. Mandëj u jep

DETYRË SHTRËPË

-Në faqen 106 një nxënës lexon ushtrimin 135 (*kjo detyrë jepet në grupe*). Bashkëbisedohet se duhet bërë, mund të merret nga një shembull, varësisht prej kohës. Kështu veprohet edhe me ushtrimin 136 dhe 140 (*detyra për të gjithë*), duke kërkuar që çdo nxënës ta ketë të qartë detyrën.⁶²²

5.5.6. ROLI I TEKSTEVE SHKOLLORE PËR MËSIMIN E GRAMATIKËS

Nisur nga karakteri i programeve mësimore për gjuhë shqipe që ishte me shtrirje lineare-koncentrike, edhe në tekstet mësimore për mësimin e gramatikës njohuritë mbi gjuhën në tekste shtroheshin edhe trajtoheshin në mënyrë sistematike dhe shkallë-shkallë prej klase në klasë. Në klasën e parë dhe të dytë, njohuritë mbi gjuhën jepeshin në mënyrë intuitive , spontane, pa asfarë rregullash e përkufizimesh . Në klasën e tretë, njohuritë mbi gjuhën të dhëna më parë, zgjerohen e sistematizohen në formë rregullash e përkufizimesh deskriptive, më shumë në bazë të situatave konkrete gjuhësore që manifestohen në të folurit e zakonshëm dhe në fjalën e shkruar, sips zhvillimit psikik të nxënësve. Në klasën e katërt vihet re tendenca e sistematizimit deskriptiv të njohurive dhe fillon me etapën e dytë të përvetësimit të njohurive mbi gjuhën. Nga klasa e pestë, fillon etapa e tretë që karakterizohet më përvetësimin sistematik të njohurive mbi gjuhën gjë që vërehet se nga kjo klasë, në programin mësimor paraqitet gramatika si lëmë (*libwr*) i

⁶²² Marrë nga :“Dispozicioni i një ore””Shkëndija” nr. 7-8 , më 1 maj 1974.

veçantë arsimor i lëndës së gjuhës shqipe. Nga një analizë e teksteve shkollore të gjuhës shqipe në arsimin e detyruar të bërënga didaktja e përkushtuar Hajrie Devetaku-Gojani, që përfshin tekstet shkollore nga viti 1996 deri në vitin 2004, dalin në spikamënjë vister çështjesh.⁶²³ Sipas vlerësimit të kësaj studiuje "…në periudhën e parë kohore ishte një kombinim i teksteve të vjetra me tekstet e hartuara në bazë të programeve zyrtare, kurse në periudhën e dytë janë analizuar tekstet e tjera të reja, të cilat tashmë zëvendësuan të gjitha tekstet e vjetra shkollore të gjuhës shqipe."⁶²⁴ Tradicionalisht, tekstet mësimore të gramatikës ishin, pothuaj, burimi më i rëndësishëm dhe i vetmi i nxënies. Sipas metodologjisë tradicionale të mësimdhënies tekstet shkollore të gjuhës shqipe, në periudhën kohore (1945-2004) janë hartuar me qasjen e vjetruar, si në përmbajtje, ashtu edhe në pyetje, detyra dhe në ilustrime. Në dhjetëvjeçarin e fundit janë bërë ndryshime të shumta pozitive në hartimin e teksteve shkollore, për dallim nga të mëparshme. Kur analizohen nga aspekti strukturor e përmbajtësor hetohet se tekstet shkollore të gramatikës së gjuhës shqipe janë "një grumbull të dhënash,, të përmbajtjeve mësimore me fakte dhe informacione të shumta.

Disa dobësi dhe probleme, janë fokusuar edhe në një raport të MASHT-it, port w ngjashme burojnë edhe nga njëvlerësimi i nxjerrë nga intervistat me mësimdhënësit e gjuhës shqipe se "Dobësitë e këtyre teksteve kryesisht qëndrojnë në përmbajtjet mësimore dhe në qasjen metodologjike."⁶²⁵ Sipas mësimdhënësve të klasës së parë, del se në abetare tekstet konsiderohen të tejkaluara, të marra kryesisht nga abetarja e vjetër, mandej është monotoni për nxënësin e njëjta metodë-teknikë për zhvillimin e shkronjës së re, në disa përmbajtje paraqitet puna fizike të fëmijët etj. Në shumicën e lëndëve mësimore, sipas këtij vlerësimi, gjuha dhe stili i tekstit është i papërshtatshëm për moshën e nxënësve dhe fjalori që përdoret shpeshherë e vështirëson të kuptuarit e lëndës. Pastaj dobësi tjetër e këtyre teksteve janë se pyetjet e formuluar nuk janë të niveleve të ndryshme dhe, si pasojë e kësaj, nuk zhvillohen shkathtësitë e të menduarit të nivelit të lartë."⁶²⁶ Tekstet shkollore të gjuhës shqipe të cilat për një kohë të gjatë ishin në përdorim në mësimdhënien e kësaj lënde mësimore promovonin dije të pastër, por shënonin lajthitje të shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, që do të duhej t'i zhvillonin nxënësit. Duke analizuar tekstet shkollore Gjuha Shqipe, klasa 5, klasa 6, klasa 7, klasa 8⁶²⁷ gramatika ofrohet të mësohet si rregull, si normë, duke i lënë anash shkathtësitë e komunikimit. Duket të jetë standarde rubrika Mbani mend, para pjesës së ushtrimeve, dhe ky është një faktor që tradicionalisht ka vështirësuar zhvillimin e shkathtësive e ka favorizuar mundësinë e të mësuarit përmendsh të rregullave dhe normave gjuhësore. Sipas programit të ri të gjuhës shqipe për klasën VII, është hartuar teksti shkollor Gjuha Shqipe, klasa VII,⁶²⁸ në linjën "Të thellojë dhe të zgjerojë njohuritë e sistemit gjuhësor," përfshinë vetëm gramatikën, si rregull dhe si normë duke vijuar me tradicionalizmin. Duket se autori si më herët vijon "…qëndrimi është në gramatikën e jo në gjuhën e gramatizuar,

⁶²³Në shkollën fillore të Kosovës deri në vitin 2004 zbatoheshin tekstet shkollore të viteve të 90-ta dhe një pjesë e teksteve të hartuara në mbështetje të programeve të reja mësimore

⁶²⁴Hajrije Devetaku Gojani, *Gjuha shqipe në tekstet shkollore*, Shtëpia Botuese Libri Shkollor, Prishtinë, 2011.f.54.

⁶²⁵ Nga rezultatet e hulumtimeve të autorit të bëra në terren në shkollat e rajonit të Prishtinës në vitin 2013.

⁶²⁶Nga një Raport i MASHT-it ku pasqyrohet „Vlerësimi i teksteve të reja shkollore për klasët I, II, VI, VII, X dhe XI ,, me një vlerësim mbi tekstet i bërë nga mësimdhënësit e klasave përkatëse dhe i hartuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, (Zyra për tekste shkollore). Këtu hetohen të gjithë përpjekjet e autorëve për të pasur tekste sa më të mira shkollore, mirëpo janë mësimdhënësit e gjuhës shqipe ata që e thonë fjalën e fundit, sepse ata i vlerësojnë më mirë tekstet që kanë në përdorim të përditshëm.

⁶²⁷ Fjala është për tekstet e Gramatikës për këto klasë gjatë periudhës kohore 1996-2004.

⁶²⁸Beci, Bahri, *Gjuha shqipe 7*, Dukagjini, Pejë, 2004.

nuk është përqendrimi në nxënësin dhe në të nxënit e tij, njohuritë që merren në këtë mënyrë nuk janë praktike dhe funksionale, por janë njohuri verbale dhe e motivojnë nxënësin vetëm për notë.”⁶²⁹ Në planifikimin bashkëkohor tashmë mësimi i gjuhës bëhet për t’i zhvilluar shkathtësitë e komunikimit përmes kategorive: *të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit*. Tashmë është hapur perspektivë e re dhe gramatika mësohet për të dëgjuar, për të folur, për të lexuar dhe për të shkruar mirë, qartë dhe kuptueshëm. Qëllimi i mësimi të gjuhës shqipe në shkollimin e detyruar, por edhe në atë të mesëm të lartë në Kosovë po shenon përmirësim dhe po ecën binarëve kurrikular të Evropës. Në disa nga tekstet tradicionale të gramatikave hetohen gabime material dhe lajthitje gjuhësore dhe lëshime të natyrave të ndryshme. Për t’idokumentuadisa vlerësime të prezantuara në punim do t’i marrim disa shembuj, të nxjerrë nga tekstet shkollore për gjuhën shqipe. Në tekstin shkollor “Gjuha Shqipe 5”,⁶³⁰ në njësinë mësimore *Lakimi i emrit* nxënësve ju jepet për detyrë:

- *Thoni përmendsh lakimin e emrit lis në trajtën e pashquar dhe në trajtën e shquar në njëjës dhe në shumës.*
- *Thoni përmendsh lakimin e emrit shok në të dy trajtat, në njëjës e në shumës.*
- *Thoni përmendsh lakimin e emrave vajzë dhe lule në të dy trajtat, (njëjës e shumës).*⁶³¹

Këto kërkesa të autorit të librit duket se bien në kundërshtim me kërkesat didaktike, sepse asnjë pjesë e ligjeratës nuk preferohet të mësohet përmendsh, sepse kjo mënyrë e të mësuarit, privon nxënësin për të zhvilluar shkathtësitë e komunikimit dhe shkathtësinë e të menduarit. Edhe te libri shkollor *Gjuha Shqipe 6*⁶³², në njësinë mësimore *Si t’i shprehim dëshirat tona* devijohen objektivat e mësimi, sepse nxënësit pengohen të mendojnë dhe të shprehin të pavarur. Këtë e mundësojnë pyetjet: *Çfarë dëshirash kanë Miri, Vera, Genta, Beni dhe Indriti? Arsyetoni dëshirat e tyre?* Pyetjet e shtruar pa profesionalizmin e mjeshtrisë së hartimit të teksteve i gjejmë edhe te *Gjuha Shqipe 7*.⁶³³ Pyetjet e shtruara në fund të tregimit *Poçari i vjetër: Lexoni tekstin dhe thoni llojin e ligjeratës?, Përse flitet në këtë tregim?, Tregimi ka hyrjen, përmbajtjen dhe mbylljen. i gjeni ato?* Nuk përmbajnë asnjë kreativitet ato sikur ia “mbyllin gojën” nxënësit dhe mbesin pa asnjë motivim për interesat e nxënësit. Në tekstet shkollore të gjuhës shqipe, *Gjuha Shqipe 2*⁶³⁴ mënyra se si janë paraqitur detyrat u mundëson nxënësve që të zhvillojnë të menduarit logjik. Shembuj: *Pastaj lahet dhe ha mëngjes, Artani zgjohet nga gjumi në orën gjashtë, Në orën shtatë e gjysmë niset për në shkollë, Hap dritaren dhe bën gjimnastikë*. Këto detyra mundësojnë zhvillimin e imagjinatës së nxënësve (*faqe 18*). Me tone pozitiviste mund të flitet edhe për tekstin shkollor *Gjuha Shqipe 3*,⁶³⁵ ku në njësinë mësimore *Llojet e fjalive* janë dhënë fjali, si: *Vazoja me lule ndodhej në dritare. Altini po luante me Benin. Vazon e theu Altini etj., për të cilat detyra që jepet nxënësve është: Ç’pyetje duhet të bëni që të merrni këto përgjigje?* Këto detyra e bëjnë mëatraktive dhe më interesant tekstin e gjuhës për këtë klasë. Edhe paraqitja e fotografive, ilustrimeve dhe e shembujve në tekstet shkollore shpeshherë flasin

⁶²⁹Hajrije Devetaku – Gojani, *Gjuha shqipe në tekstet shkollore*, Shtëpia Botuese Libri Shkollor, Prishtinë, 2011, f.54.

⁶³⁰ Grup autorësh, *Gjuha Shqipe 5*, botimi i katërt, Libri Shkollor, Prishtinë, 1999.

⁶³¹ Po aty, Vepër e cituar, 1999.

⁶³² Beci, Bahri, *Gjuha shqipe 6*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003.

⁶³³ Beci, Bahri, *Gjuha shqipe 7*, Dukagjini, Pejë, 2004.

⁶³⁴ Grup autorësh: *Gjuha shqipe 2*, botimi i gjashtë, Libri Shkollor, Prishtinë, 2001.

⁶³⁵ Grup autorësh: *Gjuha shqipe 3*, botimi i pestë, Libri Shkollor, Prishtinë, 2000.

figurativisht shumë dhe më mirë se përmbajtjet mësimore. Sespe është bindje e didaktëve se kultura pamore ndikon shumë në të menduarit dhe imagjinatën e nxënësve. Mënyra e të shtruarit të problemeve në tekstet shkollore, është një ndër faktorët kryesorë dhe shumë të rëndësishëm për realizimin me sukses të objektivave të përcaktuar për lëndën e gjuhës shqipe. Mund të konstatohet se qasja metodologjike, të shumica e teksteve ishyte e hapur, e larmishme dhe mundësonte aplikimin e metodave bashkëkohore “*Tekstet shkollore të gjuhës shqipe , të hartuara sipas qasjes tradicionale, pasqyronin metodat dhe strategjitë tashmë të vjetruara, të cilat, në shumicën e rasteve, ofronin mundësinë e aplikimit të mësimi verbal.*”⁶³⁶Metodat tradicionale të mësimdhënies dhe të nxënies përqendroheshin vetëm në të nxiturit e mësimi verbal e në perspektivat abstrakte .

Vetëm pas vitit 2004 vihen re dukshëm rrisitë, të cilat janë reflektuar edhe në tekstet e gramatikës ⁶³⁷,Në shumicën e teksteve të botuara në këtë periudhë risia qëndrore qëndron në faktin se hartuesit e teksteve shënojnë përpjekjen për integrimin e të gjitha komponentëve të gjuhës në funksion të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit. ⁶³⁸ Krahas përparimeve në tekstet e reja shkollore, shënohen edhe lëshime. Nuk arsyetohet largimi nga programi, sepse tekstet shkollore, janë emërtuar me emra të ndryshëm në kundërshti me programet mësimore.Hasen disa emërtime si “*Gjuha shqipe*”, “*Leximi*”, “*Gjuha shqipe dhe leximi*”, “*Gjuhë shqipe dhe letërsi*”,mirëpo didaktët dhe opinion kanë bindje të plotë se që të gjitha do të duhej pagëzuar në një emër “*Gjuha shqipe*”.Për të ilustruar konstatimet e mëparshme, po nisim me tekstin shkollor *Leximi 2*, ku me një qasje të integruar në harmoni me programin zyrtar të klasës prezantohen shkathtësitë e komunikimit dhe gjithashtu gramatika në funksion e saj të duhur.Vlen të përmendet se përmbajtja gramatikore realizohet në lidhje të ngushtë me tekstet ,si te “*Vjeshta dhe miqtë e saj*”, ku nxënësit kanë për detyrë të gjejnë emra të gjinisë femërore dhe mashkullore, ikurse edhe te teksti “*Marigona dhe Flamuri* “ ku nxënësit mësojnë për fjalitë dëftore, pyetëse dhe dëshirore.Nuk harrohet as shkathtësia e të shkruarit, dhe ushtrimi i drejtshkrimit (faqe 58,)ku letra është shkruar me gabime,nga nxënësi kërkohet tëpërmirësohet. Edhe teksti “*Gjuha shqipe 2*”,⁶³⁹është hartuar në frymën e zhvillimit të shkathtësive të komunikimit dhe gjithtërësia gramatikore që shtjellohet në këtë tekst ka informacione elementare, të domosdoshme për moshën e nxënësvesipas kërkesave të programit zyrtar. Fjalitë dhe shenjat e pikësimit janë një pjesë tjetër e rëndësishme dhe atraktive e këtij teksti (faqe 32), mandej kthimi i fjalive pohore në fjali mohore dhe e kundërta (faqe 36). Mënyra e trajtimit të kohëve të foljes është një risi që në tekst do të shoqërohej me detyra. (Nxënësit ta shkruajnë një tekst të shkurtër në kohën e tashme, një tekst në kohën e ardhme dhe një tekst në kohën e kryer.)⁶⁴⁰ Ky tekst duket të jetë në funksion

⁶³⁶Hajrije Devetaku Gojani, *Gjuha shqipe në tekstet shkollore: Shtëpia Botuese Libri Shkollor, Prishtinë, 2011, f.57.*

⁶³⁷Tekstet shkollore të botuara nga viti 2004 konsiderohen tekste të reja shkollore të hartuara në mbështetje të programeve zyrtare të miratuara nga MASHT-i. Në bazë të analizave shihet që janë bërë përparime të dukshme krahasuar me tekstet e kaluara. Ndryshimet janë të dukshme si për nga përmbajtja, ashtu edhe për nga qasja metodologjike, pyetjet dhe detyrat, ilustrimet, korrelacioni ndërëndor dhe ndër programor, etj.

⁶³⁸Kjo përpjekje është e dukshme vetëm në arsimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e pestë, kurse në arsimin e mesëm të ulët është vazhduar pothuajse njësoj sikurse edhe në të kaluarën. Në këtë nivel të shkollimit, pra në arsimin e mesëm të ultë nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë, përsëri gjuha identifikohet kryesisht me gramatikën, kurse leximi letrar me letërsinë.

⁶³⁹Beci, Bahri: *Gjuha shqipe 2*, Dukagjini, Pejë, 2006.

⁶⁴⁰Shih:Pyetjet e paraqitura te teksti *Gjuha shqipe 2* ,faqe 122, pyetja 2, 3, 4, dhe 5, mundësojnë praktikumin e foljes në kohën e ardhme. Për shembull: Ku do t’i kalojnë ata (nxënësit) pushimet? Po mësuesja?, Po ju ku do ti kaloni sivjet pushimet?, Çfarë do të bëni? Me anë të këtyre pyetjeve do të mund të praktikohet përdorimi i foljes në kohën e ardhme dhe një praktikë e tillë, që është shumë e mirë, do të duhej ndjekur edhe për kohët tjera të foljes.

tëndihmon që nxënësit të vijnë në përfundime të ndryshme dhe të pavarura. Edhe teksti “*Leximi 3,*” në një qasje të integruar dhe të gjitha së bashku në funksion të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit. Në varësi nga njësia gramatikore, nga hartuesi janë përzgjedhur tekstet dhe janë përshtatur në funksion të njëra - tjetrës. Kur flitet për emrat dhe trajtën e emrave, është zgjedhur tregimi “*Klasa e mbretërve dhe e mbretërëshave*”, në të cilin përfaqësohen emrat në gjini dhe në trajta të ndryshme (faqe 8). Kurse, tregimin “*Gurët e Kreshnikëve*” (faqe 54-57), autori e shfrytëzon të jap informacione për parafjalët. “*Himni i Flamurit*”, (faqe 28), tregimi “*Babai im çminues*”, (faqe 45), etj. janë tekste në funksion të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit. Këto përmbajtje i përmban edhe libri shkollor “*Gjuha shqipe dhe leximi 3*”⁶⁴¹ ku janë përfshirë përmbajtja programore në nivel të shkathtësive të komunikimit si: *Të dëgjuarit dhe të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit*, në përputhje me qëllimet dhe objektivat e programit mësimor zyrtar ku përvijohet synimi i të qe “*gjuha*” duke nënkuptuar *gramatikën* dhe *leximi* duke nënkuptuar *letërsinë*. Po përmend situatat në cilat hetohet integrimi: në vjershën *Librat rrinë radhë- radhë* (faqe 15), nxënësve u jepet detyrë që të gjejnë emrat dhe foljet që janë përdorur në këtë vjershë. Edhe te vjersha *Dhelpra dhe rrushtë*, nxënësit duhet të gjejnë mbiemrat e kundërt: rrush i pabërë ose rrush i papjekur (faqe 79) si formë ushtrimi. Në të gjitha përmbajtjet gramatikore të librit shkollor “*Gjuha shqipe dhe leximi 4*”,⁶⁴² janë prezente përmbajtjet programore në nivel të shkathtësive të komunikimit që janë: *Të dëgjuarit dhe të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit*. Është kryesorja, për nxënësit se ai ka dalë në qendër duke u bërë pjesë e rëndësishme e procesit mësimor. Progres i kënaqshëm vihet re edhe te situata kur nxënësit në një tekst të shkurtër duhet t’i vendosin emrat në rasën përkatëse (faqe 74), mandej në pjesën e ushtrimeve faqe 94 janë dhënë emra dhe mbiemra dhe nxënësit duhet të bëjnë lidhjen e tyre, pastaj t’i kthejnë nga numri njëjës në numrin shumës etj. Edhe foljet ndihmëse *kam* dhe *jam* për nxënësit dalin për detyrë që të lidhin tekstin. Integrimi i gramatikës me tekstin vihet re në tregimin *Gjyshja e të gjithëve* (faqe 32), sepse te pjesa e detyrave, nxënësit duhet të gjejnë: Sa herë përmendet në tekst mbiemri *të freskëta*, sa herë përmendet folja *gatuj* dhe sa herë përmendet ndajfolja *sot*? Pra përveç përmbajtjes e cila shtjellohet në tekst nxënësit mund të ushtrojnë edhe pjesë të gramatikës. As teksti shkollor “*Leximi 4, Gjuhë shqipe dhe letërsi*”,⁶⁴³ tnuak bishtnon komponentët e paraparë në programin zyrtar. Aty gjenden *tekstet letrare dhe jo letrare, shkrimi, leximi, gramatika*. Gjithçka është bërë në përpjekje në funksion të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit. Madje përpjekje për integrimin e gjuhës në situata të ndryshme vërehen kur njohurive që merren për gramatikë, janë përkojnë me komunikimin. (*si te njësinë mësimore “Lakimi i emrave”* (faqe 37). Pjesa tjetër e kësaj njësie mësimore, kryesisht është dhënë në formën tradicionale, pra lakimi i emrave të ndryshëm mashkullor dhe femëror, në njëjës dhe në shumës, në trajtën e shquar dhe të pashquar, është pasqyruar në tabela në formën tradicionale. Kurse te “*Mbiemrat e nyjshëm dhe të pa nyjshëm*”, “në pjesën e ushtrimeve janë dhënë një varg mbiemrash të ndryshëm dhe nxënësit duhet ti ndajnë mbiemrat sipas llojit, pra në mbiemra të nyjshëm dhe të panyjshëm. Në poezinë “*Çerdhet ku nis dashuria apo pak gramatikë*”, nxënësit mësojnë edhe përemrat vector, faqe 80. Pra, në shumicën e pjesëve të ndryshme gramatikore është bërë përpjekje që të bëhet integrimi me tekstet e ndryshme, pra, jo vetëm integrimi i komponentëve gramatikore që janë paraparë në

⁶⁴¹Grup autorësh: *Gjuha shqipe 3*, botimi i pestë, Libri Shkollor, Prishtinë, 2000.

⁶⁴²Grup autorësh: *Gjuha Shqipe 4*, botimi i katërt, Libri Shkollor, Prishtinë, 1999.

⁶⁴³Po aty.

program, por edhe lidhja e tyre me tekste të ndryshme.⁶⁴⁴ Edhe përralla “*Pse hëna nuk ka fustan*”, kërkesa është të dallohen kundrinorët e zhdrejtë pa parafjalë dhe me parafjalë. Si dobësi mund të permendet se pjesa e gramatikës asnjëherë nuk shoqërohet me ndonjë ilustrim apo foto, që do të mund ta bënte më tërheqës mësimin.

Ndërkaq, teksti shkollor “*Gjuha Shqipe dhe leximi 5*”⁶⁴⁵ përmbajtjet janë në përputhje me programin duke përfshirë gramatikën dhe tekstet letrare e joletrare dhe ajo që është kryesorja, teksti shkollor ofron vetëm informacione të domosdoshme, gjë që nuk konsiderohet se i ngarkon nxënësit. Në këtë tekst nuk është bërë lidhja në mes të teksteve letrare dhe gramatikës, ka një shkëputje në mes tyre. Emrat do të mund të mësoheshin të integruar me tekstin: Luani, Dhelpra dhe kafshët e tjera (faqe 78). Mësimi do të kishte filluar me emrat e kafshëve e pastaj gradualisht do kishte bërë krahasime edhe me emra të tjerë. Siç ndodhë edhe me, kohët e foljes (koha e pakryer) do të mund të realizohej së bashku me tekstin joletrar *Gjyshja ime Sevasti Qiriaz* (faqe 153). Meqenëse teksti është shkruar në kohën e pakryer, përmes këtij teksti, përveç informacioneve lidhur me Sevasti Qiriazin, do të mund të mësonin dhe praktikonin edhe përdorimin e foljes në kohën e pakryer. Në njësinë mësimore *Fjalë e thjeshtë*, merren disa shembuj për fjalinë si: *Nxënësi lexon, Nxënësi lexon tregimin, Nxënësi i mirë lexon tregimin me kënaqësi*, kurse përballë këtyre fjalive është vendosur fotoja e një nxënësi me libër të mbyllur. (çuditërisht me libër të mbyllur!).

Kurse në tekstin shkollor “*Leximi 6, Gjuhë shqipe dhe letërsi*”⁶⁴⁶ materia që parashihet në program, është shtjelluar në tekst, me një larmi të teksteve të ndryshme, duke përfshirë, përralla, tregime të ndryshme me përmbajtje të ndryshme, fjalë të urta shqipe, gjëgjëza, poezi, këngë të ndryshme popullore, këngë për lojëra të ndryshme, këngë kreshnike, këngë vaji apo elegji etj, duke përfshirë në të njëjtin tekst edhe anën gramatikore që e vlerwsoj tw pamjaftueshme. Nuk është ndonjë zgjidhje e qëlluar kur në poezinë “*Në parkun e Tiranës*”, faqe 45, pyetjet që janë hartuar për këtë poezi janë jot w qlluara.

Një mosrespektim i programit zyrtar vërehet jo vetëm në emërtimin e tekstit shkollor, por edhe në brendinë e tij të “*Leximi letrar 7*”.⁶⁴⁷ Pjesa gramatikore që është përcaktuar në programin zyrtar nuk është shtjelluar në këtë tekst shkollor. Edhe pse nuk ka program të veçantë për leximin letrar dhe program tjetër të veçantë për pjesën gramatikore, sepse program i përbashkët është emërotuar “*Gjuhë shqipe*” (ku dihet se *Gjuha shqipe në këtë rast përfshinë përfshin gramatikën, fonetikën, leksikun, tekstet letrare dhe jo letrare dhe të gjitha së bashku do të jenë në funksion të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit që janë të dëgjuarit dhe të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit*). Në një detyrë që u jipet nxënësve që fjalët dialektore që janë përdorur në poezinë “*Lidhja e Prizrenit*” e autorit Gjergj Fishta (faqen 20), t’i kthejnë në gjuhën e sotme shqipe, mandej kthimi i fragmentit tregimit “*Ay mal*” u jepet detyrë nxënësve që të kthehet nga gjuha dialektore në gjuhën standarde. Zhvillimi i shkathtësisë së shkrimit hetohen, kur nxënësve u jepet detyrë që të shkruajnë për temën “*Liria dhe dëshmorët*” (në faqen 48), dhe të shkruajnë për temën “*Ajo nuk i harroi stërgjyshërit tanë*” (kushtuar Elena Gjokës), në faqen 69). Nxënësve u jepet

⁶⁴⁴Kjo shihet edhe faqe 180, në njësinë mësimore “*Rrethanori*”, i cili mësohet përmes poezisë “*Ka vetëm një nënë*”, por edhe përmes shembujve të tjerë. Gjithashtu, shihet qartë se pjesa e detyrave luan një rol të rëndësishëm në ushtrimin e gramatikës, siç është dhënë faqe 195.

⁶⁴⁵Grup autorësh: *Gjuha Shqipe 5*, botimi i katërt, Libri Shkollor, Prishtinë, 1999.

⁶⁴⁶Beci, Bahri: *Gjuha shqipe 6*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003. (Ka zëvendësuar tekstin: Grup autorësh: *Gjuha shqipe 6*, botimi i tretë, Libri Shkollor, Prishtinë, 1999.)

⁶⁴⁷Beci, Bahri, *Gjuha shqipe 7*, Dukagjini, Pejë, 2004. (Ka zëvendësuar tekstin: Grup autorësh: *Gjuhë shqipe 7*, botimi i parë, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Kosovë, Prishtinë, 1996.)

detyrë që të shkruajnë nga një letër personale(në faqen 85).Shkathtësitë e komunikimit janë të lidhura aq ngushtë njëra me tjetrën saqë nuk mund të ketë një ndarje në mes tyre. Në të njëjtën kohë dhe për të njëjtën ngjarje mund të zhvillohen të gjitha së bashku. Në këtë tekst shkollor, po ashtu, trajtohen edhe tema me përmbajtje ndërkurrikulare. Si pikë referimi ishte programin zyrtarë i klasës së tetë për hartimin e tekstit, “*Gjuha shqipe 8*”,⁶⁴⁸ i cili nuk ka arrijtë të përfshinë gjithë materien që e parasheh programi. Teksti përfshinë *fushat gramatikë – drejtshkrim, gjuhë e folur dhe e shkruar*, e jo siç e ka programi zyrtar: *të dëgjuarit dhe të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit si dhe gramatikën, e cila do të zhvillohet në funksion të zhvillimit të shkathtësive*. Ky program zyrtar kishte baraspeshën në mes të strukturave gjuhësore dhe funksioneve gjuhësore. Por, gjuha e folur dhe gjuha e shkruar siç i paraqet autori, nuk janë të barabarta me shkathtësitë e të folurit dhe të shkruarit. E veçanta e këtij teksti është se një hapësirë mjaft të madhe i është lënë analizës gjuhësore të teksteve të vjetra shqipe duke i krahasuar ato me gjuhën standarde. Ka mjaftë raste kur nxënësit përvetësojnë gjuhën e sotme shqipe, duke i kthyer tekstet nga dialekti në gjuhën standarde. Te, “*Format veprorë dhe jo veprorë të foljeve*” është realizuar mbi modelin e tekstit, mandej mënyrat e foljes, *kushtore, dëshirorë, habitore, urdhërorë*, janë realizuar mbi modelet e teksteve të zgjedhura etj. Formimi i emrave dhe mbiemrave (*fjalët e prejardhura dhe kompozitat*), mësohen dhe ushtrohen përmes poezisë “*Flutura*” të Asdrenit.

Konkretizimi i mësimin në lëndën e mësimin të gjuhës dhe letërsisë shqipe

Krahas me përsosjen e teknologjisë së punës në çdo lëmë, të jetës dita-ditës po bëhet edhe përsosja dhe modernizimi i procesit mësimor, në shkollat e Kosovës, duke shkuar drejt angazhimit dhe inkuadrimit të të gjitha shqisave të nxënësit në absorbimin e njësive mësimore, në mënyrë që ai të fitojë njohuri sa më të plota, duke lënë mbresa të thella në trurin e nxënësit. Gjer në vitet shtatëdhjeta arsimitarët e gjuhës dhe letërsisë, gjatë zhvillimit të njësive mësimore, si mjete konkretizimi apo të tilla ndihmëse kanë patur vetëm *skicat e ndryshme, vizatimet, si edhe tekstet e lëndës*. Tani ata kanë një fond mjetesh më të mëdha, e së këndejmi edhe mundësi që orën e mësimin ta bëjnë më interesante, duke zhvilluar në mënyrë më bashkëkohore në saje të mjeteve ndihmëse teknike. Arsimitari, i cili me dëshirë ka marrë përsipër këtë detyrë tejet të rëndësishme, respektivisht dhënien e gjuhës dhe të letërsisë amëtare,po i përkushtohen kësaj pune me të gjitha fuqitë e veta fizike, psikike dhe arësimore.

Mësimdhënësit e gjuhës çdo ditë kërkonin më këmbëngulje nga drejtoritë e shkollave një magnetofon, kompjuter, printer me ngjyra, kamerë, fotoaparatur dhe të sigurohet furnizimi me inçizime ku janë të inçizuara njësi mësimore nga kjo lëndë. Gjatë viteve që po trajtojmë janë shfrytëzuar edhe episkopi dhe diaskopi, por në rrethanat e reja bashkëkohore paraqitet nevoja për të ilustruar njësinë mësimore me anë të filmit apo edhe të riprodhimit të fotografive të ndryshme. Arsimitari kërkohej dikur ta kishte edhe një transistor, sidomos nëse shkolla gjendej në fshat, sepse këto mjete shërbenin shumë për ta zhvilluar mësimin në mënyrë më bashkëkohore. Arsimitari të gjitha këto mjete i vendoste në vitrinë, e cila lypsej të ishte në dhomën e mësimin, respektivisht në kabinetin e gjuhës shqipe ose së paku mund t’i vendoste edhe aty ku mbante bibliotekën e shkollës. Mësimdhënësit e gjuhës dhe letërsisë shqipe kishte raste kur kishin ngritur edhe

⁶⁴⁸Beci, Bahri, *Gjuha shqipe 8*, Dukagjini, Pejë, 2006.(Ka zëvendësuar tekstin:Grup autorësh: Leximi letrar 8, botimi i tretë, Libri Shkollor, Prishtinë, 1999)

kabinetin e vet, kuptohet në shkollat e plota fillore dhe në ato të mesme. Ky kabinet kërkohet të ishte i përshtatshëm edhe për dhënien e filmave, gjegjësisht të ketë mundësi teknike në dritare për ta errësuar klasën në rast nevojë, gjegjësisht kur lypset përdor diaskopin apo episkopin .⁶⁴⁹ Në Kosovë ishte ndjekur politikë e veçantë diskriminuese edhe në financim të arsimit, andaj në lëminë e gjuhës dhe e letërsisë, konkretizimi i mësimi ishte pak më i varfër. Por, me kreativitetin e mësimdhënësve dhe vetëinciativën, por edhe me angazhimin e disa drejtuesve të arsimit të KSAK është,, *kompensuar*“ disi me shfrytëzimin e mundësisë që një sasi mjeteve mësimore është importuar nga Shqipëria, meqë dhënia e mësimi në mënyrë bashkëkohore i kërkonte këto gjëra. *Në Shqipëri nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit janë inçizuar disa filma shkollor, që kanë të bëjnë me biografite madje dhe veprimtarinë letrare të disa shkrimtarëve, si edhe filma nga lëndët tjera, p.sh: filmi shkollor mbi jetën dhe veprimtarinë e Migjenit etj.* Nga kjo del domoshmëria që tashmë pas shembjes së kufijve organet tona arsimore të angazhohen për importimin e filmave të tillë shkollor madje dhe pllakave të gramafonit, derisa Kosova të themelojmë një Institut të veçantë, i cili do të prodhojë mjete të tilla në Kosovë.

⁶⁴⁹Gjatë vizitave studimore të bërë në shkollat e ish-republikave të RSFJ-së jam ndjerë i impresionuar me nivelin e zhvillimit të mësimi dhe me përdorimin e mjeteve mësimore, e cila gjë edhe ishte e mundur sepse mësimi zhvillohej nëpër kabinete të cilat i posedonin ata.

KREU I GJASHTË

HARTIMI I TEKSTEVE TË GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË

6.1. Historia e librit shkollor në Kosovë

6.1.1. Qasja metodologjike për hartimin e një teksti cilësor shkollor

6.1.2. Funkcionet e tekstit mësimor të gjuhës shqipe në rrethanat e kohës

6.2. Historiku i hartimit të teksteve mësimore të gjuhës shqipe dhe letërsisë, 1886 – 1943

6.3. Tekstet e gjuhës shqipe deri në vitin 1945

6.4. Tekstet e letërsisë -Libri i leximit, 1945 - 2014

6.4.1. Funkzioni i teksteve të gjuhës dhe letërsisë në formësimin atdhetar të nxënësve

6.5. Vendi dhe roli i teksteve të gjuhës dhe letërsisë shqipe nga viti 1945 deri në vitin 1961

6.6. Tekstet shkollore në vitet 1962 – 1969

6.7. Tekstet e gjuhës shqipe në vitet 1970-1991

6.8. Hartimi i teksteve shkollore të gjuhës shqipe të viteve '90

6.9. Tekstet e gjuhës shqipe në vitet 1992-2000

6.1. HISTORIA E LIBRIT SHKOLLOR NË KOSOVË

Libri është një dije njerëzore e konservuar që e informon njeriun në çdo kohë për çdo kohë. Vështruar nga këndi evolutiv dhe ai specifik libri (teksti shkollor) gjatë gjithë historisë së paraqet përjetim, jo vetëm për ata që merren me hartimin e shkrimit e librave shkollorë dhe letrarë, por edhe për të gjithë ata të cilët i lexojnë librat. Nga dijetarët, vlerësohet se libri është një ndër zbulimet më të mëdha njerëzore. “Teksti, përkatësisht libri mësimor, krahas zhvillimit dhe përsosjes didaktike të punës mësimore, ka pasur ndryshime si në pikëpamje të mbarështimit të lëndës, ashtu edhe të zgjedhjeve teknike”.⁶⁵⁰ Libri ka hapur të gjitha dritaret e portat për të depërtuar dritën e diturisë mbi errësirën e shekujve. Historia e librit të shqiptarët është e lidhur ngushtë me fatet e historisë tonë kombëtare nga thellësitë e shekujve. Teksti mësimor është një lloj libri i vecantë “Libri është e pamundur të definohet” dhe “...askush deri tash nuk ka arritur të japë definicionin e plotë dhe të përhershëm të librit.”⁶⁵¹ anë dy nga nocionet më të qëndrueshme në raport me shpjegimin e nocionit të librit shkollor. Historia e lindjes së tekstit shkollor dhe historia e lindjes së shkollës është e përbashkët dhe kanë të njëjtën moshë të vjetërsisë. Themelimi i shkollave të para, në mënyrë institucionale, kudo por edhe tek shqiptarët shtroi nevojën e hartimit të teksteve shkollore, të cilat ishin të ndërlidhura me fatet e sistemeve shkollore. Tekstet shkollore në sistemin tradicional të mësimdhënësve, mëtonin të kenë rolin udhëheqës në procesin e ndërlidhur të mësimdhënies, ku nxënësit kishin rol pasiv, ishin objekt veprimi në mësimdhënie. Burimi i vetëm i mësuesit ishte teksti shkollor, siç ishte edhe për nxënësin i vetmi burim i informativ. Përkitazi me nocionin “tekst shkollor” ekzistojnë përkufizime të shumta, madje, ka mendime të ndryshme edhe për vetë këtë nocion: “tekst shkollor” apo “tekst mësimor”. Çështjen e përcaktimit (përkufizimit) të tij e vështirëson natyra komplekse e llojit dhe funksionit të tij. Por, pa u ndalur në ndonjë analizë të thellë, konstatojmë se teksti shkollor “është libër shkollor themelor dhe i obligueshëm që shërben si mjet themelor dhe burim i diturisë për fushën e caktuar mësimore. Teksti mësimor është i punuar në bazë të planit dhe programit mësimor dhe i formësuar në pikëpamje didaktike duke marrë parasysh aftësitë psikofizike të nxënësve, specifikat e lëndës mësimore, llojin e shkollës, shkallën dhe profilin e arsimit. Nxënësit e përdorin tekstin mësimor në të gjitha etapat e procesit mësimor dhe në vetëarsimimin e përditshëm”⁶⁵² Sipas tekstologëve, tekstet shkollore të gjuhës e letërsisë shqipe (Abetarja, librat e leximit, gramatikat), karakterizohen përmes dy periudhave të mëdha kohore: e para, deri më 1945 dhe e dyta, 1945 e deri më sot. Periudha e parë, karakterizohet me tekste të pakta shkollore ⁶⁵³. Me sa dihet deri sot, N. Veçilharxhi është autori i librit të parë shkollor, përkatësisht i abetareve të para shqipe⁶⁵⁴. Ndërsa, prej librave të leximit, janë të njohura librat e Ndre Mjedjes dhe Anton Xanonit, Këndime për shkollë të para të Shqipërisë

⁶⁵⁰ Nijazi Zylfiu, *Didaktika*, Prishtinë 2001, fq. 392.

⁶⁵¹ Robert Escarit, *Revolucia knjige*, Prosvjeta, Zagreb, 1972, f.13.

⁶⁵² Abdyll Ramaj, *Formësimi didaktik i lëndës mësimore*.tem e doktoraturës (dorëshkrim), Prishtinë, 1998, fq.29.

⁶⁵³ Shih më gjerësisht, Jashar Rexhepagiq. *Teksti dhe literature tjetër shkollore në gjuhën shqipe në të kaluarën*, Libri shkollor, Buletin i ETMM i KSAK, Prishtinë, 1971, nr.1, fq.57-65.

⁶⁵⁴ Hajrullah Koliqi, *Vepra dhe idetë pedagogjike të Naum Veçilharxhit*, Buletin i F.F. të U.P., Prishtinë, 1989, nr. XVIII – XIX, fq.181.

Shih edhe Kujtim Bevapi, *Meditimi pedagogjik mbi abetaret shqipe*, “Onufri“, Tiranë, 1996, fq.17.

(libri I, II, II, Vjenë, 1902, 1908) të cilat kanë qenë në përdorim deri në vitin 1918 ndërsa në shkollën fillore të Prizerenit edhe më vonë”.⁶⁵⁵ Periudha e dytë (1945 e këndej) është e frytshme në këtë drejtim sidomos, pjesa e dytë e këtyre viteve. Pas Luftës së Dytë Botërore, teksti i parë që u botua në gjuhën shqipe në Kosovë është Abetarja për të rritur (në Prizren më 1946), ndërsa abetarja e parë shqipe për klasën e parë të shkollës fillore është ajo e autorëve, Stathi Kostari, Jani Gjino dhe Mehmet Gjevori (e botuar në Beograd, më 1947). Këto ishin “dy margaritarët e parë, dy dritaret e para të dijes, dy kandilat e parë, dy shkëndijat e para të teksteve tona shkollore”⁶⁵⁶. Ndërsa, libri i parë i leximit, i hartuar nga autorë shqiptarë në Kosovë është ai i autorëve, Zeheria Rexha, Memhmet Gjevori, Stathi Kostari, Jani Gjino, Libër leximi për klasën e dytë të shkollës fillore, (botuar më 1948, në Beograd). Kurse, Gramatika e parë e hartuar nga autorë shqiptarë është ajo e Tajar Hatipit dhe Hasan Vokshit, për klasën e IV të shkollës fillore (e botuar më 1949). Këto pra, janë tekstet e para shkollore të gjuhës e letërsisë shqipe për klasat e ulta të shkollës fillore në Kosovë e që më vonë pasohen me të tjera. Por, përgjithësisht, në vitet 1945 – 1974 kishte shumë pak tekste të autorëve shqiptarë, këtë etapë e “veçon e vërteta se tekste origjinale nuk kishte aq sa duhet. Në këto vite, ndikuar dhe imponuar nga rrethana të kohës . . . nxënësi shqiptar ka në dorë kryesisht tekste të përkthyer nga gjuhët sllave.”⁶⁵⁷ Ndërsa, që nga 1970-ta , tekstet shkollore për shkollën shqipe veçmas për mësimin e gjuhës e letërsisë shqipe janë ekskluzivisht të autorëve shqiptarë. Kjo, padyshim është meritë e veteranëve të arsimit (M. Gjevori, S. Kostari, J. Gjino, S. Kolgeci, K. Shpendi, T. Hatipi etj.), të cilët “arritën që tekstin origjinal shqip ta vënë në binarë të shëndoshë me qëllim që i njëjti të përmbushë kriteret themelore të tekstit bashkëkohor. Këtë e bënë me qëllim që t’u ndihmonin nxënësve, sa në ngritjen e suksesit aq edhe në formësimin dhe në forcimin e vetëdijësimin kombëtar.”⁶⁵⁸ Tekstet shkollore të gjuhës e letërsisë shqipe (I – IV) përmbajnë krijime (pjesë të zgjedhura të zhanrëve të ndryshme, të krijuesve të ndryshëm përmes të cilave sendërtohen funksionet edukative – arsimore të mësimin të kësaj lënde.) Këtë funksion e përmban edhe teksti i parë shkollor, Abetarja, me anë të secilës nxënësi hyn në botën e re të mënyrës së përvetësimit të njohurive e të komunikimit ndërnjerzor. Mirëpo, në dallim nga tekstet tjera shkollore, përmbajtjet mësimore që shtjellohen në Abetare, për shkak të aftësive - psikofizike të fëmijëve, karakterizohen me thjeshtësinë maksimale. Kështu, “një ngjarje që në tekstet e tjera duhet të përshkruhet gjerësisht, në abetare duhet të thuhet vetëm me disa fjalë ose fjali të thjeshta.”⁶⁵⁹ Për shkak të specifikave, në Abetare zënë vend relativisht të madh ilustrimet dhe fotografitë, të cilat për këtë moshë janë mjaft impulsive dhe së bashku me pjesët e zgjedhura tekstuale ofrojnë mundësi edhe për edukimin e vlerave kombëtare.

Edhe tekstet shkollore të gjuhës (Gramatikat) për shkak të rrethanave të Kosovës (krahas përmbajtjeve mësimore gramatikore nga fonetika, morfologjia, sintaksa) dhe shprehive gjuhësore ato ofrojnë më pak mundësi (krahasuar me librat e leximit) për realizimin e funksionit edukativ kombëtar. Megjithatë, ky funksion rritet nga klasa në klasë si rezultat i ndryshimeve të aftësive fizike, psikike e linguistike të nxënësve. Tekstet shkollore të gjuhës (gramatikat) krahas mësimore gramatikore përmbajnë edhe ilustrime letrare, fragmente, shembuj

⁶⁵⁵ Jasar Redzepagic, *Citanke i citaonice na Kosovu*, Libri shkollor, Buletin i ETMM i KSAK, Prishtinë, 1985, nr.2, fq. 142.

⁶⁵⁶ Mehmet Gjevori, *Si u hartuan dhe si u pritën dy abetaret e para*, Libri shkollor, Buletin, 1998, nr. 1-2, fq.12.

⁶⁵⁷ Ali Lllunji, *Vështirësitë dhe kontributi i disa veteranëve të arsimit në Kosovë në përshtatjen*, në përkthimin dhe në hartimin e tekstit shkollor (1945 - 1970). Buletin i Librit shkollor, Prishtinë, 2000, nr.1, fq.31.

⁶⁵⁸ Po aty, fq.37.

⁶⁵⁹ Beqir Berisha, *Disa aspekte të abetares*, Libri shkollor, Buletin i ETMM i KSAK, Prishtinë, 1973, nr. 1-2, fq.89.

etj. Përmes të cilave mund të sendërtohet edhe funksioni edukativ dhe qëllimi i edukatës kombëtare. Kundrejt Abetares dhe Gramatikave, Librat e leximit me përmbajtjet e tyre ofrojnë mundësi më të shumta për realizimin e finalitetve dhe objektivave të mësimit të gjuhës e letërsisë shqipe. “Libri i leximit ka ndikim të gjerë, të shumëanshëm në edukimin dhe arsimin e nxënësve, në formimin si personalitet . . . Ai shërben për formimin e kulturës letrare dhe gjuhësore dhe për zhvillimin e aftësive shprehëse të nxënësit.”⁶⁶⁰ Roli i tij është i madh veçmas në klasat e ulëta të shkollës fillore. Përmbajtjet e caktuara programore nga letërsia që reflektojnë dashurinë ndaj gjuhës, traditës, atdheut etj., në mësimin e gjuhës e letërsisë shqipe përpunohen e realizohen në formën më të përshtatshme përmes librit të leximit. Përmbajtjet e tilla si dhe të të gjitha zhanreve duhet, prandaj, të zgjidhen me kujdes sepse “prej tyre në masë të madhe varet sendërtimi i kualitetit të mësimit të letërsisë”⁶⁶¹ si asaj kombëtare ashtu edhe asaj botërore. Gjatë punës kërkimore janë hasur në një sërë përkufizimesh për tekstet mësimore. “Teksti mësimor është mjet ndihmës në mësim që i shërben qoftë arsimtarit për përgatitje qoftë nxënësit për përsëritje gjatë mësimit.” Pra sipas këtij mendimi teksti shkollor nuk del si “mjet kryesor”. Që të kuptohet roli dhe misioni i teksteve shkollore në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, po përmendim disa nga përkufizimet më të zakonshme lidhur me nocionin e tekstit mësimor.⁶⁶²

Teksti mësimor është mjet mësimor ndihmës...

Teksti mësimor parashtron... dituritë...

Teksti mësimor është libër...parashtron bazat e diturisë shkencore...

Tekstet mësimore janë libra themelorë shkollorë...

Manuali shkollor është libër i destinuar për nxënës...

Teksti mësimor është burimi themelor shkollor...

*Teksti shkollor është dokument shkollor.....*⁶⁶³

Të gjitha këto përcaktime i japin tekstit mësimor atributin e mjetit mësimor, ose mjeti ndihmës mësimor, ndërkaq destinimi i testeve shkollore bëhet për nxënësin, herë drejtpërdrejtë e herë tërthorazi. Pra, teksti mësimor në radhë të parë krijohet për nxënësin, si burim themelor për nxënien e diturive, por edhe për zhvillimin e aftësive. Prandaj, teorikët e teksteve pajtohen se teksti shkollor është dokument në të cilin shtjellohen përmbajtjet programore për lëndë të caktuara mësimore, duke ua përshtatur nivelit dhe moshës së nxënësve.

6.1.1. Qasja metodologjike për hartimin e një teksti cilësor shkollor

Një tekst cilësor mësimor, përveç përmbajtjes mësimore për lëndën mësimore dhe klasën përkatëse, pasqyron edhe qasjen metodologjike, me qëllime, objektiva dhe standarde të qarta. “Me standarde në arsim kuptojmë kritere, apo një sërë kërkesash për të vlerësuar cilësinë; cilësinë e asaj se çka nxënësit dinë, kuptojnë dhe çka janë në gjendje të bëjnë; cilësinë e

⁶⁶⁰ Marko Maskovic, *Osvrt na koncepciju i primjenu citanka za I – IV razred osnovne škole*, “ Vaspitanje, obrazovanje ”, Titograd, 1986, nr.3, fq.38-39.

⁶⁶¹ Ugleska Kisic, *Knjizevnoteorijsko i metodicko – didacticke postavke programskih sadrzaja knjizenosto*, Zbornik Institua za Pedagoska istrazivanja, Beograd, 1993, nr.25, fq.181.

⁶⁶² Lexikon der padagogik, Bern, 1951, f.131.

⁶⁶³ Abdyl Ramaj, “*Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor,*” (Disertacioni i doktoraturës i botuar pas vdekjes se autorit), Libri Shkollor, Prishtinë, 2001, f.43.

programeve arsimore; cilësinë e mësimdhënies, cilësinë e ndihmës që sistemi i arsimit u ofron mësuesve, cilësinë e programeve mësimore dhe cilësinë e praktikave të vlerësimit.”⁶⁶⁴ Autorët kishin në konsideratë që tekstet shkollore të bazohen në programe mësimore. Tekstet mësimore, “janë çështje fundamentale për edukimin, sepse shqetësimi ynë është se si t’i organizojmë njohuritë”.⁶⁶⁵ Sepse, “...të mësosh nuk do të thotë vetëm të pranosh informacione, por gjithashtu e sidomos të trajtosh informacione”.⁶⁶⁶ Tekstet shkollore në Kosovë janë mbështetur në strategji të ndryshme të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Për një tekst shkollor të mirë shkollor, autorët duhej që:

- të nxisin motivimin e nxënësve për të mësuar;
- të sigurojnë material që nxënësi të mund të punojë pavarësisht;
- të kenë parasysh aftësitë psiko-fizike të nxënësve;
- të përdorin një gjuhë të pastër, të pasur dhe korrekte;
- të formulojnë fjali të qarta dhe të kuptueshme për nxënësit;
- të kursejnë përdorimin e fjalëve të huaja të panevojshme;
- të sigurojnë aktivitete dhe punë grupore;
- të sigurojnë zhvillimin e shkathtësive të komunikimit;
- të sigurojnë zhvillimin e diturisë, shkathtësive dhe të qëndrimeve;
- të kenë udhëzime për burime të ndryshme të informacioneve;
- të sigurojnë qasje të integruar dhe të orientojë nxënësin për të mësuar gjatë gjithë jetës;
- të sigurojnë detyra, shembuj dhe ilustrime të tilla që ndihmojnë në zhvillimin e imagjinatës, kreativitetit dhe të pavarësisë.

6.1.2. Funkcionet e tekstit mësimor të gjuhës shqipe në rrethanat e kohës

Vështruar nga këndi gjenetik fjala e “mësimdhënësit” është shumë më e vjetër se fjala e shkruar e shtypshkronjës së Guttembergut (1438). Si burime të dijes të dyja kanë rëndësitë specifike. Tekstet shkollore në gjuhën shqipe (abetaret, gramatikat dhe librat e leximit) nuk kanë ndonjë traditë të gjatë, sepse vetë gjuha shqipe, edhe pse dokumentohet se është ndër gjuhët më të vjetra në Ballkan, është e dokumentuar si e shkruar tepër vonë (shekulli XV). Për shkak të rrethanave historike, tekstet shkollore dhe në përgjithësi libri shqip ishte i ndjekur përherë nga pushtuesit të cilët në Kosovë, për dymijë vjet ndërroheshin njëri pas tjetrit (Perandoria Romake, Perandoria Osmane, okupimi nga Serbia dhe nga ish-Jugosllavia, etj.)

Kështu, deri në vitin 1946 në Kosovë nuk kemi gjurmë se është botuar ndonjë tekst shkollor në gjuhën shqipe. Pas disa abetareve (të rralla) tekstet e para shkollore në gjuhën shqipe për shkollat laike në Kosovë janë hartuar prej vitit 1946. “Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945 në Prizren ishte formuar Komisioni Pedagogjik i Drejtoratit Arsimor për Kosovën, i cili kishte për detyrë në mes të tjerash të përgatiste tekste në gjuhën shqipe për edukimin dhe arsimin fillor. Në këtë vit në edukimin dhe arsimin fillor ishin përfshirë 11.573 nxënës, kurse në arsimin e mesëm 1.456 nxënës.”⁶⁶⁷

⁶⁶⁴ Isuf Zeneli, *Bazat e standardizimit dhe vlerësimit në arsim*, Libri shkollor, Prishtinë, 2002, fq. 9.

⁶⁶⁵ Morin, Edgar, *Seven complex lessons in education for the future*, Unitet Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO), Paris, 1999, fq. 13.

⁶⁶⁶ Mabieu, Pierre, *Travailler en Équipe*, Hachette, Paris 1992, fq. 111.

⁶⁶⁷ Grup autorësh, *Arsimi i Kosovës në shifra e fakte*, Prishtinë, 2000, f.169.

Kështu, këta nxënës shqiptarë, në vitin shkollor 1945/46 nuk kishin asnjë tekst në gjuhën shqipe të botuar në Kosovë, duke u siguruar një numër shumë të vogël që siguroheshin nga Shqipëria. Dihet se simbol për fillimin e shkollimit për çdo fëmijë është Abetarja, që ishte teksti i parë i botuar në gjuhën shqipe në Kosovë, e cila doli nga shtypi në vitin 1946.⁶⁶⁸ Abetarja (e dytë) është botuar në vitin 1947 e cila ishte përdorur në vitin shkollor 1946/47. Nga viti 1950 deri në vitin 1958 tekstet shkollore në gjuhën shqipe për Kosovën janë botuar në Ndërmarrjen botuese “Mustafa Bakija” në Prishtinë dhe në Ndërmarrjen botuese “Milladin Popoviq”, ndërsa prej vitit 1958 deri në vitin 1961 tekstet në gjuhën shqipe janë botuar në NGB “Rilindja”. Prej vitit shkollor 1945/46 deri në vitin shkollor 1961/62 në ndërmarrje dhe Shtypshkronjat e Kosovës janë botuar 364 tituj tekstesh shkollore.⁶⁶⁹ Nga të gjithë këta tituj, në gjuhën shqipe ishin vetëm abetarja dhe tekstet e gjuhës shqipe (si lëndë mësimore), kurse të gjithë të tjerët ishin tekste të përkthyer nga gjuha serbe, të cilat botoheshin në Entin e Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Serbisë në Beograd. Me insistimin e strukturave udhëheqëse shqiptare të Kosovës, në vitin 1962 në Prishtinë hapet paralelja e Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Serbisë në Beograd. Por, pas kërkesave të shumta, prej vitit shkollor 1962 deri në vitin 1969 (një vit para pavarësimit të Entit) në Prishtinë. Kjo paralele e ndarë kishte botuar gjithsejt 464 tituj tekstesh shkollore (duke mos llogaritur lekturën shkollore dhe tekstet e tjera -doracakë etj.). Prej tyre për nxënës të edukimit dhe të arsimit fillor 241 tituj dhe 223 për nxënës të arsimit të mesëm.⁶⁷⁰ Funkcionet kryesore didaktike të teksteve shkollore të pas Luftës së Dytë, përherë kishin karakterin e tyre dhe funksionin informues, drejtues, stimulus, racionalizues, aplikativ dhe edukativ e patriotik.⁶⁷¹ Nga viti 1997 Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore pagëzohet me emërtimin Shtëpia Botuese “Libri Shkollor”,⁶⁷² dhe hapen horizonte të reja për tekstin në gjuhën shqipe. Tashmë kishte filluar punën pas themelimit Universiteti i Prishtinës, kur nis edhe të krijohen kuadro të përgatitura shkencore e mësimore në gjuhën shqipe. Kështu, krahas rritjes së Universitetit, rritet edhe cilësia e punës krijuese, kërkimore e shkencore –mësimore dhe shtohet numri i teksteve origjinale në gjuhën shqipe. Vendin e teksteve të përkthyer gjatë viteve 1970 dhe 1979 e zënë tekstet origjinale.⁶⁷³

Pas demonstratave të studentëve dhe “Pranverës studentore të rinisë shqiptare,” në vitet ‘81-të për tekstet në gjuhën shqipe sërish rivendoset një censurë më të theksuar, sidomos për tekstet mësimore të historisë, të artit, të gjuhës e letërsisë, të gjeografisë etj. Nga viti 1981 ndaj librit shqip është udhëhequr një politikë me elemente etnocidi dhe botimet vështroheshin me llupën e ideologjisë së partisë në pushtet! Plenumi të ndryshme partiake urdhëruan që nga

⁶⁶⁸ Kjo Abetare ishte hartuar sipas Planit dhe programit mësimor për arsimin e të rriturve të vitit 1946.

⁶⁶⁹ Po aty, f.171.

⁶⁷⁰ Vështruar nga këndi statistikor edhe pse në dukje numri i përgjithshëm i teksteve në gjuhën shqipe kishte shënuar rritje, kishte shumë pak libra të autorëve shqiptarë. Tekste origjinale ishin vetëm 62 tekste apo 13,36 për qind, ndërsa 405 tekste apo 86,64 për qind e teksteve të tjera ishin të përkthyer nga gjuha serbe. Ky raport i autorëve shqiptarë me ata të përkthyer ndryshonte sipas niveleve të arsimit. Në edukimin dhe arsimin fillor prej 241 titujve, të autorëve shqiptarë nga Kosova ishin 49 tekste apo 20,33 për qind, kurse në arsimin e mesëm prej 223 titujve, të autorëve kosovarë - shqiptarë ishin 13 tituj apo vetëm 5,83 për qind.

⁶⁷¹ Abdyl Ramaj, “Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor,” Libri Shkollor, Prishtinë, 2001. f.96.

⁶⁷² Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore të KSAK është themeluar, si institucion i pavarur, ishte themeluar më 28 mars të vitit 1970. Ky institucion me veprimtarinë e tij botuese bëri kthesa të mëdha vendimtare në edukimin dhe në arsimin e nxënësve shqiptarë të të gjitha niveleve në Kosovë, meqë deri në vitin 1970, gati të gjitha tekstet botoheshin më parë në Beograd, ndërsa në shkollat shqipe, në trojet e ish-Jugosllavisë arrinin të përkthyer nga autorë të huaj, nga serbët dhe malazezët.

⁶⁷³ Vepra e cituar, f.174.

bibliotekat e shkollave fillore dhe të mesme të menjaherë të gjithë titujt që në çfarëdo mënyre kishin ndonjë lidhje me Shqipërinë, siç ishin hequr edhe përmbajtje të shumëta mësimore nga gjuha shqipe, të cilat “glorifikonin të kaluarën”. Çuditërisht ishte urdhëruar për t’u hequr edhe mjetet mësimore të cilat ishin importuar nga Shqipëria. Inkuzicionistët e rinjë serbë, këta libra apo harta nga lokalet shkollore i dërguan në Fabrikën e përpunimit të letrës (Lipjan) i futën nën dry në ndonjë bodrum apo tavan të shkollave apo edhe përfunduan në turrën e druve! Sidoqoftë, kjo periudhë (1980-1989) kishte përmirësuar raportin në mes të teksteve origjinale të hartruara nga autorët shqiptarë të Kosovës me ato të përkthyer nga gjuha serbe, në favor të autorëve shqiptarë. Tekstet mësimore në këtë kohë kishin shënuar avansim të përmbajtjeve dhe parimeve të formësimit të përmbajtjeve, sepse ato tashmë bazoheshin në parimet bashkëkohore, si: Parimi i mbështetjes shkencore, i diferencimit dhe individualizimit, përshtatshmërisë, shtjellimit sistematik, aplikshmërisë së diturive, përjetimit dhe parimi i interesit.⁶⁷⁴ Tekstet shkollore realizojnë funksione të ndryshme dhe të shumta. Libri për nxënësit realizon funksionet e veta, si: (funksioni i transmetimit të dijeve), por ai realizonte edhe funksione të tjera edhe të mësimdhënësi, në funksionin e ngritjes shkencore, të organizimit të mësimin, integrimin e njohurive të nxënësve e funksione të tjera, e jo thjesht bartjen e informacionit. Në literaturën e tekstologjisë i gjejmë të përmenden këto funksione të tekstit shkollor:

Transmetimi i njohurive
Zhvillimi i aftësive dhe kompetencave
Përforcimi i njohurive
Vlerësimi i njohurive
Ndihmë në integrimin e njohurive
Referenca
Edukimi social e kulturor.

Prej vitit 1989 e deri në vitin 1997, janë botuar tekste dhe mjete mësimore vetëm në gjuhën shqipe.⁶⁷⁵ Gjatë gjithë kohës paraprake, tekstet mësimore u ndikuan nga didaktika jugosllave. Te këto tekste shkollore që përdorëshin në shkollat e Kosovës, krahas funksioneve tjera të përcaktuara në literaturën për formësimin didaktik i gjejmë edhe funksione të tjera, si:

Funksioni informativ,
Funksioni drejtues,
Funksioni stimulatv,
Funksioni racionalizues,

⁶⁷⁴ Abdyl Ramaj, “Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor,” Libri Shkollor, Prishtinë, 2001. f.128.

⁶⁷⁵ Grup autorësh, Arsimi i Kosovës në shifra e fakte, Prishtinë, 2000, f.169. (Në edukimin dhe arsimin fillor ishin botuar gjithsej 616 tituj, prej tyre tekste origjinale të autorëve shqiptarë ishin 499 sosh apo 81,00 për qind, kurse të përkthyer ishin 117 tekste apo 20,00 për qind. Në këtë periudhë për arsimin e mesëm ishin botuar gjithsej 215 tituj të teksteve. Prej tyre tekste origjinale ishin 103 sosh apo 47,91 për qind, kurse të përkthyer ishin 112 tekste apo 52,09 për qind.) Ndërkaq, nga viti 1970-79, arrin botimi i 492 titujve të teksteve shkollore, prej tyre 220 tituj ishin origjinalë apo 44,72 për qind, kurse të përkthyer ishin 272 tituj apo 55,28 për qind. Në arsimin e mesëm ky raport ishte po ashtu në favor të teksteve të përkthyer. Prej gjithsej 244 titujve të teksteve të botuara për herë të parë, të përkthyer ishin 190 tekste apo 77,87 për qind, kurse tekste origjinale ishin 54 sosh apo 22,13 për qind. (Në vitin 1991 përjashtohen nga procesi i punës rreth 150.000 punëtorë shqiptarë. Në të gjitha organizatat punuese, në institucionet arsimore e shkencore janë zbatuar masat e dhunshme.)

Funksioni aplikativ
*Funksioni edukativ.*⁶⁷⁶

Teksti mësimor ndikon në përmbush disa funksione. Thelbi i mesazheve, në çdo tekst mësimor të gjuhës dhe letërsisë shqipe ishe duke filluar nga funksioni njohës (gnosologjik), psikologjik e didaktik. Krahas ofrimit të njohjeve të tjera, të reja, tekstet ndihmonin edhe në udhëzimin e nxënësve për punë të pavarur. Tekstet përmbanin zgjidhje didaktike-metodike dhe ilustrative-grafike që t'i motivonin nxënësit dhe kërshërinë e tyre intelektuale për t'i përjetuar jo vetëm emocionalisht, por edhe intelektualisht përmbajtjet mësimore. Tekstet shkollore në Kosovë përherë janë përshtatur me politikat dhe me qëllimet e sistemit arsimor.⁶⁷⁷ Disa nga funksionet e para që lidhen me nxënësin janë funksione tradicionale. Por nga tipologjia tekstet shkollore, si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit kishte tekste të tipit të hapur dhe të mbyllur. Libri i tipit të mbyllur është i domosdoshëm dhe i dobishëm, atje ku niveli i mësuesve është relativisht i ulët...., kurse libri i tipit të hapur, përkundrazi, zhvillon pavarësinë e mësuesit dhe duhet të preferohet në të gjitha ato raste, ku niveli i mësuesve është mesatar ose i mirë.⁶⁷⁸ Roli i botuesve ishte ndikues në hartimin e teksteve shkollore të pjesa tekstuale, mënyra e ilustrimeve, raportit tekst - ilustrim, llojet e ilustrimeve që duhet të përdoren dhe vendi i tyre në tekste mësimore, sidomos ato të gjuhës dhe letërsisë shqipe.

⁶⁷⁶ Abdyl Ramaj, Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor, Prishtinë 2001, fq. 96.

⁶⁷⁷ François – Marie Gerard, Xavier Roegiers, Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore, botimi në shqip nga Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2002, fq. 53.

⁶⁷⁸ Po aty, fq. 98-99.

6.2. HISTORIKU I HARTIMIT TË TEKSTEVE TË GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË, 1886 – 1943

Është një traditë mbi njëqindvjeçare e hartimit të teksteve shkollore për nevoja të nxënësve shqiptarë të shkollës shqipe, në veçanti e hartimit dhe e botimit të librave të leximit, një nga llojet e teksteve shkollore që ishte fundamental në kuptimin arsimor e metodik, për zhvillimin e gjuhës shqipe, përkatësisht mësimin e shkrim-leximit dhe të komunikimit në gjuhën shqipe. Kjo traditë u bë frymëzim për pasardhësit, duke qenë libri i leximit i një rëndësie të veçantë në traditën e zhvillimit të shkollës e të gjuhës shqipe. Një nismë për një bibliografi të librave të leximit, që nga njësia e parë e njohur e deri te librat e leximit të vitit 1943, që historikisht përfshin periudhën e Rilindjes Shqiptare, atë të Pavarësisë së Shqipërisë dhe të përpjekjeve për konsolidimin e shtetit shqiptar, si dhe të përpjekjeve kulturore e politike të shqiptarëve të Kosovës e të shqiptarëve që kanë jetuar të ndarë edhe nëpër republikat e ish-Jugosllavisë e ka bërë studiuesja e re B.Haliti, një punonjëse e vyer e Bibliotekës Kombëtare. Ky studim përfshin të gjitha librat e leximit të nivelit shkollor të mesëm e fillor, nga libër leximi i pari, i Naim Frashërit “E këndimit çunavet: këndonjëtoreja” (1886), e deri te libri i fundit i kësaj periudhe të përfshirjes- “Libër Leximi për kursin e naltë të Shkollave të Mesme”, mbledhur dhe u punuar nën kujdesin e Ernest Koliqit nga Aleksandër Xhuvani, Karl Gurakuqi, Kolë Kamsi dhe Eqrem Çabej, e botuar në Tiranë, më 1943 nga Ministria e Arsimit e asaj kohe, që paraqet fundin e një periudhe të shtetit shqiptar, një traditë e kulturës së hartimit dhe të botimit të librave të leximit, që përfshin një periudhë afër 60 vjeçare⁶⁷⁹

Libra të leximit janë të botuar në vende të ndryshme, si: Stamboll, Bukuresht, Vjenë, ndërsa libri i parë i botuar në Shqipëri është Jetëshkrimi i Konstandin Kristoforidhit: rreshtuar në gjuhë të përbashkëme dhe në mënyrë që të përdoret në rent të parë të mësimorevet të dyta / prej Simon Shuteriqi, të botuar në Elbasan dhe Manastir në vitin 1911. Në kërkim të teksteve shkollore të botuara në traditën e arsimit shqip, si libër leximi (nga katalogët e ndryshëm si libër i parë leximi për shkolla është identifikuar “Këndime për shkollat e para” nga Naim Frashëri e botuar në vitin 1886). Deri në fund të Luftës së Dytë Botërore që paraqet përmbyllje të një periudhe kulturore e politike, për të nisur një tjetër, kemi hasur në libra të leximit me tituj të ngjashëm por të dallueshëm, që tregojnë dedikimin në funksion të një libër leximi, si: Kendime për çunat; Libri i knnoitorës shcypé; Vjersha për mësonjëtoret të para; Knnimé t’para per msoitoré filltaré t’Shcypniis; Këndime për reshtatë filltare; Këndime për shkollat e para; Librat e para për çunat; Librat për çunat dhe për gocat etj. Mati Logoreci,⁶⁸⁰ në Kosovë njihet si didakt dhe autor i parë tekstesh në Kosovë. Ai punoi gjatë për Kosovën, si pedagog i çmuar më pas e bëri të njohur e të nderuar për zhvillimin historik të arsimit e të shkollës në Veri e Kosovë. Ai mbi modelin laik të Mësonjëtorës së Korçës të 7 marsit 1887, themeloi shkollën shqipe të Prizrenit, hartoi tekste mësimore për shkollën fillore e më vonë edhe për të mesmet, manuale në ndihmë të mësuesve,

⁶⁷⁹ Hartimi i një bibliografie të tillë të plotë, do të ishte e një rëndësie të veçantë dhe një referencë e rëndësishme për përdorues të specializuar në fushën e kërkimeve shkencore në fushën e arsimit, pedagogë, mësimdhënës e historianë të kulturës. Një bibliografi që përfaqëson një numër relativisht të plotë të referencave bibliografike, duke përfshirë botimin e librave të leximit, janë pjesë e fondit të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, prandaj si e tillë, mund të ketë ndonjë mungesë, meqë këtu janë vetëm njësitë bibliografike që janë në fondet e kësaj biblioteke, por një punë e përbashkët gjithëshqiptare do të ishte kontribut i çmueshëm

⁶⁸⁰ Mati Logoreci është një pedagog, hartues tekstesh, atdhetar dhe intelektual që njihej si shkodran (kishte lindur në Shkodër, por edhe si kosovar (sepse vepronte në Kosovë). Me aktivitetin e tij atdhetar e arsimor Logoreci ka mbetur në Historinë e Arsimit si veprimtar i shquar i Kosovës.

ku shkriu natyrshëm edhe rezultatet e studimeve të tij në fushat e gjuhës shqipe.⁶⁸¹ Si tekstologu i parë në Kosovë “Matia mbetet edhe një metodist me vlerë edhe për të sotmen e shkollës sonë..., si dhe në afirmim të unitetit Veri-Jug, në dobi të çështjes kombëtare”.⁶⁸² Mati Logoreci si hartues i teksteve shkollore i njihet si autor veprash studimore në fushën e gjuhësisë, historisë, dhe sidomos i teksteve shkollore. Tekstet, e hartuara nga ky tekstolog prijtar, me anë të të cilave do të mësonin në shkolla legale ose ilegale sidomos në territorin e Kosovës, ai i përgatiti dhe botoi tekste shkollore dhe manuale në ndihmë të mësuesve si "Abetar", "Plotësori i abetarit", "Libër i mësuesit për përdorim të abetarit" (një libër aplikativ, ashtu siç kërkohet edhe sot për mësuesit), "Libër leximi për shkollat e mesme" (1920), "Lexime për moshën e njomë" (1934), "Fjalorth i librit të leximit për moshën e njomë" (1934), "Histori e përgjithshme" (pjesa I, 1924, pjesa II, 1926). "Ndolli historije t'motshme" (1911) etj. Në këto tekste, spikaste qartësinë në konceptet që do t'u nguliste nxënësve. "Plotësori i abetarit", përmbante copëza e vargje të thjeshta, në formë tregimesh të thjeshta apo dialogu etj.

⁶⁸¹ Shih: Musa Kraja, “Mati Logoreci”, Tiranë, 2000.

⁶⁸² Po aty, f.7.

6.3. TEKSTET E GJUHËS SHQIPE DERI NË VITIN 1945

Vendi dhe roli i tekstit shkollor të abetares, librit të leximit (letërsisë) dhe atij të gramatikës (njohurive mbi gjuhën) në procesin mësimor, edukativo –arsimor, është vlerësuar në këndvështrime të ndryshme. Teksti luajti rol të rëndësishëm në përvetësimin e leximit dhe shkrimit fillestar e deri te përparimi në zhvillimin e kulturës gjuhësore, aftësive shprehëse të nxënësve. “Puna themelore e mësimdhënësit në një orë mësimi në shkolla ka të bëjë me shtjellimin e njësisë mësimore në klasë. Kështu synimi i parë duhet të jetë zgjedhja e metodave dhe organizimi adekuat i veprimtarisë së tij për të arritur objektivat e njësisë mësimore”⁶⁸³. Tekstet shkollore ndihmuan fuqishëm në fitimin dhe ruajtjen e diturive të rëndësishme për zhvillimin e përvetësimin e objektivave kombëtare, thellimin dhe sistematizimin e dijeve nga kultura e gjuhës dhe letërsisë së shqiptarëve ndër shekuj.Për të vazhduar me kronikën e historisë së zhvillimit të librit tek shqiptarët, po përmendim shembujt e popujve të tjerë, për të dëshmuar analogjinë e përdorimit të tekstit tek parardhësit tanë. Tek shqiptarët gjurmët e para të ekzistimit të gjuhës shqipe i gjejmë nga viti 1332, për të vijuar me tri dëshmitë e dokumenteve të para të gjetura si dëshmi e gjuhës shqipe deri te libri i parë i Gjon Buzukut “Meshari” 1555.⁶⁸⁴ Është kjo kohë, kur J. Komenski e formuloi tezën me të cilën përcaktoi se përmbajtja e tekstit duhet të jetë e plotë dhe e mbështetur në premiset shkencore.⁶⁸⁵ Këto zhvillime ndërkombëtare në botën e librit, me ndonjë vonesë u reflektuan gjatë historisë së popullit shqiptar, i cili duke luftuar për ta ruajtur identitetin dhe gjuhën kundër përpjekjeve asimiluese të sunduesve të këtyre trojeve ka bërë shumë sakrifica dhe për këtë ka derdhur shumë gjak.⁶⁸⁶ Botimi i teksteve në gjuhën shqipe kishte rëndësi të veçantë sepse shkollat pa tekste nuk mund të vepronin në mënyrë efektive. Teksteve shkollore në gjuhën shqipe rëndësi të veçantë i kushtuan rilindësit, të cilët, përveç të tjerash, kërkonin që ato të kenë përmbajtje kombëtare, patriotike dhe çlirimtare, duke u liruar nga ndikimet e huaja politike dhe ndikimet fetare. Rilindësit ishin edhe hartues të teksteve të para shkollore me përmbajtje didaktike e shkencore. Duke filluar këtë periudhë të rëndësishme të historisë me Naum Veqilharxhin (hartoi abetaren e parë shqipe), Konstantin Kristoforidhin (abetaret gegërisht dhe toskërisht dhe gramatikën e gjuhës shqipe), pastaj Naim e Sami Frashëri, të cilët i vunë themelet e arsimit kombëtar. Tekste shkollore hartuan rilindësit: Naim e Sami Frashëri, Jani Vretoja, Gaspër Benusi, Gjergj Qiriazi, Thanas Sina, Petro Nini Luarasi, Nuçi Naçi, Ndre Mjeda, Andon Xanoni, Luigj Gurakuqi, motrat Sevasti e Parashqevi Qiriazi, Sotir Peci, Aleksandër Xhuvani, Kristo Dakoja, Mati Logoreci etj., të gjithë këta ishin mësues apo drejtues shkollash.⁶⁸⁷

Historianët e arsimit shqiptar sa herë kanë këndvështruar kronologjinë e zhvillimit të arsimit në gjuhën shqipe në thellësitë e shekujve kanë vënë re se ka pasur mjaftë përpjekje dhe hapje shkollash ku mësohej dhe gjuha shqipe. Ato ishin shkolla të marginalizuara dhe jetëshkurtra, por mjaft të rëndësishme për historinë e mendimit pedagogjik, historinë e didaktikës dhe mësimdhënies së gjuhës, letërsisë dhe të rëndësishme për tekstologjinë shqiptare e përgjithësisht historinë e arsimit në gjuhën shqipe. Deri në periudhën e Rilindjës kombëtare librat e hartuar në

⁶⁸³ Kastriot Gjika, “Reforma shkollore dhe mësimdhënia e letërsisë”, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore “Gjuha dhe letërsia në shkollë”, organizuar nga FHL të UT, Tiranë.

⁶⁸⁴ Dhimitër Shuteriqi, Shkrimet e para në gjuhën shqipe1332, “Rilindja”Prishtinë,1982.

⁶⁸⁵ Dmitrij Dmitrijević Zujev, Školski udžbenik, Beograd, 1988, fq. 14; Më gjerësisht për tekstin dhe historinë e tij shih te Aleksandër Stipçeviq: Povijest knjige, Zagreb, 1985.

⁶⁸⁶ Nuhi Rexhepi, Letërsia shqipe në tekstet shkollore të Kosovës (1945-1990), Prishtinë, 2002, fq. 17.

⁶⁸⁷ Prof. dr. Hysni Myzyri, Rilindasit tanë për tekstet shkollore, “Historia e Arsimit” 2, Tiranë, 2002, fq. 86-87.

gjuhën shqipe bëheshin me alfabete të ndryshme dhe kryesisht shtypeshin jashtë trojeve tona. Deri në çeljen e shkollave kombëtare edhe tekstet mësimore kishin kryesisht karakter fetar. Roli i Rilindasve është i madh në hartimin e teksteve shkollore, filluar me N. Veqilharxhin, S. Frashëri, Z. Jubani, K. Kristoforidhi, N. Frashëri, etj. Mirëpo, përveç këtyre përpjekjeve, veprimi më serioz e më konkret për zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe në territorin e Kosovës së sotme është viti 1915-1918 kur në Kosovë u vendos pushtimi austro-hungarez dhe viti 1941-45, kur në Kosovë E. Koliqi kishte derguar mbi 600 mësues për të çelur shkolla shqipe në Kosovë. Mirëpo, deri në vitin 1945 në Kosovë ka pasur fare pak shkolla në gjuhën shqipe dhe fare pak tekste shkollore të gjuhës shqipe. Pra është e dokumentuar se shkollat institucionale shtetërore – publike kmjaftë të avansuara kanë vepruar në periudhën e Luftës së Parë Botërore 1915 – 1918 dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore në vitet 1941-1944. Dihet mirëfilli se në shkollat me mësim në gjuhën shqipe gjatë viteve 1915-1918 ishin shfrytëzuar tekstet e hartuara nga autorë të huaj, p.sh., në gjuhën italiane (në Prizren) dhe ndonjë tekst i autorëve shqiptarë.⁶⁸⁸ Kështu, Ndre Mjeda dhe Anton Xanoni e kanë hartuar tekstin Këndime për shkollë të para të Shqipnisë, libri I, II, III, Vjenë, 1902, 1908 dhe 1912, të cilët ishin në zbatim deri në vitin 1918, ndërsa në shkollat fillore të Prizrenit edhe më vonë. Nxënësit shqiptarë gjatë kohës së Austro-Hungarisë në Gjakovë, në Pejë, në Gurakoc, në Mitrovicë, në Vushtrri etj., i kanë përdorur tekstet e botuara në Vjenë dhe në Shqipëri. Në këtë periudhë për shqiptarët e mbetur në zonat e okupuara nga Bullgaria nuk është lejuar arsimit në gjuhën shqipe dhe as përdorimi i teksteve në gjuhën shqipe. Kjo periudhë shënon përdorimin e tekstit të botuar në Shkodër “Abetari për msojtore filltare t’ Shqipnis”, shtypur në shtypshkronjën “Nikaj”.⁶⁸⁹ Përveç Vjenës, para viteve 1915 tekstet në gjuhën shqipe janë shtypur nga atdhetarët tanë nëpër shoqëritë jashtë vendit, në Bukuresht dhe në Sofje. Mirëpo edhe pse në udhë për atdhe jo rrallë ju nënshtroheshin kontrollit të rreptë të ushtrisë turke, ato përmes shoqërive nga ana e atdhetarëve të ndryshme shqiptarë kanë depërtuar edhe në Kosovë.⁶⁹⁰ Këto abetare e tekste mësoheshin fshehurazi nëpër kullat shqiptare dhe xhamitë, teqet e kishat nga ana e klerit shqiptar. Gjatë kësaj periudhe në Shqipëri, por edhe në Kosovë përdoren më se 30 tekste shkollore për shkollat fillore. Në Kosovë ishin në përdorim disa abetare, si ajo e M. Logorecit, N. Lako, “Stërvitjetoret”, P. Qiriazi “Abetaren për shkollat e para”, Th. Papapano “Shkëndilat e para”, J. Minga “Abetare kombëtare shqip” etj.⁶⁹¹ Përveç abetareve, ishin botuar edhe disa tekste të lëndëve të tjera mësimore, si “Këndim i shpejtë e i spjeguem”, etj. Tekstet e Shqipërisë përdoreshin edhe në shkollat fillore të Kosovës, të cilat ishin nën sundimin e Austro-Hungarisë. Këtë e dëshmon një shkresë Drejtorisë së “Mësojtorës Popullore Shqipe” në Mitrovicë, e cila kishte kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit në Shkodër “...400 abetare, 200 gramatika, 200 këndime, 130 histori Shqipërie, 30 dheshkronja (gjeografia) të përgjithshme, 130 diftime të natyrës, fjalor shqyp- shqyp etj”.⁶⁹² Lidhur me këto kërkesa, më 18 mars të vitit 1918, Mati Logoreci njoftonte L. Gurakuqin se i kishte ngarkuar 5 arka me peshë 320 kg për Mitrovicë.⁶⁹³ Periudhë e errët për shqiptarët e Kosovës dhe trojet tjera shqiptare të mbetura jashtë kufirit të Shqipërisë londineze, rinis nga viti 1918. Mirëpo, me ndërrimin e pushtuesve, për shqiptarët jashtë Shqipërisë vjen një “ditë më e mirë”! Epoka e Luftës së Dytë Botërore në Kosovë shënon

⁶⁸⁸ Akademik Jašar Redžepagić, *čitanke i čitaonice na Kosovu*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2/1985, fq. 142.

⁶⁸⁹ Murat Z. Gecaj, *Nëpër udhët e shkollës shqipe*, Tiranë, 2001, fq. 125.

⁶⁹⁰ Svetozar G. Čanović, *Specifični problemi nastave u školama Kosova i Metohije*, Priština, 1967, fq. 71.

⁶⁹¹ Instituti i Studimeve Pedagogjike, *Historia e Arsimit Shqiptar I*, Tiranë, 1990, fq. 284; Ilir Kanin, *Arsimi në Shqipëri në vitet e Luftës Parë Botërore*, Tiranë, 2001, fq. 126.

⁶⁹² Po aty, fq. 285.

⁶⁹³ Ilir Kanini, *vep. e cit.*, fq. 126.

hapjen e shkollave shqipe, ku përdoreshin tekstet e shtypura në Tiranë. Këto tekste shkollore ishin të hartuara nga autorët shqiptarë dhe të shtypura në Tiranë. Në Kosovën e viteve 1941-1944, përveç tekstit Abetarja, përdorej Libër leximi për klasën I, II, III, IV dhe V, dhe disa tekste të tjera të cilat ishin një lloj përmbledhje punimesh nga fusha të ndryshme shkencore, si: matematikë, zoologji, kimi, fizikë etj.⁶⁹⁴ Të gjitha lëndët mësimore nuk ishin të mbuluara me tekste të përshtatshme mësimore, të cilat pjesërisht janë zbatuar edhe pas vitit 1945, deri në vitin 1948.⁶⁹⁵

“Datëlindja” e teksteve të gjuhës dhe letërsisë shqipe - Lufta e Dytë Botërore

Zhvillimi normal i mësimdhënies së gjuhës shqipe e vështirësonte mungesa e teksteve shkollore. Tekstet e vjetra trashëgoreshin e përcilleshin brez pas brezi, ato shpesh dhe kopjoheshin me dorëshkrim. Janë të shumtë shkencëtarët që janë marrë me problemet teorike dhe praktike të tekstit shkollor, duke hetuar se sidomos “Letërsia është një veprimtari njerëzore që unifikon si asnjë tjetër në një mendje dhe zemrën e njeriut, arsyen dhe ndjenjën, përkatësisht letërsia përbën atë që mund të quhet plotëni e botës njerëzore. Nëpërmjet saj pasurohet mendja, por fisnikërohet edhe shpirti i njeriut”⁶⁹⁶

Në trojet shqiptare me çështjet teorike të tekstit shkollor dhe me formësimin didaktik të tekstit mësimor është marrë Mr. Abdyl Ramaj. Edhe pse nga shekulli i XV gjejmë fillet e hartimit të teksteve në gjuhën shqipe nga F.Bardhi, A.Bogdani, P.Pogdani etj.⁶⁹⁷ në Kosovë, qëkur u hapën shkollat e para shqipe, ajo e Prizrenit më 1891, e deri në ndarjen e dhunshme nga Shqipëria- nga trangu , pengesat, që iu desh t’i kapërcente në fushën e arsimit e të kulturës kombëtare, nuk janë të njohura për të Ballkanit.⁶⁹⁸ Duke u marrë me çështjet e librit dhe teksteve shkollore, A.Ramaj, që ishte edhe autor i disa teksteve shkollore, sidomos për ciklin e klasave të ulëta, ishte edhe redaktor shumëvjeçar i teksteve mësimore, si dhe autor i bibliografisë për tekstet shkollore, njihet si autori më i saktë i kësaj fushe deri në ditët e sotme në Kosovë. Ilustrativ do të dukej përkufizimi i Sami Frashërit, për shetgëtimet e shqiptarëve drejt shkollës e tekstit në gjuhën shqipe, se “Shqiptari është mësuar të bëjë shkolla ndër sheshe dhe pa libra, me laps në dorë”! Kjo ishte gjendja e arsimit dhe kulturës sonë ndër shekuj, sidomos deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Sipas pedagogut e studiuesit të teksteve shkollore, Abdyl Ramaj “Teksti mësimor është libër shkollor themelor dhe i obligueshëm, që shërben si mjet dhe burim themelor i diturisë në fushën e caktuar mësimore. I krijuar në mbështetje të planit dhe të programit mësimor dhe didaktikisht i formësuar, duke pasur parasysh aftësitë psikofizike të nxënësve, specifikat e lëndës mësimore, llojin e shkollës, shkallën dhe profilin e arsimit. Nxënësit e përdorin në të gjitha etapat e procesit mësimor dhe në vetarsimimin e përditshëm”.⁶⁹⁹ Robëria shekullore, privoi shqiptarët që teksti shkollor, të jetë libër i obligueshëm në duart e fëmijëve të Kosovës. Ndërsa në disa etapa historike (në kohën e okupimit austro-hungarez, atij italian e gjerman dhe gjatë kohës së socializmit jugosllav) tekstet e gjuhës shqipe shkollën fillore kishin rëndësi të veçantë sepse ato ishin të obligueshme dhe pavarësisht përmbajtjeve të tyre kryenin

⁶⁹⁴ Revista “Shkolla shqiptare”, Tiranë, 1941, fq. 458.

⁶⁹⁵ Akademik J. Rexhepagiq, punim i cit. fq. 143.

⁶⁹⁶ Hysen Matoshi, “Tekstet shkollore letrare dhe formimi letrar”, IAP, Prishtinë 2008, fq. 105.

⁶⁹⁷ Shefki Osmani, *Fjalori i Pedagogjisë*, Shtëpia botuese “28 Nëntori”, Tiranë 1983, fq. 649.

⁶⁹⁸ Hysni Myzyri, *Shkollat e para kombëtare*, ISP-Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Tiranë, 1973, fq. 255.

⁶⁹⁹ Abdyl Ramaj, *Qasje analitike – komparative nocionit – tekst mësimor*, Shkolla e Lartë Pedagogjike, 40 vjetori 1958- 1998 - Përmbledhje punimesh, Prishtinë, 1998, fq. 102.

mision të rëndësishëm. Është e kuptueshme, se tekstet shkollore të gjuhës shqipe si gjithë të tjerat, gjatë këtyre etapave të historisë së arsimit shqip në Kosovës duhej të merrnin leje nga organi profesional i Ministrisë së Arsimit- Pleqësia e Arsimit. Teksti shkollor (librat e leximit, gramatikat dhe lektura shkollore) sidomos në shkollën fillore, kishin dhe kanë rëndësi të jashtëzakonshme. Për tekstet shkollore për nxënësit shqiptarë pak shpresë buronte nga Kushtetuta e parë e pas Luftës së Dytë Botërore ën RFPJ-së. Në nenin 13 të saj për pakicat kombëtare, ishte lejuar që “pakicat kombëtare në RFPJ-së gëzojnë të drejtat e zhvillimit kulturor dhe të drejtën e përdorimit të lirë të gjuhës së vet,”⁷⁰⁰ por atëherë partia ishte mbi ligjin e shtetin dhe në praktikë kishte deformime. Deri në vitin 1966 në Kosovë mbretëronte një klimë e rëndë dhe çdo fjalë e shkruar ishte e supermonitoruar. Gjatë kësaj kohe tekstet shkollore në edukimin dhe arsimin fillor ndaheshin në tekstet bazë dhe tekstet punuese (fletore pune). Me qëllim të zbatimit të tekstit bazë dhe të teksteve mungonin Librat e mësuesit, tekst i cili do të ishte me udhëzime didaktiko-metodike për secilën njësi mësimore në veçanti. Rrugën e fateve të zhvillimit të shkollës shqipe e ka ndjekur edhe botimi i teksteve shkollore të gjuhës shqipe, si mjeti më i fuqishëm mësimi, edukimi e arsimimi. Hapja dhe zgjerimi i rrjetit shkollor, përgatitja e kuadrit të kualifikuar mësimor, por edhe klima politike në Kosovë u reflektua në rritjen e kerkesave dhe në përmbajtjen e formatin e teksteve shkollore të gjuhës shqipe. Hartuesit e teksteve ishin të bindur se “krahas mendjes, letërsia ndikon ndjeshëm, madje qenësisht në fisnikërimin e ndjenjave e të shpirtit të njeriut të ri, e të këtyre grupmoshave në veçanti”.⁷⁰¹ Kështu, epokë e rëndësishme për tekstin shkollor në Kosovë, mund të konsiderohet koha nga abetarja e parë e Kol Xhumarit “Këndimi im i parë” (1945) që bashkë me mësuesit e ardhur nga Shqipëria gjatë viteve 1941-45 shënojnë një epokë mjaftë delikate të udhës së shkronjave shqipe deri tek përballja me hartimin e teksteve shkollore nga autorë serbë e shqiptarë në gjuhën serbe për t’u përkthyer më pastaj shqip e deri tek vitet 1974-1981 kur libri shkollor pësoi lulëzim.⁷⁰² Letërsia si lëndë mësimore me program përfshihej në të gjitha kategoritë e shkollave në mënyrë të vijueshme; këndimi në klasën I-IV të ciklit të ultët; leximi letrar në klasat V-VIII të ciklit të lartë të shkollës fillore dhe histori të letërsisë në klasat I-IV të shkollës së mesme. Pra, teksti shkollor në Kosovë është i vjetër po aq sa shkolla shqipe në këto treva.⁷⁰³

⁷⁰⁰ Boris Zihel, Zadaci naseg skolstva i naucnih ustanova, “Savremena skola”, revistë për [ështëje pedagogjike, nr.3, 1946, fq.151.

⁷⁰¹ Bardhyl Musai, *Metodologjia e mësimdhënies*, Tiranë 2003, fq. 112.

⁷⁰² Deri në vitin 1990 vetëm tekstet shkollore të letërsisë shqipe janë botuar mbi 400 tituj. Shumica e këtyre titujve ju dedikohet shkollave fillore dhe ishte më i vogël numëri i teksteve për shkollat e mesme.

⁷⁰³ Shefik Osmani, *Fjalor i pedagogjisë*, Tiranë, 1983. fq.374.

6.4. TEKSTE SHKOLLORE TË GJUHËS SHQIPE PAS VITIT 1945

Është shumë i vonuar botimi i teksteve në Kosovë për nxënës shqiptarë. Si datë fillimi mund të merret viti 1945, kur shkolla shqipe prej vitit 1945 ka punuar në bazë të dokumentit “Drejtimet për punën e shkollave të pakicave kombëtare”, të miratuar më 10 gusht të vitit 1945⁷⁰⁴ nga Pleqësia e përkohshme arsimore e Ministrisë së Arsimit të Jugosllavisë Demokratike Federative. Në mbështetje të këtij dokumenti, tekstet shkollore për nxënësit e pakicave botohen në vend, ndërsa ato tekste të cilat nuk ka mundësi të nxirren te ne, importohen nga jashtë në bazë të lejes së organeve arsimore. Përveç mësuesve që erdhën nga Shqipëria, në bazë të këtij dokumenti u importuan edhe disa tekste nga RP e Shqipërisë, siç ishin: gramatika e gjuhës shqipe, stilistika, psikologjia (e Kornilovit), teksti i fizikës, i kimit etj.⁷⁰⁵ etj.

Tekstet e hartuara nga autorët shqiptarë, bile edhe Abetarja, së pari duhej të përktheheshin në gjuhën serbe dhe pastaj ta merrnin vizën në Beograd për botim(!) Mehmet Gjevori, njëri ndër bashkautorët e abetares së parë shkruan për peripecitë e nxjerrjes së kësaj abetareje, “...atëherë kur teksti ishte i daktilografuar dhe i pajisur dhe i bërë gati për shtyp edhe me klishtët e duhura sipas përmbajtjes... na u kërkua nga ana e Ministrisë së Arsimit në fjalë, që i tërë teksti i abetares sonë në dorëshkrim, të përkthehej në serbokroatishte dhe t’i dërgohej për shqyrtim e miratim, para së të botohej, Ministrisë së Arsimit të Republikës së Serbisë... Përkthimin e bëri Stathi Kostari”⁷⁰⁶.

Me prishjen e marrëdhënieve ndërshtetërore mes Jugosllavisë dhe RP të Shqipërisë si rezultat i Informbyrosë ndërpritet bashkëpunimi në fushën e teksteve shkollore, ndërsa procedura e nxjerrjes së tyre në gjuhën shqipe gati se u pamundësua. Vështrim i veçantë teksteve shkollore i është kushtuar në Plenumin III të vitit 1949, me ç’rast janë kritikuar tekstet mësimore kryesisht të përkthyer në gjuhën serbe nga gjuha ruse, si tekste joadekuate, joshkencore, të cilat e injorojnë historinë nacionale dhe realitetin jugosllav.⁷⁰⁷ Kështu, hartimi i teksteve të përbashkëta në nivel të Jugosllavisë nuk kishte jetë të gjatë, megjithë përpjekjet për hartimin e programeve të përbashkëta mësimore.⁷⁰⁸ Në mbështetje të realizimit të Rezolutës së Plenumit Tretë, një numër i komisioneve e ka bërë vlerësimin e teksteve të botuara, të përkthyer apo të importuara deri në vitin 1948 dhe 1949.⁷⁰⁹ Sipas këtij vendimi, nga përdorimi tërheqen të gjitha tekstet e hartuara dhe të importuara nga Rusia (sigurisht edhe nga Shqipëria). Derisa në vitin 1948 ishin botuar 10 tekste, në vitin 1949 ishin shtypur vetëm 2 të tilla, në vitin 1950 ishin botuar 5 tituj, ndërsa prej vitit 1951 numri i titujve fillon të shtohet. Deri në vitin 1951 nuk është botuar apo ribotuar asnjë libër leximi, ndërsa në vitin 1951 botohen tekstet e reja të libër leximit të autorëve shqiptarë. Prej vitit 1951 e deri në vitin 1954 librat e leximit të gjuhës shqipe ishin të hartuara kryesisht nga autorët serbë e malazias dhe pastaj ishin përkthyer. Kështu, në vitin 1951 ishin botuar 6 libra të

⁷⁰⁴ Pajazit Nushi, Zhvillimi i arsimit.... fq. 103.

⁷⁰⁵ Po aty, fq. 104.

⁷⁰⁶ Mehmet Gjevori, Kujtime e shënime rreth punës së shkollave të para shqipe në Kosovë gjatë dhe pas Luftës II Botërore, Prishtinë, 1998, fq. 149.

⁷⁰⁷ Jo vetëm në Serbi, por edhe në Kosovë me mësim në gjuhën shqipe kishte tekste të tilla të përkthyer dhe të “përshtatura” në gjuhën shqipe. Hartimi i teksteve në gjuhën shqipe nga autorët e tjerë sllavë kishte gjetur mbështetje nëudhëheqjen më të lartë, të cilët kishin kritikuar hartimin e teksteve ndaras sipas përkatësisë territoriale, përka tësisht sipas republikave.

⁷⁰⁸ Dr. Ranko Simović, Politika obrazovanja i njena realizacija u SR Srbiji, Beograd, 1990, fq. 107.

⁷⁰⁹ Këto komisione i kishin propozuar Këshillit të arsimit të përgjithshëm dhe Pleqësisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës të Serbisë të bëhet tërheqja e të gjitha teksteve shkollore të edukimit dhe të arsimit fillor dhe të mesëm nga përdorimi, të cilat ishin botuar gjatë viteve 1948 dhe 1949

leximit (pesë për shkollën fillore dhe një për shkolla të mesme). Autorët e këtyre teksteve ishin serbë. Vetëm Leximi për të rritun ishte hartuar dhe përshtatur nga grupi i autorëve: S. Kostari, P. Pavloviq, Sh. Veliu dhe M. Gjevori. Kontribut të veçantë në hartimin e teksteve shkollë, sidomos në ciklin e klasave të ulëta, në pesë vjetët e para të pasluftës, dhanë autorët: Stathi Kostari, Shefqet Veliu, Tajar Hatipi, Mehmet Gjevori, Hasan Vokshi, Talat Paçarizi, Jani Gjino, Idriz Ajeti, Ibrahim Riza e Rexhep Shpendi⁷¹⁰

Tabela 30. Librat e leximit dhe sintaksa të hartuara nga autorët serbë dhe malazes për nxënësit shqiptarë

Nr	Autorët	Titulli	Botues	Viti it	Nr.faq	Përkthyes
1.	Ivo Fërd	Gjuha jonë (sintaksë) kl. II	Jugoštampa - Beograd	1948	40	H. Vokshi T. Hatipi
2.	Ivo Fërd	Gjuha jonë (sintaksë) kl. III	Prosveta – Beograd	1949	63	H. Vokshi T. Hatipi
3.	Rade Vukoviç Janko Stankoviç ⁷¹¹	Libër leximi për kl. II sh.f.	Znanje - Beograd	1951	192	M. Shala – Stathi Kostari
4.	Stevan Filipoviç, Bogolub Markoviç	Libër leximi për klasën e III të	Mustafa Bakija	1951	190	H. Vokshi Gjeto Leka
5.	Stevan Filipoviç e Dragolub Markoviç	Libër leximi për klasën e IV të shkollës fillore	Mustafa Bakija	1951	222	Stathi Kostari
6.	Dr. Vido Llatkoviç, Dimitrije Vuçenov e Lubica Klajn	Libër leximi për kl.III gjimnaz	Mustafa Bakija	1951	228	Jani Gjino Hasan Vokshi
7.	Svetozar Matiq, Zoran Bullatoviç e Jellka Filipoviç	Libër leximi për klasën I gjimnaz (klasa V e sh.f.)	Mustafa Bakija	1951	169	H. Vokshi Mehmet Gjevori
8.	Sava Ristanoviç, Jelena Konstatinoviç Kreshimir Gjorgjeviç	Libër leximi për klasën II gjimnaz (klasa VI e sh.f.)	Mustafa Bakija	1951	270	Esad Mekuli, Tajar Hatipi
9.	Dr.Vido Llatkoviç, Dimitrije vuçenov, Lubica Klajn	Libër leximi për klasën III gjimnaz (klasa VII)fill.		1951		
10 ⁷¹²	Rade Vulloviç e Janko Stankoviç	Libër leximi për klasën I të sh.f.	Mustafa Bakija	1952	100	S. Kostari M. Gjevori
11.	Tashko Pecevski e Gjorgje Milloshev	Libër leximi për klasën e IV të sh.f.	Prosvetno dello	1954	174	Lutfi Rusi ⁷¹³
12..	Tashko Pecevski e Gjorgje Milloshev	Libër leximi për klasën e II të sh.f.		1954	139	Ska emër të përkthyesit
13.	Tashko Pecevski e Gjorgje Milloshev	Libër leximi për klasën e III të	Prosvetno dello	1954	180	Stevan Zorba

⁷¹⁰ Mehmet Gjevori, Si lindën dy abetaret e para shqipe në Kosovë, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 1/1985, fq. 53.

⁷¹¹ Qamil Batalli, vep. e cit., fq. 1.

⁷¹² Qamil Batalli, Bibliografia e abetareve dhe e librave të leximit të shkollës fillore në gjuhën shqipe në KSAK 1945 – 1975, 1978 (dorëshkrim) (Në Bibliografinë e librit shkollor të A. Ramajt nuk figurojnë 3 tekste të libër leximit të autorëve joshqiptarë (Libër leximi i klasës I të shkollës fillore, Librat e leximit për gjimnaze për klasat II dhe III).

⁷¹³ Për nxënësit dhe arsimtarët shqiptarë të shkollave fillore të Maqedonisë tekstet u hartuan nga autorët maqedonas, ndërsa u përkthyen në gjuhën shqipe, siç u veprua edhe në Kosovë.

Përveç kësaj, nxënësit shqiptarë, në krahasim me atë në gjuhën serbe, kishin edhe probleme të tjera të natyrës materiale. Tekstet në gjuhën shqipe, për shkak të numrit të vogël të nxënësve, kishin tirazh më të vogël dhe si të tilla kishin çmim më të lartë se ato në gjuhën serbe.⁷¹⁴⁷¹⁵ Përveç teksteve “origjinale” të autorëve joshqiptarë, në vitet e pesëdhjeta, kishte tekste në përdorim edhe të “autorëve” shqiptarë të cilët i kishin përmbledhur dhe përshtatur autorët anonim.⁷¹⁶

Tabela 31. Tekstet e hartuara nga “Komisioni i posaçëm”

Nr	Autorët	Titulli	Botues	Viti	Nr.f.	Përmbledhë dhe përshtatur
1.		Libër leximi për klasën e IV gjimnaz dhe klasën e VIII të shkollës tetëvjeçare	Mustafa Bakija	1954	167	Abdullah Zajmi dhe Jusuf Shushka
2.		Libër leximi për klasën e III të shkollës fillore	Mustafa Bakija	1956	146	Komisioni i posaçëm

6.4.1. Raporti i teksteve të viteve '50, autorë shqiptarë –joshqiptarë

Prej vitit 1951 deri në vitin 1954 ishin në përdorim librat e leximit të hartuara nga autorë serbë që ishin përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe. Vështirësi të veçantë dhe procedurë të tejjzgjatur do të ndodhë më vonë me tekstet shkollore për nxënësit shqiptarë, sepse të gjitha dorëshkrimet e përkthyer, duhej të dorëzoheshin në Ministrinë e Serbisë për të marrë lejen për botim. Deri në vitin 1954 asnjë tekst i libër leximit nuk kishte përmbajtje të autorëve shqiptarë.⁷¹⁷ Prej vitit 1954 tekstet e gjuhës (letërsi dhe gramatikë) për nevoja të nxënësve dhe të arsimtarëve shqiptarë hartohen nga vetë autorët shqiptarë. “Mirëpo, në libra të leximit në gjuhën shqipe deri në vitin 1974, e në një masë edhe deri në vitin 1976, ka dominuar letërsia e përkthyer, për shkak se ata hartoheshin sipas kombinimit të katër programeve...: programit të KSA, të RS të Serbisë, të RS të Maqedonisë dhe të RS të Malit të Zi”.⁷¹⁸

⁷¹⁴ Narodni Oblast..., fq. 748.

⁷¹⁵ Arkivi i Kosovës, fondi: Tekstet shkollore, kutia 1-6.

⁷¹⁶ Arkivi i Kosovës, fondi: Tekstet shkollore, kutia 1-6.

⁷¹⁷ Mehmet Gjevori, Kujtime e shënime rreth punës së shkollave të para shqipe në Kosovë gjatë dhe pas Luftës II Botërore, Prishtinë, 1998, fq.155.

⁷¹⁸ Po aty, fq. 28.

6.5. TEKSTET E LETËRSISË -LIBRI I LEXIMIT, 1945 - 2014

Librat e parë në gjuhën shqipe që ranë në duart e nxënësve pas “çlirimit” ishin tekstet e trashëguara nga e kaluara.⁷¹⁹ Ndër tekstet e para shkollore në trevën e Kosovës së sotme është abetarja e parë “Këndimi im i parë”, botuar në vitin 1945 nga Drejtorati i Arsimit, në shtypshkronjën “Laurasi” në Tiranë, në 20 mijë kopje. Ndërkaq, faqe e re për shkollën shqipe dhe për gjuhën shqipe hapet në Kosovën e pas Luftës së Dytë Botërore, kur mbi 95 për qind të popullatës ishin analfabetë. Historia e mirëfilltë e botimit të tekstit shkollor në gjuhën shqipe, nga autorë shqiptarë të Kosovës fillon pas vitit 1946. Këta autorë ishin të shtërnguar që t’i hartonin në gjuhën serbe ose t’i përshtatnin nga gjuha serbe. Ndër autorët e parë shqiptar të kësaj periudhe përmenden T. Hatipi, M. Gjevori, S. Kostari, A.Petta, M. Krasniqi, A.Zajmi, D.Shala, G.Lubeteni, R.Hoxha, R.Kelmendi, etj.Për nevojat e shkollës shqipe në Kosovë, sikur edhe shumë tekste tjera edhe ato të gjuhës shqipe deri në vitin 1948 përdorëshin edhe tekstet e hartuara dhe të botuara në Shqipëri, sepse marrëdhëniet diplomatike deri në këtë kohë ishin të mira dhe nuk kishte dallime ideologjike. Mbështetur në lëvizjet politike dhe në ndryshimet programore e ligjore në ish-Jugosllavi dhe ndryshimet ligjore e programore, tekstet shkollore të gjuhës shqipe mund të periodizoheshin në katër periudha të zhvillimit:

Periudhën e viteve 1945-1961;
Periudha e viteve 1962 – 1969;
Periudha e viteve 1970-1991 dhe
Periudha e viteve 1992 – 2014.⁷²⁰

Madje, ky periodizim argumentohet shumëdimensionalisht me argumentet e proporcionit të përfaqësimit të letërsisë shqipe, jugosllave dhe botërore, në përmbajtje dhe me kriteret ideologjike në programe, tekste dhe mësimdhënien, etj. Në këtë kohë, mjaft autorë të cilët kishin frikë nga ndjekja e policisë serbe, sidomos për tekste të lëndës së gjuhës shqipe dhe historisë. Megjithatë vazhdojnë bashkëpunimin në hartimin e teksteve shkollore, edhe jashtë lokalit të punës. Në shkollën fillore tekstet janë të hartuara kryesisht nga koautorët, ndërsa tekstet për shkollat të mesme, kryesisht nga një autor. Redaksia e Librit Shkollor angazhimet që i ka bërë rreth hartimit të teksteve ka pasur parasysh bindjen, se “Të lexuarit është një zotësi e vështirë që kërkon vite për ta zotëruar...Nxënësit tuaj është mirë të bëhen lexues eficientë në mënyrë që të përfitojnë sa më shumë nga orët tuaja të mësimt. Dhe, në rast se shtrohet pyetja se kush duhet t’i mësojë ata të bëhen të tillë, përgjigjja është: ai jeni ju.”⁷²¹ Dhe për këtë fakt kujdesi në hartimin e teksteve sa vinte e shtohet. Bibliografi e veçantë e botimeve të arsimit fillor në gjuhën shqipe në Kosovë dhe përgjithësisht në ish-Jugosllavi është e kufizuar në një periudhë të veçantë kulturore, historike e politike të shqiptarëve të Kosovës gjatë ekzistencës së kreatorës artificiale, RSFJ-së, shtet, që përfshin vitet 1945 - 1999. Në fondin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, është një koleksion i botimeve përfshijnë librat e leximit të botuar jo vetëm në Kosovë, por edhe në Republikat e ish-Jugosllavisë, si në Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi. Mbase për një kërkim më të plotë, e të veçantë, do të duhej një përkushtim më i madh në një proces të kërkimit edhe nëpër botues dhe autorë, të cilët kanë mbajtur të dhëna për këto lloj koleksioni të botimeve

⁷¹⁹ Abdulla Vokri, Zhvillimi i shkollave dhe arsimit në komunën e Mitrovicës (1945-1975)

⁷²⁰ Bajram Shatri “Historia e arsimit fillor në Kosovë” I-II, Prishtinë, 2000.

⁷²¹ Sofokli Garo, “Mësimdhënia bashkëkohore”, Tiranë 2008, fq. 46.

shkollore. Radhitja kronologjike, mund të bëhej sipas viteve të botimit, por kemi zgjedhur radhitjen e bërë në ndarja sipas klasave të arsimit fillor. Librat e leximit në gjuhën shqipe për shkollimin e obliguar i gjejmë me këto emërtime: Kendimi; Libër kendimi; Lexim, Libër leximi, Lexim letrar etj.⁷²² Disa nga tekstet e përdorura në Kosovë, gjatë viteve 1945-1999, si tekste mësimore për gjuhë dhe letërsi shqipe në shkollën fillore, do të permend në vijim, me të gjithë autorët, sipas klasave të shkollës fillore nga I-VIII:

Klasa e parë: Rade Vuković, Beqir Kastrati, Rexhep Hoxha, Mehmet Gjevari, Rexhep Rexhepi, Hajro Ulqinaku, Musa Hyseni dhe Shefik Osmani.

Klasa e dytë: Zekeria Rexha, Mehmet Gjevari, Stathi Kostari, Rade Vuković, Janko Stanković, Mehmet Gjevari, Mehmedali Hoxha, Hamza Reka, Ilaz Metaj, Rexhep Hoxha, Idris Ulaj, Qamil Batalli, Shefik Osmani, Engjëllushe Abazi, Arif Demolli.

Klasa e tretë: Mehmet Gjevari, Shevqet Veliu, Stevan Filipović, Dragolub Marković, Jani Gjino, Mehmedali Hoxha, Hamza Reka, Hajro Ulqinaku dhe Shefik Osmani, Engjëllushe Abazi, Arif Demolli.

Klasa e katërt: Stathi Kostari, Idriz Ajeti e Jani Gjinos, Stevan Filipović, Dragolub Marković, Nebil Dino, Kolë Shiroka, Mehdi Bardhi, Salih Kolgeci, Tajar Hatipi, Mehmedali Rexhep Hoxha, Petro Janura, Ilaz Metaj, Shefqet Canhasi, Mehmet Gjevari, Shefqet Veliu, Agim Deva, Ramiz Hoxha, Qamil Batalli, Anton Berisha, Shefik Osmani, Mimoza Gjokutaj, Qamil Batalli.⁷²³

Klasa e pestë: Idriz Ajeti, Anton Çetta, Sulejman Drini, Mehdi Bardhi, Rexhep Mazllom Kumnova, Gjergj Zheji, Odhise K. Grillo, Hamdi Jupe, Elvira Dilo, Munish Hyseni.

Klasa e gjashtë: Tajar Hatipi, Esad Mekuli, Ramiz Hoxha, Xheladin Topçiu, Rexhep Hoxha, Gjergj Zheji, Natasha Xhafka, Munish Hyseni.

Klasa e shtatë: Mehdi Bardhi, Salih Kolgeci, Hasan Vokshi, Demush Shala, Ibrahim Kadriu, Qazim Kashari, Pavli Haxhillazi, Mazllom Kumnova.

Klasa e tetë: Abdullah Zajmi, Jusuf Shushka, Abdullah Zajmi, Sali Qilerxhiu, Ismajl Bytyçi dhe Arian Kadiu.

6.5.1. Funkzioni i teksteve të gjuhës dhe letërsisë në formësimin atdhetar të nxënësve

Shumë pak përmbajtje në frymën kombëtare gjendeshin në tekstet e klasës së parë-Abetaret. Si teksti i parë për nxënësit, gjatë analizës së botimeve të vitit shkollor 1974/75, kur në përdorim ishte Abetarja e autorit Mehmet Gjevari⁷²⁴ nuk përmbante ndonjë karakteristikë që shprehte ndonjë element me vlerë kombëtare. Përveç dy përmbajtjeve me asocim kombëtar “Festa” (fq.39), ku në ilustrim paraqitet edhe flamuri kombëtar por krahas atij ish-jugosllav dhe “Vendlindja ime”. Edhe në vitin shkollor 1977/78 deri 1981/82, kur në përdorim kishte Abetarja e Mehmedali Hoxha,⁷²⁵ kishte fare pak përmbajtje që pasqyron ndonjë aspekt kombëtar. Vendin e kombëtarizmit autorët e kompensonin me tekstet përprijësin “Tito”, fq.42, “Me Titon përpara”, fq.44, “J.B.Tito”, fq.93, “Emri i shokut Tito”, fq.94). Aty-këtu ishte në “modë” edhe ndonjë tekst për LNÇ, si “Zana partizane”, fq.81 dhe “Qyteti Hero”, fq.95), të cilat në brendinë e tyre

⁷²² Bukuriye Haliti, Libri i leximit në gjuhën shqipe në ish-Jugosllavi... (1945 – 1999), Revista “Mësuesi i Kosovës”, Prishtinë, 2013.

⁷²³ Autorët e sipërpërmendur ndodh që të jenë hartues të dy a më shumë teksteve shkollore dhe madje të ribotimeve, por këtu i kemi përmendur vetem një herë.

⁷²⁴ Mehmet Gjevari, Abetare, ETMM të KSAK, Prishtinë, 1974.

⁷²⁵ Mehmedali Hoxha, Abetare, ETMM të KSAK, Prishtinë, 1979.

shpalosin disa vlera njerëzore-kombëtare, si porosia atdhetare “Liria nuk dhurohet, por fitohet”. Edhe nga viti shkollor 1982/83 e deri në vitin 2003 në përdorim ishte më së gjati Abetarja e autorit Qamil Batalli,⁷²⁶ si e veçanta kombëtare në mesin e katër flamujve (RSFJ, LKJ dhe RS) zë vend edhe flamuri ynë kombëtar (fq.76). Në funksion të edukimit kombëtar mund të llogaritej edhe dashuria ndaj nënës (“Nëna qëndresë”, fq.78) ku potencohen disa tipare patriotizmi: qëndresa, trimëria etj., dhe te poezia (“Gjuha jonë”, fq.87) shprehet dashuria ndaj gjuhës amtare siç shprehet poeti ynë i madh N.Frashëri: “të mirë, të ëmbël, të dliër...”. Edhe disa nga përmbajtjet me tematikë nga LNC, si “Valojnë flamujt tanë”, “Boro e Ramizi”, fq.76 janë në mesin emotiveve të pakta” kombëtare”. As ribotimet e kësaj Abetarje deri në vitin 1991 deri në botimin e pestë (1991)⁷²⁷ nuk shënojnë ndryshime. Këtë vit, janë mënjeluar disa ilustrime dhe janë zëvendësuar me disa ilustrime tjera por jo me ndonjë simbol kombëtar. Është hequr vjersha “Rruga e Titos” dhe është zëvendësuar me vjershën “Rruga jonë”. Deri te hartimi i Abetares së përbashkët Shqipëri -Kosovë, tekstet me përmbajtje kombëtare kanë munguar dhe kanë qenë fare simbolike.

Për analizë dhe pikënisje u mor viti shkollor 1974/75 e këtej. Dallohet se në klasën e parë në përdorim ishte teksti i autorëve B. Kastrati, Sh. Veliu dhe M.Gjevori⁷²⁸. Nga 107 njësi mësimore sa përfshihen në këtë tekst, vetëm pesë (vjersha), që u përkasin krijimeve me tematikë kombëtare. Ndërsa, në vitin shkollor 1975/76 deri 1977/78 në përdorim ishte libri i autorit R. Hoxha,⁷²⁹ i cili nga 100 njësi, 11 prej tyre shprehin aspekte të ndryshme të vlerave kombëtare. Si për nga cilësia ashtu edhe për nga sasia e tyre dallojnë (për të mirë) nga teksti paraprak. Krahas, krijimeve që u kushtohen dëshmorëve të luftës, ky tekst përmban edhe krijime që i kushtohen, gjuhës shqipe, dashurisë ndaj vendit, si: “Çdo gur i vendit, çdo lule bime, din gjuhën shqipe të nënës sime”. (Gjuha shqipe, fq.10). Si dhe poezia tjetër. “Sa me shumë të përparoj, në mësim e në provim; aq më tepër do’ t tregoj dashurinë për vendin tim” (Mësimet, f.20). Në vitin shkollor 1978/88, deri 1987/88, në përdorim ishte teksti i autorëve M. Gjevori, Sh. Veliu dhe B. Kastrati.⁷³⁰ Përfaqësimi i përmbajtjeve kombëtare në këtë tekst, sërish është në nivelin e atij paraprak. Nga 101 njësi, vetëm katër prej tyre janë më përmbajtje kombëtare. Dominojnë kryesisht njësi me motive nga LNC, ku fokusohen” frytet e revolucionit socialist”. Kjo, duke bërë autocensurë dhe për t’u shkuar përshtati kërkesave të asaj kohe dhe ishte arsye që me rastin e vlerësimit të këtij teksti të thuhet se si i tillë”... ky libër nuk ka të meta ideologjike dhe mund të botohet pa kurrfarë intervenimi”.⁷³¹ Vlerësuar në tërësi, është teksti me nivelin më të ultë të përfaqësimit të përmbajtjeve kombëtare. Në vitin shkollor 1988/89 deri 1991/92, në përdorim ishte Libri i leximit i autorëve M. Gjevori dhe Q. Batalli.⁷³² Ky libër nga 57 njësi, vetëm katër prej tyre janë me përmbajtje kombëtare. Edhe për nga cilësia është afërsisht në nivelin e atij paraprak. Shumë prej njësive të përfaqësuar i referohen” vëllazërim – bashkimit”, “udhëheqësit partiak” etj., të cilat ulin, madje, ishin me vlerat artistike të dobëta.

⁷²⁶ Qamil Batalli, Abetare, ETMM të KSAK, Prishtinë, 1987.

⁷²⁷ Qamil Batalli, Abetare, ETMM i Kosovës, Prishtinë, 1991.

⁷²⁸ B. Kastrati, Sh. Veliu, M. Gjevori, *Libër leximi e gjuhë për klasën parë*, ETMM të KSAK, Prishtinë, 1972.

⁷²⁹ R. Hoxha, *Libër leximi për klasën I të shkollës fillore*, ETMM të KSAK, Prishtinë, 1977.

⁷³⁰ M. Gjevori, Sh. Veliu, B. Kastrati, *Shoku im, Libër leximi për klasën e I të shkollës fillore*, ETMM, Prishtinë, 1985.

⁷³¹ Isak Shema, Ibrahim Rugova, Tafil Morina, *Vlerësimi ideestetik i librave të leximit të ciklit të ultë dhe të lartë të shkollës fillore*, Libri shkollor, Buletin i ETMM të KSAK, Prishtinë, 1982, nr.1, fq.14.

⁷³² M. Gjevori, Q. Batalli, *Gëzimi im, Libër leximi e gjuhë për klasën parë të sh.f.*, ETMM, Prishtinë, 1988.

Madje, në vitin shkollor 1992/93 deri 1995/96 në përdorim ishte Libri i leximit i autorëve M. Gjevari dhe Q. Batalli⁷³³. Në fakt, është vijimësi e tekstit paraprak, por, për arsye të rrjedhave politike – shoqërore të asaj kohe (suprimimit të autonomisë së Kosovës dhe të organeve arsimore të të gjitha niveleve) u bënë disa ndërhyrje, me çrast, mënjanohej njësitë me vlera ideo – politike dhe eliminohej ato njësi, autorë të të cilave janë krijuesit ish-jugosllav. Nga 42 njësi sa përfshihen në këtë tekst, vetëm dy prej tyre janë me përmbajtje kombëtare “ Fjala zemër” (fq.21) që i kushtohet atdheut dhe “Mëmëdheu” (fq.22). Tani hapet një shteg i ri dhe një kapull i ri për tekstin shqip në Kosovë, në vitin shkollor 1996/97 dhe 1997/98 dhe deri, 2004 ishte në përdorim Libri i leximit i Sh. Osmanit etj.⁷³⁴. Nga 37 njësi, gjashtë prej tyre janë me përmbajtje kombëtare. Ky tekst nuk përmban asnjë njësi me tematikë nga LNÇ që ishte karakteristikë për tekstet paraprake, ndërsa përparësia e tij rezultoi me faktin se, asnjë prej njësive nuk shpreh vlerat ideo – politike. Bie në sy, gjithashtu, se ky tekst niset me vjershën e mirënjohur të N. Frashërit “Gjuha jonë” (fq.3), sikurse që, për herë të parë si shembull (i mënyrës së të shkruarit të letrës) merret letërkëmbimi midis një nxënësi nga Tirana dhe Prishtina. Ky është një element i ri që vjen si rezultat i ndryshimeve politike – shoqërore – matanë dhe këndej kufirit shqiptar. Gjithashtu, vlen të përmenden vjersha” Për një shkronjë ” (fq.10), pjesa e leximit “ Burri më i fortë i botës ” (fq.42). Përkundër disa përparësive që ka ky tekst krahasuar me ata paraprak, megjithatë, përmbajtjet me vlerë kombëtare nuk janë të përfaqësuara në nivel të krenarshëm me aktualitetin e kohës që kërkonte shija kombëtare e fëmijëve në Kosovë.

Librat e leximit ishin tekstet letrare për klasën e dytë të shkollës fillore gjatë vitit 1974/75 deri 1977/78, kur në përdorim ishte libri i leximit i autorit I.Metaj⁷³⁵. Nga 108 njësi, 11 prej tyre janë me përmbajtje kombëtare. Në këto të fundit, disa prej tyre i kushtohen vendlindjes (“Jehon kënga”, fq.23, “ Për vend e vatër ”, fq.91), teksti për heroin kombëtar Skënderbeu (“ Porosia e fundit e Skënderbeut ”, fq.89-90, “ Gjergj Kastrioti Skënderbeu ”, fq.116), luftëtarëve (“ Partizani dhe Fashisti, fq. 110-111), gjyshës sepse “më tregon për Skënderbenë, që luftoi për mëmëdhenë” (“ Gjyshja ”, fq.310.).Njëkohësisht, në këtë tekst janë të pranishme edhe njësi të tjera që pasqyrojnë vlerat ideo – politike të asaj kohe. Në vitin shkollor 1978/79 deri 1986/87 në përdorim ishte Libri i leximit i autorëve M.Gjevari e Sh. Veliu⁷³⁶. Te ky tekst krahasuar me tekstin paraprak nuk vihen re dallime të ndjeshme. Kështu, nga 115 njësi, 9 prej tyre janë me përmbajtje kombëtare. Ato i kushtohen shtëpisë e cila konsiderohet se “fole ... e vendit ku kam le ” (“Shtëpia ime”, fq.41),”Fshatit” (fq.64-65), vendlindjes që “nuk ka asnjë vend më të bukur dhe më të dashur ...” (“Vendlindja ime”, fq.59), atdheut të cilin duhet dashur “... si sytë e ballit, si diellin që shndrit, si lulet e beharit, si vatrën që m’ka rritë...” (“Atdhe”, fq.60) pastaj për lulën më të bukur e cila “ ... ka çelur në atdheun tonë, ajo që gjendet në zemrën tonë, në zemrën time, në zemrën e gjithë njerëzve tanë ” (“Lulja më e bukur ”, fq.61-62).

Cilësia e krijimeve me përmbajtje kombëtare të përfaqësuara në këtë tekst, (krahas atyre që përshkohen nga fryma ideologjike) kundrejt tekstit paraprak është në nivel shumë më të lartë.Në vitin shkollor 1987/88 deri 1991/92 në përdorim ka qenë teksti i autorëve Q. Batalli dhe M. Gjevari⁷³⁷. Nga 85 njësi, 10 prej tyre janë me përmbajtje kombëtare. Disa prej tyre shquhen për

⁷³³ M. Gjevari, Q. Batalli, Libër leximi e gjuhë për klasën parë ..., ETMM të KSAK, Prishtinë, 1993.

⁷³⁴ Shefik Osmani etj., Leximi 1, për klasën e parë të shkollës fillore, “ Libri shkollor ”, Prishtinë, 1998

⁷³⁵ Ilaz Metaj, Agimi pranveror, Libër leximi për klasën e dytë ..., ETMM- KSAK Prishtinë, 1977.

⁷³⁶ Mehmet Gjevari, Shefqet Veliu, Valle rreth botës, Libër leximi për klasën e dytë të sh.f., ETMM - KSKA, Prishtinë, 1980.

⁷³⁷ Q. Batalli, M.Gjevari, Buzëqeshjet, Libër leximi e gjuhe për klasën e II të sh. fillore, ETMM- KSAK, Prishtinë, 1989.

nga niveli i lartë artistik e përmbajtësor, i kushtohen gjuhës e vendit “Një kanarinë, mbi një pip ;ka filluar këngën shqipe”. (“Lulëzo vendi im”, fq.91). Ndërsa, vargje të fuqishme hasim edhe në vjershën “Në dredhëz ka shëndet “ (fq.62).Në dredhëz ka bukuri të vendit tim,pak gjak të malsorit trim; pak rreze të diellit n’agim, pak ëmbëlsirë të kësaj toke,pak qumësht të nënes loke, pak uj bjesheke, pak vese vere, pak ninullë zogu e ere, ka rritë, shëndet e fuqi për mua, për ty...”. Ka dhe krijime të tjera u kushtohen heronjve, si “Gjakut të derdhur të deshmorit i bie shiu e s’e lan, i bie dielli e s’e than” . (“Dëshmorit”, fq.74). Për nga cilësia, njësitë me përmbajtje kombëtare edhe në këtë tekst janë të një niveli të lartë. Por si zakonisht, sikurse edhe në tekstet e mëparme, edhe këtu ka njësi që afirmojnë vlerat ideo – politike të asaj kohe. Në vitin shkollor 1992/93 dhe 1993/94 në përdorim ishte teksti i autorëve Q. Batalli e M. Gjevori⁷³⁸. Në tekstin paraprak janë bërë disa ndërhyrje, duke eliminuar krijimet e autorëve ish – jugosllavë dhe disa nga përmbajtjet ideo – politike. Në aspektin sasior kemi një ngritje të nivelit të përmbajtjeve kombëtare sepse është zvogëluar numri i përmbajtjeve të tjera. Kështu, nga 66 njësi, 12 prej tyre janë me përmbajtje kombëtare e të cilat ishin prezente edhe në tekstin paraprak. Në vitin shkollor 1994/95 deri 1998 dhe 2004 ishte në përdorim teksti i autorëve Sh. Osmani, E. Abazi dhe A. Demolli⁷³⁹. Nga 74 njësi sa janë të përfshira në këtë tekst, 7 prej tyre janë me përmbajtje kombëtare.Në këtë tekst, asnjë prej njësive nuk përkon me frymën e ideo – politike sikurse që, asnjë prej tyre nuk është tematikë nga LNÇ. Pikërisht, mospërfshirja e asnjë krijimi letrar me motive nga LNÇ, bënë që numerikisht të jetë më i varfër me njësi me përmbajtje kombëtare. Por, vështruar nga aspekti cilësor mund të cilësohet i një niveli më të lartë. Kështu, teksti fillon me vjershën e N. Frashërit, “ Atdheu ” (fq.3) dhe për herë të parë flitet për Shqipërinë si atdhe i yni:“ Sa të dua, o Shqipëri ,sa mall ndjej e sa dëshirë; për ty gaz e dashuri, mu në zemër me ka mbirë ”. Edhe disa nga njësitë e tjera i kushtohen atdheut e natyrës së tij (“ Vendi im ”, fq.149)Gjuhës amtare dhe Skenderbeut (fq. 92-93 dhe 94-95). Kjoështë një deshmi për autocensurën e autorëve dhe “krursimin” e tyre për të mos shkelur në “dërrasën e kalbur” të politikës! Me unifikimin e teksteve të gjuhës e letersisë shqipe për klasat e ulta të shkollës fillore në nivel kombëtar, në vitin shkollor 1994/95 hyri në përdorim Gramatika e B.Beci etj⁷⁴⁰, e cila është në përdorim deri në vitin 2004. Nga 32 mësimet sa janë të mbarështruara në këtë tekst, në gjashtë prej tyre janë dhënë shembuj me përmbajtje kombëtare (Si shkruhet letra shokut, fq.86), një fragment për Skënderbeun, ku përshkruhet aspekti fizik i tij. “ Skëndebeu ishte një burrë i hijshëm, me trup të fuqishëm e plot muskuj.Ai e përdorte shpatën me lehtësi të madhe. Ishte fisnik dhe madhështor.Kishte sy të zinj, që shkëlqenin dhe mjekerr të gjatë e të dendur” (Skënderbeu, fq.103). Pastaj disa shembuj, fjalë e fjali të zgjedhura me kujdes:“Flamur i kuq me shqiponjë të zezë”, “...popull i lirë”, “Kalaja e Krujës”,“Qyteti i Krujës”, “Guri i Skënderbeut”, “...njeri i guximshëm” etj. (fq.104).Gjithashtu, përfshihen edhe shembuj e mësimet për qytetin e Tiranës (fq.111) dhe të Prishtinës (fq.114).

Në vitin shkollor 1974/75 deri 1978/79 ka qenë në përdorim libri i leximit i autorëve M.Gjevori e Sh.Veliu⁷⁴¹. Nga 118 njësi të përfshira në këtë tekst, 22 prej tyre janë me përmbajtje kombëtare. Krijimet e tilla flasin për atdheun (“ Mëmëdheu ”, fq.8, “ Vendi ynë po lulëzon ”, fq.49-50, “

⁷³⁸ Q. Batalli, M. Gjevori, Libër leximi e gjuhe për klasën e II të shkollës fillore, ETMM, Prishtinë, 1992.

⁷³⁹ Sh. Osmani, E. Abazi, A. Demolli, Leximi 2, “ Libri shkollor ”, Prishtinë, 1998.

⁷⁴⁰ Bahri Beci etj., Gjuha shqipe 2, “ Libri Shkollor ”, Prishtinë, 1998.

⁷⁴¹ M. Gjevori, Sh. Veliu, Zemrat rriten, Libër për klasën e III të shkollës fillore ETMM të KSAK, Prishtinë, 1976.

Dashuria ndaj atdheut ”, fq.55-56), dashurinë prindërore dhe familjen (“ Dora e nënës ”, fq.43-44, “ Motër e vëlla ”, fq.45-46), për Skënderbeun (“Kthimi i trimit ”, fq.81, “ Kthimi i Gjergj Kastriotit në Krujë ”, fq.70, “ Dëshmori ynë i parë ”, fq.68-69, “ Rinia e vendit tim ”, fq.57, “Vajza shqiptare ”, fq.67)etj.Në këtë tekst, përfshihen edhe njësi që i përkasin afirmimit të vlerave të sistemit socialist si: vëllazërim – bashkimit, partisë, Leninit. Në vitin shkollor 1978/79 deri 1986/87 ishte në përdorim libri i leximit i autorëve Sh. Veliu dhe M. Gjevori⁷⁴². Nga 122 njësi sa janë të inkorporuara në këtë tekst, 20 prej tyre janë me përmbajtje kombëtare. Disa prej tyre i kushtohen atdheut (“ Atdheu ”, fq.79, “ Vendi im ”, fq.75, “ Fshati im ”, fq.189, “Emri im qytet hero”, fq.99-100) pastaj dashurisë ndaj prindërve (“Nënë o nënë”, fq.41), ndërsa, një pjesë e madhe e tyre janë me tematikë nga LNC si, “Hajdar Dushi ”, fq.85, “Ferid Grezda ”, fq.88, “Liria është e shtrenjtë ”, fq.92, “Emri im bir”, fq.94) etj. Krahasuar me tekstin paraprak, vërehet një rënie si sasiore ashtu edhe cilësore e njësive me përmbajtje kombëtare. Në vitin shkollor 1987/88 deri 1991/92 ishte në përdorim libri i leximit i autorëve M. Gjevori dhe Q. Batalli⁷⁴³. Nga 73 njësi, vetëm 7 janë me përmbajtje kombëtare, madje, të gjitha këto janë, gjithashtu, me motive nga LNC, si “Varri i pionerit trim ”, fq.32, “Djali i vogël po pastron ”, fq.36, “Miku ynë”, fq.38, “Djali i çetës ”, fq.41., si dhe një vjershë për Hajdar Dushin dhe Kosovën. Po t’i shtojmë edhe njësitë tjera që janë në frymën e ideologjisë së kohës, atëhere, konstatojmë se, është një prej teksteve me përmbajtje të zbehtë kombëtare. Prandaj, jo rastësisht me rastin e vlerësimit të këtij teksti arsimtarët pohojnë se: “... në këtë libër leximi duhet të këtë më shumë krijime letrare nga tradita jonë...vallë a mund të mësohet letërsia shqipe pa Naimin, Migjenin, Çajupin, Samiun...?!”⁷⁴⁴

⁷⁴² Sh. Veliu, M. Gjevori, Këngë ngadhënjimi, Libër leximi për klasën e III të shkollës fillore, ETMM , Prishtinë, 1985.

⁷⁴³ M. Gjevori, Q. Batalli, Dritat tona, Libër leximi e gjuhe për klasën e III të shkollës fillore, ETMM , Prishtinë, 1988.

⁷⁴⁴ Izet Musaj, Libri i leximit të klasës së tretë në praktikën pedagogjike (shqyrtim), Libri shkollor, Buletini i ETMM të KSAK, Prishtinë, 1989, nr.1, fq.36.

6.6. VENDI DHE ROLI I TEKSTEVE TË GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE,1945 – 1961

Si burim primar vlerësohej vendi dhe funksioni i teksteve të gjuhës dhe atyre të letërsisë shqipe në procesin edukativo-arsimor në Kosovë gjatë periudhës së viteve 1945-1961. Këto tekste shkollore ndikuan shumëdimensionalisht tek shqiptarët e Kosovës, sidomos në zhdukjen e analfabetizmit dhe në vezhdimin e ngritjes së vetëdijës kombëtare. Botuesit e teksteve dhe mjeteve mësimore gjatë viteve 1945 deri në vitin 1991 ishin Këshilli Popullor për Kosovë e Metohi “Drejtorati arsimor për Kosmet”, “Drejtorati arsimor për Kosovë e Metohi – Komisioni pedagogjik”, Shtëpitë botuese “Mustafa Bakija” (e themeluar në vitin 1950)⁷⁴⁵, “Milladin Popoviq”, “Rilindja”⁷⁴⁶, Enti i Botimeve Shkollore të Republikës Socialiste të Serbisë – Reparti Prishtinë⁷⁴⁷ (institucioni ishte i emëruar me: Reparti për Botimin e Teksteve në Gjuhën Shqipe i Entit të Teksteve të Serbisë)⁷⁴⁸, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të KSA të Kosovës, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës dhe në fund Shtëpia Botuese Libri Shkollor në Prishtinë. Nga gjithë korpusi i librave shkollor për lëndën e gjuhës shqipe dominon tekstet për nevojat e nxënësve të shkollës fillore.⁷⁴⁹ Nga viti ’50 deri ’60 librat e leximit bëheshin ,te thuash ,antologji tekstesh letrare. Ato shquheshin me aparat didaktik-metodik (me sistem të përpunuar pyetjesh e detyrash), libër leximi bëhet tekst pune. 750 Për shumicën e lëndëve mësimore edhe për gjuhë amtare (shqipe), tekstet e para në gjuhën shqipe të pasluftës janë shtypur në shtypshkronja të Beogradit. Kjo kishte ndodhur sepse politika komuniste e Beogradit vazhdonte të tregojë “dorështërnguar” për shqiptarët e Kosovës (Kosmetit siç e quanin ata) të ndikuar nga politika nacionaliste serbomadhe e krajlive. Teksti i parë shkollor, “Këndimi im i parë” është botuar në shtypshkronjën “Luarasi” – Prizren – Tiranë. “Këndimi im i parë” në të cilin nuk figuron emri i autorit, ishte shtypur në Tiranë, më 1945, dhe sipas marrëveshjes së përbashkët mes Tiranës dhe Prishtinës tirazhi për Kosovë prej 20.000 ekzemplarësh ishte shtypur (enkas për Kosovë) me fotografinë e Titos (siç ishte praktikë për të gjitha tekstet e botuar në sistemet totalitare) dhe me shënim në faqen e parë “Drejtorati Arsimor për Kosmet, Prizren, 1945.”⁷⁵¹ Ndërkaq, në vitin 1946 është botuar një Abetare e cila ishte botim i Ministrisë s’Arsimit, Komisioni Pedagogjik, e cila ishte shtypur në Firencë. Kjo Abetare është shpërndarë për nxënësit e klasës së parë të shkollës fillore edhe në Kosovë, pa kurrëfarë ndryshimi.⁷⁵² Kurse ,në vitin 1946, Abetarja për të rritur është shtypur në Shtëpinë Botuese Grafike Shtetërore në Prizren.⁷⁵³

⁷⁴⁵ Mehmet Gjevori, Kujtime e shënime rreth punës së shkollave të para shqipe në Kosovë gjatë dhe pas Luftës II Botërore, Prishtinë, 1998, f. 77.

⁷⁴⁶ Bibliografia e Librit Shkollor në Kosovë 1945-1985, përgatitur nga Mr. Abdyl Ramaj, Prishtinë, 1985, fq. 3; Dvanaest godina kulturnog razvitka Kosova i Metohije, Priština 1957, f. 104.

⁷⁴⁷ Në pjesën më të madhe të teksteve të botuara gjatë viteve 1962 – 1969 është evidencuar si botues Enti i Botimeve të Teksteve të Republikës Socialiste të Serbisë – Beograd .

⁷⁴⁸ Monografi, Njëzet vjet të Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të KSAK (1970— 1990), Prishtinë, 1990, f. 12.

⁷⁴⁹ Tipologjia e teksteve të para në Kosovë ndiqte shembullin e teksteve serbe. Deri në vitin 1950, kur nis botimi i librave të leximit të llojit antologjik, përdorehin kryesisht tekste letrare artistike dhe informative.


⁷⁵⁰ Dragutin Rosandic, Metodické osnovne suvremene nastave hrvatskog ili srpskog jezika i njizevnosti u srednoj skoli, Skolska kniga, Zagreb, f. 8.

⁷⁵¹ Mehmet Gjevori, Si lindën dy abetaret e para shqipe në Kosovë, “Libri Shkollor” 1/1985, fq. 51.

⁷⁵² Qamil Batalli, Bibliografia e abetareve dhe e librave të leximit të shkollës fillore në gjuhën shqipe në KSAK 1945 – 1975, Prishtinë, 1978 (dorëshkrim), fq. 5.

⁷⁵³ Këtë lajm të gëzueshëm e shënon e përditshmja e vetme në gjuhën shqipe “Rilindja” , më 29 mars 1947.

Dokument: Ekzemplarë të abetarës në Kosovë ,të sjellë prej Mehmet Gjevori, Stathi Kostari dhe Sami Raça.



Duket se pas këtij botimi, në vitin 1947 në Drejtoratin Arsimuer të Kosovës, me qëllim të sigurimit të planeve dhe programeve mësimore si dhe të sigurimit të teksteve shkollore, ishte formuar komisioni pedagogjik. “Me qenë se librat e marruna prej Shqipnije nuk mjaftojnë me plotësue nevojën e madhe që ndihen për këto, dhe për të mujtë me i dhanë udhëzimet e duhuna kuadrit t’onë të ri mësimuer, pranë Drejtoratit Arsimuer Krahinuer për Kosovë e Metohi, u formue komisjoni pedagogjik.”⁷⁵⁴ Siq konstaton edhe studiuesi i pasionuar i teksteve shkollore, Bajram Shatri ,ky komision për shumë vjet me radhë do të hartoi tekste shkollor. {uditërisht,për të fshehur pas veprimeve të pakauptimita shoveniste në një numër të teksteve (ishin tekste të përshtatura nga gjuha serbe në gjuhën shqipe) nuk shenohej fare emri i autorit të tekstit,as emri i përkthyesit. Duke këndvështuar historinë e tekstit shkollor në Kosovë,hetohet se teksti i parë shkollor në gjuhën shqipe i botuarështë Njohuni natyra për klasën e tretë të shkollës fillore.E vetmja dritare informative “Rilindja” për lexuesit e jep si lajm me rëndësi të veçantë për shkollën shqipe “Duel nga shtypi libri i parë shkolluer për shkollat shqipe të Kosmetit...Ky tekst që asht i pari liber shkolluer për shkollat shqipe të Kosmetit, së shpejti do të ndiqet edhe prej tekstesh të tjerë sikurse Abetarja, libri i leximit për klasën e II -të të shkollave fillore dhe gjeografis për klasën e III-të, të cilat janë në shtyp dhe se shpejti kanë me u vue në qarkullim”.⁷⁵⁵ Deri në vitin 1948 , botohen 10 tekste dhe ato u shtypën në “Jugoštampa”, “Prosveta” dhe “Znanje” të Beogradit. Madje,në vitin 1950 janë botuar 11 tituj. Të gjithë janë shtypur në shtypshkronja të Beogradit. Ndërkaq, në vitin 1951 në Prishtinë .⁷⁵⁶ Prej vitit 1951 deri në vitin 1956 të gjitha

⁷⁵⁴ Pran Drejtoratit Arsimuer për Kosmet asht formue komisjoni pedagogjik, Rilindja, 29.III.1947.

⁷⁵⁵ Rilindja, më 9. 11. 1947.

⁷⁵⁶ Vehap Shita, Nga abetarja deri të tekstet universitare, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 1/1985. fq. 42-43.

(Në këtë kohë filluan të shtypen tekstet nga Shtëpia e parë botuese “Mustafa Bakija” e themeluar më 22 maj të vitit 1950.Drejtor i parë i shtëpisë botuese “Mustafa Bakija” ishte emëruar Remzi Shahsivari, kurse kryeredaktor Stathi Kostari, pastaj në redaksi ishin Mehmet Gjevori, Sulejman Drini, Ali Rexha, Vehap Shita etj. Në vitin 1951, prej 14

botimet e teksteve e mbajnë firmën “Mustafa Bakija”. Në vitin 1956 kjo Shtëpi botuese është bashkuar me shtypshkronjën “Milladin Popoviq” me seli në Prishtinë.⁷⁵⁷ Në vitin 1957 tekstet botohen kjo ndërmarrje, pjesërisht edhe në vitin 1958⁷⁵⁸. Në vitin 1958 bëhet integrimi i kësaj Ndërmarrjes Botuese Grafike me Redaksinë e gazetës “Rilindja”, e cila, duke filluar nga 29 nëntori i vitit 1958, bëhet gazetë e përditshme.⁷⁵⁹ Pra, Ndërmarrja botuese “Rilindja” si botuese e teksteve paraqitet për herë të parë në vitin 1958 me botimin e 19 teksteve, prej gjithsej 24 titujve sa ishin botuar në këtë vit dhe 5 tekste ishin botuar me firmën e “Milladin Popoviq”. Prej vitit 1959 e deri në vitin 1961 tekstet shkollore botohen nga ndërmarrja “Rilindja” me ndonjë numër shumë të vogël të “Graficki Zavod” të Beogradit.⁷⁶⁰

titujve, 10 sish janë shtypur nga “Mustafa Bakija”, ndërsa 4 të tjerë në Beograd. Shtëpia botuese “M. Bakija” edhe në Beograd kishte një lloj ekspoziture të saj, pasi në Beograd do të vazhdojë të botojë përsëri një numër të konsiderueshëm teksteve të veta. Në këtë ekspoziturë punonin në atë kohë Sulejman Drini, Ali Rexha e disa studentë të tjerë shqiptarë.)

⁷⁵⁷ Po aty.

⁷⁵⁸ Monografi: Njëzet vjet të Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të KSA të Kosovës (1970 – 1990), Prishtinë, 1990, fq. 21.

⁷⁵⁹ Vehap Shita, Nga abetarja deri të tekstet universitare, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 1/1985, fq. 43.

⁷⁶⁰ Bibliografia e Librit Shkollor në Kosovës 1945-1985, përgatitur nga Mr. Abdyl Ramaj, Prishtinë, 1985, fq. 3.(Në vitin 1949 në Beograd ishin përgatitur dhe janë botuar disa doracakë për mësues (kursistë) nga lëmi i pedagogjisë, i psikologjisë, i filozofisë etj. Këto tekste i kanë përgatitur për shtyp në Beograd Zekeria Rexha, Tajar Hatipi dhe Abdurrahim Gashi. Bashkë me Tajar Hatipin dhe Abdurrahim Gashin punonin dhe qëndronin në Beograd edhe dy daktilografë nga Kosova, Gonxhe Lumezi dhe Katarina (Dëshmi e A. Gashit, mars 2002). Në vitin 1949 prej 17 titujve të botuar, vetëm një është shtypur në Prishtinë me firmën Shtypshkronja “Progres”, ndërsa 16 titujt tjerë shtypen në Beograd te “Prosveta” dhe “Sipërmarrja botuese litografike”.

6.7. TEKSTET E GJUHËS SHQIPE, 1962 – 1969

Në vitin 1962, në Prishtinë formohet Shtëpia Botuese e Teksteve Shkollore që ishte paralele e ndarë e Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Serbisë. Prej vitit 1962 deri në vitin 1969 tekstet botohen nga Enti i Botimeve Shkollore i Republikës Socialiste të Serbisë – Reparti Prishtinë.⁷⁶¹ Në vitin 1970 kjo shtëpi botuese pavarësohet dhe ndahet nga ajo e Beogradit. Të gjitha tekstet shkollore të botuara deri në vitin 1991 mbajnë firmën Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSA të Kosovës. Në vitin 1992 në këtë firmë është hequr KSA dhe ka ngelur vetëm Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës. Në vitin 1994 Enti riemërohet me Shtëpia Botuese Libri Shkollor – Prishtinë, kurse prej janarit të vitit 1998 të gjitha botimet e kësaj Shtëpie Botuese mbajnë firmën e re Shtëpia Botuese Libri Shkollor Prishtinë. Prej vitit 1945 deri në vitin 1991 në Kosovë janë botuar mbi 1700 tituj të teksteve dhe të mjeteve mësimore me mbi 28 milionë ekzeplare.

Tabela 32. Botimi i teksteve për arsimin fillor në gjuhën shqipe, sipas periudhave pesëvjeçare 1945-1990

Vitet	Gjithsej	Autorë shqiptarë	%	Autorë serbë	%	Të përzier	%
1945-1949	22	15	71.43	6	28.57	1	4.76
1950-1954	78	22	28.21	56	71.79	0	
1955-1959	131	41	31.30	90	68.70	0	
1960-1964	126	34	26.98	92	73.02	0	
1965-1969	156	38	24.36	118	75.64	0	
1970-1974	221	63	28.51	158	71.49	0	
1975-1979	293	137	46.76	147	50.17	9	3.07
1980-1984	323	211	65.33	92	28.17	21	6.50
1985-1989	283	207	73.14	65	22.97	11	5.31
Gjithsej	1633	768	47.03	823	50.37	42	2.57

Nga të dhënat e prezantuara në këtë pasqyrë tabelare, mund të konkludohet se numri dhe përqindja më e lartë e teksteve të botuara në gjuhën shqipe për edukimin dhe arsimin fillor ishin të përkthyer nga gjuha serbe. Prej gjithsej 1633 teksteve të botuara, si botime apo ribotime, deri në vitin 1989, 768 tekste origjinale ishin të autorëve shqiptarë, apo 47,03 për qind; të autorëve joshqiptarë ishin 823 tekste, apo 50,40 për qind, dhe 42 tekste ishin të bashkautorëve shqiptarë dhe joshqiptarë, apo 2,57 për qind. Këtu nuk janë llogaritur doracakët e ndryshëm si dhe tekset dhe ilustrimet për edukimin dhe arsimin parashkollor dhe lektyra shtëpiake.

⁷⁶¹ Shih: B. Kastrati, Sh. Veliu e M. Gjevori, Libër leximi për klasën e parë të shkollës fillore, Prishtinë, 1965.

6.8. TEKSTET E GJUHËS SHQIPE NË VITET 1970-1991

Në vitin 1972 për nxënës dhe arsimtarë të shkollave fillore ishin botuar gjithsej 220 tituj të teksteve shkollore.⁷⁶² Prej tyre tekste shkollore origjinale ishin 70, kurse të përkthyer nga gjuha serbokroate ishin 150, apo 68,18 për qind.⁷⁶³ Tekstet shkollore hartohen në mbështetje të këtyre programeve nga autorët shqiptarë. Në vitet e 80-ta prapë bëhen ndryshime në programet mësimore në parimet e Bërthamave të përbashkëta, me ç'rast heqen nga programet mësimore disa nga figurat më të ndritura të letërsisë shqipe dhe në vend të tyre futen emra të rinj, të cilët ishin më pak të njohur për opinionin kosovar në përgjithësi. Në periudhën 20-vjeçare të Entit të Teksteve (1970-1990) botohen 1.272 tituj të teksteve mësimore për shkollën fillore, prej të cilëve në gjuhën shqipe ishin 1.108 tituj (87,11 për qind), në gjuhën serbe 120 tituj (9,43 për qind) dhe në gjuhën turke 44 tituj (3,46 për qind). Për shkolla të mesme, gjatë kësaj periudhe botohen apo ribotohen 1.050 tituj të teksteve mësimore për degë dhe profile të ndryshme mësimore. Përveç shkollës fillore dhe të mesme, edhe për shkolla të larta dhe fakultete botohen 400 tituj të teksteve universitare, prej të cilëve 258 në gjuhën shqipe.⁷⁶⁴ Në vitet 1989 – 1999 në Kosovë bëhen kthesa të rëndësishme sa u përket teksteve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë. Kishte raste kur gjuha shqipe “mësohej” nga teksti i autorëve serb, të cilët nuk e dinin gjuhën shqipe(!) Ilustrim i shembullit tipik ishte teksti shkollor Libër leximi për klasën II ishte hartuar nga grupi i autorëve në krye me Rade Vukoviq (përkthyes Mustafë Shala dhe Stathi Kostari), Libër leximi për klasën III, autorë ishin Stevan Filipoviq etj. (përkthyes Hasan Vokshi, Gjeto Leka), Libër leximi për klasën IV, autorë ishin Stevan Filipoviq etj., (përkthyes Hasan Vokshi, Gjeto Leka), Libër leximi për klasën III gjimnaz, grup i autorëve në krye me Dr. Vida Llatkoviq (përkthyes Jani Gjino dhe Hasan Vokshi). Në vitin 1952 ishte botuar vetëm Libër leximi për klasën parë(I) të shkollës fillore me autorë: Rade Vukoviq etj. (përkthyer nga S. Kostari dhe M. Gjevori). Përveç librave të leximit, edhe gramatikat për gjuhën shqipe ishin të hartuara nga autorët joshqiptarë. Në vitin 1948 ishte botuar teksti Gjuha jonë (sintaksë) për klasën III të shkollës fillore nga autori Ivo Fërd (përkthyes: H. Vokshi dhe T. Hatipi). I njëjti tekst ishte ribotuar në vitin 1949.⁷⁶⁵ Libri ka 145 mësimet - në prozë dhe në poezi, prej tyre të autorëve shqiptarë vetëm 8 mësimet, 5 poezi dhe 3 proza. Vjershat ishin të Latif Berishës, Mark Krasniqit, Besim Bokshit dhe dy “kangë popullore”, kurse mësimet në prozë të Hasan Vokshit, Mehmet Gjevorit dhe Hil Mosit. Të gjitha mësimet tjera ishin të autorëve, kryesisht serbë, si B. Çopiq, R. Çollakoviq, V. Dedijer, M. Gjilas, M. Aliçkoviq, V. Karaxhiqit etj. Kishte “Tregimi mbi Beogradin e vjetër e të ri”, “N’aradhen e parë të Shumadisë”, “Qele-kulla” etj.

Ajo që nuk kishte mundur të realizohej me tekste të përbashkëta në nivel të Jugosllavisë ishte arritur në nivel të Serbisë, të Kosovës dhe të Vojvodinës. Nga autorët e teksteve dhe të shtëpive botuese obligimisht kërkohet idejshmëria e përmbajtjeve mësimore të mbarështruara në tekst. Tekstet e kësaj lënde mësimore janë tekste të përbashkëta me autorë nga Shqipëria dhe nga Kosova, të cilat janë në përdorim si në shkollat e Shqipërisë ashtu edhe në ato të Kosovës. Tekstet Leximi (libër leximi) nga klasa I e shkollës fillore e deri në klasën VIII janë të autorëve të përbashkët. Vetëm Abetarja ndryshon. Në Shqipëri përdoret Abetarja e Kolë Xhumarit më se

⁷⁶² Grup autorësh, Kosova dikur e sot, Prishtinë, 1973, fq. 571.

⁷⁶³ Me planet dhe programet e reja mësimore, të cilat miratohen nga Pleqësia e Arsimit të Kosovës, bëhet një kthesë pozitive në raportin e letërsisë shqipe dhe të asaj jugosllave, në favor të letërsisë shqipe.

⁷⁶⁴ Njëzet vjet pune të Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të KSA të Kosovës, Libri Shkollor – Buletini i ETMMK 1/1990, Prishtinë, 1990, fq. 9.

⁷⁶⁵ Bibliografia e librit shkollor në Kosovës 1945 – 1985, (Shih Mr. A. Ramaj, Prishtinë, 1985. fq. 5 - 11.)

40 vjet, ndërsa në Kosovë momentalisht është në përdorim Abetarja e Qamil Batallit, e botuar për herë të parë në vitin 1982, çka do të thotë së kjo Abetare ishte në përdorim në klasën e parë më se 20 vjet (Abetarja e re e cila është në përdorim në vitin 2005 është përgatitur nga i njëjti autor në vitin 2003). Tekstet gjuha shqipe si lëndë mësimore prej klasës II e deri në klasën VIII janë të autorëve nga Shqipëria.

Prej vitit 1951 deri në vitin 1967 kur botohet historia e A.Hadrit⁷⁶⁶ në Kosovë për nxënës të shkollës fillore, botohen apo ribotohen gjithsej 50 tekste të historisë dhe të gjitha këto ishin të përkthyer nga gjuha serbe. Se çka kanë mësuar nxënësit shqiptarë nga tekstet e historisë mund të vërehet nëse analizohet përmbajtja e vetëm një teksti: Historia për kl. IV të shkollave tetëvjeçare botuar nga sipërmarrja botuese “Rilindja” në vitin 1958.

Deri në vitin 1962 të gjitha tekstet shkollore dhe mjetet mësimor në gjuhën shqipe ishin përgatitur dhe botuar në Entin e Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Beogradit, i cili është themeluar në vitin 1957⁷⁶⁷. Në këtë vit në Prishtinë hapet paralelja e Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Serbisë në Beograd. Hapja e këtij reparti në Prishtinë mundësoi që përgatitja e teksteve në gjuhën shqipe të bëhet në një qendër e cila do të shërbejë si koordinatore e shqyrtimit të kërkesave për tekste në gjuhën shqipe, për angazhimin e përkthyesve të teksteve të gjuhës serbe në gjuhën shqipe dhe të angazhimit të ndonjë autori të gjuhëshqipe si lëndë mësimore. Redaktorët profesionalë dhe redaktori teknik i repartit të Prishtinës për çdo tekst dhe për çdo botim duhej të udhëtonin në Beograd. Disa prej tyre më shumë kanë qëndruar në rrugë dhe në Beograd se në Prishtinë.⁷⁶⁸

Prej vitit shkollor 1962 deri në vitin 1969 (një vit para pavarësimit të Entit) në Prishtinë, si paralele e ndarë e Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Serbisë, ishin botuar gjithsej 464 tituj të teksteve shkollore (duke mos llogaritur lektyrën shkollore dhe tekstet e tjera - doracakët etj.). Prej tyre për nxënës të edukimit dhe të arsimit fillor 241 tituj dhe 223 për nxënës të arsimit të mesëm. Nga numri i përgjithshëm i teksteve, të autorëve shqiptarë ishin 62 tekste, apo 13,36 për qind, ndërsa 405 tekste, apo 86,64 për qind, ishin të përkthyer nga gjuha serbe. Ky raport i autorëve shqiptarë me ata të përkthyer ndryshonte sipas niveleve të arsimit. Në edukimin dhe arsimin fillor, nga 241 tituj, të autorëve kosovarë ishin 49 tekste, apo 20,33 për qind, kurse në arsimin e mesëm nga 223 tituj, të autorëve kosovarë shqiptarë ishin 13 tituj, apo vetëm 5,83 për qind.⁷⁶⁹ Në vitin 1970 për nxënës të shkollës fillore në gjuhën shqipe ishin botuar gjithsej 220 tituj me tirazh 4.500.000 ekzemplarë. Prej tyre, tekste origjinale ishin 70 tituj, ose 31,82 për qind, kurse 150 tituj të teksteve ishin të përkthyer nga gjuha serbe, apo 68,18 për qind.⁷⁷⁰ Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore u bë institucion i pavarur nga 28 marsi i vitit 1970, kur u

⁷⁶⁶ Teksti shkollor ishte vënë në funksion të etnocidit. [uditërisht ,akademik Ali Hadri për herë të parë e shtjelloi historinë e popullit shqiptar në mënyrë shkencore dhe objektive, duke e demistifikuar politikën dhe “shkencën e miteve” dhe atë antishqiptare. Për herë të parë nxënësit shqiptarë në Kosovë u informuan për historinë shqiptare në vitin 1967, kur botohet teksti i Ali Hadrit “Pasqyrë e historisë së shqiptarëve” për klasën VI, VII dhe VIII të shkollës fillore. Se sa ishin të etshëm nxënësit dhe arsimtarët shqiptarë për ta mësuar historinë e mirëfilltë shqiptare, dëshmon fakti se ky tekst, i botuar në 15.000 kopje, për një vit u shitën të gjithë ekzemplarët. Atë e merrnin jo vetëm nxënësit e shkollës fillore, të cilëve u ishte kushtuar, por edhe nxënësit e shkollave të mesme, studentët dhe intelektualët e tjerë. Aq shumë pat interesim, sa që në vitin 1968 prapë u ribotua me një tirazh që për atë kohë ishte mjaft i madh – në 15.000 ekzemplarë. Mirëpo, ky tekst ishte vetëm si tekst plotësues për historinë e shqiptarëve, ndërsa tekstet bazë të historisë edhe më tutje ishin në përdorim ato të hartuara nga autorët serbë.

⁷⁶⁷ Dr. Ranko Simović, Politika obrazovanja i njena realizacija u SR Srbiji, Beograd, 1990, fq. 146.

⁷⁶⁸ Nijazi Hashani, redaktor teknik prej vitit 1968.

⁷⁶⁹ Grup autorësh, Shifra dhe fakte..., fq. 166.

⁷⁷⁰ Grup autorësh, Kosova dikur e sot, Prishtinë, 1973, fq. 571.

themelua viti Enti me veprimtarinë e tij botuese ka bërë kthesë të rëndësishme në edukimin dhe në arsimin e nxënësve shqiptarë të të gjitha niveleve në Kosovë dhe në treva të tjera. Në këtë vit themelohet edhe Universiteti i Prishtinës. Me themelimin e këtij Universiteti fillon një etapë e re në krijimin e kuadrit të mirëfilltë e shkencor e mësimor edhe në gjuhën shqipe. Me rritjen e Universitetit krijohet një plejadë e re intelektualësh, krijuesish dhe shkencëtarësh, të cilët më vonë do të jenë hartues të teksteve shkollore dhe universitare. Në dekadën e parë të veprimit të Entit si intucion i vetëm profesional për hartimin dhe botimin e teksteve shkollore dhe të dokumentacionit shkollor, si në arsimin fillor, dhe në atë të mesëm, dominonin tekstet e përkthyer por me një përqindje më të vogël. Në periudhën mes viteve 1970 dhe 1979, në edukimin fillor ishin botuar 492 tituj të teksteve shkollore, prej tyre 220 tituj ishin origjinale, apo 44,72 për qind, kurse të përkthyer ishin 272 tituj, apo 55,28 për qind. Në arsimin e mesëm ky raport ishte po ashtu në favor të teksteve të përkthyer. Prej gjithsej 244 titujve të teksteve të botuara për herë të parë, të përkthyer ishin 190 tekste, apo 77,87 për qind, kurse tekste origjinale ishin 54 sosh, apo 22,13 për qind⁷⁷¹


Në vitet e 80-ta, pas demonstratave të studentëve e të rinisë shqiptare, si burim kryesor të “indoktrinimit të irredentistëve dhe të seperatistëve shqiptarë” u cilësuan: a) planet dhe programet mësimore në gjuhën shqipe; b) tekstet dhe literatura shkollore; c) arsimtarët shqiptarë; d) organizimi pedagogjik i shkollës, dhe ç) bashkëpunimi i shkollave shqipe me institucionet dhe shkollat e Shqipërisë. Nga bibliotekat dhe mediotekat e shkollave fillore dhe të mesme u hoq dhe u zhduk literatura shqipe e autorëve të hequr nga programet mësimore, ndërsa plotësisht u hoqën mjetet mësimore të konkretizimit të importuara nga Shqipëria (skema për mësimin e gramatikës, herbariumet, akuariumet, fotografitë e tjera ilustrative e të konkretizimit etj.)⁷⁷²

⁷⁷¹ Po aty.

⁷⁷² Me ndryshimin e Planeve dhe të programeve mësimore, sidomos të lëndëve shoqërore, edhe tekstet shkollore në gjuhën shqipe ndryshojnë duke ju nënshtruar një censurë më të theksuar. Censura ekzistonte për të gjitha tekstet, por më e ashpër ishte ndaj teksteve shkollore të lëmenjve shoqërorë, si të teksteve të historisë, të artit, të gjuhës e të letërsisë, të gjeografisë etj.

6.9. HARTIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE TË GJUHËS SHQIPE TË VITEVE ' 90

Gjatë gjithë historisë së tij shumëshekullore populli shqiptar ka luftuar për të ruajtur gjuhën kundër përpjekjeve asimiluese, dhe në këtë përpjekje intelektualët atdhetarë paseshtur punuan në unifikimin e alfabetit dhe hartimin e rregullave të drejtshkrimit e drejtshqiptimit-gramatikave të gjuhës shqipe.⁷⁷³ Andaj mund të konstatohet se, "...libri ishte burimi më i rëndësishëm për fitimin e njohurive gjithëpërfshirëse, burim i të gjitha diturive..."⁷⁷⁴ pra, kjo vlente sidomos për librat e gjuhës shqipe. Mirëpo, edhe, "në epokën e tashme të një shpërthimi të vertetë të mjeteve moderne, si ato kompjuterike, audivizuele, etj. teksti shkollor mbetet ende instrumenti më i përhapur dhe pa dyshim më efektiv i procesit mësimor."⁷⁷⁵



Graf. Mësimdhënia dhe të nxënit në tekstet shkollorë të gjuhës shqipe⁷⁷⁶

Analizë e përmbajtjeve letrare të teksteve shkollorë të gjuhës shqipe në periudhën e pas çlirimit të Kosovës

⁷⁷³ Nuhi Rexhepi, Letërsia shqipe në tekstet shkollorë të Kosovës (1945-1990) Logos, Prishtinë, 2002.

⁷⁷⁴ Josip Malić, Ugraditi u udžbenike sve ono što nas spaja i što nas daje krila za let u bolje sutra, "Libri Shkollor", Prishtinë, 2/1985, fq. 21-22.

⁷⁷⁵ ISP, Grup autotësh, Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollorë, Tiranë, 2003, fq.11.

⁷⁷⁶ H.Devetaku, Vepër e cituar, Paraqitja grafike ilustron tekstet shkollorë të gjuhës shqipe deri në fillimin e reformës arsimore në Kosovë.

Në Kosovë, një tekst shkollor gramatike gjatë gjithë periudhave të hartimit i është nënshtruar kërkesave shkencore, didaktike, grafike dhe kontekstuale për cilësinë. Ballafaqimi me programet kombëtare ishte kusht për autorët e teksteve mësimore të gramatikës, të cilët do të duhej që përmbajtjet e teksteve duhet të pasqyrojnë përmbajtjen e planeve dhe programeve mësimore shtetërore, sipas klasave dhe niveleve të arsimit.

Tekstologët vlerësojnë se hartimin më profesional e bëjnë specialistët e fushave (mësuesi i lëndës) bashkë me ndonjë pedagog universitar. Domosdoshmërisht eksperimentohej libri pas botimit në përdorim, që të hetohen mangësitë. Periudha më e rëndësishme e teksteve në Kosovë mësimore është ajo e filimit të pavarësisht të arsimit shqip. Nga viti 1996, të kohës në shkollë zbatoheshin tekstet shkollorë të kësaj periudhe, pra tekstet e viteve të 90-ta dhe një pjesë e teksteve të hartuara në mbështetje të programeve të reja mësimore, të cilat u përdorën deri në vitin 2004.⁷⁷⁷ Pas kësaj faze, reforma arsimore përfshiu të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, gjithashtu edhe tekstet shkollorë, kështu që periudha e dytë e analizës përfshinë tekstet shkollorë të gjuhës shqipe në arsimin e detyruar, të botuara nga viti 2004 – 2008. Në periudhën e parë kohore ishte një kombinim i teksteve tradicionale me tekstet e hartuara në bazë të programeve zyrtare. Kurse në periudhën e dytë janë analizuar tekstet e tjera të reja, të cilat tashmë zëvendësuan të gjitha tekstet e vjetra shkollorë të gjuhës shqipe.⁷⁷⁸

Në Kosovë, tekstet shkollorë të botuara pas çlirimit të Kosovës vlerësohet se tekste të reja shkollorë janë të hartuara në mbështetje të programeve zyrtare të miratuara nga MASHT-i. Ndryshimet janë të dukshme si për nga përmbajtja, ashtu edhe për nga qasja metodologjike, pyetjet dhe detyrat, ilustrimet, korrelacioni ndër-lëndor dhe ndër programor. Janë shënuar përparime në tekstet e reja shkollorë. Një periudhë kishte dhe autorë të përbashkët të teksteve të gjuhës shqipe, si Leximi prej klasës së parë deri në klasën e tetë të shkollës fillore. Edhe redaktorët profesional ishin të përbashkët, një nga Prishtina dhe tjetri nga Tirana. Kështu, shtohet kujdesi i autorëve që “Pasqyrimi i letërsisë së sotme shqiptare në planprogramet dhe tekstet e shkollës së mesme paraqet në vetvete një problem nevralgjik për mësimdhënien, meqenëse është fjala: në radhë të parë për një letërsi të ndarë (apo të përbërë) nga dy periudha shumë të ndryshme në mes vete, periudha e letërsisë së ideologjizuar të diktaturës që karakterizohej nga një drejtim letrar i vetëm (1944-1990) dhe periudha e pasdiktaturës, kur vihet re një letërsi që dallohet nga një pluralizëm drejtimesh letrare dhe vënia në plan të parë të kriterit estetik dhe, së dyti periudha e saj e dytë është një letërsi në zhvillim e sipër, pra ende e pakristalizuar.”⁷⁷⁹

Vlen të ceket se në këto tekste të përbashkëta janë marrë parasysh specifikat e ndryshme të natyrës politike, por edhe ato të natyrës praktike didaktike. Duke analizuar disa nga tekstet e pas kësaj periudhe do të spikasim praninë e përmbajtjeve të letërsisë në këto tekste shkollorë.

Teksti shkollor Leximi 2,⁷⁸⁰ pasqyron tekstin “Vjeshta dhe miqtë e saj”, tekstin “Marigona dhe Flamuri”. Ky tekst vuan nga mungesa e tregimeve, poezive, përrallëzave, etj. Teksti shkollor

⁷⁷⁷ Fillimisht është hartuar Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës, e cila paraqet strukturën e re të sistemit arsimor parauniversitar 5+4+3. Kjo nënkupton rritjen e arsimit të detyruar nga tetë në nëntë vite shkollorë. Në mbështetje të strukturës së re arsimore janë hartuar programet dhe tekstet e reja shkollorë nga klasa e parë deri në klasën e trembëdhjetë. Tekstet e reja shkollorë gradualisht kanë zëvendësuar tekstet paraprake.

⁷⁷⁸ Grup Autorësh, Korniza e kurrikulit të ri të Kosovës, Libri i bardhë për diskutim, (arsimi parashkollor, fillor, i mesëm dhe i mesëm i lartë), Prishtinë, 2001, fq. 129.

⁷⁷⁹ Klara Kodra, “Dy periudhat e letërsisë së sotme shqipe në planprogramet dhe tekstet mësimore të shkollës së mesme”, në IAP “letërsia në shkollë e në fakultete”, Prishtinë 2008, fq. 35.

⁷⁸⁰ Arif Demolli, Leximi 2, Libri shkollor, Prishtinë, 2004.

“Gjuha shqipe 2”,⁷⁸¹ tekstet letrare e jo letrare, janë në harmoni me kërkesat e planit dhe programit të ri mësimor. Në këtë tekst shkollor nuk janë të mjaftueshme tregimet e zgjedhura, mandej do të duhej të kishte më shumë përrallëza dhe përralla, mungon pjesa e teksteve të thjeshta dramatike, etj.

Te libri shkollor “Leximi 3”,⁷⁸² pasqyrohen tekste me qasje të integruara. Dallon në përparësitë e këtij teksti shkollor përfshirja e tregimeve, si “Gurët e Kreshnikëve” (faqe 54-57), madje teksti që pasqyron qasje ndërlëndore, teksti “Himnin e Flamurit”, (faqe 28). E veçanta e këtij teksti është se, krahasuar me tekste të tjera shkollore këtu është prezantuar edhe “Gjuha shqipe dhe leximi 3”,⁷⁸³ si tekst shkollor është mjaft e larmishme. Është një kombinim i tradicionales me bashkëkohoren. I gjithë teksti është i paisur me ilustrime, figura, pyetje dhe detyra.

Kurse teksti shkollor “Gjuha shqipe dhe leximi 4”,⁷⁸⁴ është tekst me qasjen e integruar me informacione të domosdoshme. Ai është si një kombinim i tradicionales me bashkëkohoren. Elemente të integrimin të gramatikës i gjejmë në tregimin “Gjyshja e të gjithëve” (faqe 32). Ky tekst pasqyron edhe lidhjen ndërlëndore. Ndërsa “Leximi 4, Gjuhë shqipe dhe letërsi”,⁷⁸⁵ libër i hartuar në mbështetje të programit zyrtar, përfshin tekstet letrare dhe jo letrare, shkrimi, leximi. Pjesa e teksteve letrare dhe jo letrare përmban larminë e teksteve të zgjedhura, me përmbajtje të ndryshme fantastike, shoqërore, historike, so edhe kallëzime popullore, lloje të ndryshme të përrallave, poezi të ndryshme që trajtojnë tema të ndryshme, fjalë të urta etj.

“Gjuha Shqipe dhe leximi 5”,⁷⁸⁶ përfshin tekstet letrare e jo letrare dhe ajo që është kryesorja, teksti shkollor ofron vetëm informacione të domosdoshme, gjë që nuk konsiderohet se i ngarkon nxënësit. Në këtë tekst kemi integrim gjuhë-lexim: Dhelpra dhe kafshët e tjera (faqe 78), kohët e foljes (koha e pakryer) së bashku me tekstin jo letrar “Gjyshja ime Sevasti Qiriazit” (faqe 153). Ndërkaq libri shkollor “Leximi 5, gjuhë shqipe dhe letërsi”,⁷⁸⁷ përmban tekstet e zgjedhura, përfshirë tregime nga më të ndryshmet, si, për shembull, tregime popullore, tregime të autorëve vendorë dhe ndërkombëtarë, të zgjedhura për moshën dhe interesimin e nxënësve. Aty gjendet poezia “Në parkun e Tiranës”, f.45, pyetjet që janë hartuar nxjerrin në spikamë tri figura të shquara të Rilindjes sonë kombëtare. Kur vështrojmë tekstin “Leximi letrar 7”,⁷⁸⁸ vihet re se ka bërë ikje nga programi zyrtar sic ngjanë edhe te teksti shkollor “Gjuha shqipe 8”,⁷⁸⁹ të cilit mund të themi se i mungon vlera artistike e teksteve që janë paraqitur shumë shkurt dhe në shërbim të pjesës gramatikore.

Rishikimi i teksteve të letërsisë shqipe në Kosovë

Gjithë ndryshimet që kanë ndodhur kudo në trojet etnike shqiptare, kanë krijuar një klimë të re edhe në sferën e ndryshimeve në sistemin arsimor. Nga kjo klimë e re ka buruar nevoja për të rivlerësuar përmbajtjet në librat shkollor dhe planprogramet tona mësimore të gjuhës dhe të letërsisë.

⁷⁸¹ Bahri Beci, Gjuha shqipe 2, Dukagjini, Pejë, 2006.

⁷⁸² Arif Demolli, Leximi 3, Libri shkollor, Prishtinë, 2008.

⁷⁸³ R. Petro, M. Kumnova, Gjuha shqipe dhe leximi 3, Albas, Prishtinë, 2006.

⁷⁸⁴ R. Petro, M. Hyseni, Gjuha shqipe dhe leximi 4, Albas, Prishtinë, 2006.

⁷⁸⁵ Xhevat Syla, Leximi 4, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Libri Shkollor, Prishtinë, 2006.

⁷⁸⁶ Grup autorësh, Gjuha shqipe dhe leximi 5, Albas, Prishtinë, 2007.

⁷⁸⁷ Xhevat Syla, Leximi 5, gjuhë shqipe dhe letërsi, Libri Shkollor, Prishtinë, 2007.

⁷⁸⁸ Mazllum Kumnova, Munish Hyseni, Leximi letrar 7, botimi i tretë, Libri shkollor, Prishtinë, 2006.

⁷⁸⁹ Bahri Beci, Gjuha shqipe 8, Dukagjini, Pejë, 2006.

Në arsimin parauniversitar në Kosovë, ka filluar pilotimi i kurrikulës së re. Është kjo fazë një mundësi e mirë që të përkushtohemi në evitimin e lëshimeve dhe gabimeve. Kjo punë do të duhej bërë me kujdes dhe me emergjencë edhe për faktin se nga specialistë të fushës është reflektuar performancë e dobët, sidomos ajo e teksteve të letërsisë shqipe. Tekstet shkollore, sidomos të letërsisë shqipe vuajnë nga lëshime përmbajtësore, të aparaturës, të drejtshkrimit, etj. Nga analizat e bëra deri tani vihet re se lëshimet më të shpështa i takojnë çështjës se “Copëzimi i letërsisë shqipe është trajtim joshkencor, i papranueshëm dhe në mospajtim me interesin kombëtar të shqiptarëve shumë dhjetëvjetsha më parë”⁷⁹⁰ Kjo ka reflektuar që shpesh në tekstet e letërsisë të kemi edhe periodizimin e gabuar dhe përfaqësimin jo të drejtë të periudhave. Ka raste kur sforcohet periudha e Letërsisë së Vjetër dhe mbetet anash Letërsia e Periudhës së Rilindjes apo ajo e periudhave tjera. Në mesin e lëshimeve evidente, më të shpeshtat janë rastet kur përfaqësimi i autorëve në planprograme dhe në libra letërsie mbështetet në preferencë krahinore, fetare, partiake e klanore të autorit të librit. Nuk merret kriter vlera artistike e veprave të autorëve, por favorizimi bëhet mbi baza të nepotizmi, grupeve të interes, monopolizmit nga autorë të mbështetur nga redaktorë e recensentë mbi baza partiake e tarafe të ndryshme. Një segment i rëndësishëm i dobësive të këtyre teksteve pozita e papeshuar e përfshirjes së letërsisë, moskujdesi për korrigjimin e ndryshimin e lekturës shkollore, e kriterëve të përfaqësimit të letërsisë botërore në planprogramet dhe në librat e letërsisë. Shpesh është vënë në lajthitje misioni i tekstit mësimor për formësimin e personalitetit të ri që “...të punojnë që “të vetërealizohen”,⁷⁹¹ sepse “teksti mësimor mund të bëhet vetë mësues-udhëheqje për ata që arsimohen vetë.”⁷⁹²

Te letërsia e quajtur moderne nuk përfshihet Asdreni që është në të vërtetë modern, ndërsa krijues modern quhen Mjeda, Fishta, Koliqi, Migjeni, nga të cilët këtu e ka vendin vetëm Migjeni. Siç do të shprehej studiuesja jonë Sh. Islamaj “Fëmijët tanë kanë të drejtën e patjetërsueshme të formësohen drejt, përveç profesionalisht, edhe kombëtarisht, intelektualisht dhe gjuhësisht,”⁷⁹³ A nuk është ky një periodizim fort i gabuar që krijon defekte? Po ashtu tek përfshirja jo e drejtë dhe pa kriter e periudhave dhe autorëve është ilustrues fakti se në një nga tekstet e letërsisë përfshihen gjashtë autorëve të letërsisë së vjetër Gjon Buzuku, Frank Bardhi, Pjetër Bogdani, Jul Variboba, Nezim Berati dhe Hasan Zyko Kamberi përballë tre autorëve të letërsisë së periudhës së Rilindjes Kombëtare Jeronim De Rada, Naim Frashëri dhe Ndre Mjeda. Ç’është edhe më keq në një rast nxënësit Mjedën e mësojnë si poet romantik e në një tjetër si poet modern! Madje, ka raste kur afrohen të dhëna të pasakta, si “rasti për libri i L. Matrëngës, kur thuhet se “Ajo ruhet sot në Bibliotekën e Vatikanit dhe ka gjithësej 174 faqe” (Një pasaktësi, sepse libri ka 28 faqe.)⁷⁹⁴ Rrëshqitje tjetër në librat e letërsisë Shqipe në Kosovë është edhe përfshirja sipas parimit gjeografik, në një libër leximi nga letërsia e periudhës së Luftës së Dytë Botërore, përfshihen tre autorë, ndërsa dy prej tyre janë nga Kosova, Anton Pashku dhe Ali Podrimja dhe vetëm Ismail Kadare nga Shqipëria. Është kohë e fundit që të lirohemi nga qarku i mbyllur i autorëve, i redaktorëve dhe i recensentëve të librave të letërsisë.

⁷⁹⁰ Rexhep Qosja, Letërsia shqipe në shkolla dhe fakultete, IAP, Prishtinë, 2008, fq.14. (Shih dhe trajtesën tek “Periodizimi i letërsisë shqipe” (1973) dhe “Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi I-II III” (1985-1986).

⁷⁹¹ Andre Ouellet, L'evaluation kreative, Press de l'Université du Québec, Montreal, 1983, fq.117

⁷⁹² Abdyl Ramaj, Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor, LSH, Prishtinë, 2001, fq.20. (Shih. Pedagogickji sulovar, Moskva, 1960, fq. 532.)

⁷⁹³ Shefkije Islamaj, Tekstet e gjuhës dhe letërsisë, IAP, 2008, fq.64. (Nga botimi i veçantë “Letërsia në shkolla dhe në Fakultete”, Prishtinë, 2008.)

⁷⁹⁴ Sabri Hamiti, Letërsia e vjetër shqiptare-klasa 10, Botime shkollore, Albas, 2007, ribotim, fq.155.

Është kohë e fundit që të lirohemi nga logjika partiake, lokaliste e klanore në favorizimin e autorëve të teksteve shkollore. Gjykimin objektiv për letërsinë shqipe dhe vlerat e sajë artistike do ta ndihmonte me siguri edhe ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit mbi botimin e teksteve dhe mjeteve mësimore të Republikës së Kosovës për të evituar monopolizimin dhe varfërimin e këtyre teksteve shumë të rëndësishme për formësimin e personaliteteve të reja. Librat e leximit në Kosovën e pasluftës çlirimtare të UÇK-së vuajnë edhe nga gabime materiale, si datat e lindjes a të vdekjes të autorëve të shquar të letërsisë sonë, si dilema nëse Pjetër Bogdani lindi 1625, apo më 1630, apo pikëpyetja për datën e vdekjes së tij, është 6 dhjetor 1689, apo më 1686. Madje është paradoksal fakti se poetin Lasgush Poradeci e shpallë të vdekur më 1978, dhjetë vite para se të vdiste! Të natyrës së njejtë e bëjnë edhe gabimin mbi Naim Frashërin, të cilin e sjellin në jetë plot 18 vjet para se të lindte. Për Pjetër Budin në një tekst shkruhet se ai ka mbaruar studimet në Loreto të Italisë, kurse vet Budi dëshmon se gjithë mësimet dhe dituritë i kishte si autodidakt. Përmbajtje të gabueshme dhe gafe të madhe, e shpërfillje materiale hetohen edhe në sferën e përdorimit të terminologjisë letrare. Një rast, gabimisht shkruhet termi ode-odja si odë dhe si odeja, madje dialogje në vend të dialog, etj. Lëshim tjetër material i këtyre teksteve është fakti se për librin e parë “ Meshari “ të Gjon Buzukut, në dy tekste letrare, del se kjo vepër ka parathënje, duke mos ditur se librit tonë të parë të shkruar shqip i mungojnë 16 faqet e fillimit të tij. Edhe përfaqësimi të letërsisë popullore në tekstet mësimore bëhet jo dinjitetshëm. Edhe përdorimi i trajtave jonormative dhe gabimet në strukturën sintaksore të fjalive dhe periudhave janë evidente në këto tekste. Po ashtu edhe lektyra shkollore që u ofrohet fëmijëve tanë, thajse është konservuar është e pa shije dhe e tejkaluar! Madje edhe raporti në mes letërsisë kombëtare dhe vepra të autorëve të huaj, klasik e të rinjë nuk është i peshuar. Problem tjetër që shoqëron tekstet e leximit është edhe fakti se krijohet përshtypja se autorët e këtyre teksteve janë njohës mëse modest të letërsisë botërore. Këto tekste që ende janë në përdorim vuajn shumë nga mosrespektimi i parimeve didaktiko-metodike dhe sidomos parimit të moshës së nxënësve.

6.9.1. TEKSTET E GJUHËS SHQIPE NË VITET 1992-2000

Në vitin 1990 nga Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Serbisë dhe i strukturave shtetërore e “profesionale “të Serbisë është shtruar çështja e hartimit të teksteve unike (të përbashkëta) për tërë territorin e Serbisë. “Në një Republikë duhet të përdoret një tekst unik, tekste unike për mbarë territorin e RS të Serbisë”. Me këtë unifikim të teksteve tentohej që edhe Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës të inkorporohej në atë të Beogradit, si filialë apo servis.⁷⁹⁵ Pra, tekstet mëtohej të shkruheshin në gjuhën serbe, ndërsa ato të përktheheshin nga shqiptarët dhe ETMM i Kosovës të shndërrohej në Ent të përkthyesve, siç është vepruar një kohë të gjatë pas vitit 1948. Me ligjet diskriminuese të arsimit, të cilat ishin miratuar në Serbi, lejimin e teksteve për botim do ta bënte vetëm Pleqësia e Arsimit e RSS.⁷⁹⁶ Në nenin 21 të Ligjit për arsimin dhe edukimin fillor shkruan: “Në punën edukative-arsimore përdoren vetëm tekstet dhe mjetet mësimore, të cilat janë të lejuara nga Pleqësia e Arsimit e RS të Serbisë.”⁷⁹⁷ Sipas kësaj, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Enti Pedagogjik i Kosovës dhe Pleqësia e Arsimit e Kosovës do të duhej të shuheshin! Nxënësit shqiptarë në tekstet “e përbashkëta “do të mësojnë dhe do të lexojnë njësinë: “sllavët e jugut- stërgjyshërit tanë, pastaj ilirët – një popull i vjetër që nuk ekziston më etj.”⁷⁹⁸ Kërkohej që të kthehej koha e viteve 1950, kur edhe Sintaksën e gjuhës shqipe për klasën III e kishte hartuar një serb ose, siç ishte vepruar me tekstet e libër leximit për nxënës të ciklit të klasave të ulëta të hartuara me kritere të gjuhës serbe, nga autorët serbë me përkthime të dobëta në gjuhën shqipe. Organi i dhunshëm në këtë institucion, më 16 korrik mori në pronësi tërë pasurinë e Entit⁷⁹⁹ mbylli depon dhe i përvetësoi 657 tituj të teksteve të të gjitha niveleve të arsimit (prej tyre në gjuhën shqipe 112 tituj i dedikoheshin arsimit fillor, 195 tituj arsimit të mesëm dhe 192 tituj ishin tekste universitare) në të tri gjuhët mësimore (shqip, serbisht dhe turqisht), tërë dokumentacionin pedagogjik dhe shkollor, të gjitha mjetet mësimore, i mori të gjitha libraritë (3 sosh), përvetësoi të gjitha automjetet zyrtare të udhëtarëve dhe të transportit dhe kështu Entin e dëmtoi për rreth 7 milionë marka gjermane.⁸⁰⁰ Çdo gjë ishte ndërmarrë me qëllim të ndalimit të përdorimit të teksteve në gjuhën shqipe, të cilat për pushtuesin serb ishin në funksion të ngritjes së ndjenjës së separatizmit shqiptar. “... janë shikuar tekstet shkollore. Ato tekste të cilat nuk u përgjigjen përmbajtjeve mësimore sipas ligjeve (të Serbisë) do të hiqen nga përdorimi ose Shërbimi pedagogjik arsimor i Kosovës do të botojë

⁷⁹⁵ Tekstet e reja, sipas tyre, do të hartoheshin në bazë të konkursit të përbashkët në të cilin do të kishin” të drejtë” të konkurronin autorët e teksteve nga mbarë Serbia. Nëse ndonjë botues nuk është në gjendje të hartojë tekste të përbashkëta me specifikat përkatëse, atëherë ai botues duhet të huazojë tekste nga botuesi tjetër, përkatësisht nga Serbia e cila “është” në gjendje të botojë çdo tekst. Përmes teksteve, serbët mundoheshin që t’i zyrtarizonin planet dhe programet mësimore të cilat për tërë territorin e Serbisë ishin miratuar në janar të vitit 1990. Serbia përmes teksteve të përbashkëta tentonte që nxënësve joserbë, sidomos atyre shqiptarë, t’ua imponojë tekstet e ETMM të Beogradit.

⁷⁹⁶ Abdyl Ramaj, Tekste unike për Serbi unike!, Shkëndija, 1 qershor 1990.

⁷⁹⁷ Ligji mbi edukimin dhe arsimin fillor dhe të mesëm të Kosovës. (Në nenin 2 Pleqësia e Arsimit e Serbisë “nxjerr planin e botimit të teksteve mësimore, të cilat do të përdoren në shkollën fillore dhe të mesme dhe mjetet e tjera mësimore në shkollat fillore dhe të mesme dhe bën vlerësimin e tyre gjatë përdorimit

⁷⁹⁸ Hajrullah Koliqi, Diskriminimi dhe segregacioni në arsimin kosovar,)Shkëndija, 20 qershor 1990.

⁷⁹⁹ Xhevat Sylja, Veprimtaria e Entit të teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Kosovës gjatë periudhës 1991-1997, Libri Shkollor, 1/2000

⁸⁰⁰ Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore të Kosovës: Informatë lidhur me gjendjen e librit shkollor në Kosovë dhe ecuritë e botimit të tij viteve të fundit, Prishtinë, prill 1995. (Informata përmban 18 faqe).

udhëzime të posaçme se si të punohet me këto tekste shkollore...”.⁸⁰¹ Synimi i Serbisë ishte që shkollarëve shqiptarë në të gjitha nivelet e arsimit t’u ndalohen tekstet përkatëse mësimore në gjuhën shqipe dhe në vend të tyre të jenë tekstet e përkthyer pa asnjë veçori kombëtare shqiptare!⁸⁰² Gjatë viteve 1992 deri në vitin 1999 nga ky institucion me rëndësi të veçantë shoqërore janë botuar gjithsej 588 tituj të teksteve, të lektyrës shkollore, të dokumentacionit pedagogjik shkollor dhe të botimeve të veçanta. Megjithatë, kjo periudhë do të shënohet në analet e Entit të Teksteve si vitet më produktive sa i përket hartimit të teksteve origjinale në gjuhën shqipe.⁸⁰³

Tabela 33. Pasqyrë e teksteve të reja sipas klasave dhe viteve

Klasat	Gjithsej tituj	Tituj të rinj	%	Ribotime	%
I	10	5	50,00	5	50,00
II	11	7	63,64	4	36,36
III	12	10	83,33	2	16,67
IV	11	9	81,82	2	18,18
V	15	10	66,67	5	33,33
VI	12	6	50,00	6	50,00
VII	15	6	40,00	9	60,00
VIII	15	8	53,33	7	46,67
Gjithsej	101	61	60,40	40	39,60

Tabela 34. Pasqyrë tabelare e teksteve të reja, 1992-1999

Viti i botimit	Gjithsej tituj	Arsimi fillor		Arsimi i mesëm		Lektyra shkollore		Botime të veçanta	
		Nr.i tituj	Ekzemplarë	Nr.i tituj	Ekzemplarë	Nr.i tituj	Ekzemplarë	Nr.i tituj	Ekzemplarë
1992	8	8	225000						
1993	11	11	197319						
1994	28	24	453217	4	32457				
1995	39	26	519846	13	85117				
1996	78	46	908907	26	175281			6	5875
1997	111	43	748580	38	126570	16	157611	14	9473
1998	101	43	527770	35	88900	12	60000	11	7060

⁸⁰¹ Kështu, do të deklarojë Danillo Zh. Markoviq, Ministër i Arsimit të Republikës së Serbisë, në një intervistë, në të përditshmen beogradase “Borba”.

⁸⁰² Në vitin 1990, kur në Kosovë ishin hartuar planet dhe programet e reja mësimore, të cilat më vonë ishin miratuar në Pleqësinë e Arsimit të Kosovës, siç ishte miratuar edhe rrjeti i ri i shkollave të mesme. Me këto ndryshime arsimit shqip dhe sistemi i arsimit kosovar definitivisht i kishte shkëputur lidhjet me planet dhe programet e Serbisë dhe me sistemin arsimor të saj. Këto ndryshime në programet mësimore ishin të domosdoshme që të përfshiheshin në tekstet shkollore. Për hartimin e teksteve të reja, u arrit që tekstet ekzistuese që ishin në përdorim deri në vitin 1991 të korrigjoheshin duke i eliminuar përmbajtjet programore të ideologjizuara të cilat ishin të inkorporuara në tekste shkollore.

⁸⁰³ Sipas statistikave të këtyre viteve, në edukimin dhe arsimin fillor, prej gjithsej 101 teksteve të përdorura, tekste të reja që për herë të parë ishin botuar në Kosovë ishin 61 sosh, apo 60,40 për qind. Përndryshe, në këtë nivel të arsimit botohen si tituj të ri apo si ribotime gjithsej 276 tituj.

1999	196	77	2385000	93	524000	16	80000	10	14600
Gjithsej 572		278	5965639	209	1032325	44	297611	41	37008

Inkuzicioni i ri ndaj teksteve mësimore të dedikuara arsimin në gjuhën shqipe

Libri shkollor ndiqej nga policia serbe, që nga viti 1991, kur Enti i Teksteve dhe i Mjeteve mësimore i Kosovës, i vetmi botues i teksteve shkollore në gjuhën shqipe, funksionon në kushte shumë të vështira. Qeveria e Kosovës në Ekzil (përmes Këshillit Qendror të Financimit të Kosovës) apo ndonjë donator, e ndihmonte botimin dhe shpërndarja teksteve bëhej nëpër punkte (të fshehta) e jo në libraritë e rrjetit shitës. Përveç kësaj, tekstet, shpesh, në sasi të ndryshme edhe janë konfiskuar nga organet e tyre policore.

Shtypi i kohës dëshmi e konfiskimit të teksteve shkollore

GJAKOVË	Bujku, 25 mars 1995
Policia konfiskoi një kamion me libra shqip	
Ndërkaq, Avni Brovina, redaktor i Entit të Botimeve të Teksteve Shkollore të Kosovës, dy herë u ftua në organet e SPB-së	
<p>Gjakovë, 24 mars Pardje, një ekspeditë e policisë, pas kontrollimit disaorësh të shtëpisë në Gjakovë, ku tash banon prof. Avni Brovina, redaktor i Entit të Botimeve të Teksteve Shkollore të Kosovës, konfiskoi një kamion përplot libra shqip, që gjendeshin aty. Pjesa dërrmuese e këtyre librave ishin tekste shkollore – të gjuhës dhe letërsisë shqipe të historisë dhe të gjeografisë. Pas këtij «gjahu» Avniu u ftua dy herë në organet e SPB-së së Gjakovës – ditën e parë u mbajtë 8 orë, kurse ditën e dytë, dy orë, me ç'rast inspektorët e SPB-së u interesuan rreth veprimtarisë së Entit të Botimeve të Teksteve Shkollore dhe të LASH-it, njofton Komisioni për Informim i Degës së LDK-së së Gjakovës. Z.H.</p>	

Gjatë kësaj periudhe, milicia serbe ka konfiskuar tekste në vlerë 55.428 DM.⁸⁰⁴ Libri Shkollor pësoi dëmin më të madh financiar në vitin 1998, kur u dogjën me qëllim nga forcat ushtarake-policore dhe paramilitare tekstet shkollore në vlerën 421.006 DM.

Tabela 35. Tekstet e djegura

Nr.	Komunat-punktet	Vlera e teksteve të djegura
1.	Deçan	81.733
2.	Komoran	97.050
3.	Malishevë	98.567
4.	Rahovec	46.607
5.	Skënderaj	9.350
6.	Suharekë	34.000
7.	Shtime	53.699
	Gjithsej	421.006

⁸⁰⁴ Në të gjitha këto raste milicia ka lënë dëshmi (fletëdëshminë mbi konfiskimin e teksteve.) Nuk është shënuar asnjë rast i kthimit të teksteve të marra.

Në pranverë të vitit 1999, u dogjën shumë shtëpi të cilat ishin edhe depo të punkteve, si në Kaçanik, në Pejë, në Mitrovicë, në Istog, në Klinë, në Suharekë, në F. Kosovë, në Ferizaj, në Lipjan, në Vushtrri dhe në Polac - Skënderaj.⁸⁰⁵ Teksti dhe gjuha shqipe (pavarësisht përdorimit në dygjuhësinë pesëdhjetëvjeçare në dokumentacion,) nisi të përdorej e veçantë në mbajtjen e evidencës, si gjuhë e vetme shtetërore për realizimin e planeve dhe të programeve mësimore, për evidencimin e suksesit të nxënësve etj. Në dokumentacion shkollor bënë pjesë edhe librat e klasës, fletëkalimet, librat amë, dosjet e nxënësve, libri për regjistrimin e nxënësve në klasë të parë (me shënime karakteristike për secilin nxënës), pastaj planet dhe programet mësimore, planet e arsimtarëve, hartimet e nxënësve, ekspozitat e nxënësve etj.⁸⁰⁶ Në vitin shkollor 1992/93 libri i klasës për shkolla fillore është përgatitur në Ministrinë e Arsimit të Kosovës dhe është shtypur në shtypshkronjën “Dukagjini” të Pejës.

Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000

Gjatë viteve shkollore 1992/93 – 1999/2000 për nxënës dhe arsimtarë shqiptarë ishin në përdorim tekstet të cilat prezantohen në vazhdim:

Tabela 36. Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa parë

Nr.	Autorët	Titulli i tekstit	Botimi i teksteve sipas viteve dhe tirazhi							
			1992/3	1993/4	1994/5	1995/6	1996/7	1997/8	1998/9	1999/0
1.	Qamil Batalli	ABETARJA	45.000		20000	32254	30120	30000	25.000	90.000
2.	Sh.Osmani, E. Abazi, Q. Batalli, O.Grillo, Sh.Vreto, D. Kristo	LEXIMI					28430	23350	16.000	35.000
3.	M. Gjevori, Q. Batalli	LIBËR LEXIMI E GJUHË		30.000					0	0
	Gjithsej		4.000	55777	20000	101167	146697	147200	74680	303000

Abetarja e botuar në vitin 1992/93 është shtypur në Itali, ndërsa për shkak të vështirësive rreth futjes së saj në Kosovë, nxënësve u ka rënë në dorë në vitin 1993. Për këtë shkak ajo në atë vit fare pak është përdorur, sepse, në atë kohë kur ajo arrin në Kosovë, nxënësit tashmë i kishin mësuar shkronjat dhe ishin gati të kalonin në Librin e leximit. Për vitin shkollor 1993/94 teksti është bartur te nxënësit e klasës së parë, kështu që ndoshta në tërë historinë e botimit të teksteve shkollore ka ndodhur që për një vit të mos ribotohet, së paku Abetarja.⁸⁰⁷ Libër leximi e gjuhë është rishtypur vetëm në vitin 1993 dhe i njëjti tekst është përdorur deri në vitin shkollor

⁸⁰⁵ Shefki Ajeti, Lufta dhe dëmet që pësoi Libri Shkollor, Buletini “Libri Shkollor”, Prishtinë, 1/2000, fq. 103-105.

⁸⁰⁶ Grup autorësh, Pedagoška enciklopedija, Beograd, 1989, fq. 418.

⁸⁰⁷ Rexhep Sadrija për botimin e Abetares në vitin 1992 dhuroi 75 mijë franga zvicerane, e cila u shpërnda falas për rreth 40.000 filloristë.

1995/96, kurse prej vitit shkollor 1996/97 përdoret Leximi 1 nga grup i autorëve nga Shqipëria dhe Kosova.

Tabela 37. Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa dytë

Nr.	Autorët	Titulli i tekstit	Botimi i teksteve sipas viteve dhe tirazhi							
			1992/3	1993/4	1994/5	1995/6	1996/7	1997/8	1998/9	1999/0
1.	Sh.Osmani, E. Abazi, A.Demolli	LEXIMI			35000	19480	24218	19480	16.000	35.000
2.	B.Beci, E.Lepuri, L.Bubani, M.Gjokutaj, Z.Gurabardhi	GJUHA SHQIPE			22442		20010	20000	15.000	35.000
3.	B.Beci, E.Lepuri, L.Bubani, M.Gjokutaj, Z.Gurabardhi	GJUHA SHQIPE (Libri i mësuesit)			1910		1020			3.000
4.	M.Gjevori, Q.Batalli	LIBËR LEXIMI E GJUHE	30.000							0
5.	Sh.Riza	FLETORE PUNE E GJ. SHQIPE		12.780						0
	Gjithsej		30000	57543	59352	32680	138725	85740	61690	181000

Në klasën e dytë në vitin 1992 është botuar vetëm një tekst, Libër leximi e gjuhe, ndërsa që nga vitin 1994 ky tekst zëvendësohet me tekstin e ri, Leximi 2, i grupit të autorëve nga Shqipëria. Në vitin 1993 ribotohen për herë të fundit edhe dy tekste: Fletore pune e gjuhës, i cili zëvendësohet në vitin 1994 me Gjuha shqipe 2 (grup autorësh).

Nr.	Autorët	Titulli i tekstit	1992/3	1993/4	1994/5	1995/6	1996/7	1997/8	1998/9	1999/0
1.	M. Gjevori, Q. Batalli	LIBËR LEXIMI E GJUHE	30000		25820					
2.	Sh.Osmani, E.Abazi, A. Demolli	LEXIMI				34485	19110	25110	10920	35.000
3.	B.Beci, E. Lepuri, L.Bubani, M.Gjokutaj Z.Gurabardhi	GJUHA SHQIPE				30350	18980	17940	10760	35.000
4.	B. Beci,	GJUHA				2000	2000			3.000

Ragip GJOSHI MËSIMDHËNIA E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË
(Nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)

E.Lepuri, L.Bubani, M.Gjokutaj Z.Gurabardhi	SHQIPE (L. mësuesit)									
Gjithsej		30000		25820	76695	70090	169230	118550	256000	

Tabela 38. Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa tretë

Në klasën e tretë zëvendësimi i teksteve të vjetra, sipas programeve të reja në krahasim me vitin e parë dhe të dytë, sepse zbatimi i programeve të reja është bërë në mënyrë suksesive, duke filluar nga klasa e parë. Libër leximi e gjuhe, për herë të fundit është botuar në vitin 1994 për t'u zëvendësuar në vitin 1995 me tekstin Leximi 3 të grupit të autorëve nga Shqipëria dhe Kosova. Në këtë vit botohen për herë të parë edhe Gjuha 3 - tekst bazë për nxënës dhe Gjuha 3 – libër mësuesi. Në vitin 1992 për klasën e tretë ribotohet vetëm një tekst, në vitin 1993 asnjë, kurse në vitin 1994 po ashtu vetëm një tekst.

Tabela 39. Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa katërt

Nr.	Autorët	Titulli i tekstit	1992/3	1993/4	1994/5	1995/6	1996/7	1997/8	1998/9	1999/0
1.	M.Gjevori etj.	LIBËR LEXIMI E GJUHE	25000		25000					
2.	Sh. Osmani, M.Çamo, Q. Batalli	LEXIMI LETRAR					35100	26700	10880	35.000
3.	B.Beci, L.Bubani, M.Gjokutaj, Z.Gurabardhi	GJUHA SHQIPE					30040	15000	10000	35.000
4.	B. Beci, L.Bubani, M.Gjokutaj, Z.Gurabardhi	GJUHA SHQIPE (Libri i mësuesit)					1500			3.000
	Gjithsej		25.000		77615	35115	106762	69420	77380	257000

Libër leximi e gjuhe të grupit të autorëve për herë të fundit ribotohet në vitin 1994 dhe zëvendësohet në vitin 1996 me tekstin e ri Leximi 4 të grupit të autorëve si tekst i përbashkët me Shqipërinë.

Tabela 40. Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa e pestë

N r.	Autorët	Titulli i tekstit	1992/3	1993/4	1994/5	1995/6	1996/7	1997/8	1998/9	1999/0
1	M. Kumnova	LIBËR LEXIMI	25000							
2	Gj.Zheji, O. Grillo, H. Jupe, E. Dilo, M. Hyseni	LEXIMI LETRAR			18360	20476	20000		12000	33.000
3	B. Beci, L. Bubani, Zamira Gurabardhi	GJUHA SHQIPE			22700	22700	16160		10920	35.000
	Gjithsej		25000	12500	85510	84376	204415	67270	48530	413000

Për klasën e pestë në vitin 1992 dhe 1993 botohet vetëm nga një tekst. Në vitin 1992 Libër leximi i M. Kumnovës, ndërsa prej vitit 1994 lënda mësimore Gjuha dhe letërsia shqipe mësohet me program dhe tekst të ri mësimor. Leximi letrar 5 dhe Gjuha shqipe janë tekste të reja, të përbashkëta me Librin Shkollor të Tiranës dhe me autorë të përbashkët Leximi letrar, kurse Gjuha shqipe me autorë nga Tirana.

Tabela 41. Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa e gjashtë

Nr	Autorët	Titulli i tekstit	1992/3	1993/4	1994/5	1995/6	1996/7	1997/8	1998/9	1999/0
1.	Ramiz Hoxha	LIBËR LEXIMI	25000		19530					
2.	Grup autorësh	LEXIMI LETRAR				34694	20100		0	33.000
3.	B.Beci, L.Bubani, Mimoza Gjokutaj	GJUHA SHQIPE				25380	10500		5000	35.000
	Gjithsej		2000	25000	89082	105573	82314	64990	26050	334000

Libër leximi i R. Hoxhës për herë të fundit është ribotuar në vitin 1994, kurse prej vitit 1995 në zbatim është Leximi letrar 6 i grupit të autorëve të përbashkët nga Tirana dhe Prishtina. Në këtë vit botohet edhe Gjuha shqipe e grupit të autorëve nga Tirana.

Tabela 42. Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa e shtatë

Nr	Autorët	Titulli i tekstit	1992/3	1993/4	1994/5	1995/6	1996/7	1997/8	1998/9	1999/0
1.	I.Kadriu	LIBËR LEXIMI	25000		18500					
2.	Q.Kashari	LEXIMI LETRAR 7					26595	19770		30.000
3.	B.Beci, L.Bubani, M.Gjokutaj	GJUHA SHQIPE					26600		11790	30.000
	Gjithsej		25000	25000	51255	40100	128495	84650	67840	377000

Në vitin 1992 dhe 1993 për nxënës të klasës 7 botohet vetëm nga një tekst, në vitin 1992 Libër leximi, kurse në vitin 1993 Kimia. Libër leximi i I. Kadriut ribotohet në vitin 1994, ndërsa prej vitit shkollor 1996/97 zëvendësohet me Leximin letrar 7 të grupit të autorëve. Në këtë vit botohet edhe Gjuha shqipe me autorë nga Tirana.

Tabela 43. Tekstet shkollore të gjuhës shqipe gjatë viteve 1992-2000- Klasa e tetë

Nr	Autorët	Titulli i tekstit	1992/3	1993/4	1994/5	1995/6	1996/7	1997/8	1998/9	1999/0
1.	Abdulla Zajmi, Ismajl Bytyçi	LIBËR LEXIMI	20000		16200					
2.	Arian Kadiu, Lauresha Stroni, Kumrije Hamiti	LEXIMI LETRAR					27600		10780	28.000
3.	Bahri Beci, Loredan Bubani, Zamira Gurabardhi	GJUHA SHQIPE						16000		28.000
4.	Bahri Beci etj.	GRAMATIKA E GJUHËS SHQIPE							1000	
	Gjithsej		20000	21499	44583	44140	49409	60080	53050	282000

Edhe në klasën VIII gjatë këtyre viteve ka pasur ndryshime, jo vetëm të planeve dhe të programeve mësimore, por edhe të teksteve shkollore. Libër leximi i botuar para viteve të 90-ta është ribotuar për herë të fundit në vitin 1994 dhe i njëjti tekst është përdorur edhe në vitin shkollor 1995/96, kurse prej vitit shkollor 1996/97 është në zbatim teksti Leximi letrar i autorëve të përbashkët nga Shqipëria dhe Kosova. Në vitin 1997 është botuar për herë të parë teksti Gjuha shqipe nga grup autorësh nga Shqipëria. Në vitet e pasluftës së fundit, përkatësisht prej vitit 2002, është bërë liberalizimi i botimit të teksteve mësimore. Tekste shkollore, përveç Librit Shkollor, botojnë edhe botues të tjerë. Konkursin për botimin e teksteve e shpall Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, kurse të drejtë pjesëmarrje kanë shtëpitë botuese. Tekstet në Kosovë Qeveria për nxënësit e arsiit të detyruar i jep gratis.

Tabela 44. Numri i teksteve dhe autorët për shkollën fillore gjatë viteve 1945-1990

Vitet	Gjithsej	Autorë shqiptarë	%	Autorë serbë	Autorë të përzier
1945	1	1	100.0	0	0
1946	1	1	100.0	0	0
1947	7	6	85.71	1	0
1948	10	5	50.00	5	
1949	2	2	100.0	0	0
1950	5	4	80.00	1	
1951	9	3	33.33	5	1
1952	11	2	18.18	9	
1953	17	3	17.65	15	
1954	36	10	27.78	26	
1955	33	11	33.33	22	

Ragip GJOSHI MËSIMDHËNIA E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË
(Nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)

1956	28	6	21.43	22	
1957	18	7	38.89	11	
1958	22	7	31.82	15	
1959	30	10	33.33	20	
1960	21	9	42.86	12	
1961	34	7	20.59	27	
1962	34	4	11.76	30	
1963	20	9	45.00	11	
1964	17	5	29.41	12	
1965	13	2	15.38	11	
1966	26	9	34.62	17	
1967	37	6	16.22	31	
1968	40	14	35.00	26	
1969	40	7	17.50	33	
1970	51	9	17.65	42	
1971	38	10	26.32	28	
1972	49	12	24.49	37	
1973	49	13	26.53	36	
1974	34	19	55.88	15	
1975	40	20	50.00	19	1
1976	33	12	36.36	20	1
1977	72	29	40.28	42	1
1978	81	36	44.44	42	3
1979	67	40	59.70	24	3
1980	63	43	68.25	16	4
1981	71	46	64.79	20	5
1982	65	44	67.69	17	4
1983	53	33	62.26	16	4
1984	71	45	63.38	22	4
1985	38	34	89.47	4	
1986	52	38	73.08	13	1
1987	51	41	80.39	7	3
1988	67	45	67.16	19	3
1989	73	49	67.12	20	4

KREU VII

STANDARDIZIMI I GJUHËS DHE FORMIMI GJUHËSOR E LETRAR NË KOSOVË

7.1. Shqipja standarde dhe mësimdhënia e gjuhës shqipe

7.1.1. Kodifikimi i gjuhës standarde

7.1.1. Rëndësia e Kongresit të Manastirit

7.1.3. Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës

7.1.4. Konsulta gjuhësore e Prishtinës

7.1.5. Kongresi i Drejtshkrimit, 1972

7.2. Statusi i shqipes standarde në Kosovë

7.3. Përdorimi i shqipes standarde në shkolla dhe institucione

7.3.1. Shkollat e hershme për përgatitjen e mësimdhënësve në Kosovë

7.4. Roli i shtypit pedagogjik në Kosovë për mësimin e gjuhës shqipe

7.1. SHQIPJA STANDARDE DHE MËSIMDHËNIA E GJUHËS SHQIPE

Gjuha shqipe dhe çështja e kodifikimit të gjuhës shqipe dhe krijimi i gjuhës letrare a standarde, e vonuar për arsye të shumta e të njohura, sikurse edhe te popujt e tjerë, në një shkallë të caktuar të zhvillimit të tyre historik, erdhi si vendimi më i rëndësishëm i kthesës së madhe gjuhësore drejt njësimimit të shqiptarëve. Erdhi në një kohë delikate të ndërtimit të marrëdhënieve ekonomike e shoqërore, që karakterizojnë një shkallë të lartë të organizimit politik e kulturor, duke ndier nevojën për të krijuar një formë të veçantë e të përbashkët të gjuhës kombëtare. Edhe tek ne, kjo formë e gjuhës, është krijuar në mënyrë të ndërgjegjshme e mbi forma të tjera të gjuhës, të cilat gëzonin ndonjë respekt e epërsi të veçantë ndaj të tjerave forma. Forma e kodifikuar e gjuhës edhe tek ne sikur ndër popuj të qytetëruar është emërtuar gjuhë letrare, po e njohur edhe me të tjera emërtime, si gjuhë e kulturës, gjuhë e shkollës, gjuhë kombëtare etj. Nga gjysma e dytë e shekullit që shkoi, ka zënë të emërtohet gjuhë standarde. Në Kosovë, një kohë është quajtur gjuhë letrare (dhe kështu vazhdon të quhet ende në ditët tona në shumë mjedise në kulturën tonë), pra fillimisht do të jetë quajtur kështu, sepse ajo lidhej ose pandehej të kishte një lidhje shumë të ngushtë me letërsinë. Po emërtimi i kësaj forme të gjuhës del të duket edhe më shumë i lidhur me letërsinë sidomos në disa gjuhë evropërendimore e sllave (krahaso: *gjerm.* – Literatursprache, *rus.* – Literaturnij jazek, *serbkroat.* Literarni jezik, e të tjera), sa kohë që as në shqipen nocioni literaturë nuk është i panjohur.

Po theksojmë se Fjalori i shqipes së sotme jep këtë përkufizim për gjuhën letrare: (*“Gjuha letrare...është forma më e përpunuar e gjuhës së një populli, e cila ka norma të caktuara, të ngulitura në të shkruar e në të folur dhe arrin njësimin më të lartë në kohën e krijimit të kombeve e të shteteve kombëtare”*).⁸⁰⁸ Pa u ndalur më shumë lidhur me nocionin gjuhë standarde, sepse, sikur është e ditur, mund të konstatojmë se në Kosovë ka zënë rrënjë në përdorimin e saj në administratë, media dhe posaçërisht në institucionet arsimore – edukative, sepse *“...tashmë shumë shkurt, është quajtur kjo - gjuhë standarde, sepse në të mund të përdoren dhe/ose lejohen të përdoren dhe/ose vlerësohen të drejta për t’u përdorur vetëm elemente gjuhësore të standardizuara, duke nisur që nga shqiptimi i fonemave e morfemave, përmes përdorimit të formave gramatikore e deri tek drejtshkrimi e përdorimi i njësive sintaksore në frymën e standardit gjuhësor të caktuar.”*⁸⁰⁹ Gjuha standarde shqipe u formua në mënyrë të ndërgjegjshme, që të shërbejë për komunikimin në rrafshin kombëtar ose në një rrafsh tjetër çfarëdo, të një komuniteti, në të cilin nuk mund t’i përmbushte kërkesat asnjë nga format e tjera (dialekti, e folmja, ndonjë trajtë më e hershme e shkruar, e dëshmuar historikisht) e të tjera. Standardi i gjuhës shqipe erdhi si rezultat përfundimtar i marrëveshjeve, i bashkimit të pikëpamjeve dhe i vendimeve për elemente leksikore e fjalëformuese, për dukuri fonetike e morfologjike, për dukuri sintaksore e të tjera dhe për drejtshkrimin e drejtshqiptimin.

Krijimi i standardit nuk kishte synim dëmtimin e dialekteve a të folmet e gjuhës, e as gjuhën e shkrimtarëve a autorëve të tjerë të mëparshëm (të vjetër), por, duke ndjekur modele të gjuhëve të huaja, veçse të jetë hap i përbashkimit të shqiptarëve dhe të përdorimit unik të gjuhës në administratë, shkollë, libra, media dhe në shkolla. Standardi si një shkallë e lartë e njësisë në të gjitha nënsistemet, u reflektua në mësimdhënien e gjuhës shqipe sidomos për drejtshkrimin dhe për rregulla të veçanta gramatikore. Kjo gjuhë e kodifikuar, në Kosovë nisi të përdoret në të gjitha fushat e dijes, sidomos edhe në shkollat e këtij vendi.

⁸⁰⁸ *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë, 1984, f. 391.

⁸⁰⁹ Isa Bajcinca, *Ligjëratë me mësuesit e shqipes në shtetet skandinave*, 11-12 maj 2006, Landskrona, Suedi.

7.1.1. Kodifikimi i gjuhës standarde

Njësimi i gjuhës shqipe ishte vonuar për arsye të njohura politike. Deri te Kongresi i Drejtshkrimit është dashur të bëhej rrugë e gjatë dhe e vështirë, si; unifikimi i alfabetit. Pas Kongresit të Drejtshkrimit të gjuhës shqipe në Tiranë, i mbajtur në vitin 1972, shqipja në Kosovë ka marrë një zhvillim të hovshëm në fushën standardizimit. Arsyet e vonës së njësimit të gjuhës sonë ishin pasojë e drejtpërdrejtë e pushtimit për një kohë të gjatë të viseve shqiptare nga të huajt, të cilët ndalonin gjithsesi përparimin kulturor të shqiptarëve, që do të thotë patjetër edhe zhvillimin e shkollës në gjuhën shqipe dhe shkrimin e saj.

Përpyekjet e autorëve të vjetër të mesjetës së vonë, shkrimet me alfabetin arab dhe shkrimet në arbërishten (nga shkrimtarë arbëreshë), dhe shkrimet e mëvonshme deri tek Kristoforidhi e shkrimtarët e gjysmës së dytë të shekullit XIX janë etapat e zhvillimit të gjuhës shqipe. Në këtë rrugë, nuk ka asnjë dyshim që, sidomos veprimtaria e shoqatave e klubeve shqiptare në atë periudhë (Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip e Stambollit, shoqëritë “Agimi” e “Bashkimi” të Shkodrës, klubi i Manastirit e ndonjë tjetër), në përpjekjet për themelimin e alfabetit të shqipes, do të shtronin edhe probleme të veçanta të shqipes letrare.⁸¹⁰

Si prova e parë për të standardizuar në njëfarë shkalle gjuhën shqipe, do të duhej përmendur vitet 1916/17 nga Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës, e cila, afro dhjetë vjet pas themelimit të alfabetit të shqipes në Manastir, do të arrinte të hartonte Ortografinë e parë të shqipes. Komisia për të parën herë shtroi çështjen e zgjedhjes së dialektit që do të shërbente si bazë, mbi të cilën do të krijohesh shqipja standarde, e cila asokohe shkruhej në dy a tri variante: toskërishtja letrare, gegërishtja e ashtuquajtur e mesme letrare (me fare pak shkrime) dhe shkoderanishtja letrare. Ortografia e Komisionit Letrare të Shkodrës ishte ngritur mbi bazë të gegërishtes së mesme dhe, sado që kjo formë letrare nuk do të bëhej e vetmja, sepse do të vazhdonte përdorimi dhe lëvrimi i mëtejshëm i toskërishtes letrare, sidomos në fushë të letërsisë, dhe i shkoderanishtes letrare (nga disa autorë), do të vazhdonte të zhvillohej e të zbatohesh në administratë, në tekste shkollore dhe nga disa shkrimtarë. Në Veri të Shqipërisë dhe në Kosovë e në viset e tjera jashtë Shqipërisë, vazhdoi të përdorej varianti i gegërishtes së mesme letrare, kurse në Jugun e Shqipërisë dhe në institucionet qendrore politike, ushtarake, ekonomike, arsimore e të tjera- përdorej kryesisht toskërishtja letrare. Në këtë fazë të zhvillimit të kulturës kombëtare, të arsimit e të letërsisë, u shtrua kërkesa për themelimin e një forme të vetme, që do të thotë e krijimit të shqipes, që në diskutimet asokohe quhej gjuhë, herë e unjisuar, herë e unifikuar dhe më vonë e njësuar letrare. Për këtë qëllim qenë organizuar dy sesione shkencore (1952 e 1953 në Tiranë) dhe nga ky aktivitet rezultoi Ortografia e gjuhës shqipe e vitit 1956. Për shkallën e mbështetjes teorike e praktike të kodifikimit, dhe më pastaj të zbatimit për një periudhë, shquhej sidomos Ortografia e gjuhës shqipe (Prishtinë 1964). Kjo ishte gjendja e përdorimit të variantit të gegërishtes letrare, kurse në Shqipëri përdorej kryesisht varianti i toskërishtes letrare, krahas gegërishtes - kryesisht në letërsi nga autorë të Veriut. Në vitin 1967 Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Tiranës, në përpjekjet për njësimin e shqipes letrare, botoi një projekt të Rregullave të Drejtshkrimit të Shqipes, ku për herë të parë nuk kishte forma të veçanta për toskërishten dhe të veçanta për gegërishten letrare (sikur veprohej më përpara) dhe ato rregulla u hodhën në diskutime të gjera publike, në institucione shkencore, arsimore e në

810 Këto pikëpamje më pastaj do të vazhdonin me shkrimet për gjuhën shqipe nga intelektualë, si: Ndre Mjedja, Faik Konica, Aleksandër Xhuvani e të tjerë.

qarqe letrare e të tjera, ku t'u bëheshin vërejtje ose të miratoheshin ashtu si ishin. Pastaj vjen Konsulta gjuhësore e Prishtinës për t'iu kurorëzuar me Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë (1972) si kryeveprën e marrëveshjes së madhe gjuhësore të shqiptarëve.

7.1.2. Rëndësia e Kongresit të Manastirit

Rruga e alfabetit shqip që solli Kongresin e Manastirit ishte e gjatë, shekullore, dhe e mundimshme. Në thirrjen e Klubit “Bashkimi” të Manastirit për Kongresin, midis të tjerash, konstatohet: “Çështje e Abecesë lipset të jetë fillimi, që pa të nuk do mundim të arrijmë qëllimet tona të larta për mbrothësi të gjuhës!” Ky ishte kongresi i parë kulturor i përgjithshëm i inteligjencës e i nacionalistëve shqiptarë, ku morën pjesë përfaqësuesit e të gjitha feve dhe të gjitha krahinave të Shqipërisë, saktësisht, nga radhët e toskëve dhe nga radhët e gegëve. Komisioni i Kongresit për Alfabetin i shqyrtoi tri çështje:

1. A mund të adaptohet njëri nga tre alfabetet kryesor (Stambollit, Bashkimit, Agimit)?
2. A mund të bëhet një kombinim i këtyre tre alfabeteve?
3. A mund të lihen me një anë dhe të krijohet krejt një i ri?⁸¹¹

Kongresi u hap në Manastir më 14 nëntor 1908 dhe i vijoi punimet deri më 22 nëntor. Në Kongres morën pjesë 32 delegatë me të drejtë vote, që përfaqësonin 26 qytete e shoqëri të ndryshme shqiptare brenda dhe jashtë atdheut, si dhe 18 delegatë të tjerë si pjesëmarrës pa të drejtë vote. Kongresi i Manastirit u shndërrua kështu në një kuvend të vërtetë mbarëshqiptar, në të cilin morën pjesë gjithsej 50 delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë, nga qytetet e vilajeteve të Manastirit, të Kosovës, të Janinës e të Shkodrës, si edhe nga shoqëritë shqiptare të Bukureshtit, të Sofjes, të ShBA-së, të Egjiptit, të Italisë etj. Kongresi i Manastirit për çështjet që diskutoi e zgjidhi dhe si një nga tubimet më të gjera e më përfaqësuese nga përbërja e tij, vlerësohet me të drejtë si kuvendi më i rëndësishëm kombëtar në historinë politike e kulturore të shqiptarëve në fillim të shek. XX. Delegatë të tij ishin shkrimtarët dhe publicistët më të njohur, lëvruar të gjuhës shqipe, laikë e klerikë, si Gjergj Fishta, Nikollë Kaçori, Ndre Mjeda, Gjergj Qiriazi, Mithat Frashëri, Hilë Mosi, Mati Logoreci, Thoma Avrami, Sotir Peci, Shahin Kolonja, Luigj Gurakuqi, Adam Shkaba; veprimtarë të lëvizjes kombëtare dhe të klubeve shqiptare, si Bajram e Çerçis Topulli, Mihal Gramenoja, Fehim Zavalani, Dhimitër Mole, Nyzhet Vrioni, Rrok Berisha, Leonidha Naço, Dhimitraq Buda, Akil Eftimi, Shefqet Frashëri, Refik Toptani, Gligor Cilka, Emin bej Shkupi, Hafiz Ibrahim efendi (nga Shkupi), Ramiz Daci, Xhemal Beu (nga Ohri), Fahri Frashëri (nga Resna) etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mithat Frashëri, ndërsa nënkryetarë Luigj Gurakuqi e Gjergj Qiriazi. Meqë komisioni në parim ishte përcaktuar se për alfabetin e shqipes ka për t'u marrë baza e alfabetit latin. Variantin që përdorim sot, Justin Rota e quante Alfabet të koalicionit. Alfabetin e “Bashkimi-t” e mbronin vetëm Fishta dhe Gurakuqi, e më indiferent u tregua Sotir Peci. Për qëllime personale me Fishtën dhe ndaj Shoqërisë “Bashkimi” të Shkodrës, Dom Ndre Mjeda e mori krahun e aderuesve të alfabetit të Stambollit - “Alfabeti Frashëriot”. Vërtet, parimi i Mjedës: Një shkronjë-një tingull dhe alfabeti i tij, gati ngadhënjë, por në Komision ndodhi një kthesë me kokëfortësi në dobi të Alfabetit Frashëriot. Në këtë kthesë pati rol hoxhë Haxhí Vildan Efendia, i cili kryesonte delegacionin e Klubit Shqiptar të

⁸¹¹Muhamet Pirraku, *Roli i Kosovës në zgjidhjen përfundimtare të alfabetit kombëtar shqiptar*, “Pashtriku”, Prishtinë, 2012.

Stambollit. Atëherë ai pati pohuar se “Alfabeti është një vegël e fuqishme për përparimin e shqiptarëve” (nëntor 1908). Çdo komb ka të drejtë të zgjedhë alfabetin që i përshtatet më së miri gjuhës së tij, prandaj shqiptarët e zgjedhin alfabetin shqiptar. Turqit gjithashtu nuk kishin shkronja për ta shkruar gjuhën e tyre, ata i kanë adaptuar shkronjat arabe. Sa për drejtimin së si lypset të shkruhej - nga e majta në të djathtë a po nga e djathta në të majtë - kjo nuk është punë me rëndësi. Përsa i takon fesë, ajo i përket zemrës së njeriut, kështu që secili është i lirë të ketë pikëpamjet e veta”. Ndaj, në Vendimin e Komisionit Alfabetin, midis të tjerash u konstatua: “... me pëlqim të të gjithëve u vendos që të merret abeja e Stambollit e me të bashkë edhe një abece e thjeshtë latine, që të mësohen dhe të përdorën bashkërisht në mes të shqiptarëve. Mësimi në shkolla do të jetë i shtrënguar e detyrueshëm për të dyja”. Kongresi i Manastirit vendosi që pas dy vitesh të thirrej një Kongres tjetër, prapë të pagëzuar “gjuhësor”, për çështje të ortografisë dhe për vendosjen përfundimtare për një alfabet kombëtar, kërkesë kjo që nuk e plotësoi Kongresi i Manastirit, i ftuar për atë kërkesë historike të kombit. Kongresi i ardhshëm duhej të mbahej në Janinë, më 23 korrik 1910. Mbështetur në brendinë e të dy rezolutave të nxjerra në Kongres, mund të konstatohet se Kongresi i Manastirit shumë më tepër i kontribuoi çështjes së përgjithshme kombëtare, se sa çështjes së alfabetit, sepse bëri një zgjidhje gjysmake e cila linte shteg për vazhdimin e përçarjes midis shqiptarëve toskë e gegë.

Lëvizja arsimore kombëtare shqiptare dhe e Alfabetit shqip në Kosovë kishte marrë përpjesëtime të reja, të fuqishme. Nga fundi i vitit 1909, aktiviteti i “Klubit Arsimor Shqiptar” të Vilajetit të Kosovës, të cilin nominalisht e udhëhiqte Bajram Curri, u shtri anë e kënd trojeve shqiptare të Vilajetit, hapi shkolla të reja shqipe dhe e futi mësimin e gjuhës shqipe në Gjimnazin dhe Normalen e Shkupit. Për përmasat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në Vilajetin e Kosovës fliste gjerësisht konsulli i Serbisë në Prishtinë, më 17 dhjetor 1909. Ai, midis të tjerash, saktëson, se: “Në mesin e shqiptarëve po vërehet një pakënaqësi gjithnjë me e madhe dhe Lëvizja sa vjen e po rritet...”. Më 1 dhjetor 1909 ishte kurorëzuar një ndër vendimet më të rëndësishme të Kongresit të Elbasanit, kishte filluar nga puna Normalja e parë në gjuhën shqipe në atdheun shqiptar, në cilën, pa vonuar u regjistruan mbi 100 nxënës, prej të cilëve gati gjysma ishin nga Kosova. Alfabeti latin për shqipen, në Kosovë nxori përkrahës të flaktë, madje edhe turq që mbështetën nismën e Sami Frashërit për shkrimin e gjuhës turke me shkronja latine. Hasan Prishtina, shkruante se “... shkollat shqipe, si edhe Normalja e Elbasanit, janë kërkesë dhe vepra të shqiptarëve për interesa të jetës së kombit.” Nga fillimi i vitit 1910, armiqtë e kombit shqiptar morën nisma për ta nxjerrë alfabetin latin nga kultura shqiptare dhe mësimi i shqipes. Hasan Prishtina do të sulmohet frontalisht nga një person i nënshkruar: M. B. Elbasanasi, i cili, më 3 janar 1910, në gazetën “Tanin”, e botoi artikullin pamfletik: “Arnautllëku - deputetit të Prishtinës Hasan Beut” ku, në mes tjerash, i shkruante: “Duke kaluar nëpër shkrepë të tmerrshme dhe bjeshkë që fusin frikën, do të shohësh meshkuj e vajza se si, me abetare në dorë, shkojnë në shkollat kishtarë. Këto abetare janë shkruar shqip, por me alfabetin austriak. Përveç kësaj, në Shkup, Prizren, Pejë, Shkodër, brenda avllive të kishave janë ndërtuar shkolla nga materiali i fortë (...). Për sa i përket çështjes së alfabetit, ju thoni se këtë do ta zgjidhë koha. Mirëpo, koha është e lidhur me përpjekje, d.m.th: Aveniri varet nga munda i derdhur. Ju thoni se shkollat në Elbasan janë shqip. Mirëpo, pse nuk u erdhën ndër mend ato rrafshina të gjera ku kini lindur Ju. A mund të hapni atje shkolla të tilla, dhe nëse do t’i hapeshit, ç’do të ngjante...?!?”.

Vërtet, duhet të ritheksohet fakti se këso kohe, e tërë lëvizja kulturore dhe arsimore në Kosovë, me reflektim edhe jashtë saj, ishte nën mbikëqyrjen e Hasan Prishtinës. Ai, nga Stambolli erdhi në Kosovë, ku vizitoi fshatra e qytete për të bërë zgjedhjen e djelmoshave kosovarë për shkollën pedagogjike në Elbasan. Aktiviteti i tij është përcjellë me kujdes nga

xhonturqit, madje do të thirret edhe në hetuesi “për corpus delikt” ndaj “Meshrutijet-it” (konstitucionit). Shtypi i Stambollit i cili e përcillte Lëvizjen e alfabetit për gjuhën shqipe, Janë të njohura, madje edhe kundërshtitë e deputetit të Pejës, Mahmud Bedria, i cili në gazetën “Tanin”, më 11 janar 1910, e botoi artikullin: “Letër të hapët shqiptarëve”, në të cilën ishte kundër alfabetit latin për shqipen, duke arsyetuar se për këtë e tërë bota myslimane e përdorin alfabetin arab. Sipas këtij pejani, shqiptarët kanë filluar shkrimin e shqipes me shkronja arabe 150 vjet pas ardhjes së turqve në Shqipëri, që do të thoshte më së voni nga vitet e tridhjeta të shekullit XV.

Aderuesit e alfabetit arab nga radhët e deputetëve për viset shqiptare, numerikisht ishin më shumë. Në peticionin dërguar Kryeministrisë, i cili u botua në “Yeni Tanin”, më 19 janar 1910, janë nënshkruar 14 deputetë nga Vilajeti i Kosovës, i Manastirit dhe i Shkodrës, midis të të cilëve edhe joshqiptarë. Vetëm tri ditë më vonë, më 22 janar 1910, deputetëve të deklaruar për alfabetin arab për gjuhën shqipe iu përgjigj deputeti Hasan Prishtina: *“Çështjen e alfabetit, do ta zgjidhë koha, nëse nuk e ka zgjidhur. Çështja nuk është e një natyre të tillë, si mendojnë disa, se nuk mund të trajtohet shkel e shko, sidomos për shkak se zgjidhja nuk mund të kryhet sipas dëshirës apo kundërshtimit tëdeputetëve. Ajo mund të zgjidhet vetëm nga pikëpamja atdhetare e jo duke thënë: ‘Ne duam apo nuk duam këtë zgjidhje...’!? Dhe, më tutje, Hasani saktësonte me guxim dhe dinjitet se “...akëcili është i lirë në pikëpamjet e veta dhe kurrkush s’ka të drejtë t’i thotë tjetrit për atë asgjë. Mirëpo, nënshkruesit e peticionit të dërguar Kryeministrisë, ta quajnë vetën si të vetmit interpretë të ndjenjave të Shqipërisë, e sidomos kur disa prej tyre s’kanë kurrfarë lidhje me shqiptarët as për nga gjaku, as për nga gjuha, kur ndërhyjnë në punë për të cilat nuk mund ta marr as me mend...”!?!*

Më 24 janar 1910 do të botohet peticioni i deputetëve shqiptarë, ithtarë të alfabetit latin për shqipen. Nga burimet e konsultuara mund të konstatohet se e tërë qeveria xhonturke, ishte angazhuar në luftën kundër alfabetit latin për gjuhën shqipe. Qeveria i vuri në lëvizje spiunët dhe fanatikët islamë kundër çështjes së alfabetit e gjuhës shqipe në Vilajetin e Kosovës dhe të Manastirit ku kishte dorë dhe Serbia, me anë të dhunës policore e ushtarake. “Bashkim e Përparim”, duke vërejtur entuziazmin dhe vendosmërinë e shqiptarëve për rilindje kombëtare, gjë të cilën shqiptarët e arrinin përmes fjalës së shkruar shqipe me alfabetin “latin të perëndimit”, inskenuan një reaksion, “duke hedhur gurin e fshehur dorën”, në mesin e ulemasë shqiptare. Qëllimi i fshehtë i organizuesit të këtij mitingu ishte demaskimi para masës shqiptare islame të deputetit të Shkupit, Nexhib Dragës, përkrahësit më të vendosur të Hasan Prishtinës. Nga fillimi i shkurtit 1910, Serbia kishte aktivizuar një numër të agjentëve të cilët evidenconin të gjitha lëvizjet në fushë të alfabetit shqip. Beteja vendimtare për fatin e shkrimit të shqipes me alfabetin pastër latin, vërtet, do të zhvillohet pikërisht në kryeqendrën administrative të Vilajetit të Kosovës, në Shkup, që ishte, realisht kërthiza e Shqipërisë Etnike dhe e ngjizjes së kombit shqiptar. Për përmasat dhe pasojat e mitingut për Alfabetin arab për shqipen, të mbajtur në Shkup, shkroi gjerësisht, nga vendi i ngjarjes, edhe gazeta serbe-osmane “Vardar”. Derisa në anën tjetër gazeta “Bashkimi” i Shkodrës, më 27 janar (9 shkurt) 1910 i demantonte të dhënat në gazetën turke dhe konstatonte se kanë marrë pjesë “300 hamaj”, në disa dokumente austriake e gjejmë numrin 5000 të pjesëmarrësve. Ngadhënjimin në fushë të betejës të alfabetit latin për gjuhën shqipe e hetoi me kohë edhe bullgari Ilia Golvanov, i cili do të konstatojë: *“Mund të thuhet lirisht se alfabeti latin (tashti) ka fituar të drejtën qytetare në gjuhën e shkruar shqipe”.*

Këtu duhet të theksojmë faktin se në viset e Kosovës ku ishte më e pranishme propaganda fetare vjeneze dolën komplikime më të mëdha në terren. Në qytetet Prizren, Gjakovë do të organizohen tubime protestuese të aderuesve të alfabeteve në gjuhën shqipe. Patriotët

shqiptarë i debantonin me argumente të forta, makinacionet dhe inskenimet e Qeverisë Xhonturke dhe të shqiptarëve fanatikë. Gazeta shqipe “Bashkimi” i Shkodrës, më 13 shkurt 1910, duke lavdëruar gjuhën shqipe, si më të vjetrën gjuhë evropiane, i ftonte shqiptarët që shqipen ta mësonin me alfabetin e parë të saj, latin! Në anën tjetër të Kosovës, në Gjilan vazhdonte “pakënaqësia e madhe për shkak të lëvizjes në favor të alfabetit latin. Agallarët shqiptarë më autoritet janë kundër alfabetit latin dhe se dy mësues shqiptarë, të cilëtpërpiqeshin të fusnin alfabetin latin, janë ndjekur nga Gjilani”. Sipas këtij informatori serb, Stambolli ishte informuar nga Shkupi se “ithtarët e alfabetit latin në Vilajet kanë pasuar disfatë“, e kjo e kishte trimëruar Ministrin e arsimit që të deklarohet botërisht kundër shkronjave shqipe në Shqipëri. “Organet e larta më së tepërmi iu kanë frikësuar Sanxhakut të Prishtinës, por, si duket, këtu ithtarët e alfabetit arab kanë ngadhënjyer. Hasan Beu, Deputeti i Prishtinës, është kthyer në Stamboll pa kryer punë. Ka mbetur i kënaqur me faktin se nga Vilajeti i Kosovës ka dërguar 12 të rinj në Shkollën Normale shqipe në Elbasan”.

Lëvizja për shkrimin dhe shkollën shqipe në viset e Kosovës sa vinte dhe e siguronte aktiviteti i madh i klubeve arsimore shqiptare. Kërkesat e klubeve shqiptare i përkrahën unanimisht edhe shqiptarët e Kosovës. Një burim serb saktëson se nga viset e Drenicës nuk vinte asnjë kërkesë për alfabetin arab për gjuhën shqipe. Në Vilajetin e Kosovës, pas Urdhrit të Ministrisë të Arsimit për ndaljen e alfabetit latin në shkolla të mjediseve shqiptare islame, vijën zullumet, ndjekjet, largimet nga puna dhe internimet e patriotëve dhe të dashmirëve të shkollës shqipe me alfabetin latin. “*Shkollat, në të cilat do të mësohet gjuha shqipe me shkronjat latine do të mbyllen. Qeveria po merr masa vendimtare kundër të gjithë luftëtarëve dhe aderuesve të alfabetit latin...*”-shkruante shtypi serb. Për situatën e nderë në lëmë të alfabetit dhe të shkollës shqipe në Vilajetin e Kosovës, vend ky ku Stambolli gjithnjë i sprovoi metodat dhe armët pushtuese, shkroi me plot dhembje e pezëm, gazeta “Shqypëja e Shqypënis”.

Kongresi i Manastrit është i rëndësishë së veçantë kombëtare, por edhe për përhapjen e shkollave dhe mësimin të gjuhës shqipe, si edhe zhvillimi i kulturës kombëtare në përgjithësi. Nevojën e caktimit të një alfabeti të vetëm, Rilindësit me të drejtë e panë si një problem gjuhësor e kulturor, por edhe si një çështje politike, një shenjë ndasie, që pengonte bashkimin e shqiptarëve. Unifikimi i alfabetit ndihmoi në lëvrimin e mëtejshëm të gjuhës e të letërsisë shqipe, ashtu edhe në konsolidimin e unitetit kombëtar dhe të bashkimit politik të popullit shqiptar. Vendosja e një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe u përgatit gjatë një epoke të tërë të Rilindjes, falë veprimtarisë krijuese në lëmin e gjuhësisë dhe të letërsisë të brezave të tërë të iluministëve shqiptarë, gjuhëtarë, shkrimtarë, poetë, publicistë etj. Miratimi i alfabetit (alfabetares) së Stambollit, në vitin 1879, shënoi një hap të rëndësishëm në rrugën e vendosjes së një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe, edhe pse atë nuk arriti ta zgjidhte përfundimisht. Alfabeti i Stambollit u përhap vetëm në Shqipërinë e Jugut e të Mesme, ndërsa në Shqipërinë e Veriut, posaçërisht në Kosovë përdorëshin tri alfabete të tjera për shkrimin e shqipes. Organet e shtypit shqiptar, ndonëse botoheshin të gjitha me alfabetin latin, kishin ndryshime ndërmjet tyre.

Thirrja e kongresit për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe u bë e mundur vetëm në rrethanat e reja, që u krijuan për lëvizjen kulturore e kombëtare pas shpalljes së kushtetutës në vitin 1908. Nisma e tij u prit mirë nga atdhetarët shqiptarë dhe nga klubet e shoqëritë patriotike brenda e jashtë vendit, që u treguan të gatshme të dërgonin përfaqësuesit e tyre në këtë kongres. Vendin kryesor në punimet e Kongresit, duke përfshirë edhe mbledhjet e hapura, e zuri çështja e caktimit të një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Pas shumë diskutimesh Komisioni vendosi që të mos merrej në vështrim asnjëri nga tri alfabetet e përmendura më sipër, por të krijohej një alfabet i ri mbi bazën e atij latin, duke u dhënë shkronjave latine vlera fonetike në

përputhje me nevojat e gjuhës shqipe. Por Komisioni ndeshi në vështirësi për caktimin e shkronjave dyshe, që nevojiteshin për ata tinguj të shqipes, që i mungonin latinishtes (për dh, gj, nj, th etj.).

Në këto rrethana, pas tri ditë diskutimesh (17-19 nëntor), anëtarët e Komisionit, sikurse thuhej në vendimin e Kongresit, “të shtyrë edhe nga disa shkaqe të përjashtme”, nuk arritën të caktonin një alfabet të vetëm për gjuhën shqipe, prandaj vendosën “të kthehen prapa”, duke pranuar alfabetin e Stambollit “*e me të bashkë edhe një abece thjesht latine, që të përdroreshin e të mësoheshin bashkarisht në mes të shqiptarëve*”. Të dy alfabetet do të përdroreshin detyrimisht në shkolla. Ky vendim, që vetë Kongresi e quajti kthim prapa, u argumentua nga Komisioni me “disa shkaqe të përjashtme” dhe pikërisht me nevojën për të shtypur me alfabetin thjesht latin libra jashtë Shqipërisë dhe për korrespondencat me jashtë. Vendimi për të përdorur bashkërisht dy alfabete u mor për të mos shkaktuar përçarje në radhët e delegatëve dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Në të njëjtën kohë ai u quajt si një zgjidhje e përkohshme për të kaluar në të ardhmen në përdorimin e një alfabeti të vetëm. Megjithatë, Kongresi iu dha fund kaosit që mbretëronte deri atëherë në çështjen e shkrimit të shqipes. Në vend të alfabeteve të shumta që ishin përhapur në Shqipëri e në kolonitë e mërgimit, tani do të përdroreshin vetëm dy, edhe këta bashkërisht. Atë që nuk e çoi dot deri në fund Kongresi i Manastirit, e zgjidhi përfundimisht vetë jeta e popullit shqiptar. Alfabeti thjesht latin, duke qenë i papërzier e më homogjen nga karakteri i shkronjave, më i lehtë e më praktik për shtyp, u përhap gjithnjë e më shumë dhe nga fundi i Luftës së Parë Botërore u bë tashmë alfabeti i përbashkët e i vetëm për gjithë shqiptarët, alfabeti i sotëm i gjuhës shqipe. Megjithëse çështja e njësimimit të alfabetit zuri vendin kryesor në punimet e Kongresit të Manastirit, vetë Kongresi nuk ishte një mbledhje thjesht gjuhësore, por edhe një manifestim politik. Objekti kryesor i diskutimeve në këto mbledhje ishin marrëdhëniet e shqiptarëve me turqit, lufta për të drejtat kombëtare të popullit shqiptar, për zhvillimin kulturor dhe ekonomik të vendit, si edhe marrëdhëniet me shtetet evropiane. Vendin kryesor në program e zinin kërkesat politike për “njohjen zyrtare të kombësisë shqiptare dhe të gjuhës shqipe”. Pjesë përbërëse e kërkesës për njohjen e kombësisë shqiptare dhe e të drejtave të saj, ishte edhe themelimi i shkollës së pavarur shqipe, që do të arrihej duke i kthyer të gjitha shkollat shtetërore turke në Shqipëri, ato fillore, qytetëse e të mesme, në shkolla kombëtare dhe duke vendosur gjuhën amtare shqipe “si gjuhë mësimi në të gjitha këto shkolla shtetërore”, ndërsa turqishtja do të mësohej si lëndë e veçantë, duke filluar nga viti katërt i shkollës fillore. Një nga kërkesat më të rëndësishme në fushën e arsimit ishte ajo për themelimin e një universiteti shqiptar, që kishte qenë aspiratë e hershme e rilindës. Kongresi i Manastirit dhe vendimet e tij përbëjnë një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e re të popullit shqiptar, i cili hap shtigje edhe për unifikimin e gjuhës.

Rrugëtimi i shkrimit të gjuhës shqipe është i gjatë, shekullor, dhe me plot kurthe e pengesa politike, shqiptare e ndërkombëtare. Këto kurthe e pengesa nuk arriti t’i shmangte as Kongresi i Alfabetit të Manastirit. “Çështje e Abecesë lipset të jetë fillimi, që pa të nuk do mundim të arrijmë qëllimet tona të larta për mbrohtësi të gjuhës!”⁸¹² Andaj, për ta kuptuar më mirë rëndësinë kulturore e politike kombëtare të Kongresit të Dytë të Manastirit, do të duhej shikuar nga këndi i kritikës shkencore objektive për Kongresin e Parë të Manastirit që vlerësohet si i pari aktivitet kulturor i përgjithshëm i inteligjencës e i nacionalistëve shqiptarë.⁸¹³ Ishte ky një

⁸¹²Revista “Leka” - Numër i veçantë. Vazhdim i numrave përkujtimor të XXV Vjetorit të Pavarësisë Kombëtare, Shtypur në Shkodër më 1942, për Vitin XII/1940, fq. 13.

⁸¹³Justin Rrota, *Për historinë e alfabetit shqyp*, Shkodër, 1935, fq. 89.

Kongres i konstitucionalëve shqiptarë osmanli, me pasoja historike për unitetin kulturor e politik të kombit shqiptar, sepse u përmbyllë pa suksesin e pritur, duke i legjitimuar dy sisteme shkronjash atë “Alfabetin Frashëriot”, në shkrim hibrid latin grek e sllav dhe “Alfabetin e Bashkimit” të Shkodrës, pak të modifikuar, dhe kështu, realisht përligjet filli i ndarjes faktike të kombit në dy pjesë: në toskë dhe në gegë.⁸¹⁴

Arsyetimi i “Vendimit” për “dy sisteme të shkrimit”, i lexuar para delegatëve nga At Fishta, nuk pati mbulesë shkencore e politike të arsyeshme. Shikuar nga distanca historike vendimi që “Abeceda e Stambollit kishte me qenë e mjaftueshme që t’i plotësonte kërkesat e kombit shqiptar, por për shtypjen e librave jashtë vendit dhe për telegrame është i nevojshëm një alfabet thjeshtë latin...”krijoi indinjatë nga rilindës të kulluar.⁸¹⁵ Një kritikë me mbështetje shkencore e politike kombëtare i bëri publicisti, Faik Konica, i cili gjykoi çështjen e abesë. “...Nga që ky “kongres” do të mbetet në faqet më të pandershme e më të turpshme, është nevojë të dëftojë qëndresën time në këtë komedie orientale, dhe për këtë punë duhet të nis nga ca më lark...”⁸¹⁶

Ndërsa për organizimin e Kongresit të Dytë të Manastirit, rol madhor pati, juristi, publicisti, linguisti, etnologu, historiani, poeti, profesori i shqipes në Normalen e Shkupit dhe luftëtari i Pavarësisë së Shqipërisë, Salih Gjukë Dukagjini, ndjekësi më besnik i frymës politike patriotike të kolosëve të kombit- Hasan Prishtina – Nexhib Draga.⁸¹⁷ Sipas burimeve arkivore, në Kongresin e Dytë të Manastirit kanë marrë pjesë 24 veta, të cilët për kryetar të Kongresit e zgjodhën profesorin e historisë, Bedri be Pejanin, ish profesor i gjuhës shqipe në Idadinë (Gjimnazin) e Shkupit, kurse për sekretar: Ferid bej Ypin, avokat në Manastir e Petro Nini Luarasin, mësus në Negovan.⁸¹⁸ Ky Kongres i kushtoi rëndësi të veçantë gjendjes aktuale dhe të ardhmes së shkollës shqipe dhe ndriçoi propagandën e huaj në vendet shqiptare. Njëri ndër vendimet historike të Kongresit të Dytë të Manastirit ishte: *Alfabeti pastër latin i modifikuar për shkrim të gjuhës shqipe në Kongresin e Parë të Manastirit, të përdoret i vetëm në shkollën shqipe, në shtypin shqip, në botimet shqipe dhe në administratën shqipe në të gjitha vendet ku banonin e vepronin shqiptarët.*

7.1.3. Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës

Komisia Letrare Shqipe në Shkodër ishte një këshill i formuar nga intelektualët më në zë të kohës mbi çështjen e gjuhës shqipe. Në këtë veprimtari gjuhësore elitë merrnin pjesë edhe

⁸¹⁴Stjepan Antoljak, *Prilog historijatu borbe albanaca za svoj Alfabet*, “Gjurmime albanologjike”, nr. 1, Prishtinë, 1969, 46;

Stavro Skendi, *Historia e abeces shqipe*. Një rasë zhvillimi kulturor dhe politik të ndërlikuar- ASHKP - “Fondi i Alfabetit”;

M.Pirra, *Roli i Kosovës në zgjidhjen përfundimtare të Alfabetit Kombëtar Shqiptar*, Gazeta “55”, Tiranë, 14 -26 nëntor 2008; “Republika”, Tiranë, 15-27 nëntor 2008.

⁸¹⁵ASHKP, “Fondi i Alfabetit”. Raporti i konsullit Visart, më 25.XI.1908, fotokopje nga fondet e Arkivit të Oborrit Mbretëror të Vjenës (më tutje vetëm: AOMV).

⁸¹⁶Rev. “Albania” nr. 1, vjeti. XII, London, 1909, fq. 24. Kritika e plotë, te: M.Pirra, Albania e Konicës, Prishtinë, 1995, 55-64.

⁸¹⁷ M.Pirra, *Të dhëna për jetën dhe veprimtarinë e Salih Gjokës*, Shkrolaria e Shqypes, Pjesa e parë, Teorike dhe praktike, Prishtinë 1991, 11-66.

⁸¹⁸Elida Jorgani (Duka), Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Arbnori” “Projekt- 100-Vjetori i Kongresit të Dytë të Manastirit (2-3 prill 1910)”, Tiranë, 27. 10. 2009, Nr. Prot.1991.

albanologë të huaj.⁸¹⁹ Por puna përgatitore kishte filluar edhe më parë, por për këto veprimtari nuk kërkohej vetëm dëshira e mirë me karakter kombëtar e gjuhësor e secilit prej pjesëtarëve të saj, por edhe miratimi i komandës ushtarake austriake. Atë koncension që bënë autoritetet ushtarake austriake për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, patriotët shqiptarë e shfrytëzuan me zgjuarsi dhe shumë shpejt, pa kaluar vetëm pak muaj pas pushtimit hodhën idenë për themelimin e Komisionit Letrar Shqipe. Vendimi për miratimin e Komisionit ishte marrë më 30 qershor 1916⁸²⁰, por ka edhe një version tjetër për fillimin e Komisionit, të cilin e jep Pal Duka-Gjini.⁸²¹ Ky autor thotë se: "Dishiri dhe përkrahja e Austrisë për të mëkambë gjuhën shqipe i dhanë zemër veteranëve të kombit për punë përherë e ma të vlershme në këtë drejtim. Këtë periudhë historianët e gjuhës e vlerësojnë si punë përgatitore, mbasi si procesverbali, si broshura "Laimet..." shënojnë si datë themelimi 1 shtatorin e vitit 1916, kur u bë mbledhja e parë. Në Statutin (në versionin e parë) që mund të jetë miratuar më parë, ekzistonte edhe mendimi që Komisioni të jetë krijuar nga fundi i gushtit të vitit 1916.⁸²² Ishin dy faktorë që do të lejonin të fillonte puna e Komisionit, e para, duhej të ftoheshin dhe të merrnin pjesë intelektualët më në zë që kishin dhënë ndihmesa për kulturën shqiptare, por edhe që mund të vinin për të marrë pjesë në kushtet e luftës, e dyta, miratimi dhe legalizimi i saj nga komanda ushtarake austro-hungareze në Shqipëri. Pjesëmarrës të KLSH ishin kryesisht intelektualë me potencë, të njohur gjithandej në vendin tonë dhe jashtë, personalitete të kulturës kombëtare "ekspertë të të gjitha fushave, njohës të të gjitha gjuhëve klasike dhe moderne të kontinentit evropian, si dhe të zhvillimit arsimor e kulturor të vendeve të përparura".⁸²³ Me një përfaqësi të tillë do të arrihej në "bashkimin e një elite intelektuale të fuqishme" që patjetër do t'i jepte udhë disa prej problemeve më të mprehta dhe të ngutshme të gjuhës, letërsisë, arsimit dhe kulturës kombëtare. Në mbledhjen e parë themeluese morën pjesë gjashtë vetë: Luigj Gurakuqi, At Gjergj Fishta, Sotir Peci, Dom Ndre Mjeda, Mati Logoreci, dhe At Ambroz Marlaskaj. Pjesëmarrës dhe të ftuar të tjerë të KLSH që morën pjesë në mbledhjet e mëvonshme qenë dr. Gjergj Pekmezi, Hilë Mosi, Anton Paluca, Hafiz Ali Korça, Aleksandër Xhuvani, Maksimilian Lamerci, Rajko Nahtigal, Emzot Vinçens Prenushi, Sali Nivica, Josif Haxhimima dhe Luigj Naraçi.

Në procesverbalin e KLSH që fillon më 1 shtator 1916 dhe përfundon më 22 maj 1918 e që ruhet në Arkivin e Shtetit, janë protokolluar 63 mbledhje.⁸²⁴ Struktura e këtij institucioni ka qenë e tillë: një kryetar, i emëruar nga Komanda ushtarake austro-hungareze, një sekretar, disa disa miss, miss me korrespondencë dhe të ftuar. Anëtarë do të ishin shtatë, por ky numër mund të rritej në dymbëdhjetë. Por në mbledhjen e 16 shtatorit 1916 u morën edhe këto vendime për t'u pasqyruar në Rregulloren ose Statutin e Komisionit. Anëtarët e Komisionit do të mblidhen tri herë në javë nga dy orë. U përcaktuan edhe njëherë objekti i punës së KLSH, detyrat që do të ketë komiteti veprues, kryetari, sekretari, bibliotekari etj. Kryetari i KLSH-së u caktua nga Komanda ushtarake austriake dr. Gjergj Pekmezi, i cili e kreu këtë detyrë nga data 24 shtator 1916 deri më 17 shtator 1917. Pastaj detyra e kryetarit iu ngarkua L. Gurakuqit. Por Gurakuqi, disa muaj më parë e pikërisht që nga 15 prilli i vitit 1917 me urdhër të komandës ushtarake kishte kryer

⁸¹⁹ Në të përkohshmen "Lajmet e Komisionit Letrar Shqipe", 1918, f.2.

⁸²⁰ *Die Verwaltung Albaniens an der Hand der ergangenem Befehle*, Wien, 1918, f. 248.

⁸²¹ Monografia "Gjergj Fishta jeta dhe vepra", Tiranë, 1992, f.100.

⁸²² Ilir Kanini, *Arsimi në Shqipëri, në vitet e Luftës së Parë Botërore*, Tiranë, 2001, f.133.

⁸²³ Sh. Osmani, *Reflekse etnopedagogjike*, I, Tiranë, 1998, f. 342-343.

⁸²⁴ T. Osmani, *Çështje të gjuhës letrare shqipe gjatë viteve 1916-1918*, "Buletin shkencor", Shkodër Nr.1, 1987, f49-50;

Komisioni Letrar Shqipe në Shkodër, "Rilindja", Tiranë, 16.01.1997.

detyrën e zv.kryetarit të Komissisë. Kur u emërua Gurakuqi kryetar, zëvendës i tij u bë Mati Logoreci. KLSH kërkoi të shtrijë veprimtarinë e vet gjithandej nëpër Shqipëri. Për këtë qëllim ajo caktoi edhe anëtarë korrespondentë, si Sh. Gjeçovin. Këta veprimtarë do të ndihmonin Komissinë me materiale të mbledhura nga goja e popullit etj. Kështu në shkresën që i dërgon Shtjefën Gjeçovit, kryetari i komissisë Gj.Pekmezi, më 8.11.1916 jo vetëm e njoftonte se ishte emëruar anëtar korrespondent i KLSH, por i kërkonte të dërgonte “përralla dhe këngë popullore t’atynë viseve”, por këta duhet të mblidhen mirë dhe të përshkruhen “*krejt ashtu siç tregohen dhe këndohen si nga ana e dialektit, ashtu edhe rreshtimi i fjalëve i pandryshuem fare.*” Në përgjigjen që i jep Shtjefën Gjeçovi nga Thethi, mbasi e falënderon për emërimin si anëtar korrespondent, i shkruan: “*Unë si gjithëherë edhe prej tashit do të përpiqem me cenë (zell), për t’mbledhun t’visarit t’literaturës sonë prej gojet t’kombit...*” por ai shpreh shqetësimin nëse ka për të gjetur subjektet që interesojnë. Me të vërtetë shumica e pjesëmarrësve ishin nga Shkodra, por prania e intelektualëve nga qytete të tjera të Shqipërisë, si S.Peci, A.Xhuvani, H.Ali Korça e J.Haxhimima ishte një element i përparuar i Komissisë, që vëmendjen nuk e përqendroi vetëm tek intelektualët shkodranë, por i dha një hapësirë më të madhe dhe një shtrirje më të gjerë, duke e konceptuar veprimtarinë e saj si një çështje mbarëkombëtare dhe vendimet që mori, qenë mjaft të përparuara për kohën. Vazhdimësi e gjithë këtyre aktiviteteve dhe vendimeve të mëdha gjuhësore dhe gjithë këtyre veprimeve kulturore që organizimi i Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, që u mbajt në Tiranë në nëntor 1972, ku merrnin pjesë një numër i madh delegatësh – studiues, shkrimtarë, punonjës kulture e profesorë (gjithsej 87 - 11 prej të cilëve nga viset shqiptare në ish-Jugosllavinë dhe dy-tre arbëreshë e të huaj).

Vendimet e këtij Kongresi, të miratuara pas një diskutimi të gjerë e të gjithanshëm të të gjitha çështjeve lidhur me shqipen letrare dhe sidomos me drejtshkrimin, mbi të cilat do të hartoheshin më vonë të gjitha botimet gjuhësore normative (fjalorë, gramatika e libra shkollorë) dhe kështu, merrte fund odiejada e cila kurorëzohet me themelimin, me njësimin e shqipes standarde.

7.1.4. Konsulta gjuhësore e Prishtinës

Njëqindvjetori është simbolikë për moshën e përvjetorëve të mëdhenj të gjuhës e të kulturës shqiptare. Tashmë u mbushën njëqind vjet të alfabetit të shqipes, njëqind vjet të lindjes së Eqerem Çabejt - studiuesit me të madh të shqipes dhe njëqind vjet të shtetit shqiptar. Por, gati përgjysëm më të re është një ngjarje për gjuhën shqipe e mbajtur në Prishtinë dhe e pagëzuar si Konsulta Gjuhësore e Prishtinës. Kjo Konsultë bashkoi të gjithë shqiptarët rreth një gjuhe - gjuhës standarde shqipe. Konsulta Gjuhësore e Prishtinës e vitit 1968⁸²⁵ ishte mbledhja e katërt gjuhësore e organizuar në Prishtinë përgjatë 16 viteve. Pra, me Konsultën Gjuhësore të Prishtinës nuk fillon planifikimi gjuhësor për shqiptarët që jetonin jashtë shtetit amë, në disa ndarje administrative në ish Jugosllavi. Para saj janë mbajtur edhe tri mbledhje gjuhësore që do të shënojnë përpjekjet për standardizimin e gjuhës për shqiptarët e Kosovës dhe shqiptarët e viseve të tjera shqiptare në ish Jugosllavi. Të kujtojmë se gjatë viteve '50 e '60 edhe në Tiranë janë zhvilluar veprimtari, diskutime e debate për çështje të gjuhës, të drejtshkrimit, por edhe të planifikimit gjuhësor. Siç dihet, më 1967, rihapet Instituti Albanologjik dhe po në këtë vit në Prishtinë do të arrijë "Projekti i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe", i hartuar nga

⁸²⁵ Shefkije Islamaj, *Konsulta Gjuhësore e Prishtinës - marrëveshje për njësimin gjuhësor*, Prishtinë, 2006.

studiuesit e shquar të Tiranës, i cili do të nxiste nismën e Institutit Albanologjik të Prishtinës dhe të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë të Fakultetit Filozofik të Prishtinës që më 22 e 23 prill 1968 të organizojnë Konsultën Gjuhësore, të njohur me emrin "Konsulta e Prishtinës". Në dy ditët e Konsultës u zhvilluan diskutime të shumta nga pjesëmarrësit, në mbështetje të Projektit të Rregullave të drejtshkrimit. U shtruan çështje praktike, u bënë vërejtje parimore, u dhanë sugjerime të shumta. Numri i diskutuesve ishte i madh. Çështje e vërteta botimi i letërsisë në letrarishite në Kosovë kishte filluar më herët, bile kishte raste kur disa mësimdhënës me dije më të thelluar gjuhësore të kishin zbatuar edhe në shkollë me vetëiniciativë. Konsulta Gjuhësore u mbajt më 1968 në Prishtinë, si qendra që tubonte të gjithë shqiptarët që jetonin në Jugosllavi (administrative, arsimore e kulturore). E tillë do të bëhej, sidomos pas viteve '60 për shqiptarët e Kosovës do të nisë një periudhë e re, kur zhvillimi arsimor e kulturor dhe bashkëpunimi me Shqipërinë do të zgjerohej.

Refleksionet e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës për gjuhën standarde

Kriteri i unitetit që karakterizon këtë tubim historik gjuhësor është pranimi i bashkimit gjuhësor për të gjithë shqiptarët, pranimi për normë Projekti i Rregullave të Drejtshkrimit të Tiranës të vitit 1967, duke hequr dorë nga rregullat e drejtshkrimit të vitit 1964 të gegërishtes standarde, shqiptarët e Kosovës dhe të trojeve të tjera shqiptare në Jugosllavi i dhanë fund rrugës ndarëse gjuhësore nëpër të cilën kishin ecur në historinë e tyre të gjatë gjuhësore dhe hapi rrugën e bashkimit gjuhësor. Kur në Kosovë ende po luftohej analfabetizmi dhe shkalla e tij ishte shumë e lartë, dëshira e entuziazmi, po, sidomos, vetëdija e lartë kombëtare për rëndësinë e këtij veprimi, mundësuan të mposhten sfidat e vështirësitë, përvetësimi dhe zbatimi në formën e shkruar të shënonte suksese. Zbatimi i rregullave të projektit të drejtshkrimit filloi të realizohej menjëherë në gazetatat, në emisionet e radios, në shkolla, sidomos në mësimin e gjuhës amtare, po pak a shumë edhe në mësimin e lëndëve të tjera, më pas në botimet shkollore, botimet letrare e të tjera dhe në institucionet shtetërore aty ku kishte hapësirë për shqipen. Mund të thuhet se shumë shpejt shqipja letrare fitoi autoritetin e pakontestueshëm. Rezultatet në përdorimin praktik të saj ishin mëse modeste për arsyet e ditura, megjithatë pranimi i gjerë dhe gatishmëria që të mësohej e të përdorej, hapen mundësitë që rrjedha e këtij procesi të kishte të ardhme të mirë. Megjithë vështirësitë objektive të fillimit, vitet '70 ishin vendimtare që gjuha standarde në këto hapësira të shënonte suksese edhe përtej parashikimeve. Rruga e filluar mirë, fatkeqësisht do të ketë vështirësi pas ngjarjeve të vitit '81 për t'u intensifikuar sidomos gjatë viteve '90 për arsyet e njohura. Nisur nga këto vendime në Kosovë është shënuar shkallë e dëshirueshme e zotërimit të gjuhës standarde. *"Edhe kur u formua gjuha letrare është theksuar se e sotmja nuk do t'i takojë plotësisht gjuhës standarde"*.⁸²⁶ Në Kosovë përvetësimi i gjuhës standarde shpreh shpërpjestim midis formës së shkruar dhe asaj të folur. Kudo gjuha e shkruar dallon nga gjuha e folur dhe kudo prirja që ky dallim të rritet është i pranishëm. *"Dallimi midis gjuhës së shkruar dhe gjuhës së folur është çdo herë e më i madh. Nuk e kanë të njëjtë as sintaksën e as fjalorin. Madje edhe morfologjia dallon. Dallimi shihet sidomos në fjalorin."*⁸²⁷

Mësimi i gjuhës standarde në Kosovë është shoqëruar me veprime konkrete e përmes një procesi të vazhdueshëm të shkollës, të mjeteve të informimit dhe të veprimtarisë botuese. Në Kosovë, u morën vendime të rëndësishme që i paraprinë Kongresit Drejtshkrimor të vitit 1972

⁸²⁶ Emil Lafa kështu pohon në një shkrim të tij, duke shkruar për këto probleme.

⁸²⁷ Linguisti Vendries në librin e tij *Ligjerimi sjell shembullin e frengjishtes*.

me veprimtaritë standardizuese të shqipes, në hartimin e teksteve normëzuese ku kanë marrë pjesë, studiuesit tonë të njohur, njohësit e mirë të shqipes.⁸²⁸ Ky bashkim gjuhësor i shqiptarëve në Prishtinë dëshmoi se shqipja standarde do të vazhdojë të mbetet gjuha e përbashkët e të gjithë shqiptarëve, edhe e shqiptarëve të Kosovës, duke pasur një gjuhë të përbashkët, duke pasur identitet etnik të përbashkët e një histori të përbashkët gjuhësore. Me vendimin e Konsultës Gjuhësore të Prishtinës, shqiptarët e Kosovës dhe ata që jetonin në trojet e tyre në ish Jugosllavi, u bë një hap historik për t'i bërë një komb modern. Në Prishtinë, në një mbledhje të gjerë shkencore, e cila njihet si Konsulta Gjuhësore e Prishtinës (1968) objekt diskutimi u bënë ato rregulla me temën qendrore: të njësohej shqipja apo të vazhdonte përdorimi i variantit të gegërishtes letrare. Pas shumë diskutimesh të mbështetura, konferenca doli me konkluzat se “*populli shqiptar është një, dhe gjuha letrare shqipe duhej të ishte një, e përbashkët*”.

7.1.5. Kongresi i Drejtshkrimit, 1972

Rruga që ka ndjekur shqipja për standardizimin e saj, kulmon me dy arritje të gjuhës shqipe: *Kongresi i Manastirit më 1908*, kur u themelua alfabeti i shqipes, dhe ngjarja tjetër, më e madhja kulturore shqiptare, *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe*, mbajtur në nëntor 1972 në Tiranë.⁸²⁹ Ky tubim erdhi si kryevepër e gjuhësisë, me nismën e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës (USHT) dhe u mbajt nga 20 nëntor deri në 25 nëntor të vitit 1972. Në punimet e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, përfaqësuan gjerësisht forcat e shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare. Aty ishin të pranishëm 87 delegatë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi si dhe arbëreshë nga Italia. Kërkesa për njësimin e shqipes, po shtrohej zëshëm në këtë vend ku buruan vendime të mëdha kulturore, shkencore, politike e letrare, lidhur me variantet letrare të shqipes standarde që përdorej. Në fushat e jetës kulturore – arsimore, shkencore e publicistike, në Kosovë, ishte në përdorim varianti letrar të gegërishtes, si dhe në vise të tjera shqiptare në ish-Jugosllavinë. Në Kosovë gjatë viteve gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar kishin arritur një shkallë mjaft të lartë afrimi, madje edhe njësimi të plotë në shumë nënsisteme, dhe kjo sidomos në gramatikë (veçanërisht në morfologji), në leksik e në fjalëformim.

⁸²⁸Hartues të projektortografisë së vitit 1967 dhe Rregullave të drejtshkrimit kanë qenë Çabej, Domi, e Kostallari dhe Lafe, personalitete këto me kompetenca jo vetëm në fushën e studimeve thjesht gjuhësore, po edhe në fushën e planifikimit gjuhësor. Këta emra do t'i gjejmë si autorë të gramatikave, hartues të fjalorit të shqipes dhe të fjalorëve të tjerë terminologjikë. Autorët e përmendur, studiuesit e njohur të gjuhës shqipe e të shqipes standarde kanë shfrytëzuar erudicionin e tyre, kompetencën e tyre dhe parimet e tyre moralo-shkencore në punën rreth krijimit të gjuhës standarde.

⁸²⁹Menjëherë pas Kongresit të Drejtshkrimit nisi puna për përgatitjen dhe botimin e veprave normative për drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e gjuhës shqipe. Pas Kongresit doli botimi përfundimtar i librit “Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe” (1974). Një varg veprash të rëndësishme, si: Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” (1973), “Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës” (1973), “Fjalori drejtshkrimor” (1974), “Gjuha letrare shqipe për të gjithë” (1976), “Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme shqipe” (1976), “Çështje të normës letrare” (Prishtinë, 1980), “Rregulla të pikësimit në gjuhën letrare shqipe” (Projekt më 1981 dhe ribotim i plotësuar më 2002), “Gjuha jonë” (Revistë periodike që ka filluar të botohet që prej vitit 1981. Në vitin 1982, një revistë e tillë filloi të botohet edhe nga Instituti Albanologjik i Prishtinës), “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe” (1980), “Fjalori i shqipes së sotme” (1984), “Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe” (1976), “Gramatika e gjuhës së sotme shqipe I”, “Morfologjia” (1995), “Gramatika e gjuhës së sotme shqipe II”, “Sintaksa” (1997), “Fjalori drejtshkrimor” (2010) etj., kodifikojnë normat e gjuhës standarde, pasi janë në pajtim me rregullat e vendosura në Kongresin e Drejtshkrimit.

Por, shtrohej nevoja të kapërceheshin disa dallime në sferën e fonetikës, ndonjë çështje morfologjike që lidhej me dallime fonetike, dhe përdorimi i formës së pashtjelluar të paskajores me ardhë, me ba në gegërishten letrare, sa kohë që ajo nuk përdorej në asnjë mënyrë në toskërishten letrare. Në këtë kohë, në Kosovë dhe në të tjera vise shqiptare këtej kufirit shtetëror Shqipëri, ish-Jugosllavi, ishin krijuar kushte të volitshme për të realizuar një nga aspiratat që për një kohë të gjatë kishte qenë nga synimet e figurave më të ndritura kombëtare -për të përfunduar procesin e gjatë të njësimimit të shqipes letrare. Në këtë kohë, u nxorën për diskutime të gjithanshme në qarqe shkencore, letrare e kulturore “*Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe*” (Projekt), hartuar nga një grup studiuesish të njohur të kohës, në Shqipëri në vitin 1967. Kjo kohë karakterizohet me forcat drejtuese shkencore e kulturore (po edhe politike pse jo) të Kosovës, disa muaj pas botimit të kësaj vepre, në prill 1968, do të organizohej një diskutim i gjerë në një veprimtari shkencore, që u bë e njohur në historikun e kulturës shqiptare si Konferenca Gjuhësore e Prishtinës. Në atë konferencë, organizuar nga Katedra e Gjuhës Shqipe e Fakultetit (atëherë Filozofik) të Prishtinës, dhe Instituti Albanologjik i Prishtinës, në të cilën merrnin pjesë studiues të shqipes, redaktorë botimesh, mësues të gjuhës e të letërsisë, gazetarë, punonjës kulture e të tjerë intelektualë shqiptarë të kohës (nga të gjitha qendrat kulturore, arsimore e shkencore shqiptare këndeje kufirit, ku u mor një nga vendimet me rëndësi për njësimin e gjuhës letrare shqipe dhe njësimine saj, edhe pse në këto vise do të përdorej si variant letrar në veprimtarinë arsimore, kulturore, shkencore, në gazetari e të tjera forma e bërë publike përmes “*Rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe*” (Projekt), por vendimet përfundimtare për standardizimin e shqipes, nisën të bëheshin të detyrueshme edhe për intelektualët e për punonjësit e kulturës ndër këto vise.

Si në Shqipëri, si në Kosovë, dhe në mbarë Botën Shqiptare, me përjashtim të individëve e ndonjë qendër kulturore, jashtë trojeve, vendimet e Kongresit u pritën si një arritje e madhe jo vetëm në fushë të kulturës kombëtare. Në Shqipëri, Kosovë dhe kudo që flitej shqip njësimi në gjuhën përbënte një arritje tepër të madhe. Kjo arritje duhej të sillte edhe një dobi tjetër, duhej të ndërpritej statusi i pabarabartë i shqipes standarde në Kosovë përballë serbishtes, që ishte gjuhë zyrtare e një bashkësie shumë të madhe dhe gëzonte prestigj ndaj shqipes. Gjithë kjo duhej pritur të ndikonte në zhvillimin e mëpastajmë të shqipes vetëm në një hulli, të një shqipeje me të vërtetë të njësuar në të gjitha nënsistemet e saj ...Veçse, për fat të keq, duhet të themi se njësimi i shqipes letrare nuk arriti të këpuste lidhjet e ndikimet e serbishtes (sidomos në fushë të sintaksës) mbi shqipen standarde të përdorur në Kosovë.

Zhvillimi i vrullshëm e cilësor i kulturës, i letërsisë dhe i shkencës mbi bazën e shndërrimeve të thella historike ekonomiko-shoqërore, që janë kryer në Shqipërinë socialiste e që kanë sjellë ndryshime të thella edhe në vetëdijen gjuhësore të popullit shqiptar, i ka dhënë një shtytje të fuqishme e të pandërprerë njësimimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe, themelet e së cilës janë hedhur që në kohën e Rilindjes. Gjuha letrare shqipe kishte arritur një shkallë të zhvillimit, që na lejon të pohojmë shkencërisht, se populli shqiptar kishte trazuar udhën e parimeve të përgjithshme të drejtshkrimit të njësuar i gjuhës shqipe si një shprehje e kristalizimit të normës letrare kombëtare në të gjitha hallkat kryesore të strukturës fonetike, gramatikore, fjalëformuese e leksikore. Gjuha letrare e njësuar, norma kombëtare e së cilës ishte kristalizuar në të gjitha hallkat kryesore të strukturës fonetike, gramatikore, fjalëformuese e leksikore e në disa hallka të veçanta ndodheshin në fazën e fundit të kristalizimit. Ky pikëtakim i ajkës së gjuhësisë, ishte bërë një shqyrtim shkencor përgjithësues i nivelit të zhvillimit të gjuhës së sotme letrare shqipe, prirjeve të evolucionit të saj dhe në mënyrë të veçantë gjendjes së drejtshkrimit. Shqipja letrare e kohës sonë ka hyrë tashmë në fazën më të lartë të zhvillimit të saj, në fazën e kristalizimit të

plotë e përfundimtar, sepse “...ajo funksionon si një gjuhë letrare e përbashkët dhe e njësuar në të gjitha sferat e veprimtarisë shoqërore. Kjo shkallë e lartë zhvillimi kërkon edhe përcaktimin e normave drejtshkimore sa më të plota, sa më të njësuar dhe të qëndrueshme.”

Derisa përpara Çlirimit ritmet e zhvillimit të gjuhës letrare kombëtare, për shkak të kushteve historiko-shoqërore të vështira, kanë qenë të ngadalshme dhe pengesa të shumta i janë vënë shkollës shqipe, por është luftuar pareshtur për ta pasuruar e për ta ngritur në nivelin e një gjuhe të përbashkët kombëtare sa më të njësuar e të përparuar. Kështu, drejtshkrimi ka ecur përpara krahas zhvillimit të vetë gjuhës, është përsosur vazhdimisht në saje të zhvillimit të shkencës gjuhësore shqiptare dhe është përvetësuar e ngulitur nga shkolla dhe nga shtypi e botimet shqiptare kudo. Madje, drejtshkrimi në këtë kongres nuk ishte vetëm një çështje shkencore, por ishte edhe një shprehje e drejtpërdrejtë e njësimi të gjuhës letrare kombëtare, si një vendim i dorës së parë në forcimin e vetëdijes kombëtare.

I parë nga këndvështrimi i opinionit ndërkombëtar, por vështruar edhe mbi bazë të emrave të shkencëtarëve e studiuesve të shqipes që vinin nga të gjitha viset e qendrat më të mëdha të studimeve albanologjike jo vetëm në Shqipëri e në Kosovë, po edhe ndër arbëreshët e Italisë e nga qendra diaspora, Kongresi i Drejtshkrimit krijonte perceptimin e një ngjarjeje shumë të madhe shkencore e kulturore në shkallë kombëtare për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe. Kongresi kishte epitetin “*I drejtshkrimit të gjuhës shqipe*”, por marrë parasysh temat dhe problemet që u shtruan, u rrahën e u diskutuan aty, - ai në të vërtetë ishte një simpozium, një kongres i madh (më i madhi gjatë historisë kulturore kombëtare) i gjuhës shqipe, sepse aty, krahas çështjeve të veçanta të drejtshkrimit, u diskutuan me një mbështetësi shkencore e mbi bazë të studimeve e gjurmimeve - probleme të gjuhës shqipe në dialektet e të folmet e shqipes, tek autorët e vjetër të shkrimit shqip, në fushë të letërsisë në periudha të ndryshme (sidomos që nga Rilindja e këndej), në publicistikë e në të tjera sfera të përdorimit të shqipes së shkruar.) U diskutuan tema që merreshin me studime të rregullave të veçanta morfologjike (shumësi i emrit, trajtat e foljeve, klasifikimi i tyre, mbiemrat e shqipes, përemrat pronorë e të tjerë); tema në fushë të terminologjisë në të gjitha dijet, që kishin marrë hov zhvillimi atë kohë; tema për leksikun e për fjalëformimin në gjuhën shqipe; probleme të përdorimit të fjalëve me burim të huaj në gjuhën shqipe dhe të shkrimit të tyre; përdorimi i parafjalëve të ndryshme në shqipen e shumë të tjera çështje, që kapërcenin fushën e drejtshkrimit të shqipes. Përfundimet që u morën në kongres, u shtruan në një dokument që u quajt *Rezoluta e Kongresit*. Pas diskutimeve për probleme të veçanta, Kongresi miratoi Rezolutë, e cila përmbante parimet themelore që duheshin ndjekur kur të botoheshin në formë libri *Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe*. Në dritën e të gjitha këtyre zhvillimeve dhe në përputhje me argumentimet shkencore, që u shprehën në referatin “*Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*”, në kumtesa⁸³⁰ e në diskutime, duke u mbështetur edhe në parashtrësat e dy komisioneve të veçanta të shqyrtimit të vërejtjeve, Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe miratoi disa rezoluta dhe vendosi që: “...*Parim themelor i rregullave të drejtshkrimit të shqipes të jetë parimi fonetik, që shkrimi pasqyron jo vetëm strukturën fonetike, por edhe veçoritë e strukturës gramatikore, leksikore e fjalëformuese të gjuhës; rregullat e drejtshkrimit do të mbështeten edhe në parimin morfologjik, parimi historik-tradicional, që rregullat e drejtshkrimit të jenë sa më të thjeshta, të qarta e përgjithësuese, të jenë sa më njësuese, të pakësohen në masën më të skajshme zgjidhjet e dyfishta etj. Duke marrë parasysh gjendjen e normës gramatikore, për t’iu përgjigjur nevojave të praktikës, në “Rregullat e drejtshkrimit” të përfshihet një kapitull, ku të trajtohen çështje*

⁸³⁰Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe*, Rilindja, Prishtinë 1974.

gramatikore që lidhen ngushtë me drejtshkrimin dhe që rregullat e drejtshkrimit të zanoreve e të bashkëtingëlloreve të ndërtohen e të renditen sipas çështjeve fonetike”. Në hartimin përfundimtar të "Rregullave të drejtshkrimit të shqipes" u vendos që të kihen parasysh këto kërkesa të Kongresit:

Për drejtshkrimin e zanoreve;

Për drejtshkrimin e bashkëtingëlloreve;

Për shkrimin e fjalëve dhe të emrave me prejardhje të huaj;

Të trajtohen çështje gramatikore të shumësit,nyjeve e trajtave të ndryshme;

Për shkrimin e fjalëve bashkë ose ndaras dhe bashkë ose me vizë në mes;

Për përdorimin e shkronjave të mëdha;

*Për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit.*⁸³¹

Duke e vlerësuar gjuhën letrare të njësuar si një nga arritjet më të mëdha të shoqërisë në lëmin e kulturës, si kurorëzimin e përpjekjeve të pareshtura të shumë brezave që, edhe në kohët më të errëta, e ëndërruan këtë ditë dhe punuan me vetëmohim për ta bërë realitet, Kongresi i bëri thirrje gjithë popullit shqiptar që ta përdorë gjuhën letrare të njësuar si detyrë të vazhdueshme e kombëtare⁸³²

⁸³¹ *Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe*,1973, Prishtinë.

⁸³² Androkli Kostallari, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë*, Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë 1988, Fq. 567.

7.2. STATUSI I SHQIPES STANDARDE NË KOSOVË

Rrugët e krijimit të gjuhëve standarde janë të ndryshme. Ka raste kur merret një variant letrar i një dialekti, ka raste kur gjuha standarde vjen nga bashkimi i dy a më shumë dialekteve, etj. Varieteti i ngritur në standardizim sipas lingvistëve bëhet kur, “*kodifikimi dhe përfaqimi i një bashkësie normash që përcakton përdorimin e drejtë në kuadër të bashkësisë së përdoruesve*” (Stjuart). Tek shqiptarët kodifikimi erdhi në një rrugë të gjatë e të vështirë. Derisa, sipas Xh. Fishmanit “*Planifikimi i gjuhës është edhe planifikim i kombësisë dhe në këtë kuptim ai ndryshon nga planifikimi industrial apo bujqësor, që në rastin më të mirë fillon si planifikim kombëtar*”.⁸³³ Edhe gjuha jonë standarde e ka arritur statusin unik mbidialektor për të gjithë kombin shqiptar. Shqipja standarde shërben si mjeti themelor për ruajtjen dhe zhvillimin e traditës, për komunikim në shkollë e administratë dhe ruajtjen e identitetit kombëtar..., etj.

Për t’i përmbushur funksionet e veta, shqipja standarde në një udhë të gjatë është dashur t’i arrijë tiparet që sociologuistika e sotme i çmon si karakteristike për një gjuhë, të jetë e kodifikuar, të ketë traditë letrare, t’i ketë institucionet që kujdesen për të, të jetë simbol i njësisë, dhe i identitetit... Këto tipare, shqipja e sotme standarde (letrare) i ka, dhe me mënyrën se si i ka arritur, ajo hyn ndër dukuritë origjinale të Evropës në këtë fushë, ku siç po duket, rëndësi shumë të madhe ka njësia ekonomike.

Pas vitit 1972, gjuha jonë, shqipja standarde është futur në përdorim në jetën shoqërore dhe publike, në organizatat shoqërore e politike, madje ishte hartuar infrastrukturë ligjore që i garantonte këto, në marrëdhënie pune, në administratë, në shkolla dhe në institucionet e kulturës dhe të shkencës, në mjetet e informimit publik, në botime, në teatër, në film, etj. Përdorimi i gjuhëve në Jugosllavi ishte çështje e trajtuar dhe rregulluar në përmasa juridike. Statusi i vërtetë i shqipes standarde në Jugosllavi mund të shihet në dritë më të qartë nëse merren parasysh në tërësinë e përdorimit të shqipes standarde si mjet i kulturës dhe i qytetërimit. Derisa, serbokroatishtja ishte gjuhë standarde e katër kombeve, shqipja ishte vetëm një kombi, edhe pse flitet në shtete të ndryshme. Sipas studiuesit Ismaili, gjuha shqipe mund të përblidhet në tre tipare: historiciteti, vitaliteti, dhe ekspansiviteti. Ndër funksionet e tilla më të njohura të gjuhës shqipe ishin: *funkzioni i bartësit të edukimit, funksioni i gjuhës së mjeteve të komunikimit masiv, i gjuhës së veprimtarive kulturore e shkencore*, etj. Si më specifike do të veçonim: *funkzioni bashkues ose integruues, funksioni i prestigjit funksioni orientues dhe funksioni simbolik*. Këto tipare i shprehin qëndrimet e folësve ndaj gjuhës së tyre: lojaliteti, krenaria, vetëdija mbi rëndësinë e normës; bashkë me këtë shkon edhe kujdesi ndaj gjuhës, kultura e gjuhës, pra edukimi gjuhësor, veprimtari gjithësesi përparimtare, prandaj meriton kujdesin shoqëror; rëndësi ka sidomos atje ku shpija ndodhet objektivisht në rrethanat të veçanta, sinë Kosovë ; me rritjen e nivelit të kulturës gjuhësore rritej edhe niveli i përgjithshëm i kulturës.⁸³⁴

⁸³³ Joshua A. Fishman, *Language Modernization and Planning in Comparison with other Types of National Modernization and Planning*, në J.A.Fishman (ed), *Advances in Language Planning*. The Hague, 1974, f.89, cituar sipas Ljubiša Rajić, *Jezič i nacije u Skandinaviji*, në *Jezič i nacionalni odnosi*. Sveske, Institut za proučavanje nacionalnih odnosa, 5-6, 1984, f.113, Sarajevo.

⁸³⁴ U. Weinreich, *Languages in contact*, New York 1953 , f.99; Garvin – Mathiot, v.e.cit.f.371; shih po ashtu Bugarski, v.e.cit.

7.3. PËRDORIMI I SHQIPES STANDARDE NË SHKOLLA DHE INSTITUCIONE

Gjatë kohës sa shqiptarët e Kosovës kanë jetuar nën shtetin e quajtur Republikë Socialiste e Jugosllavisë (RSFJ), shqipja standarde funksiononte (flitej dhe shkruhej) nga më shumë se 2.000.000 shqiptarë, të cilët jetonin të përqendruar në një zonë mjaft kompakte në njësitë federale: KSA e Kosovës, RS e Serbisë (në komunat jashtë Krahinave: Preshevë, Bujanovc, Medvegjë dhe në Peshter), RS e Maqedonisë (në Maqedoninë perëndimore në komunat: Kumanovë, Shkup, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Dibër, Strugë, Ohër, Manastir, Resnje, Krushevë) dhe RS e Malit të Zi (në komunat Tivar, Ulqin, Titograd, Plavë). Kishte dhe shumë shqiptarë të tjerë jashtë këtyre zonave, si diasporë: në qendrat e mëdha në Beograd, në Zagreb, në Sarajevë, në Rijekë, në Lubjanë, e gjetiu: diaspora e Zarës (është në fazën e vdekjes gjuhësore) ku shqipja funksiononte vetëm si gjuhë e folur e shtëpisë, por asnjëherë nuk dihet saktësisht se sa ishte numri i këtyre shqiptarëve. Kur analizohet gjendja e atyre viteve, marrë parasysh numrin e folësve, shqipja në Jugosllavi zinte vendin e dytë pas serbokroatishtes. Pa marrë parasysh pozitën dhe statusin e rregullimit juridik, realitetet e atyre viteve ishin burim i së drejtës dhe nevojës për barazi. Gjuha shqipe në shkollë, në mjete të informimit, në punë, ligje e kudo u bë tipar thelbësor i identitetit kulturor dhe kombëtar, po edhe mjet komunikimi. Edhe mësimi në gjuhën amtare (shqipe) ishte garantuar si e “drejtë vetëqeverisëse”, e çdo qytetari.

Edhe para Kushtetutës së vitit 1974, edhe me kushtetutat e mëparme pas vitit 1945, shumë gjëra janë rregulluar njësoj në të gjitha zonat ku funksionon shqipja si gjuhë standarde: për shembull në shkollimin fillor dhe në disa elemente të tjera. Duke analizuar fushat e përdorimit: në shkolla dhe në institucionet e kulturës, në institucionet e shkencës, në punë, në administratë në organizatat shoqërore – politike, në rregullimin ligjor, në mjetet e komunikimit masiv – në gazeta, në radiotelevizion, në disqe, etj., në libra, në kinematografi dhe në ushtri, etj. Hetohet se një e drejtë e shkruar ishte siguruar. Në KSA të Kosovës, ishte rregulluar me Kushtetutën e saj, gjuhës shqipe i garantohet përdorimi i barabartë si gjuhë standarde me gjuhën serbokroate (dhe me turqishten në disa komuna) në rrafsh zyrtar. Kjo periudhë (1945-1990) shënon ngritjen e një rrjeti të fuqishëm shkollor në gjuhën shqipe, në nivel tetëvjeçar të obligueshëm për të gjithë me ligj, pastaj edhe në shkollimin e mesëm, i cili u intensifikua sidomos pas vitit 1966, kur u bë kthesë në orientimin e përgjithshëm në çështje të barazisë dhe të drejtave të kombësive, të shqiptarëve posaçërisht.⁸³⁵ Edhe në shkollimin e lartë para vitit 1966 gjuha shqipe përdorej vetëm në mësimet e gjuhës amtare. Ndërkaq, në vitet shtatëdhjeta Universiteti i Prishtinës u rrit me një rrjet të tërë fakultetesh dhe shkollash të larta me shumë degëzime. Mësimet në këto shkolla të larta dhe fakultete zhvilloheshin në gjuhën shqipe dhe në

⁸³⁵ Në KSAK në vitin shkollor 1983/84 kishte 933 shkolla me 336.073 nxënës dhe me 14.032 arsimtarë në të tri gjuhët. Në arsimin e mesëm të rregullt më 1983/84 vepronin 107 shkolla me 82.867 nxënës; ndryshimi në raport me vitin 1957/58 në arsimin e mesëm është shumë i madh: 39 shkolla, 7365 nxënës, me mësimet kryesisht në gjuhën serbokroate. Në gjuhën shqipe mësimin më 1983/84 e ndjekin 285.958 nxënës të shkollave fillore, ndërsa 65.776 nxënës të shkollave të mesme. Me tan ë këtë vit shkollor kanë punuar 11.163 arsimtarë të shkollave fillore dhe 3245 të shkollave të mesme . Në shkiollat e larta dhe në fakultetet e Kosovës më 1984/85 studionin 37.857 studentë; më 1960/61 studionin gjithsejt 1.542 studentë në 5 institucione të tilla. Më 1984/85 ishin 17 institucione të shkollimit të lartë. Në të gjitha këto institucione mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbokroate vetëm pas vitit 1967.

Më 1984 në KSAK kanë vepruar 11 organizata të pavarura kërkimore – shkencore dhe 14 të tjera që kanë vepruar në kuadër të organizatave të punës së bashkuar, prej të cilave shumica nëpër fakultete. Më 1984 në Kosovë kishte 107.973 pajtimtarë televizivë dhe 124.114 radiopajtimtar . Burimi: Vjetari statistikor I KSA të Kosovës 1985, Enti Krahinor i Statistikës , Prishtinë, 1985.

gjuhën serbokroate. Studentët, që më parë shkollimin e kishin marrë në gjuhën shqipe, kishin mundësi ta vazhdojnë edhe më tutje në këtë gjuhë. Është kjo një periudhë gjysëmshekullore kur janë krijuar shumë mjete mësimore dhe teknike në gjuhën shqipe. Gjendja në institucionet shkencore ishte ndryshe. Kishte një rrjet të pazhvilluar, gjë që detyronte studiuesi të përdornin gjuhët me qarkullim ndërkombëtar, po edhe serbokroatishten.

Në administratën e KSAK-së, gjuha shqipe është e barabartë me gjuhët e tjera të krahinës. Edhe në organizatat shoqëro-politike gjuha shqipe mund të përdorej në mënyrë të barabartë me serbokroatishten. Mjetet e informimit masiv, në KSAK gjuha shqipe ushtron funksionin e vet në një shkallë më të lartë. Përveç gazetës së përditshme “Rilindja”, me një tirazh rreth 50.000 ekzemplarësh botohej një numër jo i vogël gazetash dhe revistash të përkohshme me profile të ndryshme, nga informimi nëpër kolektiva, e deri te revistat shkencore e teknike. Edhe në radiogazetari dhe në mjetet e komunikimit televiziv shqipja sapo ka pushtuar hapësirë të gjerë përdorimi. Gjendja në botimin e librave dhe në botime të ndryshme në gjuhën shqipe në Kosovë kishte një përdorim shumë të gjerë, si në krijimet origjinale, ashtu edhe në përkthimet nga gjuhë të ndryshme të botimeve në fushë të kulturës, të shkencës e të jetës së përditëshme. Në shumë raste ndodh që pikërisht këtu të trajtohet, të formulohet, një mendim apo provë, një teori për herë të parë në gjuhën shqipe. Roli aktiv i përdorimit të shqipes në kulturën shqiptare në këto fusha është posaçërisht i rëndësishëm dhe reflektohej drejtpërdrejt në zhdukjen e analfabetizmit, përmirësimin e planeve dhe teksteve mësimore, në përmirësimin e të folmes së mësimdhënësve dhe nxënësve. Ndërkaq, në shërbimin ushtarak në RSFJ ekzistonte një rregullim unik i përdorimit të gjuhës, në përdorim zyrtar në komandim dhe në ushtrime ushtarake, për shkak të karakterit unik të armatës, përdoren variantet e serbokroatishtes, porse lejohet edhe përdorimi i gjuhëve të kombeve dhe të kombësive në rastet kur njësitë kanë përbërje të atillë që përdorimi i gjuhës së caktuar do ta lehtësonte komunikimin.

Gjendja më e varfër gjuhësore shënohej në kinematografi, ku shtëpia filmike “Kosovafilm” prodhimet në gjuhës shqipe i kishte simbolike (një film artistik në vit ose në dy vjet)! TV Prishtina përmbushte funksionin e vet për filmat që i shfaqte. Rrjeti i institucioneve të kulturës që e përdor shqipen standarde në Krahinë nuk është i vogël. Ishin sidomos të rëndësishme teatrot amatore, shoqëritë dhe grupet amatore, grupet e muzikës, nga popullorja e deri te roku, të cilat kanë masivitet. Kosova kishte dy teatro profesionale, të cilat kishin rëndësi të dorës së parë për kultivimin e fjalës së folur. Shumica e funksioneve të kulturës në gjuhën shqipe në RSFJ ishin të përqendruara në KSAK dhe në Prishtinë. Në Kosovë, si dhe në përgjithësi në RSFJ, gjatë viteve tetëdhjeta, mesatarisht popullata shqiptare ishte rreth 24 vjeç. Prandaj lufta kundër analfabetizmit ishte rezultati më pozitiv, megjithatë edhe më tej, deri në ditët e sotme mjaft të rinj analfabetë, sidomos femra e kjo ndikon edhe në nivelin e përvetësimit të gjuhës standarde dhe në ngritjen e nivelit të përdorimit të saj.

Tabela 46. Lëvizja e përqindjes së popullsisë analfabete të Kosovës sipas grup-moshave, sipas regjistrimeve të popullsisë 1948 – 1981

Viti	10-19 vjeç	20-34 vjeç	35-64 vjeç	65 e më tepër vjeç
1948	46.7	50.9	77.9	94.7
1953	31.2	46.0	77.0	92.6
1961	13.7	37.7	69.4	91.3
1971	11.0	16.5	56.7	87.3
1981	2.5	6.1	33.3	78.0

Tabela 45. Lëvizja e analfabetizmit të përgjithshëm dhe sipas gjinisë në Kosovë, sipas regjistrimeve të viteve 1921 – 1981

Viti	1921	1931	1948	1953	1961	1971	1981
Meshkuj	94.8	74.5	46.9	39.0	29.8	21.3	9.3
Femra	98.5	93.9	78.4	72.1	58.4	43.5	26.3
Gjithsejt	95.5	84.2	62.5	54.8	43.9	32.0	17.6

Gjendja e pafavorshme e shqiptarëve të tjerë jashtë Kosovës shënonte tendencën për të gjetur vend në bankat e shkollave në gjuhën shqipe në Kosovë. Pra gjendja në Mal të Zi (në RSMZ) në Maqedoni dhe në tri komunat e RS të Serbisë dhe jashtë Krahinave gjendja ishte jo aq e mirë.

Gjatë viteve 1945-1990 në RSFJ gjuha shqipe funksiononte si gjuhë standarde me status sociopolitik e zyrtar të ndryshëm nga mesi në mes dhe nga viti në vit. Si gjuhë e kombësisë ajo ishte shpallur e barabartë edhe me gjuhët e tjera andej nga flitet, kështu që do mohim i të drejtës për ta përdorur atë ishte cenim i barazisë. Me Kushtetutën e KSAK-së ajo ishte shpallur gjuhë zyrtare bashkë me serbokroatishten (dhe me turqishten në disa komuna). Në KSAK shqipja i realizonte funksionet e veta prej gjuhe standarde, edhe pse, e ndodhur në situatë ku ishte në raport me serbokroatishten në suaza federative dhe republikane, ajo detyrimisht i drejtohet nga funksioni kulturor si primar; ky funksionim është më pak i varur nga raporti ndaj gjuhëve të tjera. Vështuar nga kuadri i përcaktuar me Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974, mund të thuhet se shqipja radhitej në përgjithësi në statusin e gjuhës zyrtare krahinore, ndërsa brenda KSAK-së në statusin e gjuhës zyrtare bashkë me një tjetër gjuhë zyrtare. Kjo hapësirë e krijuar dhe kjo klimë me tone më të favorshme se gjithnjë gjatë pushtimeve në Kosovë, u shfrytëzua ndjeshëm pas vitit 1981 për ta pezulluar mundësinë e përdorimit të shqipes si gjuhë standarde zyrtare në segmente dhe në hapësira të ndryshme të RSFJ-së. Këto tendenca ishin veprimtari antikushtetuese politikisht të papranueshme dhe të motivuara nga një albanofobi e paparë!

7.3.1. Shkollat e hershme për përgatitjen e mësimdhënësve në Kosovë

Shkollat Normale(Darulmuallimîn) në Kosovë(1880-1912)

Përpyekjet për përgatitjen e mësimdhënësve janë të moçme, por objekt i trajtesës do të jetë periudha e fillimit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare e deri në ditët e sotme.⁸³⁶ Duke nisur nga fundi i shekullit XIX, me qëllim të reformave në arsindo të shënoheshin rezultate e para pozitive, ndonëse jo si ishte pritur e shpresuar.⁸³⁷ Kështu, me qëllim të përgatitjes dhe plotësimit të nevojave të zhvillimit dhe modernizimit të insitucioneve arsimore, u mbështet orientimi i arsimit jashtë medreseve në një shkallë shumë të gjerë.⁸³⁸ Nisja e reformave për sistemin shkollor në Perandorinë Osmane më 1848, paraqiti nevojën e domosdoshme për përgatitjen e mësuesve që do të jepnin mësim në këto shkolla, para se gjithash në shkollat e mesme të ulëta (rushdije). Prandaj, për këtë arsye, më 16 mars 1848 në Stamboll u hap një shkollë normale (darulmuallimin), shkolla e parë në Perandorinë Osmane, që përgatiste mësuesit e parë jashtë sistemit të medreseve.⁸³⁹

Këto shkolla normale të përgatishnin mësues vetëm për shkollat rushdije, hap i cili u vijua me përsheptimin e hapjes së shkollave rushidije. Hapja e shkollave laike shënonte një hap të madh në sistemin arsimor osman.⁸⁴⁰ Kështu pas reformimit të shkollave fillore klasike (meka□tib-i sibja□n) në shkolla fillore moderne (meka□tib-i-ibditadije), hapjes së shkollave të mesme të ulëta (meka□tib-i rüşdije) dhe pas hapjes së gjimnazeve (ida□dije),⁸⁴¹ u hapën edhe shkollat normale (da□rulmuallimi□n),⁸⁴² të cilat kishin për synim përgatitjen e mësuesve për shkollat fillore dhe për shkollat e mesme të ulëta. Shkollat normale në Kosovë i përmend J.Rexhepagiqi.⁸⁴³ Shkollat normale në Kosovë, me rolin, rëndësinë që patën në arsimin dhe edukimin e shqiptarëve dhe në përgatitjen e mësuesve, të cilët do të luanin rol të rëndësishëm, sidomos pas dëbimit të Perandorisë Osmane nga Kosova. Ata deri në gjysmën e dytë të shek XX ishin pjesa më e përgatitur për mësimdhënie. Mirëpo meqenëse përgatitja e mësuesve të ardhshëm u konsiderua si një çështje e domosdoshme dhe shumë domethënëse, kjo bëri që Rregullorja për Arsimin e Përgjithshëm viti 1869 të theksonte në veçanti rëndësinë dhe vendin e shkollave normale. Kohëzgjatja e studimeve për drejtimin për mësuesit të shkollave fillore, ishte paraprirë të zgjaste dy vjet kurse për mësues të shkollave rushidije dhe idadije ishte tri vjet. Më vonë edhe drejtimi për mësuesit e mektebeve zgjaste tre vjet.⁸⁴⁴ Në Prishtinë një shkollë e këtij formati nisi punën në vitin 1880. Pas vitit 1858 kur që hapur rushidija e parë e këtij lloji, si rrjedhim lindi nevoja e natyrshme për hapjen e shkollave normale për përgatitjen e mësuesve. Kusht për t'u regjistruar në këto shkolla për vijuesin ishte njohja e gjuhës arabe të dinte t'i lexonte dhe t'i kuptonte disa

⁸³⁶ Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacinalizmit shqiptar* (lindja e një kombi me shumicë muslimane ne Evropë), botime "Përpyekja", përktheu: Artan Puto,Tiranë, 2012, f.143.

⁸³⁷ Hasan Kaleshi; Hans Jürgen, *Vilajet i Prizerenit* , "Përparimi", nr. 3 Prishtinë, 1967, f.295.

⁸³⁸ Iber Ortaili, *Organizimi administrative gjatë periudhës së Tanzimatit*,në:Historia e shtetit,shoqërisë dhe qytetimit osman,vëll I,AIITC Tiranë,"Koha",2008,f.290.

⁸³⁹ Ekmeledin Ihsanglu,Insutcionet studimore-shkencore dhe arsimore osmane....po aty ,f.453.

⁸⁴⁰Noel Malcolm, *Kosova –një histori e shkurtër* ,Prishtinë –Tiranë,"Koha",2001,f.187.

⁸⁴¹ Ekmeledin Ihsanglu, *Insutcionet studimore-shkencore dhe arsimore osmane*, në :Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetimit osman,vëll.II AIITC,Tiranë,2009,f.450.

⁸⁴² Darulmuallimin (tur. "Darulmuallimin ,ar."Dar 'I-mu;al-limi□n,nga kompozita e gj.arabe "dar"- "shtëpi" dhe "mu'al-imin"- "mësues",d.m.th . "shtëpia e mësuesve ",pra shkollë normale.

⁸⁴³ Jasar Redzepagic, *Skoltvo i prosveta na kosovu od kraja XVIII stoleca do 1918 godine*, Pristina, 1974, f.26.

⁸⁴⁴ Ekmeledin Ihsanglu, *Insutcionet studimore-shkencore dhe arsimore osmane*....po aty ,f.454

tekste, si dhe në gjuhën persishte disa rregulla dhe, kandidati kërkohet të ishte me karakter të lartë.⁸⁴⁵ Në këto shkolla pranoheshin djemloshat nga mosha 15-20 vjeç, të cilët do të kishin ndjekur të paktën dy vjet të medresesë ose duke qenë nxënës në shkollë normale, të ishin njëkohësisht nxënës në ndonjë medrese. Pas kryerjes së vitit të tretë nxënësit jepnin provimin e pjekurisë para komisionit. Pas kryerjes së provimit nxënësi merrte të drejtën që të emërohej si mësues i parë në ndonjë mектеб të reformuar ose në mектебе klasike. Qeveria Osmane, në vitin 1880 hapi një shkollë normale në qendrën e Vilajetit të Kosovës në Prishtinë kurse dy dekada më vonë një shkollë e tillë u hap edhe në Prizren. Në Kosovë, nuk ka pasur shkolla normale me drejtimin për përgatitjen e mësuesve për shkollat rushidije (një drejtim të tillë pati shkolla normale e Shkupit), por vetëm për përgatitjen e mësuesve për metebe.

Shkolla Normale e Prishtinës e vitit 1880

Ka qenë hapur e para darulmaullimin e hapur në sanxhaqe në të gjithë Perandorinë Osmane. Studiuesi Rexhepagiqi, kur përmend këtë shkollë, thotë se që hapur, "në fillimin e shekullit XX " se ka punuar njëfarë kohe",⁸⁴⁶ besohet se kjo shkollë nuk do të ketë vepruar si e plotë". Sipas burimeve arkivore dëshmohet se shkolla normale e Prishtinës, e hapur në vitin 1880 me drejtimin për mësues të mектебеve, punoi si e plotë me lëndë dhe mësues të caktuar, me drejtor dhe staf të mësimeve. Gjithashtu kjo shkollë kishte vulën e saj të veçantë dhe se kishte punuar deri në vitin 1912 kur krisi Lufta e Parë Ballkanike dhe u mbyllën të gjitha shkollat moderne osmane. Në dosjet e nëpunësve të Bashkësisë Islame të Kosovës që ruhen në arkivin e këtij institucioni dokumentohet se ata, krahas shkollave rushidije ose medreseve, kishim mbaruar edhe shkollën normale të Prishtinës, të Prizrenit ose të Shkupit.

Shkolla Normale e Prizrenit e vitit 1901

Në fillim të shek XX sferës së arsimit me traditë në Prizren do t'i shtohet edhe një shkollë normale. Sipas akademik J.Rexhepagiqi, ajo kishte nisur të punonte, "disa kohë para vitit 1912". Sipas dëshmimeve arkivore shkolla normale e Prizrenit ishte hapur në vitin 1901 si e plotë për përgatitjen e mësuesve si mектебе e ngjashme me atë të Prishtinës. Ekzistimin e kësaj shkolle e pohojnë edhe dokumente si diploma e Mehmet Ramadanit, e lëshuar me datën 2 tetor 1904. Këtë shkollë e drejtonte Hfz.Ali Ahmeti nga Presheva, që ishte njëkohsisht arsimtari i parë.

Shkolla Normale/Darulmuallimin e Shkupit

Pasi edhe Shkupi (pas vitit 1888 u bë kryeqendër) në kohën e veprimtarisë së këtyre shkollave ishte pjesë e vilajetit të Kosovës po përmendim shkollën normale të Shkupit, sepse ajo ka patur një rol të rëndësishëm për shkollimin e shqiptarëve, edhe nga Kosova. Normalja e Shkupit që themeluar në vitin 1882.⁸⁴⁷ Në këtë shkollë mësoheshin edhe filozofia e logjika,

⁸⁴⁵ DHajrudin Ćurić Muslimansko školstvo ..., vep citf.159

⁸⁴⁶ Jasar Redzëpagic, Skolstvo i prosveta na Kosovu od kraja XVIII Stoleca do 1918 godine Prishtina, 1974. f.26.

⁸⁴⁷ Basbakalik Omsanli Arsivi 79.75 MF MKT ; necati Demir ,Education in Kosovo ..., vep cit f11. Dr.Jasar Redzëpagic nuk e saktëson as vitin e fillimit të kësaj shkolle .Ai thotë ; ‘ ‘ është hapur nga fundi I shek XIX ‘ ‘ (Shih: Jasar Redzëpagic Skolstvo i prosveta na Kosovu..., vep cit ..., f.38.)

sigurisht krahas lëndëve të tjera që ishin: historia, metodologjia e mësimdhënies gjeografia, njohuri natyre, matematika, turqishtja, arabishtja, frëngjishtja, persishtja gramatika punëdore, vizatim, këngë dhe gjeometria.⁸⁴⁸ Në normalen e Shkupit kanë mbajtur mësim në gjuhën shqipe Salih Gjuka Dukagjini, Niman Ferizi, Ahmet Gashi, Bedri Pejani etj...⁸⁴⁹ Ndikimi i nxënësve, mësuesve dhe pedagogëve të kësaj shkolle në arsimimin kombëtar të shqiptarëve të Kosovës, ka qenë me ndikim të madh. Nga Shkupi, patriotët shqiptarë kanë drejtuar përpjekjet për futjen e gjuhës shqipe në shkollat e vilajetit të Kosovë dhe jo vetëm si lëndë por edhe si gjuhë mësimi. Kjo shkollë u shndërrua në qendër të përhapjes së shkrimit dhe gjuhës shqipe. Atdhetarët Salih Gjuka, Bedri Pejani etj.⁸⁵⁰ Në këtë shkollë shpërndanë idetë patriotike për vijuesit, mësuesit e ardhshëm (pas dëbimit të Perandorisë Osmane), të cilët dhanë ndihmesën e tyre në mungesë kuadrosh arsimor në Kosovë, si: Ahmet Gashi, Niman Ferizi, Sadi Morina, Ibrahim Koliqi, Isuf Puka, Avni Zajmi, Januz Blakori, Minush, Ferid Imami, Ferid Bajrami, baba Qazim Bakalli, Ibrahim Fehmiu etj. Shkollat normale në Vilajetin e Kosovës i kontribuan qëllimit duke nxjerrë disa dhjetra kandidatë, jo vetëm me diploma por me dije për të shërbyer si mësues nëpër mektebe, deri më 1912, edhe në mes dy luftërave botërore, deri në vitet '50 të shekullit të kaluar në shkolla laike. Shumica prej tyre qenë emëruar edhe mësues në shkollat fillore kombëtare, andaj atyre u takon një vend meritore në historinë e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar.

Shkolla Normale “Sami Frashëri” në Prishtinë

Ndër shkollat Normale që kishte një mision dhe një rëndësi të veçantë në Kosovë, të ngjashëm me Normalën e Elbasanit për Shqipërinë ishte Shkolla Normale-Liceale “Sami Frashëri” në Prishtinë. Kalvari nëpër të cilin kapërceu Kosova dhe rrethanat specifike e të jashtëzakonshme, për shqiptarët e kësaj treve përherë të trazuar e shton peshën e kësaj shkolle pedagogjike. Pas një blic shkollimi në gjuhën shqipe të viteve 1916-1918 në trevën e Kosovës deri në Luftën e Dytë Botërore për shqiptarët e viseve të okupuara nga Serbia e Mali i Zi në vitin 1912, të cilat mbetën jashtë shtetit shqiptar që u formua në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913, solli ndalimin e përdorimit të gjuhës shqipe, tmerr, shpërngulje, shtypje, dhunë, tortura e vrasje dhe përpjekje për asimilim. Ndërsa LDB mund të thuhet se në krahasim me pozitën që ishin nën okupimin e egër serb, ishte një liri për shqiptarët e Kosovës.

Pas vitit 1941, në Kosovë dhe viset tjera shqiptare u hapën shumë shkolla fillore, kurse në qendrat e prefekturave u hapën shkolla të mesme: gjimnaze, normale dhe shkolla profesionale të drejtimeve të ndryshme. Një nga shkollat më të rëndësishme që u hapën në “Visete Liruese” ishte Shkolla Normale-Liceale e Prishtinës, e cila mbante emrin e dijetarit të madh të Rilindjes, Sami Frashërit. Për hapjen e Shkollës Normale në Prishtinë, ishte kujdesur vetë Ministri i Arsimit prof. Ernest Koliqi.⁸⁵¹ Ministri ishte mirë në dijeni se kjo pjesë e Shqipërisë Etnike kishte

⁸⁴⁸ Arkivi i Kosovës Prishtinës; Fondi i Muarrem Krasniqit, kutia nr 1, dokumenti; diploma e Sherif ef, Dauti; Arkivi i Kosovës, Fondi i Ibrahim Koliqit, dok diploma e Darmuallimin të Shkupit; Dr, Jasar Redzepagic, Skolstvo i prosveta na Kosova ..., vep cit f.38.

⁸⁴⁹ Hajrullah Koliqi, *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, Prishtinë, 2002, f.143.

⁸⁵⁰ Shih Salih Gjuka Dukagjini, *Shkrolaria e Shqypes pjesa e parë: teorike dhe praktike* u botua nën kujdesin e Muhamet Pirrakut, botoi Kryesia e Bashksisë Islame të Kosovës, Prishtinës 1991.

⁸⁵¹ Shkolla Normale “Sami Frashëri” në Prishtinë u themelua me dekretin e lëshuar nga ministri i Arsimit në Qeverinë Shqiptare prof. Ernest Koliqi më 12 nëntor 1941, kurse punën e ka filluar më 17 dhjetor 1941. (Kjo shkollë ka një traditë të pasur. Gjimnazi "Sami Frashëri" është një ndër shkollat më të vjetra në Kosovë dhe në Prishtinë që sot e mban emrin e rilindësit tonë të njohur Sami Frashëri. Edhe pse kjo shkollë nuk e ka mbajtur këtë

mungesë të madhe të mësuesve, kishte vendosur që për popullsinë e kësaj pjese të Shqipërisë ta hapte një shkollë, e cila ishte ekuivalente me Normalen e Elbasanit. Edhe plan programet, edhe kohëzgjatja e saj do të ishte pothuaj identike me Normalen e Elbasanit. Por, ai ishte kujdesur edhe për kuadrin arsimor. Kështu drejtor të parë e kishte emëruar prof.dr.Rexhep Krasniqin, kurse pas tij do të emërohej prof. Ahmet Gashi. Shkolla kishte edhe konvikt, ku drejtor i konviktit ishte emëruar prof.Vasil Andoni një nga pedagogët më të mirë që e kishte Elbasani dhe Shqipëria.

Për katër vite të punës së kësaj shkolle 1941-1944 në këtë institucion që përgatiste mësues kanë punuar mbi 70 profesorë, të gjithë të shkolluar në qendrat e ndryshme universitare të Italisë, Francës, Austrisë e vendeve tjera evropiane. Shkolla Normale e Prishtinës i kishte dy degë, dega Normale dhe ajo Liceale. Në degën e Normales për nxënësit mësimi zgjaste tetë vjet, (katër vjet përgatitore e katra Normale). Në kuadër të Normales ishte hapur edhe Kursi pedagogjik, i cili zgjaste tre muaj. Pasi i mbaronte dy kurse, kandidati konsiderohej mësues i kualifikuar. Këta mësues të mëpastajëm i kishin falas tekstet shkollore, fletoret, lapsat dhe uniformën, e cila ishte një për dimër dhe tjetra për verë. Në shkollën Normale-Liceale të Prishtinës kishte nxënës nga të gjitha trojet etnike.

Shkolla Normale e Gjakovës “Gjon Kazazi” 1942-1944

Sipas Vendimit të Ministrit të Arsimit E.Koliqi, në Gjakovë do të hapej një shkollë teknike-tregtare, e quajtur Instituti Teknik Tregtar. Por, meqë nevoja për mësues ishte shumë e madhe, në kuadër të kësaj shkolle do të hapen edhe disa klasa normale, prandaj edhe shkolla e ndërroi emrin në Institut tregtar-Normal. Mirëpo sipas kërkesave të popullit të Gjakovës,⁸⁵² që kjo shkollë të bëhet shkollë Normale, duke filluar nga 9 nëntori 1942. Shkolla punonte me plan-programet që punonin shkollat tjera normale në Shqipëri. Në vitin e parë shkollor kishte regjistruar 100 nxënës, kurse në vitet e tjera ky numër do të ndryshojë sipas rrethanave të kohës. Shkollën do ta përcjellin probleme të mëdha, sepse shkolla punonte në kushte lufte dhe kjo situatë ishte evidente gjithkund në vend.

Drejtor i shkollës ishte intelektual i atdhetari i madh Zekrija Rexha, i cili do të shkarkohet e do të kthehet në detyrë disa herë për shkak të veprimtarisë së tij politike. Sa i përket numrit të mësimeve kjo shkollë kishte shumë vështirësi. Aty punonin: Zekrija Rexha, drejtor dhe mësime Demush Gjakova, Qamil Hoxha, Haki Taha, Sadi Pejani, Zef Fort Nekaj, Rifat Spahiu, Shyqëri Hafizi etj. Mungesa e kuadrit arsimor shpesh e kishte detyrur shkollën ta reduktonte edhe numrin e nxënësve.

emër në periudha të ndryshme, identifikohet si Gjinnazi “Sami Frashëri” sepse me këtë emër kjo shkollë ka marrë fuzionimin e një institucioni me karakter të vërtetë të arsimit kombëtar dhe edukativo-kulturor dhe për arsye se këtë emër e mban edhe sot.Historiku i saj fillon me emërtimet :Gjinnazi turk (Para vitit 1913), Gjinnazi i Prishtinës në periudhën e sundimit serb 1913-1941, Gjinnazi “Sami Frashëri“ 1941-1945 (Shkolla Normale-Dega Liceale),Gjinnazi real shqiptar dhe gjinnazi real serb 1945- 1955 deri te Gjinnazi i përzier “Ivo Lllolla Ribar” 1955/56-1989/90 dhe sw fundi ky i tanishmi Gjinnazi “Sami Frashëri” 1989/90-1999 dhe Gjinnazi “Sami Frashëri” 1999-2015.

852Qeveria nxori Dekretin Mekambësues plotësues nr. 273/23 të datës 23.10.1942, sipas të cilit ky Institut Tregtar u bë Shkollë Normale me emrin “Gjon Kazazi”.

Shkolla Normale e Gjakovës 1946-1953

Në nëntor të vitit 1944 Kosova u çlirua nga fashizmi dhe u riokupua nga Jugosllavia Socialiste. Lufta e shqiptarëve për bashkimin kombëtar, pas fitores së komunizmit në Jugosllavi dhe Shqipëri, u “harrua”! Pushteti komunist në të dy anët e kufirit të imponuar më gjithë fuqi propagandonin “internacionalizmin proletar”, ku të gjithë njerëzit pa dallim kombësie a feje do të jenë të barabartë. Por, gjithë kësaj i doli boja pas Vendimeve të Konferencës së Bujanit, kur dhunshëm u rianeksua Kosova dhe trojet tjera enike. Në këto rrethana, kur gjaku i shqiptarëve shkonte rrëke, komunistët jugosllavë, për të dëshmuar “internacionalizmin” e”, lejuan hapjen e shkollave fillore në Kosovë dhe pesë gjimnazeve, (tri gjimnaze ishin të plotë dhe të përzier shqiptarë e serbë (Në Prishtinë, Pejë dhe Prizren), në Mitrovicë një gjimnaz i ulët serb dhe në Gjakovë një gjimnaz i ulët shqiptar. Përveç gjimnazeve ishin hapur edhe 8 shkolla profesionale. Ja faktet për përmasat e “barazisë” komuniste: Në Kosovë në vitin 1946 kishte vetëm 336 mësues shqiptarë, kurse serb dhe malazez ishin 337, në një kohë që shqiptarët përbënin 80% të popullsisë së Kosovës. Në këtë përqindje të popullsisë ishin vetëm 196 shkolla fillore shqipe, kundrejt 184 shkollave serbe.⁸⁵³

Në vitin 1945 në Prishtinë kishte filluar punën shkolla normale serbe, kurse nuk kishte asnjë shkollë profesionale për mësues shqiptar. Në këto rrethana të nevojës së domosdoshme për mësues shqiptarë, hapet Shkolla Normale e Gjakovës, e cila ishte e një rëndësie të madhe për arsimin në gjuhën shqipe në Kosovë. Drejtor i kësaj shkolle u emërua veterani i arsimit shqip Beqir Kastrati.

Më vonë do të rritet numri i mësimit në këtë shkollë. Në vitin e parë shkollor u regjistruan 55 nxënës, shumica nga Gjakova, Peja dhe Prizreni, por kishte edhe të viseve tjera. Nxënësit e kësaj gjenerate do të diplomojnë pas dy vjetësh, më 1948. Pas këtij viti Normalja bëhet katër vjeçare. Disa nga nxënësit më të zgjuar emëroheshin mësues ende pa e mbaruar Normalen, sepse nevoja për hapjen e shkollave ishte e madhe. Në vitin shkollor 1952 / 53 kjo shkollë i kishte 278 nxënës. Shkolla e kishte edhe konviktin për nxënësit që ishin jashtë Gjakovës. Shkolla Normale përveç këtyre në Gjakovë dhe Prishtinë do të hapën edhe në shumë qytete më të mëdha të Kosovës, pastaj edhe në disa qendra më të vogla, por rolin dhe rëndësinë që e ka pasur Normalja e Prishtinës, trashëgimtare e asaj të Gjakovës, nuk do ta ketë asnjë shkollë e rangut të tillë.

Shkolla Normale e Prishtinës 1953 – 1974-themeli i Universitetit të Kosovës

Në vitin shkollor 1953 / 54, Normalja e Gjakovës transferohet në Prishtinë. Vendimin për këtë transferim e kishte marrë Këshilli Krahinor për Arsim. Në shkollën e re të ndërtuar enkas për Shkollë Normale, mendohej të ndërtohej edhe një shkollë ushtrimore, do të transferohen nxënësit e klasave vijuese dhe shumica e mësimit në Prishtinë. Në klasën e parë në vitin shkollor 1953 /54 regjistrohen 172 nxënës, kurse gjithsejt në këtë vit shkollor në Normalen e Prishtinës ishin të regjistruar 339 nxënës.

Shkolla kishte dhe Internatin (konviktin) ku ishin vendosur shumica e normalistëve. Aty kishte rregulla të caktuara të sjelljes dhe të mësimit plotësues të obliguar që ishte shumë i dobishëm për nxënësit. Në shkollë zhvilloheshin një varg aktiviteteve kulturore dhe sportive. Në

⁸⁵³Hamdi Thaç; Shaban Pllana, Monografi -Gjeneratës së maturanëve të vitit 1970/71 (Shkolla Normale e Prishtinës), Prishtinë, 2011.

vitin shkollor 1954 / 55, Normalja i kishte 445 nxënës në të gjitha klasat. Në vitin 1955 / 56 në Normalen e Prishtinës do të ketë 331 nxënës, në vitin shkollor 1956 /57 416 nxënës, 1957 /58 ky numër do të rritet në 510 nxënës. Në këtë vit, për herë të parë shkolla Normale shqipe shndërrohet në shkollë “mikste”, e përzier në aspektin nacional. Në vitin vijues 1958 /59 Normalja do të jetë pesë vjeçare, kurse numri i nxënësve do të rritet në 830, ku numri i nxënësve serbë ishte në disproporcion me numrin e popullsisë në vend. Kjo tendencë e rritjes së nxënësve serbë në këtë shkollë do të vazhdojë deri në vitin 1966. Nga viti 1966 / 67 numri i nxënësve shqiptar do të rritet dhe kjo rritje do të vazhdojë deri në përfundim të kësaj shkolle në vitin 1974. Normalja e Prishtinës ishte bërë qendër e rëndësishme kulturore. Nga kjo shkollë po dilnin mësues që po e stolisin anë e mbanë Kosovën dhe viset tjera shqiptare në Jugosllavi me punën e tyre të zellshme në arsimin e popullit shqiptar.

Trupi arsimor i mbledhur në këtë shkollë ishte ajka e intelegjencisë shqiptare, prandaj ata mësues që e mbaronin këtë shkollë dilnin të përgatitur në aspektin profesional dhe të formuar drejt në aspektin pedagogjik por edhe kombëtar. Kjo vetëdije e lartë e kultivuar në këtë vatër diturie do të reflektohet të rinia shqiptare, e cila pas vitit 1981, nuk do të bindet më zgjedhjen e robërisë, por do të fillojë kundërshtimin e robërisë, e cila nuk do të ndalet deri në pavarësinë e Kosovës.

Numri i mësimit në këtë shkollë është i madh dhe janë emra të dalluar në shkencë, në lëmi të ndryshme. Do të veçonim Tajar Hatipin, Jashar Rexhepagiqin, Fehmi Aganin, Ali Hadrin, Pajazit Nushin, Zeqir Bajrami e shumë të tjerë. Gjeneratat e pas viteve 1966/67 i takojnë epokës së një frymëmarrje të re. Pas ndryshimeve politike në kreun e shtetit u rrit edhe vetëdija kombëtare. Këto gjenerata patën fatin që të jetë përjetuese e zgjimit kombëtar që kishte filluar pas Plenumit të Brionëve në ish Jugosllavi.

Në vitin 1968 vijnë një varg veprimesh atdhetare, si shënohet 500 vjetori i vdekjes së kryetrimt Skënderbe, mbahet Konsulta gjuhësore, shpërthejnë demonstratat e rinisë së vitit 1968, lejimi i përdorimit të Flamurit kombëtar, hapja e Universitetit të Prishtinës, etj. Në historinë e kësaj shkolle janë këto gjenerata mësuesish të ardhshëm më të privilegjuar në aspektin politik. Regjistrimi i nxënësve (mësuesve të ardhshëm) bëhej me kritere të përcaktuara që respektoheshin. Të interesuarit detyroheshin të hynin në provimin pranues (kishte mbikqyrje rigoroze të fizikut të nxënësve, veshi për ritëm e muzikë, shqiptimi i drejtë gjuhësor, si dhe provim nga matematika e gjuha shqipe) në një konkurrencë shumë të fortë, 6 paralele shqiptare dhe pesë serbe. Shkolla Normale e Prishtinës ishte halë në sy për pushtetin jugosllav, por ajo e çau rrugën e saj duke zhdukur analfabetizmin në Kosovë dhe viset tjera shqiptare në Jugosllavi.

Në këtë shkollë dominonin lëndët pedagogjike, psikologjike, didaktikë dhe shtatë metodika (Metodika e gjuhës shqipe, Matematikës, Dituri Natyre, Bazave të arsimit teknik, Artit figurative, Edukatës fizike, Edukatës muzikore), por një rol të rëndësishëm kishte edhe mësimi i lëndës së Gjuhës dhe letërsisë shqipe. Të këtij formati dhe pothuaj të kësaj rëndësie ishin edhe Shkolla Normale e Gjilanit, Mitrovicës, Pejës, Gjakovës, Ferizajit dhe Prizrenit gjatë viteve 1950-1975.

7.4. ROLI I SHTYPIT PEDAGOGJIK NË KOSOVË PËR MËSIMIN E GJUHËS SHQIPE

Periodiku pedagogjik (gazetat dhe revistat pedagogjike) dhe literatura tjetër pedagogjike, në periudha kohore të ndryshme, në rrethana të mungesës së ndjeshme të botimeve të veçanta (mungesa e didaktikave, metodikave, etj.), në Kosovë ka dhënë ndihmesë konkrete mësimdhënësve të gjuhës. Në udhëkryqet e ndryshimeve të mëdha të arsimit në gjuhën shqipe në Kosovë dhe të ndryshimeve shumë të mëdha sistemore është ndjerë edhe mungesa e literaturës pedagogjik-didaktike. Shteti shqiptar ishte një rreze drite për shqiptarët e mbetur nën administrimin jugosllav pas Luftës së Dytë Botërore, për të sjellur arritjet e didaktikës kombëtare të gjuhës shqipe dhe për të ikur nga ndikimet e frymës sllave. Në rrethana të këtilla, vështirë që kapërcenin kërkimet shkencore të Shqipërisë, kështu ndjehej mungesa e literaturës didaktike dhe mungesa e shtypit dhe periodikut pedagogjik në gjuhën shqipe. Mirëpo në gjysëmshekullin e dytë të shek. XX përpjekja e didaktëve të pakët dhe e mësimdhënësve të gjuhës shqipe në këtë trevë ishte e orientuar që:

- *Të gjenin alternativën e plotësimit të mungesës së madhe për tekstet bazë origjinale shqipe, të metodikave të lëndëve të ndryshme mësimore e për shkallë të ndryshme të shkollimit;*
- *T'i kundërvehej koncepcioneve të vjetëruara të teksteve të metodikave të lëndës së gjuhës shqipe të hartuara nga autorë të vendeve e të gjuhëve tjera, anipse të përshtatura për mësimin shqip.*
- *Të barten idetë dhe mendimi bashkëkohor botëror i metodikës ndër punonjës të arsimit e të shkollës shqipe;*
- *Të nxitet e të përparohet puna kërkimore e publicistike në gjuhën shqipe nga fusha të ndryshme të metodikës e të praktikës shkollore. (Mbase, ishte e nevojshme të bëhej pikërisht në fushën e metodikës e të praktikës shkollore të mësimin të gjuhës amtare shqipe)⁸⁵⁴*

Përmes punimeve nga periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe, mësimdhënësit e gjuhës shqipe të Kosovës eksploronin të gjenin metodologji për përpunimin më të avancuar e më të suksesshme të çështjeve nga metodika dhe praktika shkollore. Për shkak të natyrës specifike të mësimin të gjuhës amtare me vështirësi pranohej “transplantimi” i përvojave të shkollës kroat e serbe. Mësimdhënësit kishin interesim për qasje dhe zgjidhje origjinale të çështjeve nga organizimi i mësimin të gjuhës amtare. Periodiku pedagogjik ishte bërë një tribunë e problemeve arsimore të vendit. Ky shtyp (edhe pse i pakët), angazhohej për një gjuhë të pastër letrare, një ndihmës metodologjike për hartimin, përpilimin dhe vlerësimin e teksteve shkollore, duke u shndërruar në një dritare për kultivimin e shëndetshëm të mendimit krijues shkencor-pedagogjik dhe didaktiko-metodik në gjuhën shqipe në Kosovë.

Në këtë trajtesë po bëjmë një vështrim retrospektiv rrugës së zhvillimit të periodikut pedagogjik në gjuhën shqipe në Kosovë midis viteve 1945- 2015. Duke u fokusuar në këtë fushë, vihet re rëndësia që pati periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe, për plotësimin ose zbutjen e mungesës tepër të madhe që ndihej për tekstet bazë dhe ndihmesat metodike origjinale për mësimin e gjuhës amtare shqipe. Nëse, zhvillimi i përgjithshëm shkencor edhe ai pedagogjik i Kosovës matet me numrin e cilësinë e gazetave dhe të revistave pedagogjike që botoheshin vihet

⁸⁵⁴ Islam Krasniqi, *Ndihmesa e periodikut pedagogjik në gjuhën shqipe*(midis viteve 1945-1978/) Zhvillimit të mendimit metodik dhe të praktikës shkollore të mësimin të gjuhës amtare shqipe, Prishtinë, nëntor, 2002.

re varfëria jonë në këtë rrafsh. Për dallim nga Shqipëria,⁸⁵⁵ në Kosovë nga gazetat dhe revistat pedagogjike, vlen të përmenden: “Buletini”, të cilin atëherë e botonte Enti i Përparimit të Shkollave i Krahinës Autonome të Kosovës, “Përparimi”, “Libri shkollor”, “Shkëndija”, “Për prindërit”, “Pedagogu” dhe revista pedagogjike “Mësuesi i Kosovës”. Mungesa e këtyre botimeve në Kosovë kompensohej sadopak edhe nga botimi i punimeve dhe librave pedagogjike (të pamjaftueshëm) që pjesërisht, plotësonin mungesën e literaturës pedagogjike në gjuhën shqipe. Për dallim nga Shqipëria, në Kosovë, dalloheshin në këtë fushë, punimet e akademik Jashar Rexhepagiqit⁸⁵⁶ dhe pedagogëve të tjerë të mëvonshëm. Përpyekjet, ndonëse shumë të vonuara, në këtë fushë, nisën me revistën “Përparimi”⁸⁵⁷ dhe gazetës “Shkëndija”.⁸⁵⁸ Varfëria e botimeve pedagogjike, psikologjike e metodike për lëndën e gjuhës shqipe kompensohej me botimet e këtij lloji, në publicistikën shkencore pedagogjike, në gjuhë të popujve të tjerë në ish Jugosllavi, që ishte më e pasur. Ishin botuar studime monografike, e ishin hartuar bibliografi të punimeve nga gazetat dhe revistat pedagogjike në Jugosllavinë socialiste (disa nga to ishin përkthyer shqip), në këtë fushë, sidomos studimet monografike të Perushkos⁸⁵⁹ të Vukoviqit,⁸⁶⁰ të Teshiqit⁸⁶¹ të Paravinës⁸⁶² dhe disa të tjerëve. Duke bërë një analizë dhe vlerësim, të shumicës së gjithë artikujve dhe punimeve pedagogjike të botuara në gazetat dhe revistat pedagogjike në gjuhën shqipe në Kosovë. Në Kosovë dukshëm është ndjerë mungesa e botimeve të këtij lloji në gjuhën shqipe, këtë e pohojnë edhe mësimitdhënësit e të gjitha gjeneratave të ndryshme gjatë intervistave në terren. Ndihtmesën e përgjithshme që i kishte dhënë periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe zhvillimit të teorisë dhe të praktikës së mësimit të gjuhës shqipe në Kosovë e kishte dhënë redaksia, e revistës “Përparimi”,⁸⁶³ Prishtinë, Këshilli redaktues i revistës “Buletini” i Entit për Përparimin e Shkollave i KAKM-së, Prishtinë, Redaksia, “Shkëndija”⁸⁶⁴ tribunë e arsimit, Prishtinë, redaksia e periodikut, “Libri shkollor”⁸⁶⁵, Prishtinë, dhe revista pedagogjike “Mësuesi i Kosovës”, Prishtinë.⁸⁶⁶ Në këto revista vihet re një pasqyrim i qartë shtrirjes së punimeve të botuara nëpër fusha të ndryshme të Metodikës e të praktikës shkollore të mësimit të gjuhës shqipe.

⁸⁵⁵ Nga i gjithë shtypi pedagogjik që ishte botuar në Shqipëri, nga viti 1945, dallohen këto gazeta dhe revista pedagogjike: “Shkolla e re”, “Arsimi”, “Arsimi dhe kultura popullore”, “Ndihtmes’ imwsuesit”, “Ndihtmws’ imwsuesit” për shkollën fillore, “Ndihtmws’ i mwsuesit” për shkollën fillore me klasa kolektive, “Mwsuesit” dhe “Revista pedagogjike”.

⁸⁵⁶ Redzëpagic dr. Jasar, “Përparimi”- casopis za kultuma pitanja, “Pedagoski rad”, Zagreb, 1958, nr. 1-2, fq. 74-76 dhe; Rexhepagiq dr. Jashar, Revistat dhe gazetat pedagogjike te ne, Tema të zgjedhura pedagogjike, Shkup, 1972, fq.101-118.

⁸⁵⁷ Shih, Krasniqi Islam, Analiza pedagogskih radova objavljenih u “Përparimi” od 1946-1972/ Punim i magjistraturës, i mbrojtur në Fakultetin Filozofik të Universitetit në Zagreb, më 1975. Pjesërisht është botuar në: “Buletini” i Fakultetit Filozofik në Prishtinë, 1980, nr. XIV, fq. 249-275 dhe, nr. XV, fq. 285-297.

⁸⁵⁸ Shih, Krasniqi mr. Islam, Në frymën e mendimit pedagogjik progresiv, bibliografi e punimeve pedagogjike të botuara në “SHKËNDIJA” midis viteve 1971-1981, “Shkëndija”, Prishtinë, 1981, nr. 5, fq.9-12

⁸⁵⁹ Shih, Perusko Tone, Pet godina “Skolske novina”, bibliografija, Zagreb, 1955

⁸⁶⁰ Shih, Vukovic Rade, Dvadesetpet godina “Savremene škole” -“Pedagogogue”, bibliografija / 1946-1970/, Beograd,1971

⁸⁶¹ Shih, Tesic M. Vladeta, “Nastava i vaspitanje”, bibliografija /1952- 1965/, Beograd, 1966

⁸⁶² Shih, Paravina Emil, bibliografija - 30-godista casopisa “Pedagoski rad”(1946-1975)Zagreb, 1976.

⁸⁶³ Numri i parë(1) me 241 faqe, doli nga botimi në majin maj të vitit 1946. Pas ndërprerjes çfarë i ndodhi më 1948, nisi nga botimi rishtazi gjatë muajve maj-qershor të vitit 1955.

⁸⁶⁴ Numri i parë(1) nisi të botohej, më 15 mars të vitit 1971

⁸⁶⁵ Numëri parë(1) doli nga botimi në dhjetor të vitit 1971.

⁸⁶⁶ Numri i parë (1) filloi të botohet nga qershori i vitit 2011.

Në mbështetje të kriterëve të përmendur, të gjithë artikujt dhe punimet që ishin botuar në periodikun pedagogjik në gjuhën shqipe, midis viteve 1945-2015, nga metodika dhe praktika shkollore e mësimit të gjuhës shqipe, janë trajtuar sipas këtyre lëmenjve: Çështjet e përgjithshme të metodikës e të praktikës shkollorë dhe Çështje të metodikës dhe të praktikës shkollore të mësimit të gjuhës shqipe dhe letërsisë. Ndërkaq, në një vështrim më detaj, mund të konkludohet se shtypi e periodiku pedagogjik i Kosovës, mund të bëhet ndarje e punimeve përbrenda këtyre lëmenjve të metodikës e të praktikës shkollore të mësimit të gjuhës amtare shqipe e të letërsisë, jo vetëm në bazë të emërtimeve të titulljve, por kryesisht në vështrim të përmbajtjes që trajtojnë këto punime, artikuj e studime. (në periodikun pedagogjik në gjuhën shqipe midis viteve 1945-2015), në çështje:

Çështje të metodikës dhe të praktikës shkollore të mësimit të gjuhës shqipe e të letërsisë;
Çështjet e metodikës e të praktikës shkollore të mësimit të leximit dhe të shkrimit fillestar;
Çështje të metodikës e të praktikës shkollore të zhvillimit të kulturës së të folurit;
Çështje të metodikës e të praktikës shkollore të ushtrimeve të shkrimit dhe hartimeve;
Çështje të metodikës dhe praktikës shkollore të mësimit të gramatikes e të drejtshkrimit;
Çështje të metodikës dhe të praktikës shkollore të mësimit të leximit artistik e të letërsisë ;
*Çështje të metodikës e të praktikës shkollore të punës me lektyrën shkollore*⁸⁶⁷

Artikujt dhe punimet që kanë pasur për temë shqyrtimi çështje më të përgjithshme të metodikës dhe të praktikës shkollore të mësimit të gjuhës amtare shqipe dhe të letërsisë e kanë ndikuar në përparimin e përgjithshëm të teorisë dhe të praktikës mësimore nëpër lëminjë të mësimit të gjuhës shqipe si lëndë mësimi në Kosovë kishin trajtuar:

- Çështje të përgjithshme nga organizimi më cilësor i mësimit të gjuhës shqipe e të letërsisë;
- Planifikimi i punës mësimore të gjuhës amtare dhe të letërsisë;
- Çështje nga metodologjia e përpilimit, e vlerësimit dhe e punës me tekste në mësimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë;
- Disa shkaqe të ngecjes e të mospësuksit të nxënësve në mësimin e gjuhës shqipe dhe të letërsisë;
- Një numër më i vogël i punimeve nga kjo fushë i është kushtuar edhe vlerës së përgjithshme çfarë ka mësimi i gjuhës amtare shqipe dhe i letërsisë;
- Çështjeve nga arsimit dhe ngritja metodike e arsimtarëve të gjuhës shqipe dhe të letërsisë;
- Sigurimit dhe shfrytëzimit efektiv i mjeteve në mësimin e gjuhës shqipe e të letërsisë;
- Punës së pavarur të nxënësve në mësimin e gjuhës shqipe e të letërsisë dhe
- Çështjeve nga kontrolli dhe vlerësimi cilësor i diturive, shkathtësive e shprehive në mësimin e gjuhës amtare shqipe dhe të letërsisë.
- Nga një punim i kësaj natyre i është kushtuar: strukturimit të orës së mësimit të gjuhës amtare e të letërsisë, përsëritjes së mësimit të gjuhës amtare e të letërsisë, detyrave të shtëpisë dhe korrelacionit midis përmbajtjeve mësimore nga gjuha amtare shqipe e letërsia me përmbajtjet e lëndëve tjera mësimore në klasat dhe nivelet e ndryshme të shkollimit.

Mesazhi i didaktëve për mësimdhënësit ishte se “Gjuha, është shenjë e ekzistimit dhe kusht i afirmimit të qenies kombëtare. Përmes gjuhës...dhe vetëm mbi gjuhën, mbahet kombësia.

⁸⁶⁷Islam Krasniqi, *Ndihmesa e periodikut pedagogjik në gjuhën shqipe* (midis viteve 1945-1978) Zhvillimit të mendimit metodik dhe të praktikës shkollore të mësimit të gjuhës amtare shqipe, Prishtinë, nëntor, 2002.

Njësia e gjuhës është njësia e kombit. (nënvizim imi-R.Gj.)⁸⁶⁸ Ndhimesa e gazetave dhe revistave pedagogjike, në këtë rrafsh, ka të bëjë edhe me botimin në to të një numri të konsiderueshëm të punimeve si vështrime, analiza e vlerësime të programeve e të teksteve mësimore, para ose pas miratimit të tyre. Për këndvështrimet e veçanta të programeve mësimore po vemë në pah se në vështrimet e analizat e bëra planeve e programeve mësimore ishin shfaqur mëdyshje e mospajtime të konsiderueshme me zgjidhjet e ofruara. Gazetat dhe revistat pedagogjike në gjuhën shqipe, i kishin ndihmuar edhe përparimit të metodikës e të praktikës shkollore të planifikimit të punës mësimore nga gjuha amtare dhe letërsia. Në punimet që iu kishin kushtuar përgatitjes, zgjedhjes dhe përdorimit të mjeteve mësimore, theks i veçantë iu kishte vënë përdorimit të drejtë, e me masë, të tabelave, hartave, skicave, planeve e teksteve të zgjedhura, gramafonit, magnetofonit e radios, episkopit e diaskopit në mësimin e gjuhës amtare e të letërsisë. Disa punime tjera kishin dhënë rekomandime, për shfrytëzimin e kabinetit të gjuhës shqipe dhe organizimit të mësimin të gjuhës amtare e të letërsisë me kërkesë të tejkalimit të kufizimeve tradicionale të organizimit të mësimin vetëm në mësonjëtoare e “me shkumës në dorë”! Vështrimet e analizat e botuara, në gazetat dhe revistat pedagogjike shqipe të kohës, vinin edhe si këshilla për hartuesit e librave të leximit e të materialeve tjera ndihmëse për mësimin e gjuhës amtare e të letërsisë. Teknologë të rinj të Kosovës fokusonin raste të botimit të teksteve shkollore me përmbajtje të varfra, por raste të teksteve me mbingarkesë (me përmbajtje mësimore përtej aftësive kuptimore e të tjera psiko-fizike të nxënësve.) Një nga autorët, në një analizë të bërë librit të leximit për klasën e pestë të shkollave fillore të Kosovës, kishte provuar ndikimet dhe “plagjiatet” e modeleve sllave, sepse kishte “...gati aq njësi mësimore sa kanë të gjithë librat e leximit kroat, prej klasës së parë e deri në klasën e pestë”.⁸⁶⁹ Për këtë arsye dhe, me anë të punimeve nga periodiku pedagogjik bëhej thirrje që librat e leximit dhe tekstet tjera për mësimin e gjuhës amtare e të letërsisë, të shkarkohen “...nga gjërat e tepërta që të kuptohen më lehtë”! Kur në këto trajtesa bëhej fjalë për nvelin e cilësisë së gjuhës në librat e leximit e materialet e tjera mësimore për gjuhën amtare shqipe, vlerësohej se, “...në të gjitha hallkat e strukturës së gjuhës, duhet të jetë më i lartë se ai i gjuhës së nxënësve të cilëve iu dedikohet teksti, por vetëm aq sa aftësitë kuptimore dhe psiko-fizike të nxënësve lejojnë që me një mund të arsyeshëm të arrijnë që ta përvetësojnë atë shkallë (nënvizim imi-R.Gj.)⁸⁷⁰

Mangësi e dobësi karakteristike të hetuara gjatë vëzhgimit të praktikës mësimore të gjuhës amtare e letërsisë, sipas punimeve nga periodiku pedagogjik i kësaj periudhe kohore, mund të kategorizoheshin në këto fusha të lëndës së gjuhës shqipe dhe të letërsisë: Në mësimin e leximit, të përpunimit të teksteve e të recitimit, nuk ishin përfillur gjithashtu, kërkesat e programit mësimor të klasave të caktuara.; Ishin vënë re edhe raste kur hartimet e nxënësve të ishin bërë “...shumë të varfëra, me fjali të cinguar dhe me shumë gabime ortografike”⁸⁷¹ Në lëmin e metodave mësimore ishin vërejtur raste të zbatimit të favorizuar të metodave “...të shpjegimit teorik në kurriz të metodave praktike”,⁸⁷² Në lëmin e mësimin të gramatikës e të drejtshkrimit, mësuesit i kishin dhënë “...më tepër rëndësi përvetësimin mekanik të rregullave dhe përkufizimeve se sa ushtrimeve për t’i mësuar nxënësit që t’i përdorin në vend këto rregulla në të folur e në të shkruar. Kështu bëhet një shkoputje ndërmjet gramatikës dhe gjuhës së gjallë.”⁸⁷³

⁸⁶⁸Xhuvani Aleksandër, *Për themelim të një gjuhe letrare*, Tiranë, 1905.

⁸⁶⁹Bekteshi Bektesh, *Çfarë libër leximi përdorim*, “Shkëndija”, Prishtinë, 1974, nr. 9-10, f. 20.

⁸⁷⁰Munishi Zijadin, *Gjuha e teksteve në peshojë të re*, “Shkëndija”, Prishtinë, 1977.

⁸⁷¹“Arësimi popullor”, Tiranë, 1959, nr. 7, fq. 6.

⁸⁷²Dedja Pandora, *Për një hap cilësor në mësimin e gjuhës shqipe*, “Revista pedagogjike”, Tiranë, 1975, nr. 1, f. 49.

⁸⁷³Po aty, fq. 6.

Për evitimin e këtyre dhe dobësive të vëna re në praktikën mësimore të gjuhës amtare e të letërsisë, nga trajtesat e botuara jepeshin rekomandime, të gjenden rrugët që afrojnë më tepër nxënësin me lëndën, që lehtësojnë përvetësimin shkencor të lëndës, afrimi i mësuesit me nxënësit, përgatitja jociësore e mësuesve, konkretizimi i pamjaftueshëm i diturive nga gjuha dhe gramatika, moslidhja e mësimit me jetën, të gramatikës me gjuhën e gjallë të popullit⁸⁷⁴.

Në këto punime ishin porositur që mësuesit të njohin e zotërojnë mirë programin e teksteve dhe të përvetësojnë përmbajtjet e çdo lëmi programor të mësimit të gjuhës amtare e të letërsisë në klasën përkatëse, në atë pararendëse dhe atë vijuese. Madje në këto trajtesa kerkohej përsosja profesionale e metodike të arsimitarëve të gjuhës shqipe; kërkohet t'u ofrohej atyre informata të reja për të arrijturat në fushën e teknologjisë e të industrisë moderne të mësimit. Këto shkrime vinin si një flakadan për mësuesit e gjuhës shqipe për çështje të metodikës e të praktikës shkollore të mësimit të leximit dhe të shkrimit fillestar.⁸⁷⁵ Kryesisht shkrimet e botuara artikulonin kërkesat për lëndën e mësimit të gjuhës amtare, për çështje të detyrave, të përmbajtjes e të organizimit të mësimit në periudhën e përgatitjes për lexim dhe shkrim; përpilimi i abetareve dhe i librave bashkëkohorë të leximit për klasën e parë të shkollës fillore. Çështje nga metodika e mësimit të leximit në klasën e parë, përmbajtja dhe organizimi i ushtrimeve të të folurit të nxënësve të klasës së parë të shkollës fillore, ishte tematikë tjetër. Çështje nga mësimi i shkrimit në klasën e parë të shkollës fillore dhe zgjedhja, përgatitja dhe zbatimi efektiv i metodave, i mjeteve nga praktika e përparuar të mësimit të leximit dhe të shkrimit fillestar në shkollën shqipe, ishte një problematikë tjetër në këtë periodik. Gjatë analizës së bërë periodikut pedagogjik, gjetëm se edhe çështjeve nga metodika dhe praktika shkollore e organizimit të ushtrimeve të të folurit me nxënësit e shkollës fillore iu kishte kushtuar kujdes meritore. Po ashtu në disa punime haset në trajtimin e rolit të familjes për zhvillimin e kulturës së të folurit të fëmijëve, ndikimin e mësuesit e të faktorëve tjerë pjesëmarrës në mësim për zhvillimin dhe përparimin e të folurit të nxënësve të klasës së parë të shkollës fillore, etj.⁸⁷⁶ Përmendeshin raste kur "...fëmija në shkollë të fitojë dijet e tjera ma shpejt" dhe që shkolla "...të mos humbi kohë me u marrë me qortimin e të folurit, por me dhanjen e dijenive tjera".

Një numër i madh i punimeve nga periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe, iu kushtojë përvetësimin të leximit e të shkrimit, raportit mësues-nxënës në përparimin e kulturës së të folurit të nxënësve, organizimit të ushtrimeve të të folurit, si dhe taktit dhe stilit pedagogjik të punës së mësuesit gjatë zhvillimit të kulturës së të folurit të nxënësve të klasës së parë të shkollës fillore. Për reagimet e mësuesit ndaj gabimeve çfarë bëjnë nxënësit gjatë të folurit, dhe, tërhiqej vërejtja se "...mësuesi në asnjë mënyrë s'guxon t'i marrë në tallje nxënësit për shprehjet e tyre me lokalizma dhe barbarizma, të vëjë në lojë dialektin që e ka përvetësuar nga nëna e në gjirin familiar"⁸⁷⁷. Një përkushtim i veçantë, i autorëve me përparësi dhe rëndësi ishin edhe shkrimet për zbatimin efektiv të metodës analitiko-sintetike në mësimin e leximit dhe të shkrimit fillestar në shkollat shqipe. Edhe për metodat analitiko-sintetike e tingullit, në njërin prej këtyre punimeve nga periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe, thuhej se kjo metodë "...u jep fëmijëve jo vetëm

⁸⁷⁴Biblekaj Gjon, *Konkretizimi i mësimit në lëndën e gjuhës dhe të letërsisë*, "Shkëndija", Prishtinë, 1971, nr. 6, f. 14.

⁸⁷⁵Mandia Qemal, *Të zhdukim dobësitë në mësimin e gjuhës shqipe*, "Arsimi dhe kultura popullore" Tiranë, 1954, nr. 8, f. 9.

⁸⁷⁶Plava Hajrije, *Si kam vepruar për të përfunduar mësimin e abetares para afatit të caktuar*, "Arësimi popullor", Tiranë, 1958, nr. 8, f. 23-26.

⁸⁷⁷Zajazi Tahir, *Roli i mësuesit në të sistematizuarit dhe zgjeruarit e fjalorit të nxënësve të klasës së parë*, "Përparimi", Prishtinë, 1968, nr. 11-12, fq. 1085.

shprehi praktike për shqyptimin e tingujve me rastin e leximit, por ndihmon edhe hetimin e veçorive karakteristike të tingujve edhe mënyrën e bashkimit të tyre në rrokje e fjalë”.⁸⁷⁸ Ajo “...shkëputet nga metoda artificiale skolastike dhe merr një drejtim natyral.”⁸⁷⁹ Bën të mundur edhe “...zhvillimin më me hov të fëmijëve”, krijon edhe “...kënaqësi të fëmija, ua stërvit vazhdimisht vëmendjen, kujtesën dhe gjykimin, e përgatit për leximin e vetëdijshëm dhe zgjon interes për mësim”. Në këto punime, më parë ishin treguar dobësitë karakteristike të hetuara në praktikën e disa mësuesve. Shpesh botoheshin edhe kundërshtime, sidomos, kritikohej puna jo e mirë në periudhën e përgatitjes së nxënësve për mësimin e leximit dhe të shkrimit. Sipas përmbajtjes së shkrimeve vihet re se në shumë shkolla, e nga më shumë mësues, kjo periudhë ishte plotësuar, kryesisht, me përmbajtje për ushtrimet e të folurit, “...pa dhënë kuptimin e fjalës, të fjalisë, të rrokjes dhe të tingullit me veprimin e analizës dhe të sintezës.”⁸⁸⁰ Disa mësues të tjerë, s’i kishin kushtuar kujdesin e duhur ushtrimeve të shkrimit. Ato, “...ose nuk ishin përfilluar fare”, ose ishin “bërë shkel e shko”.⁸⁸¹ Punimet kërkonin edhe zbatimin e njëhershëm e të gërshetuar të më shumë metodave në mësimin e leximit dhe të shkrimit fillestar. Sipas tyre, “ndjekja e një lloj mënyre /metode për zhvillimin e të gjitha shkronjave, qoftë ajo edhe shumë e mirë, do të shkaktonte monotoni e mërzi”. Për këtë arsye, është e nevojshme që “...mësuesit të ndërrojnë nganjëherë mënyrën e paraqitjes së shkronjave”, “të kombinojnë mënyra të ndryshme”. Në këtë mënyrë, “nxënësit, jo vetëm se shkronjat i mësojnë ma lehtë, por as nuk merzitën”.⁸⁸² Në këtë shtyp modest të Kosovës, do të jenë vënë re edhe evituar, me kohë, edhe dobësitë e shfaqura në praktikën mësimore siç ishin: leximi mekanik, leximi me ton jo të natyrshëm ose “shkollaresk”⁸⁸³ dukuria e zëvendësimit dhe e përsëritjes së panevojshme të fjalëve a të morfemave, etj. Në literaturën bazë të metodikës, të botuar në periodikun pedagogjik sidomos, gjithnjë më të shpeshta ishin punimet të cilat e kundërshtojnë mendimin e këtyllë.⁸⁸⁴ Në punimet profesionale e shkencore që ishin botuar, ishte treguar gjithë ndërlikueshmëria e punës për hartimin e abetares bashkëkohore, me ide të vlefshme përkitazi me mbështetjen dhe koncipimin e abetares së re.

Çështje të metodikës e të praktikës shkollore të të shprehurit me gojë në periodikun pedagogjik

Në këtë periodik, një vend të mirë zë edhe trajtimi i rëndësisë dhe fazave të zhvillimit dhe karakteristikat e të folurit të nxënësve të moshave të ndryshme shkollore; llojet e ushtrimeve të të shprehurit me gojë; faktorët e zhvillimit dhe të përparimit të të folurit të nxënësve; përmbajtjet dhe organizimi efektiv i ushtrimeve të të folurit; gabimet dhe defektet më të shpeshta të të folurit të nxënësve; zhvillimi dhe pasurimi i fjalorit të nxënësve nëpër shkallë të ndryshme të shkollimit; roli i mësuesit dhe i mësimeve të tjerë për zhvillimin e të folurit të nxënësve; çështje të metodikës së ushtrimeve të shqiptimit të drejtë e letrar; ushtrimet e të folurit të bukur e ekspresiv; çështje nga organizimi efektiv i ushtrimeve të theksit e intonacionit dhe veçori të tjera të të

⁸⁷⁸Shehu Hava, *Rezultatet e metodës së re analitiko-sintetike në shkolla*, “Arësimi popullor”, Tiranë, 1949, nr. 3-4, f. 104.

⁸⁷⁹Metoda analitiko-sintetike, “Arësimi popullor”, Tiranë, 1948, nr. 6, f. 1

⁸⁸⁰Xhumari Kolë, *Si është zbatuar metoda analitiko-sintetike në shkollat tona*, “Arësim popullor”, Tiranë, 1952, nr. 7, f. 31.

⁸⁸¹Gjevari Mehmet, *Mësimi i lexim-shkrimit fillestar*, “Përparimi”, Prishtinë, 1959, nr. 7-8, fq. 529.

⁸⁸³Gjevari Mehmet, *Përfeksionimi i leximit në klasën e parë*, “Shkëndija”, Prishtinë, 1976, nr. 6, fq. 15.

⁸⁸⁴Gjevari Mehmet, *Të mësuarit e shkronjave të dorës - shkrimit*, “Shkëndija”, Prishtinë, 1975, nr. 17, f. 10.

folurit të bukur e të normuar ishin tematika që ishin trajtuar kryesisht te revista pedagogjike “Shkëndija”.

Këto shkrime ishin një orientim për mësimdhënësit se si të bëjë të mundur afrimin e dialekteve, shkrirjen e tyre në normën letrare. Për t’ia dalë kësaj, punimet nga periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe, i këshillonin mësuesit të punonin intensivisht në zotërimin e normës letrare shqipe⁸⁸⁵ Jetësimin e të folmes së normuar letrare nëpër shkolla, sipas periodikut pedagogjik në gjuhën shqipe mësimdhënësit kërkohet ta bënin kryesisht përmes ushtrimeve të të folurit të nxënësve, sepse “...jeta vetë e rrethit të merret si përmbajtje për ushtrime të ndryshme të shprehjes me gojë” të nxënësve. Sepse, vlerësohej se plotënia, saktësia edhe bukuria e të folurit të nxënësve varet shumë prej fjalorit që kanë. Për këtë trajtesat kërkohet një kujdes të posaçëm “...pasurimit të fjalorit të nxënësve dhe përdorimit të drejtë të fjalëve”⁸⁸⁷

Çështje të metodikës dhe të praktikës shkollore të ushtrimeve të shkrimit në periodikun pedagogjik

Çështjet e metodikës së ushtrimeve të shkrimit dhe të hartimeve janë një fushë tjetër e mësimin të gjuhës amtare shqipe, e trajtuar shumë shpesh në periodikun pedagogjik në gjuhën shqipe. Problemet e prezantuara dhe të shkoqitura, nga ky lëmë i mësimin të gjuhës amtare, mund t’i ndajmë e analizojmë në dy grupe bazë. Në punimet që kanë të bëjnë me teknikën dhe cilësinë e shkrimit dhe në punimet që kanë të bëjnë me llojet e ushtrimeve të shkrimit e të hartimeve të nxënësve. Brenda këtyre dy grupeve bazë të punimeve, ishin shtruar e shkoqitur shumë çështje të veçanta, më të ngushta, por të rëndësishme, nga metodika e ushtrimeve të shkrimit dhe të hartimeve të nxënësve të klasave dhe shkollëve të ndryshme të shkollimit. Sipas shtypit kishte raste, kur arsimtarët e gjuhës amtare nuk i kontrollojnë rregullisht punimet me shkrim të nxënësve.⁸⁸⁸ Sipas periodikut orë të tilla ishin shpesh “...të dështueme dhe, si të tilla, krejtësisht të humbura”⁸⁸⁹ Edhe hartimet e lira paraqesin formën më të përsosur të të shprehurit me shkrim të nxënësve. Ato janë “...shumë të përshtatshme për shpenjën e nxënësve në botën e gjuhës letrare e në shprehjen stilistike më të pasur”.⁸⁹⁰ Përmes punimeve nga periodiku pedagogjik ishte vënë se, ka rrezik gjithashtu që, duke lexuar shumë, por pa kujdesin e mësimdhënësit “... nxënësit të mos ndalen sa duhet dhe me kohë në leximin, të mos thellohen në të”.⁸⁹¹ Në disa punime nga gazetatat dhe revistat pedagogjike në gjuhën shqipe, kërkohet punë shumë më e madhe e mësuesve për organizimin më të mirë të orëve të hartimeve e të kontrollit dhe korrigjimit të tyre. Për këtë qëllim, gjatë përcaktimit të temave për hartim kërkohet që ato të jenë “...nga temat me karakter konkret /klasa e I dhe e II/ n’ato më pak konkrete /klasa e III dhe IV/”.⁸⁹² Korrigjimi, thuhej në njërin nga punimet e botuara në “Përparimi”, “...nuk duhet të bahet në bazë të një shablioni, njësoj për të gjithë nxënësit”, pox në mënyrë të ndryshme, ashtu “...siç janë të ndryshme edhe

⁸⁸⁵Begolli Menduh, *Lokalizmat dhe menjanimi i tyre në shkollë*, “Përparimi”, 1960, nr. 1-2, f. 75.

⁸⁸⁶Qorrolli Shefqet, *Të shprehurit me gojë*, “Shkëndija”, Prishtinë, 1975, nr. 5-6, f. 16.

⁸⁸⁷Plani dhe programi unik i punës arsimore-educative në shkollën fillore, Prishtinë, 1977, fq. 17.

⁸⁸⁸Perusko Tone, *Materinski jezik u obaveznoj skoli /Specijalna didaktika/*, Zagreb, 1964, f. 211.

⁸⁸⁹Basha Xhevdet, *Referatet e nxënësve si formë e përpunimit të landës së gjuhës e të letërsisë amnore*, “Përparimi”, Prishtinë, 1967, nr. 2, f. 207.

⁸⁹⁰Cop Milivoj, *Pismene vjezbe i sastavci u mladjim razredima osnovne škole, /Botim i dytë/*, Zagreb, 1975, f. 219.

⁸⁹¹Shala Demush, *Hartimet në shkollat e mesme*, “Përparimi”, Prishtinë, 1966, nr. 4, fq. 367.

⁸⁹²Shala Mehmet, *Ku qëndrojnë shkaqet e suksesit të dobët të nxënësve në hartime*, “Shkëndija”, Prishtinë, 1971, nr. 6, f. 9.

vetë hartimet”.⁸⁹³ Ai, “...duhet të jetë sa ma serioz, koshjent dhe vërejtjet, mendimet të jenë shumë të matura”. Gjatë korigjimit, të mos shikohen vetëm gabimet gjuhësore, por edhe ato logjike, uniteti i temës, bukuria e shprehjes, pastërtia dhe bukuria e shkrimit.

Çështje të metodikës e të praktikës shkollore të mësimit të gramatikës dhe të drejtshkrimit në periodikun pedagogjik

Mësimi i gjuhës, i gramatikës dhe drejtshkrimit, sipas shkrimeve, por edhe siç sugjeron programi mësimor, “...duhet të kuptohet si mjet që ndihmon zhvillimin e kulturës së nxënësve në të shkruar dhe në të lexuar e, nga ana tjetër, si mjet për t’i futur nxënësit në ligjësitë elementare të gjuhës shqipe”. Periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe, e kishte përmbushur me botimin e një numri të artikujve dhe punimeve nga metodika dhe praktika shkollore e mësimit të gramatikës dhe drejtshkrimit. Me disa prej këtyre punimeve ishin trajtuar çështje të rëndësishme nga ky lëmë i mësimit të gjuhës amtare. Në mbështetje të rekomandimeve të metodikës bashkëkohore të gjuhës amtare shqipe, të ligjësisve dhe karakteristikave të përmendura të zhvillimit mendor të fëmijëve të moshave të ndryshme shkollore, edhe Programi mësimor këshillonte që “Mësimi i gjuhës dhe gramatikës, prej fillimit e deri në fund të shkollimit, duhet të mbështetet në ndjenjën gjuhësore dhe në të vërejturit, në mënyrë sistematike e të organizuar të nxënësve”.⁸⁹⁴ Për të parandaluar, ose edhe për të flakur fare dukurinë e këtyre, kishin ndihmuar në masë të dukshme edhe gazetat dhe revistat pedagogjike në gjuhën shqipe. Në punimet që kishin botuar për këtë qëllim,⁸⁹⁵ kishin shpjeguar vlerën e caktimit të pozitës së përshtatshme të këtij në mesin e lëmenjve të tjerë të mësimit të gjuhës amtare shqipe. Në punimet model nga ky lëmë, ishin përpunuar në mënyrë të veçantë: çështje të formimit të shprehive drejtshkrimore të nxënësit e klasave të ulëta të shkollës fillore, format dhe përmbajtjet më të përshtatshme për formimin e shprehive drejtshkrimore, mjetet bashkëkohore në mësimin e drejtshkrimit.⁸⁹⁶ Ishte treguar roli i mësuesit për parandalimin e gabimeve dhe për përvetësimin e normës së drejtshkrimit nga nxënësit në mësimin e gramatikës e të drejtshkrimit, shoshitjes së shkaqeve dhe propozimit të hapave më të efektshëm metodik të punës për çrënjosjen e tyre nga praktika mësimore.⁸⁹⁷ Një kujdes i konsiderueshëm iu kishte kushtuar edhe diktiveve për përparimin e kulturës drejtshkrimore të nxënësve. Ishin sugjeruar edhe procedime më të përshtatshme metodike të orëve të mësimit me këtë lloj diktimi.⁸⁹⁸ Me botimin e këtyre punimeve, mendojmë se periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe, kishte ndihmuar dukshëm arsimin metodik të mësuesve e të arsimtarëve të gjuhës amtare shqipe, si dhe përparimin e praktikës shkollore të mësimit të gjuhës, gramatikës dhe drejtshkrimit në shkollat shqipe.

Periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe për çështje të metodikës dhe të praktikës shkollore të mësimit të letërsisë

Leximi dhe puna tjetër me tekste të llojeve të ndryshme, paraqiste gjithmonë një kusht të domosdoshëm për realizimin e qëllimit dhe të detyrave të mësimit të gjuhës amtare. Për këtë

⁸⁹³Shala Demush, *Hartimet në shkollat e mesme*, “Përparimi”, Prishtinë, 1966, nr. 4, f. 368.

⁸⁹⁴ *Plani dhe programi unik i punës arsimore-edukative në shkollën fillore*, Prishtinë, 1977, f. 38.

⁸⁹⁵ Jasiqi Ali, *Gramatika dhe letërsia*, “Shkëndija”, Prishtinë, 1974, nr. 7-8, f. 8.

⁸⁹⁶ Brada Riza, *Kontakti me gabime*, “Shkëndija”, Prishtinë, 1971, nr.4, f. 9.

⁸⁹⁷ Nushi Musa, *Lajthimet gjatë analizës morfologjike*, “Shkëndija”, Prishtinë, 1972, nr. 5, f. 17.

⁸⁹⁸ Brada Riza, *Kontakti me gabime*, “Shkëndija”, Prishtinë, 1971, nr.4, f. 9.

arsye dhe “Leximi dhe puna me tekst”, edhe pse me emërtime të ndryshme, ishte përfaqësuar si lëmë i veçantë mësimor, pothuaj në të gjitha programet mësimore për gjuhën amtare shqipe, të miratuara brenda harkut kohor që po trajtojmë me këtë punim.⁸⁹⁹ Duke bërë analizën e punimeve të botuara nga kjo fushë vihet re se përmbajtjet e kësaj natyre ishin nga: çështje të metodave në mësimin e letërsisë; vlera e përgjithshme edukative dhe, veçmas e edukimit estetik të mësimin të letërsisë; tretmani i përmbajtjeve mësimore të leximit, punës me tekst dhe recitimit në programet mësimore e në praktikën shkollore; llojet e leximit të ushtruara në klasat dhe shkollat e tipave e të niveleve të ndryshme të shkolimit; çështje të procedimit metodik të punës me tekste të farëve (llojeve) të ndryshme; disa dobësi më të shpeshta të shfaqura në praktikën shkollore të mësimin të leximit, punës me tekste e recitimit; çështje të punës me tekste, lexim e recitim jashtë klasës e shkollës; puna e rretheve letrare; çështje nga organizimi i përsëritjeve në mësimin e letërsisë; shumë çështje të rëndësishme nga metodologjia bashkëkohore e hartimit të librave të leximit dhe roli i mësuesit në mësimin e letërsisë.⁹⁰⁰ Përmes analizës sasiore e cilësore të punimeve nga lëmi i mësimin të gjuhës shqipe dhe letërsisë, të botuara në gazetatat dhe revistat pedagogjike në gjuhën shqipe, konstatojmë se në këto punime me një kujdes të veçantë janë sjellë vlera edukative të edukimit estetik të përmbajtjeve nga letërsia, leximi dhe recitimi. Disa funksione të tjera edukative të mësimin të letërsisë, atëherë marksiste, pohojnë se “...*arti e merr përmbajtjen jo nga “ideja hyjnore”, as nga “uni”, porse nga realiteti i jetës dhe te ajo përmbajtje reale sheh burimin e rolit aktiv të artit në jetën e shoqërisë.*”⁹⁰¹ Revistat pedagogjike në gjuhën shqipe në Kosovë këshillojnë, që në mësimin e leximit, të përpunimit të teksteve e të recitimit të kihet parasysh edhe mundësia tjetër çfarë ofron letërsia për edukimin klasor dhe politik të fëmijëve dhe të të rinjve.

Në disa artikuj e punime jepeshin edhe udhëzime konkrete për procedimet më të efektshme metodike që mundësojnë realizimin e vlerave të përmendura edukative të mësimin të letërsisë. Në këto shkrime vlerësohej mësimi i letërsisë mund të edukojë: përmes analizës së personazheve, përmes idesë së veprës letrare “...*se nxënësit, pasi të jetë analizuar një personazh pozitiv, ushqejnë dashuri e simpati për te dhe në vetëdijen e tyre patjetër zihen dëshira për ta imituar herojnë e studiuar*”.⁹⁰² Në njërin prej këtyre punimeve, që e kishte botuar “Shkëndija”, bëhej me dije se “Leximi në heshtje abstragon ligjërimin, madje edhe pëshpëritjet më të vogla. Kur lexojmë në heshtje, nuk duhet shqiptuar fjalët në pëshpëritje, nuk duhet lëvizur buzët.”⁹⁰³ Përmes leximit në heshtje, thuhej më tutje këtu, “...nxënësi zgjeron kulturën e tij gjuhësore, rrit kapacitetin e të kuptuarit, lexon më shpejt, duke fituar në kohë dhe hapësirë shkrimi (...) nuk lodhet fizikisht, (...) nuk prish qetësinë e të tjerëve”. Sipas shkrimeve pedagogjike, thuhet se leximi në heshtje edhe “...shton kureshtjen për të lexuar sa më tepër, duke kultivuar ndjenjën e duke pronësuar shprehinë e leximit të qëndrueshëm për të zgjeruar horizontin e kulturës sonë personale, shton dashurinë ndaj librit, ndaj fjalës së shkruar në art, shkencë dhe kulturë”. Një ndihmesë të vlefshme, punimet nga periodiku pedagogjik, brenda këtyre viteve, i kishin dhënë edhe përparimit të punës mësimore në orët e analizës dhe të komentit letrar. Kishin ofruar

⁸⁹⁹Emërtimet më të shpeshta të këtij lëmi mësimor,në programet mësimore për gjuhën amtare shqipe ishin: “Ushtrimet e të shprehurit logjik dhe ekspresiv”(1959, 1962), “Leximi dhe përpunimi i teksteve (1974), “Përpunimi i teksteve, leximi dhe recitimi” (1977).

⁹⁰⁰ Islam Krasniqi, *Ndihmesa e periodikut pedagogjik në gjuhën shqipe*(midis viteve 1945-1978), Prishtinë, nëntor, 2002.

⁹⁰¹Hakiu Nexhat, *Edukimi estetik në mësimin e letërsisë*, "Atësimi popullor", Tiranë, 1971, nr. 4, f. 99.

⁹⁰²Demiraj Shaban, *Edukata nëpërmjet mësimin të letërsisë*, “Arësimi Popullor”, Tiranë, 1953, nr. 10, fq. 15.

⁹⁰³Halimi Mehmet, *Të lexuarit në heshtje*, ”Shkëndija”, Prishtinë, 1977,nr. 15,f. 11.

udhëzime të vlefshme përkitazi me procedimin më të efektshëm metodik për organizimin eorëve të analizës e të komentit letrar. Në revistat pedagogjike në gjuhën shqipe, ishin trajtuar edhe çështje me vlerë që i referoheshin aparaturës pedagogjike të librave të leximit. Numri i punimeve sa ishin botuar, numri dhe lloj-llojshmëria e çështjeve që ishin trajtuar në to, dëshmon qartë për kujdesin çfarë periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe, brenda viteve 1945-2015, iu kishte kushtuar çështjeve nga metodika dhe praktika shkollore e mësimit të letërsisë. Në dritën e rekomandimeve të metodikës bashkëkohore, periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe në Kosovë ka trajtuar edhe praktikën tradicionale të mësimit të leximit në shkollat e niveleve dhe mjediseve të ndryshme, duke sjellë modele dhe përvojat të mësuesve e të shkollave të përparuara.⁹⁰⁴

Sipas periodikut pedagogjik, në programet mësimore për gjuhën amtare shqipe, pas Luftës së Dytë Botërore, në Kosovë, “Lektyra shkollore e shtëpiake” paraqiste, pothuaj gjithmonë, një lëmë të veçantë mësimi. Por, nëpër periudha të ndryshme të zhvillimit të shkollës, dhe të mësimit të gjuhës amtare shqipe dhe të letërsisë, pati raste kur lektyra shkollore e shtëpiake u kuptua, kryesisht, si përmbajtje për të plotësuar vakumet e orëve mësimore nga fushat e tjera të mësimit të gjuhës amtare. Kjo paqartësi e punës me lektyrën shkollore e shtëpiake si dhe praktika shkollore, vinte si pasojë e mungesës së teksteve bazë të metodikës në gjuhën shqipe. Për të plotësuar këtë zbrastësi revistat pedagogjike në gjuhën shqipe, për shumë vite me radhë, patën përfshirë e përpunuar çështje të rëndësishme nga metodika dhe praktika shkollore e punës me lektyrën shkollore e shtëpiake. Punimet nga periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe, bënin me dije se “Lektyra asht ai komponent i programit, që kur të zhvillohet drejt e mirë prej arsimtarit, zgjon te nxanësit ndjenja estetike, sjell njohuni të reja, zhvillon aftësinë e të mendimit e të folurit dhe (...) plotëson e formon kulturën letrare dhe atë të përgjithshme të nxanësve dhe, veçmas, fision jetën e tyre të mbrendshme”.⁹⁰⁵ Për shkak të rëndësisë çfarë ka, prandaj, punimet nga periodiku pedagogjik në gjuhën shqipe, kishin rekomanduar si të domosdoshëm planifikimin me kohë dhe përgatitjen e shumanshme e cilësore të mësuesit të gjuhës për përpunimin e lektyrës shkollore e shtëpiake.⁹⁰⁶ Ishte dhënë edhe porosia për arsimtarët që, gjatë procesit mësimor, të caktojnë disa kohë përpara veprat që duhet të lexohen e edhe orët mësimore kur do të diskutohet për to.⁹⁰⁷ Në periodikun pedagogjik në gjuhën shqipe, brenda kësaj periudhe kohore, ishin bërë edhe disa përpjekje për të hulumtuar e edhe për të ndihmuar formimin e qëndrimeve të drejta të nxënësve ndaj lektyrës shkollore e shtëpiake. Ishin dhënë edhe udhëzime konstruktive përkitazi me mënyrën si duhet qasur, kuptuar dhe interpretuar veprën letrare të lexuar. Ishte rekomanduar që nxënësve t’u jepeshin udhëzime “...përkitazi me mbajtjen e she- nimeve nëpër fletore, për mënyrën e të shkruajturit të referateve (...) si dhe për t’i drejtuar nxënësit se në çfarë aspekti duhet të kundrohët një vepër e lexuar”.⁹⁰⁸ Udhëzohej se gjatë përgatitjes për orën e lektyrës shkollore, “...ta lexojë veprën letrare që parashihet për orë të lektyrës dhe të mendojë për ecuninë e mësimit në orë, për elementet e veprës, të shënojë vendet karakteristike të librit për të cilin ka të bajë fjalë në klasë, të mbledhë shënime për shkrimtarin, për kohën që paraqet në vepër dhe të përgatitet n’atë mënyrë që t’i interesojë sa ma tepër nxanësit”.⁹⁰⁹ Krahas udhëzimeve për përgatitjen cilësore e të shumanshme dhe organizimin efektiv të orëve të mësimit të lektyrës shkollore, në punimet nga periudhiku

⁹⁰⁴Abdia Ramiz, *Mësuesi i letërsisë dhe krijimtaria e nxënësve*, ”Mësuesi”, Tiranë, 1973, nr. 16, fq. 3.

⁹⁰⁵Begolli Menduh, *Lektyra e detyrueshme dhe ora e saj në shkollë*, “Buletini”, Prishtinë, 1962, nr. 3-4, f. 31.

⁹⁰⁶Galica Abdylkader, *Lektyra shtëpiake*, ”Shkëndija”, Prishtinë, 1974, nr. 12, f. 14.

⁹⁰⁷*Plani dhe programi unik i punës edukative-arsimore në shkollën fillore*, Prishtinë, 1977, f. 38.

⁹⁰⁸Hasani Hasan; Fetahaj Jonuz, *Lektyra - ndihmesë për zgjerimin e diturisë*, “Shkëndija”, Prishtinë, 1974, nr. 18-19.

⁹⁰⁹Begolli Menduh, *Lektyra shkollore dhe ora e saj në shkollë*, “Buletini”, Prishtinë, 1962, nr. 3-4, f. 32.

pedagogjik në gjuhën shqipe, ishte kritikuar edhe dukuria e mospërgatitjes fare të disa mësuesve për orët e këtilla të mësimit. Gjatë analizës së punimeve që në periodikun pedagogjik ishin botuar nga ky lëmë, vihet re se mësimeve, mbështetëj në kërkesat e programit mësimor sipas të cilave, sepse ai e kishte për detyrë të kujdeset “...edhe për veprat që lexojnë nxënësit sipas dëshirës dhe shijes së tyre, por që nuk parashihen në lektyrën e klasës se caktuar” dhe që edhe ...për këto vepra të lexuara (...) të organizojnë biseda me nxënësit.⁹¹⁰ Punimet e botuara për këto çështje, shpjeguan rëndësinë e punës së arsimtarit të gjuhës amtare për ngjalljen dhe forcimin e interesit të nxënësve për të lexuar libra edhe jashtë lektyrës shkollore, për drejtimin e punës së nxënësve gjatë leximit të këtyre veprave, të mbajtur shënime për literaturën e lexuar dhe për analizën, për veprat që kanë lexuar nxënësit jashtë klasës dhe shkollës.⁹¹¹

Për të treguar vlerën çfarë ka angazhimi i mësuesit të gjuhës amtare rreth çështjeve nga leximi i veprave letrare që bëjnë nxënësit jashtë klasës e shkollës, një trajtesë, përkujtonte se “*Jeta nxjerr probleme të reja, në qarkullim dalin libra të rinj dhe mësuesi duhet të zgjedhë prej tyre ata libra që do të ndihmojnë në punën mësimore dhe edukative me nxënësit e tij.*”⁹¹² Disa nga punimet e botuara në periodikun pedagogjik, nga kjo fushë, kishin ndihmuar të njihen kriteret bazë për zgjedhjen e teksteve letrare për lexim jashtë klase dhe shkolle.

Me artikujt dhe punimet që ishin botuar në periodikun pedagogjik në gjuhën shqipe, brenda viteve 1945-2015, përkitazi me punën mësimore me lektyrën shkollore e shtëpiake të nxënësve u ndihmua që:

- Lektyra shkollore dhe shtëpiake mori tretman dhe status adekuat, si një lëmë mësimi i obligue shëm dhe jo si plotësim i vakuumeve të mbetura nga lëmenjtë tjerë mësimorë, e jo si vetëm çështje e vullnetit të mirë e interesit personal të mësuesit të gjuhës amtare;
- Me punimet e botuara në periodikun pedagogjik në gjuhën shqipe mbi këto çështje, ishin kundërshtuar procedime e modalitete të vjetruara dhe ishin shpjeguar e përhapur procedime e modalitete më të reja metodike për organizimin efektiv të orëve të mësimit me lektyrën shkollore dhe shtëpiake të nxënësve;
- Ishte ndihmuar të ngritet vetëdija e arsimtarëve të gjuhës amtare për nevojën e planifikimit e të përgatitjes me kohë dhe të shum- anshme edhe për orët e mësimit të lektyrësh shkollore e shtëpiake;
- Sugjeruan edhe rëndësinë e madhe çfarë ka mbikëqyrja, kontrolli dhe drejtimi i leximit të nxënësve jashtë shkolle dhe klase.⁹¹³

⁹¹⁰Qorrolli Shefqet, *Një orë e lektyrës në fillore*, “Shkëndija”, Prishtinë, 1973, nr. 13, f. 16.

⁹¹¹*Plani dhe programi unik i punës edukative-arsimore në shkollën fillore*, Prishtinë, 1977, f. 38.

⁹¹²Tabaku Faure, *Rëndësia, planifikimi dhe organizimi i mësimeve të leximit jashtë klase*, “Arsimi popullor”, Tiranë, 1963, nr. 6, f. 66.

⁹¹³Islam Krasniqi, *Ndihmesa e periodikut pedagogjik në gjuhën shqipe* (midis viteve 1945-1978), Prishtinë, nëntor, 2002.

KREU VIII

KORNIZA E RE KURRIKULARE E KOSOVËS, RËNDËSIA PËR MËSIMIN E GJUHËS

8.1. Roli dhe rëndësia e gjuhës shqipe në Kornizën e Re Kurrikulare

8.1.1. Synimet e Kurrikulës së Re

8.1.2. Çasje të reja të mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë

8.2. Parimet e zbatimit të Kurrikulit të ri të Kosovës

8.2.1. Roli dhe funksioni i Kornizës së Re Kurrikulare

8.3. Kompetencat e të nxënit sipas Kornizës së Re Kurrikulare

8.4. Aplikimi i Kurrikulës Bërthamë

8.4.1. Qëllimet dhe funksionet e fushës kurrikulare

‘Gjuhë dhe Komunikim’

8.4.2. Rezultatet e të nxënit

8.4.3. Aspekte metodologjike dhe praktike të fushës kurrikulare

‘Gjuhë dhe Komunikim’

8.4.4. Materialet mësimore në zhvillimin e kompetencave për

‘Gjuhë dhe Komunikim’

8.5. Vlerësimi i nxënësit sipas Kurrikulës së Re

8.5.1. Vlerësimi i brendshëm

8.5.2. Vlerësimi i bazuar në kompetenca

8.1. ROLI DHE RËNDËSIA E GJUHËS SHQIPE NË KORNIZËN E RE KURRIKULARE

Në vitin 2011, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) e Republikës së Kosovës ka miratuar Kornizën e Kurrikulës të Arsimit Parauniversitar të Kosovës. Hartimi i një kurrikule të re ishte hap sfidues për shtetin dhe sistemin arsimor, sepse paraqet një katalizator të qëllimeve, të fuqisë dhe të vlerave më të mira për vendin. Në këtë drejtim, hartimi i Kornizës së Kurrikulës demonstroi përkushtimin e Kosovës për të bërë arsimin ekuivalent me atë ndërkombëtar. Korniza e Kurrikulës reflekton çështjet dhe shqetësimet e ngritura gjatë debateve publike, të organizuara me nxënës, mësimitdhënës, drejtorë të shkollave, përfaqësues të autoriteteve komunale, ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë të arsimit dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Kosova tashmë ka kaluar nga një Kurrikulë e bazuar në përmbajtje në një Kurrikulë që bazohet në kompetenca, që synon sigurimin e një autonomie të shtuar të shkollës, ngritjen e llogaridhënies në nivel shkollë. Kosova bëri kështu një përpjekje serioze për integrimin në epokën digjitale dhe shndërrimin e saj në shoqëri të dijes, që gjeneron dhe zhvillohet gradualisht në një epokë të re digjitale/elektronike dhe mjaft sfiduese. Për t'u integruar me sukses në një ekonomi digjitale/elektronike, nxënësve u nevojiten kompetenca digjitale. Megjithatë, vetëm njohuritë dhe shkathtësitë digjitale nuk mjaftojnë për të krijuar personalitete komplekse për epokën digjitale, sepse forcën kryesore të botës digjitale e përbëjnë njerëzit dhe vlerat themelore që ata promovojnë. Ky hap në reformimin e arsimit parauniversitar po vendos themelet për ngritjen e cilësisë. Kurrikula e re mbështetet në parimin që gjuha dhe komunikimi si fushë kurrikulare përbëjnë themelet në procesin e të mësuarit, të komunikimit, të formimit të identitetit personal e kulturor, si dhe të lidhjeve ndërnjerëzore. Ajo është ngritur mbi bazën e parimit të integritetit të gjuhës shqipe dhe të letërsisë, si dhe të parimit të rimarrjes së njohurive, duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato. “Kjo lëndë studion artin e të lexuarit, të shkruarit, të folurit, të dëgjuarit dhe të vështruarit duke u përqendruar në tekste letrare, joletrare dhe pamore.”⁹¹⁴ Misioni i ri i lëndës është që të pasurojë përvojat dhe interesat në përdorimin e gjuhës e të letërsisë. Nxënësi gjatë arsimit parauniversitar do të përballet me të gjitha format e produkteve të shkruara (tekstin tregimtar, poetik, dramatik, shpjegues, përshkrues, argumentues/bindës dhe informativ), si dhe me format e produkteve mediatike. Nëpërmjet gjuhës shqipe dhe letërsisë nxënësi njihet e përvetëson kulturën e vendit, si dhe formon identitetin personal e kombëtar.

8.1.1. Synimet e kurrikulës së re

Pakoja e instrumenteve për planifikimin mësimor në lëndën e gjuhës shqipe në Kosovë, sipas kërkesave të Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe Kurrikulës Bërthamë, nisi zbatimin në dhjetë shkolla pilot (2013/2014) dhe zgjerimi po vazhdon në 90 shkolla të tjera (2014/2015). Hartimi i Udhëzuesit praktik për zbatimin e kurrikulës nga fusha Gjuhët dhe Komunikimi, në këtë fazë të reformimit të mësimitdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë vjen si një instrument për planifikimin mësimor, sipas kërkesave të Kurrikulës Bërthamë për nivelet përkatëse të arsimit për zbatimin e kurrikulës. Shkolla ka

⁹¹⁴ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & SWAP, *Udhëzues për mësimitdhënës për përmirësimin e praktikave në klasë*, Prishtinë, 2012.

autonomi dhe mund të vendosë edhe për shfrytëzimin e modeleve të instrumenteve të planifikimit mësimor. Lënda e gjuhës shqipe me përmbajtjet e reja kurrikulare ka për synim të zhvillojë te nxënësi:

- *Të lexuarit dhe të shkruarit e logjikshëm dhe kritik, për ta përgatitur atë që të ndër marrë sfida dhe përgjegjësi gjatë jetës në të gjitha kontekstet;*
- *Respektin dhe vlerësimin për përdorimin e gjuhës së shkruar, jo të shkruar dhe të folur në mënyrë të saktë dhe të përshtatshme;*
- *Vetëdijen për vlerat e teksteve në format e shumta të tyre për të pasuruar perceptimet, për të rritur kuptimin e identitetit kulturor dhe për të krijuar përvoja të kënaqësisë estetike.*

Gjuha shqipe dhe letërsia do të orientojnë nxënësin drejt përvetësimit aktiv të informacionit, procesit kritik dhe interpretimit të informacionit nëpërmjet: koncepteve dhe procesit, njohurive dhe përmbajtjeve, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave.

Në rrethana të globalizmit, institucionet e arsimit të Kosovës kanë përcaktuar standardet për formatin e mësimdhënësit dhe të mësimdhënies së gjuhës shqipe. Është ky një dokument që mësimdhënësve të gjuhës shqipe u shërben si udhëzues për aktivitetet që përfshijnë përgatitjen e tyre për mësimdhënie, ngritjen profesionale dhe të vlerësimit.⁹¹⁵ Në Kosovë institucionalisht janë skicuar e përcaktuar cilësitë e mësimdhënies dhe llojet e njohurive, shkathtësive dhe pikëpamjeve që kanë të bëjnë me kompetencat kyçe (themelore) për përgatitjen e programeve për mësimdhënësit.

Për të realizuar synimet e kurrikulës së re shtrohet kërkesa që mësimdhënësi i gjuhës shqipe të jetë një autoritet i përgatitur në aspektin akademik dhe profesional, që: të përcjellë dhe të zbatojë kurrikulën e re zyrtare; të njohë mirë lëndën e gjuhës dhe të letërsisë shqipe; të krijojë një repertor të gjerë të artit profesionale dhe një stil personal të mësimdhënies; të planifikojë dhe përgatisë mirë orën e mësimin; të menaxhojë klasën mirë; të njohë dhe të aplikojë parimet e çmuarjes dhe vlerësimit të nxënësve dhe ta konsiderojë veten si një aktor të ndryshimeve, etj. Parimet e Kornizës së Re të Kurrikulës së Kosovës dhe filozofia e saj rreth mësimdhënies dhe të mësuarit, sipas mesazheve që burojnë nga ky dokument dhe sipas rezultateve të para nga pilotimi, parashohin një numër kërkesash që një mësimdhënës duhet t'i përmbushë në bazë të parimeve, standardeve dhe objektivave që paraqet ajo. Sipas Kornizës së Re të Kurrikulës së Kosovës, mësimdhënësit e gjuhës shqipe dhe të letërsisë duhet:

- *Ta kuptojnë lëndën të cilën e japin;*
- *Të veprojnë si moderatorë të nxënies;*
- *Të balancojnë metodat e reja dhe ato tradicionale në mësimdhënie dhe vlerësim;*
- *Të aplikojnë qasje konstruktive ndaj mësimdhënies dhe nxënies;*
- *Të zhvillojnë shkathtësi të nivelit të lartë;*
- *Të përdorin metoda pedagogjike të bashkëpunimit me nxënësin në qendër;*
- *Të kenë kujdes në identifikimin dhe zhvillimin e potencialit individual për secilin nxënë;*
- *T'iu ndihmojnë nxënësve të zhvillojnë vetëbesimin, përgjegjësinë dhe shkathtësitë;*
- *Të krijojnë dhe mirëmbajnë një mjedis pozitiv dhe të ngrohtë ku nxënësit do të ndihen të sigurt dhe të rehatshëm;*

⁹¹⁵ MASHT, *Standardet e Praktikës Profesionale*, Prishtinë, 2011.

- Të forcojnë zhvillimin e zemërgjerësisë dhe tolerancës;
- Të shfytëzojnë udhëzimet e planifikimit për zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës;
- Të krijojnë përvojë kuptimplotë të të mësuarit për nxënësit;
- Të sigurojnë se nxënësit me nevoja të posaçme kanë të drejtë arsimimi njësoj si të tjerët;
- Të bëjnë përpjekje rreth të mësuarit të përjetshëm.
- Të kërkojnë bashkëveprim me mësimdhënës të tjerë, me familjen dhe komunitetin e gjerë.⁹¹⁶

8.1.2. Qasje të reja të mësimdhënies së gjuhës shqipe në Kosovë

Shkollat e Kosovës, si institucione të organizuara dhe të specializuara për mësimin dhe edukimin e nxënësve, sipas këtij dokumenti, kanë objektiva shumëfunktionale, si: akademike, profesionale, shoqërore dhe qytetare në shoqërinë demokratike. Që nga fillimi i shekullit të ri, shkollat në këtë shtet të ri po kthehen në vendin ku merren njohuri, por edhe në vatra ku mësohet të jetohet në një shoqëri miqësie dhe solidariteti me rrezatim të kësaj fryme edhe te nxënësit. Mësimdhënia dhe të nxënit janë dy kahet e një procesi, i cili mundëson përvetësimin e programit mësimor nga nxënësit. Kjo fushë është mjaft komplekse dhe delikate për t'u vëzhguar, analizuar dhe vlerësuar, është: "Veprimtari ndërpersonale, është akt i të dhënit mësim i drejtuar nga mësuesi, i cili planifikon dhe organizon zhvillimin e procesit mësimor dhe të të nxënit, që zhvillohet në proceset e: paraveprimit, bashkëveprimit me nxënës dhe bashkëpunëtorë të tjerë në mësim dhe pasveprimit që ka për qëllim analizën dhe vlerësimin e punës mësimore të zhvilluar. Mësimdhënia është ajo që lehtëson procesin e të nxënit të nxënësve përmes realizimit të strategjive të llojllojshme e të përshtatshme mësimore me forma, metoda, të cilat bëjnë që të ndërrohet roli i nxënësit dhe të mësimdhënësit ku nxënësi bëhet aktor kryesor (subjekt aktiv) e jo spektator i thjeshtë." Realizimi i strategjive efikase (formave, metodave, teknikave) mundëson alternativa të shumta në procesin e të nxënit dhe kjo bën që te nxënësit të zhvillojë aftësi komunikative, nxit diversitetin në të nxënit e nxënësve dhe kreativitetin e tyre.

8.2. PARIMET E ZBATIMIT TË KURRIKULIT TË RI TË KOSOVËS

Në dekadën e parë të këtij fillimshkulli të ri, sektori i arsimit në Kosovë po karakterizohet me një përpjekje intensive reformuese. Ky synim ka marrë udhë të mbarë me rritjen e cilësisë së arsimit .Në këtë përpjekje, në Kosovë janë miratuar akte të shumta ligjore e nënligjore, janë ndërtuar shumë shkolla me objektiva të qartë për përmirësimin e kurrikulave dhe hartimin e teksteve të reja shkollore.Reformat arsimore, kanë nxjerrë një varg sfidash për zbatimin e politikave të reja për arsimin e detyruar parafillor dhe arsimin e mesëm të lartë. Sfidat me të cilat ballafaqohet mësimdhënia e gjuhës shqipe në shekullin e ri janë: nevoja për ndërtimin e një shoqërie të dijes;integrimi në epokën digjitale;rritja e ndërvarësisë dhe e lëvizshmërisë dhe të mësuarit për të jetuar . Mësimdhënia e gjuhës shqipe po pëson reformë të thellë në harmoni me kërkesat që burojnë nga kurrikula e re, duke vendosur themelet për ngritjen e cilësisë dhe barazisë në shërbimet arsimore për të gjithë nxënësit dhe ndërlidhjen e sistemit të arsimit .

⁹¹⁶ MASHT, *Korniza e Re Kurikulës të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2011.

8.2.1. Roli dhe funksioni i Kurrikulës së Re të Kosovës

Korniza e Kurrikulës së Republikës së Kosovës, si një tërësi e dokumenteve, ka të përcaktuara edhe masat për zbatimin e saj. Këto dokumente ndahen në dy komponentë kryesorë: Komponenti conceptual (Korniza e Kurrikulës së Kosovës) dhe Komponenti operativ (dokumentet shoqëruese, të cilat mundësojnë zbatimin e KKK-së në nivel të sistemit arsimor duke përcaktuar qartë pritshmërinë nga nxënësit, nga mësimdhënësit dhe nga shkollat). Dokumenti i Kornizës së Kurrikulës, përveç se rregullon tërë sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës, ka përkufizuar qëllimet e arsimit parauniversitar, kompetencat kryesore, parimet kryesore për të udhëhequr procesin, nivelet formale dhe profilet e arsimit, fushat e Kurrikulës dhe lëndët mësimore, hierarkinë e dokumenteve të Kurrikulës, llojet, kohën dhe mënyrën e vlerësimit, implikimet e Kurrikulës shtetërore për hartimin e materialeve të reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies, rolin e shkollës në funksion të zbatimit të reformës së Kurrikulës dhe planin e zbatimit të Kornizës së Kurrikulës.⁹¹⁷ Synimi kryesor i Kornizës së Kurrikulës së re është që qytetarët e Kosovës të ballafaqohen me sfidat e shekullit XXI dhe të gjenerojnë dije të reja konkurruese në mënyrë aktive për tregun global të punës. Edhe mësimi i gjuhës shqipe, sipas këtij dokumenti, ka për qëllim zhvillimin e dijes, të shkathtësive, të qëndrimeve dhe të vlerave që i kërkon shoqëria demokratike. Në këtë kontekst, qëllimet e arsimit janë: kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore; promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare; zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit; aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore; dhe zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë dhe aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës. Sipas përmbajtjeve të kësaj kurrikule, nxënësit do të aftësohen që të shfrytëzojnë në mënyrë kreative dijen dhe shkathtësitë e tyre në situata të ndryshme dhe kontekste të reja, si dhe të ushtrojnë shkathtësitë për mendim të pavarur dhe kritik.

8.3. KOMPETENCAT KRYESORE TË TË NXËNIT SIPAS KORNIZËS SË KURRIKULËS SË RE

Kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të dijeve, të shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat do t'u ndihmojnë nxënësve që të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë dhe të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënive të ndërvarura. Kompetencat e parapara me Kornizën e Kurrikulës rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënit, të cilat duhet t'i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parauniversitar. Në përputhje me qëllimet e arsimit të Kosovës, kompetencat kryesore të parapara për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës janë:

- *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;*
- *Kompetenca e të menduarit;*
- *Kompetenca e të mësuarit;*
- *Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis;*

⁹¹⁷ MASHT, *Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2011.

- *Kompetenca personale*
- *Kompetenca qytetare.*⁹¹⁸

Tabela 47. Kompetencat kryesore dhe nënkompetenca të tjera operationale

Kompetencat kryesore	Rezultati përfundimtar
<p>1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</p> <p>Komunikimi nëpërmjet gjuhës amtare</p> <p>Komunikimi nëpërmjet gjuhëve të huaja</p> <p>Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të... tjera artistike</p> <p>Komunikimi nëpërmjet teknologjisë informative</p> <p>Angazhimi dhe kontributi për dialog produktivo</p> <p>Respektimi i rregullave të komunikimit</p> <p>Dhënia dhe pranimi i informatës kthyesë në mënyrë konstruktive</p> <p>Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim</p> <p>Inicimi i veprimeve konstruktive</p>	Komunikues efektiv
<p>2. Kompetenca e të menduarit</p> <p>Kompetencat matematikore dhe kompetencat themelore në shkencë dhe në teknologji</p> <p>Kompetencat digjitale</p> <p>Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit</p> <p>Zhvillimi i mendimit abstract</p> <p>Marrja e vendimeve të bazuara në informacione të verifikuara</p> <p>Lidhja e vendimeve me pasojat</p> <p>Vlerësimi dhe vetëvlerësimi</p> <p>Zgjidhja e problemeve</p>	Mendimtar kreativ
<p>3. Kompetenca e të mësuarit</p> <p>Mësimi për të mësuar</p> <p>Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit</p> <p>Zotërimi i mirëfilltë i leximit, i shkrimit, i matematikës, i shkencës, i teknologjisë së informacionit e komunikimeve</p> <p>Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme</p> <p>Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive</p>	Nxënës i suksesshëm

⁹¹⁸ MASHT, *Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2011.

<p>4. Kompetenca që ka të bëjë me punën, jetën dhe mjedisin</p> <p>Prezantim i vetvetes në paraqitjen më të mirë, duke theksuar zotësitë që posedon Punë e pavarur dhe si pjesë e ekipeve punuese Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore Dëshmim i shkathtësive ndërmarrëse, i njohurive për planifikim të punës, i shfrytëzimit racional të kohës Zotërim i aftësive për menaxhim të konflikteve dhe vlerësim të rreziqeve Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme Angazhim në mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit</p>	<p>Kontribuues produktiv</p>
<p>5. Kompetenca personale</p> <p>Dëshmim i të njohurit të vetes dhe të tjerëve Dëshmim i vetëbesimit enaxhim i emocioneve dhe i stresit Shfaqje e bashkëndjesisë për të tjerët Dëshmim i aftësive për të bërë jetë të shëndoshë Bërja e zgjedhjeve të përgjegjshme për shëndetin personal</p>	<p>Individ i shëndoshë</p>
<p>6. Kompetenca qytetare</p> <p>Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore Mirëkuptim dhe respektim i dallimeve ndërmjet njerëzve Tolerancë dhe respekt për të tjerët Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetën personale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.</p>	<p>Qytetar i përgjegjshëm</p>

Sipas Kurrikulës së re, sasia e orëve për fushën ‘Gjuhët dhe komunikim’ janë ndarë në mënyrë të baraspeshuar në përqindje, duke pasur parasysh moshën e nxënësit dhe nevojat zhvillimore. Këtu po jap vetëm minimumin e kohës së rezervuar për këtë fushë. Në pjesën e mëvonshme, kur të bëjmë analizën e Kurrikulës Bërthamë për nivele dhe shkallë, do të paraqitet plani mësimor më i specifikuar me fondin e orëve për fushën Gjuhët dhe komunikimi.

	SNKA 0		SNKA 1		SNKA 2		SNKA 3	
Fushat e Kurrikulës	ShK1		ShK2	ShK3	ShK4	ShK5&6 Arsimi i përgjithshëm	ShK5&6 Arsimi dhe aftësimi profesional	
	Parafillori	Klasa 1 & 2						
Gjuhët dhe komunikimi	33.33%	38.10%	33.33%	25.00%	26.67%	20.00%	15.63%	

8.4. APLIKIMI I KURRIKULËS BËRTHAMË

Qëllimet e fushës ‘Gjuhët dhe komunikimi’ në arsimin parauniversitar, janë të paraqitura në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës, gjegjësisht në Kurrikulat Bërthamë të të tri niveleve formale të arsimit parauniversitar. Pjesë e Kurrikulës Bërthamë janë edhe rezultatet e të nxënit për kompetenca, rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare të secilës shkallë kurrikulare. Qasjet e arritjes së qëllimeve duhet t’u përshtaten moshës dhe mundësive të nxënësve të secilit nivel formal, përkatësisht secilës klasë.

- *Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore;*
- *Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare;*
- *Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;*
- *Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;*
- *Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë;*
- *Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.*⁹¹⁹

Lënda gjuhë dhe letërsi shqipe, në qendër ka fushën e kurrikulës ‘Gjuhët dhe komunikimi’. Qëllimet e mësimi të gjuhës shqipe bëhen pjesë e planifikimeve mësimore për secilën fushë të kurrikulës, secilës klasë, si të planifikimeve vjetore, mujore, javore, ditore dhe pjesë e procesit mësimor që zhvillohet në klasë dhe jashtë saj. Në funksion të arritjes së qëllimeve duhet të jenë edhe këto aktivitete të udhëhequra nga mësimdhënësi:

- *Përzgjedhja e rezultateve për kompetencat që synohen të arrihen gjatë periudhave të caktuara përmes përmbajtjeve (temave dhe njësive mësimore) dhe aktiviteteve brenda dhe jashtë orës mësimore;*
- *Përzgjedhja apo adaptimi i rezultateve të fushës për lëndën mësimore të secilës klasë (nga planet dhe programet ekzistuese që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare);*
- *Përzgjedhja e përmbajtjes mësimore (temave apo njësive mësimore);*
- *Përzgjedhja e metodologjive të mësimdhënies dhe të nxënit;*
- *Përzgjedhja e materialeve dhe burimeve mësimore;*
- *Përzgjedhja e metodologjive, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit;*
- *Krijimi i klimës në klasë dhe shkollë në favor të arritjes së qëllimeve.*

8.4.1. Qëllimet dhe funksionet e fushës kurrikulare ‘Gjuhët dhe komunikim’

Sipas Kornizës së Re Kurrikulare, qëllimet e fushës ‘Gjuhët dhe komunikimi’ në mësimdhënien e shekullit të ri janë zhvillimi:

- *I shkathtësive të komunikimit (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit);*
- *I shkathtësive të të shprehurit nëpërmjet mjeteve auditive, vizuale dhe informative;*
- *I shkathtësive të komunikimit nëpërmjet të teknologjisë informative dhe*

⁹¹⁹ MASHT, *Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2011.

- *Formimi i përgjithshëm gjuhësor, letrar, kulturor dhe jetësor.*⁹²⁰

Gjuha amtare në kushtet bashkëkohore të zhvillimit të shoqërisë po merr funksion të rëndësishëm, ngase gjuha shqipe më nuk është mësim në vetvete, por është mjet me të cilin mësohen edhe lëndët e tjera mësimore (kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit), që gjatë procesit të të nxënimit, nxënësin e mëson të mbajë qëndrim për atë që e mëson dhe të jetë kreativ (kompetenca e të nxënimit, kompetenca e të menduarit, kompetenca personale). Prandaj, qëllimi i mësimimit të gjuhëve është përgatitja e nxënësit që të jetë qytetar aktiv i shoqërisë (kompetenca për jetë, punë dhe mjedis, kompetenca qytetar i përgjegjshëm). Kështu, për t'u zhvilluar procesi i mësimdhënies dhe procesi i të nxënimit të fushës Gjuhët dhe komunikimi, niveli i dytë dhe i tretë i arsimit parauniversitar realizohen përmes aftësisë për të komunikuar (të dëgjuarit, të folurit, leximi dhe shkrimi), aftësia për të kuptuar tekstet dhe analizën e tyre, aftësia për të menduarit kritik dhe kreativ, të shprehurit e identitetit dhe kulturës, zotërimi i gjuhës dhe të shprehurit në medie, si dhe përdorimi i shkathtësive të teknologjisë informative për të komunikuar dhe të shprehur. Fusha gjuhët dhe komunikimi përbëhet nga gjuhët amtare, gjuha e parë e huaj (gjuha angleze), gjuha e dytë e huaj (gj. gjermane, gj. frënge etj.) dhe gjuhët e mjedisit, që si qëllim kanë zhvillimin e shkathtësive të komunikimit (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit, kuptimi dhe analiza e teksteve letrare dhe joletrare, përdorimi i gjuhës për qëllime dhe auditorë të ndryshëm). Fusha 'Gjuhët dhe komunikimi' bazohet në këto koncepte të mësimdhënies:

- *Tekstet letrare dhe joletrare;*
- *Gjuha figurative dhe jofigurative;*
- *Pjesët skenike, teatri, dramatizimi etj;*
- *Historia, teoria, kritika, romantizmi, realizmi, letërsia antike, letërsia moderne;*
- *Sistemi i gjuhës (gramatikë, leksik, fonetikë, sintaksë, drejtshkrim).*

Mbështetur në Kornizën Bërthamë të fushës Gjuhët dhe komunikimi, këto koncepte kanë të bëjnë me arritjet në zhvillimin e:

- *Leksikut dhe zhvillimit të tij;*
- *Dëgjimit dhe të kuptuarit me gojë;*
- *Të folurit në funksion të dhënësit dhe marrësit të informacionit;*
- *Leximit, të kuptuarit e teksteve me shkrim;*
- *Shkrimin, prodhimi i teksteve të shkruara / diskutet koherente;*
- *Këndvështrimin, vëmendje në mjetet vizuale / informacionit;*
- *Formimit, duke përdorur mjete vizuale në të shprehur.*

Mësimi i fushës kurrikulare 'Gjuhët dhe komunikimi' ka për qëllim përmbushjen e gjashtë kompetencave të KKK-së, gjegjësisht arritjen e rezultateve të paraqitura për këto kompetenca, që këkohet të arrihen në fund të çdo shkalle të Kurrikulës. Kompetencat integrohen në mënyrë të balancuar dhe përfshijnë njohuritë, shkathtësitë qëndrimet dhe vlerat. Përdorimi i teknologjisë informative, zgjidhja e problemeve, aftësitë e të menduarit, përpunimi i informacionit, të menduarit dhe të shprehurit krijues.

⁹²⁰ MASHT, *Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*, Prishtinë, 2011.

Në fushën ‘Gjuhët dhe komunikimi’ nxënësi duhet të arrijë këto kompetenca:
Të dëgjuarit e teksteve informative, të dëgjuarit e efektshëm (shqiptimi i tingujve, pasurimi i fjalorit), të dëgjuarit dhe pasurimi i leksikut, të folurit në funksion të marrësit dhe të dhënësit të informacionit, të folurit aktiv në grup, të folurit në funksion të pasurimit të leksikut, komunikimi verbal dhe joverbal, të lexuarit në funksion të njohjes së teksteve të ndryshme letrare dhe joletrare, kuptimi i leximit, leximi i teksteve prezantuese, të shkruarit, kompetencat dhe njohuritë e dëshmuara në shkrim, aftësitë dhe të kuptuarit⁹²¹

Tabela 48. Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit

Rezultatet e të nxënit
Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare–kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre;
Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) dhe përmbajta mësimore;
Rezultatet e të nxënit për klasë, në nivel të fushës kurrikulare apo lëndës mësimore, brenda shkallës kurrikulare.

8.4.2. Rezultatet e të nxënit

Rezultatet e të nxënit për kompetenca, për fushën ‘Gjuhët dhe Komunikimi’, për shkallët 3, 4, 5 dhe 6 të shkallëve kurrikulare janë kërkesa që po arrihen nga të gjithë nxënësit në fund të secilës nga këto shkallë. Ato janë njohuri, shkathtësi, qëndrime, vlera dhe rutina, të cilat zhvillohen te secili nxënës përgjatë klasave sa kanë këto shkallë. Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht arritja e rezultateve të tyre, bëhet përmes fushave kurrikulare. Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht arritshmëria e rezultateve të tyre, bëhet përmes fushave kurrikulare.⁹²² Nuk do të thotë që domosdo secila fushë kurrikulare si e vetme të arrijë të gjitha rezultatet e të gjitha kompetencave. Mund të ndodhë që disa rezultate të njëjta të kompetencave të jenë pika synuese për disa fusha kurrikulare, por mund të ndodhë që disa të përzgjidhen nga një fushë e vetme. Për shembull: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – komunikues efektiv, shkalla e pestë (klasat X dhe XI), rezultati 9 i kompetencës: Përdor TIK-un në mënyrë efektive gjatë komunikimit dhe ndërveprimit me të tjerët në jetën e përditshme, duke përfshirë edhe të nxënit e informatave të reja dhe kryerjen e detyrave shkollore – është rezultat që duhet të arrihet përmes të gjitha lëndëve dhe të gjitha fushave kurrikulare. Ndërkaq, rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare (RNF)⁹²³ janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme të fushës përkatëse dhe janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore. Me rastin e përzgjedhjes së rezultateve të të nxënit të fushës së caktuar kurrikulare, të cilat synojmë t’i arrijmë me nxënës në klasë të caktuara, së pari identifikohen konceptet e fushës kurrikulare, nga të cilat dalin rezultatet e caktuara.⁹²⁴

⁹²¹ Udhëzuesi mbështet zbatimin e KKK-së, respektivisht KB-ve, për nivelin e dytë dhe të tretë të arsimit parauniversitar (klasat 6-9 dhe 11-12). Shembujt e modeleve praktike të planifikimeve mësimore për shkallë, për fushë dhe për lëndë, shembujt e metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit, ndihmojnë ndërlidhjen e kurrikulës dhe rezultateve me punën mësimore në shkollë.

⁹²² Të gjitha fushat kurrikulare apo lëndët mësimore që realizohen/zhvillohen në klasat 6,7,8,9,10,11,12 duhet të kontribuojnë bashkërisht në arritjen e rezultateve të kompetencave të shkallës së tretë, të katërt, të pestë dhe të gjashtë.

⁹²³ (RNF) Këto akronime janë shkurtesa për Rezultatet e të nxënit për shkallë (kompetencë).

⁹²⁴ Shih shembullin e ndërlidhjes së rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare (RNF) me konceptet e fushës kurrikulare.

Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare na ndihmojnë në përzgjedhjen e përmbajtjes mësimore (temave mësimore) për fushën lëndore për secilën klasë . Duke pasur parasysh parimin e mësimdhënies së integruar dhe koherente, mësimdhënia përmes temave të përbashkëta për lëndët mësimore do të jetë në funksion të respektimit të saj. Kjo do të thotë se secila lëndë mësimore duhet të arrijë rezultatin e fushës përmes temës së përbashkët të fushës, por secila nga këndi i vet, me njësi mësimore të lëndës së vet.

Tabela 49. Shembulli i fushës kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi

Hapi 1	Hapi 2	Hapi 3
KONCEPTI	RNF	TEMA MESIMORE
Tekstet letrare dhe Joletrare.	Kupton dhe analizon karakteristikat gjinive, llojeve, zhanreve të letërsisë (tregim, novelë, roman, poezi, tekste informative), si dhe analizon stilin, gjuhën dhe qëllimin e tyre, duke vlerësuar vlerat e paraqitura në to.	Llojet e tregimeve romaneve (historik, Social, fantastik, shkencor etj). Figurat stilistike.

Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare në Kurrikulën Bërthamë paraqiten për shkallë, e jo për klasë mësimore, dhe konsiderohet si nevojë hartimi i rezultateve të të nxënit për klasë, respektivisht lëndë mësimore, sepse sigurohet lidhshmëria dhe mosngarkesa e njëres klasë brenda një shkalle kurrikulare. Hartimi i rezultateve të të nxënit mund të bëhet nga vetë mësimdhënësit, por edhe të merren nga planet dhe programet ekzistuese. Nëse shfrytëzohen planet dhe programet ekzistuese, atëherë shkrimi i tyre bëhet duke i krahasuar rezultatet e pritshme të lëndëve mësimore të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të kurrikulës bërthamë. Në këtë rast bëhet përzgjedhja e rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese që janë në funksion të arritjes të secilit rezultat të të nxënit të fushës kurrikulare të Kurrikulës Bërthamë. Nëse rezultatet e pritshme të përzgjedhura nga planet dhe programet nuk e përmbushin në tërësi rezultatin e caktuar të fushës kurrikulare, atëherë mund të shkruhen edhe rezultate të reja. Rezultatet e fushës kurrikulare apo lëndës mësimore për klasë na ndihmojnë në përcaktimin e njësive mësimore, të cilat janë në funksion të temës së përbashkët të fushës kurrikulare.

Tabela 50. Ndërlidhja e RNSH me RNF dhe RNL në klasën e dhjetë ⁹²⁵

Hapi 1	Hapi 2	Hapi 3
RNSH (KOMPETENCA)	RNF- GJUHË DHE KOMUNIKIM	RNL
REZULTATI KURRIKULAR (kompetenca e të menduarit) - Krahason të paktën tri burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës së njëjtë, argumenton	REZULTATI I TË NXËNIT: Analizon dhe argumenton për format dhe gjinit letrare dhe artistike tradicionale, shqypton stilet dhe metodat artistike (lidhjet dhe	NXËNËSI/NXËNËSJA NË FUND TË klasës së dhjetë do të bëjë dallimet në mes të diskurseve dhe në mes të formave të ndryshme letrare, do të njohë format dhe idetë themelore të

⁹²⁵ Rezultate të të nxënit për shkallë-kompetencë (RNSH).

saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë. I prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme duke teknologjinë informative.	ndikimet midis tyre) në periudha të caktuara të zhvillimit të historisë dhe shoqërisë.	letërsisë antike, të mesjetës dhe të letërsisë së vjetër shqipe.
---	--	--

Mësimdhënësi bashkëkohor në shkollat e Kosovës, pas gjithë ndryshimeve ligjore, të zhvillimit profesional dhe pas ndryshimeve të dokumentit bazik të Kurrikulës, pasi që njihen dhe pasi të kenë analizuar informacionet e dhëna për kuptimin dhe funksionin e rezultateve të të nxënit, udhëzimet se si vijmë deri te rezultatet e të nxënit për lëndë mësimore, hartohen bashkërisht nga mësimdhënësit e fushës së kurrikulës, rezultatet e të nxënit për klasë sipas lëndëve mësimore: Vendosën rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të lëndëve mësimore që korrespondojnë me RNF të KB-ve; Vendosën rezultatet e pritshme që duhet të shtohen në planet dhe programet e lëndëve mësimore, me qëllim të arritjes së rezultateve të fushës së kurrikulës Gjuhët dhe komunikimi dhe Vendosën rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL) të fushës Gjuhët dhe komunikimi.⁹²⁶

Aktiviteti mbështetet në krahasimin e rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushës së Kurrikulës Bërthamë (KB), për çdo lëndë dhe për çdo klasë.⁹²⁷

8.4.3. Aspekte metodologjike dhe praktike të fushës kurrikulare ‘Gjuhët dhe Komunikim’

Në planifikimet e procesit mësimor, për zbatimin praktik kanë ndihmuar edhe një sërë studimesh të kësaj fushe duke ofruar informacione teorike për fushën ‘Gjuhët dhe komunikimi’ dhe për zbatimin në praktikë⁹²⁸ të kësaj fushe kurrikulare. Fusha ‘Gjuhët dhe komunikimi’, përveç se “...u ofron nxënësve zotërim të njohurive, ajo u mundëson edhe të shprehur të efektshëm dhe kreativitet. Kjo arrihet përmes kuptimit të koncepteve, zhvillimit të shkathtësive të komunikimit, si: të dëgjuarit e teksteve informative, të dëgjuarit e efektshëm (shqiptimi i tingujve, pasurimi i fjalorit), të dëgjuarit dhe pasurimi i leksikut, të folurit në funksion të marrësit dhe të dhënësit të informacionit, të folurit aktiv në grup, të folurit në funksion të pasurimit të leksikut të komunikimit verbal dhe joverbal, të krijimit të shijes artistike, dëshirës për të lexuar etj”, bënë edhe ndërlidhjen në mes të fushave të tjera, lidhjet ndërkurrikulare, si dhe përdorimi i teknologjisë informative.

⁹²⁶ Hapi i parë: Rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Gjuhët dhe komunikimi, nga KB ;

Hapi i dytë: Rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të lëndëve mësimore që korrespondojnë me RNF;

Hapi i tretë: Rezultatet e pritshme që duhet të shtohen në planet dhe programet e lëndëve mësimore ;

Hapi i katërt: Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL) , të cilat punohen sipas kësaj ecurie.

⁹²⁷ Tabela për krahasimin e rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushës së Kurrikulës. Bërthamë (KB) është e vlefshme për një shkallë, do të thotë për sa klasë që ka shkalla për një gjeneratë. Procedurë e njëjtë duhet të ndiqet për të gjitha shkallët, si për shkallën 1, si për shkallën 2, si për shkallën 3... apo shkallën 6.

⁹²⁸ IPK, Udhëzuesi praktik për zbatimin e Kurrikules-Fusha e kurrikulës (Gjuhët dhe Komunikimi), Prishtinë, 2014. (Ky udhëzues praktik është konceptuar në atë mënyrë që të ofrojë informacione teorike për fushën.)

Planifikimi i punës mësimore (Plani mësimor) kalon nëpër këto etapa:

Plani i shkallës kurrikulare;

Plani vjetor;

Plani dymujor;

Plani javor;

Plani i orës mësimore.

Plani mësimor

Para se të bëhet planifikimi më i detajuar i procesit mësimor (planifikimit vjetor, mujor) për një vit shkollor, së pari duhet përcaktuar saktësisht planin mësimor për klasën, përkatësisht vitin shkollor (mësimor). Didaktët bashkëkohorë për mësimdhënësit kanë porosi që para se të fillohet me planifikimin, Kurrikulën Bërthamë, kërkohet për t'i lexuar me kujdes rezultatet e të nxëniet të fushës kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi, duhet lexuar me kujdes rezultatet e të nxëniet për kompetenca, e sidomos të kompetencës komunikues efektiv, se cili mund të jetë niveli i arritjes së gjuhës së huaj nga nxënësit e kësaj moshe – për të pasur parasysh kriterin e mësimin të gjuhës, e cila kërkon vazhdimësi, jo në një vit të mësohet e në vitin tjetër të mos mësohet, pastaj prapë të fillohet.⁹²⁹

Tabela 51. Plani mësimor (shembull i ndarjes së orëve, sepse shkolla vendos)

Shkalla 3	Fusha 3	Lënda	Nr. i orëve	Përqindja (%) e orëve
Klasat 6-7	Mësimore dhe Gjuhët dhe komunikimi (14 orë në javë)	Gjuhë amtare Gjuhë angleze Gjuhë e dytë e huaj.	Kl.6 4	57.14 %
			Kl.7 4	
			Kl.6 2	28.57 %
			Kl.7 2	
			Kl.6 1	
Kl.7				

Në planifikimin e shkallës kurrikulare për fushën Gjuhët dhe komunikimi, sipas udhëzimeve të reja didaktike marrin parasysh rezultatet e të nxëniet për shkallë – kompetenca (RNSH) dhe rezultatet e të nxëniet për fushën Gjuhët dhe komunikimi, që janë të përcaktuara në KKK dhe në Kurrikulën Bërthamë (KB). Planifikimi për shkallët kurrikulare 3, 4, 5 dhe 6 janë pikë referimi për planifikimet e tjera, si: planifikimi vjetor, dymujor, javor dhe planifikimi i njësisë mësimore.

Tabela 52. Plani për shkallë kurrikulare / shkalla e pestë – klasa 10

RNSH për kompetenca	Konceptet për fusha joletrare.	RNF - Gjuhët dhe komunikimi	Temat mësimore
Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit- Komunikues Efektiv I.1,2,4,5,6,7.	* Gjuha figurative dhe jofigurative.	1. Të dëgjuarit dhe të folurit përdor gjuhën për të arritur efekte të veçanta, duke shqyrtuar tekste letrare dhe joletrare dhe	Epi I Gilgameshit. Letërsia klasike greke dhe latine. Letërsia e Mesjetës. Kulturë tradicionale. Struktura e fjalës, fjalive,

⁹²⁹ MASHT & SWAP, *Udhëzuesit për zbatim të KKK-së*, Prishtinë, 2012.

	*Njohuri gjuhësore.	paraqet vështrim të përgjithshëm përmes ideve dhe pikëpamjeve të veta dhe si krijimet artistike ndikojnë në interes, idetë, qëndrimet dhe vlerat e tyre.	ndërtimi i tekstit.
--	---------------------	--	---------------------

Rezultatet e të nxënësve për shkallë kurrikulare (kompetenca) dhe përshkrimi i fushës Gjuhët dhe komunikimi në KKK kanë qenë bazë për hartimin e rezultateve për fushë në KB. Nga RNSH dalin konceptet e fushës dhe nga RNF dalin temat mësimore.

Elementet përmbajtjesore të një plani vjetor

Plani vjetor i bazuar në Kornizën e re të Kurrikulës përmban këto elemente kryesore, si: i referohet fushës kurrikulare ‘Gjuhët dhe komunikimi’; rezultatet e kompetencave (rezultatet e të nxënësve për shkallën e caktuar); konceptet e fushës kurrikulare, marrë nga KB-të për shkallën e caktuar; rezultatet e fushës së Kurrikulës Bërthamë, marrë nga KB për shkallën e caktuar; temat mësimore për një vit mësimor që përcaktohen nga mësimdhënësit e fushës kurrikulare ‘Gjuhët dhe komunikimi’. Temat shpërndahen (organizohen) në pesë planifikime dymujore. Fusha kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi është një kategori e gjerë mësimore që grupon lëndët Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Gjuha shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare, Gjuhë e dytë e huaj dhe gjuhët e tjera⁹³⁰, që kanë qëllime dhe detyra të përbashkëta për mësimin e dijes, shkathtësive, vlerave, qëndrimeve dhe besimeve nga kjo fushë.⁹³¹ Plani vjetor si dokument, i cili e orienton zhvillimin e mësimin për një vit shkollor duke i përmbushur kërkesat e shkollës kurrikulare, respektivisht rezultatet e kompetencave, i ndan apo i thjeshtëson për klasën e caktuar. Planifikimi vjetor për fushën Gjuhët dhe komunikimi ka për qëllim identifikimin e rezultateve të të nxënësve të kompetencave, të cilat mund të jenë si synim i arritjeve gjatë një viti shkollor (mësimor).

Tabela 53. Hapat e planifikimit vjetor / shkalla 5 (klasa 10)

Hapi 1	Hapi 2	Hapi 3	Hapi 4
Konceptet	RNF - Rezultatet e të nxënësve për fushën kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi	Temat mësimore	Rezultatet e të Nxënësve për Shkallë - RNSH - për kompetenca.

Planifikimi vjetor së bashku me shpërndarjen e temave për çdo dy muaj, me rastin e përzgjedhjes të temave mësimore duhet pasur parasysh përvojat, interesat dhe mundësitë e nxënësve. Madje, temat duhet të sigurojnë integritet brenda lëndës, fushës dhe fushave kurrikulare. Mbështetur në udhëzimet e didaktëve të kësaj fushe, tabela me format të njëjtë mund

⁹³⁰ Gjuhët e tjera fillojnë në shkallën e pestë të kurrikulës – në gjimnaze dhe shkolla profesionale.

⁹³¹ Bashkimi i këtyre lëndëve në fushën e kurrikulës Gjuhët dhe komunikimi shtron kërkesë që mësimdhënësit e kësaj fushe të zhvillojnë së bashku planifikimin mësimor duke u mbështetur në rezultatet e të nxënësve për fushë, specifikat e fushës dhe të lëndëve të fushës.

të përdoret për planifikim për secilën klasë. Planifikimi për të gjitha fushat kurrikulare të jetë i shkurtër dhe i qartë. Me rastin e planifikimit të temave mësimore merren për bazë konceptet e fushës kurrikulare dhe rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare (RNF). Gjatë hartimit të planeve vjetore sipas metodologjive bashkëkohore, të Konceptet e fushës kurrikulare shënohen vetëm ato koncepte, të cilat trajtohen në klasën e caktuar, por të gjitha ato domosdoshmërisht duhet trajtuar gjatë shkallës kurrikulare. Konceptet merren nga KB për nivelin përkatës. Në rubrikën e emëruar “Rezultatet e të nxënit” të fushës kurrikulare vendosen rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temë mësimore, pra vetëm ato nga të cilat dalin temat mësimore - origjinale merren nga KB. Pastaj te rubrika e emëruar ‘Temat mësimore’ që trajtohen gjatë një viti mësimor për secilin fushë kurrikulare shënohen të gjitha temat, që do të trajtohen brenda një viti shkollor (mësimor). Në këtë tabelë shkruhen vetëm temat e jo njësitë mësimore. Temat mësimore janë të vlefshme për të gjitha lëndët që ka një fushë kurrikulare. Ndërsa, në rubrikën e emëruar ‘Temat mësimore’ bëhet shpërndarja e temave të përzgjedhura për një vit mësimor për muaj. Brenda dy muajve mund të jenë disa tema mësimore, 1, 2 tema apo më shumë, varësisht sa mësuesi mendon se janë të nevojshme të trajtohen brenda muajve (preferohet numri i vogël i temave). Disa tema mund të jenë prezente edhe në muajt e tjerë, kuptohet me njësi të reja mësimore. Renditja e temave për muaj sugjerohet të bëhet sipas një rendi logjik.

Mësuesi i përcakton se cilat kompetenca – rezultate të të nxënit për shkallë- kompetenca synon t’i arrijë përmes fushës kurrikulare gjatë një viti mësimor, respektivisht përmes temës mësimore. Mësimdhënësit duhet të vendosin se cilat nga rezultatet e të nxënit të një shkalle do të synojë t’i arrijë në secilën klasë.⁹³²

Plani dymujor pikë referimi dhe buron nga planifikimi vjetor


Një formë e re, që buron nga Kurrikula e re, është planifikimi dymujor. Ky planifikim mbështetet në planifikimin vjetor, dhe ka formatin e një programi mësimor. Ky planifikim hartohet për dy muaj dhe mund të përfshijë një apo më shumë tema mësimore. Planifikimi dymujor ka për qëllim zberthimin e temave mësimore në njësi mësimore, të cilat kanë për synim arritjen e rezultateve të identifikuara të të nxënit të shkallës kurrikulare (RNSH), të fushës kurrikulare (RNF) dhe rezultateve të lëndës RNL. Gjithashtu, ka për qëllim identifikimin e rrugëve (metodologjisë), mjeteve (materialeve) dhe burimeve për arritjen dhe vlerësimin e nivelit të arritjes së këtyre rezultateve.

Procesi i planifikimit dymujor zhvillohet në nivel të aktivitetit të fushës së kurrikulës Gjuhët dhe komunikimi (dhe në nivel të çdo fushe tjetër të kurrikulës). Aktiviteti profesional, duke u bazuar në rezultatet e fushës për shkallë të kurrikulës (p.sh: shkalla 5 e kurrikulës- klasat 10 dhe 11), përcakton temat mësimore për fushë të kurrikulës dhe rezultatet mësimore për lëndë/klasë.

Mësimdhënësi gjatë zberthimit të rezultatit të fushës nga e cila ka dalë tema mësimore në rezultatet e të nxënit për lëndë - klasë nga të cilat dalin njësitë mësimore, mund të shfrytëzojë planet dhe programet ekzistuese apo rezultatet përfundimtare marrë nga tabela krahasuese e rezultateve të fushës kurrikulare të KB, për shkallën e caktuar me rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese. (RN) së bashku me rezultatet e kompetencës ndikojnë edhe në përcaktimin e temave mësimore (TM) dhe në një mënyrë edhe të njësive mësimore (NJM) dhe bëhet sipas skemës si një rrugë e përcaktimit të njësive mësimore.

⁹³² Ka raste kur një rezultat i ndonjë kompetence mund të synohet të arrihet në dy klasë apo tri radhazi, kjo i mbetet mësimdhënësit të vendosë. Kujdes, rezultatet duhet të arrihen nga secili nxënës.

Graf. Zbërthimi i rezultateve të fushës kurrikulare (RNF) në rezultatet e të nxënit për lëndë/klasë (RNL)



Kështu vazhdohet të plotësohet tabela e planifikimit dymujor për të gjitha temat e dymujorit. Përzgjedhja e njësive mësimore, sikurse temat mësimore, duhet të jenë në përputhje me përvojat, mundësitë dhe interesat e nxënësve. Njësitë mësimore duhet të sigurojnë lidhshmërinë me temat mësimore dhe me rezultatet mësimore për lëndë si dhe për fushën 'Gjuhët dhe komunikimi' për shkallët kryesore përkatëse.

Plani javor- njësitë mësimore merren nga plani dymujor

Plani dymujor nuk është i ndarë në javë, kështu plani javor mundëson përcaktimin e njësive mësimore, të cilat do të realizohen gjatë javës për secilën lëndë mësimore (fushë kurrikulare) në klasën e caktuar. Njësitë mësimore merren nga plani dymujor, me qëllim të lidhshmërisë të njësive mësimore të lëndëve të ndryshme mësimore në kontekst të kuptimit të situatave, problemeve, dukurive dhe ngjarjeve si çështje të ndërlidhura e jo të ndara. Kjo qasje i obligon mësuesit që të takohen gjatë javës dhe që të bëhet lidhshmëria e njësive mësimore në mes lëndëve të ndryshme, në mënyrë që të nxënit e nxënësve të jetë më i integruar. Rasti i Kornizës së re të Kosovës ka sjellë edhe një qasje të re të prezantimit të planit javor para të gjithë mësimitdhënësve si një qasje e re në traditën e planifikimit mësimor.

Plani i orës mësimore bën të zbatueshëm punën e drejtpërdrejtë me nxënësit

Konkretizimi i gjithë planifikimit bëhet përmes Planit të orës mësimore. Me këtë planifikim procesi mësimor bëhet i zbatueshëm në punën me nxënësit në klasë, por edhe jashtë saj brenda një ore mësimore. Në këtë planifikim mësimitdhënësi përcakton: njësinë mësimore të cilën do ta realizojë (njësia mësimore merret nga plani dymujor, përkatësisht plani javor); rezultatet e synuara të fushës kurrikulare (mund të vendosen vetëm rezultatet e lëndës mësimore që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare - edhe këto merren nga plani dymujor. Të gjitha rezultatet e kompetencave, të fushave kurrikulare dhe të lëndëve mësimore, janë pjesë e planifikimit vjetor, e më pas të planifikimit dymujor, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të saktë të realizimit, përkatësisht arritshmërisë së tyre. Mbi bazën e rezultateve të

kompetencave dhe të fushës kurrikulare, mësimdhënësi e elaboron orën mësimore, duke përcaktuar edhe elemente të tjera, të cilat i sheh të nevojshme. Mënyra organizative e orës - metodologjia e mësimdhënies dhe e vlerësimit, metodat, teknikat, mjetet dhe burimet që shfrytëzohen për realizim të njësisë së orës mësimore, kërkohet të jenë në funksion të rezultateve të të nxënit të planifikuar për arritje.

Tabela 54: Një model i Planit të orës mësimore të gjuhës shqipe

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Fusha kurrikulare: Gjuhët dhe komunikimi / Lënda: Gjuhë shqipe/ Shkalla e kurrikulës: 3 / Klasa: 7
Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Sistemi gjuhësor (gramatikë, leksik, fonetikë, sintaksë, drejtshkrim)
Tema / njësia mësimore: Njohuri gjuhësore
Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën 3: I. 5,6; II 7, 8; III. 1, 3, 5,7; IV.2.
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën 3: 1,2,4,7,8,9
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE
Fjalët kyç: dialekt, standard gjuhësor, gegë, toskë, lumi Shkumbin, jug, veri.
Rezultatet e të nxënit:
Dallon gjuhën standarde nga gjuha dialektore;
Kthen në gjuhën standarde një tekst të shkruar në dialekt;
Krahason dialektet kryesore të gjuhës shqipe.
Kriteret e suksesit:
Tregon me saktësi dy dialektet qendrore të gjuhës shqipe dhe territoret në të cilat fliten ato; Tregon ndryshimet në fjalët e shkruara në dialekt dhe të njëjtat në gjuhën standarde; Krahason me saktësi përmbajtjen e një teksti me dialektet kryesore të gjuhës shqipe.
Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gjuha shqipe 7, harta..., tekste të vjetra shqipe, tekst i shkruar në dialekt, fotografi.
Përdorimi i TIK-ut: Prezantim me projektor, video-incizim.
Çështjet e ndërlidhura: Gjeografi - territoret ku fliten dy dialektet kryesore të shqipes dhe vendndodhja e lumit i cili i ndan ato.
Histori - Zhvillimet e gjuhës shqipe nga periudha e dokumenteve të para të gjuhës shqipe, Kongresi i Manastirit, drejtshkrimi i gjuhës shqipe dhe deri më tani.

Mësimdhënësi i gjuhës shqipe gjatë një ore mësimore me Kurrikulën e re kërkohet:

- Të planifikojë zhvillimin e orës mësimore – bën planin e orës mësimore;
- Të paraqesë rezultatet e të nxënit në fillim të çdo ore mësimore që duhet arritur;
- Të zbatojë planin e orës mësimore të përcaktuar për zhvillimin e saj në mënyrë të natyrshme me veprimtaritë e orës mësimore;
- Të zbatojë në mënyrë rigoroz kohën e planifikimit për çdo veprimtari mësimore;
- Të lidhë ngushtë tekstet, burimet dhe materialet mësimore për arritjen e rezultateve të të nxënit të orës mësimore;
- Të përdorë kohën në varësi të rezultateve të të nxënit dhe koncepteve të fushës;
- Të sigurojë që secili nxënës ta ketë të qartë se çfarë është duke bërë dhe se çfarë duhet të bëjë .

8.4.4. Materialet mësimore në zhvillimin e kompetencave për ‘Gjuhët dhe Kominikim’

Mësimdhënësit, mbi bazën e përmbajtjes mësimore, metodave dhe teknikave të mësimdhënies, përzgjedhin materialet mësimore, që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të identifikuar dhe parimeve të KKK-së.

Në mësimdhënien bashkëkohore, teksti mësimor nuk konsiderohet si burim i vetëm dhe i mjaftueshëm për zhvillimin e kompetencave të nxënësit. Kjo na bën me dije se mësimdhënësit duhet të sigurojnë edhe materiale të tjera mësimore për të ndihmuar nxënësit në zhvillimin e kompetencave. Materialet mësimore nuk do të thotë të jenë domosdo të shtrenjta dhe të sofistikuar. Shumë aktivitete mësimore mund të realizohen edhe me materiale të krijuara nga mësimdhënësit, por edhe nga vetë nxënësit. Gjatë hulumtimit në shkollat pilotuese kam hetuar disa shembuj të shfrytëzimit të burimeve dhe mjeteve mësimore në funksion të temave, rezultateve të të nxënësve dhe kompetencave. Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, mbështetur në Kurrikulën e re, mësimdhënësi mund të përdorë burime të ndryshme të informacionit, qoftë elektronike, por edhe të shkruara, si: libra të punës, broshura, atllase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza statistikore, dëshmitarë, përfaqësues të shoqërisë civile, prindër etj. Përveç burimeve të informacionit, rëndësi të veçantë kanë edhe mjetet mësimore, të cilat mund të përdoren nga nxënësit dhe mësimdhënësit dhe ato mund të jenë: fletë pune, fotografi, punime dhe krijime të nxënësve dhe mësimdhënësve, si dhe materiale të tjera me të cilat mësimdhënësia do të jetë më tërheqëse dhe më efektive.

Çështjet ndërkurrikulare paraqesin përmbajtje të rëndësishme kurrikulare, të cilat nuk i takojnë ekskluzivisht vetëm lëndës së gjuhës shqipe dhe vetëm një fushë kurrikulare. Çështjet ndërkurrikulare po integrohen në kurrikulë nëpërmjet njësive tematike dhe njësive mësimore, nëpërmjet aktiviteteve praktike në klasë, por edhe projekteve të përbashkëta që ndërlidhin fushat kurrikulare. Realizimi i korrelacionit po bëhet në të gjitha planifikimet mësimore. Në planifikimin vjetor përcaktohen tema mësimore, që janë në funksion të të gjitha lëndëve mësimore sa ka fusha kurrikulare (në rastin tonë fusha Gjuhët dhe komunikimi). Në planifikimet vjetore veçse kërkohet të shkruhet korrelacioni dhe kështu vijmë te planifikimi javor, i cili për qëllim ka pikërisht korrelacionin ndërmjet fushave, përkatësisht lëndëve mësimore, ky korrelacion më pas reflektohet edhe në orën mësimore.

8.5. VLERËSIMI I NXËNËSVE SIPAS KURRIKULËS SË RE

Ndryshimet kurrikulare kanë reflektuar edhe qasjen e re në vlerësimin e arritjeve të nxënësve. Një nga aspektet shumë të rëndësishëm të procesit të planifikimit mësimor, planifikimi i vlerësimit është pjesa së cilës mësimdhënësit duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë. Kjo duhet të bëhet me qëllim të përcjelljes së vazhdueshme të nxënësve për të arriturat e tyre në raport me rezultatet e të nxënësve për faza dhe periudha të ndryshme. Duke u bazuar në dy llojet e rezultateve të të nxënësve në nivel shkalle kurrikulare, pra në RNSH-kompetenca dhe RNF, si dhe në planifikimet vjetore, dymujore dhe më pas javore të orës mësimore, përcjellja dhe vlerësimi i performancës së nxënësve në raport me këto planifikime duhet të jetë në përputhshmëri me llojet e vlerësimit, siç janë përcaktuar në KKK, respektivisht në Kurrikulën Bërthamë për klasat 6-9 dhe 10. Kjo do të thotë se gjatë tërë vitit shkollor (mësimor) do të bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i performancës së secilit nxënës dhe në fokus duhet të jenë arritjet e rezultateve të të nxënësve, që janë paraparë në planifikimet dymujore, javore e të orës mësimore.

8.5.1. Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm duhet t'u mundësojë të gjithë nxënësve të shprehin nivelin e zotërimit të dijeve, zhvillimin e shkathtësive dhe formimin e qëndrimeve të tyre me anë të kërkesave dhe pyetjeve që kanë nivele të ndryshme të kompleksitetit, përfshirë:

Gjerësinë dhe thellësinë e të nxënësve të përvetësuar;

Gatishmërinë për t'u përgjigjur sfidave të shkallës/niveleit përkatës, të përcaktuar me rezultatet e të nxënësve dhe për të ecur drejt të nxënësve edhe më sfidues;

Aftësinë për të zbatuar të nxënësve në situata të ndryshme dhe rrethana të reja.⁹³³

Zbatimi i vlerësimit bazuar në kompetencat e përcaktuara me Kornizën e Kurrikulës u mundëson mësimdhënësit dhe shkollës që të jenë të saktë dhe të besueshëm në vlerësimin e arritjeve të nxënësve në të gjitha shkallët e shkollimit të tyre. Sipas kërkesave kurrikulare për shekullin e ri, në Kosovë qëllimet e vlerësimit të nxënësve në nivel klase janë:

Vlerësimi i arritshmërisë;

Vlerësimi për identifikimin e prirjeve të nxënësve;

Vlerësimi për planifikim dhe përmirësim të punës së mëtejme me nxënës.

Vlerësimi në nivel klase përfshin vlerësimin e vazhdueshëm gjatë gjithë vitit shkollor, vlerësimin përfundimtar (me rastin e përfundimit të vitit shkollor) dhe vlerësimin përmbyllës (me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës). Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve, përveç formave të ndryshme joformale gjatë gjithë procesit mësimor, bëhet përmes shkallës së vlerësimit, që përfshin notat nga 1- 5 (KKK dhe KB). Referencë kryesore për vlerësimin e nxënësve dhe të llojeve të tjera të vlerësimit janë rezultatet specifike të nxënësve të përcaktuara në kuadër të programeve shkollore.

Vlerësimi i arritshmërisë për secilin rezultat bëhet në bazë të shkallës së vlerësimit 1-5. Ky vlerësim bëhet nga ekipi i mësimdhënësit, të cilët kanë mbuluar aspekte të ndryshme të fushës përkatëse mësimore. Nota përmbyllëse për fushën përkatëse me rastin e përfundimit të një

⁹³³ Vlerësimi i brendshëm shpreh nivelin e zotërimit të dijeve, zhvillimin e shkathtësive dhe formimin e qëndrimeve të nxënësve.

shkalle të kurrikulës (nota përfundimtare A, B, C dhe D) nxirret nga mesatarja aritmetike e vlerësimit të arritshmërisë së rezultateve të të nxënësve.⁹³⁴ Në librezën e nxënësit dhe në diplomën që lëshohet me rastin e përfundimit të një niveli të shkollimit regjistrohen vetëm notat përmbyllëse dhe rezultatet e vlerësimeve të standardizuara.

a. Vlerësimi në nivel shkolle-Vlerësimi në nivel shkolle i referohet nivelit të arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e gjashtë kompetencave kryesore, të shprehura në kuadër të Kurrikulës Bërthamë, përmes rezultateve të të nxënësve me rastin e përfundimit të çdo shkalle të kurrikulës. Ky vlerësim organizohet nga vetë shkolla me qëllim të vetëvlerësimit të cilësisë së procesit edukativo-arsimor, që ofrohet në nivel të shkollës, si dhe me qëllim të planifikimit të masave për të siguruar nivelin e domosdoshëm të zotërimin të gjashtë kompetencave kryesore nga të gjithë nxënësit.

b. Metodat e vlerësimit-Vlerësimi i organizuar mirë në klasë do të thotë një klasë aktive, cilësi në nxënie, efektivitet në mësimdhënie dhe motivim të shtuar të nxënësve. Përqendrimi gjatë procesit të vlerësimit vihet në zhvillimin e shkathtësive psikomotorike, shkathtësive komunikuese dhe në fushën emocionale.⁹³⁵ Mbi këtë bazë mësimdhënësit mund ta përdorin vlerësimin për të identifikuar njohuritë dhe përvojat, të cilat nxënësit i sjellin në detyrat e tyre, në mënyrë që të planifikojnë mësimdhënien, të rafinojnë programet mësimore për t'i plotësuar nevojat individuale dhe ato grupore. Vlerësimi përdoret për të ndërtuar portfolion e të arriturave të nxënësit me njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, si dhe të bëhen bazë për raporte ose për certifikim për mundësi të shkollimit në vijim.

c. Shumëllojshmëria e metodave gjatë vlerësimit-Vlerësimi si gjithnjë edhe tani luan rol të rëndësishëm në përmirësimin e mësimdhënies dhe nxënies. Vlerësimi në klasë lejon një shumëllojshmëri të metodave të vlerësimit, që për bazë ka përmbajtjet e kurrikulës zyrtare, duke zgjedhur metoda të përshtatshme me rezultatet e të nxënësve. Metodatat e vlerësimit duhet të sigurojnë tregues të arritjes së nxënësit, të qëndrueshëm, të kuptueshëm dhe të besueshëm dhe përcaktohet se çka duhet marrë parasysh gjatë zgjedhjes së metodave të vlerësimit.

Vlerësimi për fushën e komunikimit dhe të shprehurit dhe për vlerësimin e gjuhëve dhe komunikimit bëhet duke u bazuar në tri shtylla vlerësimi: Fusha e njohjes, e cila përmbledh njohjen, të kuptuarit, zbatimin, analizën, sintezën dhe vlerësimin; Fusha e veprimit, perceptimi (kuptimi), reagimi, vlera (çmimi), organizimi, kualifikimi; Fusha e forcës psikologjike, perceptimi (kreativiteti).

Para se të fillojmë vlerësimin, është me rëndësi që mësimdhënësi të ketë të qartë disa hapa paraprakë si:

Përcaktimi i qëllimit të vlerësimit;

Përcaktimi i llojit të vlerësimit;

Identifikimi i rezultateve që duam t'i vlerësojmë;

Përcaktimi i instrumentit apo formës së vlerësimit;

⁹³⁴ Nxënësit që kanë arritur nivelin A, B, C, D, vazhdojnë në klasën/shkollën vijuese. Nxënësit që kanë arritur nivelin D vazhdojnë në klasën/shkollën vijuese me programe shtesë në fushat/lëndët/modulet në të cilat performanca e tyre ka qenë nën shkollën e vlerësimit 3. Ata të cilët edhe me këtë rast nuk e arrijnë nivelin C përsërisin vitin shkollor.

⁹³⁵ Motivimi është një prej formave më efektive, të cilat promovojnë rezultate të mira në të nxënësit dhe në vlerësim, që do të thotë se mësimdhënësi duhet të hulumtojë faktorët që krijojnë motivim te nxënësit dhe si mund ta mbështesë vlerësimin motivimin apo të ketë efekt të kundërt.

Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit.

Sipas KKK-së, vlerësimi është i bazuar në kompetenca. Vlerësimi i bazuar në kompetenca përqendrohet në atë se çka dinë nxënësit, çka bëjnë dhe çka janë në gjendje të bëjnë. Për të qenë të suksesshëm për zotërimin e kompetencave, nxënësit duhet të kenë: njohuri, aftësi, zotësi, shkathtësi, qëndrime dhe vlera, të cilat i justifikojnë përmes rezultateve të të nxënësve për fushë/lëndë dhe atë për nivel, shkallë, klasë dhe orë mësimore.

Mësimdhënësi duhet të përcaktojë udhët e veprimit, qëllimin (arsyen e vlerësimit), qasjen e vlerësimit (mënyrën se si parashikohet të realizohet vlerësimi), konteksti i vlerësimit, koha e vlerësimit; formati i instrumentit për vlerësim/testi; listimi i rezultateve të të nxënësve të fushës; niveli i kompleksitetit /të testit; përcaktimi i pikëve për çdo kërkesë /të testit; resurset e nevojshme për realizimin e vlerësimit; raportimi i rezultateve/të testit. Çfarë vlerësohet? (Performanca e nxënësve- Produkti.)

Metodat, mënyrat dhe mjetet e vlerësimit; Vlerësimi me shkrim; Vlerësimi me gojë; Vlerësimi i detyrave; Vlerësimi i projekteve; Vëzhgimi; Vetëvlerësimi.

Instrumentet e procesit të vlerësimit: Testi (me shumë zgjidhje, saktë- gabim, përputhje, plotësim, përgjigje e shkurtër dhe kërkesa të hapura); Testi i strukturuar me gojë; Lista e kontrollit; Pyetësori; Fleta për intervista; Anketa; Eseja; Projekti; Dosja/Portofoli.

Sipas kërkesave të KKK, gjatë vlerësimit merren për bazë rezultati për shkallë (kompetencës); Rezultati i të nxënësve për fushën Gjuhët dhe komunikimi (marrë nga Kurrikula Bërthamë); Rezultati i pritur.

Disa shembuj nga kriteret e vlerësimit

Kuptimi dhe analiza e teksteve: Analizohet organizimi i strukturës së tekstit, qëllimi i autorit, koha dhe vendi, si dhe argumenti për to.

Kuptimi dhe analiza e teksteve: Sintezë e përmbajtjes nga disa burime ose të punës të autorëve të veçantë, çështje të veçanta, ideja e përmbajtjes dhe burime të tjera të lidhura me qëllim të paraqitjes së kuptimit.

Kuptimi dhe analiza të teksteve: Shprehja e ideve të paraqitura në burimet parësore dhe dytësore përgjatë analizës origjinale, vlerësimit dhe përpunimit.

Kuptimi dhe analiza të teksteve: Analiza interaktive në mes karaktereve kryesore dhe dytësore në tekstet letrare (konfliktet e brendshme dhe të jashtme, motivacionet, marrëdhëniet, ndikimet) dhe në këtë mënyrë efektet ndikojnë në fabul ose subjekt.

Kuptimi dhe analiza të teksteve: Përcaktimi i tipareve të personazheve sipas asaj se çka thonë ato personazhe për veten e tyre gjatë narracionit, dialogut, monologut dramatik, monologët më vete.

Zhvillimi i kreativitetit: Krahasimi i punës për mesazhin e veçantë, temat universale dhe jep dëshmi për mbështetjen e ideve të shprehura në punën e tij.

Zhvillimi i kreativitetit: Analizon mënyrën se si të punohet me letërsinë në relacionin temë dhe probleme nga periudhat historike.

Një shembull raportimi (përshkrimi i saktë i arritjeve) për vlerësimin me notën 'Shkëlqyeshëm'. Për t'u vlerësuar me notën shkëlqyeshëm, nxënësi plotësisht e analizon, krahason tekstin letrar dhe joletrar, dallon në mënyrë kreative llojin dhe gjininë letrare dhe joletrare, përcakton informatën e përshtatshme, mendimet i shpall qartë, i organizon mirë, i përmbledh, i lidh, i shpreh rrjedhshëm, asnjë gabim në argumentim. Përdor pa vështirësi shenjat e pikësimit, diksionit, intonacionit, paragrafët, rregullat e shqiptimit, rregullat gramatikore,

strukturat komplekse efektive, një shumëllojshmëri të gjerë të strategjive për njohjen e fjalës për të përcaktuar kuptimin e fjalëve të panjohura dhe me lehtësi përdor burime referencash për të përcaktuar kuptimin e fjalës. Sipas këtij shembulli, ngjashëm hartohet formati i kërkesave për vlerësim për çdo notë.

Nr.	Rezultatet e të nxënësve	Teknika e Vlerësimit	Kriteret e suksesit (1-5)				
	Nxënësi është në gjendje të:		Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
1.							
2.							

8.5.2. Vlerësimi i bazuar në kompetenca

Mësimdhënësit mund të përdorin një spektër më të gjerë të instrumenteve për të vlerësuar kompetencat e nxënësve – shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e tyre, dhe jo vetëm dijen dhe njohuritë e tyre për faktet. Vlerësimi i bazuar në kompetenca është po ashtu edhe më gjithëpërfshirës dhe shkon përtej një procesi njëkahësh: mësimdhënësit ende i vlerësojnë nxënësit, por ata mundësojnë edhe vetëvlerësimin dhe vlerësimin e ndërsjellë, duke i angazhuar nxënësit në procesin e nxënies e të vlerësimit të vetvetes. Në fund, vlerësimi i bazuar në kompetenca është më mirë i integruar në procesin e mësimdhënies e të nxënësve dhe është në funksion të përmirësimit të praktikave të mësimdhënies. Duke konsideruar vlerësimin, në shumicën e rasteve, duhet të bashkoni standardet e caktuara të kompetencave, në mënyrë që ato të mbulojnë të gjitha njohuritë dhe shkathtësitë relevante të kërkuara për ofrimin e vlerësimit të besueshëm. Këto grupe të kompetencave pastaj shpesh mund të vlerësohen së bashku.

Tabela 55. Teknikat për mbledhjen e të dhënave (dëshmime)⁹³⁶

Llojet e të nxënësve	Çfarë kërkohet nga nxënësit?	Shembuj të vlerësimit
Rezultatet e të nxënësve		
Mendimi në mënyrë kritike dhe gjykimet.	Zhvillimi i argumenteve , reflektimi, gjykimi dhe vlerësimi.	Ese Raport, rishikimi i teksteve.
Zgjedhja e problemeve/Zhvillimi i planeve.	Identifikimi i problemeve, definimi i problemeve, analizimi i të dhënave, rishikimi, dizajnimi i eksperimenteve, planifikimi, aplikimi i informacioneve.	Skenari i problemeve, Puna në grupe, Problem i bazuar në punë, Analizimi i një rasti.
		Demonstrimi, luajtja e rolit
Përformimi i	Leximi, përdorimi i pajisjeve,	Incizimi i një video (shkrimi i një

⁹³⁶ Adaptuar nga teknikat e ndryshme të mbledhjes së dëshmime (CBET për punësim, GIZ, prill 2013) & Nightingale et.al. 1996).

procedurave dhe demonstrimi i teknikave.	përcjellja e procedurave laboratorike, përcjellja e protokolleve, ndjekja e udhëzimeve.	skenari). Prodhimi i një posteri; Raporti nga laboratori.
Demonstrimi i njohurive dhe kuptimi (mund të vlerësohet në bashkëpunim me llojet e të nxënësve të përmendura më lart).	Të përshkruajë, të raportojë, të identifikojë, të rinumërojë, të ndërlidhë etj.	Test me shkrim, me gojë; Esetë, Raportet; Pyetje të shkurtra me përgjigje; Teste të vogla.
Menaxhimi/zhvillimi i vetvetes.	Të kërkojë në bashkëpunim dhe në mënyrë të pavarur, të vetorientohet, të menaxhojë kohën, të menaxhojë detyrat.	Ditari i të nxënësve, portfolio, Vetëvlerësimi, Projektet në grupe, Vlerësimi në mes të kolegëve.
Dizajnimi, krijimi dhe përforsimi.	Dizajnimi, krijimi, përforsimi, prodhimi, etj.	Dizajnimi i projektit, Portfolio, Prezantimi, Performanca.
Vlerësimi dhe menaxhimi i informatës.	Kërkimi dhe rifitimi i informacionit, hulumtimi, interpretimi dhe rishikimi i informatës.	Bibliografite përshkruese; Detyra e kërkimit në bibliotekë; Projekte me bazë të të dhënave.
Komunikimi.	Shkathtësitë e shkruara, orale, vizuale dhe teknikes.	Prezantimi i shkruar Prezantimi oral Diskutimet/Debatet/luajtja e roleve, puna në grupe.

Vlerësimi për të nxënë është bërë instrumenti më i fuqishëm i vlerësimit, i cili gjeneron mësim. Ai "...i jep mundësi nxënësit të bëhet nxënës pa frikën se do të dështojë. Krijohet një mjedis mësimor dhe ofrohen mundësi për nxënësit t'i praktikojnë shkathtësitë dhe të marrin komente specifike dhe përshkruese që u ndihmojnë ta përmirësojnë të mësuarit."⁹³⁷ Komentet kthyes të mësimdhënësit për nxënësin/it karshi të nxënësve janë karakteristikë e veçantë e vlerësimit për të nxënë. Komentet që e tërheqin vëmendjen e nxënësve për strategjitë vetërregulluese apo aftësitë e tyre si nxënës mund të jenë efektive nëse nxënësit e kuptojnë se do t'i rrisin rezultatet në qoftë se dëshirojnë t'i shtojnë përpjekjet dhe t'i kushtojnë më shumë vëmendje. Komentet personale ("Vajzë e mirë!") nuk e tërheqin vëmendjen e nxënësit për të nxënë e tyre.⁹³⁸ Pra, ofrimi i komenteve kthyes nuk ka të bëjë me dhënien e lëvdatave, por ka të bëjë me riorientimin dhe përqendrimin e veprimeve të nxënësit karshi të nxënës/mësim.

⁹³⁷Sherry Bennett and Dale Armstrong; *Putting the Focus on Learning: Shifting Classroom Assessment Practices* (Chapter 13) f. 265.

⁹³⁸ Standardet e vlerësimit të nxënësve DVSM-USAID/ MASHT/ 2011, Prishtinë. Dhe Standardet e raportimit për procesin e vlerësimit DVSM. Prishtinë 2013. (Susan M. Brookhart; "Teacher Feedback in Formative Classroom Assessment" f. 232)

Hapat e vlerësimit për të nxënë:

- *Lexojeni në mënyrë individuale tregimin në vijim;*
- *Diskutoni me kolegë mësimet e marra nga ky tregim;*
- *Diskutoni me kolegë shembuj praktikë nga përvoja juaj me nxënës, të ngjashëm ose të përafërt me tregimin;*
- *Përzgjidheni një përvojë të diskutuar në detaje dhe përshkruani rastin/shembullin në formë të tregimit – në pika kyçe;*
- *Prezantoni shembullin para kolegëve të tjerë.*⁹³⁹

Në këtë rrafsh edhe roli i prindit me fëmijën e vet shndërrohet në përdorim klasik të vlerësimit për të nxënë, por është një shembull që mësimdhënësit mund ta marrin dhe ta përshtatin për nxënësit e tyre në situata të mësimt, kur synojnë të praktikojë vlerësimin për të nxënë.⁹⁴⁰

Çelësi i suksesit të nxënësve qëndron në bashkëpunimin kolegjial të mësimdhënësve. Kjo do të thotë që në mes të mësimdhënësve nuk duhet të ketë rivalitet negativ, sepse të gjithë synojnë zhvillimin maksimal të potencialeve të nxënësve. Zbatimi i filozofisë së KKK-së domosdoshmërisht kërkon bashkëpunimin ndërmjet mësimdhënësve. Bashkëpunimi duhet të bëhet në nivel të Këshillit të klasës-klasave, por edhe të aktiveve profesionale. Mësimdhënësit e klasës së njëjtë, por të paraleleve të ndryshme, duhet të bashkëpunojnë ndërmjet vete, por edhe me mësimdhënësit e niveleve të tjera dhe të fushave të ndryshme kurrikulare. Ky bashkëpunimi duhet të reflektohet në planifikime mësimore, që do të thotë se mësimdhënësit e klasës së njëjtë, por të paraleleve të ndryshme, duhet bashkërisht të hartojnë planifikimet për shkallë dhe planifikimet vjetore për të vazhduar më pas në shkëmbimin e ideve dhe përvojave në hartimin e planifikimeve dymujore, të cilat mund të jenë edhe të ndryshme nga mësimdhënësit e paraleleve të ndryshme. Gjithashtu, mësimdhënësit duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin edhe në planifikimet javore, edhe pse ata-ato janë përgjegjëse vetëm për një paralele. Mësimdhënësit jo rrallë po marrin iniciativa për ngritje profesionale brenda shkollës, duke mbajtur vetë takime pune për çështje të ndryshme, që janë në funksion të mësimdhënies. Mësimdhënësit bashkërisht po i përgatisin nxënësit edhe për gara të ndryshme, si gjuhëtari i ri, për kuize diturie, publikime në revista shkollore, buletin të shkollës, ekspozita dhe aktivitete të tjera, që ndihmojnë në zhvillimin e kreativitetit dhe në arritjen e kompetencave të caktuara. Gjithashtu, suksesin e zbatimit të KKK-së e forcon edhe bashkëpunimi me mësimdhënësit e shkollave të tjera, duke shkëmbyer përvoja, literatura dhe njohuri e dije reciproke.

⁹³⁹ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & GIZ IS (2012): Moduli 5 për Aftësimin e Mësimdhënësve në Shërbim: Vlerësimi në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, Prishtinë.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & SWAP, *Udhëzues për mësimdhënës për përmirësimin e praktikave në klasë*, Prishtinë, 2012.

⁹⁴⁰ MASHT & SWAP, *Udhëzuesit për zbatim të KKK-së*, Prishtinë, 2012.

Konkluzione dhe rekomandime

Edhe pse rrënjët e shkollës sonë kombëtare dhe të mësimit të gjuhës shqipe i gjejmë në “thellësi të shekujve” ende nuk kemi arritur të nxjerrim një studim gjithpërfshirës ku përmblihet historia e arsimit dhe mësimit të gjuhës shqipe në të gjitha trojet shqiptare, që nga kohët më të hershme e deri në ditët tona. Kemi disa vështrime përshikuese të kufizuar dhe disa studime që trajtojnë këtë fushë, por ato vuajnë nga prezantimi parcial në pikëpamje të tërësisë kombëtare.

Gjatë kërkimeve doli konstatimi se kishat katolike, kudo që ndodheshin, kishin në bibliotekat e tyre libra shqip, nga të cilët, mësohej shkrim-leximi shqip. Këtë segment, sado që me vonesë, e kompensuan pjesa më e madhe e hoxhallarëve me ndërgjegje të zgjuar kombëtare, që ndërkohë e kishin mësuar shkrim-leximin e shqipes. Një shtytje të veçantë dëshirës për të mësuar shqip dhe përhapjes së librit shqip në Kosovë, ia kishte dhënë patrioti i shquar Hasan Prishtina me atdhetarë të tjerë. Nuk ishin të rralla rastet kur, disa hoxhallarëve, shqiptarët e kësaj treve mësonin njëri-tjetrit shkrim-leximin shqip, edhe para se të çilesin shkollat e para. Kjo flet për forma individuale dhe në grupe të punës. Një dëshmi tjetër e interesimit dhe e ejtes për shkollim në gjuhën amtare ishte edhe pjesëmarrja sado e kufizuar e të interesuarve në kurset e mësimit të shqipes që organizoheshin në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë vende të tjera. Kjo përbënte formën e parë të mësimit të organizuar të shkrim-leximit dhe të shkollimit në gjuhën shqipe.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, deri më 1918, trevat që i takonin zonës austro-hungareze të okupimit ishin lejuar shkollimi në gjuhën amtare. Edhe periudha e Luftës së Dytë, (1941-1944) ka qenë përidha më e ndritshme e zhvillimit të arsimit dhe të shkollave në gjuhën shqipe në Kosovë. Për herë të parë fuqishëm në historinë e Kosovës shkolla, arsimit, gjuha shqipe dhe libri shqip u legalizuan. Mbi shkollën dhe gjuhën dhe arsimin shqip është ushtruar një dhunë dhe terror shtetëror sistematik, i paparë në historinë e civilizimit.

Studimi “*Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë*” i bën një vështrim historik mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe traditave të shkollës në Kosovë. Mësimi i gjuhës amtare në shkollënë këtë trevë është relativisht i ri. Shqetësimet e atdhetarëve në Kosovë për mohimin e shkronjave shqipe, shkollës në gjuhën amtare dhe librave shqipe ishin të vazhdueshme. Edhe përpjekjet për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, për përhapjen e abetareve dhe teksteve, ishte e pashkëputshme. Përkundër përpjekjeve për arsim në gjuhën shqipe që janë mbi pesëshekullore, shkollat institucionalisht datojnë nga viti 1914. Ndryshimet në programet mësimore dhe në tekstet shkollorë të gjuhës shqipe dhe të letërsisë përbëjnë një gershetë me gjithë historinë e shqiptarëve të Kosovës për ta vënë gjuhë amtare në themel të ruajtjes së qenies e të identitetit kombëtar, bashkimin kombëtar për çlirim.

Studimi për objektiv kishte prezantimin dhe analizën e sintetizuar të zhvillimeve historike deri te zhvillimet bashkëkohor në sferën e mësimit të gjuhës shqipe. Të gjitha dritëhijet dhe gjithë tradita e përvojat më të mira në fushën e mësimdhënies dhe kompetencat gjuhësore për t’u shprehur qartë, rrjedhshëm e bukur me gojë dhe me shkrim ishin pjesë e trajtesës. Gjuha shqipe si lëndë mësimore është trajtuar që nga fillimi i Rilindjes Kombëtare Shqiptare deri në ditët e sotme. Këndvështrimet e studimit u përqendruan në fushën e njësimit të gjuhës dhe në kodifikimin e normës standard, madje në zbatimin e metodologjive dhe të metodave, formave, parimeve dhe mjeteve të mësimdhënies dhe të të nxënit. U bë analizë kronologjike e përbajtjeve të planeve dhe programeve mësimore dhe teksteve mësimore të gjuhës shqipe. Kërkimet disavjeqare rreth traditës së shkollës shqipe të Kosovës, në fushën e mësimit të gjuhës

shqipe janë përqendruar edhe në vjeljen e dokumentacionit shkencor e didaktik duke fokusuar zhvillimet në kurrikulën e gjuhës shqipe e të letërsisë.

Në këtë studim është hedhur dritë mbi udhën e shkronjave shqipe dhe mbi hartimin e abetareve dhe teksteve të gjuhës shqipe, të leximit, leximit letrar dhe letërsisë, duke konstatuar se ndryshimet në planet dhe programet e në tekstet e gjuhës shqipe dhe të letërsisë kanë qenë aq të dukshme.

Ndikimi i mësimdhënies së gjuhës shqipe, teksteve mësimore dhe mësimdhënësve të gjuhës në Kosovë ishte i rëndësishëm sidoms në formësimin gjuhësor ,por edhe atdhetar të brezave në Kosovën e robëruar. Vendimet e mëdha letrare u reflektuan edhe në kodifikimin e gjuhës shqipe në Kosovë dhe në zbatimin e saj në shkollë, media, administratë e kudo. Përkundër dhunës së paparë mbi shkollën shqipe dhe librin shqip është e shënuar përpjekja e mësimdhënësve në mbijetesën e shkollës shqipe 1990-1999. Vitet '90, për mësimdhënësit, nxënësit dhe popullin e Kosovës shënon fillimin e pavarësimit të shkollës shqipe dhe fillimin e shembjes së kufijëve në mes shqiptarëve, duke hartuar programe dhe tekste të përbashkëta me Shqipërinë. Abetarja e përbashkët dhe përafrimi i kurrikulave janë kulmi i realizimit të ëndërrës së rilindasëve.

REKOMANDIME

- Të hartohen udhëzues të veçantë për zbatimin e Planeve dhe programeve mësimore bërthamë (skeleton) si dhe tekstet shkollore në frymën e Kurrikulës së re.
- Të përgatiten materiale mësimore për konkretizim për njohuritë morfologjike, sintaksore.
- Të krijohet hapësirë dhe atmosferë për kultivimin e mendimit kritik dhe të zotërimit të normës letrare dhe krijimit të shprehive të përdorimit të saj. Të punohet më shumë në punët e pavarura me karakter krijues, në pasurimin e fjalorit dhe në luftimin e fjalëve dhe shprehjeve të huaja dhe në evitimin e gabimeve në drejtshkrim, drejtshqiptim e pikësim.
- Të vazhdohet në bashkëpunim me Shqipërinë dhe trojet tjera në përafrimin dhe unifikimin e kurrikulave dhe teksteve të gjuhës dhe të letërsisë shqipe dhe ato përmbushin standardet bashkëkohore.
- Të krijohen mjete të reja audiovizuale dhe të teknologjisë së re informative dhe nxënësit të aftësohen në hartimin e projekteve, hulumtimeve, referateve etj.
- Institucioneve arsimore të Kosovës në fokus të punës së tyre të vejnë zhvillimin profesional të mësimdhënësve aktual dhe kualifikimin e trajnimit sa më bashkëkohor të mësimdhënësve të rinj për t'i ngritur ata në nivelin e kërkesave të kurrikulave të reja. Fakulteti i Edukimit dhe Fakulteti Filologjik me Departamentet përkatëse të orgonizojë seminare kombëtare e vendore etj., që të prezantojnë para mësuesve të të gjitha niveleve strategji të reja të mësimdhënies, metoda e teknika të panjohura, por më efektive nga praktikat tradicionale të vjetruara.
- Të punohet më shumë në drejtim të zbatimit të modeleve alternative, të hartohen strategji të larmishme, forma të ndryshme mësimore, metoda ndërvepruese, programe individuale etj., që lehtësojnë procesin e të nxënies tek të gjithë nxënësit. Kosovës të vazhdohet me angazhimin që çdo mësues ta njohë e ta përdorë TIK-un në dobi të procesit mësimor.
- Të zbutet apo evitohet dallimi në mes një ndarje midis tradicionales dhe bashkëkohores. Qendra e gravitetit mbetet në realizimin e roleve të aktorëve të orës së mësimi. Çdo strategji, metodë apo teknikë, sado bashkëkohore apo tradicionale, është joefektive, në qoftë se nuk do t'i japë mësuesit pritshmëritë e parashikuara.

-Të evitohet përdorimi mekanik i recetave të cdo strategjie, metode apo teknike, sado bashkëkohore apo tradicionale,të jetë, në qoftë se nuk do t'i japë mësuesit pritshmëritë e parashikuara.

-Tekstet shkollore të gjuhës shqipe të mbështeten në programeve zyrtare të miratuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës.

-Tekstet shkollore të nivelit të parë të arsimit të detyruar më shumë i përmbushin kërkesat e programeve të reja mësimore në: paraqitjen e përmbajtjes programore;qasjen metodologjike;në paraqitjen e detyrave, shembujve dhe ilustriimeve;në formulimin e pyetjeve në nivele të ndryshme të njohjes;në përfshirjen e temave me përmbajtje ndërkurrikulare; në integrimin e shkathtësive të komunikimit; në integrimin e gramatikës dhe teksteve të ndryshme letrare e jo letrare

-Përderisa programet e reja mësimore synojnë integrimin e të gjithë përbërësve të gjuhës në një të vetëm, tekstet e reja shkollore të gjuhës shqipe në nivelin e dytë nuk e pasqyrojnë një qasje të tillë.

Liria akademike e mësuesit për të përzgjedhur risitë psikopedagogjike e didaktike sa më të përshtatshme, në kushtet e shkollës e të klasës ku jep mësim, do të kthejë në traditë përvoja efektive dhe do të realizojë përditësim të praktikave në fushën e mësimdhënies dhe në atë të të nxënit.

- Të vazhdohet e thellohet me përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, në të gjitha shkollat e Kosovës,në kuadër të reformës në mësimdhënie dhe sipas standardeve bashkëkohore. të

-Tekstet shkollore të gjuhës shqipe do të duhej të përqendrohen në gjuhën e gramatizuar dhe jo në gramatikën pa shkathtësi gjuhësore.

-Praktikimi i qasjes së integruar në tekstet shkollore të gjuhës shqipe do të mundësojë që gjuha të jetë praktike dhe funksionale, që nxënësit të mund ta përdorin drejt në situata të ndryshme.

Si përfundim tjetër i këtij studimi del se tekstet shkollore të hartuara nga më shumë se një autor, janë më praktike dhe më funksionale. Bashkëpjesëmarrja e autorëve të ndryshëm e plotëson dhe bagaton më shumë tekstin me ide dhe me situata të ndryshme krijuese.

SHTOJCË

DISA NGA BALLINAT E ABETAREVE , LIBRAVE DHE DOKUMENTEVE




Abetare 1911 Abetare 1919 Abetare 1927



Abetare 1945 Abetare 1945 Abetare 1946

**Ragip GJOSHI MËSIMDHËNIA E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË
(Nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)**






Abetare 1946 Abetare 1947 Abetare 1948




Abetare 1950 Abetare 1958 Abetare 1959


Ragip GJOSHI MËSIMDHËNIA E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË
(Nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)



Abetare 1965 Abetare 1970 Abetare 1980



Abetare 1983 Abetare 1984 Pako e Abetares 2008



Abetare 2012

Ragip GJOSHI MËSIMDHËNIA E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË
 (Nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)




Disa nga ballinat e librave të leximit 1921-45




Disa nga ballinat e librave të leximit 1945-1980

**Ragip GJOSHI MËSIMDHËNIA E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË
(Nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)**



Disa nga ballinat e librave të leximit 1945-1980



Kudo dhe mbi tekste shkollore shenjat e pushtuesit(libri me stemë serbe)



Gjuha shqipe “mësohej” nga teksti i autorëve serb që nuk e dinin shqip

Ragip GJOSHI MËSIMDHËNIA E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË
(Nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)

*Q*uël nga shtypi abetarja e parë në gjuhën shqipe

Sot duet nga shtypi abetarja e parë në gjuhën shqipe e cila më punën vërtetuesë të puntorve grafik u shtyp, por një kohë relativisht të shkurtër, në shtypshkronjen e shtetit të Krahines s'onë.

Këto abetare është perpitue nga arsimtarët me të mirë të Drejtoratit Arsimit të Këshillit Populluer Krahinuer të Kosmetit, për kursët analjasetike. Përoç gërmave kursistat l'onë do të kenë mundësi me u njoft dhe me një literaturë interesante dhe me lexue tekste të ndryshme.

Abetarja përmban 58 faqe dhe është shtyp në 50,000 shkemplarësh.

Pantorët e shtypshkronjes shtetnore të Kosmetit, tue genë koshiontë për shërbimin e madh që bafit me nxerren e kësaj abetarje, me anën e së cilës me mija shokë të tyne do të mësojnë shkërim e kendim, nuk kursyen kurrgja dhe punuen me vullnet të jashtëzakonshem, si ditën është dhe natën, tue kalue me këtë rast veshitrsina të mbëdhaja.

Një numer ekzemplarësh të kësaj abetarje do t'u shperndahet falas kursistave të vobekt, dhe ekzemplarët tjerë do të gjinden me u ble neper librarit e Krahinës s'onë me çmimin e arsyshem prej 3 dinarësh.

Lajm i gëzuar për nxënës dhe arsimtarë në gazetën ‘‘Rilindja’’ 1947

GJAKOVË **Bujku**, 20 mars 1995

Policia konfiskoi një kamion me libra shqip

Ndërkaq, Avni Brovina, redaktor i Entit të Botimeve të Teksteve Shkollore të Kosovës, dy herë u ftua në organet e SPB-së

Gjakovë, 24 mars

Pardje, një ekspeditë e policisë, pas kontrollimit disaorësh të shtëpisë në Gjakovë, ku tash banon prof. Avni Brovina, redaktor i Entit të Botimeve të Teksteve Shkollore të Kosovës, konfiskoi një komion përplot libra shqip, që gjendeshin aty. Pjesa dërrmuese e këtyre librave ishin tekste shkollore – të gjuhës dhe letërsisë shqipe të historisë dhe të gjeografisë. Pas këtij «gjahu» Avniu u ftua dy herë në organet e SPB-së së Gjakovës-ditën e parë u mbajtë 8 orë, kurse ditën e dytë, dy orë, me ç'rast inspektorët e SPB-së u interesuan rreth veprimtarisë së Entit të Botimeve të Teksteve Shkollore dhe të LASH-it, njofton Komisioni për Informim i Degës së LDK-së së Gjakovës. Z.H.

Dëshmi e ‘‘inkuzicionit’’ mbi tekstet shkollore ‘‘Bujku’’ 1995

REPUBLIKA E KOSOVES
Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës

PLANI E PROGRAMI
I GJUHËS SHQIPE DHE I LETËRSISË
PËR SHKOLLËN FILLORE
Klasa I - IV

Prishtinë, shtetë, 1996

LIBRI I KLASËS

Shkollë fillore "_____"

Komuna _____ Vendi _____

Klasa _____ Parakleja _____

Viti shkollor 199___/_____

Eksport: _____

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe e Kulturës, Prishtinë, shtetë, 1996

REPUBLIKA E KOSOVËS

DËFTESË
PËR KRYELIEN E SHKOLLËS FILLORE

Shkollë fillore _____

nr. _____ Komuna _____

Nomri i produktit _____

Nomri vendor në Librin shtetë _____

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe e Kulturës, Prishtinë, shtetë, 1996

Plani e programi mësimor,Libri i klasës dhe Dëftesa për shkollën fillore në Kosovë

BIBLIOGRAFI

- *Abetare për të rritun*, Këshilli Populluer Krahinuer për Kosovë e Metohi Drejtorati arsimuer, Prizren, 1946
- Agalliu, F.; Luli, F., *Metodika e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1971
- Ahmeti, I., *Kosova*, (Monografi), 1996 ,Prishtinë.
- Ajeti, I., *Rruga e zhvillimit të gjuhës letrare në Kosovë*, Kongresi i Drejtshkrimit, Prishtinë 1974
- Ajeti, I., *Gjuha dhe mjetet e informimit në ngritjen e kulturës gjuhësore*, Çështje të normës letrare, Prishtinë, 1980
- Ajeti, Sh., *Lufta dhe dëmet që pësoi Libri Shkollor*, Buletini “Libri Shkollor”, Prishtinë, 1/2000,
- Antoljak, S., *Prilog historijatu borbe albanaca za svoj Alfabet*, “*Gjurmime albanologjike*”, nr. 1, Prishtinë, 1969,
- Badallaj, I., *Rreth programeve të gjuhës shqipe në Kosovë*, Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar, Tiranë, 2004.
- Bajcinca, I., Ligjëratë me mësuesit e shqipes në shtetet skandinave, 11-12 maj 2006
- Bajrami, H., *Rrethi i Llapit gjatë viteve 1941-1944*, Prishtinë, 1975
- Batalli, Q., *Bibliografia e abetareve dhe e librave të leximit të shkollës fillore në gjuhën shqipe në KSAK 1945 – 1975, 1978 (dorëshkrim)*
- Batalli, Q., *Abetare*, ETMM i Kosovës, Prishtinë, 1991.
- Batalli, Q., *Abetare*, ETMM të KSAK, Prishtinë, 1987
- Batalli, Q., *Abetare*, Libri shkollor, Prishtinë, 1999
- Batalli, Q.; Gjevorci, M., *Libër leximi e gjuhe për klasën e II të sh. fillore*, ETMM, Prishtinë, 1992.
- Batalli, Q.; Gjevorci, M., *Buzëqeshjet*, Libër leximi e gjuhe për klasën e II të sh. fillore, ETMM- KSAK, Prishtinë, 1989
- Beci, B., etj., *Gjuha shqipe 2*, “ Libri Shkollor ”, Prishtinë, 1998
- Beci, B., *Gjuha shqipe 7*, Dukagjini, Pejë, 2004.
- Beci, B., *Gjuha shqipe 2*, Dukagjini, Pejë, 2006.
- Beci, B., *Gjuha shqipe 6*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003
- Beci, B., *Gjuha shqipe 8*, Dukagjini, Pejë, 2006.
- Beci, B., *Gjuha shqipe 8*, Dukagjini, Pejë, 2006.
- Begolli, M., *Lekyra e detyrueshme dhe ora e saj në shkollë*, “Buletini”, Prishtinë, 1962
- Belegu, Xh., *Lidhja e Prizrenit*, Veprat e Sajë 1878-1881, Tiranë, 1939
- Bennett, Sh.; Armstrong, D., *Putting the Focus on Learning: Shifting Classroom Assessment Practices* (Chapter 13)
- Beqja, H., *Në themelet e arsimit tonë popullor*, Tiranë, 1975
- Berisha, B., *Disa aspekte të abetares*, Libri shkollor, Buletin i ETMM i KSAK, Prishtinë, 1973, nr. 1-2,
- *Bibliografia e Librit Shkollor në Kosovë 1945-1985*, përgatitur nga Mr. Abdyl Ramaj, Prishtinë, 1985
- Blaku, M., *Rreth trajtimit të gjuhës letrare në disa nga organet e shtypit të Rilindjes*, Seminari 1978
- Borzanoviq, D., *Metodika srpskohrvatskog jezika i knizivnosti* (dispencë) ,Prizren, 1979
- Canovic, S., *Specifični problemi nastave u skolama Kosova i Metohije*, Prishtinë, 1967
- Čanović, S., *Specifični problemi nastave u školama Kosova i Metohije*, Priština, 1967
- Çepani, A., *Lokalizimi i versioneve të MS Windoës e MS Offoçe dhe Fjalori i termave të informatikës- arrijtjet e shqipes përkrah gjuhëve të tjera*, nga diskutimet në një tryezë të Qendra për Edukim dhe Përparim (QEP), Prishtinë, maj 2011.

- Daka, P., *Bibliografi e studimeve dhe e artikujve në gjuhën shqipe*, Tiranë 1975
- Dedja, B., *Politika dhe pedagogjia*, Tiranë,1967.
- Dema, B., *Fjalor fjalësh të rralla të gjuhës shqipe*, Përgatiti Dom Nikë Ukgjini. Toena, Tiranë, 2005
- Demi, Z., Roli i Pleqësisë së Arsimit të Republikës së Kosovës në pavarësimin e shkollës shqipe, Prishtinë, 1995
- Demi, Z., Zhvillimi i shkollave dhe i arsimit në territorin e sotëm të Anamoravës (1945-1950), Prishtinë, 1977, Plani dhe programa mësimore për shkollat fillore shqipe për vitin shkolluer 1948-49, Prishtinë,1949
- Demolli, A., *Leximi 2*, Libri shkollor, Prishtinë, 2004.
- Demolli, A., *Leximi 3*, Libri shkollor, Prishtinë, 2008.
- Deva, A., Krasniqi, I., *Abetare*, Dukagjini, Pejë, 2008
- *Didaktika*,(përgatitur nga Katedra e pedagogjisë dhe psikologjisë me Institutin e Studimeve Pedagogjike),Universiteti i Tiranës,Tiranë 1986
- Dodi, A., *Drejtshtkrimi dhe shqiptimi letrar*, Kongresi i drejtshtkrimit të gjuhës shqipe, Prishtinë 1974
- Dogani, A., *Abetare*, Shkup, Kultura, 1946
- Domi, M., Gramatika e Jani Vretos e vitit 1866 , Gjurmime albanologjike 1977- Duka, V., *Historia e Shqipërisë*, Tiranë
- *Drejtshtkrimi i Gjuhës Shqipe*. Rilindja, Prishtinë 1974.
- *Dvanaest godina kulturnog razvitka Kosova i Metohije*, Priština 1957,
- Emil, P., *Bibliografija - 30-godista casopisa "Pedagoski rad"*(1946-1975)Zagreb, 1976.
- Escarit, R., *Revulucia knjige*, Prosvjeta, Zagreb,1972
- *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe (me rreth 41000 fjalë)*.
- *Fjalori i shqipes së sotme*,Tiranë 1984
- *Fjalorit të Gjuhës së sotmë shqipe*,TOENA,Tiranë, 2002.
- Garo, S.,*Mësimdhënia bashkëkohore*, Tiranë 2008
- Gecaj, M., *Nëpër udhët e shkollës shqipe*, Tiranë, 2001.
- Gerard, F.; Roegiers, X., *Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore*, botimi në shqip nga Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë, 2002,
- Gogaj, I., *Punëtorë të shquar të shkollës shqipe*, Tiranë, 2001
- Gojani, H., *Gjuha shqipe në tekstet shkollore*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2011
- Grup autorësh, *Gjuha shqipe dhe leximi 5*, Albas, Prishtinë, 2007.
- Grup autorësh, *Korniza e Kurrikulit të Ri të Kosovës, Libri i bardhë për diskutim*, (arsimi parashkollor, fillor, i mesëm dhe i mesëm i lartë), Prishtinë, 2001, fq. 129.
- Grup autorësh, *Kosova dikur e sot*, Prishtinë, 1973
- Grup autorësh, *Pedagoška enciklopedija*, II.Beograd, 1989
- Grup autoresh,*Arsimi i Kosovës në shifra e fakte*,Prishtinë,2000.
- Grup autorësh, *Libër për mësuësin "ABETARE"*(Abetare e përbashkët Shqipëri-Kosovë),botues Pegi dhe Dukagjini,Tirane-Pejë,2012
- Grup autorësh, *Gjuha shqipe 2*, botimi i gjashtë, Libri Shkollor, Prishtinë, 2001.
- Grup autorësh, *Gjuha shqipe 3*, botimi i pestë, Libri Shkollor, Prishtinë, 2000.
- Grup autorësh, *Gjuha Shqipe 4*, botimi i katërt, Libri Shkollor, Prishtinë, 1999.
- Grup autorësh, *Gjuha Shqipe 5*, botimi i katërt, Libri Shkollor, Prishtinë, 1999.
- Grup autorësh, *Gjuha shqipe 6*, botimi i tretë, Libri Shkollor, Prishtinë, 1999.
- Grup autorësh, *Leximi letrar 8*, botimi i tretë, Libri Shkollor, Prishtinë, 1999

- Gjedia, R., *Arsimi në Shqipëri në vitet 1925-1939*, (tezë doktore e mbrojtur në QSA, Tiranë, 2012, e pabotuar)
- Gjevori, M.; Batalli, Q., *Dritat tona*, Libër leximi e gjuhe për klasën e III të shkollës fillore, ETMM, Prishtinë, 1988
- Gjevori, M.; Batalli, Q., *Gëzimi im*, Libër leximi e gjuhë për klasën parë të sh.f., ETMM, Prishtinë, 1988.
- Gjevori, M.; Batalli, Q., Libër leximi e gjuhë për klasën parë sh.f., ETMM të KSAK, Prishtinë, 1993.
- Gjevori, M.; Sh. Veliu, B. Kastrati, *Shoku im*, Libër leximi për klasën e I të shkollës fillore, ETMM, Prishtinë, 1985.
- Gjevori, M.; Sh. Veliu, *Zemrat rriten*, Libër për klasën e III të shkollës fillore ETMM të KSAK, Prishtinë, 1976.
- Gjevori, M.; *Kujtime e shënime rreth punës së shkollave të para shqipe në Kosovë gjatë dhe pas Luftës II Botërore*, Prishtinë, 1998
- Gjevori, M.; Shefqet Veliu, Valle rreth botës, Libër leximi për klasën e dytë të sh.f., ETMM - KSKA, Prishtinë, 1980.
- Gjevori, M.; *Si lindën dy abetaret e para shqipe në Kosovë*, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 1/1985
- Gjevori, M.; *Kujtime e shënime rreth punës së shkollave të para shqipe në Kosovë gjatë dhe pas luftës së Dytë Botërore*, Prishtinë, 1998
- Gjevori, M.; *Abetare*, ETMM të KSAK, Prishtinë, 1974.
- Gjevori, M.; *Gjuha e tekstit shkollor ka rëndësi aq sa edhe përmbajtja e tij*, Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe, Simpozium shkencor i mbajtur në Prishtinë më 15, 16, dhe 17 dhjetor 1980, IAP, Prishtinë, 1983.
- Gjevori, M., *Si u hartuan dhe si u pritën dy abetaret e para*, Libri shkollor, Buletin, 1998
- Gjika, K., “*Reforma shkollore dhe mësimdhënia e letërsisë*”, kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore “*Gjuha dhe letërsia në shkollë*”, organizuar nga FHL të UT, Tiranë.
- Gjocaj, Z., *Roli i mësuesit dhe i shkollës shqipe në kohën e Rilindjes Kombëtare “100 vjetori i shkollës shqipe të vashave në Prizren*”, Simpozium shkencor i mbajtur në Prishtinë më 13 nëntor, 1992
- Gjokutaj, M.; Mërkuri, N., *Modele të sukseshme të mësimdhënieje*, Libër mësuesi, Europrint, Tiranë, 2005
- Gjokutaj, M., *Didaktika e gjuhës shqipe*, Shblu, Tiranë, 2012
- Gjokutaj, M.; Rrokaj, Sh.; Krasniqi, I.; Pozhegu, S., *Libër për mësuesin “Abetare”* (Abetare e përbashkët Shqipëri, Kosovë), Pegi&Dukagjini, 2012
- Gjoshi, R., *Gjendja e arsimit gjatë Luftës së Parë Botërore*, Prishtinë, 2014. (Punimi lexuar në Konferencën shkencore “Shqiptarët në LPB”)
- Gjoshi, R., *Disa veçori fonetike në të folmen e Sankocit të Drenicës*, Konferenca ndërkombëtare “Java e shkencës 2014” Prishtinë, 2014
- Gjoshi, R., *Shkolla e parë shqipe-shkolla e Stubllës, Malësia*, 2014
- *Gjuhë shqipe 7*, botimi i parë, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore Kosovë, Prishtinë, 1996.
- Hadri, A., *Lufta Nacional Çirimitare në Kosovë, 1941-1945*, Prishtinë, 1971.
- Hadri, A., *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave*, Prishtinë, 2003
- Hadri, A., *Nardno oslobodilacki odbori na Kosovu, (1941-1945)*, Prishtina, 1976
- Hamiti, S., *Letërsia e vjetër shqiptare-klasa 10*, Botime shkollore, Albas, 2007
- *Histori e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, Botim i ISP, Tiranë, 2001
- *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, vëllimi I, Tiranë, 2003

- *Historia e letërsisë shqiptare*, Rilindja, Prishtinë, 1989
- Hoti, I., “*Mësuesi, njohës dhe praktikues i mirë i gjuhës shqipe*”, Revista “Mësuesi”, Nr.6 (2552), shtator 2010.
- Hoxha, A., *Tekstet mësimore për letërsinë*, AP, Prishtinë, 2009
- Hoxha, E., *Metodika e gjuhës dhe e letërsisë shqipe* (Dispencë për studentët e SHLP) ETMM, KSAK, Prishtinë, 1984
- Hoxha, R., *Libër leximi për klasën I të shkollës fillore*, ETMM të KSAK, Prishtinë, 1977
- Hoxha, M., *Abetare*, ETMM të KSAK, Prishtinë, 1979
- Hudson, R.; Walmsley, J., *The English Patient: English grammar and teaching in the twentieth century*. Journal of Linguistics, 41(3), 2005
- Hyseni, H.; Shatri, B.; Salihaj, J., *Dukagjin Popovci*, Shifra e fakte për arsimin në Kosovë ,Prishtinë , 2000
- Islamaj, Sh., *Konsulta Gjuhesore e Prishtines - marreveshje per njesimin gjuhesor(e shkruar, me rastin e 40 vjetorit të mbajtjes)*, Prishtinë, 2006
- Islamaj, Sh., *Tekstet e gjuhës dhe letërsisë*, IAP, (Nga botimi i veçantë “Letërsia në shkolla dhe në Fakultete”), Prishtinë, 2008
- ISP, Grup autorësh, *Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore*, Tiranë, 2003
- Instituti i Studimeve Pedagogjike, *Historia e Arsimit Shqiptar I*, Tiranë, 1990
- Ihsanglu, E., *Institucionet studimore-shkencore dhe arsimore osmane*, Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetimit osman, vëll. II AIITC, Tiranë, 2009
- Islami, A., *Arsimi në gjuhën shqipe në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë, 2001
- Ismajli, R., *Rreth koncepteve gjuhesore të Luigj Gurakuqit*, Përparimi 1978
- Kanini, I., *Arsimi shqiptar gjatë periudhës 1912-1920*, Tiranë, 2001
- Kanini, I., *Arsimi në vitet e LPB, Zona e pushtimit Austro-Hungarez*, 1916-1918, Tiranë 2001.
- Karadža, M., *Ustavna načela o ravonopravnosti jezika naroda i narodnosti Jugosllavije i njihovo ostvarivanje u praksi saveznih organa i organizacija*, në jezik i nacionalni odnosi, Sveske, Institut za proučavanje nacionalnih odnosa, 5-6 1984 , Sarajevo.
- Kastrati, Sh. Veliu, M. Gjevori, *Libër leximi e gjuhë për klasen parë*, ETMM të KSAK, Prishtinë, 1972.
- Kastrati, Sh. Veliu e M. Gjevori, *Libër Leximi për klasën e parë të shkollës fillore*, Prishtinë, 1965.
- Kastrati, J., *Për historinë e ortografisë shqipe*, Përparimi 1971, nr. 1
- Kastrati, J., *Probleme të normës gramatikore në gramatikat e pasçlirimit*. (Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë. (Materiale të konferencës shkencore të mbajtur në Tiranë më 7-8 dhjetor, 1984.) ASH e RPS të Shqipërisë dhe IGjL, 1988
- Kërhanaj, N., *Abetarja e Zymit*, Zym-Prizren.
- Kisic, U., *Knjizevnoteorijsko i metodicko – didakticke postavke programskih sadrzaja knjizenosto*, Zbornik Institua za Pedagoska istrazivanja, Beograd, 1993, nr.25
- Klooster, D., Preece, A., *Crafting a Pedagogy for Change*, 2002.
- Kodra, K., “*Dy periudhat e letërsisë së sotme shqipe në planprogramet dhe tekstet mësimore të shkollës së mesme*”, në IAP “Letërsia në shkolla e në fakultete”, Prishtinë 2008
- Koliqi, E., *Tregtar flamujsh*, Prishtinë, 1991.
- Koliqi, H., *Shkollat dhe arsimi në Kosovë në vitet 1915 – 1918*, Shkëndija, nr. 4, maj 1994.
- Koliqi, H., *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, Prishtinë ,2002
- Kaleshi, H.; Jürgen, H., *Vilajet i Prizerenit* ,në revisten : “Përparimi”, nr. 3, Prishtinë, 1967

- Kostallari, A., *Gjuha e sotme shqipe dhe disa problem themelore të drejtshkrimit të saj*, ASH të RP të Shqipërisë, IGjL, Tiranë, 1973
- Kostallari, A., Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë: *Gjuha letrare kombëtare shqipe dhe epoka jonë (Materiale të konferencës shkencore të mbajtur në Tiranë më 7-8 Dhjetor 1984)*, Tiranë 1988
- Kostallari, A., *Rreth një pikëpamjeje të De Radës për gjuhën letrare*, SF nr.3,1981
- Kraja, M., *Mati Logoreci*, Tiranë, 1987
- Kraja, M., *Mësuesit për kombin shqiptar*, Tiranë, 1993
- Krasniqi, I., *Bibliografia*, Prishtinë, 2000.
- Krasniqi, I., *Ndihmesa e periodikut pedagogjik në gjuhën shqipe (midis viteve 1945-1978)* zhvillimit të mendimit metodik dhe të praktikës shkollore të mësimit të gjuhës amtare shqipe, Prishtinë, nëntor, 2002.
- Kumnova, M.; Hyseni, M., *Leximi letrar 7*, botimi i tretë, Libri Shkollor, Prishtinë, 2006.
- *Libri i mësuesit për klasën e parë*, Tiranë 1994
- Luarasi, S., *Kongresi II i Manastirit, Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë 1972
- Lllunji, A., *Vështirësitë dhe kontributi i disa veteranëve të arsimit në Kosovë në përshtatjen, në përkthimin dhe në hartimin e tekstit shkollor (1945 - 1970)*. Buletin i Librit shkollor, Prishtinë, 2000
- Malcolm, N., *Kosova -një histori e shkurtër*,Prishtinë-Tiranë,”Koha”,2001
- Malcolm, N., *Kosova-një Histori e shkurtër*,Koha ditore,Prishtinë,1998.
- Malić, J., *Ugraditi u udžbenike sve ono što nas spaja i što nas daje krila za let u bolje sutra*, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 2/1985
- Malić, J., *Koncepcija suvremenog udžbenika*, Zagreb, 1986
- Maloku,Sh., *Kosova tërësi e lashtë gjeografike e politike*, Prishtinë, 1993
- Maskovic, M., *Osvrt na koncepciju i primjenu citanka za I – IV razred osnovne škole*, “ Vaspitanje, obrazovanje ”, Titograd, 1986, nr.3
- MASH-ISP, *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*,(vëllimi I),Tiranë,2003
- *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, (përmbledhje artikujsh nga shtypi). Vëllimi II 1908-1910. Tiranë, 1976
- Matoshi, H., *Tekstet shkollore letrare dhe formimi letrar*, IAP, Prishtinë 2008
- Memushaj, R., *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë, 2006
- Metaj, I., *Agimi pranveror, Libër leximi për klasën e dytë*, sh.f, ETMM- KSAK Prishtinë, 1977
- *Metodika e gjuhës amtare për shkollat normale dhe për mësuesit e shkollës fillore*, Prishtinë, 1971
- Milivoj, C., *Pismene vjezbe i sastavci u mladjim razredima osnovne škole*, /Botim i dytë/, Zagreb, 1975
- *Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR-KEC*,Prishtinë 2003
- Monografi, *Njëzet vjet të Entit të Teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të KSA të Kosovës (1970- 1990)*, Prishtinë, 1990
- Monografia, *Gjergj Fishta jeta dhe vepra*, Tiranë, 1992, f.100.
- Morin, E., *Seven complex lessons in education for the future*, Unitet Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO), Paris, 1999
- Mula, M., *Cilësia e mësimdhënies dhe të nxëniet*, Botim i KEC,Prishtinë,2011
- Musaj, I., *Libri i leximit të klasës së tretë në praktikën pedagogjike (shqyrtim)*, Libri shkollor, Buletini i ETMM të KSAK, Prishtinë, 1989, nr.1,
- Musai, B., *Metodologjia e mësimdhënies*, Tiranë 2003
- Mustafa, A., *Gjurmë ndër vite*, UISHN, Shkup,2014

- Myzyri, H., *Shkollat e para kombëtare*, ISP-Fakulteti i Historiosë dhe i Filologjisë, Tiranë, 1973
- Myzyri, H., *Shkollat e para kombëtare shqipe*, Shtëpia Botuese „8 Nentori”. 1978
- Myzyri, H., *Rilindasit tanë për tekstet shkollore*, “Historia e Arsimit” 2, Tiranë, 2002,
- Myzyri, H., *Arsimi kombëtar shqiptar(1908-1912)*ETMM,1996,Prishtinë
- Obradoviq, M., *Agrarna reforma i kolonizajicja na Kosovu, 1918-1941*, Pristina, 1981
- Ortaili, I., *Organizimi administrative gjatë periudhës së Tanzimatit* (Historia e shtetit,shoqërise dhe qytetrimin osman,vëllimi I,Tiranë,”Koha”,2008)
- Osmani, Sh., etj.: *Leximi 1, për klasën e parë të shkollës fillore*, “Libri shkollor”, Prishtinë,1998
- Osmani, Sh.; Abazi, E.; Demolli, A., *Leximi 2*, Libri shkollor, Prishtinë,1998
- Osmani, Sh.; Kazazi, Nj., *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*, Tiranë, 2000.
- Osmani, Sh., *Reflektse etnopedagogjike I*, SHB “Iromeno”, Tiranë, 1998
- Osmani, Sh., *Fjalori i Pedagogjisë*, Shtëpia botuese “28 Nëntori”,Tiranë 1983
- Osmani, T., *Komisja Letrare e Shkodrës*, Shkodër 2009
- Osmani, T., *Udha e shkronjave shqipe*, Shkodër 1999
- Osmani, T., Çështje të gjuhës letrare shqipe gjatë viteve 1916-1918, “Buletin shkencor”, Shkodër Nr.1, 1987
- Ouellet, A., *L evatoution kreative*,Press de l Univesite du Quebec,Montreal,1983
- Pajaziti, N., *Disa shkarje në tekstet shkollore të letërsisë* (Letërsia në shkolla dhe fakultete), IAP,Prishtinë,2008
- Paralloi, Kontributi i Shkollës Ushtrimore në mendimin pedagogjiko-didaktik shqip. Marrë nga Normalja në traditë , Elbasan, 1995.
- Pavllloviqi, M., *Osnovi metodike nastave srpskohrvatskog jetika i knjizevnosti*(„Bazat e metodikës së mësimin të gjuhës dhe letërsisë sërbo-kroatiste”)
- Pedagogickji sulovar,Moskva,1960
- Pedagogija, redaktor Dr. Pero Šimleša, Zagreb, 1971, fq. 310.
- Perusko, T., *Materinski jezik u osnovnoj skoli*, Zagreb,1962
- Petro, R.; Hyseni, M., *Gjuha shqipe dhe leximi 4*, Albas, Prishtinë, 2006.
- Petro, R.; Kumnova, M., *Gjuha shqipe dhe leximi 3*, Albas, Prishtinë, 2006.
- Pierre, M., *Travailler en Équipe*, Hachette, Paris 1992- Rebac, H., *Nasi muslimani “Juzna Serbija”*, knjiga –II-16.1923
- Pirraku, M.; Salih Gjukë Dukagjini,*Shkrolaria e Shqypes pjesa e parë :teorike dhe praktike*,botoi Kryesia e Bashksisë Islame të Kosovës ,Prishtinës 1991.
- Pirraku, M., *Roli i Kosovës në zgjidhjen përfundimtare të alfabetit kombëtar shqiptar*, “Pashtriku”, Prishtinë, 2012.
- Popoviq, Ç., *Metodika na nastavata po majcin jezik za osnovnite ucilista*, Shkup, 1967
- *Programi i Lëvizjes për Bashkim Kombëtar*, Prishtinë, 2011
- Qosja, R., *Historia e letërsisë shqipe - Romantizmi I-II III* (1984-1986).
- Qosja, R., *Letërsia shqipe në shkolla dhe fakultete*, IAP, Prishtinë, 2008.
- Qosja, R., *Strategji e bashkimit shqiptar*,Toena,Tiranë,1998
- QTKA, Mësimdhënia me në qendër nxënësin, Tiranë, 2005
- Rade, V., *Dvadesetpet godina “Savremene skole” -“Pedagogogue”*, bibliografija / 1946-1970/, Beograd,1971
- Rahimi, Sh., *Vilajeti i Kosovës*, Prishtinë, 1969

- Raka, F., Sami Frashëri dhe shqipja e shkruar, Vëzhgime rreth shqipes së shkruar, Prishtinë 2009
- Raka, F., *Teoritë për standardizimin e shqipes, Normëzimi i shqipes ndër shekuj*, Prishtinë. 2004
- Ramaj, A., *Formësimi didaktik i lëndës në tekstin mësimor*, LSH, Prishtinë 2001
- Redjepagic, J., *Skolstvo i prosveta na Kosovu od kraja XVIII Stoleca do 1918 godine*, Prishtina, 1974.
- Ramaj, A., *Qasje analitiko – komparative nocionit – tekst mësimor*, Shkolla e Lartë Pedagogjike, 40 vjetori 1958- 1998 - *Përmbledhje punimesh*, Prishtinë, 1998
- Redjepagic, J., *Citanke i citaonice na Kosovu*, Libri shkollor, Buletin i ETMM i KSAK, Prishtinë, 1985, nr.2
- Redjepagic, J., *Školstvo i Prosveta u Kosovskoj Mitrovici i Okolini od druge polovine 19. veka do 1975. godine*, Studime (ASHAK), Prishtinë, 1980
- Redjepagic, J., *Tema të zgjedhura pedagogjike*, Shkup, 1972
- Redjepagic, J., *Zhvillimi i arsimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*, Prishtinë, 1970
- Rexhepi, N., *Letërsia shqipe në tekstet shkollore të Kosovës (1945-1990)*, Logos, Prishtinë, 2002
- Rizaj, S., *Shqiptarët dhe Serbët në Kosovë, Zëri, Prishtinë 1991*
- Rosandic, D., *Metodicke osnovne suvremene nastave hrvatskog ili srpskog jezika i njizevnosti u srednoj skoli*, Skolska kniga, Zagreb, f.8.
- Rushiti, L., *Lëvizja Kaçake në Kosovë*, 1978, Prishtinë
- *Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe*, 1973, Prishtinë.
- *Rregullat e pikësimit në gjuhën letrare shqipe* (projekt) Tiranë, 1981
- Rrota, J., *Për historinë e alfabetit shqyp*, Shkodër, 1935
- Sekulic, P., *Kako organizovati skolskih i nastavnickih biblioteka*, Pedagoska stvarnost, Novi sad, 1964
- Simović, R., *Politika obrazovanja i njena realizacija u SR Srbiji*, Beograd, 1990
- *Standardet e raportimit për procesin e vlerësimit DVSM*. Prishtinë 2013.
- *Standardet e vlerësimit të nxënësve DVSM-USAID/ MASHT/ 2011*, Prishtinë.
- *Statistički godishnjak*, Kosova, 1989, Prishtinë, 1989
- Stipčević, A., *Povijest knjige*, Zagreb, 1985
- Sulstarova, E., *Naum Veqilharxhi dhe lindja e kombit*, Tiranë, 2012
- Syla, Xh., *Leximi 5*, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Libri Shkollor, Prishtinë, 2007.
- Syla, Xh., *Leximi 4*, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Libri Shkollor, Prishtinë, 2006.
- Syla, Xh., *Veprimtaria e Entit të teksteve dhe të Mjeteve Mësimore të Kosovës gjatë periudhës 1991-1997*, Libri Shkollor, 1/2000
- Shashaj, A., *Metodikë e Mësimimit të Gjuhës Amtare*, Tiranë: ADA, 2007
- Shatri, B., *Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX* (sfida, dëshmi, fakte) I-II, Libri shkollor, Prishtinë, 2006
- Shkodra, F., *Kriteret e përfaqësimit artistik e pedagogjik te letyrës shkollore në shkollat fillore*, IAP, Prishtinë, 2008
- Shehu, F.; Shehu, S., *Pastrimet etnike të trojeve shqiptare 1953 –1954*, Prishtinë, 1993
- Shema, I.; Rugova, I.; Morina, T., *Vlerësimi ideoestetik i librave të leximit të ciklit të ultë dhe të lartë të shkollës fillore*, Libri shkollor, Buletin i ETMM të KSAK, Prishtinë, 1982
- Shema, I., *Çështje të arsimit kombëtar shqiptar*, Libri shkollor, Prishtinë, 2000

- Shimlesha, P., *Pedagogjia II*, Prishtinë, 1977
- Shita, V., *Nga abetarja deri të tekstet universitare*, "Libri Shkollor", Prishtinë, 1/1985
- Shuteriqi, Dh., *Shkrimet e para në gjuhën shqipe 1332*,"Rilindja"Prishtinë, 1982.
- Temo, S., *Aleksandër Xhuvani-psikolog dhe mendimtar i shquar shqiptar*, Tiranë, 1984
- Tezak, S., *Vokativ jednine imenica E vrste*, Radovi zavoda za slavensku filologiju, 7. Zagreb, 1998.
- Tezak, S., *Teoija i praksa nastave hrvatskog jezika I*, Zagreb, 1996
- Tone, P., *Materinski jezik u obaveznoj skoli /Specijalna didaktika/*, Zagreb, 1964
- Tone, P., *Pet godina "Školske novina"*, bibliografija, Zagreb, 1955
- Ukaj, S., *Kuadri arsimor shqiptar në Kosovë në shënjestrën e sigurimit shtetëror (1945 – 1952*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1986)
- UTSH, *Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë*, Historia e letërsisë shqipe, Tiranë, 1959
- Vasili, J.; Luli, F.; Radovicka, I., *Metodika e letërsisë dhe e leximit letrar*, Tiranë, 1971
- Velju, Sh.; Gjevorci, M., *Këngë ngadhënjimi*, Libër leximi për klasën e III të shkollës fillore, ETMM, Prishtinë, 1985
- Veseli, A., *Shkollat dhe arsimit shqip në Prefekturën e Prishtinës, 1941-1944 II*, Gjilan, 2003
- Vokri, A., *Shkollat dhe arsimit në anën e Llapit brenda viteve 1878 – 1944*, Prishtinë, 1995
- Vladeta, T., *Nastava i vaspitanje*, bibliografija /1952- 1965/, Beograd, 1966
- Vokri, A., *Ibrahim Kolçi mësues dhe patriot*, Prishtinë, 1993
- Vokri, A., *"Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore" (1918-1941)*, Prishtinë, 1990
- Vokri, A., *Zhvillimi i shkollave - arsimit në komunën e Mitrovicës (1945- 75)*, Prishtinë, 1981
- Xhuvani, A., *Për themelimin të një gjuhe letrare*, Tiranë, 1905
- Zabeli, N., *Ndikimi i Palneve dhe Programeve mësimore dhe tekste vet ë gjuhës e letërsisë shqipe te kl.I-IV të shkollës fillore në kultivimin e edukimit kombëtar gjatë 1974-1998*, Fakulteti Filozofik, UP, Prishtinë, 2001. (*Magjistratura-tekst i pabotuar*).
- Zajazi, T., *Metodologji të mësimdhënies dhe mësimnxënies*, Shkup, 2003
- Zajmi, T., *Tallazat e jetës dhe lotët e zemrës*, Bruksel, 1970.
- Zeneli, I., *Bazat e standardizimit dhe vlerësimit në arsim*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2002
- Zogaj, A.; Shala, B., *Dëshmi për Kosovën 1989-1991*, Prishtinë, 1995
- Zujev, D., *Školski udžbenik*, Beograd, 1988
- Zylfiu, Nj., *Didaktika*, Prishtinë 2001

Arkivi

- AJ,f.MP,fig.66,k.59,pov.1969/13-III-1925; pov.7,k 13, 1923 pov. 129/24-II-1924; pov. 606/22-VIII-1927
- AJ,F.MP,fig.66/ON,f.39;d.br.3094/15-X-,fond u sredjivanje
- AJ,f.MP,ON. Iz inspektora skole Kosovske Oblasti poslat Ministarstvu Prosvete u Beogradu 1923
- AJ,f.MP,pov.arihv,fig.66,k.22;pov.br.131/13-X-1934
- AJ,f.MP.f.464;d.br.485/20-IV-1929
- AJ,Ministri i drejtësisë, Zakon o nazivu i dodeli krajlevine na upravna podrucja sa zakonom o banskoj upravi, Beograd 1930.
- AJ.F.MP,F.300,d.377/3.III.1920,kao I fik. 91/95;d.br.21/4-X-1919
- AJ.F.MP.Pov.d.66.k.59.d.poc.169,d.poc.169.d.pov.2;d.pov.270,
- AJ.fig.14.f.102-409, Telegramsko odeljenje o kocackoj aktivnosti na Kosovu
- AQSH, Fondi 295, dosja 112.
- AQSh, fondi 847, viti 1916, dosja 9, faqe 2,
- AQSH,Fondi 295,viti 1941,dosja 16,fleta 8.
- AQSH,fondi 295,viti 1941,dosja 180,fleta 7 dhe 8.
- AQSH,fondi 295,viti 1941,dosja 27,fleta 48.
- AQSH. Fondi 195 i Arsimit 195. Viti 1919. Dosja 56, faqe 7-10
- AQSh.Fondi 847, viti 1916, dosja 6, faqe 5.
- Arkivi i Kosovës, fondi: Tekstet shkollore, kutia 1-6.
- ASHKP - “Fondi i Alfabetit”, fotokopje
- DASIP,DNZ,Sig,89,f.15,D.II.,d. POC.339/1919.
- Dekreti Mëkambësuer nr.43 të 28 shkurtit 1942 të Ministrisë së Arsimit të Shqipërisë.
- Socjalistika zora, nr.1.1920. AJ.MUP.fig.14.Kriminalna statistika, viti 1919-1922; Qarkorja e Ministrisë së Arsimit, Nr. 971-118, datë 13.VI.1941-XIX

SHTYPI DHE REVISTAT

- "Arësimi popullor", Tiranë, 1971, nr. 4
- “Arësim popullor”, Tiranë, 1952, nr. 7
- “Arësimi dhe kultura popullore” Tiranë, 1954, nr. 8
- “Arësimi popullor”, Tiranë, 1948, nr. 6
- “Arësimi popullor ”, Tiranë, 1953, nr. 10
- “Arësimi popullor”, Tiranë, 1963, nr. 6
- “Buletini”, Prishtinë, 1962, nr. 3-4
- Buletin i Fakultetit Filozofik,UP, Prishtinë, 1989, nr. XVIII – XIX
- *Buletini i shkencave* (Tiranë), *BUSHT* (Tiranë),
- Buletini” i Fakultetit Filozofik në Prishtinë, 1980, nr. XIV, nr. XV
- Educologia,nr.5,Prishtinë,2011
- “Fletore zyrtare e KSAK” Prishtinë, 1970, numër 3/70.
- *Gazeta “55”*, Tiranë, 14 -26 nëntor 2008

- Gazeta “Hak”,nr.709,26 janar, 1924
- Gazeta “Kombi”e 1 janarit të vitit 1909.
- Gazeta “Korça”nr.8,Korçë,20 mars 1909
- Gazeta “Kosova”, Tiranë,1941,nr.16
- Gazeta “Përlindja e Shqipënisë”, 24.08.1913
- Gazeta ”Rilindja”,9 nëntor 1988,Prishtinë
- Gazeta “ Zëri ”, 29.07.1994.
- Gazeta “Zëri”, Prishtinë 1991
- Gazeta”Shqipëria” e Bukureshtit ,më 30 gusht 1897.
- Gazeta”Zëri”, 15 qershor 1991
- Konferenca ndërkombëtare ”Java e shkencës 2014”Prishtinë,2014.
- Libri shkollor, Buletin i ETMM i KSAK, Prishtinë, 1973, nr. 1-2
- Libri shkollor, Buletin i ETMM i KSAK, Prishtinë, 1985, nr.2
- Libri shkollor, Buletin, 1998, nr. 1-2
- Librit shkollor, Buletin , Prishtinë, 2000, nr.1
- Ligji i arsimit dhe edukimit të Jugosllavisë RS Serbisë 1989
- MASHT,Standardet e Praktikës Profesionale,Prishtinë,2011.
- MASHT: Kornizës së Re të Kurikut të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës,Prishtinë,2011.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & GIZ IS (2012)
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & SËAP (2012): *Udhëzues për mësimdhënës për përmirësimin e praktikave në klasë, Prishtinë.*
- Narodni Odbor opstine Pristina, Odsek za prosvetu i kulturu, 06/1 br. 18035, 16 avgusta 1962 godina: Zaključke Saveta za prosvetu NRS, o izmeni programa.
- Plan program i njësuar i punës edukative – arsimore në shkollën fillore.ETMM i KSAK, Prishtinë, 1989
- Planet dhe programet mësimore për shkolla fillore dhe të mesme,ETMM i KSAK , Prishtinë 1974.
- Plani dhe programa mësimore për shkollat fillore shqipe për vitin shkolluer 1948-49, Prishtinë,1949
- Plani dhe programi i gjuhës dhe letërsisë shqipe ,1982.
- Plani dhe programi i gjuhës shqipe ,Pleqësia Krahinore e Arsimit të KSA ,më 24 shtatore 1971.
- Plani dhe Programi mësimor i Gjuhës shqipe për shkollën fillore,i vitit 1971.
- Plani dhe programi mësimor për gjuhën i gjuhës shqipë për klasën e VII dhe VII-të të shkollave fillore,1964.
- Plani dhe programi mësimor për shkollën fillore,KSAKM,1964.
- Plani dhe programi unik i punës arsimore-edukative në shkollën fillore për KSAK, Prishtinë, 1977.
- Plani i ri mësimor i pasluftës në Kosovë për lëndën gjuhë shqipe 1945-1946.
- Pleqësia e Arsimit e KSAK, Plan-programi i punës edukativo-arsimore në sh. fillore, Prishtinë, 1990

- Predlog zajednickog programskog jezgra maternjeg jezika i knjizevnosti u sonovnim i srednjem usmerenom obrazovanju i vaspitanju u SFRJ(peta-radna verzija),Beograd,februar 1986
- Programi i gjuhës shqipe, 1914.
- Programi i gjuhës shqipe,për shkollën fillore 1945.
- “Pedagoski rad”, Zagreb, 1958, nr. 1-2
- “Revista pedagogjike”, Tiranë, 1975, nr. 1
- Revista "Mësuesi" Tiranë,2012.
- Revista „Shkëndija” nr. 15-16 ,më 15 tetor 1978.
- Revista „Shkëndija”nr 17-18 ,më 20 nëntor,Prishtinë,1973.
- Revista ”Mësuesi”, Tiranë, 1973, nr. 16
- Revista ”Shkëndija”, Prishtinë, 1974, nr. 12
- Revista ”Shkëndija”, Prishtinë, 1974, nr. 9-10
- Revista “Leka” - Numër i veçantë. Shkodër më 1942, për Vitin XII/1940
- Revista “NIN” e 17 prillit 1983
- Revista “Perparimi” 1946-1972
- Revista “Perparimi”, Prishtinë, 1966, nr. 4
- Revista “Përparimi”, nr.1,1970
- Revista “Përparimi”, Prishtinë, 1959, nr. 7-8
- Revista “Përparimi”, Prishtinë, 1967, nr. 2
- Revista “Shkëndija”, janar, 4/1992
- Revista “Shkëndija”, nëntor 1990.
- Revista “Shkëndija”, Prishtinë, 1971, nr. 6
- Revista “Shkëndija”, Prishtinë, 1974, nr. 18-19.
- Revista “Shkëndija”, Prishtinë, 1975, nr. 5-6
- Revista “Shkëndija”, Prishtinë, 1976, nr. 6
- Revista “Shkëndija”, shtator, 1990
- Revista “Shkëndija”, shtator, 1990.
- Revista pedagogjike “Shkëndija”,nr.17, më 15 tetor 1977
- Revista pedagogjike„ Shkëndija” ,nr. 21,më 15 dhjetor 1977 .
- Revista Shkëndija”, Prishtinë, 1975, nr. 17
- Revista„Shkëndija” nr. 15—16 , 1 nëntor 1975.
- Revista”Shkëndija”, Prishtinë, 1971, nr.4
- Revista”Shkëndija”, Prishtinë, 1972, nr. 5
- Revista”Shkëndija”, Prishtinë, 1973, nr. 13
- Revista”Shkëndija”, Prishtinë, 1977,nr. 15
- Revista “Mësuesi i Kosovës”,maj 2012,Prishtinë
- Revista“Shkëndija”, 1 qershor 1990
- Revista“Shkëndija”, janar, 4/1992
- Revista“Shkëndija”, Prishtinë, 1981, nr. 5
- Revista“Shkëndija”,nr. 18 ,më 1 nëntor 1977 .
- Revista“Shqipëria”e Bukuresht ,30 gushtit 1897.
- Revista” Shkëndija” 20 shtator 1990.

Ragip GJOSHI MËSIMDHËNIA E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË
(Nga Rilindja Kombëtare deri në ditët e sotme)

- Revista” Shkëndija”, nr. 4, maj 1994.
- Revista”Përparimi”, 1960, nr. 1-2
- Revista”Shkëndija”, 1 qershor 1990
- Revista”Shkëndija”,1 maj 1990
- Revista”Shkëndija”nr.20,Prishtinë,më 15 dhjetor 1978.
- *Revista,,Kosova”, 24 maj 1941*
- Revista,,Zani i Naltë, nr. 11, Nanduer 1937
- Rregullat e pikësimit në gjuhën letrare shqipe(projekt)Tiranë,1981
- Standardet e raportimit për procesin e vlerësimit DVSM. Prishtinë 2013
- Standardet e vlerësimit të nxënësve DVSM-USAID/ MASHT/ 2011, Prishtinë
- *Statistiçki godishnjak, Kosova,1989, Prishtinë, 1989*
- Udhëzimet didaktike nga Plani e programi mësimor për gjuhën shqipe të vitit 1971, Prishtinë, 1971.

BURIME NGA INTERNETI

<http://www.home.no/dukagjin/Lidhja%20Prizrenit%20II.html>.

<http://modersmal.skolverket.se>

Abstrakt

MËSIMDHËNIA E GJUHËS SHQIPE NË KOSOVË (Nga periudha e Rilindjes Kombëtare deri në ditët e sotme)

Punimi “*Mësimdhënia e gjuhës shqipe në Kosovë*”, (nga Rilindja Kombëtare Shqiptare deri në ditët e sotme), është një përpjekje e orientuar në përshkrimin dhe pasqyrimin e rrugës së gjatë e të mundimshme të brezave të tërë, që punuan për çështjen kombëtare, arsimin në gjuhën shqipe dhe kultivimin e gjuhës shqipe. Ky studim, paraqet fakte, të munguara deri tashti, nga këndvështrimi shkencor për trajtimin e problemeve didaktike dhe metodike në mësimdhënien e gjuhës shqipe, kryesisht në arsimin parauniversitar. Si një përpjekje për të hedhur dritë mbi këtë periudhë të errët të arsimit shqip në Kosovë e për të pasqyruar informacione, nga këndvështrimi didaktik për gjuhën shqipe dhe shkollën shqipe, ai gjithashtu vjen si një trajtesë nga këndvështrime të ndryshme sipas elementeve të mësimdhënies së gjuhës shqipe, së bashku me jehonën e reformave, me ndikimet që ato patën në krijimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve në Kosovë. Metodatat e kërkimit për këtë studim, cilësore dhe sasiore, vjelja e një bibliografie sa të hershme aq dhe të sotme ka qenë një ndër pikësnyimet kryesore për të bërë një trajtim hulumtues, kërkues, zbatues dhe origjinal në fushën e historisë së arsimit. Hulumtimet kryesisht mbështeten në literaturë dhe burime arkivore, të vjetra e të reja, që i është kushtuar mësimin të gjuhës shqipe në shkollën e Kosovës. Tekstet mësimore, të konsultuara, i përkasin gjysmës së dytë të shekullit XIX e deri tek tekstet bashkëkohore të ditëve të sotme. Ndërsa planet dhe programet mësimore, të analizuara, vijnë nga viti 1914 e deri te Kurrikulum i vitit 2011.

Fjalë kyçe: abetare, gjuhë shqipe, kurrikul, mësimdhënie, reformë arsimore, tekste shkollore, unifikim

Abstract

TEACHING OF ALBANIAN LANGUAGE IN KOSOVO (From the period of National)

The paper “*Teaching of Albanian Language in Kosovo*” (From the period of National Renaissance until today) is an oriented effort in the long and tiring way of whole generations, who worked for the national issue, education on albanian language and the cultivation of albanian language. This study presents facts, missed till now, from a scientific view for the treatment of the didactic and methodic problems in albanian language teaching, especially in high school education. As an effort to light on this dusk period of albanian education in Kosovo and to present informations, form a didactic view for albanian language and school, it also comes as a treatment in different views according to albanian language elements, together with the echo of reforms, with the influence they had on the creation of the national identity of albanians in Kosovo. The research methods for this study, qualitative and quantitative, the old and contemporary bibliography has been one of the principal purpose to make an investigated study, researcher, applied and original in the field of education history. The researches are based on litterary and archive resources, old and new, dedicated to albanian language learning in Kosovo’ schools. The textbooks used for this study belong to the second half of XIX-th century until contemporary textbooks used nowadays. The plans and programes analysed are from the year 1914 till the Curriculum of the year 2011.

Key words: ABC book, Albanian language, curriculum, teaching, education reform, school textbooks, unification